



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë - Akademija Pravde - Academy of Justice

Modulet e trajnimit bazik për bashkëpunëtorët profesional

(Civile-materiale dhe procedurale)

Prishtinë, 2021



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

**Modulet e trajnimit bazik për bashkëpunëtorët profesional
(Civile-materiale dhe procedurale)**

I publikuar nga

Akademia e Drejtësisë

Autorët:

Albert Zogaj, gjyqtar në Gjykatën Supreme të Kosovës

Fejzullah Rexhepi, gjyqtar në Gjykatën Supreme të Kosovës

Zenel Leku, gjyqtar në Gjykatën e Apelit

Faton Ademi, gjyqtar në Gjykatën e Apelit

Valon Totaj, gjyqtar në Gjykatën e Apelit

Hartimi i këtij Manuali është mbështetur nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë, ndërkaq shtypja dhe publikimi nga Akademia e Drejtësisë.

Mohim:

Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim (Modul), janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet zyrtare të Akademisë së Drejtësisë dhe UNDP-së.

Të drejtat e autorit

Të drejtat e autorit për materialet e krijuara nga autorët janë të rezervuara. Nuk lejohet kopjimi/dyfishimi i materialit pa pëlqimin e Akademisë së Drejtësisë dhe autorëve. Nëse ndonjë pjesë apo shprehje individuale në tekst nuk është e ligjshme apo korrekte, përmbajtja apo vlefshmëria e pjesëve të tjera mbetet e paprekur nga ky fakt. Akademia e Drejtësisë mund ta bëjë kopjimin e materialit për nevojat e zbatimit të mandatit të vet ligjor, pa marrë pëlqimin e autorëve.

© 2021 Autorët dhe Akademia e Drejtësisë

Shtypur në Prishtinë

Tetor, 2021

PARATHËNJE

Të nderuar,

Trajnimet për sistemin gjyqësor janë një element thelbësor dhe parakusht për një sistem efikas të drejtësisë, për më shumë është garanci për zhvillim të vazhdueshëm në ushtrimin e kompetencës, ruajtjen dhe forcimin e pavarësisë gjyqësore, ngritjen e llogaridhënies dhe fitimin e besimit të publikut. Ngritja e vazhdueshme profesionale është parakusht themelor për ngritjen e performacës së sistemit gjyqësor e prokurorial në zbatimin e efikas të standardeve për sundimin e ligjit.

Në arritjen e këtij synimi, sistemi gjyqësor dhe prokurorial në Kosovë gjatë punës së tyre ballafaqohet me vështirësi dhe sfida të shumta, duke përfshirë aspektin e ndryshimeve të shpeshta legjislativë, aspektin e praktikës gjyqësore, po ashtu edhe çështjet të tjera të cilat janë duke reflektuar në imazhin e gjyqësorit dhe në besimin e publikut. Andaj, disa nga këto sfida Akademia e Drejtësisë, bazuar në mandatin e saj ligjor, është përkushtuar në zhvillimin e kapaciteteve të sistemit gjyqësor dhe prokurorial, dhe atë nëpërmes programeve të saj trajnuese të dizajnuara veçanërisht për gjyqtarë dhe prokurorë të sapo emëruar, gjyqtarë dhe prokurorë në detyrë, për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial, si dhe profesionistët e tjerë ligjor.

Nisur nga ky këndvështrim, Akademia e Drejtësisë në vazhden e realizimit të Programit Trajnues Kornizë të trajnimeve si të paraparë për vitet 2021-2022, ka vlerësuar rëndësinë e posaçme për pozitën dhe rolin e bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor në ofrimin dhe mebeshtejn e vazhdueshme profesionale për gjyqtarët, prokurorët, dhe sistemin e drejtësisë në përgjithësi. Në këtë kontekst, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me ekspertet nga sistemi gjyqësor dhe në mbështetje të donatoreve, ka kënaqësinë që nëpërmes këtijë publikimi të prezantojë modulet për trajnim bazik të bashkëpunëtorëve profesional në fushën e drejtësisë penale dhe civile gjithashtu. Modulet trajnuese sikurse të prezantuara në këto publikime, janë ndarë në dy pjesë dhe përfshijnë aspektin material dhe procedural në fushën e drejtësisë penale dhe civile, duke përfshirë edhe forma të vendimeve gjyqësore për çështje të ndryshme ligjore.

Akademia e Drejtësisë është mirënjohëse dhe falënderuese ndaj eksperteve gjyqtarë që kanë punuar në zhvillimin e përmbajtjes së moduleve trajnuese bazike si në fushën civile ashtu edhe penale duke ofruar ekspertizën e tyre profesionale. Gjithashtu një falënderim i veçantë edhe për projektin e UNDP-së për *Sundimin e ligjit* dhe projektin SAEK që kanë mbështetur hartimin e moduleve trajnuese bazike. Ndërsa, mirnjohje e veçantë për OSBE-në që ndihmuan në përkthimin në gjuhën serbe të moduleve trajnuese bazike nga fusha penale, për bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjor nga ky komunitet.

Me respekt,

Enver Fejzullahu

Drejtor Ekzekutiv, Akademia e Drejtësisë

Përmbajtja

| | |
|--|----|
| PARATHËNJE | 3 |
| DHUNA NË FAMILJE | 17 |
| Parandalimi i dhunës në familje..... | 18 |
| Përkufizimi i dhunës në familje sipas LMDHF | 22 |
| Masat mbrojtëse sipas Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje | 27 |
| Masa mbrojtëse e trajtimit psikosocial e kryesit të dhunës në familje | 27 |
| Masat mbrojtëse të ndalimit të afrimit të viktimës së dhunës në familje..... | 31 |
| Masa mbrojtëse e ndalimit të shqetësimit të personave të ekspozuar dhunës | 33 |
| Masa e Kujdestarisë së Përkohshme të Fëmijës | 34 |
| Masa mbrojtëse e largimit nga banesa, shtëpia apo hapësira tjetër e banimit | 36 |
| Masa mbrojtëse e shoqërimit të viktimës së dhunës në familje | 38 |
| Masa mbrojtëse e trajtimit mjekësor nga varësia prej alkoolit dhe substancave psikotrope..... | 41 |
| Masa mbrojtëse e marrjes së sendit..... | 45 |
| Masat mbrojtëse pasurore | 46 |
| Masa e urdhërimit të kryerësit të dhunës që të lejoj palën e mbrojtur që ta shfrytëzoj banesën të cilën e përdornin së bashku ose një pjesë të saj..... | 47 |
| Masa mbrojtëse e urdhërimit të kryerësit të dhunës në familje që të paguajë qiranë e banesës së përkohshme të palës së mbrojtur ose të paguajë alimentacionin për palën e mbrojtur dhe për fëmijë, për të cilin kryerësi i dhunës në familje ka obligim për ta mbajtur | 49 |
| Ndalimi i kryerësit të dhunës në familje ose palës së mbrojtur, bartjen si dhe çdo lloj transaksioni të çfarëdo pasurie brenda një periudhe të caktuar kohore..... | 52 |
| Ofrimi i mundsisë së palës së mbrojtur, që vetëm ajo të posedojë dhe të shfrytëzojë pasurinë e caktuar personale të saj..... | 54 |
| Caktimi i ndonjë mase tjetër që është e domosdoshme për të mbrojtur sigurinë, shëndetin ose mirëqenien e palës së mbrojtur apo personit me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare..... | 55 |
| Masa e urdhërimit të kryerësit të dhunës në familje që palës së mbrojtur t'i lejohet kthimi ne shtëpi.... | 56 |
| Inicimi i procedurës për mbrojtje nga dhuna në familje | 57 |
| Kërkesa për urdhër mbrojtje, urdhër mbrojtje emergjente ose urdhër mbrojtje të përkohshme emergjente..... | 57 |
| Kush mund ta paraqes kërkesën për urdhër mbrojtje të përkohshme emergjente?..... | 57 |
| Kush mund të paraqes kërkesën për urdhërmbrojtje emergjente? | 57 |

| | |
|--|-----------|
| Kush mund të paraqes kërkesën për urdhërmbrojtje?..... | 58 |
| Çka duhet të përmbaj kërkesa për urdhër mbrojtje ose urdhërmbrojtje emergjente? | 59 |
| Urdhri për mbrojtjen e përkohshme emergjente | 59 |
| Shqyrtimi i kërkesës për urdhër mbrojtje emergjente | 60 |
| Ndryshimi, ndërprerja dhe vazhdimi i urdhër mbrojtjes emergjente | 61 |
| Shqyrtimi i kërkesës për urdhër mbrojtje | 62 |
| Çka duhet të përmbaj urdhëri për mbrojtje? | 63 |
| E drejta për ankesë kundër vendimit për urdhër mbrojtje..... | 66 |
| Shkelja e urdhërit mbrojtës | 66 |
| Kush e zbaton urdhrin për mbrojtje?..... | 66 |
| Ndryshimi, ndërprerja dhe vazhdimi i urdhër mbrojtjes | 67 |
| Mbrojtja e fëmijëve të rastet e lëshimit të urdhërmbrojtjes dhe urdhërmbrojtjes emergjente | 67 |
| E DREJTA E TRASHËGIMISË | 70 |
| Objekti i trashëgimisë | 71 |
| Veçimi i sendeve nga pasuria trashëgimore | 71 |
| Barazia në trashëgimi..... | 72 |
| Trashëgimia në bazë të ligjit | 72 |
| Trashëgimtarët ligjor..... | 73 |
| Radhët e trashëgimisë | 74 |
| Radha e parë e trashëgimisë..... | 74 |
| Radha e dytë e trashëgimisë..... | 75 |
| Radha e tretë e trashëgimisë | 77 |
| Komuna si trashëgimtarë ligjor..... | 78 |
| Trashëgimia në bazë të testamenti..... | 78 |
| Zotësia për të përpiluar testamentin..... | 78 |
| Llojet e testamentit..... | 79 |
| Karakteristikat e testamentit | 80 |
| Revokimi i testamentit..... | 81 |
| Shkaqet kryesore mbi pa vlefshmërinë e testamentit..... | 81 |
| Testamenti absolut nul | 82 |
| Testamenti relativ nul | 82 |
| Përmbajtja e testamentit..... | 82 |

| | |
|--|-----|
| Ruajtja e testamentit | 83 |
| Legu..... | 83 |
| Pjesa e domosdoshme | 83 |
| Trashëgimtarët e domosdoshëm..... | 83 |
| Llogaritja e pjesës së domosdoshme | 84 |
| Inventarizimi i pasurisë trashëgimore | 84 |
| Veçimi i sendeve të shtëpisë..... | 86 |
| Cenimi i pjesës së domosdoshme | 86 |
| Radha e zvogëlimit dhe e kthimit | 86 |
| E drejta e kërkesë për zvogëlimin e disponimeve me testament dhe kthimin e dhurimeve | 86 |
| Zvogëlimi i legut të privilegjuar..... | 99 |
| Zvogëlimi proporcional i legeve..... | 99 |
| Llogaritja e dhurimeve dhe legëve në pjesën trashëgimore | 99 |
| Si bëhet llogaritja e dhuratave dhe legeve në pjesën trashëgimore | 100 |
| Rastet nga praktika gjyqësore lidhur me cenimin e të drejtës në trashëgimi | 100 |
| Padenjësia për të trashëguar | 102 |
| Vlerësimi i padenjësisë | 102 |
| Përrjashtimi nga trashëgimia e trashëgimtarit të domosdoshëm | 103 |
| Procedura për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore | 103 |
| Kompetenca vendore..... | 103 |
| Kompetenca lëndore..... | 104 |
| Kompetenca ndërkombëtare..... | 104 |
| Përgatitja e seancës trashëgimore..... | 104 |
| Hartimi i dëshmisë së vdekjes..... | 105 |
| Masat e përkohshme për sigurimin e pasurisë trashëgimore | 105 |
| Inventarizimi dhe vlerësimi i pasurisë së trashëgimlënësit | 105 |
| Veprimi lidhur me testamentin..... | 106 |
| Përmbajtja e procesverbalit për shpalljen e testamentit të shkruar | 107 |
| Në rastet kur i vdekuri ka bërë testament gojorë verbal..... | 107 |
| Koha e hapjes së trashëgimisë..... | 108 |
| Vendi i hapjes së trashëgimisë..... | 108 |
| Seanca për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore | 109 |

| | |
|--|-----|
| Seanca informuese..... | 110 |
| Seanca e shqyrtimi kryesorë | 110 |
| Udhëzim i palëve në kontest civil | 111 |
| Udhëzim në kontest për shkak të konfliktit rreth të drejtës apo aplikimi të së drejtës | 111 |
| Aktvendimi mbi trashëgiminë..... | 112 |
| Pasuria e gjetur pasi që aktvendimi për trashëgimi ta ketë marrë formën e prerë | 116 |
| Gjetja e testamentit pasi që aktvendimi për trashëgimi ta ketë marrë formën e prerë..... | 118 |
| Cedimi dhe ndarja e pasurisë në përgjithësi..... | 119 |
| Kushtet për vlefshmërinë e cedimit dhe pjesëtimit | 119 |
| Objekti i cedimit dhe pjesëtimit dhe përjashtimi i pasurisë së ceduar nga pasuria trashëgimore | 119 |
| Kur konsiderohet pjesa e ceduar si dhurim | 120 |
| Shuarja kontratës mbi cedimin dhe pjesëtimin e pasurisë..... | 120 |
| Të drejtat e trashëgimtarëve pas shuarjes së kontratës | 120 |
| E DREJTA FAMILJARE..... | 121 |
| Procedura e zgjidhjes së kontesteve martesore | 122 |
| Parimet e procedurës në kontestet martesore | 122 |
| Kompetenca e gjykatës në konteste martesore | 124 |
| Fillimi i procedurës për zgjidhjen e martesës | 124 |
| Procedura e zgjidhjes së martesës me anulim..... | 124 |
| Procedura e zgjidhjes së martesës me shkurorëzim..... | 126 |
| Fazat e procedurës së shkurorëzimit | 129 |
| Masat e përkohshme | 130 |
| Mënyra e vendosjes ne procedurën e shkurorëzimit | 131 |
| Mjetet e goditjes në kontestet martesore..... | 136 |
| Mjete e zakonshme të goditjes..... | 136 |
| Mjetet e jashtëzakonshme të goditjes..... | 136 |
| FORMAT E VEÇANTA TË MBROTJES SË FËMIJËVE PA KUJDES PRINDËROR | 137 |
| Birësimi (Adoptimi) | 137 |
| Llojet e birësimit | 137 |
| Themelimi i birësimit | 138 |
| Shuarja e birësimit | 139 |
| Vendosja e organizuar në familje | 140 |

| | |
|--|------------|
| Të drejtat dhe detyrimet e prindërve | 140 |
| Të drejtat dhe detyrimet e familjes, e cila bën pranimin e vendosjes së fëmijës në familje | 141 |
| Kompetenca ligjore për vendosje | 141 |
| Përfundimi i vendosjes së fëmijës në familje..... | 142 |
| Kujdestaria | 142 |
| Organi i kujdestarisë | 143 |
| Mënyrat e ushtrimit të kujdestarisë | 144 |
| Kujdestari | 145 |
| Kujdestaria ndaj të miturve | 146 |
| Kujdestaria për raste të veçanta | 149 |
| MBROJTJA E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE NË KONTESTET MARTESORE – FAMILJARE | 150 |
| Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve gjatë procedurës së shkurorëzimit | 150 |
| Parimet për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve..... | 156 |
| Parimet për mbrojtjen e fëmijëve sipas LFK-së | 159 |
| Kujdesi prindëror | 164 |
| Ushtrimi i kujdesit nga Organi i Kujdestarisë | 165 |
| Besimi, ruajtja dhe kujdesi i fëmijëve si dhe kontakti..... | 166 |
| Vendimi i gjykatës për ushtrimin e të drejtave prindërore | 166 |
| Besimi i fëmijës ndaj prindit dhe caktimi i kontaktit për tjetrin..... | 168 |
| Besimi i fëmijës personit të tretë..... | 169 |
| Roli i Organit të Kujdestarisë në procedurën e besimit të fëmijës | 171 |
| Alimentacioni | 172 |
| Zbatimi i parimeve të përgjegjësisë së prindërve | 172 |
| Parimet për caktimin e alimentacionit | 175 |
| Mbajtja financiare dhe ushqimi (alimentacioni)..... | 176 |
| Vendimi ex officio i gjykatës | 177 |
| Masat e përkohshme | 177 |
| PROCEDURA GJYQËSORE PËR PJESËTIMIN E PASURISË SË PËRBASHKËTË TË BASHKËSHORTVE..... | 178 |
| Barazia e palëve në procedurë gjyqësore..... | 179 |
| Pjesëtimi i pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve | 182 |
| Vlerësimi i pasurisë së përbashkët në rast të mosmarrëveshjes..... | 183 |
| Pjesëtimi i pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve para ndryshim/plotësimit të LFK | 185 |

| | |
|--|------------|
| Përcaktimi i pjesëve | 189 |
| Marrëdhëniet pasurore pas shkurorëzimit..... | 190 |
| Pagimi në para | 192 |
| Sendet e luajtshme | 192 |
| Mbrojtja e pasurisë së fëmijëve..... | 192 |
| Vendimi gjyqësor mbi mosmarrëveshjet..... | 193 |
| Pjesëtimi i pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve sipas ndryshim/plotësimit të LFK-së..... | 193 |
| USHQIMIA | 198 |
| E DREJTA E PUNËS..... | 203 |
| Kontestet nga marrëdhënia e punës sipas ligjit të punës..... | 204 |
| Fusha e zbatimit të Ligjit të Punës | 204 |
| Llojet e kontratave të punës sipas Ligjit të Punës..... | 205 |
| Shkaqet e shkëputjes së marrëdhënies së punës sipas Ligjit të Punës..... | 206 |
| Procedura para ndërprerjes së kontratës së punës nga ana e punëdhënësit..... | 208 |
| Procedura gjyqësore për mbrojtjen e të drejtave të punës | 208 |
| Mbrojtja e të drejtave për të punësuarit brenda organeve të punëdhënësit..... | 209 |
| Mbrojtja e të punësuarit në Gjykatë..... | 210 |
| Vendimet e gjykatës në rastet kur konstatohet paligjshmëria e ndërprerjes së kontratës së punës..... | 212 |
| Respektimi i afateve ligjore për të kërkuar mbrojtje gjyqësore | 214 |
| Shterimi i mjeteve të brendshme juridike për të kërkuar mbrojtje gjyqësore..... | 215 |
| Pasojat juridike të mos respektimit të afatit ligjor për të kërkuar mbrojtje gjyqësore sipas Ligjit të Punës | 215 |
| Mbrojtja gjyqësore kur i referohet diskriminimit | 216 |
| E DREJTA PRONËSORE..... | 219 |
| MBROJTJA GJYQËSORE NGA PENGIM POSEDIMI | 220 |
| Natyra e Posedimit..... | 220 |
| Nocioni i posedimit | 220 |
| Objekti i Posedimit..... | 221 |
| Elementet e posedimit..... | 222 |
| Llojet e Posedimit..... | 222 |
| Fitimi dhe humbja e posedimit | 224 |
| Fitimi i Posedimit | 224 |

| | |
|--|-----|
| Humbja (shuarja) e posedimit..... | 225 |
| Mbrojtja e posedimit | 226 |
| Kompetenca | 226 |
| Urgjenca | 228 |
| Objekti i shqyrtimit | 228 |
| Vendimi për kërkesëpadinë | 231 |
| Mjetet e goditjes se vendimit meritor | 232 |
| Afati për ekzekutim te detyrueshëm te vendimit..... | 233 |
| SERVITUTET DHE MBROJTJA GJYQËSORE | 234 |
| Servituti si një e drejtë sendore mbi sendin e huaj | 235 |
| Objekti i servitutit | 235 |
| Subjektet e servitutit..... | 235 |
| Ndarja e servituteve..... | 235 |
| Mënyrat e fitimit të servitutit | 236 |
| Fitimi i servitutit në bazë të punës juridike..... | 237 |
| Fitimi i servitutit në bazë kontratës | 237 |
| Fitimi i servitutit sendor në bazë të testamentit | 238 |
| Fitimi i servitutit sendor sipas vendimit të organit shtetëror | 239 |
| Fitimi i servitutit në bazë të ligjit..... | 241 |
| Fitimi i servituteve personale..... | 241 |
| Fitimi i servitutit të frytëgëzimit..... | 241 |
| Fitimi i servitutit të përdorimit..... | 242 |
| Shuarja e servitutit..... | 242 |
| Shuarja e servituteve personale | 243 |
| E DREJTA E DETYRIMEVE..... | 244 |
| PAVLEFSHMËRIA ABSOLUTE DHE RELATIVE E KONTRATAVE | 245 |
| NOCIONI I KONTRATËS DHE KUSHTET PER LIDHJËN E KONTRATËS..... | 245 |
| EFEKTET, INTERPRETIMI DHE KONVALIDIMI I KONTRATAVE..... | 248 |
| PAVLEFSHMËRIA E KONTRATËS | 250 |
| KONTRATA NULE | 250 |
| Kontratat absolutisht të pavlefshme | 250 |
| MJETE PËR SIGURIMIN E EKZEKUTIMIT TË KONTRATAVE..... | 256 |

| | |
|--|-----|
| MJETËT REALE PËR SIGURIMIN E EKZEKUTIMIT TË KONTRATËS | 257 |
| Kapari | 257 |
| Paradhënja (avanci) | 258 |
| Kaucioni..... | 259 |
| MJETËT PERSONALE PËR SIGURIMIN E EKZEKUTIMIT TË KONTRATËS | 259 |
| Pendimi | 259 |
| Kushti penal | 260 |
| Dorëzania | 261 |
| E drejta për të kërkuar kompensimin nga debitori..... | 263 |
| E drejta e kompensimit nga dorëzanët tjerë | 264 |
| PROCEDURA GJYQËSORE NË RASTET E KOMPENSIMIT TË DËMIT DHE KRITERET E VLERËSIMIT | 264 |
| Shkaktimi i dëmit dhe përgjegjësia e shkaktuesit të demit | 264 |
| Shkaqet e shkaktimit të dëmit dhe llojet e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar | 265 |
| Shkaktimi i dëmit me veprimin e njerëzve..... | 265 |
| Shkaktimi i dëmit nga sendet..... | 266 |
| Shkaktimi i dëmit nga veprimtaritë e rrezikshme | 267 |
| Shkaktimi i dëmit nga ngjarjet natyrore | 268 |
| Dëmi, kuptimi dhe llojet e dëmit | 269 |
| Llojet e dëmit | 270 |
| Dëmi material | 270 |
| Dëmi i vërtetë (damnumemergens) | 271 |
| Fitimi i munguar (lucrumcessans)..... | 271 |
| Dëmi konkret | 272 |
| Dëmi abstrakt..... | 272 |
| Dëmi i drejtpërdrejtë | 272 |
| Dëmi i tërthortë | 272 |
| Demit jomaterial | 273 |
| Kompensimi i dëmit, llojet e kompensimit | 273 |
| Nocioni dhe qëllimi i shpërblimit të dëmit | 274 |
| Kompensimi i dëmit material..... | 275 |
| Shpërblimi i dëmit në natyrë | 276 |
| Shpërblimi i dëmit me para..... | 277 |

| | |
|--|-----|
| Vëllimi i dëmit material..... | 278 |
| Shkalla e fajit..... | 279 |
| Zvogëlimi i lartësisë së kompensimit për shkak të gjendjes materiale të dëmtuesit dhe të dëmtuarit si dhe për shkak të përgjegjësisë së ndarë..... | 280 |
| Lirimi nga përgjegjësia | 281 |
| Kompensimi i dëmit jomaterial..... | 282 |
| Kriteret për caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit | 283 |
| Kushtet për shpërblimin e dëmit jo material..... | 284 |
| Rastet e shpërblimit të dëmit jomaterial..... | 285 |
| Shpërblimi i dëmit jomaterial për shkak të shkaktimit të vdekjes..... | 286 |
| Shpërblimi i dëmit jomaterial në rast të të invaliditetit tejet të rëndë ose shëmtimit të lartë të personit të afërm..... | 287 |
| Shpërblimi i dëmit jomaterial për shkak të shëmtimit | 287 |
| Shpërblimi i dëmit në të holla në raste të veçanta (Cenimi i dinjitetit)..... | 288 |
| Shpërblimi i dëmit të ardhshëm jomaterial..... | 289 |
| Shpërblimi në të holla për personin juridik | 289 |
| Trashëgimi dhe cedimi i kërkesës së shpërblimit të dëmit jomaterial | 290 |
| Parashkrimi | 290 |
| FILLIMI I PROCEDURËS KONTESTIMORE | 292 |
| Kuptimi i padisë..... | 293 |
| Përmbajtja e padisë | 293 |
| Kërkesëpadia - (Petitumi) | 294 |
| Taksa gjyqësore për padi | 296 |
| Llojet e padive | 296 |
| Padi detyrimi | 297 |
| Padi vërtetimi..... | 297 |
| Padi ndryshimi..... | 297 |
| Interesi juridik për padi..... | 298 |
| Padia e paafatshme..... | 298 |
| Kundërpadia..... | 299 |
| Llojet dhe shembujt e kundërpadive | 299 |
| Kundërpadia kompensuese | 300 |

| | |
|---|-----|
| Kundërpadia prejudiciale | 300 |
| Ndryshimi i padisë..... | 301 |
| Zmadhimi i kërkesëpadisë | 302 |
| Zvogëlimi i kërkesëpadisë | 302 |
| Fazat në të cilat mund të bëhet ndryshimi i padisë | 303 |
| Lejimi i ndryshimit të padisë pa pëlqimin e të paditurit | 305 |
| Tërheqja e padisë..... | 306 |
| Gjyqëvarësia (litispendenca)..... | 306 |
| SHQYRTIMI PARAPRAK I PADISË | 308 |
| Zbatimi i rregullave të procedurës..... | 309 |
| Çka parashihet me dispozita e LPK-së, për këtë fazë të procedurës? | 309 |
| Verifikimi i kompetencës | 310 |
| Kompetenca Lëndore..... | 311 |
| Kompetenca Territoriale..... | 314 |
| Si e përcakton LPK-ja, kuptimin e kompetencës se përgjithshme territoriale? | 314 |
| Kompetenca e veçantë territoriale | 315 |
| Kompetenca territoriale e zgjedhur..... | 316 |
| Kompetenca territoriale ndihmëse..... | 319 |
| Caktimi i kompetencës territoriale nga gjykata e lartë..... | 321 |
| Delegimi i domosdoshëm i kompetencës | 322 |
| Ordinimi | 323 |
| Marrëveshja mbi kompetencën territoriale | 323 |
| Konflikti në lidhje me kompetencën..... | 323 |
| Zgjidhja e konfliktit për kompetencën | 325 |
| Përbërja e rregullt e gjykatës (kompetenca funksionale)..... | 326 |
| Përbërja e gjykatës në shkallë të parë | 326 |
| Përfundimi dhe rekuizimi i gjyqtarit nga gjykimi..... | 326 |
| Rrethanat të cilat qojnë deri të përfundimi i gjyqtarit nga gjykimi | 328 |
| Rrethanat të cilat qojnë deri të rekuizimi i gjyqtarit nga gjykimi..... | 329 |
| Palët në procedurë..... | 332 |
| Kuptimi i palëve në procedurën kontestimore | 332 |
| Kush mund të jetë palë në procedurën kontestimore..... | 332 |

| | |
|---|-----|
| Kush e përfaqëson palën me pazotësi procedurale..... | 334 |
| Përfaqësuesi ligjor..... | 335 |
| Përfaqësuesi i përkohshëm..... | 336 |
| Përfaqësimi i rregullt i personit juridik | 340 |
| Përfaqësuesit e autorizuar të palëve (me prokurë)..... | 341 |
| Mënyrat e dhënies së autorizimit | 341 |
| Vëllimi dhe përmbajtja e autorizimit | 343 |
| Parashtrimi i autorizimit | 344 |
| Revokimi dhe denoncimi i autorizimit | 344 |
| E drejta e ndjekjes së çështjes në gjykatë (legetimatio ad processum) | 345 |
| Prezumimet procedurale lidhur me objektin e kontestit | 346 |
| Mosekzistimi i gjyqëvarësisë (litispencës) së dyfishtë..... | 346 |
| Prezumimet procedurale lidhur me padinë..... | 348 |
| Si do të veprohet nëse padisë i mungon kërkesa e caktuar në pikëpamje të çështje kryesore dhe kërkesave aksesore? | 350 |
| Si do të veprojnë gjykata nëse padisë i mungojnë faktet mbi të cilat paditësi e bazon kërkesë?..... | 351 |
| Si do të veprohet në rast së padisë i mungojnë provat për të vërtetuar fakte e paraqitura në padi?..... | 352 |
| Si do të veprojnë gjykata në rast së padisë i mungon vlera e objektit të kontestit? | 352 |
| Si do të veprojnë gjykata në rast së padisë i mungon baza juridike? | 353 |
| SIGURIMI I KËRKESËPADISË..... | 354 |
| SIGURIMI I KËRKESËPADISË..... | 355 |
| Kushtet për caktimin e masave të sigurimit | 355 |
| LLOJET E MASAVE TË SIGURIMIT | 356 |
| KOMPETENCA PËR TË VENDOSUR PËR MASAT E SIGURIMIT TË KËRKESËPADISË | 358 |
| Mënyra e paraqitjes dhe përmbajtja e propozimit për caktimin e masës për sigurimin e kërkesëpadisë | 358 |
| Përmbajtja e aktvendimit mbi caktimin e masës së sigurimit | 359 |
| Shpenzimet e shkaktuara përgjatë procedurës për sigurimin e kërkesëpadisë | 361 |
| Pasojat e mosrespektimit të masës për sigurimin e kërkesëpadisë | 361 |
| Ekzekutimi i masave të sigurimit | 362 |
| Pasojat e mosrespektimit të masave me të cilat sigurohet kërkesëpadia | 362 |
| MASAT E PËRKOHSHME TË SIGURIMIT..... | 363 |

| | |
|---|-----|
| Dallimi në mes të masës së përkohshme të sigurimit dhe masës së sigurimit..... | 364 |
| GARANÇIONI ME RASTIN E CAKTIMIT TË MASËS SË SIGURIMIT TË KËRKESËPADISË | 365 |
| PËRFUNDIMI I PROCEDURËS KONTËSTIMORE..... | 367 |
| Aktgjykimi..... | 368 |
| Përmbajtja e aktgjykimit | 368 |
| Përmbajtja formale e aktgjykimit: | 368 |
| Disa udhëzime rreth arsytimit të aktgjykimit | 370 |
| Procesi gjyqësor i hartimit të aktgjykimit | 376 |
| Vendimet gjyqësore për përputhshmërinë ligjore të kërkesave | 378 |
| Llojet e aktgjyqimeve sipas LPK-së | 381 |
| Aktgjykimi i pjesshëm | 381 |
| Aktgjykimi në bazë të pohimit | 382 |
| Aktgjykimi në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpapia..... | 384 |
| Aktgjykimi për shkak të padëgjueshmërisë | 386 |
| Aktgjykimi për shkak të mungesës..... | 388 |
| Aktgjykimi pa shqyrtim kryesor të çështjes | 391 |
| Nxjerrja e aktgjykimit pa caktuar seancë gjyqësore sipas dispozitës së nenit 398 të LPK-së..... | 391 |
| Aktgjykimi plotësues | 393 |
| Dhënia, hartimi me shkrim dhe dërgimi i aktgjykimit..... | 394 |
| Aktgjykimi burimor | 395 |
| Korrigjimi i aktgjykimit | 395 |
| Forma e prerë e aktgjykimit..... | 396 |
| Aktvendimi | 397 |
| NDËRMJETËSIMI SI METODË ALTERNATIVE E ZGJIDHJES SË KONTËSTEVE..... | 398 |
| Ndërmjetësimi në çështje civile | 399 |
| Analizë..... | 401 |
| Parimet e Ndërmjetësitimit | 403 |
| <i>Shprehja e Vullnetit të palëve</i> | 403 |
| <i>Paanshmëria dhe Pavarësia</i> | 404 |
| <i>Urgjenca</i> | 404 |
| Përparësitë dhe pengesat në Ndërmjetësim | 404 |
| E drejta për të inicuar procedurën e ndërmjetësitimit | 405 |

| | |
|--|-----|
| Ndërmjetësimi i Detyrueshëm..... | 406 |
| Roli dhe rëndësia e gjyqtarit në zhvillimin e ndërmjetësimit | 408 |
| Natyra e rasteve civile që mund të zgjidhen përmes ndërmjetësimit..... | 409 |
| Procedura e Ndërmjetësimit..... | 410 |
| Referimi i lëndëve në procedurë të ndërmjetësimit | 410 |
| Pëlqimi për procedurën e ndërmjetësimit | 412 |
| Menaxhimi i lëndës së referuar nga gjykata | 412 |
| Zhvillimi i Procedurës së Ndërmjetësimit | 413 |
| Marrëveshja e ndërmjetësimit | 414 |
| PROCEDURA PËRMBARIMORE..... | 417 |
| PALËT NË PROCEDURË PËRMBARIMORE..... | 419 |
| DOKUMENTI PËRMBARIMOR DHE DOKUMENTI I BESUESHËM..... | 422 |
| ORGANI PËRMBARUES DHE VENDIMET..... | 424 |
| MJETET E GODITJES..... | 426 |
| ANKESA KUNDËR AKTVENDIMIT LIDHUR ME PRAPËSIMIN | 441 |
| Përmbarimi në sendet e luajtshme..... | 459 |
| Veprimet përmbarimore..... | 461 |
| Shitja e sendeve të sekuestruara | 463 |
| PËRMBARIMI NË SENDET E PALUAJTSHME | 467 |
| KUNDËR PËRMBARIMI | 472 |
| SHTYRJA, PEZULLIMI DHE PËRFUNDIMI I PËRMBARIMIT | 473 |
| Bibliografia | 480 |

DHUNA NË FAMILJE

Parandalimi i dhunës në familje

Mbrojtja e të drejtave të njeriut, konform standardeve ndërkombëtare dhe kornizës ligjore vendore, si dhe gjetja e mekanizmave adekuat për të zbatuar ligjin është brengë e të gjitha shoqërive demokratike¹. Republika e Kosovës, në aspektin formalo-juridik lidhur me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ka bërë hapa progresiv duke përcaktuar zbatimin e drejtpërdrejtë të marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare (*neni 22 i Kushtetutës*), si dhe duke miratuar një numër ligjesh të brendshme për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Pavarësisht progresit formal që është bërë në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, fenomenet e caktuara si dhuna në familje etj, vazhdojnë të paraqiten si sfida serioze për shoqërinë dhe mekanizmat / agjencitë që zbatojnë këto ligje, lidhur me parandalimin e dhunës, si fenomen që cënon drejtpërdrejtë liritë dhe të drejtat e njeriut, në këtë rast kategori të caktuara të drejtash dhe kategori të caktuara qytetarësh.

Të gjitha mekanizmat që merren me mbrojtjen e të drejtave të njeriut në përgjithësi, por edhe mekanizmat e veçantë që merren me mbrojtjen e të drejtave mbi baza gjinore vlerësojnë që në përgjithësi kjo dhuna në familje dhe sfida të tjera të ngjashme kërkojnë veprime urgjente, efikase dhe të koordinuara të të gjithë mekanizmave ligjore në funksion të parandalimit të dhunës në familje dhe mbrojtjes së viktimave të dhunës.

Padyshim, rol qëndror për të dhënë mbrojtjen e kërkuar në funksion të parandalimit të dhunës në familje dhe në funksion të mbrojtjes dhe rehabilitimit të viktimave të dhunës kanë gjykatat. Praktika gjyqësore ka treguar së në rastet e dhunës në familje mbi çfarëdo baze të shfaqjes së dhunës, përfshirë edhe rastet e dhunës mbi baza gjinore, gjykatat janë përballur me vështirësi të ndryshme, të cilat kanë ndikuar në efikasitetin e procedurës, ligjshmërinë e procesit dhe të vendimmarrjes gjyqësore.

Mbrojtja nga dhuna në familje është rregulluar me Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (LMDHF) nr.03/L-182, i cili ka hyrë në fuqi në muajin gusht të vitit 2010, duke e shfuqizuar Rregulloren e UNMIK-ut nr.2003/12, për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje.

Me Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje është përcaktuar edhe qëllimi i ligjit i cili është parandalimi i dhunës në familje, në të gjitha format e saj, me masa të përshtatshme ligjore, të pjesëtarëve të familjes që janë viktimat e dhunës në familje, duke u kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara.

¹Haxhi Gashi & Ruzhdi Berisha, “Komentari” Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Prishtinë 2014.

Ky ligj, po ashtu ka për qëllim edhe trajtimin e kryerësve të dhunës në familje dhe lehtësimin e pasojave.² Nga konteksti i qëllimit të LMDHF-së, për parandalimin e dhunës me masa të përshtatshme ligjore rrjedh edhe kompleksiteti i çështjeve të dhunës në familje, për shkak të ndërveprimit të shumë mekanizmave ligjorë që sipas autorizimeve ligjore, të ndërmarrin veprime nga paraqitja e rastit të dhunës e deri në përfundimin e procedurës dhe pastaj veprime për mbikëqyrjen dhe zbatimin e urdhrin mbrojtës.

Konteksti i parandalimit të dhunës me masa të përshtatshme ligjore është mjaft i gjerë, jo vetëm për shkak të procedurave që zbatohen për secilin lloj të urdhrave³, por edhe për shkak të nevojës për ndërveprim të institucioneve të ndryshme për të vlerësuar në mënyrë të përshtatshme masat që duhet të caktohen në një rast konkret, e të cilat duhet t'i shërbejnë gjithsesi qëllimit të parandalimit të dhunës dhe në disa raste rehabilitimit të kryesit të dhunës në familje.

Në praktikën gjyqësore janë shfaqur dhe mund të shfaqën dilema për natyrën e urdhrin mbrojtës të caktuar nga ana e gjykatave, nëse caktimi i urdhrin mbrojtës është një masë, respektivisht sanksion i karakterit inkriminues ndaj kryerësit të dhunës. Në lidhje me këtë, LMDHF-së me dispozitën e nenit 1, paragrafi 1, e ka qartësuar së qëllimi është parandalimi i dhunës në familje me masa të përshtatshme ligjore ndaj viktimave të dhunës⁴.

Koncepti i parandalimit të dhunës, i referohet masave të përshtatshme ligjore që mund të caktohen së bashku me urdhrin për mbrojtje sipas dispozitave ligjore të LMDHF, në procedurë gjyqësore, (civile,) sikurse çdo çështje tjetër civile, natyrisht duke i'u referuar specifikave të çështjes që përcaktohen me LMDHF.

² Neni 1, i Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje

³ Urdhri për mbrojtje, urdhri për mbrojtje emergjente dhe urdhri për mbrojtje emergjente të përkohshme.

⁴ Gjykata Komunale në Prishtinë, me aktvendimin C.nr. 2550/1, të datës 02.12.2011, ka caktuar urdherin mbrojtës dhe në asyretim të aktvendimit ka thelsuar qëllimin e masës së caktuar. Pjesë nga arsyetimi i aktvendimit, "Në rastin konkret, gjykata vlerëson se ekzistojnë shkaqet të cilat e përbëjnë bazën juridike për shqiptimin e masave mbrojtëse ndaj palës përgjegjëse, nga neni 5, par. 1 e 2, neni 6, par. 1 e 2 dhe neni 11, par. 2, të Ligjit për Mbrojtje kundër Dhunës në Familje, për të cilat konsideron se janë të domosdoshme për sigurinë, shëndetin dhe mirëqenien e palës së mbrojtur si dhe të gjithë të involvuarve.

Këto masa Gjykata i lëshoi me bindjen e forcuar e të fituar drejtpërdrejtë nga ballafaqimi me palët dhe deklaratat e dëshmitarëve, ku shihet se pala përgjegjëse ka kërcënuar palën e mbrojtur.

Me këto masa gjykata ka për qëllim të siguroi qetësi, rehati dhe siguri për kohën e caktuar dhe rehabilitimin nga situata e krijuar si dhe për krijimin e kushteve me qëllim që palët në ndërkohë, të gjëjnë zgjidhje për tejkalimin e situatave të rënduara e të pakëndshme të krijuara në mes tyre – e të mbroj jo vetëm viktimën por edhe kryesin ngase i njëjti kështu pengohet të përseris sjelljet e palejuara e për të mos bartur pasoja juridike më të rënda më vonë.

Këto masa nuk paraqesin dënim ndaj palës përgjegjëse, por masa parandaluese dhe vërejtje për pasojat ligjore, të cilat mund të bijnë në barrë të palës përgjegjëse, nëse i njëjti përserit sjellje të tilla të palejuara.

Sa i përket të drejtës që pala e mbrojtur me shoqërimin e Policisë t'i merr gjërat e saj personale, gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 11, par. 2, të Ligjit për Mbrojtje kundër Dhunës në Familje.

Urdhri për mbrojtje dhe masat e caktuara në asnjë mënyrë nuk e inkriminojnë kryerësin e dhunës. Atë (*kryerësin e dhunës*) mund ta inkriminojnë veprimet e tij me rastin e kryerjes së dhunës (*aktit të dhunës*), sepse veprimet e të njëjtit, të cilat janë shfaqur si akt i dhunës, mund t'i konsumojnë edhe elementet e ndonjë vepre penale të veçantë (*si për shembull: lëndimi trupor, etj*).

Urdhri nuk shënohet në asnjë evidencë inkriminuese. Nuk ekziston asnjë dispozitë ligjore që përcakton evidentimin e urdhrin mbrojtës në ndonjë evidencë inkriminuese. Përveç kësaj është natyra e procedurës në këtë rast procedurë civile që pamundëson se urdhri dhe masat të trajtohen si inkriminuese.

Shkelja e urdhrin pastaj është sanksion në vete dhe për shkeljen e urdhrin mbrojtës zhvillohet procedura penale, në të cilën mund të shqiptohet sanksioni penal nëse konstatohet shkelja e tillë. Trajtimi i rasteve të dhunës parimisht trajtohet si procedurë civile /kontestimore, duke përfshirë edhe specifikat ligjore procedurale dhe materiale juridike, të cilat e diktojnë procedurën gjyqësore në kuptimin e dinamikës së procedurës, në kuptimin e oficalitetit të veprimeve nga ana e gjykatës, në kuptimin e disponibilitetit dhe në kuptimin e masave që mund të caktohen.

Pavarësisht se caktimi i një urdhri, nuk përbën një sanksion penal ndaj kryerësit të dhunës dhe pavarësisht se karakteri i masave që caktohen së bashku me urdhrin janë vetëm të përkohshme, e që parimisht nuk e ndikojnë asnjë procedurë tjetër që mund të zhvillohen në mes të palëve të njëjta, gjykatat duhet të jenë të kujdesshme dhe objektive në caktimin e urdhrin dhe masave së bashku me urdhrin mbrojtës.

Procedura ligjore për shqyrtimin e rasteve të dhunës në familje jep gradacionin e objektivitetit të procesit gjyqësor, duke synuar që gjykatat të kenë vlerësime adekuate dhe objektive për nevojën e caktimit të urdhrin dhe masave të përshtatshme për parandalimin e dhunës.

Eksperienca e shkurtër gjyqësore për çështjet e mbrojtjes nga dhuna në familje, ka ndikuar që praktika gjyqësore të mos jetë shumë unike. Kjo për arsye se në raste të caktuara nuk ka vlerësime objektive për ekzistimin e aktit të dhunës dhe rrjedhimisht të gjitha masat e caktuara së bashku me urdhrin nuk i shërbejnë qëllimit të parandalimit të dhunës. Përveç kësaj mund të ekzistojnë rastet kur gjykatat aktin e dhunës (*që të paktën sipas përkufizimit ligjor në LMDHF përbën akt të dhunës*), e kanë vlerësuar të minimizuar duke e konsideruar si një çështje mosmarrëveshje (*për shembull në mes të bashkëshortëve*), për çka edhe kanë refuzuar kërkesat për caktimin e urdhrin dhe në këtë mënyrë nuk i kanë shërbyer qëllimit të ligjit⁵.

⁵ Gjykata e Apelit, me aktvendimin Ac.nr.153/18, të datës 05.02.2018, e ka ndryshuar aktvendimin e gjykatës së shkallë së parë me të cilin ishte refuzuar kërkesa për urdhërmbrojtje dhe e ka aprovuar kërkesën për urdhërmbrojtje. Pjesë nga arsyetimi i aktvendimit të Gjykatës së Apelit: “Gjykata e shkallës së parë në këtë rast e ka anashkaluar në tërësi dhunen psikologjike, pra nuk është marrë fare me të, përkundër faktit që nga deklaratimet e palëve ndërgjyqëse, provat e dëshmueshme, qartë rezulton se të pala e mbrojtur është krijuar ndjenja e frikës, pasigurisë dhe e shqetësimit. Sjelljet e tilla kjo gjykatë i vlerëson si sjellje që të pala e mbrojtur kanë sjellë vuajtje psikike dhe paraqet një nga format e dhunës në familje nga neni 2, pika 2 paragrafi 1 të LMDHF.

Nga kjo rrjedh se procedura e shqyrtimit të kërkesës për urdhër mbrojtje, nuk i ka shërbyer qëllimit të ligjit, as në situatën kur në mënyrë të ekzagjeruar pranohet kërkesa për urdhër mbrojtje, pa ekzistuar dhuna dhe as në situatën kur akti i dhunës minimizohet dhe kërkesa për urdhër mbrojtje refuzohet.

Për shkak të llojeve të shumta të masave mbrojtëse që mund të caktohen me urdhër mbrojtje, sidomos të atyre pasurore, nuk përjashtohet mundësia e paraqitjes së rasteve fiktive të dhunës në familje. Kjo mundësi e rasteve fiktive, në njëfarë mënyre edhe nga praktika gjyqësore konfirmohet. Qëllimi i këtyre rasteve mund të jetë që të shfrytëzohet urgjenca e procedurës për urdhër mbrojtje dhe gjykata të caktojë masa të karakterit pasuror, gjë që të paktën përkohësisht do të ndikojë që pala e caktuar të realizojë disa të drejta të cilat nuk ka mundur ose nuk do të mund t'i realizojë në procedurë të rregullt ose të paktën nuk kanë mundur t'i realizojnë në afate të shkurta kohore si në rastin e dhunës. Kjo tendencë e paraqitjes së rasteve në mënyrë fiktive, më së shpeshti ekziston kur në mes të palëve ekzistojnë mosmarrëveshje të karakterit personal-martesor, pronësor, pasuror, të mbajtjes, trashëgimisë etj.

Procedura gjyqësore në rastet e dhunës në familje, duhet ta promovojë qëllimin e ligjit, duke siguruar objektivitet në procedurë, ligjshmëri, besueshmëri dhe siguri. Kjo do të arrihet përmes ngritjes së kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve dhe të gjithë subjekteve tjerë, të përfshirë në

Bazuar në nenin 1.2 të Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (LMDHF), dhuna në familje paraqet një ose më shumë vepra apo lëshime të qëllimshme që i bën një person personit tjetër me të cilin është ose ka qenë në marrëdhënie familjare siç janë: shkaktimi i ndjenjës së frikës, rrezikshmërisë personale apo cenimin e dinjitetit dhe mënyra të tjera të shqetësimit të vrazhdë etj. Prandaj, dhuna në familje mund të nënkuptoj çdo lloj sjelljeje e cila dallon nga një standard normal i sjelljes dhe komunikimit me personat të cilët gjenden në marrëdhënie familjare, të përkufizuar më saktësisht si në nenin 1.1 të LMDHF-së. Për t'u kualifikuar si dhunë familjare, sjellja apo veprimi i tillë, nuk është e nevojshme që të ketë një vazhdimësi–kontinuitet, por në situata të caktuara, mjafton edhe vetëm një akt i vetëm ashtu që i njëjti të kualifikohet si dhunë në familje. Po ashtu, me nenin 3 par. 4 të LMDHF-së, është e paraparë se “masat mbrojtëse shqiptohen me qëllim të parandalimit të dhunës në familje, për mbrojtjen e personit që i është ekspozuar dhunës, duke mënjeluar rrethanat që ndikojnë apo mund të ndikojnë në kryerjen e veprave të tilla”, ndërsa me nenin 6 par.1 të po të njëjtit ligj është e përcaktuar se “masa mbrojtëse e ndalimit të shqetësimit në përputhshmëri me përkufizimin e dhënë në nenin 2 nënparagrafi 1.2, të këtij ligji, mund t'i shqiptohet kryerësit të dhunës në familje, nëse ekziston rreziku i përsëritjes së dhunës në familje.

Duke marrë parasysh sjelljet e lartpërmendura të palës përgjegjëse, dispozitat ligjore të lartshënuara, kjo gjykatë vlerëson se duhet të ndryshohet aktvendimi i shkallës së parë dhe të aprovohet kërkesa për urdhër mbrojtje, pasi që ndaj palës së mbrojtur është përdorë dhunë fizike, është shkaktuar shqetësim dhe krijuar ndjenja e frikës, pasigurisë dhe rrezikshmërisë personale. Nga këto arsye është e nevojshme caktimi i masave të parapara me nenin 6 të sipërcituar të Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje. Këto masa nuk do të duhej të kuptoheshin vetëm si një dënim për palët përgjegjëse, por edhe si mjete parandaluese dhe vërejtje në lidhje me pasojat ligjore të cilat mund ti ketë ai, në rast se i përsërit sjelljet e tilla. Ndërsa për palën e mbrojtur, këto masa duhet të jenë të atilla që t'i mundsojnë qetësi, rehati dhe siguri për një periudhë të caktuar kohore, gjegjësisht një jetë pa frikë nga dhuna e mëtejme apo edhe rehabilitim nga pasojat – traumat eventuale të cilat mund t'i ketë pësuar”.

procedura të tilla, si dhe përmes koordinimit dhe standardizimit të të gjitha veprimeve në funksion të një procedure unike, nga do të rrjedhin edhe vendimet gjyqësore të drejta dhe të ligjshme.

Në vijim për qëllime të ngritjes së kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve dhe të gjithë subjekteve tjerë të përfshirë në këto procedura, tema e dhunës në familje është trajtuar me të gjitha specifikat e saj, (*ligjore, procedurale, të përfaqësimit, inicimit të procedurës, zhvillimit të procedurës dhe vendosjes, përfshirë edhe arsyetimin e vendimit, mbikëqyrjes dhe zbatimit të vendimeve*) e fokusuar edhe në dimensionin gjinor.

Përkufizimi i dhunës në familje sipas LMDHF

Në bazë të LMDHF, Dhuna në Familje definohet në nenin 2, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, pikat nga 1.2.1 deri tek 1.2.12, me të cilat dispozita përcaktohet së një apo me shumë vepra apo lëshime të qëllimshme që i bën një person ndaj personit tjetër me të cilin është ose ka qenë në marrëdhënie familjare si këto, por nuk kufizohet në:

- *përdorimin e forcës fizike ose presionin psikik të ushtruar ndaj anëtarit tjetër të familjes*
- *çdo veprim tjetër i një anëtari të familjes që mund të shkaktojë apo kanosë se do të shkaktojë dhembje fizike dhe vuajtje psikike;*
- *shkaktimi i ndjenjës së frikës, rrezikshmërisë personale apo cënimit e dinjitetit;*
- *sulmi fizik pa marrë parasysh pasojat;*
- *ofendimi, sharja, thirrja me emra ofendues dhe mënyra të tjera të shqetësimit të vrazhdë;*
- *përsëritja e vazhdueshme e sjelljeve me qëllim të përuljes së personit tjetër;*
- *marrëdhënia seksuale pa pëlqim dhe keqtrajtimi seksual;*
- *kufizimi i kundërligjshëm i lirisë së lëvizjes ndaj personit tjetër;*
- *dëmtimi apo shkatërrimi i pasurisë dhe kanosja që ta bëjë këtë;*
- *vënia e personit tjetër në pozitën që ai të frikësohet për gjendjen fizike, emocionale dhe ekonomike;*
- *hyrja apo largimi me dhunë nga banesa e përbashkët apo banesën e personit tjetër;*
- *rrëmbimi.*

Lidhur me vlerësimet e gjykatës se një apo me shumë vepra apo lëshime të qëllimshme i konsumojnë elementet e dhunës në familje apo nuk i konsumojnë, në praktikën gjyqësore bëhen gabime.

Vlerësimet e gabueshme, zakonisht në praktikë paraqiten raste kur viktimat e dhunës në familje është bashkëshortja apo bashkëshorti, qoftë martesor apo nga bashkësia jashtëmartesore. Kjo ndodh për shkak se në disa raste perceptimi i krijuar në gjykatë mund të jetë se në mes të palëve ndërgjyqësore ekzistojnë mosmarrëveshje në martesë apo në bashkësinë jashtëmartesore, por që mosmarrëveshja nuk i konsumon elementet e dhunës në familje. Në raste të tilla gjykatat duhet të

jenë të kujdesshme, sepse rastet e tilla mund të duken si raste të mosmarrëveshjes së rëndomtë në mes të bashkëshortëve apo të bashkësisë faktike, por në fakt mund t'i konsumojë elementet e dhunës në familje.

Për shembull: Në një rast mund të mos ketë përdorim të forcës fizike si akt dhune, por bashkëshorti nuk e lejon bashkëshorten të kthehet në shtëpinë ku ka jetuar deri në momentin e largimit.

Nga këndvështrimi i dispozitave të Ligjit për Familjen i Kosovës, ky rast do të konsiderohej si ndërprerje faktike e martesës apo bashkësisë martesore, por nga këndvështrimi i dispozitave të LMDHF ky rast është dhunë në familje.⁶

LMDHF, përveç që ka dhënë përkufizimin e dhunës në familje, me dispozitat nga neni 2, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, pikat 1.1.1 deri tek 1.1.7, ka dhënë edhe përkufizimin e personave që gjenden në marrëdhënie familjare, duke përcaktuar se në marrëdhënie familjare konsiderohen personat nëse:

- janë të fejuar apo ishin të fejuar;
- janë të martuar apo ishin të martuar;
- janë në bashkësi jashtëmartesore apo ishin në bashkësi jashtëmartesore;
- bashkëjetojnë në ekonomi të përbashkët ose që bashkëjetuan në një ekonomi të tillë;
- përdorin një shtëpi të përbashkët dhe janë në lidhje gjaku, martesë, adoptimi, krushqie apo janë në lidhje kujdestarie duke përfshirë prindërit, gjyshërit, fëmijët, nipat, vëllezërit dhe motrat, hallat e tezet, xhaxhallarët e dajallarët ose kushërinjtë;
- janë prindër të një fëmije të përbashkët,
- janë palë procedurale në një kontest nga marrëdhëniet familjare;

⁶Gjykata e Apelit me aktvendimin Ac.nr.39933/17, të datës 14.09.2017, konstaton së gjykata e shkallës së parë gabimisht ka vlerësuar së në rastin e paraqitur në gjykatë për mbrojtje nga dhuna nuk ka pasur dhunë në atë mënyrë që largimin e viktimës nga shtëpia dhe mos lejimin e të njëjtës që të kthehet dhe ta shfrytëzojë shtëpinë ku ka jetuar deri më parë nuk i ka konsumuar elementet për ta kualifikuar si dhunë në familje. Gjykata e Apelit në arsyetim të aktvendimit (pjesë nga arsyetimi) ka theksuar së:

“ Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar është i përfshirë në zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, e për të cilat shkelje Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Lidhur me ndryshimin e aktvendimit të atakuar, sa i përket lëshimit të urdhrin për mbrojtje, Gjykata e Apelit, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale, ka bërë ndryshimin e aktvendimit në kuptim të dispozitës së nenit 195 paragrafi 1 pika e), e lidhur me nenin 201 paragrafi 1 pika d) e LPK-së, sepse ka gjetur se nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, por sipas kësaj gjendje faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, gabimisht është zbatuar e drejta materiale Gjykata e Apelit vlerëson se me vetë faktin e largimit nga shtëpia të palës së mbrojtur dhe moslejimit të shfrytëzimit të shtëpisë së përbashkët, në të cilën deri më tani kanë jetuar së bashku me palën përgjegjëse, paraqet aktin e kryerjes së dhunës në familje nga ana e palës përgjegjëse, e konform nenit 2 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 pika 1.2.11 të LMDHF -së, e cila nuk ka qenë rrethanë kontestuese”.

Nga interpretimi i dispozitave të nenit 2 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, pika 1.1.1-1.1.7 dhe nën paragrafi 1.2, pika 1.2.1-1.2.12 të LMDHF, gjykatat me rastin e vlerësimit dhe vendosjes sipas kërkesave për mbrojtje nga dhuna në familje, çdoherë duhet të kenë parasysh se ky ligj mund të zbatohet vetëm për rastet kur konstatohet se dhuna në familje është shkaktuar në mes personave të cilët janë në marrëdhënie familjare apo me herët kanë qenë në marrëdhënie familjare (*përkufizimi që jep LMDHF për personat që gjenden në marrëdhënie familjare*) dhe kryesi i dhunës ka kryer një apo më shumë vepra apo lëshime të qëllimshme ndaj personit tjetër më të cilin është ose ka qenë në marrëdhënie familjare.

Kushtet ligjore të lartcituara, çdo herë duhet të plotësohen në mënyrë kumulative, pasi që pa plotësimin e këtyre dy kushteve në mënyrë kumulative (*veprimi-vepra-lëshimi dhe ekzistimi i raportit që konsiderohet marrëdhënie familjare*), ligjërisht nuk mund të konsiderohet se kemi të bëjmë me rast i cili i përmbush kushtet për tu kualifikuar si dhunë në familje. Kështu që në mungesë të plotësimit të këtyre kushteve, gjykatat në asnjë rast nuk do të kenë mundsi që të marrin vendim me të cilin do të lëshohet urdhri mbrojtës apo urdhri mbrojtës emergjent, duke caktuar masat mbrojtëse të cilat parashihen me dispozitat e LMDHF.

Në rastet kur ekzistojnë elementet e dhunës, por nuk plotësohet kushti që dhuna të jetë shkaktuar nga persona që janë në marrëdhënie familjare, atëherë çështja mund të trajtohet në procedura të tjera, varësisht se cilat elemente të veprës penale, kundërvajtjes apo deliktit civil i ka konsumuar veprimi apo mos veprimi i kryerësit të dhunës.

Ritheksojmë se është e rëndësishme për gjykatat që të kenë vlerësime adekuat lidhur me atë se cilët persona mund të jenë në lidhje familjare, konform këtij ligji dhe në mes cilëve mund të shkaktohet dhunë, që sipas ligjit konsiderohet dhunë në familje.

LMDHF në krahasim me Ligjin për Familjen e Kosovës, e përcakton rrethin më të gjerë të personave që konsiderohen në marrëdhënie familjare. Ligji për Familjen i Kosovës me dispozitën e nenit 271 për bashkësinë familjare jep këtë përkufizim: "*Bashkësia familjare përfshin bashkëshortët dhe familjen e tyre të ngushtë, që në këtë ligj përfshijnë fëmijët dhe prindërit e bashkëshortëve. Personat tjerë të afërm të familjes, si dhe personat të cilët kryesisht janë të varur ekonomikisht dhe të cilët jetojnë në shtëpi të përbashkët me bashkëshortët, mund të konsiderohen anëtarë të bashkësisë familjare për qëllimet e këtij ligji*".

LMDHF e ka zgjeruar konceptin e lidhjes familjare duke dhënë një përkufizim më të gjërë të familjes dhe lidhjes familjare, ku si persona të cilët konsiderohen në marrëdhënie familjare ka përfshirë edhe të fejuarit apo ish të fejuarit, të martuarit apo ish të martuarit, ata që janë në bashkësi jashtëmartesore apo që kishin jetuar në bashkësi jashtëmartesore, personat që bashkëjetojnë në ekonomi të përbashkët ose që bashkëjetuan në një ekonomi të tillë, anëtarët e familjes se gjerë që

jetojnë bashkërisht, prindërit e një fëmijë të përbashkët dhe palët procedurale në një kontest nga marrëdhënia familjare.⁷

Sipas përkufizimit që parashihet me nenin 2 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, pika 1.1.1-1.1.7, të LMDHF, gjykatat me rastin e shqyrtimit të kërkesave për mbrojtje nga dhuna në familje, duhet të kenë parasysh që ky nocion i marrëdhënies familjare duhet të interpretohet në lidhshmëri të plotë me këto dispozita ligjore dhe shprehjet e përdorura sipas këtyre dispozitave.

Në praktikën gjyqësore, mund të paraqitën rastet kur personat që janë viktimë të dhunës nuk janë në marrëdhënie familjare sipas përkufizimit që jep LMDHF, kështu në këto raste natyrisht që gjykata nuk mund të jep mbrojtje gjyqësore përmes urdhrin mbrojtës. Po ashtu, mund të paraqiten edhe rastet kur gjykatat gabimisht kanë vlerësuar se viktimë e dhunës nuk është në marrëdhënie familjare⁸ me kryerësin e dhunës.

Gjykatat duhet të kenë në konsideratë se qëllimi i LMDHF për parandalimin e dhunës në familje, në mënyrë të arsyeshme përkrahë me dispozitat ligjore konceptin e marrëdhënies familjare për një rreth më të gjerë të personave, e që nuk përputhet me përkufizimin ligjor të Ligjit për Familjen i Kosovës. Ky përkufizim më i gjerë i LMDHF për rrethin e personave që janë në marrëdhënie familjare, rrjedh apo diktohet veçanërisht nga rrethanat shoqërore, ekonomike, sociale, kulturore, arsimore, etj, prandaj duhet kujdes i veçantë për të vlerësuar çdo rast sipas specifikave të rastit për ta konsideruar viktimën e dhunës, si viktimë të dhunës në familje.

⁷Haxhi Gashi & Ruzhdi Berisha, “Komentari” i Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Prishtinë 2014.

⁸Gjykata e Apelit me aktvendimin, Ac.nr.39933/17, të datës 14.09.2017, konstaton se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka vlerësuar se viktimë e dhunës dhe kryerësi i dhunës nuk janë në marrëdhënie familjare, sipas të cilave arsye edhe e ka refuzuar kërkesën për urdhër mbrojtje. Gjykata e Apelit në arsyetim të aktvendimit (*pjesë nga arsyetimi*) ka theksuar se: *Sa i përket zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave të LMDHF, përkatësisht të nenit 2 par.1, nënparagrafi 1.1, pikat. 1.1.1, deri në 1.1.7 të këtij ligji, sipas të cilit në mënyrë decisive theksohet se çka konsiderohet marrëdhënie familjare dhe cilët persona bëjnë pjesë në marrëdhënie familjare.*

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, sipas nenit 2 paragrafi 1 të LMDHF, marrëdhëniet familjare konsiderohen personat mes tjerash nëse: 1.1.3. janë në bashkësi jashtëmartesore apo ishin në bashkësi jashtëmartesore, nga çka vërtetohet fakti se pala e mbrojtur me palën përgjegjëse kanë qenë në marrëdhënie familjare që nga dt.01.06.2017, gjë që gjykata e shkallës së parë nga provat e administruara nuk është bazuar në dispozitat e LMDHF, por në dispozitat e LFK dhe gabimisht iu është referuar dispozitës së nenit 39 të LFK, për vërtetimin e ekzistimit të marrëdhënies familjare mes palëve, andaj e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e palës së mbrojtur për urdhër mbrojtje.

Gjykata e Apelit, vlerëson se bazuar në nenin 2 paragrafi 1 nënparagrafi 1 pika 1.1.3, ka ekzistuar bashkësia jashtëmartesore mes palëve dhe se ekzistojnë marrëdhëniet familjare me vetë faktin kur pala përgjegjëse e ka marrë palën e mbrojtur për të jetuar tek ai, andaj edhe gjykata i ka aprovuar ankesën e palës së mbrojtur përkitazi me ekzistimin e marrëdhënies familjare dhe e ka ndryshuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë, C.nr.372/2017, të datës 24.08.2017 dhe e ka aprovuar pjesërisht kërkesën e palës së mbrojtur për lëshimin e urdhrin mbrojtjes”.

Pala e mbrojtur nënkupton personin ndaj të cilit është ushtruar dhuna në familje dhe vartësit në dobi të të cilit është kërkuar urdhri për mbrojtje, urdhri për mbrojtje emergjente ose urdhri për mbrojtjen e përkohshme emergjente.

Natyrisht, në çdo rast procedura do të zhvillohet sipas interesit juridik të palës së mbrojtur dhe nga interesi i të njëjtit për mbrojtje gjyqësore, do të përfundohet procedura dhe do nxirret vendimi meritor për themelësinë e kërkesës për urdhër mbrojtje. Nëse do të mungojë interesi juridik për urdhër mbrojtje, atëherë përfundimi i procedurës është i njëjtë sikurse për çdo procedurë gjyqësore civile. Meqenëse në çështjet civile pala me interes juridik përfshihet me vullnetin e tij në procedurë, sipas vullnetit zgjedh momentin e fillimit të procedurës, zgjedh objektin dhe subjektin e paditur, tek rastet e dhunës në familje do të shohim se ekzistojnë disa specifika sa i përket përzgjedhjes së objektit, (*masave të kërkuara*) sepse në shumë raste ato nuk diktohen nga një raport paraprak juridik civil, por diktohen nga akti i dhunës dhe nga nevoja që masat të jenë të përshtatshme për parandalimin dhunës.

Momenti i fillimit të procedurës, gjithmonë diktohet nga momenti i shfaqjes së aktit të dhunës dhe rrjedhimisht subjektet e procedurës legjitimohen në kuptimin real aktiv dhe real pasiv, pikërisht nga akti i dhunës.

Vlen të cekën edhe disa specifika që lidhen me mundsinë që jo vetëm subjekti (*viktima e aktit të dhunës*) të kërkojë urdhrin për mbrojtje, por të njëjtin ta kërkojnë edhe subjektët tjerë dhe gjithashtu ka specifika edhe të përfaqësimit në procedurë.

Kryerësi i dhunës në familje nënkupton personin i cili ka kryer një apo më tepër vepra të dhunës në familje, kundër të cilit kërkohet urdhri për mbrojtje, urdhri për mbrojtje emergjente, ose urdhri për mbrojtjen e përkohshme emergjente. Kryerësi i dhunës është subjekti që përfshihet pa vullnetin e tij në procedurë dhe realisht ai e fiton cilësinë e palës përgjegjëse në procedurë gjyqësore në momentin e dorëzimit të kërkesës për urdhër mbrojtje në gjykatë.

I njëjti në momentin që e fiton cilësinë e palës përgjegjëse në procedurë, rrjedhimisht fiton edhe cilësinë procedurale për të drejtën e ndjekjes së çështjes në gjykatë, por kur bëhet fjalë për legjitimitetin real pasiv, atëherë çështja është shumë më specifike, se sa në rastet e rëndomta civile. Nëse në një rast të zakonshëm (*për shembull të shkaktimit të dëmit*) legjitimiteti real i palëve buron nga veprimi deliktor, tek rastet e dhunës, legjitimiteti nuk plotësohet vetëm nga akti i dhunës, por edhe nga kushti i ekzistimit të marrëdhënies familjare sipas përkufizimit ligjor të përcaktuar më LMDHF, neni 2, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, pikat 1.1.1 deri tek 1.1.7, (*elaboruar më lartë*).

Viktima, nënkupton personin i cili është nënshtruar dhunës në familje.

Urdhri për mbrojtje paraqet urdhrin e lëshuar me vendim gjykate (aktvendim), kur përsihen masat mbrojtëse për viktimën.

Urdhri për mbrojtje emergjente nënkupton urdhrin e lëshuar përkohësisht me vendim gjykate.

Urdhri për mbrojtje të përkohshme emergjente nënkupton urdhrin e lëshuar jashtë orarit të punës së gjykatave.

Masat mbrojtëse sipas Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje

Qëllimi parësor i Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje është parandalimi i dhunës në familje në të gjitha format e saj.⁹ Për përmbushjen e këtij qëllimi ligji ka paraparë një numër masash mbrojtëse kundër dhunës në familje, siç janë: masat mbrojtëse të trajtimit psikosocial, masat mbrojtëse të ndalimit të afrimit të viktimës së dhunës në familje, masa mbrojtëse e ndalimit të shqetësimit të personave të ekspozuar dhunës, masa mbrojtëse e largimit nga banesa, shtëpia apo hapësira tjetër e banimit, masa mbrojtëse e shoqërimit të viktimës së dhunës, masa mbrojtëse e trajtimit mjekësor nga varësia prej alkoolit dhe substancave psikotrope, masa mbrojtëse e marrjes së sendit dhe masat mbrojtëse pasurore.

Masa mbrojtëse e trajtimit psikosocial e kryesit të dhunës në familje

Shqiptimi i kësaj mase ka për qëllim që kryesi i dhunës në familje të trajtohet me masa psiko sociale, për një kohë të caktuar, me qëllim të evitimit të sjelljeve të dhunshme dhe rrezikut për përsëritjen e dhunës në familje. Kjo masë mbrojtëse çdoherë duhet shqiptuar bashkë me ndonjë masë tjetër parandaluese, varësisht nga lloji dhe natyra e dhunës në familje. Për dallim nga masat e tjera mbrojtëse, afati i kohëzgjatjes së kësaj mase është më i shkurtër, ashtu që ajo mund të zgjasë deri sa të përfundojnë shkaqet për të cilat është shkaktuar, por nuk mund të zgjasë më tepër se 6 muaj.

Për zbatimin e drejtë të kësaj dispozite ligjore, gjykatat çdoherë duhet të kenë parasysh se masa mbrojtëse e trajtimit psikosocial ndaj kryesit të dhunës mund të shqiptohet nëse në mënyrë kumulative plotësohen dy kushte ligjore dhe atë:

- Nëse konstatohet se kryesi i dhunës ka kryer një ose me shumë vepra apo lëshime të qëllimshme ndaj personit tjetër më të cilin është ose ka qenë në marrëdhënie familjare, ashtu siç përcaktohet me dispozitën e nenit 2 paragrafi 1.2 të LMDHF; dhe
- Nëse konstatohet se kryesi i dhunës këto vepra apo lëshime të qëllimshme ndaj personit tjetër më të cilin është ose ka qenë në marrëdhënie familjare, i ka ndërmarrë si shkak i gjendjes së rënduar psikike ose emocionale.

⁹ Neni 1 i LMDHF.

Për të konstatuar faktin se veprimet e qëllimshme nga kryesi i dhunës kanë mundur të ndërmerren si shkak i gjendjes së rënduar psikike ose emocionale, gjykatat çdoherë duhet kujdesur sipas detyrës zyrtare edhe pa propozim të palëve në procedurë, sepse kanë për detyrim ligjor që të nxjerrin provë me ekspertizë përkatëse nga lëmi i psikiatrisë. Vetëm përmes vërtetimit të drejtë të gjendjes psikosociale të kryerësit të dhunës gjykata do të ketë mundsi objektive që të vlerësojë se a plotësohen kushtet ligjore për shqiptimin e masës mbrojtëse të trajtimit psikosocial apo ndonjë mase tjetër mbrojtëse të paraparë me dispozitat ligjore të LMDHF.

Në çdo rast kur në gjykatë paraqitet kërkesa për urdhër mbrojtje dhe si propozim është shqiptimi i masës mbrojtëse – trajtimi psikosoacial, gjykata në bazë të dëgjimit të palëve, por edhe nxjerrjes së provave të tjera, konstaton se kryesi i dhunës, lëshimet apo veprat e qëllimshme ka mundur t'i kryejë për shkak të gjendjes së rënduar psikike, emocionale apo si shkak i ndonjë çrregullimi psikik të përkohshëm. Për të hetuar këtë rrethanë detyrimisht duhet që edhe pa propozimin e palëve, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare, të nxjerrë provë me ekspertizën nga lëmia përkatëse, ngase rrjedhimisht përmes nxjerrjes dhe vlerësimit të drejtë të kësaj prove, do të varet edhe mënyra e vendosjes lidhur me shqiptimin e masave tjera mbrojtëse të propozuara nga pala e mbrojtur dhe kohëzgjatjen e tyre.

Gjykatat duhet të jenë të kujdesshme në rastet e propozimeve për masën mbrojtëse të trajtimit psikosocial, sepse nuk përjashtohet mundsia që propozimet e tilla të paraqiten edhe kur shkak i dhunës nuk është fare i lidhur me gjendjen psikosociale të kryerësit të dhunës. Gjykata para së të vendos për marrjen e provës me ekspertim nga lëmia e psikiatrisë, duhet të ketë prova rrethanore që flasin për fakte që lidhen me gjendjen shëndetësore të kryerësit të dhunës. Nuk do të ishte e drejtë nëse gjykatat nuk do të kishin kujdes dhe do të urdhërojnë ekspertizë psikiatrik të kryerësit të dhunës, i cili aktin e dhunës nuk e ka kryer në gjendje të rënduar psikosociale. Nëse do të veprohej në këtë mënyrë rrezikojmë që të humbet besimi në gjykatë, sepse veprime të gjykatës mund të perceptohen si jo objektive dhe jo serioze. Prandaj gjithmonë gjykata duhet të shfrytëzojë autorizimet e saj, përmes pyetjeve të ndryshme që mund t'iu paraqiten palëve ndërgjyqësore, por edhe subjekteve të tjerë në procedurë, të sigurohet paraprakisht se a është e nevojshme marrja e provës me ekspertizë.

Gjykata ka autorizim që sipas pretendimeve të palëve ndërgjyqësore, të shfrytëzojë edhe mundsinë që në rrugë zyrtare të merr dokumente apo informacione të rëndësishme në funksion të vërtetimit të fakteve përcaktuese të çështjes kontestuese. Kështu me dispozitën e nenit 332 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, përcaktohet së: *“Nëse dokumenti ndodhet tek organi shtetëror ose personi juridik, të cilit i është besuar ushtrimi i autorizimeve publike, kurse pala vetë nuk është në gjendje ta dorëzojë apo tregojë atë, atëherë gjykata sipas propozimit të palës do ta marrë sipas detyrës zyrtare këtë dokument”*. Nga interpretimi i kësaj dispozite, rezulton se sipas pretendimeve

të palëve, për nevoja të procedurës, gjykata mund të kërkojë marrjen e ndonjë dokumenti i cili mund të shërbejë për vërtetimin e fakteve kontetsuese.

Kështu, para se gjykata të vendos për ekspertim psikiatrik të kryerësit të dhunës, nëse ka informata që kryesi i dhunës në një periudhë më të hershme është trajtuar nga ndonjë problem psikik, pranë një klinike të caktuar, atëherë gjykata mund të kërkojë informacion nga klinika, spitali apo çfarëdo qendre apo institucioni që është trajtuar kryerësi i dhunës. Për gjendjen paraprake të kryerësit të dhunës gjykata informohet nga pretendimet e palës së mbrojtur, por edhe të subjekteve tjerë të përfshirë në procedurë apo edhe nga ndonjë procedurë gjyqësore e mëhershme, ku si subjekt i procedurës në çfarëdo cilësie të ketë qenë kryesi i dhunës.

Pasi që gjykata të konstatojë nevojën e marrjes se ekspertizës për gjendjen shëndetësore të kryerësit të dhunës, e njëjta mundet edhe pa propozimin e palëve të vendos për marrjen e provës. Mundsia e marrjes se ekspertizës pa propozimin e palëve, përcaktohet me dispozitën e nenit 356 të LPK-së, ku përcaktohet së: *“Gjykata ex-officio ose me propozimin e palëve mund të bëjë të provuarit me anë të ekspertizës, sa herë që për vërtetimin apo sqarimin e fakteve apo të rrethanave të caktuara nevojitet dijeni profesionale të cilën nuk e ka gjyqtari i çështjes”*.

Pas marrjes se ekspertizës përkatëse, gjykata duke i vlerësuar të gjeturat me ekspertizë, duhet të vlerësojë nevojën për shqiptimin e masës mbrojtëse të trajtimit psikosocial. Një masë e tillë gjithsesi duhet të jetë e justifikuar nga shkaku i dhunës dhe nga nevoja e trajtimit të kryerësit të dhunës, për të evituar, respektivisht për të parandaluar në të ardhmen përsëritjen e dhunës. Në asnjë mënyrë nuk mund të shqiptohet një masë e tillë pa marrjen e ekspertizës përkatëse për të konstatuar nevojën e trajtimit psikosocial¹⁰.

Nëse gjykata gjatë seancës dëgjimore, përmes provave të administruara vlerëson se plotësohen kushtet ligjore për shqiptimin e masës së trajtimit psikosocial, përmes vendimit të nxjerrë, e në kuptim të Udhëzimit Administrativ nr. 12/2012 për përcaktimin e vendit dhe mënyrës së trajtimit psikosocial të kryesit të dhunës në familje, duhet urdhëruar organin kompetent, i cili e ka për detyrim

¹⁰ Gjykata a Apelit, me aktvendimin Ac.nr.2330/17, të datës 14.06.2017, ka vendosur ta prish aktvendimin e gjykatës së shkallë së parë në pjesën e dispozitivit me të cilin është caktuar masa e trajtimit psikosocial, për shkak së gjykata ka caktuar një masë të tillë pa marrjen e provës me ekspertizë.

Gjykata e Apelit, ka theksuar: *“Për pjesën që është kthyer në rishqyrtim, gjykata ka vlerësuar se për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës, konstatimit jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, është vendos që pjesërisht çështja të kthehet në rishqyrtim, më qëllim që në riprocedurë gjykata të evitojë shkeljet e sipër theksuara duke zhvilluar procedurën për vërtetimin e fakteve vendimtare mbi bazën e të cilave do të konstatojë nevojën për caktimin e masës së trajtimit psikosocial. Në këtë pikë duhet të vërtetohen faktet vendimtare mbi bazën e të cilave duhet të vërtetohet nëse është e nevojshme që të caktohet masa për trajtimit psikosocial. Vërtetimi i fakteve duhet të bëhet përmes nxjerrjes së ekspertizës përkatëse, e cila duhet të nxjerret si provë në përputhje me dispozitat e LPK-së. Para se të nxjerrët ekspertiza si provë gjykata duhet që përmes vlerësimit të rrethanave të caktuara të bindet se është e nevojshme nxjerrja e ekspertizës. Kjo nënkupton se gjykata duhet të ketë ndonjë indikator se pala përgjegjëse ka probleme të natyrës psikike, e pastaj të vendosë për marrjen e provës me ekspertizë dhe rrjedhimisht edhe të vendos masën e trajtimit psikosocial”*.

të zbatohet këtë masë të shqiptuar, që trajtimi i kryesit të dhunës të bëhet në përputhje me këtë udhëzim administrativ dhe kohëzgjatja e masës së shqiptuar të vlejë, derisa të përfundojnë shkaqet mbi bazën e të cilave i është shqiptuar kryesit të dhunës, por jo me shumë se 6 muaj.

Krahas kësaj mase mbrojtëse, gjykata mund të caktojë edhe masat tjera mbrojtëse të parapara me dispozitat ligjore të LMDHF, por në asnjë rast masat tjera mbrojtëse nuk mund të shqiptohen në kohë më të gjatë sesa kohëzgjatja e urdhrit mbrojtës më të cilin kryesit të dhunës i është shqiptuar masa mbrojtëse e trajtimit psikosocial.

Në praktikë gjyqësore, ekzistojnë edhe rastet kur gjykatat fare nuk vlerësojnë propozimin për shqiptimin e masës mbrojtëse të trajtimit psikosocial, por konsiderojnë së konsumohet procedura e mbrojtjes nga dhuna në familje duke e caktuar urdhrin mbrojtës dhe masa të tjera. Një veprim i tillë nuk mund të justifikohet, sepse do të bie ndesh me qëllimin e ligjit i cili është parandalimi i dhunës më masa të përshtatshme. Kjo vlen veçanërisht në rastet kur në mënyrë të pakontestueshme konstatohet së shkakut i dhunës është gjendja shëndetësore e rënduar e kryerësit të dhunës.

Në lidhje me këtë gjykata e shkallës së dytë mban qëndrim formal-ligjor në raport me vendimet e gjykatave të shkallës së parë, ku konstatohet se nuk është vendosur për të gjitha propozimet dhe të gjitha masat e nevojshme për parandalimin e dhunës¹¹, sepse duke mos i shqyrtuar dhe vlerësuar propozimet për masa, atëherë rrezikon që vetë gjykatat të pengojnë parandalimin e dhunës në të ardhmen duke neglizhuar propozimet e palëve.

Me Ligjin për Procedurën Jokontestimore (LPJ), dispozita nga neni 75 deri 96, përcaktojnë procedurën e vendosjes dhe mbajtjes së të sëmurit psikik në institucionin shëndetësor.

¹¹Gjykata e Apelit me aktvendimin Ac.nr.1637/17, të datës 24.01.2017, konstaton së gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) dhe 0) e lidhur me nenin 160 të LPK-së, gjendja faktike në këtë pjesë nuk është vërtetuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë, me çka ka ardhur edhe gjer tek zbatimi i gabuar i të drejtës materiale. Gjykata e Apelit në arsyetim të aktvendimit (*pjesë nga arsyetimi*) ka theksuar së: “Po qe se i referohemi kërkesës për urdhër mbrojtje të parashtruar nga pala e mbrojtur, rezulton se e njëjta ka kërkuar që gjykata e shkallës së parë, pas mbajtjes së seancës dëgjimore dhe administrimit të provave, të bie aktvendim më të cilin do të caktohen masat mbrojtëse nga neni 6 pika 2 të LMDHF caktimi i kujdestarisë së përkohshme ndaj fëmiut të përbashkët –të miturit D. palës se mbrojtur dhe heqja e përkohshme e të drejtës prindërore kryesit të dhunës, neni 5 pika 1 dhe 2 të LMDHF ndalimi afrimi kryesit të dhunës që ti ofrohet palës së mbrojtur në rrugë dhe vend punimin e saj në distancë prej 50 metrash, neni 4 pika 1, 2 dhe 3 të LMDHF trajtimi psikosocial i kryesit të dhunës dhe masat mbrojtëse të parapara me nenin 2 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 pika 1.2.1, 1.2.2, 1.2.3 dhe 1.2.5, nenin 6.1, nenin 8 dhe nenin paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të LMDHF.

Gjykata e shkallës së parë përkundër faktit se para vetes ka pasur një kërkesë të qartë të palës se mbrojtur, pranë se cilës kërkesë pala e mbrojtur ka mbetur në tërësi edhe në seancën dëgjimore të mbajtur, gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes nuk ka vendosur lidhur kërkesën e palës se mbrojtur që kryesit të dhunës ti ndalohet afrimi palës se mbrojtur në rrugë dhe vend punimin e saj në distancë prej 50 metrash dhe masën e trajtimit psikosocial të kryesit të dhunës, edhe pse ligjërisht ka pasur për detyrim që të vendos lidhur me të gjitha kërkesat e palës se mbrojtur.

Sipas vlerësimit të gjykatës ankimore, në rastin konkret sikurse gjykata e shkallës së parë të vlerësonte masën e trajtimit psikosocial të kryesit të dhunës, e cila është kërkuar nga pala e mbrojtur, pastaj varësisht prej bazueshmërisë së kësaj mase të propozuar, vendimi i gjykatës së shkallës së parë, rrjedhimisht do të ishte me ndikim edhe për vendosjen lidhur me masat tjera të propozuara nga pala e mbrojtur”.

Masa mbrojtëse e trajtimit psikosocial duket analoge me procedurën e vendosjes dhe mbajtjes së të sëmurit psikik në institucionin shëndetësor, por në procedurën për urdhër mbrojtje gjykata për nevojën e secilës masë bënë vlerësimet adekuate pa u ndikuar nga procedura tjera të mundshëm në të cilat mund të jenë të përfshira palët e njëjta. Kjo parashihet me dispozitën e nenit 12 paragrafi 1, i LMDHF.

Masat mbrojtëse të ndalimit të afrimit të viktimës së dhunës në familje

Me shqiptimin e kësaj mase i ndalohet kryesit të dhunës në familje që t'i afrohet viktimës, personave të tjerë që janë të varur nga viktima apo personave të tjerë nëse është e nevojshme. Kjo masë i shqiptohet kryesit të dhunës në familje dhe nëse ekziston rreziku i përsëritjes së dhunës, me qëllimi të evitimit të rrezikut për përsëritjen e dhunës në familje.

Në urdhrin me të cilin caktohet kjo masë, gjykata e cakton edhe vendin, regjionin dhe largësinë, brenda së cilës kryesi nuk guxon t'i afrohet viktimës së dhunës në familje. Nga kjo dispozitë nuk do duhej të nxirret përfundimi se gjykata me rastin e caktimit të kësaj mase, duhet gjithmonë të caktojë edhe vendin dhe regjionin ku kryesi i dhunës nuk guxon t'i afrohet viktimës, por vetëm në ato raste kur e sheh të arsyeshme duhet të bëhet kjo.

Konsiderohet që kjo masë të vendoset kur ka rrezik, pra ka fakte të besueshme se duke e lejuar kryesinë të lirë që t'i afrohet viktimës, mund të përsëritet dhuna në të ardhmen.¹²

Në lidhje me këtë masë në praktikën gjyqësore paraqiten raste kur shqiptimi i një mase të tillë, para caktimi i një distance brenda të cilës kryerësi i dhunës nuk guxon t'i afrohet viktimës-palës së mbrojtur, si masë bie në kundërshtim me masat tjera ose objektivisht kryerësi i dhunës e ka të pamundur ti përmbahet një distance të caktuar nga ana e gjykatës. Pavarësisht së masa e ndalimit të afrimit viktimës së dhunës, duket në mesin e masave më teknike, kjo nuk nënkupton që gjykatat nuk duhet ta vlerësojnë caktimin e një mase të tillë në mënyrë objektive dhe sipas rrethanave të rastit konkret. Në vendime të gjykatave të shkallës së parë, shpesh vërehet se kjo masë caktohet pa u vlerësuar mirë nevoja e caktimit, distanca e nevojshme, mundësia objektive e ruajtjes së distancës nga kryerësi i dhunës, gjithashtu në disa raste kjo masë bie në kundërshtim me masat tjera.

Shembull: Ka raste kur gjykata ka vendosur që të shqiptojë masën mbrojtëse me të cilën është urdhëruar kryerësi i dhunës në familje që të lejohet palën e mbrojtur të shfrytëzojë banesën të cilën e përdorin së bashku ose ndonjë pjesë të saj dhe krahas kësaj mase ka shqiptuar edhe masën e ndalimit të afrimit viktimës së dhunës në familje duke e caktuar distancën (*për shembull 2 metra, 5 metra, etj.*). Në këtë rast urdhri mbrojtës është i shkëlur në momentin e kthimit të viktimës në banesën ku duhet të jetojë sipas urdhrit të gjykatës. Shtrohet pyetja logjike, si mund të ruhet

¹² Haxhi Gashi & Ruzhdi Berisha, "Komentari" i Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Prishtinë 2014, fq.63.

distanca 2 metra ose 5 metra brenda ambientit të përbashkët, siç janë shkallët hyrëse, dera hyrëse, korridori, kuzhina, banjë etj.

Shembull: Kryersi i dhunës dhe pala përgjegjëse punojnë të dy në ambientin e njëjtë dhe gjykata e cakton masën mbrojtëse të ndalimit të afrimit viktimës së dhunës në familje, duke e caktuar vendin e punës si vend ku nuk guxon t'i afrohet viktimës në distancë prej 5 metra. Shtrohet pyetja a mundet të ruhet distanca prej 5 metra në ambientin e njëjtë të punës (psh. zyra e njëjtë)¹³.

Shembull: Është caktuar kontakti i kryerësit të dhunës me fëmijët e tij, i cili jeton me palën e mbrojtur dhe njëkohësisht është caktuar distanca prej 50 metra brenda të cilës kryerësi i dhunës nuk guxon t'i afrohet palës së mbrojtur. Shtrohet pyetja logjike, dorëzimi i fëmijës të kryerësi i dhunës nga kush bëhet? S' do mend së bëhet nga pala e mbrojtur. Në këtë rast kur fëmija dorëzohet nga pala e mbrojtur tek kryesi i dhunës ose në Qendrën për Punë Sociale, duke qenë se termini është i caktuar nga ana e gjykatës, a mund të ruhet distanca prej 50 metra?

Përveç shembujve të lartcekur, e të cilët në praktikën gjyqësore janë të shpeshtë, gjykatat duhet të kenë kujdes edhe në rast kur me të vërtetë ekzistojnë shkaqet që diktojnë nevojën e shqiptimit të masës së ndalimit të afrimit viktimës së dhunës në familje, që caktimi i distancës të jetë i arsyeshëm, duke pasur në vëmendje ambientin kur duhet të ruhet distanca. Ekzistojnë rastet kur gjykatat, në vendet publike caktojnë distancën 50 metra. Si mund të zbatohet kjo kur kryerësi i dhunës dhe viktimat ndjekin rrugën e njëjtë për të shkuar tek banesat e tyre, tek puna e tyre, etj.

Sipas arsyeve të paraqitura, rritet nevojën që kërkesa për një masë të tillë të mos shikohet vetëm në aspektin teknik, por e njëjta të vlerësohet në mënyrë përmbajtëse dhe të shqiptohen në

¹³ Gjykata e Apelit, me aktvendimin Ac.nr. 3363/16, të datës 20.09.2016, ka vendosur ta ndryshoj aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me distancën e caktuar nga gjykata, brenda së cilës kryerësi i dhunës nuk mund të afrohet viktimës së dhunës. Për ndryshimin e vendimit gjykata ka arsyetuar së në rastin konkret nuk mund të ruhet objektivisht distanca.

Gjykata e Apelit, ka theksuar: “ Lidhur me pjesën e ndryshuar të aktvendimit të atakuar sa i përket masave mbrojtëse të shqiptuara me paragrafin III të aktvendimit, Gjykata e Apelit duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale, ka bërë ndryshimin e aktvendimit në kuptim të dispozitës së nenit 209 paragrafi 1 pika (c) e lidhur me nenin 208 të LPK-së, sepse ka gjetur se nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, por sipas kësaj gjendje faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë është zbatuar gabimisht e drejta materiale, për çka është dashur që të ndryshohet aktvendimi i atakuar.

Në këtë rast janë zbatuar në mënyrë të gabuar dispozitat e nenit 5 të LMDH -së. Deri te ky qëndrim dhe përfundim i Gjykatës së Apelit për pjesën e ndryshuar është ardhur për shkak se kjo gjykatë konsideron se me urdhrin e shqiptuar si në pikën II të dispozitivit të aktvendimit të atakuar është konsumuar nevoja për shqiptimin e masave mbrojtëse si në pikën III të dispozitivit të aktvendimit të atakuar, aq më tepër kur kihet parasysh fakti se masa e shqiptuar me pikën III është në kundërshtim me gjendjen faktike, pasi që nga provat e administruara është provuar se kryerësi i dhunës dhe viktimat veprimtarinë e punës e realizojnë në ambiente të njëjta, prandaj logjikisht rrjedh se nuk mund të ruhet distanca e përcaktuar në ambientin e njëjtë të punës apo në shtëpinë e përbashkët.

atë mënyrë që t'i shërbejë parandalimit të dhunës, por asesi kryesi i dhunës të vendoset në pozitë të tillë, ashtu që objektivist ta ketë të pamundur ruajtjen e distancës.

Masa mbrojtëse e ndalimit të shqetësimit të personave të ekspozuar dhunës

Masa mbrojtëse e ndalimit të shqetësimit të personave të ekspozuar dhunës përcaktohet me dispozitën e nenit 6 paragrafi 1, të LMDHF dhe mund t'i shqiptohet kryesit të dhunës në familje në të gjitha rastet e kryerjes së dhunës në familje të parashikuara me nenin 2 nën paragrafi 1.2, të LMDHF, nëse ekziston rreziku i përsëritjes së dhunës në familje.

Në kuadër të dispozitës ligjore me të cilën është parashikuar kjo masë mbrojtëse, me paragrafin 2 të këtij neni (*neni 6*), është rregulluar edhe kujdestaria e përkohshme e fëmijës, me çka dispozita përcakton së: “ *Kujdestaria e fëmijës përkohësisht i besohet viktimës së dhunës në familje, ndërsa e drejta prindërore përkohësisht i hiqet kryerësit të dhunës në familje*”.

Me dispozitën e nenit 6, paragrafi 1, të LMDHF, përcaktohet masa e ndalimit të shqetësimit për personat e ekspozuar dhunës duke dhënë hapësirë që gjykata varësisht nga kërkesat, por edhe nga rrethanat të vendos një kombinim masash me përkufizim si në neni 2, nën paragrafi 1.2, të LMDHF.

Duke e pasur parasysh mundsinë që masa e ndalimit të shqetësimit të personave të ekspozuar dhunës në familje mund të shqiptohet sipas përkufizimit që japin dispozitat e nenit 2, nën paragrafi 1.2, të LMDHF, në praktikë zakonisht kjo masë shqiptohet e kombinuar me disa masa që bazën e kanë në nenin 2 nënparagrafi 1.2. të LMDHF.

Kombinimi i masave për rastet konkrete diktohet në mënyrë parimore nga mënyra dhe forma e shfaqjes së dhunës.

Shembull: Nëse dhuna është shfaqur në formë të përdorimit të forcës fizike ose presionit psikik të ushtruar ndaj anëtarit të familjes (*neni 2, nën paragrafi 1.2, pika 1.2.1*), atëherë edhe masa e ndalimit të shqetësimit të personave të ekspozuar ndaj dhunës, do të shqiptohet si ndalim i përdorimit të forcës fizike apo psikike të ushtruar ndaj anëtarit të familje.

Nëse dhuna është shfaqur si shkaktim i ndjenjës së frikës, rrezikshmërisë personale apo cënimit të dinjitetit, do të ishte e arsyeshme që edhe masa të ishte ndalim i shkaktimit të ndjenjës së frikës, rrezikshmërisë personale apo cënimit të dinjitetit.

Zakonisht në praktikë gjykatat kur vendosin për masën e ndalimit të shqetësimit të personave të ekspozuar ndaj dhunës, vendosin për më shumë masa të kombinuara të cilat rrjedhin nga mënyra

se si është shfaqur dhuna në familje, por edhe si nevojë e vendosjes së masave të përshtatshme për parandalim¹⁴.

Masa e Kujdestarisë së Përkohshme të Fëmijës

Kjo masë është përcaktuar me dispozitën e nenit 6 paragrafi 2, të LMDHF, e cila sipas përkufizimit ligjor që ka në zbatim, paraqet një sfidë të vërtetë për praktikën gjyqësore në rastet e paraqitura në gjykatë për mbrojtje gjyqësore me propozim që të caktohet edhe kjo masë.

Lidhur me zbatimin e kësaj dispozite për këtë masë (*kujdestarinë e përkohshme dhe heqjen e të drejtës prindërore përkohësisht*), në praktikë janë krijuar mënyra të ndryshme të veprimit nga ana e gjykatave të shkallës së parë.

Për të pasur një ide më të qartë dhe më konkrete për arsyet e zbatimit të kësaj dispozite, në mënyrë jo unike nga ana e gjykatave është bërë një përpjekje për të tërhequr një paralele në mes të dispozitave të Ligjit për Familjen i Kosovës (LFK), për çështjen e të drejtës prindërore, çështjen e besimit, kontaktit dhe alimentacionit, si dhe dispozitave të LMDHF për këtë çështje.

Kujdestaria e përkohshme e fëmijës sipas LMDHF - duket se qëllimi i ligjvënësit që kujdestaria e përkohshme e fëmijës t'i besohet përkohësisht viktimës së dhunës në familje, ndërsa e drejta prindërore t'i hiqet përkohësisht kryerësit të dhunës ka qenë si masë për parandalimin e dhunës. Kjo masë ka logjikën e saj, ngase për shkak të rrezikut për përsëritjen e dhunës duke i hequr përkohësisht kryerësit të dhunës të drejtën prindërore në mënyrë të ligjshme i pamundsohet kontakti me fëmijën. Në çdo rast kur prindit nuk i është hequr e drejta prindërore, ai e ka të drejtën e mbajtjes së kontakteve me fëmijën e mitur, jo vetëm si e drejtë prindërore, por edhe si interes i fëmijës, sepse fëmija e ka të drejtën që të rritet me të dy prindërit edhe në rastin kur prindërit në mënyrë faktike e kanë ndërprerë jetën e përbashkët, ashtu që kjo e drejtë e fëmijës dhe e prindit realizohet duke mbajtur kontakte të vazhdueshme¹⁵.

¹⁴ Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, duke vendosur në çështjen C.nr.2808/17, me datën 24.10.2017, në seancë dëgjimore ka nxjerrë aktvendimin duke e caktuar urdhrin për mbrojtje. Në pjesën e parë të diapozitivit ka vendosur: “*Urdhërohen palët përgjegjëse _____ dhe _____, nga _____, që ndaj palës së mbrojtur _____, të mos ndërmarrin kurrfarë veprimesh të dhunës fizike, psikike, shqetësimi apo komunikimit, pa prezencën e punëtorit social, sikundër që të njëjtit Urdhërohen që të mos i afrohen palës së mbrojtur në banesën ku banon në Prishtinë, Rr. _____, në distancë prej 100 metra dhe në rrugë publike në distancë prej 10 metra*”.

¹⁵Gjykata e Apelit duke vendosur në procedurën e ankesës, gjen se vendimi i gjyaktës së shkallës së parë për heqjen e përkohshme të së drejtës prindërore dhe caktimi i kontaktit të kryerësit të dhunës me fëmijën është i përfshirë në shkelje. Gjykata e Apelit, me vendimin Ac.nr.115/17, i datës 19.01.2017, thekson së: “*Lidhur me zbatimin e të drejtës materiale duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare, Gjykata e Apelit, vlerëson se dispozita e nenit 6 paragrafi 2, i LMDHF -së, është zbatuar gabimisht për arsye së heqja e të drejtës prindërore përkohësisht për kryerësin e dhunës dhe caktimi i kontaktit për të njëjtin me fëmijën e mitur, nuk mund të vendosen njëkohësisht. Gjykata duhet sipas propozimeve të palëve, por edhe zyrtarisht të hetojë rrethanat e çështjes nëse është e nevojshme heqja e të drejtës prindërore*

Në kuadër të dispozitës ligjore me të cilën është parashikuar masa mbrojtëse e ndalimit të shqetësimit të personave të ekspozuar dhunës, me paragrafin 2 të këtij neni është rregulluar edhe besimi përkohësisht i fëmijës njërit nga prindërit, në rastet kur dhuna në familje është kryer ndaj njërit nga prindërit e fëmijës. Në këto raste gjykata vendos që kujdestaria e fëmijës përkohësisht t'i besohet viktimës së dhunës në familje, ndërsa e drejta prindërore përkohësisht i hiqet kryesit të dhunës në familje.

Më anë të kësaj dispozite ligjore nuk është i paraparë afati kohor rreth kujdestarisë së përkohshme të fëmijës së viktimës së dhunës në familje dhe heqjen e të drejtës prindërore ndaj kryesit të dhunës, me çka në situatat e tilla, gjykatat duhet t'i referohen dispozitës ligjore të nenit 11 paragrafi 3 të LMDHF, më të cilën shprehimisht parashihet se: „Masat mbrojtëse të parapara me nenet 4,5,6,7,8,9,10 dhe 11 shqiptohen në pajtim më kohëzgjatjen e urdhrit mbrojtës” dhe masën e shqiptuar mbrojtëse të paraparë me nenin 6 të këtij ligji, gjykatat duhet ta shqiptojnë në pajtim me kohëzgjatjen e urdhrit mbrojtës të caktuar.

Edhe pse paragrafi 2 i nenit 6, të LMDHF, për nga përmbajtja e tij del të jetë dispozitë ligjore e karakterit imperativ, me interpretimin e të cilës mund të kuptohet se gjykata në çdo rast kur konstaton dhe gjen se duhet të caktohet masa mbrojtëse e ndalimit të shqetësimit personave të ekspozuar dhunës, sipas përkufizimit të dhënë me nenin 2 nën-paragrafi 1.2 të LMDHF, ka për obligim ligjor që duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare, fëmijën apo fëmijët e mitur të cilët i ka pala e mbrojtur dhe kryesi i dhunës, t'ia besojnë kujdestarit të përkohshme viktimës se dhunës në familje, ndërsa e drejta prindërore t'i hiqet përkohësisht kryesit të dhunës në familje.

Mirëpo, sipas mendimit të Gjykatës se Apelit, gjykata para se të vendos lidhur më një gjë të tillë, duhet të vlerësojë në mënyrë të drejtë dhe objektive se fëmijët e mitur a i janë ekspozuar dhe a mund t'i ekspozohen në të ardhmen, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, dhunës së shkaktuar në mes prindërve të tyre, e cila do të kishte ndikim negativ në rritjen dhe zhvillimin e drejtë psikik dhe fizik të tyre në të ardhmen.

përkohësisht dhe nëse konstaton se duhet ti hiqet e drejta prindërore kryerësit të dhunës, atëherë për të njëjtin nuk mund të caktohet kontakti, por nëse gjen se nuk është e nevojshme heqja e të drejtës prindërore, atëherë mund të caktohet kontakti. Përveç tjerave gjykata duhet të ketë në konsideratë së çdo fëmijë ka të drejtë të rritet me të dy prindërit, ndërsa në rastet kur kjo është e pamundur, kjo e drejtë realizohet përmes kontaktit, por në asnjë rast nuk mund të justifikohet kontakti si e drejtë duke e rrezikuar fëmijën apo kujdestarin/en e fëmijës.

Nën këto rrethana, gjykata e shkallës së dytë gjeti se vendimi i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë, duhet prishur në pikën III (tre), më qëllim që në ri procedurë gjykata e shkallës së parë ti evitojë shkeljet e dispozitave të sipër theksuara, në atë mënyrë që në procedurën sipas kërkesës për urdhër mbrojtje të kujdeset për specifikat e procedurës, duke hetuar të gjitha rrethanat sipas të cilave gjykata mund të sjellë një vendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Gjykata duhet të ketë një vlerësim specifik për nevojën e kujdestarisë së përkohshme, për heqjen eventuale të së drejtës prindërore dhe për caktimin apo mos caktimin e kontaktit në mes të fëmijës se mitur dhe palës përgjegjëse, gjithsesi duke respektuar dispozitat e së drejtës materiale”.

Në çdo rast, kur gjykata vlerëson se është e nevojshme që ndaj kryesit të dhunës të shqiptohet masa mbrojtëse e ndalimit të shqetësimit të personave të ekspozuar dhunës dhe fëmijët i janë ekspozuar dhunës së shkaktuar, e që mund t'i ekspozohen edhe në të ardhmen, atëherë varësisht edhe prej masave të tjera mbrojtëse, të cilat mund t'i shqiptojë, detyrimisht duhet të vendos edhe lidhur me besimin e kujdestarisë se përkohshme të fëmijëve njërit prind dhe heqjen e së drejtës së përkohshme prindit tjetër, ashtu siç edhe kërkohet me paragrafin 2 të nenit 6 të LMDHF –së. Kjo për shkak se çdoherë duhet të merret parasysh interesi më i mirë i të miturit në rritjen dhe zhvillimin e drejtë psikik dhe fizik të tij në të ardhmen.

Gjykatat në çdo rast, kur fëmijën e mitur përkohësisht nën kujdestari i a besojnë njërit prind, ndërsa të drejtën prindërore i a heqin përkohësisht prindit tjetër, duhet të kenë parasysh se në këtë situatë nuk mund të lejohet kontakti i fëmijës së mitur me prindin të cilit përkohësisht i`u ka hequr e drejta prindërore. Kjo pasi që, masa e shqiptuar është e karakterit të përkohshëm dhe zgjatë aq sa edhe urdhri mbrojtës i caktuar nga gjykata. Kjo masë e shqiptuar ka për qëllim që kryesi i dhunës t`i ndjejë pasojat e dëmshme dhe jo të këndshme të cilat kanë ardhur si shkak i veprës apo lëshimeve të tij të qëllimshme të ndërmarra ndaj anëtarit tjetër të familjes dhe që në një formë apo formë tjetër tek i njëjti do të rrisin ndërgjegjen për veprimet të cilat mund ti ndërmer në të ardhmen apo ato të cilat tani më i ka ndërmarrë.

Caktimi i masës nga neni 6 paragrafi 2 të LMDF, po ashtu nuk ka asnjë ndikim në të drejtat e palëve, që ata përmes padisë në procedurën kontestimore, të kërkojnë që të vendoset lidhur me besimin e fëmijëve njërit apo prindit tjetër, kontaktin, alimentacionin, por edhe ndonjë kërkesë tjetër. Kjo pasi që masat të cilat caktohen nga gjykata, sipas dispozitave të parapara me LMDHF, janë të karakterit të përkohshëm, qëllimi i të cilave është ruajtja e një gjendjeje ekzistuese dhe lehtësimi i pasojave të dëmshme, të cilat janë shkaktuar apo mund të shkaktohen si rezultat i veprave apo lëshimeve të qëllimshme që një anëtar i familjes i ka ndërmarrë ndaj anëtarit tjetër.

Masa mbrojtëse e largimit nga banesa, shtëpia apo hapësira tjetër e banimit

Me dispozitën e nenit 7 të LMDHF është paraparë masa mbrojtëse e largimit nga banesa, shtëpia apo hapësira tjetër e banimit, e cila i shqiptohet personit që ka kryer dhunë ndaj anëtarit të familjes me të cilin jeton në banesë, shtëpi apo në ndonjë hapësirë tjetër banimi, nëse ekziston rreziku i përsëritjes së dhunës në familje.

Për shqiptimin e kësaj mase duhet të plotësohet kushti që paraprakisht të jetë kryer njëra nga format e dhunës në familje nga një person ndaj personit tjetër me të cilin jeton në banesë, shtëpi apo hapësirë tjetër të banimit, në rastet kur ekziston rreziku i përsëritjes së dhunës në familje.

Me urdhrin me të cilin caktohet kjo masë mbrojtëse duhet urdhëruar personi të cilit i është shqiptuar masa, që të obligohet menjëherë ta lëshojë banesën, shtëpinë apo hapësirën tjetër të

banimit, në prezencën e zyrtarit policor. Duke u nisur nga fakti, që ankesa kundër vendimit për caktimin e urdhrit për mbrojtje apo për mbrojtje të menjëhershme nuk e ndalon ekzekutimin (*neni 19 paragrafi 3*), kjo masë mbrojtëse do të ekzekutohet menjëherë në praninë e zyrtarit policor.

Shqiptimi i kësaj mase, sigurisht se është një prej masave, e cila në raste të caktuara vlerësohet të jetë masë e përshtatshme për parandalimin e dhunës në familje, por i mbetet gjithmonë gjykatës të vlerësojë në mënyrë objektive nevojën e shqiptimit të një mase të tillë. Shqiptimin e një mase të tillë, e justifikon vetëm vlerësimi objektiv, së nëse nuk shqiptohet kjo masë ekzistojnë mundsitë e përsëritjes së dhunës dhe nga ana tjetër nuk ekziston ndonjë masë tjetër alternativeme të cilën do të arrihej efekti i njëjtë parandalues.

Në pikëpamje praktike, kjo masë në disa raste mund të jetë alternative me masën e ndalimit të shqetësimit personave të ekspozuar ndaj dhunës, me masën e lejimit për palën e mbrojtur që të shfrytëzojë një pjesë të banesës apo me masën e detyrimit të kryerësit që të paguajë qiranë e banesës së përkohshme të palës së mbrojtur.

Shembull: Mund të jetë me efektive masa e detyrimit të pagesës së qirasë së sa masa e largimit të kryerësit të dhunës nga banesa, madje zbatimi i saj mund të mbikëqyret shumë me lehtë. Sido që të jetë i mbetet vlerësimi të gjykatës që të vlerësoj specifikat e rastit, e pastaj të vendos edhe për masat e përshtatshme për parandalimin e dhunës në familje.

Disa nga rrethanat që mund të diktojnë nevojën e shqiptimit të kësaj mase kanë të bëjnë me numrin e subjekteve të cilët janë palë e mbrojtur (*për shembull bashkëshortja dhe fëmijët*), ka të bëjë me rrethanën se kush është kryeri i dhunës (*bashkëshorti, vjehëri, vjehërra, nusja apo persona në gjini gjaku apo të krushqisë në shkallë me të largët*).

Gjykata në disa raste janë treguara të rezervuara në shqiptimin e kësaj mase sepse qëllimi i ligjit përveç së është që të parandalohet dhuna me masa të përshtatshme është edhe rehabilitimi i kryerësve të dhunës dhe lehtësimi i pasojave.

Në kontekstin e këtij qëllimi dhe të rrethanave me të cilat paraqiten raste për mbrojtje gjyqësore gjykatat këtë masë e kanë aplikuar në me pak raste. Shqiptimi i kësaj mase në praktikën gjyqësore vjen në shprehje vetëm në raste kur me masat tjera nuk mund të sigurohet se do të arrihet preventiva e ndalimit të përsëritjes së dhunës. Përveç kësaj ka një logjikë edhe për shkak të raporteve familjare të cilat edhe pas caktimit të urdhrit mbrojtës dhe shqiptimit të masave vazhdojnë të jenë raporte familjare. Disa here është thënë së qëllimi i LMDHF do të përmbushet nëse gjykatat vendosin vetëm masat e nevojshme pa e ekzagjeruar situatën dhe po ashtu pa e minimizuar aktin e dhunës.

Gjykatat duhet të vlerësojnë të gjitha fakte vendimtare në një çështje të iniciuar sipas kërkesë për urdhër mbrojtje dhe mbi bazë e fakteve vendimtare duhet të arrijnë në përfundime të ligjshme dhe të drejta. Shpesh në praktikë paraqitën raste të dhunës në mes të bashkëshortëve, personave në bashkësi jashtëmartesore apo edhe të familjarëve në gjini gjaku si prindërit me fëmijët dhe anasjelltas. Jo gjithmonë këto raste përcillen me rrezikun permanent të përsëritjes së dhunës dhe në disa raste dhuna është në limitet e një mos marrëveshjeje verbale dhe që faktet e çështjes nuk flasin për një sjellje dhune të përsëritur, andaj rekomandohet që masat e shqiptuara të jenë në përputhje me nevojën e parandalimit të dhunës.

Në çdo rast që shqiptohen masa të pa justifikuar mund të ndodh që vendimi i gjykatës për një periudhë të përkohshme të shërbej vërtetë si preventive në përsëritjen e dhunës, por pas kalimit të periudhës së përkohshme ekziston mundësia potenciale që raporte familjare të jenë çrregulluar seriozisht dhe mundësia e rivendosjes të jetë e pamundur.

Çështjet e dhunës në familje në gjykatë paraqitën me tërë kompleksitetin e tyre familjar, shoqëror, social, ekonomik, të edukimit, kulturor, etj, dhe të gjitha këto rrethana ndikojnë në shfaqjen e akti të dhunës por diktojnë edhe llojin e masave të cilat mund të jenë të përshtatshme për parandalimin e dhunës.

Për shqiptimin e masës së largimit nga banesa, shtëpia apo hapësira tjetër e banimit nuk mund të shikohet njëjtë rasti kur kryerës i dhunës është fëmija në raport me prindërit dhe i njëjti është përsëritës i dhunës, në raport me rastin kur kryerës i dhunës është burri i cili është mbajtës i familjes (*fëmijëve dhe bashkëshortës*) dhe veprimet e të njëjti ngjajnë më një lloj mosmarrëveshje verbale (*por që i konsumon elementet e dhunës*). Në rastin e parë kur fëmija (*madhor*) është përsëritës i dhunës ndaj prindërve është krejt e mundshme që njëra prej masave të përshtatshme për parandalimin e dhunës është largimi i tij nga banesa shtëpia apo hapësira tjetër e banimit, ndërsa në rastin e dytë masë e përshtatshme mund të jetë ndonjëra nga masat që mund të shqiptohen në përputhje me nenin 6 paragrafi 1, lidhur me nenin 2, nën paragrafi 1.2, të LMDHF.

Masa mbrojtëse e shoqërimit të viktimës së dhunës në familje

Masa mbrojtëse e shoqërimit të viktimës së dhunës përcaktohet me dispozita e nenit 8 të LMDHF. Me dispozitën e nenit 8 paragrafi 1, të LMDHF përcaktohet së: *“masa mbrojtëse e shoqërimit të viktimës, mund të shqiptohet më qëllim të mbrojtjes gjatë marrjes së gjëseneve personale”*, ndërsa në paragrafin 2, të nenit të njëjtë përcaktohet së: *“Masa nga paragrafi 1, i këtij neni zbatohet nën shoqërimin e zyrtarit policor”*.

Kur ka dhunë në familje në disa raste viktimës i ndalohet nga kryerësi i dhunës edhe hyrja në shtëpi ku ka jetuar së bashku me kryerësin e dhunës më parë. Në pamundsi të largimit të kryerësit nga shtëpia, banesa ose për shkak të ndarjes së bashkëshortëve dhe mbetjes në pronë-banesë të

viktimës, në të shumtën e rasteve gruas, shfaqet nevoja edhe e marrjes së sendeve në përdorim personal.

Sendet personale janë sendet që i takojnë viktimës dhe nuk hyjnë në pasurin e përbashkët të bashkëshortëve. Këto sende mund të jenë veshmbathje, sende të ushtrimit të zanatit, zejes, profesionit ose pasuri e veçantë e fituar para martesës ose pjesa e pjesëtuar e pasurisë së përbashkët bashkëshortore.¹⁶

Shqiptimi i kësaj mase mbrojtëse nënkupton mbrojtjen e viktimës gjatë ekzekutimit të urdhrimit për mbrojtje apo atij për mbrojtje emergjente, të caktuara me rastin e kryerjes së dhunës në familje e cila zakonisht mund të jetë pasojë e largimit me dhunë nga banesa e përbashkët (*neni 2, nën paragrafi 1.2, pika 1.2.11e LMDHF*), apo pasojë e dëmtimit apo shkatërrimit të pasurisë apo me kanosje se do të ndodhë kjo (*neni 2, nën paragrafi 1.2, pika 1.2.9 të LMDHF*). Qëllimi i kësaj mase është mbrojtja e viktimës gjatë marrjes së gjëseneve personale me rastin e ekzekutimit të masës mbrojtëse me të cilën i është mundësuar palës së mbrojtur që vetëm ajo të posedoj dhe shfrytëzoj pasurin personale të vetën (*neni 11 par 1.4*).

Lidhur me shqiptimin e kësaj masë në praktikën gjyqësore nuk hasen vështirësi sa i përket vlerësimit të nevojës nëse duhet apo nuk duhet të shqiptohet një masë e tillë. Vështirësitë hasen për mënyrën se si duhet të përpilohet dispozitivi i vendimit për shqiptimin e një masë të tillë dhe rrjedhimisht edhe ekzekutimi i vendimit. Kjo për arsye se zakonisht gjykatat shqiptojnë një masë të tillë sipas formulimit: *“caktohet shoqërimi i viktimës nga zyrtari policor për marrjen e gjëseneve personale nga banesa-shtëpia ku ka jetuara para aktit të dhunës përkatësisht datës.....”*, dhe pikërisht për shkak të një formulimi i cili është sipas përcaktimit ligjor, por i përgjithshëm, shfaqet edhe dilema së cilat janë gjësendet personale që do të mund të marr viktima nga banesa-shtëpia ku ka jetuar më herët me kryerësin e dhunës.

Në praktikën gjyqësore nuk është promovuar ideja se vendimi për shqiptimin e një mase të tillë duhet të ketë përshkrim specifik, sepse është e pamundur të përshkruhen në mënyrë specifike të gjitha gjësendet që mund të jenë të viktimës e të cilat duhet ti marrë e shoqëruar nga zyrtari policor. Nëse gjatë procedurës konstatohet së bëhet fjalë për disa gjësende (***për shembull: një ore, një unazë, apo edhe ndonjë sendet tjetër***) përshkrimi edhe mund të jetë specifik, por nëse gjësendet numerikisht janë shumë atëherë përshkrimi në dispozitivin e vendimit mund të jetë i përgjithshëm. Në çdo rast mënyra e harrimit të dispozitivit të aktvendimit për shqiptimin e një mase të tillë do të varet nga rrethanat specifike të rastit.

Shembull: Nëse në gjykata është paraqitur një rast ku vlerësohet se ekziston nevoja e shqiptimit të një mase të tillë, por që gjësendet janë vetëm mjete të punës, atëherë gjykata mund të hartojë

¹⁶ Haxhi Gashi & Ruzhdi Berisha, “Kommentar” Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Prishtinë 2014, fq.70.

dispozitivin në atë mënyrë që caktohet masa mbrojtëse e shoqërimit të viktimës për marrjen e mjeteve të punës (*dhe atë sipas profesionit mjek, piktor, skulptor, etj.*).

Në mënyrë të njëjtë mund të hartohet dispozitivi i aktvendimit edhe në raste kur për shembull nevoja e shqiptimit të masës së shoqërimit është vetëm për veshmbathje.

Gjykatat gjithmonë duhet të bëjnë përpjekje që dispozitivi i aktvendimit për shqiptimin e masës së shoqërimit të viktimës të jetë i formuluar në atë mënyrë që jep mbrojtjen e duhur por njëkohësisht nuk jep mundsinë e keqpërdorimit të urdhrin dhe rrjedhimisht masës në atë mënyrë që gjatë shoqërimit të viktimës për marrjen e gjësendeve të merren edhe gjësendet që nuk janë personale. Duhet bërë dallimi esencial në mesë të gjësendeve në përdorim personale dhe pasurisë (*pasuri e përbashkët e bashkëshortëve*) për pjesëtimin e të cilës duhet të zhvillohet procedurë tjetër kontestimore. Për të zhvilluar idenë edhe më tutje referenca duhet të jetë në dispozitat e Ligjit për Familjen i Kosovës, nenet 45 deri 58.

Në praktikë mund të paraqiten raste kur përveç masës së shoqërimit të viktimës për marrjen e gjësendeve në përdorim personale, shfaqet nevoja e mbrojtjes edhe të pasurisë tjetër të përbashkët por e cila nuk mund të jetë objekti i masës së shoqërimit të viktimës për marrjen e gjësendeve në përdorim personal.

Në rastet kur vlerësohet nevoja e shqiptimit të masës së shoqërimit të viktimës por edhe e sigurimit të pasurisë së përbashkët nga veprimet e kryerësit të dhunës të cilat do të mund të ndikojnë që në të ardhmen viktima e dhunës ta ketë të vështirësuar apo të pamundësuar realizimin e kërkesës për pasurin e përbashkët, atëherë gjykata me kërkesën e palës së mbrojtur mund të shqiptoj edhe masën tjetër të paraparë me dispozitën e nenit 11, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 të LMDHF. Më këtë dispozitë përcaktohet se: *“i ndalohet kryerësit të dhunës në familje ose palës së mbrojtur, bartja si dhe çdo lloj transaksioni të çfarëdo pasurije brenda një periudhe të caktuar”*. Kjo do të ishte masa adekuate për të mbrojtur pasurinë tjetër mbi të cilën pala e mbrojtur ka pretendim, por e cila nuk mund të jetë objekt i masës së shoqërimit për marrjen e gjësendeve në përdorim personal.

Në mënyrë logjike arrimë në përfundimin së masë e shoqërimit të viktimës për marrjen e gjësendeve në përdorim personal i referohet ekskluzivisht sendeve të luajtshme dhe të identifikueshme si personale, ndërsa masa tjetër e paraparë me depozitën e nenit 11, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 të LMDHF, shqiptohet edhe për sigurimin e pasurisë-pronës së paluajtshme, por jo vetëm të saj sepse mund objekt të jenë edhe transaksionet bankare etj. Masa pasurore e ndalimit, bartjes dhe çfarëdo lloj transaksioni me gjerësisht trajtohet te masat pasurore (neni 11 i LMDHF). Pala e mbrojtur gjatë marrjes së gjësendeve personale do të shoqërohet nga zyrtari policor për shkak së gjatë marrjes së sendeve personale pala e mbrojtur mund të jetë e penguar nga kryerësi i dhunës për marrjen e gjësendeve, e po ashtu mund të ndodhë që të përsëritet akti i dhunës. Shoqërimi nga ana e zyrtarit policor krijon mundsinë dhe sigurinë e nevojshme për zbatimin-përmbarrimin e masës

Masa mbrojtëse e trajtimit mjekësor nga varësia prej alkoolit dhe substancave psikotrope

Masa mbrojtëse e trajtimit nga varësia prej alkoolit dhe substancave psikotrope është paraparë me dispozitat e nenit 9, të LMDHF. Me dispozitën e nenit 9 të LMDHF, përcaktohet së: “ *Masa mbrojtëse e trajtimit të obligueshëm mjekësor nga varësia e alkoolit dhe substancave psikotrope i shqiptohet personit, i cili ka kryer dhunën në familje nën ndikimin e tyre, kur ekziston rreziku i përsëritjes së dhunës në familje*”, ndërsa në paragrafin 2, të nenit të njëjtë është përcaktuar përgjegjësia e Ministrisë së Shëndetësisë për nxjerrjen e aktit nënligjor për mënyrë e trajtimit të personave ndaj të cilëve është shqiptuar masa e trajtimit.

Kjo masë mbrojtëse i shqiptohet kryesi të dhunës në familje i cili dhunën në familje e ka kryer nën ndikimin e alkoolit apo substancave psikotrope dhe nëse ekziston rreziku i përsëritjes së dhunës. Masa e tillë mbrojtëse do të caktohet vetëm pasi të vërtetohet se dhunë në familje e ka shkaktuar personi i cili është i varur nga alkooli dhe substancat psikotrope.

Me këtë masë tentohet të evitohet mundsia e përsëritjes së dhunës nga personi që ka shkaktuar dhunë në familje. Ka raste kur njëri nga bashkëshortëve (*zakonisht burrat*) ose anëtari tjetër i familjes nga shkak i është bërë i varur nga alkooli ka sjellje të dhunshme dhe të cilat manifestohet vetëm pas konsumit të alkoolit ose mjeteve tjera narkotike. Kështu, duke ditur këtë fakt, shërimi i këtij personi paraqitet si masë preventive, pra masa parandaluese për dhunë në të ardhmen.¹⁷

Nga interpretimi i dispozitës së nenit 9 të LMDHF, rrjedh se trajtimi për kryerësin e dhunës duhet të jetë i detyrueshëm në çdo rast kur gjykata konstaton në mënyrë të provuar së shkak i dhunës është varësia e kryerësit të dhunës nga alkooli apo substancat psikotrope. Nuk mund të shqiptohet kjo masë nëse gjykata nuk e ka të provuar se akti i dhunës është pasojë e varësisë së kryerit të dhunës nga alkooli apo substancat psikotrope. Në raste të tilla sygjerohet që gjykata të marrë informata para shqiptimit të masës për gjendjen shëndetësore të kryerit të dhunës lidhur me rrethanën e varësisë së mundshëm nga alkooli apo substancat psikotrope.

Për mënyrën se si do të bëhet trajtimi i kryerësve të dhunës në familje ndaj të cilëve është shqiptuar kjo masë mbrojtëse, Ministria e Shëndetësisë ka nxjerr Udhëzimin Administrativ Nr.02/2013.

Ky udhëzim administrativ zbatohet ndaj personave të cilëve gjykata u ka shqiptuar masën e mbrojtjes trajtimin e obligueshëm mjekësorë nga varësia prej alkoolit dhe substancave psikotrope, të cilët nën ndikimin e tyre e kanë kryer dhunën në familje.

Ky udhëzim administrativ e rregullon trajtimin e obligueshëm mjekësor të kryesit të dhunës në familje, i cili është i varur nga alkooli dhe substancat psikotrope dhe se qëllimi i trajtimit është:

- Mjekimi i kryesit të dhunës në familje nga varësia nga alkooli dhe substanca psikotrope;

¹⁷ Po aty, fq.71

- Rehabilitimin dhe vetëdijesimin e kryesit të dhunës në familje për të marrë përgjegjësinë për sjelljen e dhunshme në mënyrë që të arrijë vetëkontroll mbi sjelljet dhe veprimet e tij/saj;
- Risocializimin dhe ri-integrimin e kryesit të dhunës në familje dhe përgatitjen e tij/saj për jetë dhe sjellje të përgjegjshme.

Me nenin 2 të këtij udhëzimi është paraparë që një masë e tillë e shqiptuar nga gjykata nuk mund të zgjasë më shumë se dy (2) vite.

Kryesit të dhunës në familje të cilit gjykata i ka shqiptuar masën mbrojtëse është i detyruar që t'i nënshtrohet trajtimit mjekësor. Zbatimi i kësaj mase bëhet në institucionet shëndetësore dhe atë:

- Të nivelit parësorë të kujdesit shëndetësor - Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF);
- Të nivelit dytësor të kujdesit shëndetësorë – Spitale Regjionale të cilët posedojnë Reparte Psikiatrike dhe Qendrat e Shëndetit Mendor;
- Tretësor të kujdesit shëndetësor – Qendra Klinike Universitare e Kosovës –Klinika Psikiatrike / Instituti i Psikiatrisë Forenzike; dhe
- Institucione tjera të licencuara për ofrimin e shërbimeve përkatëse.

Me udhëzimin e lartëcekur është përcaktuar mënyra e zbatimit të trajtimit (*neni 5*), ashtu që me dispozitën e nenit 5, paragrafi 1, është përcaktuar se: “*Kryerësi i dhunës në familje të cilit gjykata i ka shqiptuar masën mbrojtëse është i detyruar që t'i nënshtrohet trajtimit mjekësor*”, ndërsa në paragrafin 2, të nenit të njëjtë përcaktohet së:” *Trajtimi i obligueshëm mjekësor nga varësia e alkoolit dhe substancave psikotrope kryhet sipas protokolleve të trajtimit në institucionit shëndetësore sipas nenit 4 të këtij udhëzimi administrativ*”. Pra, varësisht nga institucioni shëndetësor së ku do të kryhet trajtimi i detyrueshëm do të varet edhe mënyra dhe tretmani mbështetur në protokollat shëndetësore të institucionit.

Nga kjo mund të kuptohet së është niveli i varësisë së kryerësit të dhunës nga alkooli apo substancat psikotrope që përcakton së në cilin institucion do të kryhet tretmani i detyrueshëm, e pastaj varësisht nga institucioni mbështetur në protokollat e trajtimit të institucionit shëndetësor do të bëhet dhe trajtimi.

Për planet e trajtimit dhe protokollat mjekësore me nenin 6 paragrafin 1, të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2013, përcaktohet së: “*Për planet e trajtimit dhe protokollat mjekësore, institucioni shëndetësor përkatës me shkrim njofton kryerësin e dhunës, viktimën dhe familjen apo kujdestarin*”. Ky detyrim është në frymën e LMDHF, respektivisht me qëllimin e LMDHF të përcaktuar në nenin 1 paragrafin 2, ku theksohet së: “*Ky ligj, po ashtu, ka për qëllim edhe trajtimin e kryerësve të dhunës në familje dhe lehtësimin e pasojave*”.

Një prej masave kryesore të shqiptuara me urdhrin mbrojtës e që është edhe në interesin e kryerësit të dhunës është masa e trajtimit mjekësor nga varësia prej alkoolit dhe substancave psikotrope. Kjo masë jo vetëm që është në interesin e viktimës së dhunës dhe kryerësit të dhunës por edhe të gjithë familjes dhe me gjerë, sepse përmes kësaj mase synohet jo vetëm të evitohet përsëritja e dhunës duke e parandaluar përmes kësaj mase por edhe të rehabilitohet kryerësi i dhunës dhe të zvogëlohen pasojat jo vetëm për viktimën por edhe për kryerësin e dhunës dhe gjithë familjen. Në këtë kuptim udhëzimi administrativ Nr.02/2013, ka përcaktuar mundsinë që gjatë zbatimit të trajtimit të obligueshëm mjekësor ndaj kryerësit të dhunës të përfshihet dhe të bashkëpunoj edhe viktima e dhunës për aq sa ai/ajo pajtohet¹⁸.

Masa e trajtimit të kryerësit të dhunë i varur nga alkooli apo substancat psikotrope do të zbatohet nga institucioni përkatës shëndetësor pavarësisht mospajtit të kryerësit të dhunës. Për planin e trajtimit dhe protokollet mjekësore, institucioni shëndetësor përkatës me shkrim e njofton kryerësin e dhunës, viktimën dhe familjarin apo kujdestarin, (neni 6, paragrafi 1, i udhëzimit administrativ Nr.02/2013). Me dispozitën e nenit 4 paragrafin 2, të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2013, përcaktohet se në pajtim me nenin 3 paragrafi 6, të Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, organi kompetent për ekzekutimin e masës mbrojtëse është Policia e Kosovës. Pra, nëse do të haset në rezistencë nga ana e kryerësit të dhunës për nënshtrim të tretmanit, atëherë përmes organit kompetent Policisë së Kosovës masa duhet të zbatohet.

Mbikëqyrjen e zbatimit të masës mbrojtëse për trajtim mjekësor e bën gjykata. Me dispozitën e nenit 9 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2013, përcaktohet së: “*Mbikëqyrjen e zbatimit të masës mbrojtëse për trajtim mjekësor e bën gjykata kompetente, në bazë të raporteve të pranuar nga institucionet shëndetësore që kanë ofruar trajtim dhe rehabilitim për kryerësin e dhunës në familje*”.

Nga interpretimi i kësaj dispozite rezulton se gjykatat duhet të mbikëqyrin zbatimin e kësaj mase, përderisa masa është duke u zbatuar në kohëzgjatjen e caktuar nga ana e gjykatës. Pra, gjykata duhet të ketë një rol aktiv për të bërë mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj mase sepse gjykata ka autorizimet ligjore për të ndryshuar masën për të ndërprerë masën por edhe për ta zgjatur masën (deri në kohëzgjatjen e lejuar maksimumi 2 vite).

Është e kuptueshme se gjykata do të bëjë mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj mase e koordinuar me institucionin shëndetësor ku është duke u kryer trajtimi i detyrueshëm i kryerësit të dhunës.

¹⁸ Me dispozitën e nenit 6 paragrafi 1, të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2013, për mënyrë e trajtimit të kryerësve të dhunës në familje ndaj të cilëve është shqiptuar masa e trajtimit të obligueshëm mjekësor nga varësia e alkoolit dhe substancave psikotrope, përcaktohet së: “*Gjatë zbatimit të tretmanit të obligueshëm mjekësor ndaj kryerësit të dhunës, viktima e dhunës në familje mund të përfshihet dhe të bashkëpunoj në këtë trajtim përderisa ai/ajo pajtohet*”.

Me dispozitën e nenit 8 paragrafi 1, të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2013, përcaktohet se: *“Institucionet shëndetësore, të cilat merren me zbatimin e masës së trajtimit të obligueshëm mjekësor të kryerësve të dhunës në familje janë të obliguar të mbajnë evidencë dhe të dorëzojnë raporte sipas kërkesës së gjykatës kompetente”,* ndërsa në paragrafin 2, të nenit të njëjtë përcaktohet së: *“Forma dhe përmbajtja e evidencës nga paragrafi 1, i këtij neni, afatet dhe mënyra e dorëzimit të raporteve përcaktohet nga Gjykata Kompetente”*.

Është në përgjegjësinë e gjykatës që kur shqipton një masë të tillë të vendos komunikimin me institucionin shëndetësor dhe të merr të dhënat e nevojshëm për zbatimin e tretmanit, kështu që varësisht nga vlerësimet që merr prej institucionit të vendos për hapa e mëtutjeshëm.

Në praktikën gjyqësore nuk ka një formë të standardizuara të komunikimit të gjykatës me institucionet shëndetësore pranë të cilave bëhet zbatimi i masës së trajtimit të detyrueshëm të kryesve të dhunës të varur nga alkooli apo substancat psikotrope. Do të ishte e dëshirueshme që së bashku me urdhrin dhe masën e trajtimit të kryesit të dhunës nga varësia e alkoolit apo substancave psikotrope, gjykatat të caktojnë edhe detyrimin e Institucionit Shëndetësor për mënyrën dhe formën se si duhet gjykata të informohet nga Institucioni Shëndetësor për zbatimin e tretmanit.

Nuk ka ndonjë pengesë që gjykata edhe me vendim të veçantë apo shkresë zyrtare të kërkoj informacione apo raporte për zbatimin e tretmanit dhe për gjendjen e kryesit të dhunës, sepse sipas dispozitave të sipërcituara është çështje diskrecionale e gjykatës se si ajo do të përcaktoj detyrimin e Institucionit Shëndetësor për raportim lidhur me zbatimin e tretmanit. Ashtu siç u theksua edhe më lartë gjykata do ta mbikëqyrë zbatimin e kësaj mase dhe kjo nënkupton se gjykata gjatë tërë periudhës sa zgjatë urdhër mbrojtja apo masa e trajtimit të detyrueshëm do të ketë rol aktiv mbikëqyrës.

Mbikëqyrja e masës nga ana e gjykatës është e detyrueshme edhe për faktin së me dispozitat e nenit 7 të Udhëzimit Administrativ parashihet ndryshimi i masës mbrojtëse. Me dispozitën e nenit 7 paragrafi 1, përcaktohet se: *“Gjykata kompetente merr vendim për ndryshimin apo kohëzgjatjen e trajtimit mjekësor të obligueshëm për kryerësin e dhunës në familje duke u bazuar në propozimin e institucionit shëndetësor dhe ekspertit përkatës”,* ndërsa në paragrafin 2, të nenit të njëjtë përcaktohet se: *“Ndryshimi i masës mbrojtëse për trajtim të obligueshëm mjekësor ndodh kur:*

- 2.1. trajtimi nuk jep rezultate;*
- 2.2. kryerësi i dhunës nuk vijnë rregullisht në trajtim;*
- 2.3. paraqitet nevoja për ndryshimin e masës”*.

Nuk mund të përmbushën përgjegjësitë e gjykatës që rrjedhin nga LMDHF dhe nga Udhëzimi Administrativ Nr.02/2013, nëse gjykata nuk do të ketë një komunikim të mirëfilltë me institucionin shëndetësor ku është duke u zbatuar masa ndaj kryerësit të dhunës.

Nevoja e komunikimit dhe marrjes së informacioneve në mënyrë periodike dhe sipas gjendjes së ndryshuar të kryerësit të dhunës ndërlidhet drejtpërdrejt me detyrimin e ndryshimit të masës.

Nuk është në kompetencë të institucionit shëndetësor ndryshimi i masës, por vetëm mundsia e rekomandimit për ndryshimin e masës, andaj gjykatat duhet të jenë plotësisht të përkushtuara që zbatimi i masës të bëhet në mënyrë më të mirë të mundshëm dhe në çdo rast kur plotësohen kushtet për ndryshimin apo ndërprerjen e masës të vendosin.

Nëse gjykata për shkak të neglizhencës dhe për shkak të mos komunikimit adekuat me Institucionin Shëndetësor, dështojë që të vendosin sipas gjendjes së ndryshuar, apo sipas rrethanave të ndryshuara, atëherë mos veprimi i gjykatës mund të kualifikohet si shkelje e të drejtave të njeriut në raport me kryerësin e dhunës.

Organi kompetent për ekzekutimin e kësaj mase mbrojtëse është Policia e Kosovës (neni 3 par 6 LMDHF).

Masa mbrojtëse e marrjes së sendit

Me nenin 10 të LMDHF është paraparë mundsia e shqiptimit të masës mbrojtëse me marrjen e sendit me të cilin është kryer dhuna në familje, apo sendeve me të cilat dyshohet se mund të përsëritet dhuna në familje. Qëllimi i shqiptimit të kësaj mase është mbrojtja e personit ndaj të cilit është ushtruar apo ekziston rreziku i përsëritjes së dhunës në familje dhe personave të tjerë të cilët janë në varësi nga ai.

Me paragrafin 2 të këtij neni është paraparë që kjo masë do të zbatohet në pajtim me Kodin Penal të Kosovës. Me nenin 69 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, përkatësisht në paragrafin 1 të këtij neni është parapa që: *“Sendet e përdorura apo të destinuara për kryerjen e veprës penale apo sendet të cilat janë rezultat i kryerjes së veprës penale do të konfiskohen”*, ndërsa me paragrafin 2 është paraparë që: *“Sendet nga paragrafi 1, i këtij neni mund të konfiskohen edhe kur nuk janë pronë e kryerësit nëse kjo është në dobi të sigurisë së përgjithshme ose për arsye të moralit, nëse kjo nuk ndikon në dëm të të drejtave të palës së tretë për të marrë nga kryerësi kompensimin e çfarëdo dëmi”*.¹⁹

Kjo nënkupton se në të gjitha rastet kur dhuna në familje është kryer me përdorimin e ndonjë sendi, duhet të shqiptohet masa mbrojtëse e marrjes së sendit me përdorimin e të cilit është kryer dhuna. Sendet mund të merren edhe nëse nuk janë pronë e kryerësit të dhunës në familje, nëse kjo është në dobi të sigurisë së përgjithshme.

Nëse veprimet e kryerësit të dhunës përveç elementeve që kualifikohen si dhunë në familje kanë konsumuar edhe elementet e ndonjë vepre penale, atëherë me rastin e parë të njoftimit për kryerjen e veprës penale zakonisht nga ana e policisë konfiskohet mjeti i kryerjes së veprës e cila është

¹⁹ Kodi Penal i Republikës së Kosovës NR. 04/L-082

edhe dhunë në familje. Në këtë mënyrë konsumohet në shumë raste nevoja e shqiptimit të një mase të tillë sepse sendi me të cilin është kryer dhuna veç është konfiskuar nga organi kompetent për nevoja të procedurës penale, megjithatë një munds i tillë ekziston edhe në procedurën për urdhër mbrojtje.

Masat mbrojtëse pasurore

Me nenin 11 të LMDHF, janë parashikuar masat mbrojtëse të cilat mund të shqiptohen krahas masave mbrojtëse jo pasurore të parapara në nenet 4 deri 10 të këtij ligji. Kjo nënkupton faktin se masat mbrojtëse pasurore nuk mund të shqiptohen si masë mbrojtëse e vetme por vetëm krahas masave mbrojtëse jo pasurore. Kjo argumentohet edhe nga paragrafi 3 i këtij neni që parasheh se kohëzgjatja e këtyre masave duhet të jetë në pajtim me kohëzgjatjen e urdhrit mbrojtës.

Me këtë dispozitë ligjore të nenit 11 të LMDHF, janë paraparë disa nga masa mbrojtëse të cilat mund të shqiptohen, siç janë:

- *Urdhërimi i kryerësit të dhunës në familje që të lejojë palën e mbrojtur të shfrytëzojë banesën të cilën e përdorin së bashku ose ndonjë pjesë të saj*²⁰;
- *Urdhërimi i kryerësit të dhunës në familje që të paguajë qiranë e banesës së përkohshme të palës së mbrojtur ose të paguajë alimentacionin për palën e mbrojtur dhe për fëmijë, për të cilin kryerësi i dhunës në familje ka obligim për ta mbajtur*²¹;
- *Ndalimi i kryerësit të dhunës në familje ose palës së mbrojtur, bartjen si dhe çdo lloj transaksioni të çfarëdo pasurie brenda një periudhe të caktuar kohore*²²;
- *Ofrimi i mundsit të palës së mbrojtur, që vetëm ajo të posedojë dhe të shfrytëzojë pasurinë e caktuar personale të saj*²³.
- *Caktimi i ndonjë mase tjetër që është e domosdoshme për të mbrojtur sigurinë, shëndetin ose mirëqenien e palës së mbrojtur apo personit me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare*²⁴;
- *T'i urdhërohet kryerësit të dhunës në familje që palës së mbrojtur t'i lejohet kthimi në shtëpi*²⁵.

²⁰ Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, neni 11, paragrafi 1, pika 1.1.

²¹ Po aty, neni 11, paragrafi 1, pika 1.2.

²² Po aty, neni 11, paragrafi 1, pika 1.3.

²³ Po aty, neni 11, paragrafi 1, pika 1.4.

²⁴ Po aty, neni 11, paragrafi 1, pika 1.5.

²⁵ Po aty, neni 11, paragrafi 1, pika 1.6.

Masa e urdhërimit të kryerësit të dhunës që të lejoj palën e mbrojtur që ta shfrytëzoj banesën të cilën e përdornin së bashku ose një pjesë të saj

Për shqiptimin e kësaj mase duhet të plotësohet kushti që paraprakisht, deri në momentin e kryerjes së dhunës në familje, banesa të jetë përdorur bashkërisht nga pala e mbrojtur dhe kryesi i dhunës në familje.

Në praktikën gjyqësor për një kërkesë të tillë të paraqitur nga pala e mbrojtur gjykatat duhet të kenë vlerësime adekuate, duke vlerësuar të gjitha rrethanat që lidhen me rrezikun e përsëritjes së dhunës në familje. Në çdo rast gjykata duhet të bindet se me shqiptimin e një mase të tillë nuk ekziston rreziku i përsëritjes së dhunës. Duhet të merren në konsideratë faktet së çështjet e dhunës në familje në gjykatë paraqiten me gjithë kompleksitetin e tyre familjar, shoqëror, social, ekonomik, etj, dhe të gjitha këto rrethana ndikojnë në shfaqjen e akti të dhunës por diktojnë edhe llojin e masave të cilat mund të jenë të përshtatshme për parandalimin e dhunës.

Shembull: pavarësisht se akti i dhunës në dy raste të ndryshme mund të duket i njëjtë dhe në situatën e ngjajshme (*shembull: në mes të bashkëshortëve*), masat e përshtatshme për parandalimin e dhunës mund të dallojnë shumë dhe kjo diktohet nga rrethanat specifike që paraqiten dhe që duhet të vlerësohen nga gjykatat. Në të dy rastet mund të jenë kryerës të dhunës burrat.

Rasti i parë: martesë në mënyrë faktike është ndërprerë para aktit të dhunës dhe palët kanë filluar procedurën e shkurorëzimit;

Rasti i dytë: martesë në mënyrë faktike është ndërprerë nga momenti i shfaqjes së dhunës dhe nuk ka filluar asnjë proces për zgjidhjen e martesës me shkurorëzim.

Në rastin e parë duket se masë e përshtatshme mund të jetë ndalimi kryerësit të dhunës që të shqetësoj personat e caktuar dhe ndalimin që të ofrohet në distancë të caktuar dhe eventualisht ndonjë mase tjetër por kjo nuk duket shumë logjike shqiptimi i masës për kthimin e viktimës në banesë apo ambient tjetër të përbashkët. Mund të merret në konsideratë edhe masa e pagesës së qirasë për një kohë të caktuar.

Në rastin e dytë, masa e urdhërimit të kryerësit që të lejoj viktimën të kthehet në banesën e përbashkët mund të jetë masë adekuate dhe e përshtatshme, natyrisht nëse gjykata nuk vlerëson se ekziston mundësia e përsëritjes së dhunës.

Është theksuar edhe më parë se qëllimi i ligjit është parandalimi i dhunës me masa të përshtatshme, rehabilitimi i kryerësve të dhunës dhe zvogëlim i pasojave. Nga kjo rrjedh se gjykatat kërkesat për masat pasurore duhet t'i vlerësojnë nën dritën efekteve të provuara në procedurë gjyqësore dhe rrjedhimisht pasi të binden së janë të nevojshëm të shqiptohen. Në asnjë rast nuk do të justifikohet shqiptimi i asnjë mase pasurore pa vlerësimin adekuat të rrezikut për përsëritjen e dhunës, për vlerën parandaluese të masës dhe konstatimin së masa e caktuar është e përshtatshme.

Është theksuar edhe me herët që nuk përjashtohet mundësia që palët të caktuara të provojnë që përmes rasteve fiktive të dhunë të bëjnë përpjekje që t'i realizojnë synimet e tyre kryesisht pasurore. Gjykata paraprakisht duhet të sigurohet se ekziston akti i dhunës i kualifikuar si dhunë në familje sipas dispozitave të LMDHF, e pastaj të shqiptoj masat pasurore.

Në procedurën gjyqësore të shqyrtimit të kërkesave për masa mbrojtëse pasurore gjykatat duhet të hetojnë çështjen në masë të mjaftueshëm duke i vlerësuar të gjitha fakte përcaktuese për shqiptimin e masave. Në praktikën gjyqësore është shumë me thjeshtë vlerësimi i nevojës dhe shqiptimi i masave jo pasurore, ndërsa është shumë më komplekse vlerësimi dhe shqiptimi i masave pasurore. Kjo për shkak se nuk përmbushet qëllimi i ligjit vetëm duke shqiptuar masat formalisht, por qëllimi përmbushet kur gjykata vlerëson kërkesat dhe shqipton masat e përshtatshme për mbrojtje nga dhuna në familje të cilat do ta arrijnë efektin e pritur vetëm nëse mund të zbatohen. Gjykata duhet të shikoj me kujdes që masa e kthimit të viktimës në banesën ku ka jetuar më parë të jetë e zbatueshme.

Nevoja që masa të zbatohet ndërlidhet me detyrimin që dispozitivi i vendimit gjyqësor të jetë konkret dhe i zbatueshëm. Nuk mund të jetë dispozitivi i vendimit konkret dhe i zbatueshëm për këtë masë, nëse gjykata nuk i ka informatat të dhënat e nevojshme për identifikimin e objektit ku duhet të kthehet viktimja. Çështja bëhet edhe më komplekse kur gjykata duhet ta kthejë viktimën në një pjesë të banesës apo shtëpisë ku ka jetuar më parë, sepse kërkohet që dispozitivi i vendimit të jetë konkret, specifik dhe rrjedhimisht i ekzekutueshëm. Nevoja për të saktësuar dispozitivin e vendimit gjyqësor nuk e përjashton mundsinë që në disa raste gjykata të del në vend shikim.

Është më e thjeshtë bëhet kur vendimi i referohet kthimit të viktimës në banesën ku ka jetuar më parë dhe jo në një pjesë të saj. Në rastet kur shqiptohen masat jo pasurore së bashku me masat pasurore, atëherë gjykata duhet të ketë kujdes që masat të mos jenë në kundërshtim me njëra tjetrën.

Në praktikë hasim shpesh raste kur është caktuar masa e ndalimit të shqetësimit të viktimës nga kryerësi i dhunës, caktohet distanca brenda të cilës kryerësi nuk guxon t'i ofrohet viktimës dhe gjithashtu caktohet masa e kthimit të viktimës në banesën ku ka jetuar më parë së bashku me kryerësin e dhunës. Është objektivisht e pamundur që kryerësi i dhunës dhe viktimja e dhunës të jetojnë në banesën e njëjtë dhe të ruajnë distancën sa do e shkurtër që të jetë. Nuk duhet gjykata të caktoj masa që nuk janë objektivisht të zbatueshme sepse më një masë të tillë ku është caktuar distanca që duhet të ruhet në mes kryerësit të dhunës dhe viktimës dhe masa e kthimit të viktimës në banesë, gjykata e vendos kryerësin në rrethana të papërshtatshme, pasojë e të cilave ai do të shkel urdhrin.

Ka një lidhje logjike në mes të masës së kthimit të viktimës në banesën ku ka jetuar më parë së bashku me kryerësin dhe masës së detyrimit që kryerësi i dhunës të paguaj qiranë e banesës

përkohësisht. Në rast kur gjykata vlerëson se është me rrezik përsëritja e dhunës dhe viktimat kthehet në banesën e mëparshme dhe në pamundsi që të ruhet distanca nëse është e nevojshme në mes të kryerësit të dhunës dhe viktimës, atëherë mund të shqiptohet masa e detyrimit të pagesës së qirasë.

Në praktikë gjyqësore ka një dilemë të madhe se a mundet gjykata që masat e përshtatshme mos t'i shqiptoj sipas detyrës zyrtare. Mbizotëron mendimi se sidomos për masat pasurore gjykata duhet të vendos vetëm brenda kërkesave të palëve sepse përndryshe palët në procedurë vendosen në pozita të pabarabarta. Mendimi i njëjtë nuk ekziston për disa masa jo pasurore siç janë **për shembull**: masa e trajtimit mjekësor nga i varuri prej alkooli dhe substancave psikotorope, të cilën gjykata mund ta shqiptoj edhe pa propozimin e palës së mbrojtur.

Duke qenë se ekziston kjo pikëpamje në praktikë gjyqësore që gjykata për masat pasurore të vendosin vetëm me propozimin e palëve, atëherë ju rekomandohet përfaqësuesve të viktimave dhe institucioneve tjera që merren me këtë çështje siç janë: Zyra për Mbrojtjen e Viktimave të Dhunës në Familje, që në raste të caktuara kërkesat për masa pasurore t'i parashtrojnë me alternativë, si **për shembull** të propozohet masa e kthimit në shtëpi e alternativa e saj të jetë pagesa e qirasë, ose masa e largimit të kryerësit të dhunës nga banesa, e alternativa e saj pagesa e qirasë.

Nuk do të mund të shqiptohet gjithmonë masa më e përshtatshme për shkak se në procedurë gjyqësore mund të provohet se masa më e përshtatshme do të ishte pagesa e qirasë, por gjykata mund të jetë e bindur që pagesa e qirasë është e pamundshme të realizohet për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike të kryerësit të dhunës. Pra, gjykata nuk duhet vetëm formalisht të përfundoj çështjen dhe të shqiptoj masat pa u siguruar se ato janë të përshtatshme por edhe të zbatueshme.

Masa mbrojtëse e urdhërimit të kryerësit të dhunës në familje që të paguajë qiranë e banesës së përkohshme të palës së mbrojtur ose të paguajë alimentacionin për palën e mbrojtur dhe për fëmijë, për të cilin kryerësi i dhunës në familje ka obligim për ta mbajtur

Në mesin e masave pasurore të parapara me dispozitat e nenit 11 të LMDHF, është përcaktuar masa pasurore e urdhërimit të kryerësit të dhunës që të paguaj qiranë e banesës së përkohshme të palës së mbrojtur ose të paguajë alimentacionin për palën e mbrojtur dhe për fëmijë.

Në kuadër të kësaj mase pasurore në fakt ekzistojnë dy nën llojet e masës pasurore dhe atë: pagesa e qirasë dhe pagesa e alimentacionit për palën e mbrojtur dhe për fëmijët.

Urdhërimi i kryerësit të dhunës në familje që të paguajë qiranë e banesës së përkohshme të palës së mbrojtur- kjo masë pasurore vjen në zbatim kur kryerësi i dhunës e ka ndaluar viktimën e dhunës që të shfrytëzoj banesën, ose për shkak të dhunës së shkaktuar kërkohet masa mbrojtëse

për t'i lejuar viktimës shfrytëzimin e banesës ose të një pjese të saj²⁶. Një masë e tillë zakonisht shqiptohet krahas masave tjera jo pasurore siç mund të jenë: ndalimi i përdorimit të forcës fizike apo presionit psikik ndaj viktimës së dhunës, ndalimi i shqetësimit, ndalimi i ofrimit në distanca të caktuara, etj.

Masa e urdhërimit të kryerësit të dhunës që të paguaj qiranë e banesës së përkohshme të palës së mbrojtur shqiptohet në rastet kur viktimë e dhunës është larguar nga shtëpia/banesa dhe kthimi i të njëjtës është i pamundur për shkak të ekzistimit të rrezikut për përsëritjen e e dhunës. Në një situatë të tillë është e natyrshme së masë e përshtatshme është detyrimi i kryerësit të dhunës që t'i paguaj qiranë e banesës së përkohshme të viktimës së dhunës në familje.

Përveç ndërlihdjes që ekziston në mes të masës për kthimin e viktimës në banesë ku ka jetuar para aktit të dhunës dhe masës për detyrimin e kryerësit të dhunës për pagesën e qirasë, është edhe masa e largimit të kryerësit të dhunës nga shtëpia e cila duhet të konsiderohet nga ana e gjykatës në relacionin e gjetjes së masës së përshtatshme, për të gjitha rastet kur viktimës së dhunës i mohohet e drejta e shfrytëzimit të mëtejshëm të banesës/shtëpisë ku ka jetuar më parë.

Kur viktimës së dhunës në familje i pamundsohet shfrytëzimi i banesës / shtëpisë në të cilën ka jetuar më parë (*zakonisht u mohohet femrave*), atëherë gjykata sipas propozimit të palëve duhet të shikoj alternativat se cila masë është e përshtatshme për parandalimin e dhunës, por njëkohësisht duhet të shohë edhe mundsinë e përmbartimit të masës. Kështu nëse gjykata vendos që të detyrohet kryerësi i dhunës që të paguaj qiranë e banesës së përkohshme për viktimën e dhunës, përderisa të gjitha faktet e çështjes tregojnë që do të jetë i pamundur zbatimi i kësaj mase për shkak të pamundsisë financiare të kryerësit të dhunës, rezulton se nuk është përmbushur qëllimi i ligjit për parandalimin dhe evitimin e pasojave të shkaktuara nga akti i dhunës.

Gjykata duhet të sigurohet që masat e shqiptuara të jenë të zbatueshme, në të kundërtën vendimi gjyqësor do ta ri-viktimizonte viktimën për shkak të mos ofrimit të mbrojtjes adekuate edhe pse e njëjta ka kaluar procesin gjyqësor. Në kontekstin e këtij diskutimi rekomandohet që të provohen fakte vendimtare për aktin e dhunës, për llojet e masave të përshtatshme, për mundsinë e zbatimit të masave të përshtatshme dhe në disa raste për shkak të vlerësimit të pamundsisë së zbatimit të masave të caktuara duhet të shikohen masat alternative por që janë të përshtatshme.

Për shqiptimin e masës së detyrimit të kryerësit të dhunës që të paguaj qiranë e banesës së përkohshme për viktimën e dhunës, rekomandohet që gjykata të vërtetoj faktet për mundsitë financiare të pagesës së qirasë nga ana e kryerësit të dhunës.

Pra, gjykata gjithsesi duhet të marrë informacion për mundsitë e pagesë së qirasë për banesën e përkohshme dhe nëse gjykata nuk bindet se mund të zbatohet masa atëherë të shikohet mundësia për ndonjë masë alternative, sigurisht duke vepruar sipas propozimeve të palëve.

²⁶ Haxhi Gashi & Ruzhdi Berisha, "Komentari" Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Prishtinë 2014, fq.75.

Për shkak se urdhri dhe masat janë të përkohshme, rrjedhimisht gjykatat zakonisht kanë treguar një qasje më fleksibile për të provuarit e fakteve në rastet e dhunës në familje. Në shumicën e rasteve dëgjimi i palëve si mjet provues është mundsi e mirë për të vërtetuar edhe fatet përcaktuese për shqiptimin e masës së detyrimit të kryerësit për pagesën e qirasë së banesës së përkohshëm për viktimën, por edhe për të përcaktuar lartësinë e qirasë dhe kohëzgjatjen e urdhrin.

Në praktikë për këtë masë paraqiten raste kur gjykatat kanë shqiptuar masën e detyrimit që kryerësi t'i paguaj qiranë e banesë së përkohshme për viktimë të dhunës, por që në seancën e shqyrtimit të kërkesës për urdhër mbrojtje gjykata nuk ka administruar asnjë provë lidhur me nevojën e shqiptimit të një mase të tillë dhe lidhur me lartësinë e pagesës së qirasë. Zakonisht gjykata mjaftohet me faktin se kanë konstatuar që ekziston rasti i dhunës, ndërsa për kërkesat lidhur me shqiptimin e masave tjera fare nuk administrojnë prova dhe rrjedhimisht nuk vërtetojnë faktet vendimtare. Një mënyrë të tillë të vendosjes për masat mbrojtëse, Gjykata e Apelit nuk e pranon dhe zakonisht çështjet kthehen në rishqyrtim.

Nuk mund të pranohet vlerësimi së konstatimi i aktit të dhunës mundson se pa vlerësimin e shqiptimit të të gjitha masave. Një vlerësim i tillë është i paqëndrueshëm, sepse përveç rrethanave nga të cilat konstatohet akti i dhunës në familje si bazë për caktimin e urdhrin mbrojtës, gjykatat duhet të vlerësojnë edhe nevojën e shqiptimit të masave tjera mbrojtëse. Kur bëhet fjalë veçanërisht për masat mbrojtëse pasurore procesi i vlerësimit të nevojës për shqiptimin e masës apo masave pasurore duhet të jetë i thellë i mbështetur në fakte dhe prova. Në radhë të parë duhet të vlerësohet nevoja e shqiptimit të masave pasurore, pastaj të shikohet lloji i masa pasurore dhe mundsia e zbatimit të masave të shqiptuara pasurore.

Gjykata nuk duhet të udhëhiqen nga qëllimet që çështjet vetëm formalisht të jenë ligjore, por në procedura të tilla duhet të udhëhiqen edhe nga qëllimi që me urdhrin për mbrojtje të shqiptohen vetëm masat e nevojshme dhe rrjedhimisht të zbatueshme të cilat do të shërbejnë si preventivë për ndalimin e shfaqjes së dhunës dhe do zvogëlojnë pasojat e mundshme. Në kontekstin e këtij diskutimi është me rëndësi të shikohen masat pasurore sipas alternativës që mund të aplikohen, për shembull nëse është e mundur shqiptimi i masës së kthimit të viktimës në banesë ku ka jetuar më parë me kryerësin e dhunës, të shmangjet masa e detyrimit për pagesën e alimentacionit.

Ky koncept i shqyrtimit të masave sipas alternativës i shërben disa qëllimeve në radhë të parë:

- eviton mundsinë që ndonjë palë përmes rastit fiktiv të arrijë të realizoj interesat e caktuara duke marrë urdhër mbrojtje më masë pasurore që përmbushin interesat e asaj pale;
- duhet të shikohet edhe dimensionin familjar, shoqëror, social, ekonomik, etj, në kuptimin që në disa raste në mënyrë konkludente gjykatat duhet të ketë në konsideratë edhe rrethanat që masat e shqiptuara mos të thellojnë edhe me shumë krizën e raporteve

bashkëshortore (*kur dhuna ekziston në mes të bashkëshortëve*), krizën familjare (*kur dhuna është shfaqur në mes të anëtarëve tjerë të fëmijës*);

- shqiptimi i masave domosdoshmërisht të nevojshëm është në përputhje me qëllimet që shoqëria promovon dhe mbron përmes ligjeve tjera, siç është ligji i familjes ku përveç të tjerave familjes i është dhënë rëndësi shoqërore dhe rrjedhimisht mbrojtje e veçantë duke përcaktuar edhe procedura specifike të mbrojtjes gjyqësore në kontestet familjare.

Ndalimi i kryerësit të dhunës në familje ose palës së mbrojtur, bartjen si dhe çdo lloj transaksioni të çfarëdo pasurie brenda një periudhe të caktuar kohore

Me këtë masë pasurore i ndalohet kryerësit të dhunës apo palës së mbrojtur bartja apo transaksioni i çfarëdo pasurie brenda një periudhe të caktuar. Kjo masë është më specifike se masat e tjera për shkak se kjo masë mund të caktohet jo vetëm ndaj kryerësit të dhunës por edhe ndaj palës së mbrojtur, natyrisht me kërkesën e kryerësit të dhunës. Sikurse edhe masat tjera kjo masë lëshohet për një periudhë të caktuar kohore brenda të cilës i ndalohet bartja apo transaksionet e ndryshme të pasurisë.

Qëllimi i kësaj mase është që duke u ndaluar palëve (*kryerësit të dhunës apo viktimës*) transaksionet që mund të bëhen nga të njëjtit, të mbrohet pasuria për një periudhë të caktuar.

Varësisht nga lloji i pasurisë apo pronës mund të shqiptohen edhe ndalesat. Nëse do t'i referohet ndalesa pronës së paluajtshme ajo mund të jetë si: ndalesë e tjetërsimit, shitjes, ngarkesës me hipotekë, servitutit, ndryshimi i gjendjes ekzistuese, paralizimi, ndërtimi, etj.

Nëse ndalesa i referohet pasurisë tjetër atëherë ndalesat mund të jenë si: bllokimi i mjeteve në xhirollogari, ndalesë e shitjes së ndonjë sendi të luajtshëm, apo ndalesë e përdorimit të ndonjë sendi, etj.

Në raste kur në procedurën e shqyrtimit të kërkesës për urdhër mbrojtje paraqitet edhe kërkesa për ndonjë masë pasurore (*ndalimi i bartjes apo çfarëdo transaksioni*) gjykatat duhet ta vlerësojnë kërkesën nëse e njëjta i plotëson kushtet për të dhënë masën mbrojtëse të kërkuara. Kushtet kanë të bëjnë me aspektin formal të parashtrësës dhe pastaj edhe me vlerësimin për besueshmërinë e kërkesës. Kështu gjykata së pari vlerëson së kërkesa për këtë masë a është e rregullt në kuptimin e përmbajtjes së propozimit për mbrojtje gjyqësore. Kërkesa duhet të jetë konkrete dhe e pambarueshme, sepse në praktikë paraqiten raste kur gjykatat kanë caktuar këtë masë por e njëjta nuk prodhon kurrfarë efekti pasi që vendimi nuk është i zbatueshëm.

Shembull: Nuk mund të caktohet kjo masë më përshkrimin se: *“I ndalohet kryerësit të dhunës çfarëdo transaksioni më patundshmërinë”*²⁷.

Kërkesa për këtë masë dhe rrjedhimisht edhe dispozitivi i aktvendimit për këtë masë duhet të përshkruajnë të dhënat e patundshmërisë që kërkohet të vendoset në ndalesë apo të dhënat e pasurisë tjetër dhe në këtë mënyrë vendimi mund të zbatohet.

Përveç nevojës që kërkesa për këtë masë të jetë konkrete dhe e zbatueshme në procedurë gjyqësore gjykata për këtë masë duhet të kujdesen edhe për çështje që kanë të bëjnë me legjitimitetin real të palëve. Ka raste kur gjykatat kanë caktuar këtë masë duke i ndaluar kryerësit të dhunës apo viktimës çfarëdo transaksioni të pronës apo pasurisë, por masa i është referuar pronës e cila nuk është në pronësi apo bashkëpronësi të palëve të përfshira në rastin e dhunës. Nuk mund të shqiptohet kjo masë ndaj asnjë subjekti që nuk është palë e përfshirë në rastin e dhunës.

Kjo masë pasurore është analoge më masën e sigurimit të kërkesëpadisë e drejtuar tek sendi i caktuar. Pra edhe propozimi për caktimin e kësaj mase por edhe dispozitivi i vendimit kanë ngjajshmëri pothuajse identike pavarësisht së procedurat dallojnë dhe nga kjo rrjedh se kjo masë mund të shqiptohet vetëm ndaj pasurisë së subjekteve që janë të përfshira në rastin e dhunës.

Nëse ndonjëra nga palët ka interes juridik të bëj mbrojtjen e pasurisë nga transferet e mundshme të palës tjetër dhe nëse subjekti ndaj të cilit duhet të drejtohet kërkesa për ndalimin e çfarëdo transaksioni nuk është subjekt i përfshirë në rastin e dhunës, atëherë ndalesa mund të caktohet vetëm në procedurën e sigurimit të kërkesëpadisë.

Ka raste kur veçanërisht viktima e dhunës në familje ka interes juridik që të bëjë mbrojtjen e pasurisë përmes një ndalesë transferimi për pasurinë e cila nuk është në pronësi ekskluzive e saj apo bashkëpronësi me bashkëshortin, por është pronë ku kanë kontribut edhe anëtarët tjerë të familje së gjërë (si: *babai i bashkëshortit, nëna e tij, vëllezërit e tij, e kështu me radhë*) dhe prona

²⁷Gjykata e Apelit, me aktvendimin AC.nr.2156/17, të 07.06.2017, ka vendosur që pjesërisht çështjen ta kthej në rishqyrtim lidhur me masë e ndalimit të transferit e çfarëdo pasurie nga ana e kryerësit të dhunës, me arsyetim në vendimi nuk i përmban të dhënat e sakta për pronën për të cilën është shqiptuar masa e ndalimit të transferit.

Gjykata e Apelit, ka theksuar: *“Për veç kësaj në pikën V (pesë) të dispozitivit kryesit të dhunës i është ndaluar bartja si dhe transaksioni i çfarëdo pasuri brenda një periudhe të caktuar kohore. Kjo masë e ndalimit të transaksionit të pasurisë është në kundërtënie me pjesën tjetër të dispozitivit sepse pasuria nënkupton “tërësinë e vlerave financiare që përbëhet nga të gjitha kredit minus debit e një subjekti”, e që në rastin konkret sipas këtij urdhri logjikisht rrjedh se pala përgjegjëse nuk mund të paguaj as alimentacionin sepse gjykata i ka të ndaluar transaksionin e çfarëdo pasuri. Përveç kësaj është konstatuar së brenda një periudhe të caktuar nuk mund të bëhen transaksione, pa përcaktuar me saktësi sa është kjo periudhë e ndalesë. Në këtë rast gjykata duhet të saktësoi se çfarë është natyra e transaksioneve që i ndalohet palës përgjegjëse dhe rrjedhimisht edhe periudhën duke u kujdesur që masat e caktuara mos të jenë në kundërtënie në mes tyre, nëse urdhri zgjatë 12 muaj parimisht edhe masat zgjasin aq, që nënkupton së nuk ka nevojë të thuhet brenda një periudhe të caktuar. Lidhur me urdhrin për ndalimin e transferit të çfarëdo pasuri, gjykata nëse e gjen të themeltë një kërkesë të tillë duhet të saktësoj në mënyrë specifike se çfarë është natyra e ndalimit të transferit dhe rrjedhimisht edhe të përcaktoj periudhën”*.

është e regjistruar në emrin e ndonjërit prej anëtarëve të familjes që nuk është i përfshirë në rastin dhunës. Në këto raste masa e ndalimit të transferimit të pronës nuk mund të shqiptohet në procedurën sipas kërkesës për urdhër mbrojtje, por pala me interes juridike mundet që në procedurën e sigurimit të kërkesëpadisë të paraqesë një kërkesë të tillë.

Në procedurë e shqyrtimit të kërkesës për urdhër mbrojtje dhe rrjedhimisht edhe të kërkesë për këtë masë gjykata nëse palët (*viktima e dhunës në familje*) nuk mund të sigurojnë provat për pronësinë e patundshmërisë ndaj të cilës kërkohet të caktohet masa, atëherë gjykata ka mundsi që sipas propozimit të palëve të marrë këto dëshmi si **për shembull**, çertifikatën e pronësisë, të dhënat e tjera për transferet, punësimin, etj.

Këto veprime gjykata mund t'i ndërmerrë duke ju referuar dispozitës së nenit 332 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, me të cilën përcaktohet se: *“Po që se dokumenti ndodhet tek organi shtetëror, ose personi juridik, të cilit i është besuar ushtrimi i autorizimeve publike, kurse pala vet nuk është në gjendje që ta dorëzoj apo tregoj atë, atëherë gjykata sipas propozimit të palës do ta marrë sipas detyrës zyrtare këtë dokument”*.

Gjithmonë gjykata edhe kur bëhet fjalë për kërkesat pasurore juridike veprimet e saj duhet t'i ndërmerrë në afat sa më të shkurtër dhe procedurën ta zhvillojë me shumë efikasitet.

Ofrimi i mundsisë së palës së mbrojtur, që vetëm ajo të posedojë dhe të shfrytëzojë pasurinë e caktuar personale të saj

Kjo masë duket që ka ngjajshmëri me masën e përcaktuar me dispozitën e nenit 7 paragrafi 1, të LMDHF, me të cilën përcaktohet së: *“masa mbrojtëse e largimit nga banesa, shtëpia apo hapësira tjetër e banimit, i shqiptohet personit që ka kryer dhunë ndaj anëtarit të familjes me të cilin jeton në banesë, shtëpi apo ndonjë hapësirë tjetër të banimit, nëse ekziston rreziku i përsëritjes së dhunës në familje”*.

Edhe masa pasurore e ofrimit të mundsisë palës së mbrojtur, që vetëm ajo të përdorë dhe shfrytëzojë pasurinë caktuar personale të saj, mund të jetë e lidhur me mundsinë e shfrytëzimit të banesës, shtëpisë apo pasurisë tjetër.

Dallimi në mes të këtyre dy masave qëndron në atë se e kujt është pasuria apo prona. Në të dy rastet qëllimi i masave është parandalimi i përsëritjes së dhunës, por në rastin e shqiptimit të masës pasuror sipas dispozitës së nenit 7 paragrafi 1, të LMDHF gjykata nuk është e lidhur me rrethanën se e kujt është prona, pra edhe nëse prona është e kryerësit të dhunës gjykata mund të urdhëroj largimin e të njëjtit nga banesa apo shtëpia. Ndërsa, në rastin e masës nga neni 11 paragrafi 1, pika 1.4 e LMDHF, me të cilin përcaktohet ofrimi i mundsisë së posedimit dhe shfrytëzimit të pasurisë së caktuar, gjykata është e lidhur me rrethanën se e kujt është pasuria apo prona dhe mund të shqiptoj këtë masë vetëm nëse pasuria apo prona është e viktimës së dhunës në familje. Pra për ta

shqiptuar këtë masë gjykata në procedurë e shqyrtimit të kërkesës duhet të sigurohet dhe të ketë të konstatuar rrethanën së pasuria është e viktimës së dhunës në familje.

Në rastet të praktikës zakonisht vendimet e gjykatës lidhur me këtë masë i referohen kërkesave të palëve për shfrytëzimin banesës apo shtëpisë si dhe hapësirave tjera, por është me rëndësi të kuptohet së kjo masë nuk kufizohet vetëm në posedimin dhe shfrytëzimin pasurisë se paluajtshme por i referohet çfarëdo lloji pasurie, por natyrisht që duhet të plotësohet kushti që pasuria të jetë e viktimës. Në këtë kuptim mund jenë **për shembull**: paga e viktimës, ndonjë pension, ndonjë e ardhur nga ndonjë aktivitet afarist, ndonjë veturë, makineri apo çfarëdo sendi i luajtshëm dhe natyrisht edhe patundshmëritë, etj.

Ashtu siç është cekur edhe për masat e tjera edhe për këtë masë vendimi është i kufizuar në kohë dhe natyrisht së nuk ka asnjë impakt në asnjë procedurë kontestimore që mund të zhvillohet për sendin apo pasurinë e njëjtë që është e përfshirë në masë, në mes të subjekteve të njëjta apo të ndryshme.

Si përfundim për këtë masë po ritheksojmë nevojën që gjykata të sigurohet fillimisht që pasuria apo prona është personale e viktimës së dhunës dhe nëse do të këtë përpjekje qoftë edhe nga viktima e dhunës që të disponoj me diçka që nuk mund të disponoj, atëherë gjykata duhet të marrë provat për tu siguruar nëse viktima e dhunës ka autorizimin personal mbi pasurinë apo sendin për të cilin kërkon masën mbrojtëse.

Caktimi i ndonjë mase tjetër që është e domosdoshme për të mbrojtur sigurinë, shëndetin ose mirëqenien e palës së mbrojtur apo personit me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare

Me dispozitën e nenit 11 paragrafi1, pika 1.5, të LMDHF parashihet që përveç masave të përcaktuar në mënyrë konkrete me dispozita e LMDHF, të caktohen edhe masat e tjera kur ato janë të domosdoshme për të mbrojtur sigurinë, shëndetin ose mirëqenien e palës së mbrojtur.

Kjo dispozitë nuk cakton saktësisht masën por e lejon që kjo të vlerësohet në çdo rast veç e veç. Si masë tillë mund të jetë ruajtja e viktimës nga organet kompetente, përcjellja / shoqërimi i viktimës, etj.²⁸.

Në çdo rast gjykatat duhet t'i vlerësojnë kërkesat e palës së mbrojtur në raport me mundsit ligjore për shqiptimin e masave të përshtatshme dhe të domosdoshme. Nëse do të paraqitet apo vlerësohet se ekziston nevoja e caktimit të një mase që ka të bëjë me sigurinë e palës së mbrojtur, shëndetin dhe mirëqenien, për të cilën nuk ekziston një masë konkrete në dispozitat e tjera të LMDHF, atëherë gjykata ka mundsi që duke ju referuar dispozitës së nenit 11, paragrafi 1, pika 1.1, të caktoj masë më të përshtatshme.

²⁸ Haxhi Gashi& Ruzhdi Berisha, “ Komentari” Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Prishtinë 2014, fq.77

Masa e urdhërimit të kryerësit të dhunës në familje që palës së mbrojtur t'i lejohej kthimi në shtëpi

Kjo masë përcaktohet me dispozitën e nenit 11, paragrafi 1, pika 1.6, e LMDHF dhe në përmbajtje ka ngjashmëri me masën e përcaktuar në nenin 11 paragrafi 1, pika 1.1, të LMDF. Dallimi qëndron në atë se masa nga neni 11, paragrafi 1, pika 1.1, i referohet urdhërimit të palës përgjegjëse që të lejoj palën e mbrojtur të shfrytëzoj banesën të cilën e përdorin së bashku ose më ndonjë pjesëtar tjetër të familjes, ndërsa masa nga neni 11 paragrafi 1, pika 1.6, i referohet urdhërimit të kryerësit që të lejoj palën e mbrojtur të kthehet në shtëpi.

Pavarësisht ngjashmërive në mes të këtyre dy masave, megjithatë ekzistojnë disa dallime sepse në rastin e parë (*neni 11, paragrafi 1, pika 1.1, i LMDHF*) gjykata me urdhër përcakton detyrimin e lejimit të shfrytëzimit të banesës apo të një pjese të saj, ndërsa tek masa (*neni 11, paragrafi 1, pika 1.6, i LMDHF*), gjykata vetëm urdhëron kthimin në shtëpi.

Në këtë rast kur gjykata urdhëron kryerësin e dhunës që të lejoj viktimën për tu kthyer në shtëpi, praktikisht kjo masë vjen në shprehje për shkak të largimit të viktimës nga shtëpia si pasojë e aktit të dhunës, ndërsa te masa e urdhërimit të shfrytëzimit të banesës viktimja jo domosdoshmërisht është e larguar nga banesa, por ekzistojnë elementet që e bëjnë të nevojshme urdhrin për të parandaluar dhunën dhe rrjedhimisht edhe largimin e viktimës nga banesa. LMDHF dhe praktika gjyqësore janë unike lidhur me shqiptimin e këtyre dy masave përkitazi me kushtet që duhet të plotësohen.

Nuk është me rëndësi se kush është pronari i banesës apo i shtëpisë, i vetmi kusht përveç aktit të dhunës që duhet të provohet është që të konstatohet se viktimja ka jetuar deri në aktin e dhunës në atë banesë apo shtëpi. Shumë herë nga kryerësit e dhunës apo përfaqësuesit e tyre ngritet ky pretendim i kundërshtimit të kërkesës, respektivisht kundërshtimin se banesa apo shtëpia nuk janë pronë e kryerësit të dhunës dhe as e viktimës së dhunës por janë pronësi e ndonjë anëtarit tjetër të familjes. Gjykatat duhet të kenë në konsideratë vetëm kërkesat e ligjit dhe nevojën për shqiptimin e masave të caktuara. Urdhri për mbrojtje dhe rrjedhimisht masat mbrojtëse janë të përkohshme dhe nuk kanë asnjë impakt në çështjen e të drejtave të pronësisë dhe gjithashtu nuk kanë asnjë impakt në asnjë procedurë tjetër

Për dallim nga disa masa tjera pasurore siç mund të jetë masa e mbrojtjes së ndalimit të transferit të pronës ku kërkohen të dhëna të sakta përshkruese për të identifikuar pronën sipas certifikatës së pronës, në rastin e shqiptimit të masës nga neni 11, paragrafi 1, pika 1.1. dhe 1.6, të LMDHF, nuk kërkohet domosdoshmërisht të kemi në procedurë certifikatën e pronës apo ndonjë dokument tjetër në pronësi apo të shfrytëzojë, por mjafton shtëpia ku do të kthehet viktimja, apo ku do të këtë të drejtën e shfrytëzimit të një pjese të shtëpisë, të jetë e identifikuar, (*për shembull shtëpia në fshatin X, rruga, numri i shtëpisë, janë të mjaftueshme*).

Inicimi i procedurës për mbrojtje nga dhuna në familje

Kërkesa për urdhër mbrojtje, urdhër mbrojtje emergjente ose urdhër mbrojtje të përkohshme emergjente

Një prej aspekteve procedurale për t'i dhënë mbrojtje viktimës është edhe adresimi i duhur i kërkesës te organi kompetent. Neni 13 ka mbuluar aspektin e paraqitjes së kërkesës për dy rastet: për urdhërmbrojtje dhe për urdhërmbrojtje emergjente²⁹. Me dispozitën e nenit 13 të LMDHF -së, parashihet së kush mund ta paraqes kërkesën qoftë për urdhërmbrojtje, qoftë për urdhërmbrojtje emergjente.

Kush mund ta paraqes kërkesën për urdhër mbrojtje të përkohshme emergjente?

Kërkesën për urdhër mbrojtje të përkohshme emergjente mund ta paraqesë:

- pala e mbrojtur;
- përfaqësuesi i autorizuar i palës së mbrojtur, ose mbrojtësi i viktimave;
- personi me të cilën pala e mbrojtur ka lidhje familjare;
- përfaqësuesi i qendrës për punë sociale në komunën ku pala e mbrojtur e ka vendbanimin apo vendqëndrimin në rastet kur viktimë është i mituri;
- personi i cili është në dijeni të drejtpërdrejtë për një apo më tepër vepra të dhunës në familje ndaj palës së mbrojtur

Kush mund të paraqes kërkesën për urdhërmbrojtje emergjente?

Kërkesën për urdhër mbrojtje emergjente mund ta paraqesë:

- pala e mbrojtur;
- përfaqësuesi i autorizuar i palës së mbrojtur;
- mbrojtësi i viktimave me pëlqimin e palës së mbrojtur;
- personi me të cilën pala e mbrojtur ka lidhje familjare³⁰;
- përfaqësuesi i qendrës për punë sociale në komunën ku pala e mbrojtur e ka vendbanimin apo vendqëndrimin në rastet kur viktimë është i mituri;

²⁹ Po aty, fq.81.

³⁰ Lidhur me mundsinë e paraqitjes së kërkesës për urdhër mbrojtje emergjente nga personi me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare, në LMDHF nuk ekziston një përkufizim tjetër për marrëdhëniet familjare përveç përkufizimit në nenin 2 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, pikat 1.1.1 deri 1.1.7, andaj vlerësojnë së nëse kërkesa paraqitet nga cilido person me të cilin pala e mbrojtur është në lidhje familjare sipas dispozitës së cituara, kërkesa është e vlefshme.

- personi i cili është në dijeni të drejtpërdrejtë për një apo më tepër vepra të dhunës në familje ndaj palës së mbrojtur³¹.
- Kërkesë për urdhër mbrojtje ose për urdhër mbrojtje emergjente mund të paraqesin edhe OJQ-të, që janë familjarizuar me problemin e viktimës, që janë njoftuar mirë për trajtimin e tyre³².

Kush mund të paraqes kërkesën për urdhërmbrojtje?

Kërkesën për urdhër mbrojtje mund ta paraqes:

- pala e mbrojtur;
- përfaqësuesi i autorizuar i palës së mbrojtur³³;
- mbrojtësi i viktimave me pëlqimin e palës së mbrojtur³⁴;
- përfaqësuesi i qendrës për punë sociale në komunën ku pala e mbrojtur ka vendbanimin apo vendqëndrimin në rastet kur viktimë është i mituri³⁵.

³¹ Është në funksion të qëllimit të LMDHF mundsia që i është dhënë secili person që ka dijeni të drejtpërdrejtë për veprën të dhunës në familje të paraqet kërkesë për urdhër mbrojtje emergjente. Natyrisht kjo mundsi nuk i është dhënë edhe për kërkesën për urdhër mbrojtje, por vetëm për urdhërmbrojtje emergjente sepse në disa raste rrethanat mund të jenë të tilla që do ta pengonin palën e mbrojtur të paraqet kërkesë për urdhërmbrojtje emergjente., andaj një gjë të tillë mund ta bëjë secili që ka dijeni për veprën e dhunës në familje.

³² Ligdhënësi ka krijuar hapësirën e nevojshme ligjore për mundsin e mbrojtjes së viktimave të dhunës në familje me masa të përshtatshme ligjore, por sigurisht nuk mund të aplikohen masat e përshtatshme ligjore për mbrojtje nëse nuk do të ndiqet procedura ligjore. Për shumicën e viktimave iniciimi i procedurës mund të jete një sfidë e vërtet për shkak të mosnjohjes së ligjit dhe për shkak të pamundsisë financiare për të marrë këshilla ligjore, në këtë kontekst të njëjtave u është dhënë mundësia që të ndihmojnë edhe në procedurë gjyqësore nga Organizata Joqeveritare të cilat merren me çështje familjare. Proceduralisht është e nevojshme që nëse kërkesa paraqitet nga organizata të tilla të ofrohen dëshmi se aktiviteti i organizatave të tilla është i fokusuar në çështjen familjare, të mbrojtjes së viktimave etj. Në Kosovë ka organizata të tilla që merren me ofrimin e ndihmës dhe mbrojtjen e viktimave e të cilat ndihmën e tyre mund ta ofrojnë edhe në procedurë gjyqësore.

³³ Kur kërkesën për urdhër mbrojtje ose urdhër mbrojtje emergjente e paraqet përfaqësuesi i autorizuar i palës së mbrojtur, atëherë vlerësimi i gjykatës për rregullsinë e përfaqësimit bëhet sikurse për çdo çështje tjetër. Në raste kur kërkesën e ka paraqitur përfaqësuesi i autorizuar por i njëjti bashkë me kërkesën për urdhërmbrojtje ose urdhër mbrojtje emergjente, nuk e ka bashkangjitur edhe autorizimin, atëherë për shkak të urgjencës së çështjes do rekomandohej që gjykata të caktoj seancën dhe në seancë të marr veprime për evitimin e të metave për shkak të përfaqësimit. Një mënyrë për evitimin e kësaj të metë që lidhet me përfaqësimin, respektivisht mos dorëzimin e autorizimit në gjykatë do të ishte që gjykata ta pyes palën e mbrojtur në seancë për përfaqësuesin dhe deklarin e palës për autorizimin ta konstatoj në procesverbal.

³⁴ Kur kërkesën për urdhër mbrojtje ose urdhër mbrojtje emergjente e paraqet mbrojtësi i viktimave sipas LMDF parashihet se i njëjti duhet ta ketë pëlqimin e palës së mbrojtur. Në aspektin praktik pëlqimi mund të jetë i shkruar, kërkesa e përgaditur nga mbrojtësi i viktimave mund të nënshkruhet nga pala e mbrojtur, por edhe nëse është nënshkruar nga mbrojtësi i viktimave dhe në shkresat e lëndës nuk ekziston pëlqimi i palës së mbrojtur, rekomandohet që gjykata të caktoj seancë dhe në seancë të pyes palën e mbrojtur nëse e njëjta ka dhënë pëlqim për paraqitjen e kërkesës. Në këtë kuptim rekomandohet që gjykatat të rezervohen nga kthimi i kërkesave në plotësim për shkak të procedurat janë urgjente dhe të metat mund të evitohen edhe gjatë seancës për shqyrtimin cilës do kërkesë.

³⁵ Roli i tyre është përcaktuar me nenin 7 të Ligjit për Shërbimet Sociale dhe Familjare nr. 02/L-17, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-081.

Çka duhet të përmbaj kërkesa për urdhër mbrojtje ose urdhërmbrojtje emergjente?

Kërkesa për urdhër mbrojtje ose urdhër mbrojtje emergjente paraqitet me shkrim ose gojarisht dhe përfshinë:

- Emrin e gjykatës;
- Emrin, adresën dhe profesionin e kërkuesit dhe kryerësit të dhunës në familje;
- Emrin dhe adresën e palës së mbrojtur dhe të personit i cili ka kërkuar mbrojtjen për palën e mbrojtur për palën ndaj së cilës është ushtruar dhuna, si dhe lidhja familjare e palës me personin i cili ka shkaktuar dhunë në familje;
- Përshkrimi në hollësi i gjendjes faktike dhe kur është e mundur duhet të bashkangjesë edhe provat, si dhe arsyen e kërkesës për shqiptimin e urdhërit mbrojtës ose urdhërit për mbrojtje emergjente;
- Propozimin e masës mbrojtëse.

LMDHF bën një përjashtim nga të dhëna e paraqitur më lartë kur është fjala për vendbanimin apo vendqëndrimin e kërkuesit, të palës së mbrojtur ose të personit me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare, e i cili duhet të mbrohet me anë të urdhërit për mbrojtje ose urdhërit për mbrojtje emergjente, nëse zbulimi i vendbanimit apo vendqëndrimit do të rrezikonte atë person. Në një situatë të tillë veprimet që mund të ndërmerren janë:

- Kërkesa të siguroj një adresë alternative;
- Adresa tjetër e siguruar në kërkesë duhet të jetë adresa e vetme që paraqitet në dokumentet dhe dosjet publike të gjykatës; ose
- Nëse gjykata vendos se zbulimi i adresës në dosjen e gjykatës është i domosdoshëm, ato dosje në të cilat shkruhet adresa duhet të jenë të mbyllura.

Është e kuptueshme se qëllimi i këtij përjashtimi në LMDHF është mbrojtja e palës e cila është viktimë e dhunës në familje dhe parandalimi i përsëritjes së dhunës, kur ekziston rreziku i përsëritjes së dhunës.

Urdhri për mbrojtjen e përkohshme emergjente

Me nenin 22 të LMDHF -së, parashihet se jashtë orarit të punës së gjykatave, kërkesa për lëshimin e urdhërmbrojtjes së përkohshme emergjente mund t'i parashtrohet Policisë së Kosovës dhe atë nga:

- pala e mbrojtur;
- përfaqësuesi i autorizuar, ose mbrojtësi i viktimave;
- personi me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare;
- përfaqësuesi i Qendrës për Punë Sociale ku e ka vendbanimin ose vendqëndrimin pala e mbrojtur;

- si dhe personi i cili është në dijeni të drejtpërdrejtë për një vepër ose për më shumë vepra të dhunës në familje ndaj kërkuesit.
- Këtë kërkesë mund ta paraqet në polici edhe cilado OJQ që ka njoftime të sigurta për dhunën në familje dhe që janë familjarizuar me viktimën.

Jashtë orarit të punës së gjykatës, sipas kërkesës nga personat e lartshënuar, Shefi i Njesisë Rajonale të Policisë së Kosovës (Drejtori i Policisë Regjionale) mund të shqiptoj urdhrin për mbrojtje të përkohshme emergjente dhe të caktoj në apo disa nga masat e parapara me këtë ligj, nëse vërteton se:

- Ekzistojnë baza për të besuar se kryesi ka kryer ose është kërcënuar se do të kryejë ndonjë vepër të dhunës në familje;
- Kryesi i dhunës paraqet kërcënim të drejtpërdrejtë dhe të atypëratyshëm për sigurinë, shëndetin dhe mirëqenien e palës së mbrojtur ose të personit me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare, të cilët duhet të mbrohen me anë të urdhrit për mbrojtje dhe
- Shqiptimi i urdhrit për mbrojtje të përkohshme emergjente është i domosdoshëm për të siguruar shëndetin ose mirëqenien e palës së mbrojtur ose të personit me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare, e që duhet të mbrohen me anë të urdhërit për mbrojtje.

Kohëzgjatja e urdhrit të përkohshëm emergjent skadon në fund të ditës së ardhshme gjatë të cilës gjykata punon.

Vendimi për lëshimin e urdhërmbrojtjes së përkohshme emergjente duhet të përmbajë: masën e caktuar, kohëzgjatjen e këtij urdhri, vërejtjen se shkelja e këtij urdhri paraqet vepër penale, njoftimin se kryerësi i dhunës mund të kërkoj ndihmë nga përfaqësuesi ligjor, si dhe shpjegimin se pas kalimit të afatit të këtij urdhri, pala e mbrojtur mund të paraqes kërkesë për urdhër mbrojtje emergjente.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë pas shqiptimit të tij nga ana e Shefit të Njesisë Regjionale të Policisë së Kosovës kundër dhunës në familje dhe fillon të zbatohet ndaj kryerësit të dhunës në familje pasi që t'i jetë dorëzuar atij personalisht.

Shqyrtimi i kërkesës për urdhër mbrojtje emergjente

Gjykata vendos përkitazi me kërkesën për urdhër mbrojtje emergjente brenda 24 orëve pas parashtrimit të kërkesës. Në këto raste gjykata duhet të mbajë seancë në të cilën dëgjohen personat si në vijim:

- palën e mbrojtur (viktimën), përfaqësuesin e palës së mbrojtur, apo mbrojtësin e viktimave;

- kryerësin e dhunës në familje ose përfaqësuesin e autorizuar të tij;
- parashtruesin e kërkesës dhe çdo dëshmitarë i cili ka njohuri për dhunën në familje.

Për dallim nga dëgjimi dhe shqiptimi i urdhër mbrojtjes te rasti i urdhërmbrojtjes emergjente, sipas nenit 16.3 të LMDHF -së, kushti është paksa ma ndryshe ngase, sipas nevojës, gjykata mund të bëjë dëgjimin dhe shqiptimin e urdhërit mbrojtës në mungesë të kryerësit të dhunës në familje, duke shfrytëzuar edhe mjetet e tjera alternative përfshirë edhe ato elektronike³⁶.

Në vendimin për urdhër mbrojtje emergjente duhet të ceket:

- masa mbrojtëse e caktuar nga gjykata;
- njoftimi se moszbatimi i urdhrit mbrojtës emergjent paraqet vepër penale;
- njoftimin për të drejtën e ankesës;
- data e dëgjimit të serishëm për vërtetimin e urdhrit për mbrojtje emergjente, e cila duhet të jetë brenda 8 ditëve prej shqiptimit të urdhrit për mbrojtje emergjente;
- njoftimi se kryerësit të dhunës mund t'i ofrojë ndihmë përfaqësuesi i autorizuar.

Kohëzgjatja e urdhrit për mbrojtje emergjente skadon në fund të dëgjimit për vërtetimin e urdhërit për mbrojtje emergjente. Gjatë dëgjimit për vërtetimin e urdhërit për mbrojtje emergjente, gjykata mundet që të lëshoj urdhrin për përfundimin e urdhërit për mbrojtje emergjente, apo që të shqiptoj urdhrin për mbrojtje.

Gjykata e shqipton urdhrin për mbrojtje apo urdhrin për mbrojtje emergjente në rastet kur dyshon se kryerësi i dhunës pashmangshëm rrezikon sigurinë, shëndetin ose mirëqenien e palës së mbrojtur dhe personit me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare dhe i cili duhet të mbrohet me anët asaj urdhërmbrojtje apo urdhërmbrojtje emergjente. Pas skadimit të urdhërmbrojtjes ose urdhërmbrojtjes emergjente, pushojnë të gjitha kufizimet e shqiptuara.

Ndryshimi, ndërprerja dhe vazhdimi i urdhër mbrojtjes emergjente

Te rastet urdhër mbrojtjes emergjente, pas shqyrtimit të ankesës së parashtruar nga kryerësi i dhunës në familje apo nga personi i autorizuar, gjykata mund të vendos për vërtetimin e urdhrit për mbrojtje emergjente, ndryshimin ose ndërprerjen e tij.

Në këto raste pala e mbrojtur, përfaqësuesi i autorizuar ose mbrojtësi i viktimave mundën që dy ditë para skadimit të urdhrit për mbrojtje emergjente të parashtrojnë kërkesë për vazhdimin e urdhrit për mbrojtje emergjente. Nëse nuk parashtrohet kërkesë për vazhdimin e këtij urdhri, ai ndërpritet menjëherë në ditën e skadimit.

³⁶ Neni 16.3 LMDHNF parasheh mundsinë që në rrethana të tilla gjykata të përdorë edhe mjetet tjera alternative, duke përfshirë edhe ato elektronike.

Pas marrjes së kërkesës gjykata mundet që ta vazhdoj urdhrin për mbrojtje, nëse nuk kanë pushuar shkaqet, mbi bazën e të cilave është caktuar urdhri për mbrojtje emergjente apo ta ndërpres urdhrin për mbrojtje emergjente në ditën e skadimit të tij.

Shqyrtimi i kërkesës për urdhër mbrojtje

LMDHF me dispozita e nenit 15 e ka rregulluar dhe përcaktuar shqyrtimin e kërkesave për urdhërmbrojtje.

Gjykata kompetente vendosë përkitazi me kërkesën për urdhërmbrojtje brenda 15 ditëve pas pranimit të saj (neni 15, paragrafi 1, i LMDHF).

Gjatë shqyrtimit të kërkesës për urdhër mbrojtje, gjykata e mbanë seancën e dëgjimit për t'i dëgjuar:

- Palën e mbrojtur, përfaqësuesin e autorizuar ose mbrojtësin e viktimave
- Kryesin e dhunës ose përfaqësuesin e autorizuar
- Parashtruesin e kërkesës
- Përfaqësuesin nga qendra për punë sociale i komunës në të cilin jeton përherë ose përkohësisht për rastet kur parashtruesi i kërkesës është i moshës nën tetëmbëdhjetë vjeç ose i mungon zotësia e veprimit ose veprat e supozuara të dhunës në familje kanë ndikim në personin i cili është i moshës nën tetëmbëdhjetë vjeç ose nuk ka zotësi të veprimit.
- Dhe dëshmitaret të cilët gjykata i konsideron të domosdoshëm.

Gjykata mundet që dëgjimin dhe shqiptimin e urdhër mbrojtjes ta bëjë edhe në mungesë të kryerësit të dhunës në familje nëse kryerësi i dhunës në familje është thirrur në mënyrë të rregullt dhe nëse kërkesa është mbështetur në dëshmi të mjaftueshme.

Kërkesa mund të konsiderohet si e tërhequr nëse në seancën e dëgjimit nuk paraqiten as pala e mbrojtur e as përfaqësuesi i autorizuar i palës së mbrojtur dhe nëse këta individë janë thirr në mënyrë të rregullt, ndërsa që mungesën e tyre nuk e kanë arsyetuar. Tërheqja e kërkesës nuk e parandalon paraqitjen e kërkesës tjetër, (neni 15, paragrafi 2, pika 5 dhe 6, e LMDHF).

Afti i shqyrtimit të kërkesës dhe marrjes së vendimit për urdhërmbrojtje sipas ligjit është përcaktuar 15 ditë, çka nënkupton se kjo procedurë është e natyrës urgjente. Në bazë të kësaj mund të konkludohet se kërkesa për urdhër mbrojtje është shumë më urgjente se kërkesat e natyrave tjera sipas të cilave kërkohet mbrojtje gjyqësore. Në këtë kontekst rekomandohet që veprimet e gjykatave të jenë të shpejta dhe vendimet po ashtu të jenë brenda afateve ligjore.

Me rastin e pranimit të kërkesës për urdhërmbrojtje gjyqtari i çështjes duhet ti bëjë një shqyrtim të shpejtë në bazë të secilit do të këtë një vlerësim për natyrën dhe urgjencën e veprimit që duhet ti

ndërmarrë në seancën e shqyrtimit të kërkesës për urdhër mbrojtje. Vlerësimi i gjyqtarit të çështjes ka të bëjë me faktin se cilët subjekt duhet të thirrën në seancën e shqyrtimit të kërkesës për urdhërmbrojtje, pastaj nëse është dhënë ndonjë propozim për marrjen e ndonjë prove e cila nuk është në disponim të palëve por të ndonjë organi të merr veprime për sigurimin e atyre provave (për shembull deklaratave dhe dëshmime tjera që gjenden në polici, në ndonjë spital, klinike, etj) dhe natyrisht edhe të caktoj datën e seancës duke u siguruar për plotësimin e kushteve që e njëjta të mbahet pa pengesa.

Sa i përket afateve dhe urgjencës gjykata duhet të ketë në vëmendje kërkesat e LMDHF dhe jo ato të LPK, pra raste e dhunës në familje edhe pse trajtohen në procedurë kontestimore për disa çështje nuk vlejnjë dispozitat e LPK-së, (siç janë mënyra e thirrjes së palëve në seancë, afatet për mbajtjen e seancës dhe marrjen e vendimit).

Në lidhje me dëgjimin e subjekteve që ka paraparë LMDHF, në praktikën gjyqësore vërehen dështime të gjykatave për ta zbatuar në tërësi procedurën e shqyrtimit të kërkesës për urdhër mbrojtje. Në plotë raste gjykatat e konsumojnë detyrimin e dëgjimit të palëve me vetë faktin se ato deklarojnë se mbesin pranë kërkesës për urdhërmbrojtje ose e kundërshtojnë të njëjtën (kryerësi i dhunës), por nuk zhvillojnë një procedurë të mirëfilltë të dëgjimit të palëve dhe subjekteve tjerë. Në këtë kuptim rekomandohet që veçanërisht dëgjimi i palëve të bëhet në procedurë të rregullt të dëgjimit të palës në mënyrë që deklaratimet e tyre pastaj ta kenë vlerën e provës për vërtetimin e fakteve përcaktuese për urdhërmbrojtje dhe për llojet e masave që do të vlerësohen si të përshtatshme për parandalimin e dhunës.

Nuk mund të aprovohet kërkesa për urdhër mbrojtje nëse nuk provohet akti i dhunës, andaj përveç dëshmime tjera është shume e rëndësishëm të dëgjohen palët në procedurë, aq më tepër për shkak së në shumicën e rasteve për të vërtetuar aktin e dhunës është e nevojshme të bëhet dëgjimi i palëve sepse mungojnë provat tjera për të provuar aktin e dhunës. Marrja e provave është shume me rëndësi edhe për faktin se kryerësi i dhunës mund të mos marrë pjesë në seancë gjyqësore dhe në këtë kontekst në pamundsi të dëgjimit të njëjtin gjykata duhet ta dëgjoj palën e mbrojtur dhe të marrë edhe prova tjera qoftë dëgjimi i dëshmitarëve, të dhënat nga policia, apo edhe ndonjë provë tjetër siç mund të jetë ndonjë raport mjekësore për trajtimin e viktimës.

Çka duhet të përmbaj urdhëri për mbrojtje?

Në vendimin me të cilin lëshohet urdhri për mbrojtje gjykata duhet të cekë:

- Masën apo masat mbrojtëse të caktuara nga gjykata
- Njoftimin se moszbatimi i urdhrit mbrojtës është vepër penale
- Njoftimi për të drejtën në ankesë dhe për të drejtën e ndihmës nga përfaqësuesi i autorizuar.

Urdhri për mbrojtje shqiptohet për një periudhë kohore jo më shumë se 12 muaj por mund të vazhdohet jo më shumë se 24 muaj.

Çka duhet të përmbaj arsyetimi i vendimit për urdhërbrojtje?

Ligji për Procedurën Kontestimore me dispozita e nenit 160 paragrafi 4 dhe 5, ka paraparë se në arsyetim të vendimit duhet të përfshihen:

- Kërkesat e palëve;
- Faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar palët;
- Specifikimi se cilat nga faktet e tilla janë vërtetuar, dhe arsytet përse janë vërtetuar ato fakte;
- Përshkrimin se si janë vërtetuar ato fakte, nëse faktet janë vërtetuar me anë të provave, duhet të saktësohet se cilat prova i ka shfrytëzuar gjykata dhe si i ka vlerësuar ato;
- Dispozitat e së drejtës materiale të cilat janë zbatuar në nxjerrjen e aktgjykimit;
- Deklarimi për pretendimet e palëve lidhur me bazën juridike të kontestit, si dhe propozimet dhe kundërshtimet e tyre për të cilat gjykata nuk ka arsyetuar vendimet e nxjerra më parë në procedurë.

Edhe te rastet e dhunës në familje arsyetimi nuk dallon shumë sa i përket kronologjisë që duhet të ndiqet dhe përmbajtjes që duhet të ketë. Është identike edhe të rastet e dhunës në familje se fillimisht në arsyetim të aktvendimit gjykata duhet të përshkruajë kërkesat e palëve gjegjësisht pretendimet kundërshtuese (të palës përgjegjëse). Kjo për arsye se fillimi i procedurës për mbrojtje gjyqësore në raste e dhunës në familje mbështetet në parimin e disponibilitetit e jo të oficialitetit, prandaj gjykata përshkruan se cilat kanë qenë kërkesat e palës së mbrojtur (në këtë rast për masat mbrojtëse) dhe cilat kanë qenë kundërshtimet e palës përgjegjëse nëse i njëjti ka marrë pjesë në procedurë.

Duke qenë se procedura për urdhër mbrojtje zhvillohet sipas dispozitave të LPK-së, edhe të rastet e dhunës në familje është e natyrshme sikurse në çdo rast tjetër që në arsyetim të aktvendimit të përshkruhen fakte që i kanë parashtruar palët dhe provat që i kanë propozuar për vërtetimin e fakteve. Me dispozitën e nenit 7 paragrafi 1, i LPK-së, është përcaktuar se: “*Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla*”, ndërsa me dispozitën e nenit 319 paragrafi 1, të LPK-së, është përcaktuar se: “*Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta*”.

Nga këto dy dispozita rrjedh se në sistemin tonë të procedurës kontestimore dominon sistemi i bazuar në parimin e shqyrtimit sepse palëve u takon e drejta ekskluzive që të parashtrajnë faktet të cilat gjykata do ti merr për në themel të vendimit të saj³⁷.

³⁷ Përfundimisht nga dispozita e cituar bënë dispozita e nenit 7 paragrafi 2, e LPK-së, me të cilën përcaktohet se: “*Gjykata është e autorizuar të vërtetojë edhe faktet të cilat palët nuk i kanë paraqitur si dhe të marrë edhe provat të cilat palët nuk i kanë propozuar, vetëm po që se nga rezultati i shqyrtimit dhe i të provuarit del përfundimi se palët kanë për*

Ka një diferencë në mes të fakteve të paraqitura respektivisht të propozuara nga palët ndërgjyqësore dhe fakteve të vërtetuara, sepse është në diskrecionin e gjykatës të vendos se cilat nga faktet e propozuara kanë peshën e “fakteve vendimtare” e të cilat duhet të vërtetohen.

Në këtë kontekst gjykata duhet të arsyetoj se cilat fakte janë vërtetuara dhe arsyet se përse janë vërtetuara.

Përshkrimi se si janë vërtetuar ato fakte, nëse faktet janë vërtetuar me anë të provave, duhet të saktësohet se cilat prova i ka shfrytëzuar gjykata dhe si i ka vlerësuar ato. Edhe pse në disa raste e përbëjnë thelbin e padisë, të kundërpadisë apo të prapësimeve, disa fakte nuk ka nevojë të provohen, dhe atë: *Faktet e ditura botërisht dhe ato të vërtetuara nga gjykata në gjykimin e mëhershëm, Faktet e pranuar (pohuara) dhe Faktet e prezumuara me ligj.*

Vërtetimin e fakteve kontestuese gjykata e bënë përmes mjeteve provuese. Mjetet provuese janë të parashikuara në dispozita të veçanta të LPK sipas llojit të tyre. Këto mjete janë: Këqyrja në vend, shkresat, dëshmitarët, ekspertët dhe dëgjimi i palëve. Siç shihet lloji i provave varet nga lloji i burimeve të parashikuar në ligj. Varësisht nga mënyra se si janë vërtetuar faktet do të jetë edhe arsyetimi i aktvendimit. Posaçërisht të faktet kontestuese të cilat rëndom vërtetohen përmes mjeteve provuese gjykata duhet të ketë një arsyetim të zgjeruar dhe atë duke arsyetuar specifikisht secilin fakt kontestues dhe provën e administruar me të cilin është vërtetuar secili fakt. Gjykata në këtë hap të arsyetimit duhet të ketë edhe një vlerësim/arsyetim për vlerën provuese/fuqinë provuese të secilës provë të administruar dhe rrjedhimisht besueshmërinë e saj.

Në pjesën e analizës për përfundimin e gjykatës lidhur me themelin e kërkesës për urdhër mbrojtje përveç hapave tjerë ta arsyetimit të përshkruar më lartë, pjesa e përshkrimit të dispozitave ligjore të LMDHF për rastin konkret është tejet e rëndësishme sepse përmes zbatimit të normës materiale do të përcaktohet nëse rrethanat faktike të çështjes kontestuese konsumojnë elementet e normës juridike për mbrojtjen gjyqësore të kërkuar.

Gjykata duhet të arsyetoj ekzistimin e aktit të dhunës dhe nevojën për secilën masë të shqiptuar.

qëllim disponimin me kërkesat me të cilat nuk mund të disponojnë lirisht (të përcaktuar në nenin 3 paragrafi 3 të këtij ligji), në qoftë se me ligj nuk është përcaktuar ndryshe”, ndërsa me dispozitën e nenit 356 e ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-118, është përcaktuar se: “Gjykata ex officio, ose propozimin e palëve mund të bëjë të provuarit me anë të ekspertizës, sa herë që për vërtetimin apo sqarimin e fakteve, apo të rrethanave të caktuara nevojitet dijeni profesionale të cilën nuk e ka gjyqtari i çështjes”. Siç vërehet nga dispozita e cituar lidhur me paraqitjen e fakteve të çështjes mund të konkludojmë se parimisht vlen parimi i shqyrtimit që nënkupton se përgjegjësia për prezantimin e fakteve u takon palëve, ndërsa si përjashtim gjykatës i është dhënë mundsi e konstatimit të fakteve nëse palët provojnë të disponojnë me kërkesa që nuk mund të disponojnë. Ndryshe qëndron situata sa i përket marrjes së provave për vërtetimin e fakteve sepse edhe marrja e provave do të duhet me qenë analoge me mënyrën e paraqitjes së fakteve, por ligjdhënësi ka bërë një përjashtim të dispozita e nenit 356 kur ka përcaktuar marrjen e provës me ekspertizë edhe ex officio, pa e kufizuar marrjen e kësaj prove vetëm për vërtetimin e fakteve që kanë të bëjnë me kërkesat e padisponueshme.

Nuk është korrekte që në disa raste gjykata koncentrohet të arsyetoj vetëm të gjeturat lidhur me aktin e dhunës dhe kufizohet shumë ose fare në dhënien e arsyeve për masat e shqiptuara mbrojtëse. Secila masë e shqiptuara duhet të arsyetohet specifikisht në të kundërtën aktvendimi për caktimin e urdhërit për mbrojtje do të jetë i përfshirë në shkelje për shkak të të cilave çështja mund të kthehet në rishqyrtim.

E drejta për ankesë kundër vendimit për urdhër mbrojtje

Kundër vendimit të urdhrit për mbrojtje, mund të ushtrohet ankesë, brenda afatit 8 ditor nga dita e dorëzimit të vendimit. Kundër vendimit të urdhrit për mbrojtje emergjente, pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë në afatin prej 3 ditësh nga dita e dorëzimit të vendimit. Parashtrimi i ankesës nuk e ndalon ekzekutimin e urdhrit mbrojtës apo urdhrit për mbrojtje emergjente.

Shkelja e urdhërit mbrojtës

Kush e shkel në tërësi ose pjesërisht urdhrin për mbrojtje, urdhrin për mbrojtje emergjente ose urdhrin për mbrojtje të përkohshme emergjente, kryen veprë penale që dënohet me gjobë prej 200€ e deri më 2000€, ose me burgim deri në gjashtë muaj. Shkelja e përsëritur e urdhërit për mbrojtje ose e urdhërit për mbrojtje emergjente konsiderohet rrethanë rënduese për kryerësin. Shkelja e urdhërit për mbrojtje, e urdhërit për mbrojtje emergjente ose e urdhërit për mbrojtje të përkohshme emergjente do të ndiqet *ex officio*.

Shqiptimi i urdhërit për mbrojtje dhe urdhërit për mbrojtje emergjente me vendim gjykate, nuk i ndalon palët e interesuara të nisin procedurë penale, për sa i përket veprimeve ose mosveprimeve që përbëjnë vepra penale. Po ashtu shqiptimi i urdhërit për mbrojtje, urdhërit për mbrojtje emergjente, apo urdhërit për mbrojtje të përkohshme emergjente, nuk i cenon të drejtat pasurore ose të kujdestarisë së asnjë personi pas skadimit të urdhërit.

Kush e zbaton urdhrin për mbrojtje?

Në parim organ kompetent për ekzekutimin e masave mbrojtëse është Policia e Kosovës. Themë në parim sepse disa masa të cilat lëshohen në rastet kur viktimë është i mituri, apo rastet kur preken interesat e fëmijëve të mitur, ekzekutimin e masave duhet ta bëjë gjykata në procedurën e përmbarrimit të dhunshëm e në prani edhe të përfaqësuesit të Qendrës për Punë Sociale në territorin e të cilës e ka vendbanimin apo vendqëndrimin viktimë. Kjo për arsye se në rastet kur viktimë është i mituri, apo kur nga rasti konkret i dhunës në familje, preken edhe interesat e fëmijës së mitur, ekzekutimi i masave përkatëse mbrojtëse paraqet sfidë në vete dhe kjo procedurë duhet të zhvillohet me kujdes të veçantë. Në procedurën e përmbarrimit të këtyre rasteve përveç gjyqtarit, dhe zyrtarit përkatës policor, duhet të marrin pjesë edhe përfaqësuesi i Qendrës për Punë Sociale,

e sipas rastit edhe pjesëmarrës të tjerë siç janë psikologu, pediatri, mjeku i lëmisë përkatëse, etj. Kjo ngase në këtë mënyrë mbrohet dhe sigurohet interesi më i mirë i fëmijës në këto procedura.

Ndryshimi, ndërprerja dhe vazhdimi i urdhër mbrojtjes

Neni 20 i LMDHF -së parasheh të drejtën e palës së mbrojtur apo të kryerësit të dhunës në familje që t'i parashtrij kërkesë gjykatës për ndryshimin ose ndërprerjen e urdhërit për mbrojtje, me ç'rast gjykata ka tagër që të vendos që të mbetet në fuqi urdhëri për mbrojtje, që i njëjti të ndryshohet, apo që ai urdhër të ndërpritet, gjithnjë nëse gjykata vlerëson se kanë pushuar shkaqet mbi bazën e të cilave është shqiptuar ai urdhër.

Pesëmbëdhjetë ditë para se të skadojë urdhri për mbrojtje, pala e mbrojtur ose përfaqësuesi i autorizuar, mund të parashtrij kërkesë për vazhdimin e urdhërit për mbrojtje.

Pas kësaj gjykata ka mundsi që nëse nuk ekzistojnë shkaqet mbi bazën e të cilave është lëshuar urdhri për mbrojtje ta ndërpresë urdhrin për mbrojtje në datën e skadimit të tij, ta ndryshoj atë apo në rastet kur nuk kanë pushuar shkaqet mbi bazën e të cilave është shqiptuar masa mbrojtëse të vendos që të vazhdohet urdhri për mbrojtje.

Te rasti i shqiptimit të masës së trajtimit të obligueshëm mjekësor ndaj kryesit të dhunës në familje nën ndikimin e alkoolit dhe substancave psikotrope, gjykata kompetente mund të marr vendim për ndryshimin e kësaj mase mbrojtëse vetëm duke u bazuar në propozimin e institucionit shëndetësor dhe mendimin e ekspertit përkatës. Deri te ndryshimi i kësaj mase mund të vije kur trajtimi mjekësor nuk jep rezultate, kryesi i dhunës nuk vjen rregullisht në trajtim dhe në rastet kur paraqitet nevoja për ndryshimin e masës.³⁸

Nëse nuk parashtrihet kërkesa për vazhdimin e urdhërit për mbrojtje, ai ndërpritet menjëherë ditën e skadimit. Ndërsa parashtrimi i kërkesës për ndryshim ose ndërprerje të urdhërit për mbrojtje, nuk e ndalon ekzekutimin e urdhërit për mbrojtje.

Mbrojtja e fëmijëve të rastet e lëshimit të urdhërmbrojtjes dhe urdhërmbrojtjes emergjente

LMDHF parasheh masa përmes të cilave preken edhe interesat e fëmijëve të mitur. Kështu me rastin e caktimit të masës së ndalimit të shqetësimit të personave të ekspozuar dhunës në familje, të paraparë me nenin 6 të këtij ligji, përkatësisht në rastet kur ekziston rreziku i përsëritjes së dhunës në familje, parashihet se në të njëjtën kohë kujdestaria e fëmijës përkohësisht i besohet viktimës së dhunës në familje, ndërsa e drejta prindërore përkohësisht i hiqet kryerësit të dhunës në familje gjykata.

³⁸ Neni 7 i Udhëzimit Administrativ Nr.02/2013

Në bazë të nenit 13 të LMDHF -së, në rastet kur viktimë është i mitur, ndër të tjera, kërkesën për lëshimin e urdhërmbrojtjes mund ta parashtrorjnë edhe përfaqësuesi i Qendrës për Punë Sociale në komunën ku pala e mbrojtur e ka vendbanimin apo vendqëndrimin.

Gjatë shqyrtimit të kërkesës për urdhërmbrojtje, gjykata e mbanë seancën e dëgjimit në mënyrë që t'i dëgjojë personat si në vijim: palën e mbrojtur (viktimën), përfaqësuesin e palës së mbrojtur, apo mbrojtësin e viktimave; kryerësin e dhunës në familje ose përfaqësuesin e autorizuar të tij; parashtruesin e kërkesës; përfaqësuesi i Qendrës për Punë Sociale i komunës në të cilën jeton përherë ose përkohësisht personi, në rastin kur parashtruesi i kërkesës është i moshës nën 18 vjeç, ose të njëjtit i mungon zotësia e veprimit, apo në rastin kur veprat e supozuara të dhunës në familje kanë ndikim në personin i cili është i moshës nën 18 vjeç, ose kur të njëjtit i mungon zotësia e veprimit; si dhe dëshmitarët të cilat sipas rastit gjykata mund t'i konsideroj si të domosdoshëm.

Gjithsesi, rëndësi të veçantë paraqesin rastet kur procedura zhvillohet si rezultat i kërkesës të bërë nga personi i cili është i moshës nën 18 vjeç, ose të njëjtit i mungon zotësia e veprimit, apo në rastin kur veprat e supozuara të dhunës në familje kanë ndikim në personin i cili është i moshës nën 18 vjeç, ose kur të njëjtit i mungon zotësia e veprimit.

Pra në këto raste është e detyrueshme prezenca e përfaqësuesit të Qendrës për Punë Sociale, e kjo për mbrojtjen sa më të mirë të interesit të fëmijës së mitur. Është interesant të ceket se përkundër faktit se këto procedura janë shumë të ndejshme dhe komplekse, shprehimisht me LMDHF nuk është e paraparë se procedura në këto raste është jo publike, ndërsa që marrja në pyetje e të miturit, duhet të bëhet në prezencën e përfaqësuesit të Qendrës për Punë Sociale.

Në fakt, me nenin 6.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr.2003/12, të datës 07.05.2003, në mënyrë indirekte është thënë se kërkesa e parashtruar për lëshimin e urdhërmbrojtjes apo urdhërit për mbrojtje emergjente mund të paraqitet sipas ligjit mbi familjen dhe marrëdhëniet martesore. Megjithatë, praktika gjyqësore ka dëshmuar se seancat në këto procedura janë jo publike dhe se marrja në pyetje e fëmijës së mitur, nuk guxon të bëhet pa pjesëmarrjen e përfaqësuesit të Qendrës për Punë Sociale.

Meqenëse në nenin 23 pika 3.4 të LMDHF -së, përveç të tjerave parashihet që vendimi për urdhërmbrojtje i dorëzohet edhe Qendrës për Punë Sociale, ku e ka vendbanimin apo vendqëndrimin pala e mbrojtur apo personat e tjerë të përmendur në këtë urdhër, nënkuptohet se edhe në këtë procedurë, është i kyçur aktivisht organi i kujdestarisë në kuadër të Qendrës për Punë Sociale.

Në fakt, me nenin 24 par.5 të LMDHF -së, parashihet detyrimi ligjor i Policisë së Kosovës që në rastet kur viktimë është e moshës nën 18 vjet, ose kur e njëjta nuk ka zotësi veprimi, apo kur veprat e dhunës në familje janë aq të rënda sa që ndikojnë në qetësinë apo sigurinë e personit të moshës së mitur, apo në rastet kur ky i mitur nuk e ka aftësinë e plotë të veprimit ndërkohë që jeton në

banesën e njëjtë, rasti të raportohet menjëherë në Qendrën për Punë Sociale të komunës në të cilën ai person e ka vendbanimin apo vendqëndrimin.

Pra edhe në këto raste, rendon detyrimi mbi Policinë e Kosovës, që jo vetëm se duhet ta njoftoj Qendrën për Punë Sociale, por se edhe vetë procedura e shqiptimit të kësaj mase, në rastet kur viktima janë të miturit, apo kur ata janë të prekur në çfarëdo mënyre nga rasti konkret, duhet të jetë shumë e kujdesshme, gjithmonë me prezencën e përfaqësuesit të Qendrës për Punës Sociale dhe gjithnjë duke e marrë për bazë interesin sa më të mirë të të miturit, duke e ruajtur dinjitetin, personalitetin dhe integritetin e të miturit.

E DREJTA E TRASHËGIMISË

E drejta në trashëgimi përfaqëson një të drejtë e cila është e rregulluar me norma pozitive. Aktualisht në Kosovë, trashëgimia është e rregulluar me Ligjin për Trashëgiminë i Kosovës nr.2004/26, i aprovuar nga Kuvendi i Kosovës me 28.06.2004, i cili ka hyrë në fuqi me datën 01.08.2006 (Gazeta zyrtare e IPVQ-ve, viti I, nr.3/2006), në tekstin e mëtutjeshëm edhe si LTK.

Në nenin 1, të LTK-së, është përcaktuar objekti i LTK-së. Në paragrafin 1, të nenit 1, të LTK-së, përcaktohet se: *“Me këtë Ligj rregullohet e drejta në trashëgimi”*, ndërsa në paragrafin 2, të nenit të njëjtë përcaktohet se: *“Trashëgimia është kalimi me ligj ose në bazë të testamentit i pasurisë (trashëgimit) së personit të vdekur (trashëgimlënësit) tek një ose më shumë persona (trashëgimtarët ose legatarët), sipas rregullave të caktuara në këtë ligj”*.

Objekti i trashëgimisë

Në objektin e trashëgimit hyjnë si sendet e luajtshme, ashtu edhe ato të paluajtshme që i kanë takuar trashëgimlënësit në kohën e vdekjes së tij, pa marrë parasysh vlerën apo sasinë e sendeve. Me nenin 2 të Ligjit për Trashëgiminë të Kosovës (LTK), është ka përcaktuar se: *“Mund të trashëgohen sendet dhe të drejtat të cilat u përkasin individëve”*, nga e cila dispozitë ligjore rezulton se objektin e trashëgimisë e përbëjnë të drejtat pasurore të përshtatshme për trashëgim në kohën e vdekjes së trashëgimlënësit.

Nga kjo rezulton se objekti i trashëgimisë mund të përkufizohet si:

- tërësi e të drejtave reale (e drejta e pronësisë, pengut, servituteve, posedimit etj.);
- tërësi e të drejtave të detyrimeve (kontrata e shitblerjes, shpërblimi i dëmit, pasurimi i pabazë, depozita, premitë e sigurimeve etj);
- tërësi e të drejtave të autorit, dhe
- tërësi e të drejtave të pronësisë industriale.

Veçimi i sendeve nga pasuria trashëgimore

Sendet që nuk e përbëjnë objektin e trashëgimisë veçohen para se të bëhet pjesëtimi i pasurisë (neni 158 i LTK). Këtu veçohet prona e përbashkët e bashkëshortëve dhe pasuria e pasardhësve. Sipas dispozitës së nenit 36.3 të LTK-së *“veçimi i pasurisë dhe sendeve bëhet vetëm me kërkesën e autorizuesit”* brenda pesë viteve nga dita e hapjes së trashëgimisë.

Në pasuri trashëgimore nuk hyjnë:

- pasuria e përcaktuar si shpërblim për mbajtjen e trashëgimlënësit në bazë të kontratës për mbajtje të përjetshme;
- punët e tjera juridike për së gjalli tek të cilat është përcaktuar se dorëzimi i sendit mund të bëhet deri në mbarimin e jetës së trashëgimlënësit;
- sendet që trashëgimlënësi i ka pasur në ruajtje, dhe
- sendet e tjera (orenditë e shtëpisë, veshmbathje, shtrojë-mbulojë etj.)

Barazia në trashëgimi

Barazia e trashëgimtarëve është e garantuar me ligj. LTK me dispozitat e nenit 3 ka rregulluar çështjen e barazisë në trashëgimi duke përcaktuar në paragrafin 1, të nenit 3, se: “ *Të gjithë personat fizik në kushte të njëjta janë të barabartë në trashëgimi*”. Në paragrafin 2, të nenit 3 të LTK-së, është përcaktuar se: “*Fëmijët e lindur jashtë martesë, kur atësia është njohur rregullisht ose është vërtetuar me vendim të gjykatës apo organit kompetent si dhe fëmijët e adoptuar barazohen me fëmijët legjitim*”.

Për të drejtën e fëmijëve në trashëgimi në mënyrë specifike LTK me dispozitën e nenit 22 ka paraparë se: “*Fëmijët e lindur në martesë, jashtë martesë, kur atësia është njohur rregullisht ose është vërtetuar me vendim të gjykatës apo të organit kompetent, si dhe ata të adoptuar dhe pasardhësit e tyre kanë të drejta të barabarta në trashëgimi*”.

Nga dispozita e cituar rrjedh se të gjithë fëmijët janë të barabartë në trashëgimi, pavarësisht faktit se të njëjtit janë legjitim pra nga një martesë e ligjshme, janë nga një bashkësi jashtëmartesore apo faktike apo janë të adoptuar. Ky parim është në frymën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve pavarësisht nga fakti se janë apo nuk janë nga një martesë e ligjshme.

Duke qenë se fëmija i adoptuar është i barabartë me fëmijët tjerë sipas dispozitave të LTK-së, është përcaktuar edhe pamundësia ligjore që fëmija i adoptuar të trashëgojë te familja e origjinës. Në paragrafin 3 të nenit 3, të LTK-së, është paraparë se: “*I adoptuari nuk trashëgon në familjen e origjinës së tij dhe as kjo nuk e trashëgon atë*”.

Trashëgimia në bazë të ligjit

Trashëgimia me ligj është kalim me ligj i pasurisë së personit të vdekur tek një a më shumë persona sipas rregullave të caktuara ligjore.

Trashëgimia me ligj zbatohet kur trashëgimlënësi nuk ka lënë testament, ose ka lënë testament vetëm për një pjesë të pasurisë së tij ose kur testamenti është tërësisht ose pjesërisht i pavlefshëm³⁹.

Si fakte më të rëndësishme për formimin e radhëve të trashëgimisë ligjore janë marrë kryesisht:

- gjinia si lidhje për caktimin e radhës ligjore të trashëgimisë, dhe
- martesë si lidhje për caktimin e radhës ligjore të trashëgimisë.

³⁹ Shih LTK neni 9.

Trashëgimtarët ligjor

LTK me dispozitat e nenit 11 e ka rregulluar çështjen e trashëgimtarëve ligjor. Kështu me dispozitën e nenit 11 paragrafi 1, përcaktohet se: *“Trashëgimtarët ligjor janë: fëmijët e trashëgimlënësit, të adoptuarit e tij dhe pasardhësit e tyre, bashkëshorti, prindërit, vëllezërit e motrat dhe pasardhësit e tyre, gjyshi e gjyshja dhe pasardhësit e tyre”*, ndërsa në paragrafin 2, të nenit të njëjtë përcaktohet se: *“Me ligj trashëgimlënësin e trashëgon edhe bashkëshorti i tij jashtëmartesor, i cili barazohet me bashkëshortin martesor. Bashkësi jashtëmartesore në kuptim të këtij Ligji konsiderohet bashkësia jetësore e gruas së pamartuar dhe e burrit të pamartuar e cila ka zgjatur një kohë të gjatë dhe që ka pushuar me vdekjen e trashëgimlënësit, me kusht të kenë qenë plotësuar prezumimet për vlefshmërinë e martesës”*. LTK në paragrafin 1, të nenit 11, ka përcaktuar të gjithë subjektet që mund ta kenë cilësinë e trashëgimtarëve ligjorë për ta trashëguar trashëgimlënësin, natyrisht sipas radhëve trashëgimore.

Përveç kësaj është shumë me rëndësi të theksohet që me këtë dispozitë është përcaktuar edhe mundsia e përfaqësuesve të trashëgimtarëve ligjorë për ta trashëguar trashëgimlënësin sipas kushteve ligjore që përcakton LTK.

Në paragrafin 2, të nenit 11 të LTK-së, është paraparë mundsia që trashëgimlënësin ta trashëgojë edhe bashkëshorti jashtëmartesor, i cili është barazuar me bashkëshortin martesor. Por në këtë rast LTK ka definuar edhe kuptimin e bashkësisë jashtëmartesore, e cila sipas këtij ligji është *“Bashkësia jetësore e gruas së pamartuar dhe e burrit të pamartuar e cila ka zgjatur një kohë të gjatë dhe që ka pushuar me vdekjen e trashëgimlënësit”* me kusht që t'i ketë plotësuar prezumimet për vlefshmërinë e martesës. LTK duke e definuar kuptimin e bashkësisë jashtëmartesore ka eliminuar edhe mundsitë që dispozita të interpretohet me dykuptimësi dhe rrjedhimisht edhe të zbatohet në mënyrë të gabuar. Pra në këtë rast bashkëshorti jashtëmartesor do të mund ta trashëgojë bashkëshortin martesor nëse bashkësia jashtëmartesore ka zgjatur në kohë të mjaftueshme për tu konsideruar se i plotëson prezumimet për vlefshmërinë e martesës e që do të thotë se përveç kohëzgjatjes duhet të plotësohen edhe kushtet tjera sikur kur lidhet martesë dhe gjithashtu të mos kenë pasur asnjëri nga bashkëshortët jashtëmartesor njëkohësisht edhe martesë me ndonjë person tjetër.

E drejta trashëgimore në Kosovë ia njeh të drejtën në trashëgimi të bashkëshortit jashtëmartesore nëse plotësohen këto kushte, sipas nenit 28 të LTK, i ndryshuar dhe plotësuar me nenin 4 të Ligjit nr.06/L-008, dhe atë:

- Bashkësia jashtëmartesore deri në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit ka zgjatur të paktën pesë (5) vjet, e nëse nga kjo marrëdhënie kanë lindur fëmijë-të paktën tri (3) vjet dhe,
- Në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit as njëri nga personat që kanë bashkëjetuar të mos ketë qenë ligjërisht i martuar me ndonjë person të tretë, ose nëse trashëgimlënësi ka

qenë ligjërisht i martuar me personin e tretë, ka paraqitur padi për shkurorëzimin ose anulimin e martesës dhe pas vdekjes së tij konstatohet se padia ka pasur mbështetje.

Ndërsa sipas nenit 28.2 të LTK, trashëgimtarë të domosdoshëm nuk konsiderohen bashkëshortët jashtëmartesor.

Në rast se trashëgimlënësi ka fëmijë martesor dhe jashtëmartesor dhe njëkohësisht ka jetë të përbashkët me gruan martesore dhe atë jashtëmartesore, atëherë në kuptimin e dispozitave të cituara rrjedh se trashëgimtarë të barabartë do të jenë fëmijët si nga martesa ashtu edhe jashtë martese dhe bashkë me të gjithë fëmijët edhe bashkëshorti martesor, duke e përjashtuar bashkëshortin jashtëmartesor.

Të gjithë personat e përcaktuar në paragrafin 1, të nenit 11, të LTK-së, do të thirren në trashëgimi sipas radhës së caktuar në LTK. Po ashtu është përcaktuar se trashëgimtarët e radhës me të afërt të trashëgimisë do t'i përjashtojnë nga trashëgimi personat e radhës më të largët.

Radhët e trashëgimisë

Trashëgimtarët ligjor sipas të drejtës sonë trashëgimore riradhitën në tri radhë të trashëgimit. Numri i vogël i radhëve të trashëgimisë është pasojë e ndikimit të tendencave të reja për pakësimin e radhëve të trashëgimisë. Sipas normave ligjore, duhet të plotësohet njëri nga këto kushte për të qenë trashëgimtar ligjor potencial në momentin e vdekjes se de-cujus-it: 1) gjinia e gjakut, 2) gjendja civile), dhe 3) lidhja martesore⁴⁰. Rrethi i personave të thirrur në trashëgimi është përcaktuar me dispozitën e nenit 11.1, të LTK-së.

Raporti midis radhëve të trashëgimisë caktohet sipas parimit të përjashtimit, ashtu që trashëgimtarët e radhës më të afërt i përjashtojnë nga trashëgimi personat e radhës më të largët.

Radha e parë e trashëgimisë

Radha e parë e trashëgimisë përbëhet nga pasardhësit dhe bashkëshorti i trashëgimlënësit. Në nenin 12, përcaktohet se: *“Trashëgimlënësin e trashëgojnë para të gjithëve fëmijët e tij dhe bashkëshorti i tij. Personat nga paragrafi (1) i këtij neni trashëgojnë në pjesë të barabarta”*.

Në kuptim të kësaj dispozite ritheksojmë faktin se në mënyrë të barabartë do të trashëgojnë të gjithë trashëgimtarët e radhës së parë, ndërsa ashtu siç është diskutuar edhe më lartë me fëmijët legjitim janë barazuara edhe fëmijët jashtëmartesor dhe fëmijët e adoptuar, ndërsa për bashkëshortin jashtëmartesor vlen rregulli sipas të cilit i njëjti do të mund të trashëgojë nëse bashkësia jashtëmartesore i ka plotësuar kushtet e kërkuara për këtë bashkësi sipas këtij ligji.

E drejta e përfaqësimit në radhën e parë- Me të drejtën e përfaqësimit (jus representationes) kuptojmë autorizimet e pasardhësve në kuadër të një vije të drejtë zbritëse që të paraqiten me

⁴⁰ Hamdi Podvorica, E Drejta Trashëgimore, Prishtinë 2006, fq.49.

zëvendësim në vend të paraardhësit të vdekur përpara de cujus-it, të cilët zaten janë persona të afërt gjinie dhe trashëgojnë atë pjesë të trashëgimisë të cilën do ta kishte trashëguar paraardhësi i tyre në rastin konkret, sikur të ishte paraqitur vet si trashëgimtar⁴¹.

Në rastin kur ndonjëri nga fëmijët e trashëgimlënësit ka vdekur para trashëgimlënësit, kur fëmijët kanë hequr dorë nga trashëgimia, janë shpallur të padenjë për të trashëguar, ose janë përjashtuar krejtësisht nga trashëgimia, atëherë pjesën trashëgimore që do ta trashëgonin këta fëmijë e trashëgojnë fëmijët e fëmijëve të trashëgimlënësit. Në lidhje me të drejtën e përfaqësimit me dispozitën e nenit 13, të LTK, është përcaktuar se: *“Kur një nga fëmijët ka vdekur para trashëgimlënësit, në vend të tij hyjnë me zëvendësim fëmijët e tij, e kur edhe të paslindurit për shkaqet e parapara me ligj nuk mund të jenë trashëgimtarë, hyjnë në trashëgim të paslindurit e tyre pa kufizim”*. Në rastin e përfaqësimit nuk ka kufizim dhe përfaqësimi sipas vijës do të zbatohet deri sa ka trashëgimtarë përfaqësues. Në lidhje me padenjësinë në trashëgim LTK me dispozitën e nenit 110 paragrafi 1, ka përcaktuar se: *“Nuk mund të trashëgojë personi i padenjë për të trashëguar, ndërsa paragrafi 2 ka përcaktuar se: “Padenjësia nuk i pengon pasardhësit e personit të padenjë të trashëgojnë njësoj sikur personi i padenjë të kishte vdekur para trashëgimlënësit”*. Nga dispozita e cituar në mënyrë eksplicite është paraparë e drejta e pasardhësve të personit të padenjë për ta trashëguar paraardhësin e prindit të tyre.

Në lidhje me rrethanën e përjashtimit LTK me dispozitën e nenit 117 ka paraparë se: *“Me përjashtimin trashëgimtari humb të drejtat trashëgimore në vëllimin në të cilin është përjashtuar, kurse të drejtat e personave të tjerë që mund të trashëgojnë trashëgimlënësin caktohen sikur i përjashtuari të kishte vdekur para trashëgimlënësit”*.

Në rastin e përjashtimit të trashëgimtarit për pasardhësit e tij e drejta në trashëgim të paraardhësit të tij nuk humbet sepse aplikohet rregulli analog sikurse personi i përjashtuar të kishte vdekur para trashëgimlënësit.

Radha e dytë e trashëgimisë

Do të vijë në shprehje radha e dytë e trashëgimisë në qoftë se nuk do të ketë pasardhës trashëgimlënësi. Në radhën e dytë të trashëgimisë vijnë në shprehje prindërit e trashëgimlënësit dhe bashkëshorti i trashëgimlënësit. LTK me dispozitën e nenit 14 paragrafi 1, ka përcaktuar se: *“Pasurinë e trashëgimlënësit që nuk ka lënë pasardhës e trashëgojnë prindërit e tij dhe bashkëshorti i tij”*, ndërsa në paragrafin 2, të nenit të njëjtë përcaktohet se: *“Prindërit e trashëgimlënësit trashëgojnë gjysmën e pasurisë në pjesë të barabarta, kurse gjysmën tjetër të pasurisë e trashëgon bashkëshorti i trashëgimlënësit”*. Me dispozitën në paragrafin 2, është përcaktuar se kush e përbënë radhën e dytë të trashëgimtarëve, ndërsa në paragrafin 2, është përcaktuar masë e trashëgimisë që do të trashëgojë secili trashëgimtar në radhën e dytë.

⁴¹ Po aty, fq.51.

Në sistemin tonë pozitiv është bashkëshorti i trashëgimlënësit që trashëgon në të dy radhët edhe në radhën e parë edhe në radhën e dytë. Në radhën e parë në mënyrë të barabartë me trashëgimtarët tjerë (fëmijët e trashëgimlënësit) ndërsa në radhën e dytë trashëgon në rast se trashëgimlënësi nuk ka lënë pasardhës. Për dallim nga radha e parë që trashëgon në mënyrë të barabartë me trashëgimtarët tjerë, tek radha e dytë bashkëshorti i trashëgimlënësit trashëgon ½ e pasurisë-masës trashëgimore, ndërsa ½ e trashëgojnë prindërit e trashëgimlënësit.

E drejta e përfaqësimit në radhën e dytë- Edhe në radhën e dytë ekziston e drejta e përfaqësimit. Me dispozitat e nenit 15 është rregulluar e drejta e përfaqësimit nga ana e vëllezërve dhe motrave dhe pasardhësve të tyre. LTK në paragrafin 1 të nenit 15 ka paraparë se: *“Në qoftë se njëri nga prindërit e trashëgimlënësit ka vdekur para trashëgimlënësit, pjesën e pasurisë trashëgimore që do t’i takonte sikur të kishte jetuar pas trashëgimlënësit e trashëgojnë fëmijët e tij (vëllezërit dhe motrat e trashëgimlënësit), nipat e stërnipat e tij dhe pasardhësit e largët të tij, sipas dispozitave të këtij ligji që vlejnë për rastin kur trashëgimlënësin e trashëgojnë fëmijët dhe pasardhësit e tjerë të tij”*, ndërsa në paragrafin 2 të nenit të njëjtë përcaktohet se: *“Në qoftë se të dy prindërit e trashëgimlënësit kanë vdekur para trashëgimlënësit, pjesën e pasurisë trashëgimore që do t’i takonte secilit prej tyre sikur të kishin jetuar pas trashëgimlënësit e trashëgojnë pasardhësit përkatës, siç është përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni”*. Në kuptim të dispozitave të cituara rezulton së vëllezërit dhe motrat e trashëgimlënësit do të kenë të drejtën në trashëgimi në raport me trashëgimlënësin (vëllain apo motrën) në radhën e dytë sipas përfaqësimit, pasi që LTK nuk ka përcaktuar se në rast se në qoftë se njëri nga prindërit e trashëgimlënësit ka vdekur para trashëgimlënësit, pjesa që kish pas mi taku atij t’i shtohet prindit tjetër. Një zgjidhje e tillë ligjore ka ekzistuar në ligjin e vjetër të trashëgimisë. Edhe në rastin kur para trashëgimlënësit kanë vdekur të dy prindërit e trashëgimlënësit ½ e pasurisë që kishte me iu takuar prindërve të trashëgimlënësit sipas të drejtës së përfaqësimit ju kalon vëllezërve dhe motrave.

E drejta e përfaqësimit edhe në radhën e dytë vjen në shprehje derisa sa ka trashëgimtarë sipas përfaqësimit në këtë radhë. Për shembull nëse ka vdekur njëri prind i trashëgimlënësit apo të dy prindërit e trashëgimlënësit para trashëgimlënësit atëherë sipas përfaqësimit vijnë në shprehje vëllezërit dhe motrat e trashëgimlënësit, por në qoftë se edhe ndonjëri nga vëllezërit apo motrat e trashëgimlënësit ka vdekur para trashëgimlënësit, atëherë vijnë në shprehje fëmijët e vëllezërve apo motrave të trashëgimlënësit, d.m.th. nipat apo mbesat.

Në të gjitha rastet vëllezërit dhe motrat e trashëgimlënësit vetëm nga ana e atit trashëgojnë në pjesë të barabarta pjesën e pasurisë trashëgimore të atit, vëllezërit dhe motrat vetëm nga ana e nënës trashëgojnë në pjesë të barabarta vetëm pjesën e nënës, kurse vëllezërit dhe motrat të së njëjtës nënë dhe të të njëjtit at trashëgojnë në pjesë të barabarta me vëllezërit dhe motrat nga ana e të atit pjesën e të atit, kurse me vëllezërit dhe motrat nga ana e nënës pjesën e nënës⁴².

LTK e ka rregulluar edhe situatën kur njëri nga prindërit e trashëgimlënësit ka vdekur para trashëgimlënësit por nuk ka lënë pasardhës. Me dispozitën e nenit 16 të LTK është paraparë se:

⁴² Shih neni 15 paragrafi 3, i LTK

“Në qoftë se njëri nga prindërit e trashëgimlënësit ka vdekur para trashëgimlënësit, e nuk ka lënë asnjë pasardhës, pjesën e pasurisë trashëgimore që do t’i takonte sikur të kishte jetuar pas trashëgimlënësit e trashëgon prindi tjetër, e në qoftë se edhe ky ka vdekur para trashëgimlënësit, pasardhësit e tij trashëgojnë pjesën e pasurisë trashëgimore që do t’u takonte të dy prindërve, sipas nenit 15 të këtij ligji”. Në kontekstin e kësaj dispozite na rezulton se në qoftë se ka vdekur njëri prind i trashëgimlënësit dhe nuk ka pasardhës atëherë pjesa nga masa trashëgimore që kish për t’i takuar prindit që ka vdekur para trashëgimlënësit i shtohet prindit pasjetues. Gjithashtu me dispozitën e njëjtë është paraparë edhe situata kur të dy prindërit e trashëgimlënësit kanë vdekur para trashëgimlënësit me ç’rast është përcaktuar se kur të dy prindërit kanë vdekur atëherë pjesën që do tu takonte të dy prindërve (1/2 e tërësisë) do ta trashëgojnë pasardhësit e tyre, pra vëllezërit dhe motrat e sipas përfaqësimit nipat dhe mbesat.

Në praktikën gjyqësore tek radha e dytë e trashëgimisë janë paraqitur raste kur është kontestuar nga ana e bashkëshortit pasjetues e drejta e pasardhësve të prindërve të trashëgimlënësit, me idenë se kur kanë vdekur të dy prindërit e trashëgimlënësit para trashëgimtarit nuk vjen në shprehje e drejta e përfaqësimit. Një nxitje e tillë është ndikuar në njëfarë mase nga përmbajtja e dispozitës së nenit 17 të LTK me të cilën është paraparë se: *“Në qoftë se të dy prindërit e trashëgimlënësit kanë vdekur para trashëgimlënësit e nuk kanë lënë asnjë pasardhës, tërë pasurinë trashëgimore e trashëgon bashkëshorti i trashëgimlënësit”.* Për këtë çështje praktika gjyqësore është treguar mjaft e prerë duke i interpretuar dispozitat e nenit 15, 16 dhe 17, në atë mënyrë që edhe në radhën e dytë vjen në shprehje e drejta e përfaqësimit nëse ka trashëgimtarë sipas radhës përkatës dhe vetëm në rastin kur prindërit e trashëgimlënësit kanë vdekur pa lënë trashëgimtarë dhe përfaqësues që i përfaqësojnë trashëgimtarët e prindërve, atëherë e tërë pasuria trashëgohet nga bashkëshorti.

Në këtë situatë kushti për ta trashëguar në radhën e dytë tërë pasurinë bashkëshorti është që në anën e prindërve të trashëgimlënësit të kenë vdekur prindërit dhe të njëjtit të mos kenë trashëgimtarë tjerë as sipas përfaqësimit

Radha e tretë e trashëgimisë

Radha e tretë e trashëgimit vjen në shprehje vetëm në raste kur nuk ka trashëgimtarë në radhën e parë dhe të dytë, kur ata nuk e pranojnë të trashëgojnë apo kur përjashtohen nga trashëgimi.

Me dispozitën e nenit 18 paragrafi 1, është paraparë se: *“Pasurinë trashëgimore të trashëgimlënësit që nuk ka lënë pasardhës, bashkëshort prindër dhe prindërit e tij nuk kanë lënë pasardhës të tjerë, e trashëgojnë gjyshërit dhe gjyshet e tij”*, ndërsa në paragrafin 2, është paraparë se: *”Gjysmën e pasurisë trashëgimore e trashëgojnë gjyshi dhe gjyshja nga ana e atit, kurse gjysmën tjetër gjyshi dhe gjyshja nga ana e nënës”.*

Është karakteristike për radhën e tretë të trashëgimit se si trashëgimtarët konkurojnë në trashëgimi vetëm trashëgimtarët ligjor të thirrur në trashëgim sipas faktit të gjinisë së gjakut. Kjo nuk ishte

karakteristikë për të dy radhët tjera të trashëgimisë, sepse aty konkurronin trashëgimtarët edhe sipas faktit të gjendjes civile (birësimi), edhe sipas faktit të lidhjes së martesës (bashkëshorti)⁴³.

Kur konkurojn për të drejtën në trashëgimi trashëgimtarët e radhës së tretë rezulton se gjyshërit nga të dy trungjet janë të barabartë, pra trashëgojnë nga ½ të tërë masës trashëgimore. Pra këtu pasuria trashëgimore ndahet në dy pjesë të barabarta: njëra u takon trashëgimtarëve të trungut të atësisë dhe tjetra u takon trashëgimtarëve të trungut të amësisë.

E drejta e përfaqësimit në radhën e tretë- Edhe në radhën e tretë të trashëgimisë vjen në shprehje e drejta e përfaqësimit. Formula e përfaqësimit është pothuajse identike sikur në radhën e dytë. Për shembull nëse njëri nga gjyshërit e trungut të amësisë ka vdekur para trashëgimlënësit, atëherë pasuria që do ti takonte të njëjtit nuk i shtohet gjyshit tjetër por u kalon sipas përfaqësimit pasardhësve të gjyshit i cili ka vdekur para trashëgimlënësit. Edhe në rastin kur të dy gjyshërit kanë vdekur pasuria u takon sipas përfaqësimit trashëgimtarëve të tyre. Në rastin kur të dy gjyshërit e njërit trung kanë vdekur para trashëgimlënësit dhe nuk kanë lënë pasardhës dhe as pasardhësit nuk kanë trashëgimtar atëherë e tërë pasuria trashëgohet nga trungu tjetër i gjyshërve. Kjo situatë është rregulluar me dispozitën e nenit 20 të LTK sipas kësaj përmbajtje: *“Në qoftë se gjyshi dhe gjyshja e të njëjtit trung kanë vdekur para trashëgimlënësit dhe nuk kanë lënë pasardhës, pjesën e pasurisë trashëgimore që do t’u takonte sikur të kishin jetuar pas trashëgimlënësit e trashëgojnë gjyshi dhe gjyshja e trungut tjetër, sikurse është caktuar në nenin 19 të këtij ligji”*.

Komuna si trashëgimtarë ligjor

Nëse trashëgimlënësi nuk ka lënë as trashëgimtarë dhe as testament, trashëgimi i takon komunës ku trashëgimlënësi ka pasur vendbanimin apo vendqëndrimin e fundit. Çështja e trashëgimit nga ana e komunës është rregulluar me dispozitat e nenit 20 të LTK.

Trashëgimia në bazë të testamenti

Testamenti është deklaratë e fundit e vullnetit, e njëanshme, rigorozisht personale, e personit me zotësi testamentare, e rregulluar me ligj, me të cilën disponon pasurinë pas vdekjes së tij dhe eventualisht jep urdhëresa të tjera dhe deklarata lidhur me pasurinë e tij. Testatori mund të lë shumë teste, por ato duhet të përmbajnë vetëm një vullnet të fundit të trashëgimlënësit.

Zotësia për të përpiluar testamentin

Kushti thelbësor që një testament të jetë i vlefshëm është që testatori të ketë pasur zotësinë e bërjes së testamentit. Është rregull që një person për të lënë një testament duhet që në mënyrë komulative t’i plotësoj këto kushte, të cilat janë parapa në nenin 70 të LTK, dhe atë:

1. Të ketë mbushur 18 vjet, apo 16 vjet, por me kusht që të jetë i martuar.
2. Të ketë zotësinë për të vepruar.

⁴³ Hamdi Podvorica, E Drejta Trashëgimore, Prishtinë 2006, fq.58.

Llojet e testamentit

Legjislacioni ynë për trashëgimin njëhë këto lloje të testamentit, të cilët do trajtohen ne vijim

1. Testamenti i shkruar me dorë të vetë testatorit (neni 74 të LTK). Këtë testament testatori duhet ta ketë shkruar që nga fillimi e deri në mbarim me dorën e vet, si dhe ta ketë datuar dhe nënshkruar ose ta ketë venë gishtin e vet.
2. Testamenti me shkrim në prani të dy dëshmitarëve (neni 75 të LTK). Ky testament shkruhet nga dikush tjetër sipas tregimit të testatorit e jo nga testatori, por pasi që ta ketë lexuar testatori tekstin e shkruar të testamentit dhe të ketë deklaruar se ky është testamenti im, e nënshkruan, dhe e daton në prani të dy dëshmitarëve që e kuptojnë gjuhën e testatorit dhe që kanë zotësi për të vepruar.
3. Testamenti gjyqësor (*testamentum judiciale neni 76 LTK*) quhet testamenti të cilin e përpilon gjyqtari sipas tregimit të vullnetit të fundit të trashëgimlënësit, në mënyrën dhe kushtet e parapara me ligj. Gjyqtari është i obliguar që pasi të vërtetojë identitetin e tij ta njofton me pasojat juridike të testamentit.

Në rastet e caktuara kur testatori nuk është në gjendje të lexojë, testamentin e përpilon vetë gjyqtari dhe e lexon në praninë e dy dëshmitarëve, të cilin pas leximit e nënshkruan vet testatori, përkatësisht e vënë shenjën e gishtit të vet, me të cilin rast testamentin duhet të nënshkruajnë edhe vetë dëshmitarët.

Testatori mund ti besoj për ruajtje gjykatës sikur testamentin e bërë në gjykatë, ashtu që edhe testamentin që e ka përpiluar vetë. Me rastin e pranimit të këtij testamenti gjykata harton në procesverbal, e vendos në një pliko, e vulos dhe e ruan në gjykatë.

4. Testamenti në rrethana të jashtëzakonshme -Në raste të tilla testatori shprehë vullnetin e tij të fundit me gojë para dy dëshmitarëve që nuk është e domosdoshme të dinë shkrim-leximin, kur për shkak të rrethanave të caktuara nuk mund ta bënë atë me shkrim apo në ndonjë formë tjetër.

Këta dëshmitar qëndrojnë në obligim, duhet ta përpilojnë një deklaratë me shkrim të testatorit dhe si të tillë ta dorëzojnë në gjykatë, apo edhe fjalët e fundit të testatorit drejtë për drejtë në gjykatë ti përsërisin duke treguar se kur, ku dhe në çfarë rrethana testatori ka deklaruar vullnetin e tij të fundit.

Këta dëshmitar janë të obliguar që pas përfundimit të rrethanave të jashtë zakonshme në afat prej 30 ditësh të deklarohen në gjykatë mbi shprehjen e vullnetit të fundit të testatorit

5. Testamenti noterial- këtë lloj të testamentit nuk e ka rregulluar ligji për trashëgimin, por me hyrjen në fuqi të ligjit për noterinë dhe funksionalizimin e sistemit noterial, tanimë ka filluar të aplikohet edhe në Kosovë. Kushtet për vlefshmërinë e testamentit noterial dhe mënyra e përpilimit të tij janë të njëjta si të testamenti gjyqësor, por si person zyrtarë merr pjesë noteri e jo gjyqtari.

Karakteristikat e testamentit

Testamentin e veçojnë nga punët tjera juridike shumë karakteristika të rëndësishme e të cilat do trajtohen në vijim.

- Testamenti është akt rigoroz personal

Testatori është i obliguar personalisht ta shfaqë vullnetin e fundit duke përcaktuar qartë përmbajtjen e testamentit. Këtu nuk mund të ia lë gjykatës apo ndokujt tjetër që ta bëjë në emër të këtij personi. Me rastin e përpilimit të testamentit përjashtohet çdo mundsi e përfaqësimit.

- Testamenti është punë juridike *mortis causa*

Testamenti prodhon efekte juridike vetëm në çastin e vdekjes së trashëgimlënësit, kur pasuria trashëgimore me forcën e ligjit kalon në trashëgimtarë. Pra, duhet thuhet se vdekja e personit të caktuar është element thelbësor për fillimin e prodhimit të efekteve juridike të punës juridike *mortis causa*.

- Testamenti është punë juridike bamirëse

Testamenti është gjithmonë punë bamirëse pa kundër shpërblim. Edhe atëherë kur trashëgimtarët ngarkohen me borxhe, me barrë, testamenti ka karakter bamirës, sepse vlera e borxheve dhe e barrave duhet të jetë të paktën në proporcion me përpjesën e tyre dhe deri në vlerën e pjesës së tyre të pasurisë trashëgimore.

- Testamenti është punë juridike e një anshme

Testamenti është akt juridik i një anshëm nga se lind dhe prodhon efekte juridike vetëm me deklarin e një vullneti të fundit. Vullneti i fundit i formuluar në testament duhet të jetë vullnet i vërtetë, real, i shfaqur lirshëm nga trashëgimlënësi.

- Testamenti është akt formal juridik

-

Një ndër kushtet që duhet me qenë një testament i vlefshëm është plotësimi i kërkesës ligjore lidhur me formën e paraparë me ligj. Në bazë të këtij fakti mund të konkludohet se testamenti bënë pjesë në punët juridike formale, për vlefshmërinë e të cilave kërkohet forma e paraparë me ligj.

Revokimi i testamentit

Testamenti si akt juridik universal mund të revokohet tërësisht apo pjesërisht në çdo kohë nga trashëgimlënësi. Trashëgimlënësi mund ta revokojë kurdoherë testamentin në tërësi ose pjesërisht⁴⁴. Ketë mund ta bëjë me shkrim, sipas procedurës së përcaktuar me ligj apo me asgjësim të dokumentit. Pasi ta revokoj testamentin trashëgimlënësi, revokimi shënohet në testament i cili ruhet në gjykatë⁴⁵.

Shkaqet kryesore mbi pa vlefshmërinë e testamentit

Janë tri shkaqe kryesore që si pasojë kanë pavlefshmërinë e testamentit edhe atë:

- kanosja, shtrëngimi, mashtrimi, lajthitja mbi shkaqet që kanë shtyrë trashëgimlënësin për të bërë testamentin;
- mungesa e formës së kërkuar me ligj, dhe
- mungesa e lirisë së vullnetit të testatorit.

Testamenti është i pa vlefshëm nëse është bërë me kanosje, me shtrëngim dhe me mashtrim. Vullneti i trashëgimlënësit përmban të meta kur nuk është shprehur në mënyrë serioze, reale dhe të lirë. Kanosja dhe shtrëngimi shkaktojnë frikë te trashëgimlënësi e kur ndjekja e frikës është shkak vendimtar për vendosjen e trashëgimlënësit për të bërë testament, atëherë ky testament është i pa vlefshëm. Në kuptim të dispozitës së nenit 71 të LTK-së edhe disponimet në testament janë të pa vlefshëm edhe kur ekziston lajthitja mbi shkaqet që kanë shtyrë trashëgimlënësin për ti bërë këto disponime.

Testamenti është i pa vlefshëm atëherë kur mungon forma e kërkuar me ligj. Për të qenë i plotfuqishëm kërkohen të plotësojë tri kushte kryesore edhe atë:

- testatori ta ketë shkruar tërësisht me dorën e vet;
- ta ketë nënshkruar me dorën e vet ose ta ketë vënë gishtin e vet, dhe
- ta ketë ditur duke treguar ditën, muajin dhe vitin e bërjes së testamentit.

Mungesa e zotësisë aktive të testamentit po ashtu është shkak i nulimit të testamentit. Raste të tilla paraqiten kur testamenti është bërë nga personi i cili nuk ka mbushur 18 vite, përkatësisht 16 vite. Humbja e më vonshme e kësaj zotësie, u tha edhe më lartë, nuk prekë vlefshmërinë e testamentit.

Një testament mund të jetë tërësisht i pa vlefshëm ose vetëm një pjesë e tij dhe kjo do të varet në radhë të parë nga shkak i pa vlefshmërisë dhe nga ajo se personi i interesuar a kërkon pavlefshmërinë e tërë testamentit apo një pjesë të tij.

⁴⁴ Shih LTK, neni 107.1.

⁴⁵ Shih LPJ, neni 109.

Testamenti absolut nul

Testamenti është absolut nul nëse dispozitat e tija janë në kundërshtim me dispozitat imperative ligjore, me rendin juridik dhe me rregullat e moralit. E drejta për të vërtetuar pavlefshmërinë nuk shuhet dhe në këtë nuk preket në rregullat e mbajtjes, fitimin nga jo pronari dhe në parashtrimin e kërkesave.

Testamenti relativ nul

Një testament është relativ nul vetëm atëherë nëse shkaqet e nulitetit cenojnë interesat individuale të caktuara në kuptim të dispozitës së nenit 85 të LTK-së, nulimin e testamentit për shkak të formës së kërkuar me ligj mund ta kërkojë pas hapjes së trashëgimisë vetëm personi që ka interes juridik edhe atë brenda një viti nga dita që merr njohuri për testamentin e më së largu brenda 10 viteve pas shpalljes së testamentit.

Përmbajtja e testamentit

Përmbajtjen e testamentit e përbëjnë urdhrat që dalin nga dispozitat e testamentit, pra, ajo përbëhet nga:

- caktimi i trashëgimtarëve,
- përcaktimi i pasurisë që do tu kalojë trashëgimtarëve (këtu mund të përfshihet gjithë pasuria trashëgimore apo vetëm një pjesë e saj),
- detyrimet që u ngarkohen trashëgimtarëve testamentar ose ligjor për dorëzimin e një pjese të pasurisë trashëgimore personave të tjerë (legu) dhe
- caktimi i zbatuesit të testamentit.

Në kuptim të dispozitës së nenit 87 të LTK-ës parashihet mundësia që trashëgimlënësi të caktojë me testament një ose më shumë trashëgimtar, që të trashëgojë tërë pasurinë e tij, ose një pjesë të pasurisë, pastaj që një apo më shumë personave u është lënë një apo më shumë sende etj. Për caktimin e trashëgimtarëve ose pasurisë trashëgimore ose të pjesës së sajë, me vullnetin e fundit të lirë të trashëgimlënësit, nuk mund të ketë as testament të plotfuqishëm dhe në bazë të normave ligjore.

Përmbajtja formale e testamentit ka të bëjë me rastin e caktimit të ndonjë ekzekutori të testamenti, apo caktimin e të ashtuquajturit konkretizor të vullnetit të testatorit vetëm në lidhje të veçantë në testament, p.sh., që të kujdeset vetëm për përmbushjen e urdhrat. Sa i përket caktimit të trashëgimtarëve me testament është i njohur edhe instituti i substitutit, me të cilin kuptojmë caktimin e përfaqësuesit të trashëgimtarit në rastet kur ai nuk mund ose nuk do të trashëgojë trashëgimlënësin.

Ruajtja e testamentit

Mënyra e ruajtjes nuk ka ndonjë rëndësi të natyrës së atillë sa i përket vlefshmërisë së testamentit. Me norma ligjore është rregulluar vetëm mënyra e dorëzimit dhe ruajtjes së testamentit gjyqësor. Testamentin mund ta ruajë vetë testatori, tek çdo person fizik apo juridik, por mund ta ruajë edhe në gjykatë. Shkenca juridike njehë tri mënyra të ruajtjes së testamentit, edhe atë:

- ruajtja e testamentit nga vetë testatori,
- ruajtja e testamentit nga personi i besuar dhe
- ruajtja e testamentit në institucione me depozitë (bankë , postë etj)

Legu

Testatori mund të vendos në testament një ose më shumë lege. Kjo nënkupton se testatori në testament mund të urdhërojë trashëgimtarin ose ndonjë person tjetër të cilit i ka lënë një pjesë të pasurisë së tij, t'ia jep personit të caktuar një shumë të hollash, ta liroj nga ndonjë borxhë, të përmbahet nga ndonjë veprim ose të fitoj diçka, apo të bëjë diçka për të⁴⁶.

Pjesa e domosdoshme

Instituti i pjesës së domosdoshme, është institut materialo juridik i të drejtës trashëgimore. Pjesa e domosdoshme pra është ajo pjesë e masës së pasurisë trashëgimore të trashëgimlënësit, e për të cilën pjesë trashëgimtar i domosdoshëm ka nevojë për plotësimin e nevojave të veta jetike, por që e kufizon vullnetin e trashëgimlënësit, në lidhje me disponimin e pasurisë së tij me rastin e vdekjes.

Trashëgimlënësi me rastin e disponimit të pasurisë së tij, mund të disponoi me pasurin e tij deri 1/2 pjesë, të masës së pasurisë trashëgimore, kur ka pasardhës të tij fëmijë dhe bashkëshort, ndërsa kur ai nuk ka si trashëgimtarë fëmijë dhe bashkëshort, ndërsa pas vetes ka vëllezër e motra, ai mund të disponoj deri në 2/3 e pjesë së pasurisë trashëgimore. Kjo është përcaktuar me dispozitën e nenit 31.2 të LT .

Trashëgimtarët e domosdoshëm

Si trashëgimtar të domosdoshëm mund të jenë vetëm rrethi i ngushtë i trashëgimtarëve të cilët për shkak të afërsisë së gjakut me trashëgimlënësin e gëzojnë mbrojtjen e veçantë ligjore. Që një trashëgimtarë të mund të realizoi të drejtën e tij në pjesën e domosdoshme është e nevojshme të ketë cilësinë e trashëgimtarit ligjor sipas dispozitave të Ligjit për trashëgimi.

Trashëgimtarët e domosdoshëm janë të ndarë në dy grupe dhe atë:

⁴⁶ Shih LTK, neni 93.

1. Pasardhësit e trashëgimlënësit, të adoptuarit e tij dhe pasardhësit e tyre, prindërit dhe bashkëshorti i tij (nenit 30.1 LTK).

Njësoi sikurse të radha e trashëgimisë edhe të trashëgimtarët e domosdoshëm të radhës së parë i përjashtojnë trashëgimtarët e domosdoshëm të radhës së dytë apo të tretë.

2. Grupin e dytë e përbejnë gjyshërit e trashëgimlënësit, motrat dhe vëllezërit (nenit 30.2 të LTK), por vetëm në qoftë se përmbushen dy kushte kumulative dhe atë :

- a) që trashëgimtari i domosdoshëm të jetë i pa aftë për punë, dhe
- b) të mos ketë mjetet për jetesë.

Llogaritja e pjesës së domosdoshme

Për llogaritjen e pjesës së domosdoshme është e nevojshme të bëhet vlerësimi i pasurisë trashëgimore të trashëgimlënësit. Kjo bëhet në disa faza sepse është e nevojshme të dihet dhe vlerësohet pjesa aktive, ashtu edhe pjesa pasive e pasurisë trashëgimore të trashëgimlënësit e të cilën pasuri e ka pasur në çastin e vdekjes.

Mënyrat e llogaritjes :

- Inventarizimi i pasurisë trashëgimore ,
- Rexhistrimi i kërkesave të trashëgimlënësit ndaj personave të tretë,
- Regjistrimi i disponimeve të trashëgimlënësit me kontratë apo me testamente dhe
- Regjistrimi i borxheve që trashëgimlënësi i ka ndaj personave të tretë.

Inventarizimi i pasurisë trashëgimore

Inventarizimi i pjesës trashëgimore, bëhet me qëllim të regjistrimit të pasurisë trashëgimore të trashëgimlënësit të cilën pasuri e ka pasur në çastin e vdekjes. Pra bëhet regjistrimi i sendeve të luajtshme, regjistrimi i sendeve të paluajtshme, regjistrimi i të hyrave nga të drejtat (të qirasë, kamatave, nga mjetet deponuara në banka, aksione, etj.). Gjatë regjistrimit do të kihet parasysh edhe çështja e veçimit të sendeve që kanë shërbyere në plotësimin e nevojave të përditshme siç janë orenditë, mobilet, apo sendet tjera personale e të cilat ju kanë shërbyer trashëgimtarëve me të cilët ka bashkëjetuar në një familje me trashëgimlënësin. Pas inventarizimit të sendeve dhe të hyrave nga të drejtat atëherë bëhet edhe vlerësimi i këtyre sendeve në mënyrë që të dihet se cila është vlera e këtyre sendeve të pa luajtshme dhe të luajtshme.

Regjistrimi i kërkesave të trashëgimlënësit ndaj personave të tretë apo trashëgimtarëve

Në regjistrimin e kërkesave të trashëgimlënësit merret parasysh, regjistrimi i kërkesave që trashëgimlënësi i ka ndaj personave të tretë, qoftë në sende, në të drejta, të holla apo në letra me

vlerë. Këtu merren parasysh kërkesat të cilat dihen, natyrisht këtu nuk merren parasysh kërkesat të cilat nuk mund të dihen dhe ato që nuk mund të realizohen. Pastaj është e nevojshme të regjistrohen edhe borxhet e trashëgimtarëve ndaj trashëgimlënësit.

Regjistrimi i disponimeve të trashëgimlënësit me kontratë apo me testament

Është e rëndësishme që të bëhet regjistrimi i disponimeve që trashëgimlënësi i ka bërë me kontrata të ndryshme në lidhje me pasurin e tij, si kontratave të dhurimit, kontratave të dy anshme apo të legeve, nëse është hartuar testamenti. Te kontratat e dhurimit është e rëndësishme të identifikohen se dhurimet a janë bërë për trashëgimtarët, apo personat e tjerë, mandej të bëhet edhe regjistrimi i dhurimeve që u ka bërë trashëgimtarëve, trashëgimlënësi e të cilët kanë hequr dorë nga trashëgimia, si dhe atyre dhurimeve për të cilat trashëgimlënësi ka urdhëruar që të mos i llogariten trashëgimtarit në pjesën e tij trashëgimore.

Regjistrimi i borxheve që trashëgimlënësi ua ka personave të tretë.

Gjithashtu te vlerësimi i pasurës trashëgimore është i rëndësishëm edhe regjistrimi i borxheve të trashëgimlënësit ndaj personave të tretë, apo ndaj trashëgimtarëve dhe kjo përmes identifikimit të personave që kanë kërkesa ndaj trashëgimlënësit. Është e rëndësishme që të theksohet se ka rëndësi edhe identifikimi i shpenzimeve të ceremonisë së varrimit, nëse vetëm njëri prej trashëgimtarëve i ka hequr këto shpenzime .

Pas vërtetimit të aktives dhe të pasives, bëhet përcaktimi i vlerës së pasurës trashëgimore, dhe pas vlerësimit të pjesës së pasurisë trashëgimore atëherë vijmë deri te identifikimi i pjesës së domosdoshme , qoftë për trashëgimtarët e domosdoshëm të grupit të parë , apo të grupit të dytë.

Pasuria që veçohet nga pasuria trashëgimore

Pjesa e veçuar e pasurisë trashëgimore është ajo pjesë, e cila ka ndikuar në rritjen e pasurisë trashëgimore në sajë, të kontributit të trashëgimtarëve me të cilët ka jetuar trashëgimlënësi. Pra pasardhësit e trashëgimlënësit të cilët kanë bashkëjetuar me të është e natyrshme që ata kanë dhënë kontributin e veçantë ose në ndonjë mënyrë tjetër duke e ndihmuar me punë trashëgimlënësin të kenë dhënë kontribut që vlera e pasurisë trashëgimore të jetë më e madhe. Vlera e pasurës trashëgimore e cila është shtuar me kontributin e pasardhësve nuk do të hyjë në pasurinë trashëgimore dhe kjo vlerë e pasurisë trashëgimore do të veçohet . Pra në rastin konkret kjo pjesë e pasurisë nuk do të llogaritet gjegjësisht nëse është llogaritur ajo do të zvogëlohet dhe nuk do të merret si pasuri trashëgimore e trashëgimlënësit që ka kontribuar në rritjen e vlerës. Afati për kërkimin e veçimit të pjesës së pasurisë trashëgimore është 5 vite, nga momenti gjegjësisht dita e hapjes së trashëgimisë⁴⁷ .

⁴⁷ Shih LTK, neni 36.

Veçimi i sendeve të shtëpisë

Veçimi i sendeve të shtëpisë, të cilat kanë shërbyer në plotësimin e nevojave të përditshme të bashkëshortit pasjetues dhe pasardhësve të trashëgimlënësit të cilët kanë bashkëjetuar me trashëgimlënësin nuk do të hyjnë në pasurin trashëgimore. Këto sende mund të jenë si : orenditë shtëpiake, mobilet, shporetet, frigoriferët, lavatriqa etj. Mirëpo në rast se këto sende kanë një vlerë të lartë, e të cilat janë blerë në kohën kur të gjithë trashëgimtarët kanë bashkëjetuar me trashëgimlënësin, atëherë edhe këto sende do të llogariten në pasurinë trashëgimore dhe në pjesën e domosdoshme.

Cenimi i pjesës së domosdoshme

Themi se ekziston cenimi i pjesës së domosdoshme atëherë kur trashëgimlënësi me rastin e shprehjes së vullnetit të tij të fundit, disponon me tërë pasurin trashëgimore me rastin e caktimit të trashëgimtarit të tij të afërm apo jo të afërm, apo me punë juridike të dhurimit apo të lënies legë të sendeve nga pasuria trashëgimore. Pra cenimi në pjesën e domosdoshme themi se ekziston atëherë kur vlera e disponimit me testament apo me punë juridike, kontratë të dhurimit, e tejkalon vlerën e paraparë me ligj që do t'i takonte trashëgimtarit të domosdoshëm.

Në rastet kur cenohet pjesa e domosdoshme, disponimi me testament do të zvogëlohet, kurse dhurimet do të kthehen në masën që nevojitet për plotësimin e pjesës së domosdoshme.

Radha e zvogëlimit dhe e kthimit

Kur shkaktohet cenimi i disponimit, atëherë disponimi me testament do të zvogëlohet dhe nëse me zvogëlim të disponimit plotësohet pjesa e domosdoshme atëherë nuk ka nevojë që të kërkohet kthimi i dhurimeve të bëra nga trashëgimlënësi Në këtë rast kthimi i dhurimeve do të kërkohet vetëm nëse me zvogëlimin e disponimeve me testament nuk do të mund të plotësohej pjesa e domosdoshme. Por nëse dhurimet e trashëgimlënësit të bëra kanë qenë sende, ndërsa si sende nuk mund të kthehen sepse ato në ndërkohë janë tjetërsuar apo ato janë konsumuar, atëherë do të veprohet, sipas dispozitave mbi kthimin sipas normave të pasurimit pa bazë siç e rregullojnë dispozitat e LMD-së.

E drejta e kërkesë për zvogëlimin e disponimeve me testament dhe kthimin e dhurimeve

Të drejtën për të paraqitur kërkesë (padi) për zvogëlimin e disponimit me testament dhe kthimin e dhurimeve, me të cilat është cenuar pjesa e domosdoshme, mund ta bëjnë vetëm trashëgimtarët e domosdoshmë. Kjo e drejtë nuk mund të cenohet nga kreditorët e trashëgimtarit të domosdoshëm (neni 45 LT).

Kërkesa për zvogëlimin e disponimeve me testament mund të ushtrohet brenda afatit prej tri viteve nga dita e shpalljes së testamentit dhe kthimi i dhurimeve , brenda afatit prej tri vitesh nga vdekja

e trashëgimlënësit, përkatësisht nga dita që ka marr formën e prerë vendimin për shpalljen e tij si të vdekur ose vendimi me të cilin konfirmohet vdekja.

Rasti kur disponimi me testament zvogëlohet për shkak të cënimit të pjesës së domosdoshme

C.nr.....

GJYKATA KOMUNALE NË PRISHTINË, me gjyqtarin _____ duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësit Sh. B, nga fshati Lubinjë e Ultë Komuna e Prizrenit, të cilin e përfaqëson B.A, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës M.B. H, nga Prishtina, të cilën e përfaqëson Zh.J, avokat nga Prishtina, për anulim testamenti, në seancën e datës 21.06.2012, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT kërkesëpadia e paditësit Sh.B, nga fshati Lubinjë e Ultë Komuna e Prizrenit, ANULOHET pjesërisht testamenti gjyqësor i testatorit-trashëgimlënës B.B, ish nga Prishtina, i përpiluar nga Gjykatën Komunale Prishtinë, me datë 11.02.1994, nën shenjen N.nr....., vetëm për ¼ e masës trashëgimore të lënë me testament.

II.REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit Sh.B, nga fshati Lubinjë e Ultë Komuna e Prizrenit, me të cilën kërkon që të anulohet testamenti përtej pjesë së anuluar si në pikën një të diapozitivit të këtij aktgjykim.

III. DETYROHET e paditura M.B.H, nga Prishtina, që paditësit ti njoh të drejtën e përshkruar në pikën një të diapozitivit të aktgjykimit në afat prej 15 ditësh nga marrja në dorëzim e aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të krijuara.

A r s y e t i m

Paditësi me padi, gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka kërkuar nga gjykata që të aprovoi padinë dhe ta shpall nule testamentin e përpiluar gjyqësor, nga testatori B. B, sepse urdhrat që dalin nga dispozita e testamentit janë në kundërshtim të plotë me dispozita ligjore, ato procedurale, me të cilat rregullohen çështja e përpilimit, ruajtjes dhe hapjes së testamentit si dhe me ato materiale me të cilat rregullohet përmbajtja e testamentit. Ka shtua së në seancën e mbajtur në Gjykatën Komuna e në Prishtinë, me datë 05.03.2007, në çështjen trashëgimore pas vdekjes së të ndjerit B.B, ish nga Prishtina, me rastin e shqyrtimit të pasurisë trashëgimore, sipas propozimit të ushtruar nga ana e të paditurës, përveç tjerave është konstatuar se testaori kishte përpiluar testament ligjor dhe atë sipas procesverbalit nga datë 11.12.2006 për shpalljen e testamentit, në gjykatë paralele në Nish Serbi, sipas të cilit e paditura shpallët trashëgimtare ndërsa paditësi përjashtohet nga trashëgimia.

Ka shtua se testamenti duhet të shpallët nule sepse së pari testamenti gjyqësor përpilohet në gjykatën kompetente, së dyti testamenti nuk ka guxuar të ruhet dhe të shpallët para gjykatës paralele se treti shpallja e testamenti nuk ka guxuar të bëhet vetëm në praninë e të autorizuarit të të paditurës, e gjithashtu edhe vet brendia e testamentit është në kundërshtim me dispozitat e të drejtës materiale.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar sipas tarifës së OAK-ës.

E paditura përmes të autorizuarit më përgjigje në padi, gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare e ka kundërshtua kërkesëpadinë duke i kërkuar gjykatës që të refuzoj të njëjtën si të pabazuar. Ka shtua së trashëgimlënësi B.B, ka qenë njëri shumë i ndershme dhe i njëjti ka shprehur dëshirën tij të fundit përmes testamentit dhe ka kërkuar që trashëgimtarët të respektojnë. Ka shtuar se e paditur ka marrë pjesë në ndertimin e shtëpisë, rrethanë kjo të cilën nuk ka dashur ta përmend, mirëpo nëse paditësi insiston në anulimin e testamenti atëherë e paditura do të jete e detyruar që me padi të kërkoj ndarjen e pasurisë sipas kontributit.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike sipas propozimit të palëve ka zhvilluar procedurën dhe ka administruar provat: procesverbalin T.nr....., i përpiluar në Gjykatën Komunale në Prishtinë, me dt.05.03.2007, aktvendimin T.nr....., i Gjykatës Komunale në Prishtinë, dt.05.03.2007, certifikatën numër 11, dt.27.06.2011, dëshminë mbi vdekjen e dt.20.07.2006, për B.B, procesverbalin-testamentin N.nr.../1994, i përpiluar në gjykatën Komunale Prishtinë, dt.11.02.1994 dhe certifikatën e pronës UL-----.

Nga provat e administruar gjykata gjeti së paraardhësi juridike i palëve ndërgjyqësore tani i ndjeri B.B, ish nga Prishtina, me dt.11.02.1994, pran gjykatës Komunale në Prishtinë, kishte përpiluar testament gjyqësor. Në bazë të provave të administruar gjykata ka gjetur së B. B ka vdekur me dt.25.10.2005, në Prishtinë.

Gjykata ka gjetur së pran gjykatës Komunale në Prishtinë e paditura M.B.H, me dt.16.05.2006, ka ushtruar propozim për shqyrtim të trashëgimisë pas vdekjes së të ndjerit B.B. Në seancë e datës 05.03.2007, të mbajtura në Gjykatën Komunale në Prishtinë, në procedurë të trashëgimisë gjykata ka konstatuar së për masën trashëgimore e cila duhej të shqyrtohej ekzistonte testamenti i hapur i cili kishte qenë në ruajtje pran Gjykatës komunalë në Prishtinë, nën shenjen N.nr.../94, të dt.11.02.1994, në zarf të kaltër dhe i vulosur në anën e prapme me tri vula dhe me mbishkrimin me makinë B.B. Gjykata ka konstatuar së në procesverbalin e mbajtur në Gjykatën Komunale në Prishtinë, me dt.11.02.1994, është përpiluar testamenti gjyqësor nga ana e testatorit. Gjykata ka konstatuar gjithashtu së në faqen e tretë të testamentit është përpiluar procesverbali i hapjes së testamentit pran Gjykatës komunale paralele në Nish.

Gjykata Komunale në Prishtinë, në procedurë të trashëgimisë e ka udhëzuar tani paditësin në kontest civile, sipas aktvendimit T.nr.158/2007, dt.05.03.2007.

Gjykata pasi konstatoi këtë gjendje faktike në kuptim të dispozitave ligjor nga Ligji për Trashëgimin i Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Sipas dispozitave nga neni 38.1 parashihet së kur cenohet pjesa e domosdoshme, disponimi me testament do të zvogëlohet. Sipas dispozitave nga neni 38.2 parashihet së pjesa e domosdoshme cenohet kur vlera e përgjithshme e disponimit me testament dhe e dhurimit tejkalon pjesën disponibile.

Me dispozitat e nenit 31.1 parashihet së trashëgimtarët e domosdoshëm kanë të drejtë në pasurinë trashëgimore me të cilën trashëgimlënësi nuk mund të disponojë dhe e cila quhet pjesë e domosdoshme.

Sipas dispozitës së nenit 31.2 parashihet së pjesa e domosdoshme e pasardhësve dhe bashkëshortit përbën një të dytën, ndërsa pjesa e domosdoshme e trashëgimtarëve të tjerë një të tretën e pjesës që do t'i takonte secilit si trashëgimtar ligjor në pajtim me dispozitat mbi radhët e trashëgimit.

Në rastin konkret gjykata ka vlerësuar së kërkesëpadia duhet të provohet pjesërisht pikërisht për faktin së me testament është cenuar pjesa e domosdoshme. Sipas dispozitave të cituar pjesa me të cilin nuk mundet trashëgimlënësi të disponojë është $\frac{1}{2}$ e as që do ti takonte secilit kur është fjala për trashëgimtarët e radhës së parë. Në rastin konkret $\frac{1}{2}$ e as që do ti takonte paditësi është $\frac{1}{4}$, prandaj edhe është anuluar testamenti në këtë masë.

Gjykata nuk ka gjetur rrethana që e bëjnë testamentin të nulueshem në kuptim të dispozitës së nenit 72.1. ku parashihet nuliteti i testamentit për shkak të paaftësisë së testatorit për të vepruar ose për shkak se testatori nuk ka pasur moshë madhore, si dhe nulimin e testamentit ose të disa dispozitave të tij për shkak të kanosjes ose shtrëngimit, mashtrimit ose lajthimit, mund ta kërkojë vetëm personi që ka interes juridik.

Në rastin konkret gjykata nuk ka gjetur së testamenti është përpiluar në ndikimin e këtyre shkaqeve që kishin me paraqit arsye për nulitetin absolut të testamenti.

Gjykata gjithashtu ka vlerësuar pretendimet e paditësit së testamenti është hapur në gjykatën jo kompetente dhe paralele. Edhe kjo gjykatë vlerëson së testamenti është hapur në gjykatën jo kompetente dhe paralele, rrethanë kjo që e bën të pavlefshëm hapjen e testamenti por jo testamentin, mirëpo testamenti është përpiluar pran gjykatës kompetente dhe nga gjykata kompetente paditësi është udhëzuar në kontest civil.

Vendimi që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta, gjykata e mbështet në dispozitën e nenit 450 dhe 452.2 dhe 463.1 të LPK-ës.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMUNALE NË PRISHTINË,
C.nr./07, dt.21.06.2012

Gjyqtari,

KËSHILLA JURIDIKE Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjti, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.

Rasti kur zvogëlohet disponimi me kontratën për dhuratën për shkak të cenimit të pjesës së domosdoshme.

C.nr.-----

GJYKATA THEMELORE NË _____, gjyqtari _____, në çështjen juridike kontestimore të paditësve _____, të gjithë nga _____, të cilët me autorizim i përfaqësojnë _____, kundër të paditurës _____, të cilën me autorizim e përfaqëson _____, për shkak të anulimit të kontratës mbi dhurimin, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me datën _____, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht kërkesëpadia e paditësve _____, **ANULOHET** kontrata mbi dhurimin Leg.nr._____, e datës _____, për paluajtshmërisë - ngastrës kadastrale nr.P----- ZK -----, e lidhur në mes të _____ - si dhuratëdhënës dhe _____ - si dhuratëmarrëse, dhe atë vetëm në pjesën me të cilën është cënuar pjesa e domosdoshme e paditësve, ndërsa në pjesën tjetër kontrata mbetet e pandryshuar (në fuqi), dhe **vërtetohet** se paditësit _____, janë bashkëpronarë me nga 1/12 pjesë ideale të ngastrës kadastrale nr.----- ZK -----, në sipërfaqe të përgjithshme prej 65 m2, si dhe detyrohet e paditura -----, që paditësve të ua pranojë këtë të drejtë, të gjitha brenda afatit prej 15 ditëve nga plotëfuqishmëria e aktgjykimit, e nën kërcënim përmbarimi.

III. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve përmes të cilës kanë kërkuar anulimin e tërësishëm të kontratës së dhurimit dhe që të vërtetohet se të njëjtit janë bashkëpronarë me nga

1/8 të pjesës ideale të paluajtshmërisë - ngastrës kadastrale nr.P----- ZK -----, si tërësisht e pa bazuar.

IV. DETYROHET e paditura që t'ia paguajnë shpenzimet procedurale paditësve në lartësi prej - -----€, në afat prej 15 ditësh pas ditës pas plotëfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

A r s y e t i m

Paditësit _____, të gjithë nga _____, të cilët me autorizim i përfaqëson av. _____, pranë kësaj gjykate kanë parashtruar padi kundër të paditurës _____ nga _____, përmes së cilës kanë theksuar se paditësit janë fëmijë të _____, i cili sipas kontratës dhurimit Leg.nr.-----, të datës -----, të vërtetuar pranë Gjykatës Komunale në _____ në mes të _____ si dhuratëdhënës dhe të paditurës _____ – si dhuratëmarrëse e cila është vajza e tij me gruan tjetër. Me këtë kontratë bëhet bartja e pronësisë me të cilën _____ bëhet pronare e ngastrës kadastrale nr.-----ZK -----. Paditësit kanë lindur nga prindërit _____ dhe e ëma _____, të cilët kanë lidhur martesë më _____, e cila martesë përmes aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut C.nr._____, të datës _____, është prishur, por që kujdesjen e fëmijëve i ka takuar babait. Në ndërkohë _____ ka lidhur martesë me një grua tjetër _____, ndërsa nëna e paditësve ka lidhur martesë me _____. Me lidhjen e kontratës së dhurimit _____ i ka përjashtuar nga e drejta e trashëgimisë dhe nga trashëgimia e domosdoshme paditësit dhe nuk ka pasur të drejtë të lidh këtë kontratë me të paditurën - vajzën e vet sepse edhe të paditurit si fëmijë tjerë kanë të drejtë në pasurinë e paluajtshme, andaj paditësit kanë parashtruar padi duke kërkuar nga gjykata që ta aprovojë kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Edhe përgjatë shqyrtimit kryesor, i autorizuari i paditësve ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke shtuar se paditësit janë trashëgimtar legjitim të ndjerit _____, i cili të paditurës ia ka dhuruar edhe pjesët e domosdoshme të paditësve. Dispozita e nenit 30 të LT të Kosovës flet për trashëgimtarët e domosdoshëm, sipas kësaj dispozite janë pasardhësit e trashëgimlënësit dhe trashëgimtarët tjerë të cilësuar në këtë dispozitë ligjore, ndërsa dispozita e nenit 31 të këtij ligji parasheh se trashëgimtarët e domosdoshëm kanë të drejtë në pasurinë trashëgimore me të cilën trashëgimlënësi nuk mund të disponoj e cila quhet pjesë e domosdoshme. Në fjalën e fundit i autorizuari i paditësve ka theksuar së qëndron në tërësi në të thënat në padi, precizim të padisë dhe në seancat paraprake, duke pretenduar që ka bazë të mjaftueshme për anulimin e kontratës që është objekt i kontestit. Anulimin e kontratës e ka kërkuar në tri baza juridike: e para me dhurimin e paluajtshmërisë janë cenuar të drejtat e trashëgimtarëve domosdoshëm të paraparë me nenin 30 dhe nenin 31 të LTK-ës. Baza e dytë e anulimit të kësaj kontrate është mungesa e aftësisë së veprimit dhe shprehjes së vullnetit e paraparë me nenin 97 të LMD-së, si dhe baza e tretë që shtëpia që ka qenë objekt i kontratës ka qenë pasuri e përbashkët e të gjithë familjes -----, duke i lënë në vlerësim gjykatës që të zgjedhë se në cilën bazë dëshiron që

të përcaktohet. Nga të gjitha të lartcekurat ka theksuar se ka bazë të mjaftueshme për anulimin e kësaj kontrate dhe aprovimin e padisë të paditësve, ashtu siç është kërkuar në petitumin e padisë, dhe precizimin e saj. Shpenzimet procedurale i ka kërkuar dhe atë për përfaqësime në seanca shumë prej 135.00€ për çdo seancë, për përpilimin e parashtresave shumë prej 150€. *(më gjërësisht si në fjalën përfundimtare të dhënë në seancën e datës -----, i cili gjindet në shkresat e lëndës).*

Përmes përgjigjes në padi i autorizuari i të paditurës e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësve, duke theksuar se kontrata anulimi i së cilës kërkohet është vërtetuar në mënyrë legjitime pranë Gjykatës Komunale në ----- dhe e njëjta është lidhur me pëlqimin dhe dëshirën e lirë dhe të plotë, pa ndonjë shantazh dhe presion. Më tej ka shtuar se _____ është njeri i papunë dhe jeton i vetëm në gjendje të vështirë ekonomike kështu që i ndihmon vajza e tij _____, ndërsa paditësit asnjëherë dhe sot nuk e shiqojnë dhe nuk janë kujdesur për babain e tyre edhe kur ka qenë i sëmurë, porr vetëm dëshirojnë që të përfitojnë diçka materiale, e paoshtu paditësi _____ dhe _____ me datën _____ në shtëpinë e paditësit e kanë sulmuar _____ dhe i kanë shkaktuar lëndime trupore. Andaj nga të lartcekurat i ka propozuar gjykatës refuzimin e kërkesëpadisë së paditësve si të pa bazuar.

Edhe përgjatë shqyrtimit kryesor, i autorizuari i të paditurës av. _____ nga Prizreni, ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësve, duke theksuar se sa i përket kërkesëpadisë së paditësve nuk është zhvilluar procedura trashëgimore asnjëherë. Sa i përket gjendjes psikike ose mendore të të ndjerit _____ nuk janë të vërteta të theksuarat e përfaqësuesve të paditësve që ai qenka i sëmurë në bazë neuropsiqike dhe i njëjti deri në momentin e vdekjes ka punuar në mënyrë aktive, ka qenë shitës - tregtare në pazarin e qyllhanit në Prizren dhe asnjëherë nuk ka treguar ndonjë mangësi ose sëmundje psikike. Sa i përket kujdesit të të ndjerit _____, gjersa ka qenë ai gjallë, këtu paditësit asnjëherë nuk janë kujdesur dhe nuk janë interesuar për jetën e tij, ndërsa për këtë është interesuar e bija e tij Miranda, e cila i ka dërguar mjete të holla nga Zvicra, në mënyrë speciale ka ardhur që të kujdeset për babain e tij, dhe shërimin e tij. Andaj prej momentit të bërjes së kontratës mbi dhurimin e kësaj pasurie, edhe përpara e paditura Miranda është kujdesur për babain e saj, dhe ka bërë - kryer të gjitha ceremonitë e varrimit të babait të vet, dhe të pagesës së shpenzimeve për këtë ceremoni. Andaj konsideroj se edhe pjesa e domosdoshme nga kjo pasuri e patundshme nuk ju takon paditësve fare, ndërsa në fjalën përfundimtare ka theksuar se pas nxjerrjes të gjitha provave në këto seanca kontestimore dhe të vlerësimit të kërkesëpadisë, në tërësi kundërshtojë dhe konsiderojë se e njëjta është e pa bazuar në provat të cilat i parashtruan ana paditëse. Sa i përket legjitimitet të drejtë të kontratës mbi dhurimin e pasurisë së patundshme të ndjerit _____ ndaj vajzës së tij _____, konsiderojë se kjo kontratë është legalizuar në gjykatë në mënyrë të drejtë ku vet i ndjeri _____ ka nënshkruar kontratën e theksuar. Andaj pretendimet e paditësve sa i përket gjendjes psikike të ndjerit _____ me ç' rast ka hartuar edhe kontratën mbi dhurimin e pasurisë së patundshme ndaj _____ janë të pa vërteta dhe duhet të refuzohen si kundërligjore. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë për tri seanca nga

135.00 euro dhe për dhënien e përgjigjes në padi shumë prej 100.00 euro, respektivisht shumë e përgjithshme prej 505.00 euro.

Gjykata në këtë çështje juridike - kontestimore me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, sipas propozimit të palëve, ka zhvilluar procedurën dhe ka administruar këto prova: Shkresat e lëndës -----; Shkresat e lëndës Ndr.nr.-----; Çertifikatën për njësinë katastrale ----- ZK -----, të lëshuar nga zyra komunale katastrale -----; Çertifikatën e martesës me numër rendor ----të lëshuar nga zyra e gjendjes civile ----, datë -----; Çertifikatat e lindjes për ----- të lëshuar nga zyra e gjendjes civile ----, datë -----; Raportin mjekësor të lëshuar nga ordianca -----, datë -----; Çertifikatën e vdekjes për -----, të lëshuara nga zyra e gjendjes civile në -----, datë -----; Kontratën për dhurimin e pasurisë së paluajtshme -----, të datës -----; Aktvdekjen për -----, të lëshuar nga Drejtoria e administratës në -----, datë -----; Deklaratën e dhënë nga ana e ----- pranë zyrës noteriale me nr.LRP 4903/13, të datës 19.09.2013; Fletë lëshimin e lëshuar nga Fakulteti i mjekësisë në Prishtinë, me nr.2533, të datës 29.10.2002; Vërtetimin të lëshuar nga zyra e gjendjes civile në -----, datës 20.02.2017; Është bërë dëgjimi i dëshmitarit ----- nga Peja dhe dëshmitares ----- nga Prizreni, si dhe është bërë dëgjimi në cilësi të palëve për paditësen --- -----, e vazhërisë -----dhe të paditurës -----.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartë cekura, në kuptimin e nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditësve duhet të aprovohet pjesërisht si e **bazuar**.

Me leximin e Shkresave të lëndës -----, gjykata ka konstatuar se e njëjta padi është ngritur nga këtu palët e njëjta ndërgjyqëse e cila është hedhur poshtë për shkak të gjyqvarësisë.

Nga leximi i Shkresave të lëndës Ndr.nr. -----, gjykata ka konstatuar se këtu paraadhësi i palëve ndërgjyqëse ka lënë testament në gjykatë në të cilën tërë paluajtshmërinë kontestuese ia ka lënë në trashëgim këtu të paditurës -----.

Nga leximi i Çertifikatës për njësinë katastrale ----- ZK -----, të lëshuar nga zyra komunale katastrale -----, gjykata ka konstatuar se e njëjta paluajtshmëri evidentohet në emër të ----- të paditurës.

Nga leximi i Çertifikatës së martesës me numër rendor ---- të lëshuar nga zyra e gjendjes civile - ----, datë -----, gjykata ka konstatuar se ----- ka qenë në martesë me ----- nga data ----- -deri më -----, kur me vendim të gjykatës kjo martesë është zgjidhur.

Nga leximi i Çertifikatave të lindjes për -----të lëshuar nga zyra e gjendjes civile -----, datë 02.02.2012, gjykata ka konstatuar faktin e lindjes për të lartcekurit.

Nga leximi i Raportit mjekësor të lëshuar nga ordianca Bronhomed -----, datë 14.05.2014, gjykata ka konstatuar se i njëjti është lëshuar nga institucioni i lartcekur për -----, ku si diagnozë ka qenë sëmundja pulmonare.

Nga leximi i Çertifikatës së vdekjes për -----, të lëshuar nga zyra e gjendjes civile në ----, datë 06.11.2014, gjykata ka konstatuar faktin e vdekjes për ----- – babai i palëve ndërgjyqëse.

Nga leximi i Kontratës për dhurimin e pasurisë së paluajtshme Leg.nr.-----, të datës 04.07.2011, gjykata ka konstatuar se me të njëjtën ----- ia dhuron ngastrën -----ZK ----- vajzës së tij ----- -- këtu të paditurës.

Nga leximi i Aktvdekjes për -----, të lëshuar nga Drejtoria e administratës në -----, datë 09.02.2017, gjykata ka konstatuar se këtu palët ndërgjyqëse janë trashëgimtarët e të ndjerit ----- ---.

Nga leximi i Deklaratës së dhënë nga ana e A.B pranë zyrës noteriale me nr.LRP 4903/13, të datës 19.09.2013, gjykata ka konstatuar se i ndjeri ka deklaruar se me të jetojnë edhe V. Z dhe Ser Zulfallari.

Nga leximi i Fletë lëshimit të lëshuar nga Fakulteti i mjekësisë në Prishtinë, me nr.2533, të datës 29.10.2002, gjykata ka konstatuar se paraardhësi i palëve ndërgjyqëse ka qëndruar i shtrirë në spital nga data 29.10.1992 deri më 12.11.1992.

Nga leximi i Vërtetimit të lëshuar nga zyra e gjendjes civile në -----, datës -----, gjykata ka konstatuar se Xh. R ka qenë e martuar me A.B nga data ----- deri më -----, kur është shkëputur dhe ka lidhur martesë tjetër me datën ----- me B.R.

Gjykata ka bërë dëgjimin e dëshmitarit M. G nga Peja, i cili ka theksuar se “ A ka qenë burri i nënës sime dhe me të njëjtin kam pasur marrëdhënie shumë të mira, pothuajse ka qenë si prindi im, e po ashtu edhe M kam dashur më shumë se motrat tjera. Mund të them se një kohë të gjatë kam jetuar në Çeki dhe nga viti 2007 jetoj në Pejë dhe pasi që profesioni im është kasap dhe vijë në treg në Rogovë të Hasit, pothuajse çdo javë kam ardhur që ta vizitoj A dhe nënën time pasi që këtë e kam ndjerë si obligim dhe pas vdekjes së nënës kam pasur kontakt me A. Gjendja fizike e A ka qenë shumë e mire deri pak kohë para vdekjes kur ka pësuar një djegie të shtëpisë së tij dhe prej atij rasti ka pasur probleme me shëndet-kallje të mushkërive, ndërsa gjendja psikike e tij mund të them se ka qenë më i shëndoshë dhe më i aftë se personat tjerë pasi që shpesh kam udhëtuar me të në Prishtinë kur merrte material të ndryshëm të cilin e tregonte. M ka ardhur shumë shpesh dhe është kujdesur për nënën dhe babain e saj A.B. A ka punuar vazhdimisht dhe kur kam ardhur fillimisht kam shkuar në treg që ta kontaktoj, përafërsisht ka punuar dy- tre muaj para vdekjes. Para ardhjes time kam dëgjuar se aty ka jetuar një bullgare, ndërsa pas ardhjes sime nga Çekia në vitin 2007 A.B ka jetuar vetëm me nënën time A. B. Për herë të fundit e kam parë atë ditë kur ka vdekur pasi që kam qenë në momentin kur ka dhënë shpirt gjendja shëndetësore e nënës time nuk ka qenë shumë e mirë por as shumë e rëndë e njëjta ka vuajtur nga sëmundja e sheqerit. Me sa kam njohuri dhe sa herë kam shkuar unë ata janë kujdesur për vete dhe kurrë nuk kam takuar askënd

aty ndërsa kur ka qenë gjendja më e rëndë e tyre ka ardhur nga Zvicra M dhe është kujdesur për ta. A jo që ka pasur problem me dëgjim por mund të them se ka qenë shurdh, me fry marrje mund të them se nuk ka pasur fare problem, por vetëm pas djegies së shtëpisë, ndërsa sëmundje psikike kur nuk ka pasur problem pasi që edhe mua më ka dhënë këshilla kur kam qenë i nervozuar dhe në depresion, nuk kam njohuri pse është larguar nga puna dhe për këtë kur nuk kemi biseduar pasi që në atë kohë fare nuk kam qenë në Kosovë. Nuk e di saktësisht sa herë ka ardhur M në Prizren, por e njëjta ka ardhur shumë shpesh dhe nuk kam njohuri se A a ka qenë te psikiatri”.

Gjykata ka bërë dëgjimin e dëshmitares V. Z nga Prizreni, e cila ka theksuar se “E kam njohur A qe 15 vite dhe më shumë se 10 vite kam qëndruar tek ai, ndërsa kur ka ardhur vajza e tij M në Prizren, A dhe bashkëshortja e tij më dërgonin në një vend tjetër që të mos kem probleme me vajzën e tyre. Unë jam kujdesur për A dhe A. Bashkëshortja e vet ka ushtruar dhunë fizike te A që të shkruan shtëpinë në emër të vajzës. Unë nuk e kam parë vetëm që më ka treguar A, se i ka dhënë vajzës së vet 500€, a ajo ia ka dhënë vjehrrit të saj për të shkuar në haxh. A ka pasur probleme mendore pasi që ka pasur një lëndim duke punuar në treg, është rrëzuar dhe ka lënduar kokën dhe kur shkonin në Prishtinë për të blerë material i kishte të hollat por nuk e dinte. B ka pasur sjellje të mira, po ashtu pas djegies të shtëpisë dhe meremetimit të saj kam parë M dhe B duke gëlqerosur se bashku. Po thuajse deri në vdekjen e A kam qëndruar me të kur një javë para vdekjes A më ka thënë që të dal nga shtëpia që të thirr vajzën e vet M. Me A kam bashkëjetuar”.

Gjykata ka bërë dëgjimin në cilësi të palës për të paditurën M.B nga Prizreni, e cila ka theksuar se “Unë me babain tim dhe nënën time kam pasur raporte shumë të mira dhe mund të them se për mua kanë qenë shokë e shoqe dhe për ta jam kujdesur unë vazhdimisht edhe pas martesës sime. Qe 20 vite jetoj në Zvicër dhe fillimisht pas martesës të njëjtit nuk kanë pas nevojë të mëdha për kujdesej pasi që kanë pasur kushte të mira materiale, mirëpo pas luftës për shkak se disa herë i është thyer shtëpia dhe është vjedhur të njëjtit vazhdimisht ia kam dërguar nga një pagë mujore edhe pse kam qenë duke jetuar si azilant. Nuk është e vërtetë se babai im ka pas probleme psikike siç e quajnë këtu shizofren, të gjitha punët i ka bë me vet dëshirë dhe nuk është e vërtetë se unë ndonjë herë e kam mal tretuar dhe pasurinë – shtëpinë të cilën ma ka dhuruar babai më ka dhuruar me dëshirë duke më thënë se kemi vendosur me nënën që këtë shtëpi ta dhurojmë ty pasi që ne nuk kemi askënd tjetër dhe ti vazhdimisht kujdesesh për neve, e po ashtu me vet dëshirë në vitin 2009, ka bërë testament të cilën e ka dorëzuar në gjykatë. Babai im ka vdekur me dt.02.11.2014, dhe të njëjtin e kam ndihmuar vazhdimisht me të holla. Kur ka vdekur babai kam qenë aty dhe 2 muajt e fundit kam qëndruar në Kosovë te babai dhe jam kujdesur për shpenzimet e varrimit dhe gjithë ceremonisë fetare, ndërsa në momentin e varrimit nuk kanë qenë prezentë B, L dhe motrat e tyre dhe të njëjtit nuk i kam njoftuar pasi që B dhe të gjithë kanë ditur për sëmundjen e babait dhe B jeton në Prizren dhe bashkëshorten e ka në atë lagje dhe i njëjti ka qenë në dijeni për këtë. Sa e di unë babai im ka qenë te psikiatri vetëm për rastin e përpilimit të testamentit i cili është në gjykatë”.

Gjykata ka bërë dëgjimin në cilësi të palës për të paditësen A. R, e lindur Berisha e cila ka theksuar se “Marrëdhëniet e mia kanë qenë shumë të mira pasi që më ka dashtë si djalë dhe kur ka qenë

vetëm me mua ka bisedua lirshëm, dhe unë besojë që këtë kontratë nuk e ka bërë me dëshirën e tij, por e ka bërë në mënyrë të dhunshme. Unë kam dertuar shtëpinë, kam dërguar të hollat pasi që jam në Zvicër qe 30 vite dhe shtëpia është ndërtuar para 25 viteve dhe tjetër kush ka kontribuu nuk e di. Kohën e fundit nuk kam qenë në shtëpi dhe kam dëgjuar se ka qenë vëllai dhe motra dhe kanë pasur probleme pasi që kanë njoftuar policinë. Herën e fundit kur e kam takuar A nuk e di saktësisht por me të kam biseduar kur kam ardhur në pushim kam shkua në treg dhe ndonjëherë kemi shkua në restorant, me të cilin kemi biseduar normalisht vetëm se i njëjti nuk ka dëgjuar mirë”.

Në nenin 51 par.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), i cili ka qenë në fuqi në kohën e lidhjes së kontratës në mënyrë decidive është paraparë se *“Secili detyrim duhet të ketë bazën e lejueshme”*, ndërsa në par.2 të këtij neni ceket se *“Baza është e palejueshme po që se është në kundërshtim me parimet e rregullimit shoqëror, pëcaktuar me kushtetutë me dispozitat e dhunshme dhe rregullat e moralit...”*. poashtu në nenin 111 të këtij ligji parashihet se *“kontrata është e rrëzueshme kur e ka lidhur pala me zotësi të kufizuar për të vepruar, kur gjatë lidhjes së saj ka pasur të meta në pikëpamje të vullnetit të palëve, si dhe kur kjo gjë është e caktuar me këtë ligj ose dispozitë të veçantë”*. Ndërsa me nenin 117 të po këtij ligji parashihet se *“e drejta për të kërkuar anulimin e rrëzueshmërisë së kontratës pushon me skadimin e afatit prej një viti nga data kur të jetë ditur shkaku i rrëzueshmërisë, respektivisht pushimit të dhunës. Kjo e drejtë në çdo rast pushon me skadimin e afatit prej 3 vitesh nga data e lidhjes së kontratës”*.

Në nenin 30 par.1 të Ligjit për Trashëgiminë, i datës 28.07.2014 parashihet se *“Trashëgimtarët e domosdoshëm janë: pasardhësit e trashëgimlënësit, të adoptuarit e tij dhe pasardhësit e tyre, prindërit dhe bashkëshorti i tij”*. Poashtu në nenin 31 par.1 të të njëjtit ligj parashihet se *“Trashëgimtarët e domosdoshëm kanë të drejtë në pasurinë trashëgimore me të cilën trashëgimlënësi nuk mund të disponojë dhe e cila quhet pjeës e domosdoshme”*. Ndërsa në par.2 të këtij neni parashihet se *“Pjesa e domosdoshme e pasardhësve dhe bashkëshortit përbën një të dytën, ndërsa pjesa e domosdoshme trashëgimlënësve të tjerë një të tretën e pjesës e cila do ti takonte secilit si trashëgimtar ligjor në pajtim me dispozitat mbi radhët e trashëgimit”*. Me nenin 38 par.1 të këtij ligji ceket se *“Kur cënohet pjesa e domosdoshme, disponimi me testament do të zvogëlohet, kurse dhurimi do të kthehet në masën që nevojitet të plotësohet pjesa e domosdoshme”*. Në par.2 të këtij neni ceket se *“Pjesa e domosdoshme cenohet kur vlera e përgjithshme e disponimit me testament dhe e dhurimit tejkalon pjesën disponibile.....”*.

Ligji Nr. 03/L-154 mbi Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore (LPDS, i cili ligj ka hyrë në fuqi me datë 20.08.2009), më saktësisht kapitulli III, që ka të bëjë me fitimin dhe humbjen e të drejtës së pronësisë parasheh mënyrat dhe kushtet ligjore që duhet të plotësohen për të kaluar pronësia mbi një send të paluajtshëm nga një pronar tek tjetri. Në këtë drejtim neni 34 parag.1 i këtij ligji shprehimisht thotë *“Për bartjen e pronësisë në paluajtshëmëri është e nevojshme një punë juridike e vlefshme ndërmjet tjetërsuesit dhe fituesit si bazë juridike dhe regjistrimi i ndryshimit i pronësisë në Regjistrin e të drejtave në paluajtshëmëri”*, ndërsa parag.2 i po këtij neni thotë: *“Kontrata për bartjen e paluajtshëmërisë të lidhet me shkrim në prezencë të dy palëve në një zyrë kompetente”*.

Ndërsa neni 18 parag. 1 i po këtij ligji përcakton se *“Pronësia është e drejta e tërësishme në një send. Pronari mund të disponojë me sendin sipas dëshirës së tij, veçanërisht atë ta posedojë dhe ta përdorë, me atë të disponojë dhe të tjerët t'i përjashtojë nga çfarë do ndikimi, nëse nuk kundërshtohet nga ligji ose nga të drejtat e një të treti.....”*.

Çështja kryesore në këtë lëndë është anulimi i kontratës mbi dhurimin dhe nëse paditësve ju takon e drejta e pronësisë si bashkëpronarë në pjesë ideale të paluajtshmërisë kontestuese, e cila në regjistrin kadastral evidentohen në emër të të paditurës M. B.

Pas analizimit dhe vlerësimit të provave të cilat i kemi cekur më lartë, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar pjesërisht në ligj dhe fakte.

Gjykata vlerëson se në bazë të kontratës mbi dhurimin, të legalizuar nga ana e Gjykatës Komunale në Leg.nr....., të datës -----, ku është vërtetuar se e njëjta është lidhur në mes të A.B - si dhuratëdhënës dhe M.B - si dhuratëmarrëse, ku si lëndë e kësaj kontrate kanë qenë paluajtshmëria - ngastra kadastrale ZK P, dhe pas legalizimit të kontratës, ngastra e lartcekur është regjistruar në emër të këtu të paditurës M. B (*pra, e njëjta kontratë është realizuar në tërësi*). Paditësit kanë pretenduar në padi se me lidhjen e kontratës së lartcekur është shkelur pjesa e domosdoshme e tyre, pasi që të njëjtit janë trashëgimtarë ligjorë të dhuratëdhënësit, përkatsisht fëmijët e A. B, i cili përpos pasurisë së tjetërsuar me kontratën anulimi i së cilës kërkohet nuk ka lënë trashëgimi tjetër. Nga provat e dëshmizuara gjykata ka vërtetuar se këtu palët ndërgjyqëse janë trashëgimtarë ligjor të të ndjerit A. B, respektivisht paditësit janë fëmijët e tij nga martesja e parë me Xh. B, e cila martesë është zgjidhur përmes vendimit të gjykatës, së datës -----, ndërsa e paditura M. B është e bija e tij, nga martesja e dytë me A. H. Me kontratën e dhurimit anulimi i së cilës kërkohet paradhësi i palëve ndërgjyqëse A.B, ia ka dhuruar ngastrën kadastrale ----- ZK P vajzës së tij M. B - këtu të paditurës. Përveç pasurisë të cilën e ka tjetërsuar me këtë kontratë i ndjeri nuk ka lënë pasuri tjetër. Andaj, gjykatës i rezultoi se pretendimi i paditësve për të anuluar kontratën mbi dhurimin dhe për të fituar të drejtën e pronësinë në një pjesë të ngastrës kadastrale kontestuese, është pjesërisht i bazuar dhe në përputhje me dispozitat ligjore të cilat i kemi përmendur më lartë dhe në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar në këtë procedurë, del se me lidhjen e kontratës së tillë është cënuar pjesa e domosdoshme e trashëgimtarve ligjor (pasardhësve të trashëgimlënësit), e paraparë sipas dispozitave të 38 par.1 të Ligjit për Trashëgiminë, kui ceket se *“Kur çënohet pjesa e domosdoshme, disponimi me testament do të zvogëlohet, **kurse dhurimi do të kthehet në masën që nevojitet të plotësohet pjesa e domosdoshme**”, dhe ky fakt ka qenë me rëndësi sipas vlerësimit të gjykatës, andaj këtyre provave gjykata ia dha besimin dhe vendosi si në dispozitivin nën **I** të aktgjykimit.*

Përveç të lartcekurave dhe duke marr parasysh të gjitha pretendimet e palëve ndërgjyqëse dhe provat e dëshmizuara në lidhje me këtë çështje kontestimore, gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar edhe për faktin se siç edhe u cek më lartë, të njëjtit përveç që hyjnë në radhën e trashëgimtarve të domosdoshëm, me asnjë provë nuk është vërtetuar se të

njëjtë të jenë përjashtuar nga trashëgimia për ndonjë shkak të paraparë sipas dispozitave ligjore në fuqi të Ligjit për Trashëgiminë (neni 114, 115, 116, 1117 dhe 118) apo për shkak të padenjesisë apo ndonjë shkak tjetër i cili i bënë të padenjës për të trashëguar (neni 110, 111, 112 dhe 113).

Sa i përket pjesës refuzuese të kërkesëpadisë gjykata vendosi pasi nga provat e administruara ka konstatuar se kontrata duhet të anulohet vetëm pjesërisht, që do të thotë vetëm sa i përket cënimit të pjesës së domosdoshme të trashëgimtarëve të domosdoshëm (këtu paditësve), e poashtu paditësit si trashëgimtarë të domosdoshëm në rastin konkret trashëgojnë $\frac{1}{2}$ e pjesës e cila do ti takonte si trashëgimtarë ligjor, e të njëjtë si pasardhës të dhuratëdhënësit ligjërisht do të trashëgonin me nga $\frac{1}{6}$ së bashku me këtu të paditurën, e që pjesa e domosdoshme e tyre përbën pjesën prej $\frac{1}{12}$, ndërsa për pjesën tjetër kontrata mbetet në fuqi. Poashtu gjykata e anuloi kontratën duke mos marrë për bazë testamentin e lënë nga ana e parardhësit të palëve ndërgjyqëse (edhe pse është administruar si provë), pasi që e njëjta paluajtshmëri ka kaluar në emër të këtu të paditurës në bazë të kësaj kontrate dhe e njëjta ka qenë objekt i kërkesëpadisë, pasi që me vendosje lidhur me testamentin do të tejkalohet edhe kërkesëpadia, andaj dhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Përfundimisht, në bazë të të lartcekurave gjykata është e mendimit se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e bazuar, respektivisht se ka kushte ligjore për anulimin e pjesërishtëm të kontratës së dhurimit, e rrjedhimisht edhe për fitimin e të drejtës së pronësisë, në pjesët të cilat janë cekur në dispozitiv, ndërsa për pjesën tjetër të kërkesëpadisë e njëjta është e pabazë, andaj dhe për këtë pjesë kërkesëpadia u desht që të refuzohet si e pabazuar.

Nga arsyet e cekura si dhe të dhënat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, kjo gjykatë gjeti se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e bazuar.

Gjykata i ka vlerësuar deklaratimet dhe provat tjera materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, por erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen meritore të kësaj çështje juridike kontestimore.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform 449 lidhur me nenin 452.4 të LPK-së, pasi që pala paditëse pjesërisht ka pasur sukses në procesin gjyqësor, andaj dhe i janë njohur shpenzimet për përgjigje në padi shumë prej 104.00 euro, dhe për 4 seanca të mbajtura nga 135.00, dhe për taksë gjyqësore shuma prej 15.00 euro, respektivisht shuma e përgjithshme prej 659.00 euro, pasi që këto kanë qenë shpenzime të domosdoshme dhe proporcionale me suksesin e arritur në procedurë.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në diapozitiv të këtij aktvendimi, e duke u bazuar në nenin 143.1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NE -----

C.nr.-----, datë -----

Gjyqtari

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite, pas ditës së pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.

Zvogëlimi i legut të privilegjuar

Kur trashëgimlënësi ka lenë me testament disa legë dhe ka urdhëruar që ndonjë legë të paguhet para legave të tjerë, ky legë do të zvogëlohet vetëm nëse vlera e legeve të tjera nuk mjafton për tu plotësuar pjesa e domosdoshme. Pra pjesa e domosdoshme plotësohet edhe me sendet apo të drejtat e lëna në legë me testament në atë vlerë sa plotësohet pjesa e domosdoshme e trashëgimtarit të domosdoshëm. Parimisht për plotësimin e pjesës së domosdoshme legu i privilegjuar nuk do të zvogëlohej, nëse me zvogëlimin e legeve të tjera do të plotësohej pjesa e domosdoshme e trashëgimtarëve të domosdoshëm. Pra vetëm përjashtimisht legu i privilegjuar do të zvogëlohej nëse nuk plotësohet pjesa e domosdoshme me lege tjera.

Zvogëlimi proporcional i legeve

Trashëgimtari i caktuar me testament, pjesa trashëgimore e të cilit duhet zvogëlohet, për tu plotësuar pjesa e domosdoshme, mund të kërkojë zvogëlimin proporcional të legeve që ai duhet ti paguajë po që se nga përmbajtja e testamentit nuk kuptohet diçka tjetër. Pra në rastin konkret kur trashëgimtarit të caktuar me testament të trashëgimlënësit, pjesa e të cilit është e nevojshme të zvogëlohet për ta plotësuar pjesa e domosdoshme të trashëgimtarit të domosdoshëm, ka të drejtë të kërkojë në mënyrë proporcionale të zvogëlohen leget që ai duhet ti paguaj personit tjetër. Kjo situatë do të vlen dhe zbatohet edhe për legatarin të cilin trashëgimtari e ka urdhëruar të paguaj diçka nga legu i vet. Atë që mund të kërkojë të zvogëlohet nga pagesa e legut kjo është për aq sa legu zvogëlohet, vlera e cila do të plotësojë pjesën e domosdoshme.

Llogaritja e dhurimeve dhe legëve në pjesën trashëgimore

Çdo trashëgimtari ligjor i llogaritet në pjesën trashëgimore çdo gjë që ka marrë dhurim nga trashëgimlënësi nga çfarëdo mënyre⁴⁸. Përjashtimet janë të përcaktuara në nenin 47.2, sipas të cilës dhurimet nuk llogariten nëse trashëgimlënësi shprehimisht është deklaruar në kohën e dhurimit, më vonë apo edhe me testament se dhurimet nuk do të llogariten në pjesën trashëgimore ose nga rrethanat mund të konkludohet se ky ka qenë vullneti i trashëgimlënësit.

⁴⁸ Shih LTK, neni 47.1.

Dhurimet rëndom nuk llogariten në pjesën trashëgimore, mirëpo duhet precizuar se cilat janë ato përkatësisht dhurimet e rëndomta janë ato që tradicionalisht dhurohen në raste të caktuara dhe vlera e tyre është e ulët, si p.sh. dhuratat e dhëna për festa dhe për përgëzime të tjera.

Si bëhet llogaritja e dhuratave dhe legeve në pjesën trashëgimore

Llogaritja e dhuratave dhe legeve bëhet në atë mënyrë që trashëgimtarët e tjerë marrin nga pasuria trashëgimore vlerën përkatëse dhe pastaj ajo që mbetet nga pasuria trashëgimore ndahet në mes trashëgimtarëve. Përndryshe, legu që është lënë trashëgimtarit ligjor llogaritet në pjesën trashëgimore të tij, përveç nëse nga testamenti del se trashëgimlënësi ka dashur që trashëgimtari të merr legun për pos pjesës së tij trashëgimore.

Rastet nga praktika gjyqësore lidhur me cenimin e të drejtës në trashëgimi

Në praktikën gjyqësore rastet që paraqiten për mbrojtje gjyqësore kanë të bëjnë me situata kur në procedurën e shqyrtimit të trashëgimisë ndonjëri prej trashëgimtarëve nuk është paraqitur-deklaruar (*është fshehur*), pastaj rastet e cedimit faktik të pasurisë për së gjalli pa u plotësuar kushtet ligjore për cedim për së gjalli dhe rastet cënimit të pjesës së domosdoshme përmes testamentit, dhuratës dhe kontratës mbi mbajtjen e përjetshme jo me qëllimet për të cilat parashihet kontrata mbi mbajtjen e përjetshme por me qëllim të pamundimit të ndonjërit prej trashëgimtarëve për të trashëguar.

Situata e parë kur ndonjëri nga trashëgimtarët nuk është deklaruar (është fshehur)- si mundsi ekziston sepse zakonisht ndonjëri prej trashëgimtarëve ligjor në procedurën e përgaditjes së dokumentacionit për shqyrtimin e trashëgimisë me rastin e nxjerrjes së aktit të vdekjes nuk e deklaron ekzistimin e ndonjërit apo të disa trashëgimtarëve. Në këtë mënyrë në aktin e vdekjes nuk shënohen të gjithë trashëgimtarët ligjorë. Në procedurën e shqyrtimit të trashëgimisë gjykata procedurën e shqyrtimit e zhvillon pa bërë hulumtim sipas detyrës zyrtare por mbështet ekskluzivisht në dokumentacionin të cilin e kanë lëshuar organet përkatëse. Në këtë rast dokument bazë është akti i vdekjes dhe sipas të njëjtës në procedurën e shqyrtimit të trashëgimisë për tu deklaruar ftohen vetëm personat që janë të shënuar në të. Në këtë mënyrë trashëgimtari i cili nuk është i shënuar në aktin e vdekjes nuk mund të bëhet pjesë e procedurës dhe rrjedhimisht nuk shpallet si njëri prej trashëgimtarëve.

Në momentin kur trashëgimtari i cili nuk është përfshirë në procedurën e shqyrtimit të trashëgimisë ka të drejtë të kërkojë mbrojtje gjyqësore pranë gjykatës kompetente. Në këtë rast nuk kërkohet anulimi i aktvendimit të gjykatës me të cilin është vendosur për trashëgiminë por kërkohet me padi e drejta sipas pas bazës së trashëgimisë në masën që trashëgimtari ka të drejtë si trashëgimtar ligjor. Nuk kërkohet anulimi i aktvendimit për trashëgimin sepse ai është vendim i natyrës deklarative që shërben për regjistrimin e të drejtës sipas trashëgimisë por nuk përbën akt me të cilin kërkesa e trashëgimtarit të pa përfshirë do të konsiderohej e gjykuar.

Këto situata janë nga ana e gjykatave duhet të trajtohen me kujdes të duhur edhe në fazën e sigurimit të kërkesëpadisë sepse rëndom në këto raste në gjykatë parashtrohet edhe kërkesa për sigurimin e kërkesëpadisë. Natyrisht këtu duhet aprovuar kërkesa për sigurimin e kërkesëpadisë dhe rrjedhimisht edhe kërkesëpadia.

Situata e dytë është kur cedimi i pasurisë për së gjalli ka ndodhur në mënyrë faktike por pa u përfshirë të gjithë trashëgimtarët ligjorë- Kjo situatë në vendin tonë për shkak edhe të ndikimit zakonor është e shpeshtë dhe në këtë mënyrë cenohet në mënyrë me të rëndë e drejta në trashëgimisë sepse një pjesë e trashëgimtarëve zakonisht femrat nuk përfshihen në këtë ndarje të pasurisë e cili në fakt në të ardhmen pas vdekjes se trashëgimlënësit do të përbënte masën trashëgimore. Kjo mënyrë e ndarjes faktike të pasurisë së trashëgimlënësit bëhet për së gjalli të trashëgimlënësit por pa ndjekur procedurën ligjore. Zakonisht në praktik trashëgimlënësi iu ndanë secilit prej trashëgimtarëve (zakonisht meshkujve) nga një pjesë të pasurisë së tij duke përjashtuar kështu një pjesë tjetër të trashëgimtarëve. Kjo është një prej mënyrave të vrazhda të cenimit të së drejtës në trashëgimi sepse në shumicën e rasteve trashëgimtarët pas vdekjes së trashëgimlënësit për shkak të kohëzgjatjes së madhe që ka ndodh nga ndarja faktike e deri të vdekja e trashëgimlënësit dekurajohen për ta kërkuar të drejtën e tyre. Madje në shumicën e rasteve heqin dorë në procedurën e shqyrtimit të trashëgimisë në favor të trashëgimtarëve që kanë përfituar nga ndarja faktike.

Natyrisht këto raste duhet të trajtohen me kujdes nga ana e gjykatave dhe të zbatohet me korrektësi LTK në kontekstin e cenimit të pjesës së domosdoshme dhe rrjedhimisht ofrimit të mbrojtjes gjyqësore adekuate.

Situata e tretë është zakonisht kur cenohet pjesa e domosdoshme me testament apo dhuratë- Edhe kjo mënyrë e cenimit të pjesës së domosdoshëm është një prej mënyrave që është prezent në praktikën tonë gjyqësore e cila duhet të trajtohet nga ana e gjykatave me seriozitetin e duhur. Në këtë pikë nuk po zgjerohemi më shumë sepse kjo formë e cenimit të pjesës së domosdoshëm është trajtuar mjaft gjerësisht në këtë punim.

Situata e katërt ka të bëjë me rastet kur është lidhur kontrata mbi mbajtjen e përjetshme jo për qëllimet për të cilat lidhet kontrata e përjetshme- Kontrata mbi mbajtjen e përjetshme është një prej mundësive ligjore që personat të cilit nuk mundën të kujdesen vete për veten e tyre apo kur këtë kujdes nuk e marrin nga familje të lidhin kontratë mbi mbajtjen e përjetshme me ndonjë anëtarë të familjes apo edhe me ndonjë person jashtë familjes. Zakonisht me këtë kontratë përfshihet e tërë pasuria e marrësit të mbajtjes e cila pas vdekjes së tij do ta përbënte masën trashëgimore por që në rastin e lidhjes së kontratës për mbajtjen e përjetshme ajo pasuri kalon në dhënësin e mbajtjes duke u pamundësuar kështu trashëgimtarëve potencial ligjor të drejtën në trashëgimi nëse e tërë pasuria është përfshirë me kontratë.

Për qëllime të këtij punimi diskutimi duhet të kufizohet vetëm në rastet kur qëllimi i kontratës mbi mbajtjen e përjetshme nuk është mbajtja por përjashtimi i trashëgimtarëve të caktuar nga trashëgimia. Veçanërisht kjo vjen në shprehje në raste kur kjo kontratë lidhet me ndonjërin prej

anëtarëve të familjes i cili po ashtu është trashëgimtarë ligjor. Kjo natyrë e kontesteve është mjaftë komplekse dhe gjykatat duhet të kujdesën dhe të kenë në vëmendje që në disa raste lidhja e kontratës mbi mbajtjen e përjetshme bëhet edhe për qëllim të trashëgimisë.

Padenjësia për të trashëguar

Padenjësia për të trashëguar është institucion juridik trashëgimor me paraqitjen e të cilit një person (ex lege) humb autorizimit juridike të trashëgimtarit. Mirëpo, në kuptim të dispozitës së nenit 110.2 të LTK, padenjësia nuk i pengon pasardhësit të personit të padenjë të trashëgojnë sikurse personi i padenjë të kishte vdekur para trashëgimlënësit.

Sipas nenit 111 të LTK i padenjë për të trashëguar është ai person që:

- Me dashje e ka vrarë, apo ka tentuar ta vrasë trashëgimlënësin, bashkëshortin, fëmijët apo prindërit e tij⁴⁹;
- Ndaj trashëgimlënësit ka bërë kallzim apo dëshmi të rreme për kryerjen e veprës penale, për të cilën parashihet dënimi me heqje lirie⁵⁰;
- Që me mashtrim, kanosje, apo dhunë e ka shtyrë trashëgimlënësin të bëjë, ndryshojë, ose të fuqizoj testamentin ose e ka përpiluar vetë një të rremë, ose e ka përdorur atë për interesat e tij apo të të tjerëve⁵¹;
- Që është sjellë ndaj trashëgimlënësit në mënyrë poshtëruese dhe keqtrajtuese⁵²;
- Që nuk e ka përmbushur detyrimin për ta mbajtur apo për ta ndihmuar trashëgimlënësin⁵³.

Vlerësimi i padenjësisë

⁴⁹ Në rastet kur me dashje e ka vrarë, apo ka tentuar ta vrasë trashëgimlënësin, bashkëshortin, fëmijët apo prindërit e tij, jep të kuptohet se këto veprime përfaqëson sjelljen më të rëndë të mundshme të trashëgimtarit të mundshëm ndaj trashëgimlënësit apo anëtarëve tjerë ashtu siç përcaktohet në dispozitë ligjore. Duke qenë se këtu bëhet fjalë për veprime që konsumojnë elemente e veprës penale na rezultojnë se personi i padenjë do të jetë a' i person që është dënuar për vepër penale.

⁵⁰ Është i padenjë për të trashëguar edhe personi i cili trashëgimlënësit ka bërë kallzim apo dëshmi të rreme për kryerjen e veprës penale, për të cilën parashihet dënimi me heqje lirie. Në kontekstin e kësaj rrethane na rezultojnë se shkak i padenjësisë në këtë rast qëndron në rrethanën se personi i caktuar ndaj trashëgimlënësit është udhëhequr me qëllim të këqija dhe se qëllimi i tij ka qenë që trashëgimlënësi të dënohet për vepër penale dhe rrjedhimisht të burgoset.

⁵¹ Nëse personi i caktuar me mashtrim, kanosje, apo dhunë e ka shtyrë trashëgimlënësin të bëjë, ndryshojë, ose të fuqizoj testamentin ose e ka përpiluar vetë një të rremë, ose e ka përdorur atë për interesat e tij apo të të tjerëve, atëherë i njëjti është i padenjë. Shkak në këtë situatë është qëllimi dashakeq dhe i nxitur nga përfitimi i padrejtë dhe i pandershëm i personit të padenjë për trashëgim.

⁵² Nëse personi i caktuar është sjellë ndaj trashëgimlënësit në mënyrë poshtëruese dhe keqtrajtuese përbën shkak për padenjësi në trashëgim. Në këtë situatë bëhet fjalë për veprime të tillë të cilat kanë për qëllim denigrimin e personaliteti të trashëgimlënësit. Pra sjellje të tilla që cenojnë integritetin e trashëgimlënësit. Këto sjellje mund të kualifikohen në grupin e rrethanave që konsumojnë elemente të dhunës në familje. Për shembull kur i drejtohet me emra fyese etj.

⁵³ Një prej shkaqeve për padenjësinë është edhe mos përmbushja e detyrimit për ta mbajtur dhe ndihmuar trashëgimlënësin. Në sistemin tonë pozitiv brenda familjes ekziston detyrimi i mbajtjes dhe nëse trashëgimlënësi është në pozitë të tillë të nevojës për mbajtje dhe ndihmë, ndërsa trashëgimtarit potencial; refuzon të përmbushë detyrimin e mbajtjes apo ndihmës, përbën shkak për padenjësi në trashëgim.

Për disa shkaqe që shkaktojnë padenjësinë e një personi për trashëgim, gjykata është e detyruar të kujdeset zyrtarisht e për disa arsye të tjera vetëm atëherë kur pala ngre një kundërshtim. Në kuptim të dispozitës së nenit 112 të LTK-së, për padenjësinë gjykata kujdeset kryesisht, përveç në rastet e padenjësive për shkeljen e detyrimit të mbajtjes dhe për shkak të mos dhënies së ndihmës së domosdoshme.

Përfshirja nga trashëgimia e trashëgimtarit të domosdoshëm

Me përfshirje nga trashëgimia duhet të kuptojmë heqjen e cilësisë së trashëgimtarit ligjor nga ana e trashëgimlënësit me deklarin e vullnetit të fundit, ashtu që ai nuk fiton asgjë nga pasuria trashëgimore.

Kështu Ligji mbi Trashëgimin e Kosovës në dispozitën e nenit 114 ka paraparë se kur mund të bëhet përfshirja nga trashëgimia e domosdoshme, edhe atë:

- nëse ai me shkeljen e ndonjë detyrimi ligjor ose moral ka bërë cenimin e rëndë ndaj trashëgimlënësit;
- nëse ka bërë me dashje vepër të rëndë penale ndaj trashëgimlënësit, bashkëshortit, fëmijëve ose ndaj prindërve të tij, dhe
- nëse është plëngprishës, nuk do të punojë ose është dhënë pas jetës së pandershme.

Procedura për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore

Procedura trashëgimore paraqet një tërësi veprimesh të ndërmarra nga gjykata apo noteri për vërtetimin e pasurisë juridike të trashëgimisë, pas vdekjes së trashëgimlënësit dhe përcaktimin e masave dhe veprimeve për mbrojtjen e pasurisë trashëgimore si dhe të drejtat që prej sajë burojnë. Ligji për trashëgiminë e Kosovës nuk ka rregulluar me norma ligjore institutin e procedurës trashëgimore veç se me dispozitën e nenit 145 ka autorizuar gjykatat, organet të tjera dhe personat e autorizuar të zbatojnë në çështjet e trashëgimisë dispozitat e procedurës jokontestimore.

Procedura për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore inicohet nga pala e interesuar, gjykata apo nga noteri pas informimit të tij nga organi kompetent se një person ka vdekur ose është shpallur i vdekur me vendim gjyqësor.

Në këtë procedurë gjykata apo noteri konstaton se kush janë trashëgimtarët të vdekurit, ose personit vdekja e të cilit është shpallur me vendim gjyqësor, cila pasuri përbën pasurinë e tij trashëgimore, dhe cilat të drejtat nga pasuria trashëgimore u takojnë trashëgimtarëve, legatarëve dhe personave të tjerë⁵⁴.

Kompetenca vendore

⁵⁴ Shih LPJK, Neni 125.

Me dispozitën e nenit 128. 1 të Ligjit mbi Procedurën Jokontestimore dhe nenit 5 të ndryshim dhe plotësim të këtij ligji, është përcaktuar se për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore territorialisht është kompetente gjykata apo noteri në terretiron e të cilës trashëgimlënësi në kohën e vdekjes ka pasur vendbanimin e përhershëm ose të përkohshëm. Ndërkaq në pikën 2 të nenit 128 të po këtij ligji është parapa që në qoftë se trashëgimlënësi në kohën e vdekjes nuk ka pasur as vendbanim të përhershëm e as të përkohshëm në territorin e Republikës së Kosovës, kompetente është gjykata apo noteri, në jurisdikcionin e së cilës gjendet pjesa më e madhe e pasurisë trashëgimore të tij.

Kompetenca lëndore

Për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore kompetencën lëndore e ka gjykata themelore apo noteri, e cila është e autorizuar për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore dhe nxjerrjes së vendimit gjegjësisht. Kompetenca lëndore është e caktuar me ligj ndërsa palët nuk mund ta ndryshojnë këtë me marrëveshje.

Kompetenca ndërkombëtare

Pasi ta ketë marrë aktvdekjen dhe certifikatën nga libri amëz i të vdekurve gjykata me vendim do të shpallet inkompetent dhe do të ndërpresë procedurën nëse gjen se për shqyrtimin e trashëgimisë është kompetent gjykata e huaj. Në bazë të dispozitës së nenit 147. 2 të LTK-së është përcaktuar se në qoftë se në shtetin e shtetasit të huaj shqyrtohet pasuria trashëgimore e shtetasit të Kosovës, sipas ligjit atij shteti, atëherë edhe pasuria trashëgimore e shtetaseve të atij shteti të huaj që ndodhet në territorin e Republikës së Kosovës, do të shqyrtohet sipas dispozitave të ligjit të Kosovës. Nga kjo rezulton se ligji mbi trashëgiminë i Kosovës ka gjetur zgjedhjen më të drejtë, zbatimin e parimit të reciprocitetit. Përkitazi me kompetencën ndërkombëtare edhe ligji mbi procedurën jokontestimore në mënyrë decidive e rregullon çështjen e kompetencës ndërkombëtare⁵⁵.

Përgatitja e seancës trashëgimore

Veprimet procedurale që merren paraprakisht para mbajtjes së seancës trashëgimore konsiderohen:

- hartimi i dëshmisë së vdekjes;
- masat e përkohshme për sigurimin e pasurisë trashëgimore;
- regjistrimi dhe vlerësimi i pasurisë dhe
- emërtimi i kujdestarit të përkohshëm të pasurisë trashëgimore.
-

⁵⁵ Shih LPJK, neni 129.2.

Hartimi i dëshmisë së vdekjes

Pas vdekjes së një personi ose shpalljes si i vdekur nga gjykata, hartohet dëshmia e vdekjes nga zyra e Gjendjes Civile, sipas të dhënave të marra në mënyrë të pavarur nga regjistri civil, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e regjistrimit të vdekjes dhe i dërgohet Odës së Noterëve. Oda e Noterëve e dërgon tek noteri kompetent sipas radhës alfabetike. Nëse organi lartpërmendur nuk ka shënime të mjaftueshme për hartimin e dëshmi vdekjes, do ta dërgojë dëshmi vdekjen në gjykatë apo te noteri vetëm me ato shënime që disponon dhe e informon për shkaqet për të cilat nuk ka mundur ta përpiloj dëshmi vdekjen.

Të dhënat për hartimin e dëshmisë së vdekjes mund të verifikohen edhe nga të afërmit e personit të vdekur, nga personat me të cilin personi i vdekur ka bashkëjetuar, si dhe nga personat e tjerë që mund të japin të dhëna që shënohen në dëshminë e vdekjes. Në qoftë se gjykatës apo noterit i është dërguar dëshmia e vdekjes jo e plotë ose vetëm certifikata nga regjistri i gjendjes civile, noteri sipas rrethanave të rastit do të kërkojë nga organi kompetent për mbajtjen e regjistrave të gjendjes civile plotësimin e dëshmisë së vdekjes ose verifikimin e të dhënave.

Me nenin 136 të LPJK-ës janë përcaktuar të dhënat të cilat shënohen në dëshmi vdekjen, që në bazë të dëshmi vdekjes të mund të shqyrtohet pasuria trashëgimore.

Masat e përkohshme për sigurimin e pasurisë trashëgimore

Gjatë gjitha fazave të zhvillimit të procedurës për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore, gjykata apo noteri mund ta caktojë masa për sigurimin e pasurisë trashëgimore. Masat për sigurimin e pasurisë trashëgimore mund të urdhërohen:

- nga gjykata apo noteri në rajonin e së cilës gjendet pasuria trashëgimore, dhe
- nga gjykata apo noteri në juridikcionin e së cilës ka vdekur trashëgimlënësi.

Inventarizimi dhe vlerësimi i pasurisë së trashëgimlënësit

Regjistrimi dhe vlerësimi i pasurisë trashëgimore bëhet me qëllim të sigurimit të pasurisë që ajo të jetë e mbrojtur nga vjedhja, fshehja, ose asgjësimi. Ky regjistrim bëhet sipas vendimit të gjykatës apo noterit kur nuk dihen trashëgimtarët apo vendbanimi i tyre, kur trashëgimtarë janë personat që për shkak të moshës së mitur, sëmundjes mendore ose rrethanave të tjera nuk janë fare të aftë, ose nuk janë plotësisht të aftë që të kujdesen vetë për punët e veta, kur pasuria trashëgimore duhet t'i dorëzohet komunës ose personit juridik tjetër, ose në rastet tjera të arsyeshme. Gjykata apo noteri vendos që të bëhet inventarizimi dhe vlerësimi i pasurisë trashëgimore edhe në rast se këtë e kërkojnë trashëgimtarët, legatarët ose kreditorët e trashëgimlënësit.

Në mbështetje të dispozitave të neneve 139 dhe 140 të LPJK-së bëhet inventarizimi dhe vlerësimi i pasurisë trashëgimore, e që përfshihet :

- tërë pasuria e luajtshme dhe e pa luajtshme që ka qenë në posedim të trashëgimlënësit në momentin e vdekjes së tij;
- pasuria që i ka takuar trashëgimlënësit e që gjendet te personi tjetër apo edhe pasuria që gjendet te trashëgimlënësi dhe është pronë e dikujt tjetër, dhe
- në regjistrin e pasurisë do të shënohet edhe kërkesat dhe borxhet e trashëgimlënësit sikur edhe obligimet e tij (p.sh. borxhet, tatimi etj.)

Me rastin e inventarizimit të pasurisë trashëgimore do të tregohet edhe vlera e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme që e përbëjnë pasurinë trashëgimore.

Organi kompetent i komunës i cili e ka bërë inventarizimin dhe vlerësimin e pasurisë, do t'ia dërgojë të dhënat lidhur me inventarizimin dhe vlerësimin gjykatës trashëgimore dhe noterit. Po qe se ka mospajtime lidhur me inventarizimin apo vlerësimin e pasurisë, gjykata apo noteri mund të vendosë që vlerësuesi i licencuar i pasurisë ta bëjë inventarizimin ose vlerësimin e pasurisë.

Në qoftë se konstatohet se asnjëri nga trashëgimtarët e pranishëm nuk është i aftë të administrojë pasurinë trashëgimore, e nuk ka përfaqësues ligjor, ose në rast se trashëgimtarët janë të panjohur apo mungojnë, si dhe kur rrethanat tjera kërkojnë kujdes të posaçëm, shërbimi komunal kompetent, në raste të ngutshme, do t'ia dorëzojë pasurinë, ose vetëm një pjesë të saj, për ruajtje personit të sigurt dhe për këtë do ta njoftojë menjëherë gjykatën apo noterin në territorin e të cilës gjendet kjo pasuri.

Në rastet e caktuara kur paraqitet nevoja e emërimit të përfaqësuesit të përkohshëm të pasurisë trashëgimore, emërimin e bënë gjykata apo noteri. Para se të emërtoj kujdestarin e përkohshëm gjykata apo noteri, sipas mundsive për personalitetin e kujdestarit do të kërkojë mendim nga personat që paraqiten si trashëgimtarë.

Veprimi lidhur me testamentin

Organi i cili e përpilon dëshmi vdekjen duhet të verifikojë se mos ka lënë i vdekuri testament të shkruar, përkatësisht a ekziston dokumenti mbi testamentin oral verbal. Testamenti që ka lënë i vdekuri i dërgohet gjykatës trashëgimore apo noterit bashkë me dëshmin e vdekjes. Kur gjykata apo noteri konstaton se personi që ka lënë testament ka vdekur ose është shpallur i vdekur me vendim gjyqësor, atëherë do ta hapë atë, pa e dëmtuar vulën, dhe lexojë duke hartuar procesverbal për një gjë të tillë. Në këtë mënyrë veprohet pa marrë parasysh se a është testamenti i vlefshëm sipas ligjit dhe sa teste ekzistojnë.

Hapja dhe leximi i testamentit bëhet në praninë e dy personave të moshës madhore që mund të jenë edhe nga radha e trashëgimtarëve të mundshëm. Me rastin e shpalljes së testamentit mund të jenë të pranishëm trashëgimtarët, legatarët dhe personat e tjerë të interesuar dhe të kërkojnë kopjen e testamentit. Me nenin 149.4 të LPJK i plotësuar është përcaktuar që noteri apo gjykata tek e cila gjendet testamenti apo të cilit i dorëzohet ai do ta hapë dhe shqyrtoj testamentin edhe kur për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore kompetent është noteri tjetër apo organi i shtetit tjetër.

Përmbajtja e procesverbalit për shpalljen e testamentit të shkruar

Me nenin 150 të LPJK, i plotësuar dhe ndryshuar me nenin 22, është përcaktuar se çka duhet të përmbaj procesverbalin kur shpallet testamenti i shkruar:

- sa testamente janë gjetur, cilën datë e mbajnë dhe ku janë gjetur;
- kush ia ka dorëzuar gjykatës apo noterit, testamentin për ruajtje;
- a është dorëzuar testamenti i hapur apo i mbyllur, dhe me çfarë vule ka qenë i vulosur;
- cilët dëshmitar kanë qenë të pranishëm kur është hapur dhe shpallur testamenti.

Nëse me rastin e hapjes së testamentit vërehet se vula në të ka qenë e dëmtuar apo se në testament është fshirë, vijëzuar apo ndrequr diç, apo ndonjë gjë e dyshimtë konstatohet, atëherë e gjithë kjo duhet theksuar në procesverbal.

Në testamentin e shpallur gjykata apo noteri e venë vërtetimin për shpalljen e tij duke cekur datën e shpalljes, si dhe numrin dhe datën e testamenteve të tjerë të gjetur të të njëjtit trashëgimtar. Procesverbalin e nënshkruan gjykatësi apo noteri dhe dëshmitarët.

Në rastet kur i vdekuri ka bërë testament gojorë verbal

Në qoftë se i vdekuri ka bërë testament gojor verbal dhe për këtë ekziston dokumenti, të cilin dëshmitarët e kanë nënshkruar me dorën e vet, gjykata apo noteri përmbajtjen e këtij dokumenti do ta shpallë sipas dispozitave të cilat vlejné për shpalljen e testamentit të shkruar nga testament lënësi⁵⁶.

Po qe se dokumenti i tillë nuk ekziston, dëshmitarët përpara të cilëve është bërë testamenti gojor verbal do të dëgjohen veç e veç për përmbajtjen e testamentit, e sidomos lidhur me rrethanat nga të cilat varet vlefshmëria e tij, dhe pas kësaj procesverbalin i përpiluar me deklaratat e tilla do të shpallet sipas dispozitave që vlejné për shpalljen e testamentit të shkruar nga testament lënësi.

Në qoftë se pjesëmarrësi i procedurës kërkon që dëshmitarët e testamentit gojor verbal të merren në pyetje me betim, apo në qoftë se vetë gjykata vij në përfundim se është i nevojshëm dëgjimi i këtillë i dëshmitarëve, atëherë ajo do të caktojë seancën për dëgjimin e dëshmitarëve për në të cilën

⁵⁶ Shih LPJK, neni 151.

thirret propozuesi, kurse pjesëmarrësit e tjerë thirren vetëm po qe se një gjë e tillë nuk e zvarritë procedurën e mëtejme.

Në rast se testamenti i shkruar nga testament lënësi është humbur apo asgjësuar pa vullnetin e testament lënësit, kurse midis personave të interesuar nuk ka kontest për ekzistimin e testamentit të tillë, për formën në të cilën është hartuar, për mënyrën e humbjes apo të asgjësimit, si dhe për përmbajtjen e testamentit, atëherë gjykata trashëgimore apo noteri lidhur me ekzistimin e testamentit do t'i dëgjojë të gjithë të interesuarit dhe sipas propozimeve të tyre do të marrë prova, e pastaj procesverbalin e përpiluar do ta shpallë sipas dispozitave që vlejné për shpalljen e testamentit gojor verbal.

Procesverbali për shpalljen e testamentit bashkë me testamentin gojor verbal burimor, përkatësisht bashkë me dokumentin mbi testamentin gojor apo procesverbali mbi dëgjimin e dëshmitarëve të testamentit gojor, do t'i dërgohet gjykatës trashëgimore apo noterit, e gjykata apo noteri që e ka shpallur testamentin do ta mbajë kopjen e tyre. Testamenti i shkruar nga testament lënësi burimor, dokumenti mbi testamentin gojor, procesverbali mbi dëgjimin e dëshmitarëve të testamentit gojor , si dhe procesverbali mbi përmbajtjen e testamentit të shkruar nga testament lënësi të humbur apo të asgjësuar, do të ruhet në gjykatë apo te noteri ndaras nga dosjet e lëndëve të tjera, kurse kopja e tyre e verifikuar i bashkëngjitet dosjes së lëndës.

Koha e hapjes së trashëgimisë

Trashëgimia hapet në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit, sipas dispozitës së nenit 5 të LTK-së, personi i vdekur fizik (trashëgimlënësi) e trashëgon ai i cili në momentin e vdekjes së tij ka fituar të drejtën trashëgimore (trashëgimtari), pra edhe nga kjo dispozitë ligjore rezulton në mënyrë të padyshimtë se momenti i vdekjes së trashëgimlënësit, është edhe momenti i hapjes së trashëgimisë.

Hapja e trashëgimisë sjell kalimin e të drejtave pasurore të trashëgimlënësit tek trashëgimtarët e tij. Në kuptim të dispozitës së nenit 7.1 të LTK-ës, personi që në kohën e hapjes së trashëgimisë është gjallë ose është zënë para vdekjes së trashëgimlënësit dhe ka lind i gjallë ka zotësi për të trashëguar. Po sipas kësaj dispozite ligjore konsiderohet se ka qenë i zënë nëse në kohën e hapjes së trashëgimisë ai person që ka qen i lindur gjallë brenda 300 ditëve nga dita e vdekjes së trashëgimlënësit.

Vendi i hapjes së trashëgimisë

Vendi i hapjes së trashëgimisë është vendqëndrimi ose vendbanimi i trashëgimlënësit. Nëse trashëgimlënësi ka qenë jashtë Kosovës, vendi i hapjes së trashëgimisë konsiderohet vendi ku trashëgimlënësi ka pasur vendqëndrimin ose vendbanimin e fundit dhe në raste të caktuara edhe ku ndodhet pasuria e tij trashëgimore.

Seanca për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore

Seanca trashëgimore është stadi qendror dhe themelor i procedurës trashëgimore. Në seancën për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore gjykata apo noteri do t'i shqyrtojë gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pasurinë trashëgimore, sidomos me të drejtën e trashëgimit, me madhësinë e pjesës trashëgimore dhe me të drejtën e legut.

Gjykata apo noteri para fillimit të seancës përveç njoftimit të trashëgimtarëve që janë të njohur duhet që të bëjnë njoftim publikë në gazetën Zyrtare të RKS, Portalin Shtetërorë të Republikës së Kosovës dhe ëeb faqen zyrtare të Odës së Noterëve të RKS, i cili njoftim duhet të qëndroj 30 ditë.

Model i njoftimit për inicimin e procedurës trashëgimore

Nr.48/2021

Bazuar ne Ligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit mbi Procedurën Jokontestimore, Ligji Nr. 03/L-007, Neni 32, për Plotësimin/Ndryshimin e Nenit 161 paragrafi 1 te Ligjit bazik dhe Neni 33 për Plotësimin/Ndryshimin e Nenit 163, Noter _____, me seli ne _____, publikon këtë:

NJOFTIM PER INICIMIN E PROCEDURES TRASHEGIMORE

Pranë zyrës se Noterit _____, me seli në _____, nga palët në interes është iniciuar procedura për shqyrtimin e trashëgimisë, pas vdekjes së trashëgimlënësit -ës: F.Sh, ish nga _____, nga babai, E dhe e ëma, M, ka lindur ne _____, me datën, 25.09.1935.

Ne bazë të Dëshmisë mbi Vdekjen Nr. 208/2021, të lëshuar nga Komuna _____, me datën, 18.06.2021, është iniciuar procedura për shqyrtimin e trashëgimisë, për të ndjerën: F. Sh.

Njoftohen trashëgimtarët e mundshëm dhe palët tjera me interes qe të lajmërohen në këtë zyre noteriale.

Trashëgimtarët informohen gjithashtu se seanca informuese do të mbahet menjëherë pas përfundimit te afatit 30 ditësh nga dita e publikimit te këtij Njoftimi.

Secila palë që argumenton ekzistencën e ndonjë të drejte trashëgimore do të marrë informata gjithëpërfshirëse dhe shpjegime për të drejtat e tija apo saja trashëgimore.

Njoftimi do të qëndron i hapur për 30 (tridhjetë) ditë nga dita që publikohet në Gazetën Zyrtare, në përputhje me Nenin 161, 161.1, 161.3 dhe pika 161 a.2 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-007 për Procedurën Jokontestimore.

Për çdo informacion shtesë në lidhje me këtë njoftim apo procedurën trashëgimore mund të kontaktoni direkt Zyrën Noteriale -----, me seli në -----, apo të kontaktoni atë përmes e-mail: ----- dhe numrave të tel.:

_____, me datë: 18.06.2021.

Noter:

Seanca informuese

Pas 30 ditësh mbahet seanca informuese në të cilën do të ftohen të gjithë trashëgimtarët e mundshëm të marrin pjesë në seancë informuese në të cilën do t'ë njoftohen me të drejtat dhe detyrimet e tyre si trashëgimtarë. Çdo trashëgimtar që nuk merr pjesë në seancën informuese do të konsiderohet se ka hequr dorë nga e drejta e tij për të marrë pjesë në seancë informuese përveç nëse ai trashëgimtar ka dërguar deklaratë të vërtetuar.

Seanca e shqyrtimi kryesorë

Në këtë seancë gjykata apo noteri do të shqyrtojë gjitha çështjet e rëndësishme për marrjen e vendimit meritor. Për veprimet e kryera gjatë procedurës trashëgimore, gjykata apo noteri përpilon procesverbal, të cilin e nënshkruajnë pjesëmarrësit në seancë dhe noteri .

Trashëgimtari mund të heq dorë nga pjesa trashëgimore që do ti takonte, apo të deklarohej se e pranon trashëgiminë. Personi i cili nuk ka dhënë deklaratë për heqjen dorë nga trashëgimia konsiderohet se dëshiron të bëhet trashëgimtarë, ndërsa ai që vleftësisht ka dhënë deklaratë me të cilën e ka pranuar trashëgimin, nuk ka të drejtë që më vonë ta revokojë atë.

Në deklaratën trashëgimore duhet cekur se a e pranon, apo heqë dorë nga pjesa që i takon në bazë të ligjit apo në bazë të testamentit, ose se ajo ka të bëjë me pjesën e domosdoshme. Kur mungon specifikimi i përmendur, konsiderohet se deklarata i përket të gjitha bazave për trashëgim.

Deklaratën verbale për heqjen dorë nga trashëgimia, trashëgimtari mund ta jep edhe para gjykatës trashëgimore ose ndonjë gjykatë tjetër kompetente si dhe pran noterit.

Me rastin e dhënies së deklaratës për heqjen dorë nga trashëgimi, gjykata apo noteri do ta njoftojë trashëgimtarin me mundsinë që të heqë dorë vetëm në emër të vet apo edhe në emër të pasardhësve të tij.

Heqja dorë vlen edhe për pasardhësit e atij që ka hequr dorë, përveç nëse shprehimisht ka deklaruar se hequr dorë vetëm në emër të vet. Në qoftë se pasardhësit janë të mitur për këtë heqje dorë, nevojitet leja e organit të kujdestarisë. Trashëgimtari, i cili ka hequr dorë në emër të vet

konsiderohet sikur të mos ketë qenë trashëgimtar. Në qoftë se për trashëgim kanë hequr dorë të gjithë pasardhësit të cilët i takojnë radhës me të afërt të trashëgimisë në çastin e vdekjes të trashëgimlënësit, në trashëgim thirren pasardhësit e radhës pasuese të trashëgimit.

Me plotësim ndryshimin e LPJK është shtuar një nen i ri (neni 165A) me të cilin është përcaktuar që në rast që deklarimi për heqjen dorë nga trashëgimia e paraqitur para gjykatës apo noterit duhet të pasohet nga një bisedë me trashëgimtarin për të siguruar që ai i kupton plotësisht të drejtat e tij për të trashëguar, për t'u siguruar se trashëgimtari nuk është vënë nën presion kundër dëshirës së tij për të hequr dorë, për të vlerësuar arsyet e heqjes dorë, si dhe për ta njoftuar se heqja dorë është e parevokueshme. Gjykata apo noteri bisedën me trashëgimtarin gjatë heqjes dorë e bën pa praninë e trashëgimtarëve të tjerë të mundshëm. Nëse gjykata apo noteri është vënë në dijeni se një trashëgimtar është nën shtrëngim për të hequr dorë nga trashëgimia e tij, gjykata apo noteri nuk mund të pranojë heqjen dorë, por do të referojë çështjen te prokurori i shtetit.

Gjykata në seancën e shqyrtimit mbledhë fakte, duke vërtetuar ekzistimin e Testamentit, të legut apo edhe të ndonjë fakti tjetër sipas detyrës zyrtare apo edhe në ndonjë mënyrë tjetër. Në rast se kur palët kundërshtojnë vlerësimin ose regjistrimin e pasurisë mund të urdhërohet një vlerësim i ri, apo në situata të caktuara edhe vetë gjykata mund të bëjë përcaktimin e pasurisë trashëgimore.

Udhëzim i palëve në kontest civil

Gjykata trashëgimore apo noteri nuk është e autorizuar për t'i vërtetuar vetë faktet kontestuese prej të cilave do të varet konkludimi për ekzistimin e së drejtës trashëgimore, të legut ose për ekzistimi e ndonjë të drejte tjetër nga pasuria trashëgimore, nga përbërja e pasurisë trashëgimore apo nga objekti i testamentit. Po qe se ndërmjet palëve janë kontestuese faktet nga të cilat varët ndonjë e drejtë e tyre, në bazë të dispozitës së nenit 166 të LPJK-së, do të ndërpres shqyrtimin e pasurisë trashëgimore dhe do të udhëzojë palët që ta fillojnë kontestin ose procedurën para organit kompetent.

Udhëzim në kontest për shkak të konfliktit rreth të drejtës apo aplikimi të së drejtës

Në situata të caktuara trashëgimtarët mund të bien në konflikt si për faktet ashtu edhe për aplikimin e së drejtës. Në bazë të nenit 169 të LPJK-së, gjykata apo noteri do ta ndërpres procedurën trashëgimore dhe ti udhëzojë palët që të fillojnë kontestin ose procedurën para organit kompetent në këto raste:

- Në qoftë se në mes trashëgimtarëve ka konflikt rreth faktit se a hyn ndonjë pasuri në pasurinë trashëgimore dhe
- në qoftë se ndërmjet trashëgimtarëve ka konflikt lidhur me kërkesën e të paslindurve të trashëgimlënësit, me të cilit kanë bashkëjetuar në një familje apo që nga pasuria trashëgimore duhet të veçohet pjesa që i përgjigjet kontributit të tyre në vlerën e pasurisë trashëgimore.

Nuk do të ndërpritet shqyrtimi i trashëgimisë në qoftë se mes palëve gjykata apo noteri e vërteton se ekziston konflikti rreth së drejtës së legatorit ose ndonjë të drejte tjetër nga pasuria trashëgimore. Këtë gjykata do ta bënë duke marr parasysh natyrën juridike të së drejtës së legut si një e drejtë individuale, me bindje se nuk do të dëmtohet e drejta e legut.

Aktvendimi mbi trashëgiminë

Në bazë të rezultateve të procedurës për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore, gjykata trashëgimore apo noteri vendosë me aktvendim për trashëgiminë. Kur konstaton se cilëve personave u takon trashëgimia ata i shpall trashëgimtarë të pasurisë trashëgimore me aktvendim⁵⁷.

Në qoftë se në procedurën trashëgimore të gjithë trashëgimtarët dhe legatarët me marrëveshje i propozojnë gjykatës apo noterit ndarjen dhe mënyrën e ndarjes, gjykata apo noteri marrëveshjen e këtillë e inkorporon në aktvendimin për trashëgiminë. Gjykata apo noteri vepron kështu edhe kur ndarjen e pasurisë trashëgimore e bënë duke e aprovuar kërkesën e trashëgimtarit që ka jetuar në bashkësi familjare me të vdekurin, që t'i lihen sendet e caktuara që shërbejnë për nevoja të përditshme apo për ushtrimin e profesionit.

Formë e aktvendimit që merret në procedurën e shqyrtimit të trashëgimisë

T.nr.....

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, si gjykatë trashëgimore me gjyqtarin _____, në procedurën e shqyrtimit të trashëgimisë, pas vdekjes së tani të ndjerit _____, në seancën e mbajtur gjyqësore për shqyrtimin e trashëgimisë me dt. _____, mur këtë:

⁵⁷ Shih LTK, neni 171.2 Aktvendimi për trashëgiminë duhet të përmbajë: a) emrin dhe mbiemrin e të vdekurit dhe emrin e njërit nga prindërit e tij, datën e lindjes dhe shtetësinë e të vdekurit, e sipas mundsisë numrin personal të qytetarit, kurse për personat e vdekur në martesë edhe mbiemrin që e kanë pasur para lidhjes së martesës; b) paluajtshmërinë me të dhënat nga librat publike të nevojshme për regjistrim, si dhe sendet e luajtshme dhe të drejtat të tjera për të cilat gjykata ka konstatuar se bëjnë pjesë në pasurinë trashëgimore; c) emrin dhe mbiemrin e trashëgimtarit, vendbanimin e tij, marrëdhënien e trashëgimtarit ndaj trashëgimlënësit, a e trashëgon trashëgimlënësin në bazë të ligjit apo të testamentit, e po qe se janë më tepër trashëgimtarë edhe pjesën trashëgimore të secilit, nga ta të shprehur me vijë thyese, e sipas mundsisë numrin personal unik të trashëgimtarit; d) a është kushtëzuar, afatizuar, kufizuar apo ngarkuar, dhe në dobi të kujt, e drejta e trashëgimtarit; 32 e) emrin e mbiemrin, vendbanimin e personave të cilëve u ka takuar në pasurinë trashëgimore e drejta e legatit apo ndonjë e drejtë tjetër nga trashëgimia me shënimin e saktë të kësaj të drejte, dhe sipas mundsisë numrin personal të tyre.

A K T V E N D I M

I

I ndjeri _____ ish nga Prishtina, i lindur më 01.06.1944, në _____ Komuna _____, vdekur më 29.06.2011, nga babai _____ dhe nëna _____, pa lënë testament apo kontratë mbi mbajtje të përhjetshme, ka lënë :

Pasurinë e paluajtshme

- 1/1 certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr. UL-71107027-00147 të dt. 12.07.2012 ZK Kamenicë. Për parcelat: P-71107027-00402-0, P 71107027-00406-0, P-71107027-00412-0 dhe P- 71107027-00423-0, Komuna Kamenicë, ZK Desivojcë.
- 1/1 certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme,P-71914050-01346-1 evidentuar në certifikatën nr. 011-953-7147/2012 dt. 07.12.2012, ZK Matiqan,
- E drejta në shfrytëzimin e banesës sipas aktvendimit nr. 929 dt. 5.04.1973 dhe
- Pasurinë e luajtshme, mjetet që gjenden në xhirollogarinë – NLB Prishtina _____ dhe mjetet në xhirollogarinë NLB – Visa – _____,

II.

Për trashëgimtar të pasurisë së paluajtshme të lartshënuara në dispozitivin nën I të këtij aktvendimi, sipas rendit ligjor të trashëgimisë, konform nenit 11 dhe 12 të Ligjit mbi Trashëgiminë dhe nenit 164 të Ligjit mbi Procedurën Jokontestimore e në ngarkim të kompensimit eventual të borxheve të trashëgimlënësit në lartësi të vlerës së patundshmërisë së trashëguar, gjykata:

S H P A L L Ë

1. _____ , bashkëshortja e trashëgimlënësit në:

- 1/1 certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme,P-71914050-01346-1 evidentuar në certifikatën nr. 011-953-7147/2012 dt. 07.12.2012, ZK Matiqan,
- ½ e të drejtës në shfrytëzimin e banesës sipas aktvendimit nr. 929 dt. 5.04.1973 dhe
- 1/1 në pasurinë e luajtshme, mjetet që gjenden në xhirollogarinë – NLB Prishtina - _____ dhe mjetet në xhirollogarinë NLB – Visa – _____,

2. _____, djali i trashëgimlënësit në:

1/3 në certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr. UL-71107027-00147 të dt. 12.07.2012 ZK Kamenicë. Për parcelat: P-71107027-00402-0, P 71107027-00406-0, P- 71107027-00412-0 dhe P- 71107027-00423-0, Komuna Kamenicë, ZK Desivojcë.

3. _____, djali i trashëgimlënësit në:

1/3 në certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr. UL-71107027-00147 të dt. 12.07.2012 ZK Kamenicë. Për parcelat: P-71107027-00402-0, P 71107027-00406-0, P- 71107027-00412-0 dhe P- 71107027-00423-0, Komuna Kamenicë, ZK Desivojcë dhe .

4. _____, djali i trashëgimlënësit në:

1/3 në certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr. UL-71107027-00147 të dt. 12.07.2012 ZK Kamenicë. Për parcelat: P-71107027-00402-0, P 71107027-00406-0, P- 71107027-00412-0 dhe P- 71107027-00423-0, Komuna Kamenicë, ZK Desivojcë dhe ½ e të drejtës në shfrytëzimin e banesës sipas aktvendimit nr. 929 dt. 5.04.1973 .

Trashëgimtarët e shpallur obligohet që të paguajnë taksën gjyqësore në shumë prej 50 euro në arkën e kësaj Gjykate.

Propozuesja dhe trashëgimtarët kanë deklaruar se heqin dorë nga e drejta në ankesë ndaj këtij Aktvendimi.

A r s y e t i m i

Në këtë Gjykate është iniciuar procedura për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore pas vdekjes së tani të ndjerit _____ ish nga Prishtina, sipas propozimit të propozueses _____.

Gjatë procedurës së provave është konstatuar se trashëgimlënësi ka vdekur me dt. 29.06.2011 në Prishtinë. Po ashtu është vërtetuar se i ndjeri nuk ka lënë testament apo ndonjë shkresë tjetër për ndarjen e pasurisë së vet në rast vdekjeje dhe se nga pasuria i ka mbetur patundshmëria dhe mjetet e cekura në dispozitivin nën I të këtij aktvendimi, kurse prej trashëgimtarëve ligjorë të ftuar në trashëgimi ka lënë bashkëshorten _____, vajzat: _____, _____ dhe _____ dhe djemtë _____, _____ dhe _____.

Në seancën gjyqësore të mbajtur me dt. 21.03.2013, trashëgimtarët ligjorë deklarojnë:

- bashkëshortja e të ndjerit _____, deklaron se e pranon pasurinë që i takon sipas Ligjit pas vdekjes së bashkëshortit të saj, tani të ndjerit _____, dhe atë pasurinë e cekur më lartë, ndërsa heq dorë në favor të djemve të saj: _____, _____ dhe _____ për certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr. UL-71107027-00147 të dt. 12.07.2012 ZK Kamenicë, për parcelat: P-71107027-00402-0, P 71107027-00406-0, P- 71107027-00412-0 dhe P-71107027-00423-0.

- djali i të ndjerit _____, deklaron se e pranon pasurinë që i takon sipas Ligjit pas vdekjes së babait të tij, tani të ndjerit _____, dhe atë pasurinë e cekur më lartë, por në të njëjtën kohë heq dorë në favor të nënës së tij _____, për certifikatën mbi paluajtshmërit respektivisht parcelën P-71914050-01346-1 evidentuar në certifikatën nr. 011-953-7147/2012 dt. 07.12.2012, ZK Matiqan, dhe për mjetet që gjenden në xhirollogarinë _____ dhe mjetet në xhirollogarinë _____, ndërsa për të drejtën e shfrytëzimit të banesës sipas aktvendimit nr. 929 dt. 5.04.1973 heq dorë në favor të nënës së tij _____ dhe vëllait _____,

- vajza e të ndjerit, _____ deklaron se e pranon pasurinë që i takon sipas Ligjit pas vdekjes së babait të saj, tani të ndjerit _____, dhe atë pasurinë e cekur më lartë, por në të njëjtën kohë heq dorë në favor të nënës së saj _____ dhe vëllezërve _____, _____ dhe _____.

- vajza e të ndjerit _____, deklaron se e pranon pasurinë që i takon sipas Ligjit pas vdekjes së babait të saj, tani të ndjerit _____, dhe atë pasurinë e cekur më lartë, por në të njëjtën kohë heq dorë në favor të nënës së saj _____ dhe vëllezërve _____, _____ dhe _____.

- vajza e të ndjerit _____ – përmes të autorizuarës së saj _____ deklaron se e pranon pasurinë që i takon sipas Ligjit pas vdekjes së babait të saj, tani të ndjerit _____, dhe atë pasurinë e cekur më lartë, por në të njëjtën kohë heq dorë në favor të nënës së saj _____ dhe vëllezërve _____, _____ dhe _____.

-djali i të ndjerit _____, deklaron se e pranon pasurinë që i takon sipas Ligjit pas vdekjes së babait të tij, tani të ndjerit _____, dhe atë pasurinë e cekur më lartë, por në të njëjtën kohë heq dorë në favor të nënës së tij _____, për certifikatën mbi paluajtshmërit respektivisht parcelën P-71914050-01346-1 evidentuar në certifikatën nr. 011-953-7147/2012 dt. 07.12.2012, ZK Matiqan, dhe për mjetet që gjenden në xhirollogarinë _____ dhe mjetet në xhirollogarinë _____, ndërsa, për të drejtën e shfrytëzimit të banesës sipas aktvendimit nr. 929 dt. 5.04.1973 heq dorë në favor të nënës së tij _____ dhe vëllait _____ dhe _____

- djali i të ndjerit _____, deklaron se e pranon pasurinë që i takon sipas Ligjit pas vdekjes së babait të tij, tani të ndjerit _____, dhe atë pasurinë e cekur më lartë, por në të njëjtën kohë heq dorë në favor të nënës së tij _____, për certifikatën mbi paluajtshmërit respektivisht parcelën P-71914050-01346-1 evidentuar në certifikatën nr. 011-953-7147/2012 dt. 07.12.2012, ZK Matiqan dhe për mjetet që gjenden në xhirollogarinë _____ dhe mjetet në xhirollogarinë _____.

Andaj Gjykata, duke pasur parasysh këto që u cekën më lart, pra duke u bazuar në deklaratat trashëgimore të palëve në procedurë dhe shkresave tjera të lëndës, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

T.nr. _____, dt. _____

Gjyqtari

Pasuria e gjetur pasi që aktvendimi për trashëgimi ta ketë marrë formën e prerë

Me aktvendimin për trashëgimi duhet të vendoset për gjithçka që hynë në pasurinë trashëgimore dhe për të gjitha të drejtat lidhur me pasuri. Në qoftë se pasi të jetë bërë i formës së prerë aktvendimi për trashëgimin gjendet pasuria e cila nuk është përfshirë me këtë aktvendim, gjykata apo noteri nuk do të shqyrtojë përsëri pasurinë trashëgimore, por këtë pasuri me një aktvendim të ri do ta pjesëtojë në mbështetje të aktvendimit të mëparshëm për trashëgimin. Kjo rregull nuk vlen po qe se ndonjëri nga trashëgimtarët ka hequr dorë nga trashëgimi apo pjesën trashëgimore i a ka dhënë bashkëtrashëgimtarit.

Në qoftë se më parë nuk është shqyrtuar pasuria trashëgimore, gjykata apo noteri do ta shqyrtojë atë vetëm në qoftë se pasuria e gjetur përbëhet nga sendet e paluajtshme apo nga të drejtat që barazohen me sendet e këtilla. Në qoftë se pasuria e gjetur përbëhet nga sendet e luajtshme apo nga të drejtat që barazohen me sendet e tilla, gjykata do ta filloj procedurën për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore vetëm me kërkesën e personave të interesuar.

Formë e aktvendimit për shqyrtimin e pasurisë trashëgimor të gjetur pasi që aktvendimi për trashëgimi ka marrë formën e prerë

T.nr. _____

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, si gjykatë trashëgimore me gjyqtarin _____ në procedurën e shqyrtimit të trashëgimisë, sipas propozimit të propozuesit _____ nga Prishtina, lidhur me patundshmërinë e gjetur më vonë, pas vdekjes së tani të ndjerit _____ ish nga Prishtina, në seancën e mbajtur gjyqësore më dt. _____, mur këtë:

A K T V E N D I M

I. Patundshmëria e përbërë prej: 1/7 të ngastrave kadastrale P-71914059-01023-0 në sipërfaqe prej 252.5 m² e evidentuar sipas fletës poseduese nr. 11-953-50966, ZK Prishtinë, KK Prishtinë dhe ngastra kadastrale P-71914059-01025-0 në sipërfaqe prej 121 m² e evidentuar sipas fletës poseduese nr. 11-953-50966, ZK Prishtinë, KK Prishtinë, e gjetur më vonë, pas vdekjes së të

ndjerit _____ ish nga Prishtina, i biri i _____ dhe _____, i lindur me datë 01.01.1904 në _____, i vdekur me 17.02.1975 në Prishtinë, u jepet në trashëgim djemve: _____, _____, _____ dhe _____, dhe atë nga ¼ e pjesës ideale e pasurisë së gjetur më vonë, pas plotfuqishmërisë së aktvendimit mbi shqyrtimin e trashëgimisë T.nr. _____ dt. 07.09.2012, të marr nga kjo Gjykatë.

II. Trashëgimtarët e shpallur obligohen që të paguajnë taksën gjyqësore në shumë prej 40,00 euro.

A r s y e t i m i

Propozuesi _____ nga Prishtina, me propozimin e ushtruar në këtë Gjykatë dt. 28.03.2013 respektivisht precizimin e dt. 15.04.2013 dhe atë të dhënë seancën e dt. 28.05.2013, ka kërkuar që gjykata të vendos lidhur me patundshmërinë e gjetur më vonë, pas vdekjes së babait të tij _____ ish nga Prishtina dhe pas shqyrtimit të trashëgimisë me aktvendimin e plotfuqishëm të kësaj gjykate T.nr. _____ dt. 7.09.2012. Bashkangjitur propozimit, propozuesi gjykatës i ka prezantuar edhe provat si: aktvendimin e plotfuqishëm të kësaj gjykate mbi shqyrtimin e trashëgimisë T.nr _____ dt. 7.09.2012 dhe fletat poseduese për ngastrat kadastrale P-71914059-01023-0 dhe P-71914059-01025-0, ZK Prishtinë, KK Prishtinë.

Gjykata duke vepruar sipas propozimit dhe precizimit të propozimit të ushtruar në këtë gjykatë, ka mbajtur seancën në të cilën ka dëgjuar propozuesin dhe të gjithë trashëgimtarët tjerë ligjor, i ka administruar provat e prezantuara dhe ka gjetur se pas vdekjes së të ndjerit _____ ish nga Prishtina, me aktvendimin e plotfuqishëm të kësaj gjykate, njëherë është shqyrtuar trashëgimia dhe prej trashëgimtarëve ligjorë të ftuar në trashëgimi ka lënë djemtë: _____, _____, _____, _____, _____, dhe _____, ndërsa ndërkohë është gjetur edhe patundshmëria e tij më detalisht e përshkruar në dispozitiv të këtij aktvendimi, për të cilën në kohën e shqyrtimit të trashëgimisë nuk është ditur se ekziston.

Në seancën gjyqësore të mbajtur me dt. 28.05.2013, gjykata ka dëgjuar trashëgimtarët ligjor të cilët deklarojnë:

_____, djali i të ndjerit e pranon pasurinë që i takon sipas Ligjit pas vdekjes së babait të tij, tani të ndjerit _____, dhe atë pasurin e cekur më lartë.

_____, djali i të ndjerit e pranon pasurinë që i takon sipas Ligjit pas vdekjes së babait të tij, tani të ndjerit _____, dhe atë pasurin e cekur më lartë, por në të njëjtën kohë heq dorë në favor të trashëgimtarëve të tjerë

_____, djali i të ndjerit e pranon pasurinë që i takon sipas Ligjit pas vdekjes së babait të tij, tani të ndjerit _____, dhe atë pasurin e cekur më lartë, por në të njëjtën kohë heq dorë në favor të trashëgimtarëve të tjerë..

_____, djali i të ndjerit e pranon pasurinë që i takon sipas Ligjit pas vdekjes së babait të tij, tani të ndjerit _____, dhe atë pasurin e cekur më lartë.

_____, djali i të ndjerit e pranon pasurinë që i takon sipas Ligjit pas vdekjes së babait të tij, tani të ndjerit _____, dhe atë pasurin e cekur më lartë.

_____, djali i të ndjerit e pranon pasurinë që i takon sipas Ligjit pas vdekjes së babait të tij, tani të ndjerit _____, dhe atë pasurin e cekur më lartë.

Andaj gjykata, duke pasur parasysh rrethanat e rastit, trashëgimtarëve: _____, _____, _____ dhe _____, iu jep në trashëgim nga ¼ e pjesës ideale të pasurisë së gjetur më vonë, më hollësisht të përshkruar në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga të cekurat më lartë, konform dispozitës së nenit 182 të LPJ-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

T.nr. _____, dt. _____

Gjyqtari

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj Gjykate.

Gjetja e testamentit pasi që aktvendimi për trashëgimi ta ketë marrë formën e prerë

Testamenti i gjetur pasi të jetë bërë i plotfuqishëm aktvendimi për trashëgimi apo aktvendimi për legatarin, do të ketë kuptimin e faktit të ri. Ekzistimi i këtij fakti të ri krijon bazën juridike që palët në procedurën kontestimore ti realizojnë kërkesat e tyre.

Në qoftë se pasi të jetë bërë i formës së prerë aktvendimi për trashëgimin gjendet testamenti i trashëgimlënësit, gjykata apo noteri te i cili është dhënë për ruajtje testamenti do ta shpallë atë, dhe procesverbalin për shpalljen dhe kopjen e testamentit do t'ia dërgoj noterit i cili ka zhvilluar procedurën e trashëgimisë, kurse origjinalin e mbanë për vete. Noteri i cili ka zhvilluar procedurën e trashëgimisë nuk do ta shqyrtojë përsëri pasurinë trashëgimore, por do t'i njoftojë personat e interesuar për testamentin e shpallur dhe do t'ua tërheqë vërejtjen se të drejtat e veta në bazë të testamentit mund t'i realizojnë në procedurën kontestimore.

Personi të cilin nuk e lidhë aktvendimi për trashëgimin apo legatin, i cili mendon se i takojnë të drejtat e trashëgimtarit apo legatarit, mund t'i realizojë të drejtat e tilla vetëm në procedurë kontestimore.

Cedimi dhe ndarja e pasurisë në përgjithësi

Përveç mënyrës ligjore dhe asaj me testament, me ligjin për trashëgimin janë paraparë edhe mundsi tjera të kalimit të pasurisë nga paraardhësi në pasardhës. Paraardhësi me anë të veprimit juridik, për së gjalli mund t'ua cedojë dhe pjesëtojë pasurinë e vet pasardhësve të tij⁵⁸. Një veprim i tillë mund ta kryen me anë të kontratës për ndarje të pasurisë gjatë jetës.

Me këtë kontratë paraardhësi për së gjalli ua pjesëton dhe cedon pasardhësve të vet gjithë pasurinë apo një pjesë të saj pasardhësve të vet të cilët sipas ligjit në qoftë se me këtë pajtohen të gjithë pasardhësit të cilët konkurrojnë në trashëgimi.

Kushtet për vlefshmërinë e cedimit dhe pjesëtimit

Që cedimi apo pjesëtimi i pasurisë të jetë i vlefshmen LTK me nenin 59 ka parapa disa kushte të cilat duhet plotësuar, dhe atë:

- a) pajtimi i të gjithë pasardhësve të ceduesit që do të ishin trashëgimtarë ligjor të ceduesit në kohën e cedimit;
- b) kontrata mbi cedimin dhe pjesëtimin e pasurisë duhet të përpilohet me shkrim dhe të vërtetohet nga gjyqtari, pasi që i njëjti t'ua lexon dhe tregon kontraktuesve për pasojat e kësaj kontrate.

Nëse ndonjëri nga pasardhësit nuk e ka dhënë pëlqimin, këtë mund ta bëjë më vonë në të njëjtën formë. Cedimi dhe pjesëtimi mund të mbeten të vlefshme nëse pasardhësi që nuk e ka dhënë pëlqimin ka vdekur para ceduesit pa lënë pasardhës, ose ky pasardhës ka hequr dorë nga trashëgimi, ose ky pasardhës është bërë i pa denjë.

Objekti i cedimit dhe pjesëtimit dhe përjashtimi i pasurisë së ceduar nga pasuria trashëgimore

Objekt i cedimit apo pjesëtimit është vetë pasuria e trashëgimlënësit, qoftë si tërësi apo vetëm si një pjesë e saj. Nëse trashëgimlënësi ka bërë cedimi apo pjesëtimin e të gjithë apo një pjesë të pasurisë së tij midis të gjallëve, atëherë pasuria e tij trashëgimore do të përbëhet vetëm nga pasuria që nuk është ceduar apo pjesëtuar, si dhe çdo pasuri që e ka fituar pas cedimit apo pjesëtimit. Ndërsa pasurinë që e kanë marrë paraardhësit me anë të cedimit dhe pjesëtimit nuk hynë në

⁵⁸ Shih LTK, neni 58.

pasurinë trashëgimore të ceduesit dhe as nuk merret për bazë në përcaktimin e vlerës së pasurisë trashëgimore⁵⁹.

Kur konsiderohet pjesa e ceduar si dhurim

Pjesët e pasurisë që u janar ceduar pasardhësve por me të cilin cedim nuk është pajtuar ndonjë trashëgimtarë, konsiderohet si dhurim dhe pas vdekjes së ceduesit – paraardhësit me to do veprohet si me dhurimet e bëra trashëgimtarëve. Në të njëjtën mënyrë do veprohet edhe në rastin kur ceduesit, pas cedimit apo pjesëtimit të bërë me marrëveshje me gjithë trashëgimtarët, i lind fëmijë apo paraqitet trashëgimtari që ka qenë shpallur i vdekur⁶⁰.

Shuarja kontratës mbi cedimin dhe pjesëtimin e pasurisë

Cedusi ka të drejtë të kërkoj shpëputjen e kontratës në mënyrë të njëanshme dhe kthimin e pasurisë, nëse përfituesit e cedimit dhe pjesëtimit kanë treguar mosmirënjohje të vrazhdë ndaj tij. Nëse kthimi i sendit është i pamundur atëherë duhet të kthehet vlera e sendit të ceduar në pajtim me dispozitat e pasurimit të pabazë. Një veprim të tillë cedusi mund ta ndërmerret edhe në rastet kur përfituesi i cedimit nuk i jep atij apo ndonjë personi tjetër ushqimin e caktuar, nuk paguan borxhet e ceduesit apo ndonjë personi tjetër, të cilat detyrime i kanë parapa në kontratën për cedimin apo pjesëtimin e pasurisë. Gjykata, duke i kushtuar kujdes rëndësisë së detyrimit për cedimin dhe rrethanave të tjera të rastit, do të vendosë se a ka të drejtë ceduesi të kërkojë kthimin e të mirave që i ka dhënë apo vetëm të drejtën të për mbushjen e detyrimeve⁶¹.

Të drejtat e trashëgimtarëve pas shuarjes së kontratës

Pasardhësi që ka qenë i detyruar t'i kthejë ceduesit atë që ka marrë me rastin e cedimit dhe pjesëtimit do të mund të kërkojë pjesën e vet të detyrueshme pas vdekjes së ceduesit, me kusht që to mos jetë përjashtuar nga trashëgimi, të mos jetë i padenjë të trashëgojë ceduesin dhe të mos ketë hequr dorë nga trashëgimi. Kur llogaritet madhësia e pjesës së domosdoshme të tij, pjesët e pasurisë që trashëgimlënësi gjatë jetës së vet ua ka ceduar dhe pjesëtuar pasardhësve të tjerë të tij do të konsiderohen si dhurim.

⁵⁹ Shih LTK neni 61 par 1 dhe 2.

⁶⁰ Shih LTK, neni 62.

⁶¹ Shih LTK, neni 66.

E DREJTA FAMILJARE

Procedura e zgjidhjes së kontesteve martesore

Procedurat për zgjidhjen e kontesteve martesore janë procedura gjyqësore të rregulluara me norma juridike ligjore imperative. Ligji për Familjen (LFK) nuk e ka rregulluar tërësisht me dispozita ligjore procedurën për zgjidhjen e martesës me anulim dhe shkurorëzim dhe kur mungojnë këto rregulla zbatohen rregullat e përgjithshme të procedurës kontestimore. Pra edhe kjo procedurë është e karakterit kontestimor dhe zhvillohet sipas rregullave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), mirëpo në relacion me procedurën e përcaktuar me LFK përparësi në zbatim ka Ligji i Familjes i cili është ligj special. Vetëm në rastet kur mungojnë dispozitat e LFK, përshtatshmërisht zbatohen dispozitat e LPK.⁶²

Parimet e procedurës në kontestet martesore

Parimet kryesore të procedurës së zgjidhjes së martesës janë:

- a. Parimi i mbrojtjes së veçantë të personave në procedurë

Sipas këtij parimi gjykata ka për detyrë që gjatë gjithë fazës të zhvillimit të procedurës së shkurorëzimit të kujdeset për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave më të larta të fëmijëve të mitur si dhe personave me sëmundje psikike dhe pazotësi veprimi.

- b. Parimi i përjashtimit të publikut

Ky parim në kontestet martesore është themelor. Me nenin 75 të LFK është rregulluar ky parim, ku është paraparë që *“Publiku përjashtohet në procedurat e kontestit martesorë”*. Qëllimi i këtij parimi është ruajtja e fshehtësisë të marrëdhënieve martesore në mesë të bashkëshortëve, sepse në këto konteste shqyrtohen dhe zbulohen fakte që prekin të drejtat personale të pjesëmarrësve në procedurë, e që lidhën ngushtë me privatësinë e tyre që është e garantuar me ligj. Parimisht puna e gjykatave është publike dhe pjesëmarrja e publikut është e lejuar.⁶³ Përveç kësaj edhe LPK ka lejuar përjashtimin e publikut në raste të caktuara.⁶⁴ Ruajtja e privatësisë është një e drejtë e garantuar edhe me akte ndërkombëtare.⁶⁵ Kuptimi i kësaj dispozite është zgjeruar ashtu që në procedurë duhet të përfshihen edhe ekspertët, prokurori dhe Organi i Kujdestarisë kur kjo kërkohet nga ligji⁶⁶.

- c. Parimi i dispozicionit

⁶² Shih LFK, neni 349.

⁶³ Shih neni 7, par. 4, LGJ.

⁶⁴ Shih LPK, neni 4 par 3, gjykata e shqyrton çështjen në seancë jopublike vetëm më rastet e përcaktuara me ligj.

⁶⁵ KEMDNJ, neni 8, par.1.

⁶⁶ Shih faqe 206, Komentari Ligji Për Familjen i autorëve Haxhi Gashi/ Avdullah Aliu\Adem Vokshi

Bashkëshortët janë të lirë në lidhje me paraqitjen e provave dhe materialit tjetër procedural në të gjitha fazat e zhvillimit të procedurës për zgjidhje apo anulim të martesës. Mirëpo, nuk do të thotë që gjykata në këto konteste ka rol pasiv në sigurimin e provave. Përkundrazi, gjykata ka rol aktiv dhe mundet që t'i hetoj edhe ato fakte mbi të cilat palët i mbështesin kërkesat e tyre e të cilat nuk i kundërshtojnë. Me nenin 85.1 të LFK- së është përcaktuar që *“Faktet në të cilat pala e mbështet kërkesën e vet në kontestet martesore gjykata mund t'i konsiderojë si të kontestueshme edhe atëherë kur ato fakte janë të pa kontestueshme ndërmjet palëve”*.

Sipas dispozitës së nenit 70.2 të LFK, bashkëshortët së bashku me propozimin për shkurorëzim me marrëveshje të dyanshme janë të detyruar të parashtrorjnë marrëveshjen me shkrim për përkujdesje, edukim dhe ushqim të fëmijëve të tyre të përbashkët si dhe propozimin me shkrim mbi atë se si kontaktet personale mes fëmijës dhe të dy prindërve do të garantohen në të ardhmen. Në qoftë se konstatohet se këto marrëveshje nuk janë në pajtim me interesat ma të larta të fëmijëve, gjykata mundet që marrëveshjen t'ua kthej palëve që atë ta harmonizojnë me interesat e fëmijëve, apo ta modifikoj atë vetë, me qëllim të mbrojtjes së interesave të fëmijëve të mitur.

d. Parimi i kufizimit të disponimit me objektin e kontestit

Veçori e procedurës për zgjidhjen e kontesteve martesore që e dallon nga procedura kontestimore është kufizimi i dukshin i mundsisë së kryerjes së veprimeve disponibile. Palët në të gjitha rastet nuk mund të disponojnë me objektin e kontestit, madje ekzistojnë raste të përcaktuara me dispozita ligjore kur nuk mund të inicojnë as procedurë gjyqësore. Sipas dispozitës së nenit 70.1 të LFK parashihet se *“Bashkëshortët nuk do të parashtrorjnë padi për shkurorëzim gjatë shtatzënisë së gruas dhe derisa fëmija i tyre i përbashkët t'i këtë mbushur një vit”*.

Rast tjetër i kufizimi të këtij parimi është kur gjykata duhet ti hetoj edhe faktet të cilat palët nuk i kanë parashtruar, e edhe ato të cilat nuk janë kontestuar midis tyre. Në këto konteste nuk mund të jepet aktgjykimi në bazë të pohimit dhe aktgjykim për shkak të mungesës, siç mund të ndodhë në procedura tjera kontestimore.

Procedura e anulimit të martesës mund të iniciohet për shkaqet e përcaktuar me ligj edhe nga personat e tjerë e jo vetëm nga bashkëshortët. Sipas nenit 67 të LFK, përkatësisht par. 1 të këtij neni është paraparë që *“Personat që kanë të drejtë të parashtrorjnë padi për anulimin e martesës për shkaqet parapara në këtë Ligj janë bashkëshortët, prokurori publik dhe të gjithë personat tjerë të cilët kanë interes të drejtpërdrejtë juridik për anulimin e martesës.”*

Edhe kjo është një karakteristik themelore e procedurës për zgjidhjen e martesës, që këtë procedurë e bënë specifike dhe të veçantë në shumë aspekte.

Kompetenca e gjykatës në konteste martesore

Që një gjykatë ta procedoj çështjen ajo duhet që të jetë kompetente në pikëpamje lëndore dhe territoriale.

Kompetenca lëndore – E kompetencës lëndore për zgjidhjen e kontesteve martesore është Gjykata Themelore. Kjo është rregulluar me nenin 11 të Ligjit për Gjykatat.⁶⁷ Sipas këtij neni Gjykatat Themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë gjitha çështjet, përveç nëse me ligj parashihet ndryshe. Kjo gjykatë vepron në përbërje të trupit gjykues të përbërë prej një gjyqtari profesional dhe dy porotë ndërsa gjykata e shkallës së dytë vepron në kolegji prej tre gjyqtarëve⁶⁸.

Kompetenca territoriale – Në këto konteste përveç gjykatës në territorin e së cilës i padituri e ka vendbanimin apo vendqëndrimin (kompetenca e përgjithshme territoriale) kompetente është edhe gjykata në territorin e së cilës bashkëshortët e kanë pasur vendbanimin e fundit të përbashkët⁶⁹. Kjo dispozitë i ka ofruar mundsinë e zgjedhjes së kompetencës që do të thotë se paditësi ose kur bashkëshortët bëjnë propozim të përbashkët, mund të zgjedhin në mes të dy mundsive që padinë ose propozimin ta paraqesin në gjykatë ku i padituri e ka vendbanimin ose në gjykatë ku bashkëshortët e kanë pasur vendbanimin e tyre të përbashkët. Në këto konteste vjen në shprehje edhe kompetenca ndihmëse e cila përcakton mundsinë që pala paditëse ta paraqesë padinë në vendin ku e njëjta e ka vendbanimin⁷⁰.

Fillimi i procedurës për zgjidhjen e martesës

Procedura për zgjidhjen e kontesteve martesore vihet në veprim me anë të padisë (për zgjidhjen e martesës me shkurorëzim apo anulim) dhe propozimit të përbashkët të përbashkët të bashkëshortëve.

Procedura e zgjidhjes së martesës me anulim

Anulimi i martesës është mënyrë e zgjidhjes së martesës së pavlefshme, e lidhur në kundërshtim me dispozitat ligjore që parashohin kushtet për lidhjen e një martesë të vlefshme.⁷¹ Ky institut juridik ka për qëllim që të parandalojë lidhjen e martesës në kundërshtim me cilindo kusht që ka parapa ligji për lidhjen e martesës së vlefshme. Anulimi i martesës mund të bëhet vetëm në procedurë gjyqësore. Edhe në këto raste vlen supozimi juridik se çdo martesë e lidhur është e

⁶⁷ Ligji nr.03/L-199 për Gjykatat

⁶⁸ Shih LFK, neni 73.

⁶⁹ Shih LFK, neni 72.

⁷⁰ Shih LFK, neni 56.

⁷¹ Shih LFK, nenet 14-31.

vlefshme deri sa nuk paraqiten faktet për anulimin e saj. Faktet për anulimin e martesës mund ta paraqiten nga personat e përcaktuar me ligj.⁷²

Shkaqet që sjellin pavlefshmërinë e martesës kanë efekt të ndryshëm, që si rrjedhojë disa shkaktojnë pavlefshmërinë absolute e disa pavlefshmërinë relative.

Anulimi absolut i martesës – anulimi absolut i martesës ekziston atëherë kur nuk plotësohen kushtet ligjore për lidhjen e një martesë të vlefshme. Ligji nuk specifikon se cilat janë shkaqet që sjellin anulimin absolut, por nga pasojat juridike që sjellin disa shkaqe mund të cilësohen si shkaqe me karakter absolut për anulimin e martesës.

Shkaqet që sjellin anulimin absolut të martesës janë:

- Martesa ekzistuese;
- Paaftësia për të vepruar;
- Mosrespektimi i dallimeve të sekseve;
- Gjinia (e gjakut, krushqisë dhe adoptimit);
- Lidhja e martesës para moshës 16 vjeçare;
- Mosrespektimi i procedurës për lidhjen e martesës;
- Shmangja nga qëllimi i martesës.

Kur ekzistojnë shkaqet e nultetit absolut të martesës rrethi i personave që mund të kërkojnë anulimin e martesës përkatësisht të bëjnë padi për anulim është më i gjerë. Këtë padi përveç bashkëshortëve mund ta paraqesin edhe personat e tretë që kanë interes juridik të drejtpërdrejtë për anulimin e saj, si dhe prokurori publik.

Për anulimin e martesës që është me pavlefshmëri absolute nuk ka ndonjë afat për paraqitjen e padisë, pra e drejta në padi nuk parashkruhet. Kjo do të thotë që në çdo kohë kur kuptohet se ekzistojnë shkaqe që shkaktojnë anulimin e martesës, mund të kërkohet anulimi. Martesa është konsideruar jo vetëm si interes i bashkëshortëve, por edhe i shoqërisë, prandaj për anulimin e saj nuk vlen ndonjë afat. Martesa absolutisht e pavlefshme konsiderohet që nuk është lidhur fare. Anulimi i martesës shkakton efekt vetëm në të ardhmen, e assesi prej momentit të lidhjes së martesës së pavlefshme juridike, tipar ky i cili e dallon anulimin e martesës nga teoria e pavlefshmërisë së punëve juridike.

Anulimi relativ i martesës - Është mënyrë e anulimit të një martese të pavlefshme, sepse mungojnë disa nga kushtet ligjore për vlefshmërinë e saj. Klasifikimi në anulim relativ mund të bazohet në shkaqet që shkaktojnë pavlefshmërinë dhe anulimi mbi këtë bazë mund të kërkohet vetëm me padi private dhe në afat të caktuar.

Si shkaqe që mund të sjellin anulimin relativ të martesës mund të konsiderohen;

⁷² Shih LFK, neni 67.

- Mungesa e vullnetit për të lidhur martesë;
- Lidhja e martesës me personin nën moshën 18 vjeç;
- Paaftësia për të vepruar.

Rrethi i personave aktivisht të legjitimuar për të bërë padi dhe kërkuar anulimin relativ të martesës është i kufizuar: kjo e drejtë u përket vetëm bashkëshortëve. Në këto raste ndryshe është situata edhe sa i përket afatit të parashtrimit të padisë. Me nenin 67 par.2 të LFK-së është parapa që *“Kur shkaqet e parapara në këtë Ligji shuhen, e drejta për të parashtruar padi për anulimin e martesës i takon vetëm bashkëshortit i cili ka pësuar sëmundje psikike apo për shkaqe tjera ka qenë i paaftë për të vepruar. Padia duhet të parashtrohet brenda një viti nga data kur shkaqet e lartpërmendura shuhen.”* Sipas kësaj dispozite rezulton që e drejta në padi u takon vetëm bashkëshortëve me sëmundje psikike apo që për shkaqe të tjera kanë qenë të paaftë për të vepruar dhe se padia duhet të ushtrohet brenda një viti nga dita kur kanë përfunduar (janë shuar) shkaqet e përmendura.

Nga praktika gjyqësore vërehet se janë të pakta rastet kur janë filluar dhe përfunduar procedurat për anulimin e martesës, ndërsa numri real i martesave të pavlefshme është shumë herë ma i lartë se numri i rasteve më kërkesë për anulimin e martesave nëpër gjykata tona. Kjo ndodh për arsye se në vendin tonë viteve të fundit janë lidhur shumë martesë jo më qëllim të jetës së përbashkët, por për qëllime tjera që dalin jashtë qëllimit të vërtet të martesës. Në këto raste pasi janë realizuar qëllimet tjera të martesave apo pasi kanë dështuar në realizimin e qëllimeve tjera palët kanë parashtruar kërkesa të përbashkëta më propozim shkurorëzim më marrëveshje me justifikim se jeta e përbashkët është bërë e padurueshme. Gjykatat kanë filluar procedurën sipas propozimeve të përbashkëta për shkurorëzime me marrëveshje, pa u lëshuar në shqyrtime me të hollësishme dhe për pasojë janë shkurorëzuar shumë martesë të pavlefshme.

Kurë ekzistojnë shkaqet për anulimin e martesës duhet të zhvillohet procedura e anulimit dhe këto shkaqe nuk mund të përdoren për procedurën e shkurorëzimit.

Procedura e zgjidhjes së martesës me shkurorëzim

Shkurorëzimi është një nga mënyrat e zgjidhjes së martesës së vlefshme. Kjo procedurë vihet në veprim me padi të njërit bashkëshort të ngritur kundër tjetrit apo sipas propozimit të përbashkët të bashkëshortëve për shkurorëzim me marrëveshje⁷³.

Shkurorëzimi ka katër komponente të cilat së bashku e bëjnë procesin e shkurorëzimit dhe atë:

1. Ekzistim i martesës së vlefshme;
2. Shkurorëzimi mund të bëhet për të gjallë të bashkëshortëve
3. Për shkaqet e përcaktuara me ligj dhe
4. Shkurorëzimi mund të bëhet në procedurë gjyqësore.

⁷³ Shih LFK, neni 68.

Shkaqet për shkurorëzim – Shkurorëzimi mund të kërkohet vetëm për shkaqet e caktuara me neni 69 i LFK-së. Padia ose propozimi i përbashkët për shkurorëzim duhet ti referohet njëres ndër shkaqet e parapara me këtë nenë, ndërsa vendimi i gjykatës me të cilin lejohet shkurorëzimi duhet të jetë i bazuar në këto shkaqe. Neni 69 i LFK parasheh dy kategori të shkaqeve të shkurorëzimit:

1. Shkaqet e përgjithshme dhe
2. Shkaqet e veçanta

Shkaqet e përgjithshme nuk janë numëruar në mënyrë laksative, por përshkruhen në mënyrë të përgjithshme si “*çrregullimi serioz dhe i vazhdueshëm i marrëdhënieve bashkëshortore*” (par 1 neni 69 LFK). Është nxjerr një formulim i përgjithshëm për faktin se në jetën praktike është e pamundur që të numërohen këto shkaqe. Ato mund të jenë të natyrave të ndryshme si p.sh grindjet e vazhdueshme, mos përputhja e karaktereve, alkoolizmi narkomania, etj. Është me rëndësi që paraqitja e kësaj rrethanë të jetë e intensitetit të tillë që i çrregullon marrëdhëniet bashkëshortore seriozisht dhe në mënyrë të vazhdueshme, ashtu që jetë e përbashkët të bashkëshortëve e bënë të padurueshme.

Shkaqet e veçanta - përveç shkaqeve të përgjithshme shkurorëzimi mund të kërkohet edhe për shkak të shkaqeve të veçanta e të cilat janë të numëruara në mënyrë laksative nga ligji (par 2 neni 69 LFK). Si shkaqe të veçanta të parapara në këtë nenë janë:

- a. Jeta e padurueshme e bashkëshortëve
- b. Shkelja e besnikris bashkëshortore
- c. Vepra penale kundër jetës së bashkëshortit
- d. Keqtrajtimi serioz
- e. Lënia qëllim keqe dhe e paarsyeshme
- f. Sëmundja psikike e pashërueshme dhe paaftësia e vazhdueshme për të vepruar
- g. Ndërprerja e paarsyeshme e jetës faktike për më shumë se një vit dhe
- h. Marrëveshja e bashkëshortëve si shkak i shkurorëzimit.

Padia për zgjidhjen e martesës – Procedura për shkurorëzim mund të filloj me padi. E drejta e padisë është e lidhur me personalitetin e bashkëshortëve, që do të thotë se vetëm ata kanë të drejtë të parashtrimit të padisë. Megjithatë kjo rregull ka përjashtimet e veta, kjo nga fakti se LFK ka parapa mundsin që kujdestari të mund të parashtrojë padi për shkurorëzim në emër të bashkëshortit i cili vuan nga sëmundjet psikike të diagnostifikuara (e provuar me dokumente përkatëse mjekësore), ose në emër të personit të paaftë për të vepruar, mirëpo për këtë duhet ta marrë pëlqimin e Organit të Kujdestarisë⁷⁴. E drejta e padisë shuhet me vdekjen e njërit apo të dy bashkëshortëve. Kjo e drejtë nuk mund të kaloj në trashëgimtar, por trashëgimtarët vetëm mund ta

⁷⁴ Shih LFK, neni 74.

vazhdojnë procedurën e filluar për shkurorëzim jo për të kërkuar shkurorëzimin por vetëm të kërkojnë nga gjykata vërtetimin se padia a ishte e bazuar apo e pabazuar⁷⁵.

Tërheqja e padisë - Në kontestet për shkurorëzim paditësi mund ta tërheqë padinë deri në përfundimin e seancës kryesore gjyqësore pa pajtimin e të paditurit, kurse me pajtimin e të paditurit derisa procedura nuk ka përfunduar në formë të prerë. Ndërsa propozimin e përbashkët për shkurorëzim me marrëveshje bashkëshortët mund ta tërheqin derisa aktgjykimi mbi shkurorëzimin të marrë formën e prerë. Do të konsiderohet se është tërhequr propozimi edhe kur nga propozimi heq dorë njëri bashkëshort⁷⁶.

Për dallim prej procedurave tjera gjyqësore kontestimore ku paditësi mund ta tërheq padinë pa pëlqimin e të paditurit më së largu deri sa i padituri paraqet përgjigje në padi,⁷⁷ në konteste të shkurorëzimit këtë të drejtë mund ta shfrytëzoj deri në përfundimin e seancës kryesore. Pas kësaj periudhe e deri sa procedura të përfundon në formën e prerë padia mund të tërhiqet por për këtë duhet që të jepet pëlqimi nga i padituri. Nëse i padituri nuk jep pëlqimin atëherë gjykata duhet të zhvilloj procedurën e rregullt dhe të marrë vendim. Në këto konteste heqja dorë nga kërkesëpadia ka efekt të njëjtë sikurse edhe tërheqja e padisë apo e propozimit të përbashkët.⁷⁸

Kundërpadia – Me ligj nuk është parapa shprehimisht se i padituri, gjatë gjykimit në kontestin martesore, ka të drejtë kundërpadie. Mirëpo një gjë e tillë mund të bëhet sipas rregullave të LPK-së në kundërpadi. Kundërpadinë i padituri mund ta ngris sikurse në gjykimin sipas padisë për shkurorëzim apo anulim të martesës. Në qoftë se në padi paditësi kërkon shkurorëzimin, i padituri në kundërpadi mund të kërkoj p.sh., anulimin e saj. Për kërkesën e padisë dhe kundërpadisë gjykata duhet të vendos me një aktgjykim të vetëm.⁷⁹

Propozimi për zgjidhje të martesës me marrëveshje të përbashkët - Bashkëshortet mund të kërkojnë zgjidhjen e martesës edhe me marrëveshje, nëse janë marrë vesh njëri me tjetrin për zgjidhjen e saj. Me nenin 68 par.2 të LFK është parapa mundësia që bashkëshortët të paraqesin padi të përbashkët për shkurorëzim me marrëveshje. Në aspektin procedural marrëveshja e përbashkët është trajtuar si propozim i përbashkët për zgjidhjen e martesës dhe në këtë mënyrë është vepruar në praktiken gjyqësore. Me nenin par 4 të këtij neni është parapa mundësia që padia të shndërrohet përkatësisht të konsiderohet si propozim i përbashkët i bashkëshortëve për shkurorëzim me marrëveshje, në rastet kur gjatë procedurës gjyqësore nga bashkëshorti tjetër nuk është kundërshtuar bazueshmeria e kërkesëpadisë.

Në rastet kur procedura për shkurorëzim është ven në veprim sipas propozimit të përbashkët, ndërsa bashkëshortët kanë fëmijë, ata janë të detyruar që së bashku me propozimin për

⁷⁵ Shih LFK, neni 68.3.

⁷⁶ Shih LFK, neni 68.

⁷⁷ Shih LPK, neni 261, par.1.

⁷⁸ Dr. Faik Brestovci, E drejta e procedurës civile, Prishtinë 2002, fq.285

⁷⁹ Dr. Faik Brestovci, E drejta e procedurës civile, Prishtinë 2002, fq.284

shkurorëzim me marrëveshje të dyanshme të parashtrojnë marrëveshjen me shkrim për përkujdesje, edukim dhe ushqim të fëmijëve të tyre të përbashkët si dhe propozimin me shkrim mbi atë se si kontaktet personale mes fëmijës dhe të dy prindërve do të garantohen në të ardhmen. Në këto raste gjykata ka për obligim që nga bashkëshortët të kërkoj edhe marrëveshjen për mbajtjen e fëmijëve dhe kontaktet e ndërsjella prind fëmijë.

Marrëveshja e kësaj natyre nuk është obligative për gjykatën. Gjykata ka të drejtë të vlerësoj se marrëveshja a është në interes të fëmijëve dhe bazuar në këtë vlerësim mund ta pranoj apo refuzoj marrëveshjen. Nëse gjykata vlerëson se marrëveshja e prezantuar nga prindërit nuk është në interes të fëmijëve, me vendimin me të cilin e zgjidh martesën, vendos edhe për përkujdesjen, ruajtjen dhe edukimin e fëmijëve si dhe kontaktet e prindërve dhe fëmijëve⁸⁰.

Fazat e procedurës së shkurorëzimit

Me rastin e shqyrtimit të padisë për shkurorëzim apo të propozimit të përbashkët për zgjidhjen e martesës me marrëveshje, procedura e shkurorëzimit kalon në disa faza, siç janë: a) përpjekjet për pajtimin e bashkëshortëve (nenet 76-79 të LFK-së), b) caktimi i m asave të përkohshme (neni 71 i LFK-së), c) prezantimi dhe administrimi i provave dhe ç) marrja e aktgjykimit.

Përpjekjet për pajtimin e bashkëshortëve - Është detyrimi i gjykatës që aktgjykimin për shkurorëzim ta merr pas një periudhe të përpjekjeve për pajtim të zhvilluara në seancë të veçantë⁸¹. Kjo seancë mbahet para kryetarit të trupit gjykues dhe në të mund të marrin pjesë vetëm bashkëshortët personalisht e jo nëpërmjet përfaqësuesve të tyre. Prandaj, gjykata as që do ta caktoj mbajtjen e kësaj seance kur njëri prej bashkëshortëve është i paaftë për të vepruar, kur njëri apo të dy bashkëshortët jetojnë jashtë vendit dhe kur nuk dihet vendbanimi i njërit nga bashkëshortët.

Në qoftë se në seancën e caktuar për pajtim nuk vjen njëri ose që të dy bashkëshortët edhe pse janë ftuar në mënyrë të rregullt, ndërsa asnjëri prej tyre nuk e arsyetojnë mungesën, gjykata, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret, do të çmojë se a do të caktojë seancën e re për përpjekjen e arritjes së pajtimit ose do të konsiderojë se pajtimi ka dështuar. Gjatë seancës gjykata ua shpjegon bashkëshortëve rëndësinë e martesës dhe pasojat negative që mund të paraqitet në rast të zgjidhjes së martesës. Nëse në seancën e parë nuk arrihet pajtimi, gjykata mund të caktoj një ose disa seanca të reja, përderisa të mos vlerësoj se nuk ka gjasa për një gjë të tillë.

Një seancë të tillë gjykata e cakton edhe në rastet kurë shkurorëzimi kërkohet me anë të propozimit të përbashkët⁸². Në këtë rast kur njëri apo të dy bashkëshortët nuk paraqiten në seancën për përpjekje që të arrihet pajtimi dhe mungesa e tyre nuk arsyetohet, do të konsiderohet se kanë tërhequr propozimin. Sipas kësaj dispozite ligjvënësi i jep përparësi pajtimit të bashkëshortëve kur

⁸⁰ Shih LFK, neni 70.2.

⁸¹ Shih LFK, neni 76.

⁸² Shih LFK, neni 79 par.3.

ata mungojnë në seancën e pajtimi duke e autorizuar gjykatën që të nxjerr konkludim për tërheqjen e propozimit për shkurorëzim.⁸³

Nëse bashkëshortët kanë fëmijë të përbashkët të mitur, atëherë procedurën e pajtimit e zhvillon Organi i Kujdestarisë, duke zbatuar metodat e punës sociale, metodat tjera profesionale, duke shfrytëzuar shërbimet e këshillimores për martesë dhe familje, si dhe institucionet tjera profesionale⁸⁴. Organi i Kujdestarisë ka këtë kompetencë që të kujdeset në çdo rast për mbrojtjen e interesave të fëmijëve duke përfshirë këtu edhe rastet e shkurorëzimit.⁸⁵ Me shkresën me të cilën gjykata ja kalon pajtimin organit të kujdestarisë, ky i fundit njoftohet lidhur me datën e fillimit të procedurës për shkurorëzim, shkaqet kryesore për të cilat kërkohet shkurorëzimi si dhe me faktin se bashkëshortët kanë fëmijë të mitur.

Kompetent për procedurën e pajtimit përveç organit të kujdestarisë në territorin e të cilit i padituri e ka vendbanimi apo vendqëndrimi, është edhe ai në territorin e të cilit bashkëshortët kanë pasur vendbanimin e fundit të përbashkët⁸⁶. Ndërsa kur procedura fillon me propozimin për shkurorëzim me marrëveshje të dyanshme, kompetent për procedurën e pajtimit të bashkëshortëve është përveç organit të kujdestarisë në territorin e të cilit e ka vendbanimin ose vendqëndrimin njëri prej bashkëshortëve, është edhe ai në territorin e të cilit bashkëshortët e kanë pasur vendbanimin e fundit të përbashkët.

Procedura e pajtimit pranë organit të kujdestarisë nuk mund të zgjasë më shumë se tre muaj, por mund të vazhdohet, nëse bashkëshortët pajtohen që të vazhdojnë një procedurë të këtillë pas përfundimit të këtij afati. Organi i Kujdestarisë ka për detyrë që pa vonesë t'ia dërgojë gjykatës raportin më shkrim lidhur me rezultatin e procedurës së pajtimit⁸⁷.

Faza e pajtimit të bashkëshortëve parashihet si mundsi për ruajtjen e martesës pasi që është edhe në interes të shoqërisë ruajtja e martesave dhe familjeve të shëndosha, sidomos kur të merre në konsideratë fakti se shkurorëzimi shkakton pasoja lidhur më fëmijët sidomos për mbajtjen e tyre.

Masat e përkohshme - Gjatë procedurave të kontesteve martesore, gjykata me vendim duke u bazuar në padi, mund të caktojë masa të përkohshme për sigurimin e mbajtjes financiare për bashkëshortin dhe vendosjen⁸⁸. Këto masa cilësohen si masa të përkohshme sigurorese që kanë për qëllim sigurimin e mbajtjes së bashkëshortit të pasiguar deri sa të nxjerrët vendim mbi shkurorëzimin. Gjykata nuk vendos sipas detyrës zyrtare për caktimin e masës por që vendimin e merr duke u bazuar në kërkesën e palës, e cila mund të bëhet përmes padisë apo me parashtrësë të veçantë. Qëllimi i masës është detyrimi e mbajtjes financiare dhe strehimit e cila i ngarkohet

⁸³ Shih faqe 212, Komentari Ligji Për Familjen i autorëve Haxhi Gashi/ Avdullah Aliu\Adem Vokshi

⁸⁴ Shih LFK, neni 80.

⁸⁵ Shih LFK, neni 6.4.

⁸⁶ Shih LFK, neni 81.1

⁸⁷ Shih LFK, neni 83.

⁸⁸ Shih LFK, neni 71.1.

bashkëshortit tjetër i cili ka kushte për të dhënë mbajtje. Bashkëshorti i cili nuk ka mundsi për të dhënien e mbajtjes, është i përjashtuar nga detyrimi.⁸⁹

Mënyra e vendosjes ne procedurën e shkurorëzimit

Me aktgjykim gjykata vendos për zgjidhjen e martesës, si në rastin e zgjidhjes së martesës me shkurorëzim ashtu edhe kur është fjala për zgjidhje të martesës me anulim.

Aktgjykimet me të cilat anulohet martesë apo vendoset shkurorëzimi janë të natyrës konstitutive dhe prodhojnë efekt në të ardhmen. Këtë efekt ai e prodhon nga momenti në të cilin bëhet i formës së prerë.

Në kontestet martesore nuk mund të nxirret aktgjykim për shkak të mungesë ose aktgjykimi në bazë të pranimit⁹⁰. Në këto konteste edhe kur pala mungon në seancë edhe pse është ftuar në mënyrë të rregullt apo nuk jep përgjigje me shkrim, gjykata vazhdon me procedurë duke i shqyrtuar të gjitha faktet relevante të nevojshme për nxjerrjen e vendimit. Në të njëjtën mënyrë vepron edhe nëse kemi pohim të ndonjë fakti. Gjkata vazhdon me vërtetimin e fakteve dhe provave pavarësisht pohimit të palës dhe nuk mund të nxjerrët ndonjë vendim vetëm duke u bazuar në pohimin e palës pa i vërtetuar saktësitë e fakteve.

Në dispozitiv të aktgjykimit për zgjidhjen e martesës gjykata vendos për të gjitha kërkesat e parashtruar në padi dhe për çështje që duhet vendos sipas detyrës zyrtare: zgjidhja e martesës; besimin e fëmijëve në përkujdesje, mbajtje dhe arsimim; kontaktet personale të fëmijëve me prindërit të cilit nuk i janë besuar në përkujdesje; ushqimin e fëmijëve dhe për shpenzimet e procedurës.

Aktgjykimi i paraqitur si model ka të bëjë me zgjidhjen e martesës me shkurorëzim, çështjen e besimit të fëmijës në përkujdesje, rregullimin e kontaktit me prindin që nuk i është besuar fëmija dhe alimentacionin.

C.nr. _____

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtari _____, kryetar i trupit gjykues, dhe gjyqtarët porotë _____ dhe _____, anëtarë të trupit gjykues, në çështjen juridike të paditësit _____, me vendbanim në Prishtinë, rruga “Tahir Meha”, pa.nr. dhe të paditurës _____, me vendbanim në fshatin _____, komuna e _____, lidhur me çështjen për zgjidhjen e martesës me shkurorëzim, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor jopublik, në prani të paditësit dhe të paditurës, të mbajtur me datën _____, mori këtë:

⁸⁹ Shih LFK, neni 307.

⁹⁰ Shih LFK, neni 85.2.

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditësit _____ ZGJIDHET me shkurorëzim martesë e lidhur me dt.09.12.2009 në zyrën e ofiqarisë në Prishtinë, me numër rendor _____, numri i referencës _____, në mes paditësit _____ nga Prishtina, i lindur me 03.06.1977, nga i ati _____ dhe e ëma _____, dhe të paditurës _____ nga fshati _____, komuna e _____, e lindur me 01.10.1984 nga i ati _____ dhe e ëma _____, në bazë të nenit 68 të Ligjit për Familjen i Kosovës – me marrëveshje.

II. Fëmija i përbashkët, vajza e mitur _____, e lindur me 10.01.2010 në Prishtinë, i besohen në ruajtje, mbajtje dhe edukim të paditurës – nënës _____.

III. Obligohet paditësi _____, që në emër të ushqimisë – alimentacionit për fëmijën e mitur _____, të paguaj çdo muaj nga 70 €, dhe atë duke filluar nga 01.12.2013, deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore për pagesë, e atë më së largu gjer me datën 5 të muajt, për muajin në vijim.

IV. Obligohet e paditura _____ që t'i mundsoj paditësit _____ – të atit kontaktin me fëmijën si në vijim:

- T'i mundsohet të atit kontakti me fëmijën dy (2) herë në muaj, të premten e dytë dhe të katërt të muajt ku e paditura do ia dorëzojë fëmijën paditësit prej orës 10.00 deri në ora 16.00. Kjo mënyrë e kontaktimit do të zgjasë deri me 01.06.2014, ku pastaj të atit duhet t'i mundsohet kontakti me fëmijën dy (2) herë në muaj, të premten e dytë dhe të katërt të muajt, ku e paditura duhet t'ia dorëzojë fëmijën paditësit të premten prej orës 16.00 deri të hënën kur paditësi duhet të dorëzojë fëmijën në ora 09.00.
- T'i mundsohet të atit kontakti me fëmijën ditën e dytë të festave shtetërore dhe fetare.
- T'i mundsohet të atit kontakti me fëmijën në ditëlindjen e saj, ashtu që vajza një vit të festojë ditëlindjen me të ëmën duke filluar nga ditëlindja e ardhshme me 10.01.2014 kurse vitin tjetër me të atin, dhe kjo mënyrë e kontaktimit të vazhdojë edhe në vitet në vijim.
- Të gjitha kontaktet e lartcekura në mes të atit _____ me të miturën _____ do të bëhen përmes Qendrës për Punë Sociale në Lipjan.

V. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi fillimisht kundër të paditurës ka ushtruar padi për anulim të martesës ndërsa gjatë seancës së shqyrtimit kryesor datë 13.06.2013 ka bërë precizimin e padisë dhe kërkesëpadisë dhe ka

kërkuar që të bëhet zgjidhja e martesës me shkurorëzim.

Pas kësaj gjykata ka kërkuar nga qendra për punë sociale në Prishtinë dhe ajo në Lipjanë që të mbajn seancat për tentim pajtimi të bashkëshortëve dhe lidhur me dhënien e anamnesës sociale sa i përket çështjes së besimit të fëmies në ruajtje, mbajtje, edukim si dhe mbajtjes së kontakteve me prindër.

Pas kësaj gjykata ka caktuar sencen e shqyrtimit kryesor me datën 21.11.2013 dhe gjykimin e ka nisur nga fillimi për shkak të ndryshimit të përbërjes së trupit gjykues. Edhe gjatë kësaj seance paditësi e ka precizuar kërkesëpadinë dhe ka kërkuar që martesë të zgjidhet me anë të shkurorëzimit. Ka theksuar se arsyet pse kërkon zgjidhjen e martesës qëndrojnë në faktin se marrëdhëniet bashkëshortore në mes tyre janë çrregulluar në atë masë sa që jeta e tyre e përbashkët është e pamundur dhe nuk ka gjasa që të pajtohen për të jetuar së bashku. Ka kërkuar që me rastin e zgjidhjes së martesës fëmija i mitur _____ t'i besohet atij në ruajtje, kujdes dhe edukim nga fakti se ai ka mundsit financiare që të kujdeset për të pa pasur nevojë që e paditura të kontribuoj në mbajtje financiare, ndërsa e paditura nuk është e aftë dhe e denjë për t'u kujdesur për vajzën. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në emër të taksës gjyqësore për padi.

E paditura nuk e ka kontestuar kërkesën e paditësit që martesë të zgjidhet me shkurorëzim e nga fakti se raportet në mes tyre janë keqësuar, që 1 vit e tre muaj janë ndarë dhe nuk ka gjasa që të arrijnë pajtim për të jetuar së bashku. E ka kundërshtuar kërkesën e paditësit që atij t'i besohet vajza në ruajtje dhe edukim nga fakti se që kur me të është ndarë ai asnjëherë nuk ka treguar kujdes dhe gatishmëri që me vajzën të kontaktoj. Ka theksuar se prej që janë ndarë vajza vetëm dy herë ka folur me të atin dhe atë vet ajo e ka shtyrë vajzën që ta thirr në telefon për të biseduar. Ka theksuar se tani nuk është në marrëdhënie pune dhe mbi këtë bazë ka kërkuar nga gjykata që me rastin e vendosjes ta detyroj paditësin që në emër të mbajtjes-alimentacionin për vajzën e mitur të paguaj një shumë të cilën gjykata e vlerëson të arsyeshme sipas ligjit. Ka kërkuar që me rastin e vendosjes t'i kthehet mbiemri i vajzërisë para lidhjes së martesës. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata për të vendosur drejtë në këtë çështje kontestimore në procedurën e provave, bëri shikimin dhe leximin e provave dhe atë: certifikata e martesës numër të referencës _____ datës 10.12.2009, certifikata e lindjes me numër të referencës _____ datës 15.02.2010, në emër të _____, deklarata e dhënë nga _____ datës 12.03.2013, vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës në bazë të kërkesës nr.885 datë 24.09.2012, kontrata e punës nr.32 në emër të paditësit e datës 01.01.2013, anamneza sociale e lëshuar nga Qendra për Punë Sociale Kodra e Diellit Prishtinë me numër 998/2013 datës 11.07.2013, anamneza sociale e lëshuar nga Qendra për Punë Sociale në Lipjan me nr.577-561 datës 26.08.2013, leximi i raportit të Qendres Klinike Universitare në Prishtinë për të paditurën pa datë.

Pas vlerësimit të provave të administruara e në pajtim me dispozitat e nenit 8 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në mes palëve ndërgjyqësore nuk është kontestuese se marrëdhëniet bashkëshortore janë çrregulluar deri në atë shkallë sa që jeta e tyre e përbashkët është bërë e padurueshme dhe si rezultat i kësaj bashkësi martesore edhe faktikisht është shkëputur nga data 28.08.2012.

Duke u nisur nga fakti se e paditura nuk e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësit për zgjidhjen e martesë me shkurorëzim, kjo gjykatë, në kuptim të nenit 68 par.4 të Ligjit për Familjen i Kosovës, padinë e paditësit e konsideron si propozim i përbashkët për zgjidhjen e martesës me marrëveshje dhe nuk i heton faktet sa i përket shkaqeve të zgjidhjes së martesës në kuptim të nenit 69 dhe martesën e zgjidh në bazë të nenit 68 par 2 të Ligjit në fjalë.

Në bazë të certifikatës së martesës shihet se bashkëshortët kanë lidh martesë me dt. 09.12.2009 pranë zyrës së ofiqarisë në Prishtinë. Nga certifikatat e lindjes vërtetohet se nga kjo bashkësi martesore kanë lindur të miturën _____, e lindur me 10.01.2010 e lindur në Prishtinë, nga i ati ____ dhe e ëma _____.

Paditësi me padi ka kërkuar që ati ti besohet vajza në ruajtje kujdes dhe edukim përkatsisht nënës së tij, ndërsa e paditura këtë e ka kundërshtuar.

Nuk ishte kontestuese që vajza e mitur pas ndarjes së prindërve që nga data 28.08.2012 jeton me nënën e saj. Për të vendosur lidhur me çështjen se cilit nga prindërit t'i besohet fëmija në përkujdesje dhe edukim gjykata ka marr raportet e dy qendrave për punë sociale, asaj në Prishtinë dhe Lipjan. Qendra për punë sociale në Prishtinë në raportin e saj, lidhur me këtë çështje, ka dhënë mendim dhe propozim që duke i marrë parasysh kushtet e paditësit për rritjen e vajzës pse mos t'i besohet edhe atij dhe se për këtë i mbetet gjykatës që të vendos për rastin. Qendra për punë sociale në Lipjan në raportin e saj ka dhënë mendimin përfundimtar me një konstatim që shikuar nga ana psiko-fizike nëna i plotëson të gjitha kushtet që të përkujdeset për fëmijën e saj.

Sa i përket besimit të fëmijës së mitur _____ gjykata vlerësoi raportet e të dy Qendrave për Punë Sociale në Prishtinë dhe Lipjan dhe pasi i mori për bazë edhe rrethanat e tjera vendosi që vajzat e mitura t'i besohet në ruajtje mbajtje dhe edukim të paditurës gjegjësisht nënës, për arsye se vajza e mitur më tepër është e lidhur emocionalisht me nënën, sepse që nga momenti i ndarjes jeton së bashku me nënën si dhe për shkak të moshës së re të saj i nevojitet kujdesi i vazhdueshëm i nënës. Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit dhe duke ju referuar neneve 140 dhe 144 të Ligjit mbi Familjen ka shqyrtuar të gjitha rrethanat e rëndësishme objektive dhe ato subjektive të cilat janë më rëndësi për zhvillimin e drejtë psikik e fizik dhe për edukimin e fëmijës, e në radhë të parë është nisur nga interesi më i mirë i fëmijës.

Në kuptim të nenit 290 par. 1 të Ligjit për Familjen i Kosovës, prindërit janë të detyruar të ofrojnë mbajtje financiare për fëmijët e tyre të mitur. Shuma e detyrimit ushqimor caktohet në përpjesëtim me mundsitë e detyruesit për ushqimi dhe brenda kufijve të nevojave të kërkuesit të ushqimit, duke pasur parasysh moshën dhe nevojat e fëmijëve si dhe mundsitë e personit që ka për detyrë të japë ushqimin, gjykata do t'i marrë parasysh të gjitha të ardhurat e tij dhe mundsitë reale që të realizojë fitimin si dhe nevojat e tij vetanake dhe detyrimin ligjor të ushqimit. Rrethanat në bazë të të cilave caktohet ushqimi vlerësohen në kohën e vendosjes lidhur me ushqimin.

Mbi këtë bazë gjykata vlerësoi kërkesën e të paditurës për caktimin e pagesës për ushqimi për të miturën dhe vendosi që paditësi – babai i të miturës të kontribuoj në edukimin dhe kujdesin për të miturën ashtu që i njëjti proporcionalisht me mundsit e tij materiale do të paguaj për çdo muaj nga 70 €, sepse sipas pohimit të tij dhe kontratës së punës rezulton që paditësi është në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar në “N.H.T SIRUS-B” dhe merr pagë mujore në shumën prej 300€, ndërsa e paditura është e pa punë dhe nuk realizon të ardhura personale.

Sa i përket lartësisë së ushqimit, kjo Gjykatë konsideron se shuma e caktuar është në përpjesëtim me mundsitë e paditësit dhe se u përgjigjet nevojave dhe kërkesave të vajzës së mitur, duke pasur parasysh edhe kontributin e të paditurës dhe mundsitë e saj për ushqimi. Në këtë rast kemi të bëjmë me zbatimin e vlerësimit të lirë nga neni 323 të LPK, sipas të cilit kur gjykata vërteton se palës i takon e drejta që t'i shpërblehet dëmi me të holla, por pamundsitë që të caktohet shuma e të hollave, apo se një gjë e tillë do të mund të bëhej me vështirësi shumë të mëdha, gjykata për këtë do të vendosë sipas çmuarjes së lirë.

Vendimin për rregullimin e kontakteve personale të fëmijëve me prindërin, që nuk e ushtron të drejtën prindërore, gjykata e merr në radhë të parë duke e marrë për bazë interesin e fëmijës që të sigurohet mbajtja e lidhjes ndërmjet fëmijës dhe prindit, me qëllim të kultivimit të ndjenjave dhe raporteve të ndërsjella të tyre. Nisur nga kjo e duke e marrë për bazë edhe faktin që e paditura nuk e ka kundërshtuar çështjen e kontaktit të vajzës me paditësin, gjykata vlerëson se kontakti personal i paditësit me fëmijën e mitur të caktohet si në pikën V të dispozitivit të aktgjykimit, nga këto arsye u vendos që në gjashtëmujorin e parë vajza të kontakton me të atin në orar më të shkurtuar, ashtu që gradualisht të njifet me të atin, të rikrijoj kontaktin e humbur, të rifitoj sigurinë dhe besimin për të qenë në prani të tij. Besohet që një periudhë gjashtëmujore është e mjaftueshme që i ati dhe vajza të krijojnë një lidhje të shëndoshë prind – fëmijë për të krijuar bazën për kontakt më të gjatë dhe atë duke i dhënë përparësi interesit të fëmijës për zhvillimin e drejtë psikik, fizik dhe për edukimin e saj.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale bazohet në dispozitën e nenit 347 të LFK-së, dhe gjykata vendosi që secila palë ti heqë shpenzimet e veta.

Kryetari i trupit gjykues - gjykatësi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të kopjes së aktgjykimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.

Mjetet e goditjes në kontestet martesore

Mjetet e goditjes së aktgjykimit në këto konteste janë dy llojesh: a) mjetet e zakonshme të goditjes dhe b) mjetet e jashtëzakonshme të goditjes. Me të parat goditen aktgjykimet që nuk kanë marrë formën e prerë, kurse me të dytat gjykimet që kanë marrë formën e prerë.⁹¹

Mjete e zakonshme të goditjes - Ankesa është mjet i rregullt i goditjes me të cilin pala e pakënaqur në afat prej 15 ditësh nga marrja së kopjes së aktgjykimit të shkallës së parë mund ta kundërshtoj atë. Lidhur me ankesën vendos gjykata e shkallës së dytë e në rastin tonë vendos Gjykata e Apelit.⁹²

Aktgjykimi me të cilin është zgjidhur martesa sipas propozimit të përbashkët të bashkëshortëve për shkurorëzim me marrëveshje të përbashkët mund të goditet me ankesë vetëm për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore ose për arsye se propozimi është dhënë në lajthim ose nën ndikimin e shtrëngimit ose të mashtrimit⁹³. Shkaqet për ankesë kundër këtij aktgjykimi përputhen me ato për ankesë kundër aktgjykimit në bazë të pohimit ose tërheqjes së kërkesës.

Kundër aktgjykimit me të cilin refuzohet padia për shkurorëzim apo për anulim të martesës ankesa lejohet për të gjitha shkaqet e parapara me Ligjin e Procedurës Kontestimore.

Mjetet e jashtëzakonshme të goditjes – me dispozitën e nenit 88 të LFK-së nuk lejohet paraqitja e mjeteve të jashtëzakonshme juridike kundër aktgjykimit të formës së prerë me të cilin është

⁹¹ Dr. Faik Brestovci, E drejta e procedurës civile, Prishtinë 1986, fq.420.

⁹² Shih LPK, neni 176 lidhur me nenin 17,17 të LGJ.

⁹³ Shih LFK, neni 87.

zgjidhur apo anuluar martesë. Mirëpo, kundër atij me të cilin është refuzuar padia janë të lejuara mjetet e tilla të goditjes.⁹⁴

Mjetet e jashtëzakonshme të goditjes nuk janë të lejuara vetëm sa i përket pjesë së aktgjykimit me të cilin është zgjidhur martesë ndërsa në pjesë të tjera kurë është vendosur për mbajtjen dhe kujdesin për fëmijë, mbajtjen e bashkëshortit të pasiguruar etj, këto mjete janë të lejuara.

FORMAT E VEÇANTA TË MBROTJES SË FËMIJËVE PA KUJDES PRINDËROR

Birësimi (Adoptimi)

Birësimi është institucion i vjetër juridik dhe shoqëror. Mund të thuhet se kanë qenë dy qëllime kryesore të birësimit. Njëri ka qenë mbrojtja e pasurisë së qytetarëve të pasur, kurse qëllimi tjetër ka qenë ruajtja e vazhdimësisë së familjes, traditës dhe kultit të familjeve të qytetarëve pa fëmijë.

Vlenë të theksohet se përkundër qëllimeve të lartëcekura, disa vende të botës asnjëherë nuk e kanë njohur institutin e birësimit, madje të njëjtin edhe e kanë ndaluar me norma ligjore.

Llojet e birësimit

Duke pasur parasysh efektet juridike të cilat i shkakton birësimi, si dhe shkallën e integritetit të të birësuarit në familjen e birësuesit, teoria shkencore juridike njeh dy lloje të birësimit: a) birësimi i plotë dhe b) birësimi jo i plotë.

Birësimi i plotë (adoptio plena)– Themelohet kur në mes të birësuesit dhe të birësuarit vendosen marrëdhënie të njëjta sikurse mes prindërve natyrore dhe fëmijëve, por edhe me persona të tjerë siç janë ata të gjinisë së gjakut. Birësimi në mes të palës birësuese dhe të birësuarit themelon të njëjtat të drejta dhe detyrime sikurse ato që ekzistojnë në mes të prindërve dhe fëmijëve. Birësuesi regjistrohet si prind i të birësuarit (neni 190 i LFK-së) në regjistrin amë të të lindurëve. Kjo nënkupton se i birësuarit i shkëput lidhjet me familjen e tij të origjinës. Ai futet në familjen e birësuarit me të drejta dhe detyrime sikurse të kishte lindur prej birësuesit. Me birësim të plotë fëmija i humb të gjitha të drejtat dhe detyrimet ndaj të afërmeve të tij biologjik. Mirëpo në të njëjtën kohë këto të drejta dhe detyrime i fiton në raport me birësuesin dhe të afërmit e tij biologjik. Ky lloj i birësimit është i pashkëputshëm.

Birësimi jo i plotë (adoptio semi plena). – Kuptohet vendosja e marrëdhënieve prindërore vetëm në mes të birësuesit dhe fëmijës që birësohet si dhe pasardhësve eventual të fëmijës që birësohet, ndërkohë që janë të mundshme kufizimet në pikëpamje të të drejtave përkitatzi me mbiemrin dhe të drejtën trashëgimore. Tek ky lloj i birësimit, fëmija i birësuar edhe më tej mbetet anëtar i familjes së tij biologjike. Në fakt ai gëzon edhe më tej të drejtën trashëgimore dhe të mbajtjes ndaj prindërve

⁹⁴ Dr. Faik Brestovci, E drejta e procedurës civile, Prishtinë 2002, fq.286

të vet biologjik. Ky lloj i birësimit është i shkëputshim dhe pas shkëputjes eventuale të tij, i birësuarit u kthehet prindërve të tij biologjikë.

Kush mund të jetë i birësuar . - Që një person të jetë i birësuar, duhet t'i plotësoj disa kushte:

- a. të jetë i lindur gjallë;
- b. të jetë fëmijë i mitur;
- c. të mos jetë në gjini gjaku me të birësuarin dhe
- d. fëmija që ka mbushur moshën 14 vjeç duhet ta jep pëlqimin se a dëshron të birësohet apo jo.

Kush mund të jetë birësues. – Birësuesi duhet t'i plotësoj këto kushte:

- a. të ketë zotësinë për të vepruar;
- b. të ketë cilësitë e nevojshme personale për ushtrimin e suksesshëm të të drejtave dhe detyrimeve prindërore;
- c. të mos vuaj nga ndonjë sëmundje ngjitëse që do ta rrezikonte shëndetin e fëmijës;
- d. të ketë së paku 21 vite;
- e. të jetë qytetar i Kosovës.

Fëmijën e mitur mund ta birësojnë edhe bashkëshortët. Kur ata e birësojnë fëmijën e mitur, njëri prej bashkëshortëve duhet ta ketë moshën 25 vjeçare, kurse tjetri moshën 21 vjeçare (neni 178 i LFK-së). Nëse fëmijën e birëson vetë njëri bashkëshort, kërkohet edhe pëlqimi i bashkëshortit tjetër.

Themelimi i birësimit

Themelimi i birësimit është akt juridik. Procedura e birësimit është në kompetencë të gjykatës dhe atë Gjykatave Themelore në procedurë jashtëkontestimore, për dallim nga ligji i mëparshëm për Martesën dhe Marrëdhëniet Familjare, në bazë të të cilit birësimi themelohej përpara Organit të Kujdestarisë. Gjykata mund të kërkoj këshilla nga Organi i Kujdestarisë gjatë marrjes së vendimit mbi adoptim.

Birësimi si rregull nuk do të themelohet derisa birësuesi të kujdeset për të birësuarin për një kohë të arsyeshme të përcaktuar nga gjykata, por që nuk kalon periudhën tre muajshe. Kjo periudhë do të iniciohet, mbikëqyret dhe vlerësohet nga organi i kujdestarisë. Në procedurën e birësimit përjashtohet publiku. Procesverbali dhe dokumentet e themelimit të birësimit paraqesin sekret zyrtar. Procedura e birësimit fillon me kërkesën për birësim të birësuesit. Kompetenca territoriale caktohet sipas vendbanimit të fundit të parashtruesve të kërkesës për adoptim, si dhe në bazë të vendbanimit të të adoptuarit. Nëse gjykata në bazë të provave të siguruar dhe të bashkëngjitura si

dhe çmuarjes së të gjitha rrethanave të tjera, konstaton se adoptimi nuk është i dobishëm për të adoptuarin, ajo do të marrë aktvendimin për refuzimin e kërkesës për birësim. Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 ditëve nga dita e marrjes së aktvendimit. Nëse gjykata konstaton se janë plotësuar kushtet për birësim të parapara me LFK, ajo do të hemelojë birësimin.

Për themelimin e birësimit nevojitet prania e birësuesit, e bashkëshortit të tij, e prindërve, përkatësisht e kujdestarit të të birësuarit, si dhe prania e të birësuarit nëse është mbi moshën 10 vjeçare. Deklarata e pëlqimit të pjesëmarrësve duhet të shënohet në procesverbalin e procedurës, i cili pastaj do tu lexohet pjesëmarrësve. Gjkata kompetente, i'a dërgon menjëherë procesverbalin e themelimit të birësimit organit kompetent për regjistrim në librat amë të të lindurëve, palës dhe organit të kujdestarisë. Në këtë rast pala birësuese regjistrohet si prindi i të birësuarit dhe fëmija e merr mbiemrin e personit birësues sikur të ishte mbiemri i tij. Është me rëndësi të ceket se nuk mund të zhvillohet procedurë e vërtetimit të amësisë apo të atësisë së fëmijës së birësuar.

Nuk mund të ketë themelim të birësimit pas vdekjes së fëmijës.

Shuarja e birësimit

Me nenin 195 të LFK-së, është e paraparë se birësimi mund të shuhet vetëm në bazë të rregullave të parapara me këtë ligj, përkatësisht me dispozitat nga neni 196-200 të këtij ligji. Nga kjo del se kemi disa lloje të shuarjeve të birësimit, siç janë: a) shuarja me anulim; b) shurja e birësimit për shkak të keqësimit të mirëqenies së fëmijës; dhe c) shuarja e birësimit ex officio nga gjykata.

Shuarja me anulim (neni 196 i LFK-së). – Gjkata mund të anulojë marrëdhënien e birësimit në bazë të kërkesës, nëse kjo marrëdhënie ka qenë e themeluar pa kërkesë të birësuesit, pa pëlqimin e fëmijës ose të prindit. Padia për anulim mund të paraqitet brenda afatit prej 6 muajsh nga dita që është marrë në dijëni shkak i anulimit, e më së voni brenda një viti nga dita e themelimit të birësimit.

Shuarja e birësimit për shkak të keqësimit të mirëqenies së fëmijës. – Përjashtimisht birësimi mund të shuhet edhe kur keqësohet mirëqenia e fëmijës, por vetëm nëse këtë e kërkojnë interesat themelore të fëmijës, ngase në të kundërtën nuk do të lejohet shuarja e marrëdhënies së birësimit. (neni 197 i LFK).

Shuarja e birësimit ex officio nga gjykata. – Kjo situatë mund të ndodhë në rastet kur pavarësisht faktit se në procedurën e themelimit të birësimit kanë qenë të respektuara të gjitha procedurat dhe kushtet e kërkuara me ligj, gjykata vlerëson se vazhdimi i marrëdhënies së birësimit do të ishte i dëmshëm për fëmijën dhe mirëqenien e tij. Me nenin 198 të LFK-së, janë të parapara edhe shkaqet e shuarjes ex officio.

Përndryshe shuarja e birësimit ka efekt vetëm për të ardhmen. Me rastin e shuarjes së birësimit, fëmija e humb të drejtën që të bartë edhe ma tutje mbiemrin e birësuesit, përpos nëse gjykata vendos se është në interesin e fëmijës që të vazhdojë ta mbajë këtë mbiemër. Po ashtu marrëdhënia

e të birësuarit dhe pasardhësve të tij eventual, me të afërmit e birësuesit ndërpritet së bashku me të drejtat dhe detyrat e krijuara.

Vendosja e organizuar në familje

Vendosja e fëmijës në familje tjetër është formë e organizuar shoqërore e përkujdesjes ndaj fëmijëve pa përkujdesje prindërore ose të lënë pas dore në edukimin, si dhe fëmijët me zhvillim të penguar. Organi i kujdestarisë duhet në mënyrë të gjithanshme të vërtetojë arsyet për shkak të të cilave ekziston nevoja që fëmija të jetë në përkujdesje në këtë mënyrë. Ai duhet të vërtetojë se a është fëmija pa prindër apo pa përkujdesje prindërore, e veçanërisht nëse fëmija i ka prindërit apo njërin prind, zhvillimi i tij a është i penguar me situatën në të cilën gjendet familja e tij. Fëmijëve pa prindër apo pa kujdesin prindëror u garantohet vendosja në familje deri sa të mos aftësohen për jetë dhe punë të pavarur. LFK-ja në parag. 3 të nenit 204, normon se vendosja është e përcaktuar me pëlqim paraprak të prindërve biologjik të fëmijës dhe si rregull vendosja do të zgjasë për aq sa do të vazhdonin rrethanat të cilat e kanë shkaktuar atë.

Gjithsesi organi i kujdestarisë pas vendosjes së fëmijës në familjen tjetër, i ndërmerret menjëherë të gjitha masat e domosdoshme që të adresojë dhe në të ardhmen të mënjanojë të gjitha rrethanat të cilat e kanë bërë të domosdoshme vendosjen në familje tjetër. Po ashtu organi i kujdestarisë ka për obligim të përcjellë zhvillimin e të miturit dhe të verifikon se ruajtja, kujdesi, edukimi dhe arsimimi a janë duke u realizuar në harmoni me dispozitat e këtij ligji dhe kontratës mbi vendosjen.

Të drejtat dhe detyrimet e prindërve

Sipas parag. 5 të nenit 203 të LFK-së, të drejtat dhe detyrat e prindërve dhe kujdestarit të fëmijës kufizohen për kohëzgjatjen e vendosjes në familje. Një përkufizim i tillë nuk na jep shpjegim të duhur dhe adekuat mbi llojin e të drejtave të cilat gjatë kohës së vendosjes janë të kufizuara dhe në ç'masë, mirëpo duke u nisur nga ky institut konsiderojmë se të drejtat e edukimit dhe të mirërritjes së fëmijës pushojnë për prindërit e fëmijës për aq kohë sa do të zgjasë vendosja në familje tjetër.

Prindërit apo kujdestari i fëmijës mund të kërkojnë nga organi i kujdestarisë kompetente për vendosjen e fëmijës në familje tjetër, që të bëjë rishikimin e zbatimit të mirëfilltë të kujdesit ndaj fëmijës, po që se eventualisht vërenë se ky kujdes në familjen në të cilën është vendosur fëmija, mungon apo është anashkaluar. Gjithashtu prindërit ushtrojnë të drejtat tjera prindërore siç janë të drejtat e natyrës pasurore të fëmijës duke bërë administrimin e pronës së fëmijës, përfaqësimin, si dhe të drejtat tjera përveç nëse këto të drejta u janë marrë me vendim të posaçëm të organit kompetent.

Të drejtat dhe detyrimet e familjes, e cila bën pranimin e vendosjes së fëmijës në familje

Vendosja në familje bëhet në familjen e cila mund t'i përmbushë me sukses detyrimet prindërore, posaçërisht në pikëpamje të kujdesit, të edukimit dhe të aftësimit të drejtë të fëmijës për jetë të pavarur. Paragrafi 2 i nenit 205 të LFK-së kërkon që vendosja e fëmijës në familje do të bëhet vetëm në familjen në të cilën prindi ose prindërit të cilit i besohet fëmija i plotëson të gjitha kushtet e parashikuara me Ligjin për Familjen, për fëmijë dhe përgjegjësinë prindërore. Para së gjithash familja pranuese ka për detyrë që fëmijën ta ruajë, ta mbajë, të kujdeset për mirëritjen, edukimin dhe arsimimin e tij. E njëjta ka për detyrë që t'i informojë prindërit biologjik dhe organin e kujdestarisë për të gjitha çështjet e rëndësishme lidhur me realizimin e detyrimeve të cekura më lartë. Familja pranuese në të cilën është vendosur fëmija, ka të drejtë në shpërblim. Gjithashtu kjo familje ka për detyrë që t'i bëjë të mundur vizitat e prindërve të fëmijës, përveç kur Organi i Kujdestarisë cakton ndryshe për interes të fëmijës.

Kompetenca ligjore për vendosje

Ligji për Familjen ndër të tjera ka normuar se organ kompetent për vendosjen e fëmijës në familje tjetër është Organi i Kujdestarisë i komunës në territorin e së cilit fëmija ka vendbanimin apo vendqëndrimin. Siç e kemi përmendur edhe më lartë para marrjes së vendimit për vendosje në familje, Organi i kujdestarisë siguron dokumentacionin e plotë mbi të gjitha të dhënat me rendësi për marrjen e vendimit për vendosjen e fëmijës në familje, si dhe për familjen në të cilën vendoset fëmija.

Zgjedhja e familjes në të cilën fëmija vendoset bëhet me propozim të grupit profesional të Organit të Kujdestarisë, i cili grup profesional zakonisht përbëhet nga punëtori social, pedagogu, psikologu, mjeku, si dhe ekspertë tjerë varësisht nga natyra e shkaqeve të cilat shkaktojnë vendosjen e fëmijës në familje tjetër. Konsiderojmë se vendosja e fëmijës në familjen tjetër kërkon përgatitje serioze, duke aplikuar metodat e punës profesionale dhe sociale. Para dhe gjatë kohës së zhvillimit të vendosjes është e nevojshme përgatitja e fëmijës, prindërve, familjes në të cilën fëmija duhet të vendoset. Gjatë qëndrimit të fëmijës e veçanërisht në fillim zhvillohet trajtim i veçantë i njoftimit të fëmijës me familjen dhe përshtatjes së tij, puna edukuese me familjen, bashkëpunimi me shkollën etj.

Neni 208 parag.1 parasheh obligimin e Organit të Kujdestarisë që të lidh kontratë me shkrim me njërin prej prindërve të familjes në të cilën do të vendoset fëmija, e kjo pas nxjerrjes së vendimit mbi vendosjen e fëmijës në familje. Nga aspekti i të drejtës civile kontrata mbi vendosjen familjare përfaqëson kontratë të dyanshme me barrë e cila lidhet në mes të Organit të Kujdestarisë dhe personit i cili në emër të familjes merr obligimin se do të kujdeset për fëmijën si prind.

Përveç të cekurave si më lartë, Organi i Kujdestarisë mbikëqyrë zhvillimin e fëmijës, siguron se mbrojtja, kujdesi dhe edukimi i fëmijës bëhet në përputhje me dispozitat ligjore, si dhe me dispozitat e kontratës për vendosjen e fëmijës. Gjithashtu i njëjti ka obligim që të informojë

familjen në të cilën është vendosur fëmija për mangësitë në sigurimin e kujdesit, mbrojtjes dhe edukimit të fëmijës që kanë shkaktuar vendosjen e fëmijës, duke ju dhënë propozime për mënjanimin e këtyre rrethanave në të ardhmen.

Përfundimi i vendosjes së fëmijës në familje

LFK-ja ka normuar taksativisht kushtet ligjore të cilat duhet të plotësohen për pushimin e vendosjes së fëmijës në familje, si në vijim:

1. me marrëveshjen e palëve kontraktuese,
2. me heqjen dorë nga kontrata,
3. me arritjen e moshës madhore të fëmijës, përkatësisht me aftësimin e tij për jetë të pavarur ose kur fëmija martohet para kësaj moshe,
4. me adoptimin e fëmijës,
5. me vdekjen e njërit nga prindërit e familjes, i cili ka lidhur kontratën për vendosje në familje.

Ndërsa para.2 i nenit 209 ka normuar se në rast të vdekjes së njërit nga prindërit e familjes, kontrata për vendosje në familje mbetet në fuqi nëse prindi tjetër brenda afatit prej një muaji e njofton Organin e Kujdestarisë dhe nëse disponon me garancionin se familja në të ardhmen do t'i plotësojë kushtet e përcaktuara me ligj.

Kujdestaria

Kujdestaria është institut me karakter shoqëror dhe i rëndësisë gjithëpërfshirëse shoqërore. Ajo përfaqëson pjesën e kujdesit shoqëror mbi njeriun, veçanërisht mbi personat të cilët nuk janë në gjendje që të kujdesen për vete. Këtu bëjnë pjesë në rend të parë të miturit, ku për shkak të moshës gjithnjë ju nevojitet kujdesi, ndihma dhe mbrojtja e të rriturve dhe shoqërisë. Përveç këtyre, edhe personat e moshës madhore mund të vijnë në gjendje e cila e përjashton aftësinë e tyre që vet të kujdesen për vete dhe për të drejtat e interesat e tyre (personat e sëmurë psikikisht, personat me zhvillim të pamjaftueshëm psikikë dhe personat tjerë).

Kur është fjala për të miturit, të gjithë nuk janë në pozitë të njëjtë. Në pozitë më të mirë gjenden ata të mitur të cilët i kanë të dy, apo së paku njërin prind dhe të cilët prindër janë në gjendje që të kujdesen për ta. Në pozitë më të vështirë janë të miturit pa prindër, apo pa kujdesin prindëror. Megjithatë as këta nuk janë lënë pa përkujdesje, pasi që për ta kujdeset shoqëria dhe shteti.

Ligji për Familjen ka paraparë parimet e kujdestarisë për të miturit dhe të rriturit. Nga dispozitat mbi kujdestarinë, si dhe nga dispozitat mbi të drejtën familjare në përgjithësi përcaktojnë katër parime themelore të kujdestarisë:

- a. parimi i karakterit shoqëror dhe i rëndësisë gjithë shoqërore të kujdestarisë;
- b. parimi i mbrojtjes së veçantë shoqërore të personave nën kujdestari;
- c. parimi i kujdesit gjithëpërfshirës shoqëror mbi personat nën kujdestari dhe
- d. parimi i kujdesit prioritar mbi personalitetin;

Në bazë të dispozitave të LFK-së, organet shtetërore kanë për detyrë t'u sigurojnë mbrojtje të veçantë fëmijëve të mitur pa përkujdesje prindërore, personave madhor pa zotësi veprimi apo me zotësi të kufizuar veprimi, e që nuk janë në gjendje për t'u kujdesur për pasurinë dhe për interesat e veta. Si rrjedhojë, mund të konstatojmë se qëllimi i vendosjes nën kujdestari është:

- a. që fëmijët e mitur të gëzojnë mbrojtje të veçantë nga institucionet publike kur prindërit e tyre nuk kanë mundsi për të ushtruar kujdesin prindëror për shkak të vdekjes së prindërve, për shkak se të njëjtit nuk njihen, janë shpallur të zhdukur ose u është hequr e drejta prindërore, apo çfarëdo shkakut tjetër kur gjykata vendos në të mirë të mirëqenies së fëmijës;
- b. që personave, të cilët me vendim të gjykatës plotësisht apo pjesërisht u është hequr zotësia e veprimit;
- c. që titullarëve të panjohur të të drejtave të pasurisë së supozuar dhe pa përfaqësues statusor t'u sigurohet mbrojtja e të drejtave, organi i kujdestarisë ka të drejtë të emërojë kujdestar për raste të veçanta (neni 229 parag. 1 i LFK-së).

Organi i kujdestarisë

Ligji për Familjen në nenin 6 përcakton se organ kompetent për mbrojtjen institucionale të të drejtave është Organi i Kujdestarisë. Në këtë nen ndër të tjera është normuar se punët e mbrojtjes dhe të ndihmës familjare do t'i ushtron organi i kujdestarisë i cili është një organ komunal administrativ kompetent për çështje sociale dhe përbëhet nga një grup i ekspertëve me përvojë profesionale në fushën e veçantë të përgjegjësisë.

Më tutje në parag. 4 të nenit 6 të LFK-së janë përcaktuar autorizimet e organit të kujdestarisë në raport me mbrojtjen institucionale të të drejtave. Kështu që ky organ është i autorizuar të bëjë propozime për mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të fëmijëve, të paraqesë fakte të cilat nuk janë përfshirë, të propozojë administrimin e provave të domosdoshme, të ushtrojë mjetet juridike dhe të ndërmer veprime tjera gjyqësore. Ndërsa gjykata në këto raste është e obliguar të ftojë në gjykatë Organin e Kujdestarisë pjesëmarrës në procedurë në të gjitha seancat gjyqësore dhe t'i dorëzojë atij të gjitha vendimet gjyqësore.

Rol të veçantë Organi i Kujdestarisë ka në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror (kujdestaria, strehimi familjar, strehimi rezidencial dhe adoptimi), të cilët siç e kemi cekur më lartë gëzojnë mbrojtje të posaçme shoqërore. Në këtë drejtim neni 158 i LFK-së normon se vendimin mbi zbatimin e cilësdo formë të mbrojtjes së fëmijëve pa kujdes prindëror merret pas shqyrtimit të hollësishëm të secilit rast individualisht, ndërsa organi kompetent do të nxjerrë përfundim për formën e mbrojtjes së familjes për fëmijën që i plotëson kërkesat e fëmijës në masë të madhe.

Edhe Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare (me ndryshimet e tij), në nenin 7 ndër të tjera përcakton rolin e Qendrave për Punë Sociale dhe obligimin e kësaj të fundit që të themelojë Organin e Kujdestarisë. Gjithashtu ky ligj përcakton detyrimet e QPS-së, gjegjësisht Organit të Kujdestarisë në lidhje me shërbimet që duhet të ofrojnë për fëmijët pa kujdes prindëror, ndërsa në parag. 1 të nenit 9 të këtij ligji theksohet detyrimi i këtyre institucioneve që në të gjitha çështjet lidhur me ofrimin e shërbimeve për fëmijë dhe familje, interesi më i mirë i fëmijës duhet të jetë konsiderata e parë dhe më e rëndësishme. Kjo është në përputhje edhe me kërkesat që dalin nga Konventa për të Drejtat e Fëmijës. Posaçërisht me këtë ligj është përcaktuar detyrimi i Organit të Kujdestarisë që të zbatojë masat mbrojtëse institucionale në të gjitha rastet kur janë në pyetje të drejtat e fëmijëve pa kujdes prindëror.

Ligji i Procedurës Jokontestimore ndër të tjera përcakton se Organi i Kujdestarisë, në procedurën jokontestimore të cilën nuk ka të drejtë ta iniciojë, mund t'i kryejë të gjitha veprimet procedurale me qëllim të mbrojtjes së të drejtave dhe interesave juridike të të miturve dhe personave nën mbrojtje të posaçme, dhe sidomos të paraqet fakte relevante të cilat nuk i kanë paraqitur pjesëmarrësit e procedurës, të propozojë marrjen e provave dhe të përdorë mjete goditjeje të vendimeve.

Mënyrat e ushtrimit të kujdestarisë

Punët dhe detyrat e Organit të Kujdestarisë siç e cekëm edhe më lartë janë të shumta dhe të ndërlikuara.

Ky organ punët nga veprimtaria e vet i kryen në dy mënyra:

- a. të drejtpërdrejtë; dhe
- b. të tërthortë.

Mënyra e drejtpërdrejtë e kryerjes së punës nga ana e Organit të Kujdestarisë është në rastet kur ky i fundit i kryen detyrat e veta pa pjesëmarrjen e personave të tjerë. Kjo ndodhë në rastet kur ky organ nuk mund të gjejë dhe të caktojë persona të përshtatshëm për t'i emëruar kujdestarë, e të cilët do të ishin garanci për kryerjen e suksesshme të këtij funksioni. Kjo në praktikë mund të ndodhë p.sh. kur personat që ky organ i emëron si kujdestar nuk janë të detyruar për ta pranuar këtë funksion, ndërsa në rastet e tilla organi i kujdestarisë emëron kujdestar një punëtor nga radhët e punëtorëve të vet. Me vendimin mbi ushtrimin e drejtpërdrejtë të punëve të kujdestarit, përfaqësuesi i organit të kujdestarisë është i caktuar që të drejtojë detyrat në emër të kujdestarit.

Me kryerjen e tërthortë të detyrave të organit të kujdestarisë, kemi të bëjmë në rastet kur ky organ gjithë kujdesin për të drejtat, interesat dhe pasurinë e të kujdesurit ia beson një kujdestari, i cili detyrat i kryen nën kujdesin e organit të kujdestarisë. Në të gjitha rastet e tjera Organi i Kujdestarisë emëron dhe shkarkon kujdestarinë nga detyra, merr vendimin për vënien e personave nën kujdestari, i jep lejen kujdestarit për kryerjen e punëve të veçanta, mban evidencën e personave nën kujdestari etj.

Kujdestari

Kujdestari është person fizik, i aftë për të vepruar, i cili i ka vetitë dhe aftësitë e veta personale, i caktuar nga ana e organit të kujdestarisë, pas pëlqimit të tij paraprak, që në mënyrë të pavarur, me ndërgjegje dhe mirëbesim të kujdeset mbi personalitetin, të drejtat dhe interesat e të kujdesurit dhe që me ndërgjegje të drejtojë me pasurinë e tij, nën mbikëqyrjen e organit të kujdestarisë.

Në këtë mënyrë edhe LFK-ja e përcakton kujdestarin, duke normuar se në radhë të parë kujdestari caktohet në mesin e personave në mesin e familjes të personit nën kujdestari, ndërsa organi i kujdestarisë do të vendos nëse kjo është në interes të të kujdesurit, mirëpo nuk është i lidhur për këtë fakt, pasi që duke u bazuar në parimin e arsyeshmërisë dhe oportunitetit, mund të caktojë si kujdestar edhe ndonjë person tjetër, nëse është në interes të të kujdesurit. Nga kjo rezulton se nëse personi është nën përkujdesje të organit të kujdestarisë, ky organ ia cakton kujdestarin, i cili do të përkujdeset për mbrojtjen dhe ruajtjen e interesave dhe të drejtave të personit i cili është nën përkujdesje.

Ligji për Familjen ka paraparë edhe përjashtimet nga e drejta për kujdestari, duke normuar në nenin 237, se nuk mund të jetë kujdestar personi i cili paraprakisht ka humbur të drejtën ligjore ose prindërore të kujdestarisë me vendim të gjykatës, personi i cili pjesërisht apo plotësisht ka humbur zotësinë për të vepruar, interesat e të cilit janë në konflikt të dukshëm me interesat e personit që do të vihet nën kujdestari, si dhe personi, veçoritë personale ose interesi material i të cilit mund të jenë në konflikt me interesat e kujdestarit. Neni 237 pra rregullon çështjen e cilësive personale që duhet të ketë personi që emërohet për kujdestar, ndërsa personat me cilësi negative, qoftë të natyrës së përgjithshme apo në raport me personin nën përkujdesje janë të përjashtuar apriori nga e drejta për t'u caktuar në detyrën e kujdestarit.

Përveç, përjashtimeve nga e drejta në kujdestari, LFK-ja ka paraparë edhe detyrimin për të pranuar kujdestarinë. Ndërsa parag. 2 i nenit 238 ka normuar se personat e cekur në parag. 1, nuk janë të detyruar të pranojnë detyrën e kujdestarit nëse: nuk kanë mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeçare, nëse për shkak të ndonjë sëmundje apo të meta trupore nuk janë të aftë të kryejnë këtë detyrë, nëse në atë kohë kujdesen për dy apo më shumë fëmijë të huaj, nëse nëna e cila konsiderohet për këtë detyrë, ka fëmijën më të ri se shtatë vjet, si dhe nëse personi i cili tashmë kujdeset për tre ose më shumë fëmijë të tij të mitur.

Me rastin e caktimit të kujdestarisë, organi i kujdestarisë do të merr parasysht kërkesën e personit nën kujdestari nëse është në gjendje të shpreh interesin e tij. Gjithsesi nëse është në interes të personit i cili do të vihet nën kujdestari, Organi i Kujdestarisë mund të vendosë që të mos i caktojë kujdestar, por që detyrat e kujdestarit t'i përmbush drejtpërdrejtë. Ndërsa me aktvendim mbi ushtrimin e drejtpërdrejtë të punëve të kujdestarit përfaqësuesi i organit të kujdestarisë është i caktuar që të drejtojë detyrat në emër të kujdestarit. Organi i kujdestarisë i cili vendos për emërimin e kujdestarit i definon detyrat e kujdestarit dhe fushën e veprimit, ndërsa para marrjes së këtij vendimi ka për obligim që të informojë kujdestarinë për rëndësinë e kujdestarisë, të drejtat dhe detyrimet e tij.

LFK-ja ka normuar detyrat e kujdestarit në nenin 244 të tij, ku posaçërisht kujdestari është i detyruar që të kujdeset me mirëbesim për personalitetin, të drejtat dhe interesat e të kujdesurit, si dhe ta administrojë pasurinë e tij me kujdes, ndërsa në fund ta informojë Organin e Kujdestarisë për drejtimin e kujdestarisë. Kujdestari dhe Organi i kujdestarisë janë të detyruar që raportit të punës t'ia bashkëngjisë raportin e vlerësimit për këtë pasuri. LFK-ja në nenin 248 ka normuar edhe detyrimin e kujdestarit që të kërkojë leje të veçantë për kryerjen e punëve juridike në emër të të kujdesurit, ndërsa leja mund t'i jepet vetëm kujdestarit personalisht. Gjithashtu me nenin 250 të LFK-së është përcaktuar e drejta e kujdestarit, prokurorit të shtetit, komunës në territorin e së cilës personi nën kujdestari ka vendbanimin apo vendqëndrimin, personi i afërt në gjini me të kujdesurin, organizatat humanitare ose personat e tretë të pa përfshirë, që të parashtrajnë kërkesë para Organit të Kujdestarisë për të ndërmarrë veprime dhe masa mbrojtëse për të mbrojtur interesat e personit nën kujdestari.

Në fillim të çdo viti kujdestari duhet t'i paraqesë raport Organit të Kujdestarisë dhe të jap arsyetim për punën e tij gjatë vitit të kaluar, ndërsa raportet mujore jepen me kërkesë të Organit të Kujdestarisë dhe një raport final që ndërprejnë kujdestarinë e tij. LFK-ja ka normuar të drejtën e të kujdesurit dhe personave të afërm të tij të japin vërejtje në punën e kujdestarit dhe detyrimin e Organit të Kujdestarisë që të ndërmerr veprime të caktuara në raport me këto vërejtje. Me dispozitat e LFK-së janë rregulluar edhe shpërblimi për shpenzimet dhe dëmet e shkaktuara me rastin e caktimit të kujdestarit, si dhe shkarkimin dhe lirimin e kujdestarit nga detyrimet.

Kujdestaria ndaj të miturve

Ndërsa neni 216 i këtij ligji ka rregulluar kompetencën dhe qëllimet e kujdestarisë për të miturit, ku në parag. 1 është normuar se Organi i Kujdestarisë e vë nën kujdestari personin e mitur i cili nuk është nën kujdesin prindëror.

Kujdestari i personit të mitur ka për detyrë që të kujdeset me mirëbesim për personalitetin e të miturit, posaçërisht për shëndetin e të miturit, edukimin e arsimimin e tij dhe për zhvillimin e aftësisë për të bërë jetë të pavarur. Sa i përket kompetencës territoriale të Organit të Kujdestarisë e njëjta rregullohet me Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare, ndërsa përcaktohet se kjo

kompetencë caktohet në bazë të vendbanimit të personit i cili duhet të vihet nën kujdestari apo sipas vendqëndrimit të tij.

Kujdesi për shëndetin e të miturit përfaqëson detyrimin më të rëndësishëm të kujdestarit, pasi që e drejta themelore e fëmijës është e drejta në jetë, ndërsa detyra themelore e kujdestarit është mbrojtja e jetës dhe shëndetit të fëmijës si vlera më madhore. Si edukator kujdestari duhet ta zëvendësojë prindin, si në ndikimin pedagogjik ashtu edhe në atë emocional në zhvillimin e personalitetit të të miturit. Obligim i kujdestarit është që të aftësojë të miturin për jetë të pavarur, obligim ky që rrjedh nga detyra natyrore e shoqërisë.

Kjo detyrë e kujdestarit është me përparësi, në kuadër të funksionit dhe detyrave të tij. Kujdestari kur e dorëzon raportin përfundimtar pas mbushjes së moshës madhore të të kujdesurit në rend të parë duhet të arsyetojë se i kujdesuri i tij a është aftësuar dhe në ç'masë për jetë të pavarur. Në fund kujdestari është i autorizuar që t'i mbikëqyrë kushtet e vendosjes së të miturit, kushtet jetësore dhe ato higjienike dhe banesore të personave me të cilët personin nën kujdestari jeton. Qëllimi i kujdestarisë ndaj të miturit është që i njëjti të aftësohet për jetë dhe punë të pavarur, ndërsa për këtë arsye kujdestari duhet që në mënyrë sistematike dhe të pandërprerë ta udhëzojë të miturin në të gjitha punët, si dhe të këshillohet me të për secilën punë apo veprim të ndërmarrë, nën kushtin, nëse i mituri është në gjendje të kuptojë se për çfarë është fjala.

LFK-ja në nenin 217 ka paraparë se i mituri nën kujdestari që nuk i ka mbushur 14 vjet, nuk mund të ushtrojë vetë punë juridike, me përjashtim të veprimeve me rendësi të vogël. Ndërsa për veprimet të cilat nuk mund t'i ushtrojë vetë është e nevojshme leja e kujdestarit të tij për t'i bërë këto veprime të vlefshme, kurse për veprimet të cilat kujdestari nuk mund t'i ndërmarr vetë, i njëjti ka për detyrë që të kërkojë leje nga organi i kujdestarisë. Në anën tjetër paragrafi 2 i këtij neni përcakton të drejtën e të miturit që është nën kujdestari që themelon marrëdhënien e punës, mund t'i disponojë të ardhurat e tij personale dhe pasurinë që e ka fituar me punën e tij. Në rastin e tillë i mituri ka për obligim që të kontribuojë për ushqimin dhe arsimimin e tij në nivel të arsyeshëm. Kur i mituri themelon marrëdhënien e punës ai fiton të drejtat e parapara me kushtetutë dhe ligjin e punës, si të gjithë punëmarrësit e tjerë, përfshirë këtu edhe të drejtat për mbrojtje dhe siguri në punë.

Pra i mituri nën kujdestari i cili nuk ka mbushur moshën 14 vjet, nuk mund të ushtrojë vetë punë juridike, me përjashtim të veprimeve me rendësi të vogël (blerja e shtypit, e gjësendeve tjera të përditshme), mirëpo edhe pse i njëjti nuk ka aftësinë e veprimit, të njëjtin e përfaqëson subjekti i së drejtës. Aftësia e veprimit është rregulluar me nenin 15 par.3 dhe nenin 136 të LFK-së, kështu që dispozitat që kanë të bëjnë me zotësinë e veprimit duhet të interpretohen në lidhshmëri me këto nene.

I mituri i cili nuk ka mbushur moshën 14 vjeçare ka të drejtë ankese kundër vendimit të kujdestarit, organit të kujdestarisë dhe organeve të tjera me të cilat i cenohet dhënia e lejes, e cila është e nevojshme në mënyrë që i njëjti të ketë mundsi të lidhë ndonjë punë juridike (neni 218 i LFK-së). Kjo është në përputhje edhe me Konventën Evropiane mbi Ushtrimin e të Drejtave të Fëmijës, e

miratuar në Strasburg me 25 janar 1996, ku në dispozitën e nenit 3 është paraparë e drejta e fëmijës për t'u informuar, konsultuar dhe për të shprehur pikëpamjet e tij në procedurë.

Kompetencat e kujdestarit të të miturit janë të numëruara taksativisht si në vijim:

1. t'ia besojë të miturin shtëpisë së bonjakëve ose ndonjë organizate tjetër për fëmijë dhe të mitur për ruajtje, edukim dhe arsimim, apo ndonjë personi tjetër, ose ta vendos të miturin për një kohë të gjatë për mjekim në institucionin shëndetësor,
2. të iniciojë ndërrimin e shkollës,
3. të vendos për zgjedhjen e profesionit ose ushtrimin e profesionit të të miturit, si dhe
4. të marrë edhe masat e tjera të rëndësishme, lidhur me personalitetin dhe interesat e të miturit.

Në rastin e fundit ligjdhënësi nuk i ka theksuar taksativisht dhe se një gjë e tillë nuk është e mundur, pasi që gjatë kohës sa është i mituri nën kujdestari paraqiten situata të ndryshme, por një gjë e tillë i ka lënë në dispozicion vet kujdestarit dhe Organit të Kujdestarisë që të vlerësojnë secilën situatë veç e veç.

LFK-ja në nenin 220 ka normuar marrjen e informacioneve nga kujdestari për të kujdesurin nga të gjitha institucionet ku është besuar fëmija për përkujdesje lidhur me të gjitha çështjet e rëndësishme për fëmijën. Ky obligim i informimit të kujdestarit dhe Organit të Kujdestarisë ka për qëllim që këta të fundit në mënyrë konstante të jenë të informuar për të gjitha ndryshimet eventuale gjatë kujdesit për të kujdesurin, në mënyrë që çdo ndryshim eventual i gjendjes apo situatës në të cilën do të ndodhet i kujdesuri, të ketë kujdesin e duhur nga kujdestari i tij apo eventualisht nga Organi i Kujdestarisë. Gjithashtu informimi i Organit të Kujdestarisë nga ana e personave dhe institucioneve kanë për detyrë që para se ta lëshojnë të miturin që e kanë nën përkujdesje, ta informojnë me kohë lidhur me këtë rrethanë Organin e Kujdestarisë, në mënyrë që ky i fundit të ketë mundsinë e ndërmarrjes së hapave të nevojshëm, për masat e mbajtjes dhe sigurimin e të miturit.

Në fund LFK-ja në nenin 221 ka normuar rastet se kur përfundon kujdestaria ndaj të miturit.

Kujdestaria ndaj të miturit përfundon në këto raste:

1. me arritjen e moshës madhore,
2. me lidhjen e martesës para mbushjes së moshës madhore,
3. me adoptim dhe
4. me kthimin e kujdesit prindëror të prindërit të tij.

Këtu duhet bërë dallimin në mes përfundimit të kujdestarisë ndaj të miturit dhe përfundimit të detyrës së kujdestarit. Kujdestaria ndaj të miturit përfundon në rastet kur përfundon nevoja për kujdestari, ndërsa detyra e kujdestarit përfundon kur pushon nevoja për kujdestari, por edhe pavarësisht nga ajo (me shkarkim të kujdestarit sipas kërkesës, me ndërrimin e kujdestarit etj). Edhe në rastet e kujdestarisë ndaj të miturit Organi i Kujdestarisë duhet të kërkojë nga kujdestari

raport për punën e vet dhe shpërndajë pasurinë e të kujdesurit dhe t'ia dorëzojë personit në kujdestari për administrim, respektivisht prindit apo adoptuesit.

Kujdestaria për raste të veçanta

Kujdestarët për raste të veçanta përfaqësojnë llojin e tretë të kujdestarisë, pas kujdestarisë ndaj të miturve dhe kujdestarinë ndaj personave madhorë të cilëve iu është hequr zotësia e veprimit dhe ndahen në dy grupe:

- a. rastet e veçanta të parapara me ligj dhe
- b. rastet tjera.

Në grupin e parë ligjdhënësi ka paraparë disa raste të veçanta si: kujdestarinë për pasurinë që nuk i dihet pronari, kujdestarinë për të miturin kur ekziston kontesti në mes të fëmijës dhe prindërve.

Në rastin konkret do të flasim vetëm për kujdestarinë e veçantë në të cilën përfshihen të miturit. LFK-ja këtë çështje e normon në nenin 230, ku taksativisht paraqiten rastet se kur të miturit i caktohet kujdestari i veçantë. Kështu që në paragraf 1 të këtij neni përcaktohet se kujdestari për raste të veçanta do të emërohet për fëmijën në rastet kur edhe pse prindërit e ushtrojnë kujdesin prindëror, mes tyre dhe fëmijës ekziston kontest, pra në punë juridike të dukshme që kanë të bëjnë me pasurinë e familjes. Në paragraf 2 të këtij neni përcaktohet se kujdestar i veçantë i caktohet personit nën kujdestari të cilit mund t'i caktohet kujdestari special për kontestet e rënda mes tij dhe kujdestarit. Ndërsa prindërit, palët adoptuese, kujdestarët, kushërinjtë dhe fqinjët janë të detyruar të njoftojnë organin e kujdestarisë për çështjet ose rastet e cekura në paragraf 1 dhe 2 të këtij ligji.

Në praktikë nuk janë raste të rralla kur iniciohen konteste gjyqësore rreth ndonjë të drejte apo pasurie, ndërsa në të gjitha këto raste kujdestari ligjor nuk mund t'i paraqet dhe mbrojtë interesat e veta dhe interesat e personave ndaj të cilëve ushtron kujdesin. P.sh. prindi nuk mund të paraqitet në njërën anë si palë e në anën tjetër si i autorizuar i palës tjetër, apo i njëjti nuk mund të jetë në njërën anë paditës e në anën tjetër përfaqësues i të paditurit apo e kundërta.

Andaj, ligjdhënësi ka paraparë që në këto raste personit të përfaqësuar do t'i caktohet kujdestari vetëm në atë rast. Si raste të veçanta kur të miturit duhet t'i caktohet kujdestari i veçantë janë: në rastin kur midis të miturit dhe prindit që e ushtron kujdesin prindëror ekziston kontest lidhur me pasurinë e fëmijës apo për interesa tjera, në kontestet në mes kujdestarit dhe të kujdesurit, në kontestet në mes të adoptuarit dhe adoptuesit, në kontestet për vërtetimin e atësisë apo amësisë etj.

Si rregull, kujdestarinë ndaj të miturit e ushtrojnë prindi, kujdestari ose adoptuesi, ndërsa në rastet kur ekziston kontesti në mes këtyre të fundit dhe të miturit, atëherë të miturit Organi i Kujdestarisë pas marrjes në dijeni nga personat e përmendur në paragraf 3 të nenit 230 të LFK-së i cakton kujdestarin e veçantë. Gjithsesi kërkesën për caktimin e kujdestarit të veçantë e bën edhe gjykata

në rastet kur zhvillohet kontesti gjyqësor, ndërsa deri atëherë Organi i Kujdestarisë nuk e ka caktuar këtë kujdestar.

Me rastin e caktimit të kujdestarit për raste të veçanta, Organi i Kujdestarisë do të caktojë vëllimin, detyrimet dhe të drejtat e kujdestarit të veçantë, duke pasur parasysh rrethanat e secilit rast individual, ndërsa dispozitat e parag. 2 dhe 3 të nenit 215 të LFK-së zbatohen me analogji edhe ndaj kujdestarit të veçantë.

MBROJTJA E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE NË KONTESTET MARTESORE – FAMILJARE

Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve gjatë procedurës së shkurorëzimit

Bota sot është duke u ballafaquar me një problem social shumë serioz, siç është shkurorëzimi, që sikur është bërë normë në jetën tonë. Shkurorëzimi mund të ndodh për shkak të arsyeve të ndryshme, si konflikti në martesë, problemet financiare, stresi dhe arsye tjera, por pasojat që lë ai te fëmijët, janë të shumëfishta.⁹⁵

Ajo që e bën shkurorëzimin edhe më të vështirë, është fakti se shumica e çifteve të divorcuara kanë fëmijë, të cilët në shumicën e rasteve janë shumë të vegjël dhe nuk kanë ide se si të sillen në këto raste. Kjo gjendje pasigurie ndikon drejtpërdrejtë në personalitetin e fëmijëve i cili në rrethana normale nuk është i përgatitur për të përballuar raportet e acaruar të prindërve e rrjedhimisht edhe procedurën e shkurorëzimit.⁹⁶ Legjislacioni i aplikueshëm në Kosovë, për nga mënyra e rregullimit martesën e përcakton si një institucion të rëndësishëm për shoqërinë pasi që është bazë e krijimit të familjes. Në këtë kuptim pra është bërë përpjekje që martesës edhe në pikëpamje ligjore ti epet rëndësia e duhur, pasi që martesë përfaqëson një institucion shoqëror dhe juridik. Është institucion shoqëror sepse është formë e organizuar shoqërore, ndërsa është institucion juridik, sepse më krijimin e martesës krijohen të drejta dhe detyra për bashkëshortet.⁹⁷

Qëllimi shoqëror qëndron në faktin se martesë është bazë e familjes, e familja është bazë e shoqërisë. Në martesë realizohen edhe interesat e shoqërisë, prandaj shoqëria ka për detyrë që, me instrumente juridike dhe me instrumente të tjera, të krijoj kushte të nevojshme për martesë të harmonishme.⁹⁸

⁹⁵Vana Jerliu Ramadani: Divorçet rrezikojnë të ardhmen e familjes/ <http://ëëë.zemrashqiptare.net>

⁹⁶Po aty, fq.1.

⁹⁷Abdullah Aliu & Haxhi Gashi, E drejta Familjare, Prishtinë, 2007.

⁹⁸Gani Oruçi, Ligjerat të autorizuara, E Drejta Familjare, Prishtinë, 1994, fq. 40.

Thuajse qëllimi më kryesor i martesës ishte dhe mbetet edhe me tutje lindja dhe mirërritja e fëmijëve, që nënkupton kryerjen e marrëdhënieve seksuale të burrit dhe gruas. Martesa është institucion juridik i rregulluar kryesisht me dispozita ligjore urdhëruese, ndërsa zgjidhja e saj mund të bëhet vetëm në një mënyrë të parashikuar më dispozita ligjore.⁹⁹

Me nenin 60 par. 1 të Ligjit për Familjen i Kosovës (LFK), është paraparë shuarja e martesës me shkurorëzim, ndërsa me dispozitën e nenit 68 par 1 është parapa së martesa mund të zgjidhet me shkurorëzim vetëm në bazë të vendimit të gjykatës. Shkurorëzimi është mënyrë e zgjidhjes së martesës së vlefshme.

Shkurorëzimi është përfundim ligjor i martesës.¹⁰⁰ Procedura në kontestet martesore fillon përmes parashtrimit të padisë në gjykatën kompetente nga njëri prej bashkëshortëve.

Kushte themelor për fillimin e procedurës së shkurorëzimit është që padia apo propozimi i përbashkët të dorëzohet gjykatës kompetente. Duhet theksuar së në procedurën e shkurorëzimit gjykata ka rol aktiv në hetimin dhe shqyrtimin e çështjes lidhur me mbrojtjen e interesit me të mirë të të miturve të cilët përfshihen në procedurën e shkurorëzimit që zhvillohet në mes të prindërve të tyre. Në këtë rast LFK ka përcaktuar rolin aktiv të gjykatës për mbrojtjen e interesave të të miturve. Për shkak të rëndësisë që i jepet mbrojtjes së interesave të të miturve në konteste martesore, LFK ka parapa që gjatë zhvillimit të procedurave gjyqësore në konteste martesore gjykata dhe subjektet tjerë të përfshirë në këto procedura detyrohet të zbatojnë disa parime për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve të cilat do të trajtohen në vijim të këtij punimi.

Përveç parimeve bazë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve LFK ka përcaktuar edhe disa kufizime për zhvillimin e procedurës së shkurorëzimit e të cilat i referohen mbrojtjes së interesave të të miturve, pasi që më dispozitën e nenit 71 pik 1 parasheh së: “bashkëshortet nuk do të parashtrajnë padi për shkurorëzim gjatë shtatzënisë së gruas dhe derisa fëmija i tyre i përbashkët t’i mbush një vit”. Më këtë kufizim ligjor parashihet një masë mbrojtëse për nënë e fëmijës dhe për fëmijën duke e ndaluar paraqitjen e padisë përderisa zgjatë shtatzënia dhe përderisa fëmija të mbushë moshën një vjeçare.

Qëllimi i kësaj dispozite ligjore është jo të ndaloj shkurorëzimin, por të pengoj zhvillimin e procedurës gjatë kësaj kohe duke pasur parasysh rrethanat rënduese shëndetësore në të cilat gjendet bashkëshortja, respektivisht nëna e fëmijës si rrjedhojë e shtatzënisë.¹⁰¹

⁹⁹ Hamdi Podvorica, E drejta Familjare, Prishtinë, 2011, ho fq.40.

¹⁰⁰ Robin Leonard & Stephen Elias, “Child Custody” <http://ëëë.lectal.com>

¹⁰¹ Haxhi Gashi/Abdullah Aliu/Adem Vokshi, “Komentar” Ligji për Familjen i Kosovës, fq.199.

Kjo ndalës e zhvillimit të procedurës duhet kuptuar në kuadrin e parimeve për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, të cilat në mënyrë specifike do të trajtohet në pjesën e parimeve për mbrojtjen e fëmijëve.

Roli aktiv i gjykatës në hetimin, shqyrtimin dhe ofrimin e mbrojtjes juridike për të drejta e fëmijëve gjatë procedurës së shkurorëzimit i referohet edhe detyrës së gjykatës që exofficio të caktoj mas të përkohshme në kuptim të dispozitave nga neni 225, 327 dhe 328 të LFK-së,(të cilat do të trajtohen në pjesën e caktimit të alimentacionit për fëmijët). Gjatë procedurës së shkurorëzimit rol esencial përveç gjykatës për të ofruar mbrojtjen e drejtave të fëmijëve jo vetëm në kuptimin formal por edhe përmbajtjesor ka edhe organi i kujdestarisë.

Kujdesi i gjykatës dhe i organit të kujdestarisë gjatë procedurës së shkurorëzimit për mbrojtjen e fëmijëve dhe të drejtave të tyre duhet të jete i veçantë jo vetëm për faktin se këto dy institucione janë të ngarkuara më këtë përgjegjësi ligjor por edhe për shkak të disa faktorëve të cilët ndikojnë që mbrojtja e fëmijëve dhe e të drejtave të tyre të bëhet ma komplekse e rrjedhimisht ma e vështirësuar.

Studimet dhe hulumtimet e praktikës gjyqësore për konteste martesore ku janë të përfshirë edhe fëmijët, tregojnë së ekzistojnë një numër faktorësh-rrethanash të cilat e vështirësojnë dukshëm mundsin e gjykatës dhe mekanizmave tjerë që fëmijëve tu sigurohet adekuate e të drejtave të tyre. Rëndom në konteste martesore ku janë të përfshirë edhe fëmijët gjykata dhe institucionet tjera që janë të detyruar të ofrojnë mbrojtje për fëmijët përballën dhe do të përballën me: manipulimin e fëmijëve nga njëri ose prindi tjetër, ndryshimin e ambientit familjare pa njërin prind gjatë dhe pas procedurës së shkurorëzimit, ndryshimin e vendbanimit, ambienteve sociale apo edhe shkollës, martesën e prindërve të shkurorëzuar pas ndarjes, detyrimin e fëmijëve më prindër të shkurorëzuar që të punojnë para moshës madhore dhe mundsia e përfshirjes së këtyre fëmijëve në veprimtari kriminale.

Ndikimi dhe manipulimi i fëmijës-ve nga njëri prind gjatë dhe pas procedurës së shkurorëzimit - Nga hulumtimi dhe studimi i ndikimit të shkurorëzimit tek fëmijët rezulton së gjatë procedurës së shkurorëzimit shpesh here fëmijët ndikohen dhe manipulohen nga printërit. Rrethanën e ndikimit dhe manipulimit të fëmijëve nga prindërit e konfirmojnë punëtorët e qendrave për punë sociale siç janë: sociologet, pedagoget, psikologet, mësuesit por edhe gjyqtaret të cilët trajtojnë rastet e kontesteve martesore-familjare.

Sipas të gjeturave nga praktika gjyqësore rezulton së dukuria e ndikimit dhe manipulimit të fëmijëve gjatë dhe pas procedurës së shkurorëzimit të bashkëshortëve është në rritje e sipër. Faktorët që ndikojnë në këtë aspekt janë dëshira e bashkëshortëve që tu besohen fëmijët nga ana e gjykatës njërit apo bashkëshortit tjetër, pastaj bashkëshortet në procesin e shkurorëzimit tentojnë ti përdorin fëmijët më qëllim që para gjykatës ta identifikojnë prindin tjetër si shkaktar të prishjes

së martesës. Në këtë kuptim gjykata duhet të kenë vëmendjen e duhur që edhe përmes ndihmës profesionale nga organit të kujdestarisë (psikologut, sociologut, pedagogut etj), të pamundsojnë në radhë të parë mundsin e manipulimit të fëmijëve dhe rrjedhimisht të evitojnë mundsin që gjykatat të marrin në vlerësim deklaratimet e fëmijëve të manipuluar (në rast së ata dëgjojnë nga gjykata) si rrethanë, mbi bazën e të cilave do të vendosin në mënyrë meritore.

Ndryshimi i ambientit familjare pa njërin prind gjatë dhe pas procedurës së shkurorëzimit- Njëri ndër faktorët që ndikon drejtpërdrejt tek fëmija është edhe ndryshimi i ambientit. Në shumicën e rasteve gjatë dhe pas procesit të shkurorëzimit të bashkëshortëve fëmijët detyrohen të adaptohen më një ambient tjetër ku mungon njeri prind.

Nga intervistimi me punëtorët social rezulton së në shumë raste fëmijët përveç se detyrohen të adaptohen më mungesën e njërit prind ata edhe janë të kufizuar të zhvillojnë biseda të lirshme lidhur me nevojën që kanë për prindin tjetër i cili nuk jeton me fëmijët. Në shumë raste për shkak të nevojës që kanë fëmijët për përkujdesjen nga ana e prindit me të cilin jetojnë ata detyrohen të pranojnë kushte që dikton prindi me të cilin jetojnë duke ndikuar drejtpërdrejt në marrëdhëniet e fëmijëve me prindin tjetër me të cilin fëmijët mund të kenë vetëm kontakt. Fëmijët me prindër të shkurorëzuar, zakonisht nuk kanë udhëzime të mjaftueshme sikur fëmijët që jetojnë me të dy prindërit dhe kjo mund të paraqet problem në jetën e tyre të ardhshme. Mungesa e prindërve për shkak të shkurorëzimit, tek disa ndikon edhe në humbjen e fëmijërisë pasi që familja ka obligim për të siguruar një lloj kujdesi për anëtarët e tjerë.¹⁰²

Ndryshimi i vendbanimit, ambienteve sociale apo edhe shkollës - Ndryshimi i vendbanimit, ambienteve sociale apo edhe shkollës është njëkohësisht një ndër faktorët që ndikon drejtpërdrejt në jetën e fëmijëve e rrjedhimisht edhe në personalitetin e tyre. Fëmijët nuk janë të gatshme për ndërrime të vendbanimit, ambienteve sociale apo edhe shkollës, sepse fëmijët ma shumë së të tjerët janë të lidhur me rrethin ku jetojnë.

Nga intervistimi i mësuesve rezulton se shpesh here fëmijët kur ndryshojnë vendbanimi apo edhe shkollën, ndryshon edhe sjellja e tyre në raport më përgjegjësin ndaj shkollës. Në shumë raste fëmijët pas ndryshimit të shkollës përcillen më reni të mësimit dhe të interesit për mësim por kjo nuk përfundon vetëm me renien e interesit të fëmijëve por përcillet edhe me rënien e interesit të prindërve për fëmijët e tyre.

Rëndom pas shkurorëzimit më nuk janë të dy prindërit që kujdesen për edukimin e fëmijëve, nuk janë të dy prindërit që kujdesin për nivelin e ndjekjes së shkollës dhe mësimit dhe si përfundim fëmijët e tillë shpesh edhe braktisin shkollën.

¹⁰² Vana Jerliu Ramadani, punimi i cituar, fq.1.

Fëmijët, pas shkurorëzimit të prindërve, ndjehen të tradhtuar, sepse ata mendojnë se prindërit e tyre duhet të rregullojnë problemet në mes vete, për të jetuar së bashku, sepse ata kalojnë në një periudhë të vështirë ndryshimesh në jetën e tyre.¹⁰³ Humbin miqësi dhe nganjëherë humbin një mjedis shoqëror të rëndësishëm, sikurse mund të humbin edhe vëllezërit dhe motrat nga kjo ndarje, ose t'i lëndojnë këto raporte. Është përgjegjësi e prindërve për të gjetur mënyrën se si mund t'i ndihmojnë fëmijët e tyre që të kenë një jetë sa më të mirë.¹⁰⁴

Fëmijët kanë nevojë të kenë pikë referimi të qëndrueshme gjatë formimit të tyre, që do të thotë që nëse të dy prindërit që zgjidhin martesën “duan” t'i mbajnë fëmijët në mënyrë të barabartë, ata duhet të kenë të qartë së ndryshimet përditshme ose të shpeshta të banimit të fëmijës, herë pranë njërit prind herë pranë tjetrit, bëjnë që fëmijët të humbasin qëndrueshmërinë dhe kjo situatë provokon rrezikun e personalitetit të dyfishtë tek ata.¹⁰⁵ Edhe për këtë faktor të mundshëm gjykata duhet ta kenë vëmendjen e duhur në mënyrë që të realizojnë hetimin e duhur të të gjitha rrethanave që mund të kenë efekt në jetë e fëmijëve, prindërit e të cilëve shkurorëzohen, dhe mbi bazën e një vlerësimi profesional, objektiv, gjithëpërfshirës e me referencë në parimin e mbrojtje së interesit ma të mirë të të miturit të vendosin.

Tërheqim vëmendjen në këtë pikë pasi që në disa raste gjykatat do të përballën edhe më informacione të mangëta për shkak së organi i kujdestarisë nuk posedon ma kapacitetet e nevojshme profesionale për ta ndihmuar punë e gjykatës, por kjo nuk do të thotë së gjykatat lirohen nga përgjegjësia për të ofruar dhe garantuar më të mirën e mundshme për fëmijët. Në raste të tilla është në diskrecionin e gjykatave që të përdorin të gjitha mundsit ligjore për të marrë edhe ndihem e institucioneve tjera profesionale më shpenzimet e gjykatës më qëllim që vendimi i gjykatës të jetë zgjidhja ma e mirë për një situatë të tillë.

Martesa e prindërve të shkurorëzuar pas ndarjes dhe pasojat për fëmijët - Pas martesës së prindërve, nganjëherë fëmijët janë shumë konfuz në marrëdhëniet me familjen e re. Shumë faktorë kanë të bëjnë me çështje të tilla, si njerka ose njerku, që mund të mos jenë të mirë dhe të mos kenë konsideratë për ta, ose në këto marrëdhënie ndikojnë edhe vëllezërit dhe motrat nga martesa e re.¹⁰⁶ Në raste të tilla fëmijët do të përballën më vështirësinë e vendosjes së një marrëdhënie normale më njerken apo njerkun, në disa raste kjo edhe për shkak së ketë të fundit nuk tregojnë interesin që më fëmijët e bashkëshorti apo bashkëshortes të vendosin një marrëdhënie normale dhe njerëzore. Duhet theksuar faktin së fëmijët në shumë familje ku jetojnë fëmijët (vëllezër dhe motra) me prindër të ndryshëm trajtimi i tyre nuk është i barabartë dhe kjo sigurisht që le gjurmë në personalitetin e fëmijëve. Në këtë kontekst theksojmë nevojën që gjykata duhet ti kushtojnë vëmendje të veçantë kësaj rrethane me rastin e vendosjes për besimin e fëmijëve apo edhe për ndryshimin e vendimit për besimin e fëmijëve.

¹⁰³ Po aty, fq.1.

¹⁰⁴ Po aty, fq.1.

¹⁰⁵ Arta Mandro, E Drejta Familjare, Tiranë, 2009.

¹⁰⁶ Vana Jerliu Ramadani, punimi i cituar, fq.1.

Detyrimi i fëmijëve më prindër të shkurorëzuar që të punojnë para moshës madhore -Fëmijët me prindër të shkurorëzuar, zakonisht nuk kanë udhëzime të mjaftueshme sikur fëmijët që jetojnë me te dy prindërit dhe kjo mund të paraqet problem në jetën e tyre të ardhshme.

Mungesa e prindërve për shkak të shkurorëzimit, tek disa ndikon edhe në humbjen e fëmijërisë pasi që familja ka obligim për të siguruar një lloj kujdesi për anëtarët e tjerë. Në këto rrethana, fëmijët detyrohen të punojnë në moshë shumë të re, madje disa ndërpresin edhe shkollimin dhe kjo ka pasoja negative sociale.¹⁰⁷

Detyrimi që fëmijët të punojnë në moshë të re është në kundërshtim me të drejtat e fëmijëve që duhet të garantoj çdo shoqëri demokratike. Në Kosovë ky është një problem i theksuar i cili kërkon vëmendjen dhe përkushtimin e tërë shoqërisë dhe të gjitha institucioneve për të ndryshuar këtë trend. Në këtë kuptim edhe gjykatat duhet të realizojnë funksionin e tyre për aq sa është në juridiksionin e tyre.

Mundësia e përfshirjes së fëmijëve me prindër të shkurorëzuar në veprimtari kriminale -Disa nga fëmijët prindërit e të cilëve janë shkurorëzuar krijojnë respekt të ulët për vetveten, për shkak të mungesës së mbështetjes emocionale nga prindërit, gjë që ndikon që disa fillojnë të krijojnë varësi të ndryshme, siç janë: drogat, duhani, alkooli etj. Ky vlerësim konfirmohet edhe nga studimet dhe hulumtime e realizuar në Kosovë.

Hulumtimet gjejnë së një ndër problemet që mbizotëron tek të rinjtë, sidomos tek ata të shkollave të mesme është përdorimi i duhani.¹⁰⁸ Edhe sa i përket përdorimit të alkoolit dhe të drogës, ndonëse vërehet së ato përdoren me pak se duhani, dukuria e përdorimit të tyre është në rritje.¹⁰⁹

Fëmijët me prindër të shkurorëzuar kanë treguar shqetësime në aftësitë e tyre në shkollë dhe aktivitetet tjera në shoqëri. Efektet negative kanë të bëjnë me emocionet që kanë paraqitur probleme në martesën e tyre, ndjenja e vetëbesimit të ulët, ndjenja e pasigurisë dhe e braktisjes së jetës shoqërore.

Fëmijët me prindër të shkurorëzuar shpeshherë për shkak të braktisjes së jetës shoqërore bëhen pjesë e grupeve të ndryshme e kriminale dhe pjesë e jetës kriminale pasojat e të cilës shpeshherë janë fatale për ta dhe shoqërinë. Është më rëndësi që edhe shkollat dhe institucionet tjera edukative të rrisin kapacitet e tyre profesionale duke punësuar psikolog dhe ekspert të fushave të tjera të cilët do të ofronin ndihme profesionale për të gjithë fëmijët që vërehet së u nevojite ndihma e tillë e posaçërisht për fëmijët të cilët jetojnë më prindër të ndarë për arsye të ndryshme.

¹⁰⁷ Po aty, fq.1.

¹⁰⁸ Valon Murati & Qerkin Berisha, Roli i Edukimit në Parandalimin e Delikuencës së të Miturve, Prishtinë, 2009, fq.39.

¹⁰⁹ Po aty, fq.39.

Edhe analizat e ndryshme që i referohen parandalimit të delikuencës së të miturve rekomandojnë që përveç tjerave të bëhet emërimi i psikologëve (por edhe i sociologëve) nëpër shkolla në funksion të parandalimit të delikuencës së të miturve dhe të nevojave tjera që kanë nxënësit.¹¹⁰

Parimet për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve

“Të gjitha masat që ndërmerren për fëmijët, qofshin ato të marra nga institucionet publike apo nga ato private të përkujdesjes sociale, nga gjyqet, nga autoritetet e administratës apo nga organet legislative, interesi më i mirë i fëmijës duhet të jetë synim mbizotërues....”¹¹¹

Të drejtat e fëmijëve kanë një historik të mbrojtjes ndërkombëtare të të drejtave të tyre. Koncepti i të Drejtave të fëmijës u zhvillua në një rën anë nga angazhimi i gjerë i lëvizjes për të drejtat e njeriut, e nga ana tjetër, derivoi edhe nga zhvillimet e tjera në fushën sociale, psikologjike e të arsimit të këtyre 200 viteve të fundit.¹¹²

Dokumenti i parë ndërkombëtar që shpall të drejta e fëmijëve si kategori të veçantë të të drejtave të njeriut, ishte Deklarata e Lidhjes së Kombeve, e viti 1924 e njohur si deklarata e Gjenevës.

Pas kësaj konvente të drejta e nënës dhe fëmijës përcaktohen edhe në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, (DUDNJ) e viti 1948.

Pjesa e dytë e nenit 25 e DUDNJ përcakton së: nënat dhe fëmijët kanë të drejtë për një kujdesie dhe ndihmë të veçantë. Të gjithë fëmijët, pamarre parasysh a kanë lindur brenda apo jashtë martesës, do të gëzojnë mbrojtje të njëjtë sociale. Mund të duket së nënat dhe fëmijët, nga përpiluesit e DUDNJ-së, janë kuptuar si gjendje kalimtare dhe së femrat dhe fëmijët janë parë si objekte për të cilët diçka duhet të ndërmerret.¹¹³ Cenueshmeria e nënave këtu padyshim është kuptuar në lidhje me funksionet riprodiktive të gruas: shtatzënia, lindja, kujdesi i menjëhershëm për foshnjën derisa të bëhet e pavarur dhe i gatshëm që të jetë nën përkujdesjen e nënës apo të përkujdesesit/ve të tjerë. Kjo dispozitë është vetëm në kuptim të kufizuar, e lidhur më atë që më vonë u shëndrrua në të drejtë të gruas fëmijës.¹¹⁴

Deklarata e OKB-së për të drejta e fëmijës, e viti 1959, në preambulën e saj përmbante shprehjen së njerëzimi i ka borxh fëmijëve më të mirat që mund të japë. Edhe traktatet e të drejtës ndërkombëtare humanitare kanë pranuar cenueshmërin e veçantë të fëmijëve, në situata të konflikteve të armatosura.¹¹⁵

¹¹⁰ Po aty, fq.48.

¹¹¹ Konventa për të Drejta e Fëmijës, e Kombeve të Bashkuara, 1989, neni 3.

¹¹² Editor:Ëolfgang Benedek, Kuptimi i të Drejtave të Njeriut, Ëien-Graz 2009, fq.295.

¹¹³ Gudmund Alfredsson & Asbjorn Eide, Deklarata Universale mbi të Drejta e Njeriut/ Standard i arritjes së Përbashkët, Holandë 1999.

¹¹⁴ Po aty, fq.535.

¹¹⁵ Konventa e Gjenevës, 1949, protokollet shtesë.

Në rrafshin ndërkombëtare deri në vitin 1979 lëvizjet në drejtim pozitiv për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve kanë qenë të ngadalta. Një ndryshim i theksuar është bërë në aktivitete e Vitit Ndërkombëtar të Fëmijëve të Kombeve të Bashkuara. Pas kësaj, Komisioni për të Drejta e Njeriut i Kombeve të Bashkuara filloi të shqyrtoj propozimin e qeverisë polake për hartimin e një konvente për të drejta e fëmijës.¹¹⁶

Pas dhjetë vitesh është miratuar Konventa mbi të Drejta e Fëmijës, (KDF) e Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989. Kjo konventë është unike në mesin e dokumente tjera për të drejta e njeriut sepse në një dokument përmban dispozita jo vetëm për ët drejta civile dhe politike por edhe për ët drejta ekonomike, sociale dhe kulturore.

Edhe pas miratimit dhe ratifikimit të Konventës Ndërkombëtare për të Drejta e Fëmijës, kanë vazhduar aksionet e ndryshme për implementimin e saj, e si e arritura në këtë drejtim ishte samiti Botëror i fëmijëve i mbajtur më ftesë të UNICEF-it në Nju-Jork në shtator të vitit 1990, i cili vuri në pah së fëmijë të panumërt në tërë botën i janë ekspozuar rreziqeve që pengojnë rritjen dhe zhvillimin e tyre.

Samiti Botëror miratoj një deklaratë për mbijetesën, mbrojtjen dhe zhvillimin e fëmijëve dhe një Plan për aksion për implementimin e deklaratës së vitit 1990.¹¹⁷

KDF i ka vendosur të drejta e fëmijës në agjendë botërore. Kjo është konventa me e ratifikuar ndër të gjitha dokumente tjera për ët drejta e njeriut të aprovuara ndonjëherë.¹¹⁸

Në konventë parimi i interesave më të mira të fëmijës ka një status dominues. Ky parim është pjesë e çdo neni të konventës dhe obligon shtetet nënshkruese që në të gjitha veprimet e tyre që kaun të bëjnë më fëmijët, interesi më i mirë i fëmijës duhet të jetë synim mbizotërues.

Kjo konventë përveç tjerash në preambulën e saj i referohet akteve më të rëndësishme ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, në atë mënyrë që duke mbajtur parasysh se domosdoshmëria për t'i dhënë një mbrojtje të posaçme fëmijës është pohuar në Deklaratën e Gjenevës mbi të Drejtat e Fëmijës të vitit 1924 dhe në Deklaratën mbi të Drejtat e Fëmijës të miratuar nga Kombet e Bashkuara më 20 nëntor 1959 dhe që është njohur në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, në Paktin Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike (në veçanti në nenet 23 dhe 24), në Paktin Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore (në veçanti në nenin 10) dhe në statutet e instrumentet përkatëse të agjencive të specializuara dhe të organizatave ndërkombëtare, që merren me mirëqenien e fëmijës.

¹¹⁶ Bardhyl Hasanpapaj & Vjosa Osmani, Fëmijët e rrugës në Kosovë, Prishtinë, 2004, fq.13.

¹¹⁷ Po aty, fq.13.

¹¹⁸ Po aty, fq.21.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 22 parasheh Zbatimin e drejtpërdrejtë të Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare, duke përcaktuar se “të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike: (1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, (2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj, (3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj, (4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, (5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor, (6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas, (7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës, (8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.

Kushtetua e Republikës së Kosovës, përveç të tjerave e parasheh drejtpërdrejtë të zbatueshme Konvente për të Drejta e Fëmijës.

Përveç akteve ndërkombëtare të cilat kanë gurë themel parimin e interesit ma të mirë të të miturit, këtë e një edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e cila në nenin 50 paragrafi 4 parasheh se “të gjitha veprimet e ndërmarra nga autoritetet publike ose private që kanë të bëjnë me fëmijët do të jenë në interesin më të mirë të fëmijëve,” ndërsa në paragrafin 5 parasheh se çdo fëmijë ka të drejtë për “marrëdhënie të rregullta dhe kontakt të drejtpërdrejtë”, me prindërit e vetë, përveç nëse një organ kompetent ka vendosur se kjo nuk do të ishte në interesin më të mirë të fëmijës.

Përveç Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si akti më i larët juridik, e cila siç është theksuar më lartë parasheh zbatimin e drejtpërdrejtë të marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare për të drejta e njeriut, Kosova më ligj të veçantë “ Ligji për Familjen i Kosovës” rregullon: fejesën, martesën, marrëdhëniet ndërmjet prindërve dhe fëmijëve, adoptimin, kujdestarinë, mbrojtjen e fëmijëve pa kujdes prindëror, marrëdhëniet pasurore në familje dhe procedurat e posaçme të gjykatës përkitazi me konteste lidhur me marrëdhëniet familjare. Pra, LFK përveç tjerave parasheh edhe në frymën e Konventës për të Drejta e Fëmijës, që në procedura gjyqësore ku përfshihen fëmijët gjithmonë të dominoj parimi i interesit ma të mitë të të miturit.

Parimi i interesit më të mirë gjithashtu parashihet edhe në ligjin mbi shërbimet sociale dhe familjare, neni par 1 i cili parasheh së: në të gjitha çështjet lidhur me ofrimin e shërbimeve për fëmijët dhe për familjet interesi më i mirë i fëmijës duhet të jetë konsiderata e parë dhe më e rëndësishme LFK me dispozita të veçanta përmban parimet për mbrojtjen e fëmijëve dhe parimet për mbrojtjen e fëmijëve gjatë procedurës së shkurorëzimit.

Parimet për mbrojtjen e fëmijëve sipas LFK-së

LFK më dispozitat e nenit 125 i ka parapa parimet për mbrojtjen e fëmijëve si në vijim:

Çdo fëmijë ka të drejtën e pamohueshme për të jetuar- e drejta e fëmijës për të jetuar është ndër parimet themelore. E drejta në jetë nënkupton të drejtën e fëmijës që të jetoj, përkatësisht që jeta e tij të jetë e garantuar në atë mënyrë që askush mos të këtë të drejtë ta privoj nga jeta. Ky parim i LFK-së, është në pajtim edhe me nenin 6.1 të KDF-së, ku përcaktohet së shtetet palë njohin se çdo fëmijë ka të drejtën e pamohueshme për të jetuar. Në këtë rast Republika e Kosova si zbatuese e drejtpërdrejtë e konventës detyrohet në garantimin dhe mbrojtjes e jetës së fëmijës. Në paragrafin 2 të nenit 6 të konventës përcaktohet së Shtete Palë, marrin të gjitha masat e mundshme për të siguruar mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijës. Në këtë rast shtet duhet të marrin masa adekuate jo vetëm për t'i garantuar fëmijës të drejtën e jetës por edhe për t'i siguruar mbijetesë dhe zhvillim. Roli i shteti në këtë rast duhet të jetë aktiv për siguruar mbijetesën e fëmijës dhe zhvillimin e tij.

Kjo e drejtë është në pajtim me neni 3 të Deklaratës Universale për të Drejta e Njeriut, (1948) ku përcaktohet së çdokush ka të drejtë në jetë, liri dhe siguri personale, e gjithashtu në pajtim të plotë me nenin 2.1 të Konventës Evropiane për të Drejta e Njeriut (1950) ku përcaktohet se “E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj. Askujt nuk mund t'i merret jeta qëllimisht, me përjashtim të rastit kur zbatohet një vendim gjyqësor me vdekje, pas dënimit për një krim për të cilin ky dënim është parashikuar me ligj”.

Fëmijët kanë të drejtë të rriten në familje me prindër. Fëmijët që nuk jetojnë bashkë me të dy prindërit kanë të drejtë t'i takojnë rregullisht prindërit me të cilët nuk jetojnë – Është e drejtë e garantuar e fëmijës që të rritet më prindër. Kjo e drejtë i referohet rasteve kur fëmija jeton në familje me të dy prindërit, ndërsa në rastet kur prindërit jetojnë të ndarë atëherë është e drejtë e garantuara e fëmijës që ta takoj rregullisht prindin më të cilin nuk jeton.

Ky parim i referohet të gjitha rasteve kur fëmija nuk jeton më të dy prindërit. Kjo dispozitë është në pajtim edhe me nenin 9 të KDF-së. Rastet ma të shpeshta kur fëmija nuk do të jetoj më të dy prindërit janë raste e zgjidhjes së martesës në mes të bashkëshortëve dhe besimi i fëmijës njërit apo bashkëshortit tjetër. Këtu bëjnë pjesë edhe rastet kur shteti u heq të drejtën prindërore prindërve për shkak të keqtrajtimit të fëmijës apo arsye tjera.

Fëmijët me të meta të diagnostifikuara mendore ose fizike kanë të drejtë për kujdes të posaçëm, për një jetë të përshtatshme, në kushte të jetës që garantojnë dinjitetin e tyre dhe lehtësojnë pjesëmarrjen e tij aktive në jetën shoqërore - fëmijët më të meta të diagnostifikuara mendore konsiderohen fëmijët të cilët intelekti i tyre dhe aftësia e të menduarit është e kufizuar

për shkaqe të ndryshme shëndetësore.¹¹⁹ Fëmijëve më të meta sipas këtij parimi duhet tu sigurohet kujdes i posaçëm, për një jetë të përshtatshme sipas gjendjes së tyre shëndetësore, në kushte të jetës që garanton dinjitetin e tyre dhe mundsin që këta fëmijë të marrin pjesë në aktivitet në jetën shoqërore. Ky detyrim ligjor në radhë ta parë përcaktohet për prindërit e fëmijëve më të meta por natyrisht niveli i plotësimi të këtyre kushteve për fëmijë më të meta do të varet nga mundësia financiare e prindërve. Duhet theksuar së ky detyrim nuk kufizohet vetëm në nivelin e përgjegjësisë së prindërve por i referohet edhe detyrimit të shtetit që të krijoj kushte të nevojshme për këtë kategori personash që tu garantohet kujdes i posaçëm, jetë e përshtatshme dhe e dinjitetshme dhe mundsi për pjesëmarrje aktive në jetën shoqërore. Këtyre fëmijëve dhe familjeve të këtyre fëmijëve duhet tu sigurohet përkrahje e veçantë dhe e vazhdueshme nga shteti.

Ky parim është në pajtim të plotë me dispozita e nenit 23 të KDF-së ku përcaktohet së:

- Shtetet Palë pranojnë se fëmija me paaftësi mendore ose fizike duhet të bëjë një jetë normale dhe të përshtatshme, në kushte që garantojnë dinjitetin e tij, që nxisin autonominë dhe lehtësojnë pjesëmarrjen e tij aktive në jetën e bashkësisë;
- Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës me paaftësi për kujdes të posaçëm dhe nxisin e sigurojnë, brenda mundsive të të ardhurave të disponueshme, dhënien fëmijës, i cili përmbush kushtet, si dhe atyre që kujdesen për të, të ndihmës që kërkohet dhe që i përshtatet gjendjes së fëmijës dhe gjendjes financiare të prindërve të tij, ose të atyre që kujdesen për të;
- Duke njohur nevojat e veçanta të fëmijës me paaftësi, ndihma e dhënë sipas paragrafit 2 të këtij neni jepet falas sa herë të jetë e mundur, duke pasur parasysh burimet financiare të prindërve të tij ose të atyre që kujdesen për të dhe kjo synon që fëmijët me paaftësi të kenë mundsi efektivisht të marrin arsim, kualifikim, shërbime shëndetësore, shërbime riaftësimi, përgatitje për punësim dhe veprimtari argëtuese, në mënyrë që fëmija të sigurojë një integritet shoqëror dhe zhvillim vetiak sa më të plotë, përfshirë zhvillimin e tij kulturor dhe shpirtëror;
- Shtetet Palë, në frymën e bashkëpunimit ndërkombëtar, nxisin shkëmbimin e informacionit të përshtatshëm në fushën e kujdesit shëndetësor parandalues dhe të trajtimit mjekësor, psikologjik dhe funksional të fëmijëve me paaftësi, përfshirë përhapjen dhe mundsinë e marrjes së informacionit lidhur me metodat e riaftësimi, edukimit dhe shërbimeve të formimit profesional, me qëllim që Shtetet Palë të kenë mundsi të përmirësojnë cilësitë dhe aftësitë e tyre dhe të zgjerojnë përvojën e tyre në këto fusha. Në këtë drejtim, duhet të mbahen parasysh në mënyrë të veçantë nevojat e vendeve në zhvillim.

Fëmijët kanë të drejtën e shkollimit fillore falas, të marrjes së informimit për profesione të ndryshme si dhe për shkollat që ekzistojnë – e drejta për shkollim është njëra ndër të drejta

¹¹⁹ Haxhi Gashi/Abdullah Aliu/adem Vokshi, “Kommentar” Ligji për Familjen i Kosovës, fq.292.

themelore të fëmijës që garantohet me akte ndërkombëtare. KDF me dispozita e nenit 28 parash të drejtë e fëmijës për arsim.¹²⁰ Është detyrim i shtetit që të njohin të drejtën e fëmijëve për shkollim dhe njëkohësisht është detyrim i prindërve që të mbështesin fëmijët për shkollim. Kushtetuta e Republikës së Kosovës parasheh së: secili person gëzon të drejtën e shkollimit themelor pa pagesë. Shkollimi i detyrueshëm rregullohet me ligj dhe financohet nga fondet publike.

Neni 47 par 1 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ndërsa në paragrafin 2 të nenit 47 përcaktohet së: Institucionet Publike sigurojnë për secilin person mundsi të barabarta për tu arsimuar, sipas aftësive dhe nevojave të veçanta të tij/saj. Në mënyrë specifike çështja e të drejtës së arsimit rregullohet me Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës. Në nenin 3 par 2 të këtij ligji parashihet së asnjë personi nuk guxon t'i mohohet e drejta e arsimit, ndërsa në paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet së: Arsimi parauniversitar është përgjegjësi e përbashkët e prindërve, institucioneve arsimore dhe aftësuese, komunave dhe qeverisë, sipas funksioneve dhe detyrave përkatëse të përcaktuara në këtë ligj. Fëmijët kanë të drejtë edhe të informohen për profesione të ndryshme dhe për ekzistimin e shkollave që ekzistojnë, respektivisht në të cilat organizohet mësim.¹²¹Duhet theksuar së në Republikën e Kosovës arsimi falas garantohet edhe për nivelin fillor dhe të mesëm.

Fëmijët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes nga shfrytëzimi ekonomik, eksploatimit të fëmijëve, trafikimit dhe eksploatimit seksual dhe nga kryerja e çdo pune që paraqet rrezik ose që cenon edukimin ose dëmton shëndetin e tyre - në kuadër të këtij parimi parashihet mbrojtja e fëmijëve nga disa forma të ndryshme eksploatimi. Ky parim është në pajtim me nenin 32 të KDF-së ku përcaktohet së: Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës për t'u mbrojtur nga shfrytëzimi ekonomik dhe nga kryerja e çdo pune që paraqet rreziqe ose që cenon edukimin e tij ose dëmton shëndetin apo zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral ose shoqëror. Kjo konventë meriton vëmendje të posaçme si njëra ndër mjetet me efikase në luftimin e praktikave të skllavërisë, e tëra kjo duke pasur parasysh numrin e viktimave fëmijë.¹²²

¹²⁰ Neni 28 I KDF-së parasheh: 1. Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës për arsimim dhe, me qëllim që të arrihet kjo e drejtë, hap pas hapi dhe mbi bazën e mundsive të barabarta, në mënyrë të veçantë ata: (a) Bëjnë arsimin fillor të detyrueshëm dhe falas për të gjithë, (b) Inkurajojnë zhvillimin e formave të ndryshme të arsimit të mesëm si të përgjithshëm, dhe profesional, i bëjnë ato të hapura e të mundshme për çdo fëmijë dhe marrin masa të përshtatshme, si vendosja e arsimit falas dhe dhënia e një ndihme financiare në rast nevojë, (c) U sigurojnë të gjithëve arsimin e lartë, sipas aftësive të secilit, me të gjitha mjetet e përshtatshme, (d) Bëjnë të mundshëm dhe të arritshëm për çdo fëmijë informacionin dhe orientimin shkollor e profesional, (e) Marrin masa për të inkurajuar frekuentimin e rregullt të shkollës dhe uljen e përqindjes së braktisjes së shkollës. 2. Shtetet Palë marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që disiplina shkollore të zbatohet në mënyrë të pajtueshme me dinjitetin njerëzor të fëmijës dhe në përputhje me këtë Konventë. 3. Shtetet Palë nxisin dhe inkurajojnë bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e arsimit, për të kontribuar, në mënyrë të veçantë, në zhdukjen e padijes dhe të analfabetizmit kudo në botë dhe për të lehtësuar përvetësimin e njohurive shkencore e teknike dhe të metodave moderne të mësimdhënies. Për këtë, mbahen parasysh në mënyrë të veçantë nevojat e vendeve në zhvillim.

¹²¹ Haxhi Gashi/Abdullah Aliu/Adem Vokshi, "Komentar" Ligji për Familjen i Kosovës, fq.294

¹²² Bardhyl Hasanpapaj & Vjosa Osmani, Fëmijët e rrugës në Kosovë, Prishtinë, 2004, fq.23

Sipas këtij parimi LFK synon të siguroj mbrojtjen e të drejtave të fëmijës në radhë të parë nga shfrytëzimi ekonomik- që nënkupton të drejtën e çdo personi për të, që të zgjedh punën e tij. Në veçanti kur bëhet fjalë për fëmijët punësimi mund të jetë vetëm brenda aftësive të tij psikike dhe fizike dhe vetëm për orar të caktuar që parashihet me ligj të veçantë, sepse për punësimin e fëmijëve kërkohet moshë e caktuar dhe vetëm për orar të caktuar dhe të përshtatshëm. Ndalesë tjetër sipas këtij parimi parashihet mbrojtja nga trafikimi dhe eksploatimi seksual- që nënkupton së trafikimi dhe eksploatimi seksual i fëmijëve hynë në kategorinë e veprimeve antiligjore që parashihet me legjislacionet e të gjitha vendeve e edhe me legjislacionin e vendit tonë.

Duhet theksuar faktin së Republika e Kosovës me legjislacionin pozitiv trafikimin dhe eksploatimin seksual e parashih si vepër penale e cila bën pjese në grupin e veprave penale kundër jetës dhe trupit, veprat penale kundër nderit dhe autoriteti si dhe veprat penale kundër integritetit seksual. Për këto vepra sanksionet penale janë mjaft të ashpra pasi që konsiderohen vepra të rënda penale. Kjo ndalesë e përcaktuar më dispozita e LFK-së është në pajtim edhe në nenin 19 par 1 të KDF-së, e cila përcakton së: 1. Shtetet Palë marrin të gjitha masat legislative, administrative, shoqërore dhe edukative për mbrojtjen e fëmijës nga çdo formë e dhunës fizike ose mendore, fyerja ose keqtrajtimi, braktisja apo mospërfillja, nëpërkëmbja ose shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual, për sa kohë që ai është nën ruajtjen e prindërve të tij ose të njërit prej tyre, të përfaqësuesit ose përfaqësuesve të tij ligjorë ose të çdo personi tjetër të cilit i është besuar.

Në kuadër të këtij parimi përfshihet edhe ndalesa tjetër e njohur si mbrojtja nga puna që paraqet rrezik ose cenon edukimin apo dëmton shëndetin e fëmijës- që nënkupton së fëmijët nuk mund të punojnë punë të cilat paraqitën së të rrezikshme për shëndetin dhe pengojnë edukimin e tyre si për shembull punët e rënda fizike, punët gjatë orarit të natës, punët gjatë orarit të vijimit të shkollimit etj.¹²³ Sipas ligjit të punës fëmijët e moshës 15 deri 18 vjeçare mund të themelojnë marrëdhënie të punës vetëm për punë të lehta dhe të cilat nuk janë të dëmshme për shëndetin e fëmijës dhe nuk paraqesin rrezik për mirërritjen dhe edukimin e tyre. Sipas ligjit të punës për fëmijët e para moshës 15 vjeçare është e ndaluar themelimi i marrëdhënies së punës.

Fëmijët duhet të mbrohen nga keqtrajtimi dhe dhunimi seksual – ndalimi i keqtrajtimit dhe dhunës seksuale ndaj fëmijëve është standard ndërkombëtar që duhet respektuar, sepse është garantuara më aktet ndërkombëtare të cilat parashohin ndalimin e çfarëdo “ dhunë formë e dhunës fizike ose mendore, fyerja ose keqtrajtimi, braktisja apo mospërfillja, nëpërkëmbja ose shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual, për sa kohë që ai është nën ruajtjen e prindërve të tij ose të njërit prej tyre, të përfaqësuesit ose përfaqësuesve të tij ligjorë ose të çdo personi tjetër të cilit i është besuar”.¹²⁴

¹²³ Haxhi Gashi/Abdullah Aliu/adem Vokshi, “Komentar” Ligji për Familjen i Kosovës, fq.294

¹²⁴ Konventa për të drejta e fëmijëve, neni 19 par 1.

Në kuadër të këtij parimi parashihet ndalimi i keqtrajtimit dhe ndalimi i dhunës seksuale. Ndalimi i keqtrajtimit nënkupton së ndaj fëmijëve keqtrajtimi dhe dhuna janë të ndaluara me aktet ndërkombëtare dhe me ligjet vendore ashtu që mosrespektimi i kësaj ndalese nënkupton edhe mundsin e heqjes së të drejtës prindërore për prindërit që keqtrajtojnë fëmijët e tyre.

LFK privimin nga kujdesi prindërore e parasheh me dispozitat e nenit 149 ndërsa konventa për të drejta e fëmijëve me dispozita e nenit 9. Keqtrajtimi i fëmijëve është edhe vepër penale.

Ndalimi dhunës seksuale është një ndalesë ligjore pasi që marrëdhëniet seksuale me fëmijë janë të ndaluara me ligj. Çfarëdo forme e marrëdhënies seksuale me fëmijët konsiderohet edhe si dhunë seksuale, sepse kanë mungesë vullneti për shkak së fëmijë nuk ka zotësi për të vepruar.¹²⁵ Në kuptimin e ngush dhuna seksuale ndaj fëmijë nënkupton kryerjen e marrëdhënies seksuale pa vullnetin fëmijëve. Mungesa e vullneti në raste të tilla i referohet mungesës së zotësisë së veprimit për fëmijët e cila fitohet me moshën madhore e e cila nënkupton edhe mundsin që me arritjen e moshës madhore fëmija edhe të mund të shpreh vullnetin. Në këtë drejtim duhet të merren masa parandaluese të cilat parashihen me KDF neni 19 par 2, si: procedura të efektshme për hartimin e programeve shoqërore për përkrahjen e nevojshme të fëmijës dhe atyre që kujdesen për të, si dhe për forma të tjera parandalimi dhe identifikimi, raportimi, referimi, hetimi, trajtimi dhe ndjekjeje të rasteve të keqtrajtimit të fëmijës, të përshkruara më lartë, duke përfshirë, nëse duhet, procedurat e ndërhyrjes gjyqësore.

Fëmijët duhet mbrojtur nga përdorimi i paligjshëm i drogave dhe substancave psikotrope dhe nuk duhet lejuar që fëmijët të përdoren për prodhimin dhe trafikimin e paligjshëm të këtyre lëndëve – përdorimi i drogave dhe mjeteve tjera narkotike janë të ndaluara për secilin person, në këtë kuptim ato janë të ndaluara edhe për përdorim nga fëmijët, mirëpo, kujdesi për fëmijët duhet të jetë një detyrë e prindërve ose kujdestarëve për të marrë masa mbrojtëse ndaj fëmijëve nga përdorimi i paligjshëm i drogave ose substancave tjera psikotrope. Një detyrim i tillë është i institucioneve arsimore, shëndetësore, ose institucioneve tjera mbikëqyrëse për përkujdesjen ndaj fëmijëve.¹²⁶ Neni 33 i Konventës kërkon nga shtetet që të “ndërmarrin të gjitha masat e duhura, duke përfshirë ato legjislative, administrative, shoqërore dhe edukative, për të mbrojtur fëmijët nga përdorimi i paligjshëm i materieve narkotike dhe lëndëve psikotrope, siç përcaktohet në konventat përkatëse ndërkombëtare...”.

Përveç parimeve të cekura LFK, me dispozitat e nenit 70 parasheh parimet e mbrojtjes së fëmijëve gjata procedurës së shkurorëzimit si në vijim:

- Bashkëshortët nuk do të parashirojnë padi për shkurorëzim gjatë shtatzënisë së gruas dhe derisa fëmija i tyre i përbashkët t'i këtë mbushur një vit;

¹²⁵ Haxhi Gashi/Abdullah Aliu/Adem Vokshi, “Komentar” Ligji për Familjen i Kosovës, fq.297.

¹²⁶ Po aty, fq.297.

- Së bashku me propozimin për shkurorëzim me marrëveshje të dyanshme, bashkëshortët janë të detyruar të parashtrajnë marrëveshjen me shkrim për përkujdesje, edukim dhe ushqim të fëmijëve të tyre të përbashkët si dhe propozimin me shkrim mbi atë se si kontaktet personale mes fëmiut dhe të dy prindërve do të garantohen në të ardhmen;
- Leja për shkurorëzim mund të mos jepet ose mund të shtyhet edhe pse martesë ka dështuar vetëm në raste të veçanta nëse dhe përderisa ruajtja e martesës bëhet për arsye specifike, të domosdoshme për interesin e fëmijës.

Parimi i mbrojtjes së veçantë të disa personave në procedurë- që nënkupton faktin se gjatë të gjitha fazave të procedurës së shkurorëzimit, gjykata duhet të ketë parasysh mbrojtjen e interesave të fëmijëve të mitur, të personave të sëmurë, të cilët nuk janë në gjendje të kujdesen për të drejtat dhe interesat e tyre.¹²⁷

Kujdesi prindëror

LFK me dispozitën e nenit 128 par. 4 të këtij ligji përkufizon përgjegjësinë prindërore në të cilën përfshihen të drejtat dhe detyrat që kanë për qëllim të sigurojnë mirëqenien emocionale, sociale dhe materiale të fëmijës, duke u kujdesur për të, duke mbajtur raporte vetjake me të, duke i siguruar mirërritjen, edukimin, arsimimin, përfaqësimin ligjor dhe administrimin e pasurisë, për të cilat gjëra prindërit duhet t'i kenë në konsiderim aftësitë, prirjet dhe dëshirat e fëmijëve të tyre. Konventës për të drejtat e fëmijëve, neni 18 përcakton se *“të dy prindërit kanë përgjegjësi të përbashkëta për mirërritjen dhe zhvillimin e fëmijëve dhe interesat e fëmijëve paraqesin brengën themelore të tyre”*.

Interesimi i fëmijëve është elementi qenësor në të drejtën prindërore, përkatësisht në marrëdhëniet e fëmijëve i cili duhet të mbrohet nga prindërit por edhe nga gjykata e cila zhvillon procedurën gjyqësore në konteste të shkurorëzimit dhe anulimit të martesës dhe atë sipas detyrës zyrtare. Kujdesi prindëror përfshin të gjitha të drejtat dhe detyrat e kujdesit të përcaktuar më LFK.¹²⁸ Kujdesin prindëror e ushtrojnë të dy prindërit bashkërisht dhe më marrëveshje.¹²⁹ Nëse njëri nga prindërit ka vdekur ose është shpallur i vdekur, ose nuk i është dhënë kujdesi prindëror ose i është marrë ajo, kujdesi prindëror i takon prindërit tjetër.¹³⁰

Prindërit rëndom e ushtrojnë së bashku kujdesin prindëror. Të dy prindërit kanë të drejtë dhe detyrim që në mënyrë të barabartë të ushtrojnë kujdesin prindëror ndaj fëmijëve të tyre. Është në vullnetin e prindërve që më marrëveshjen e tyre të vendosin për mënyrë e ushtrimit të kujdesit prindëror ndaj fëmijëve përkatësisht së cilat veprime do të ndërmerren njëri prind e cilat prini tjetër.

¹²⁷ Hamdi Podvorica, vepra e cituar, fq.126.

¹²⁸Neni 137 par 1 i LFK-së.

¹²⁹Neni 137 par 2 i LFK-së.

¹³⁰Neni 137 par 3 i LFK-së.

Prindërit duhet të merren vesh për mënyrë e kryerjes së verimeve rreth ushtrimit të kujdesit prindëror si për shembull për vendosje lidhur më shkollimin e fëmijëve, përkujdesjen shëndetësore, mbajtjen etj.¹³¹ Kjo do të thotë së prindërit nuk duhet të vendosin në mënyrë arbitrare pa pëlqimin e prindërit tjetër. Por dispozitë (neni 137 par 2) flet edhe për faktin se ata mund të merren vesh për ndarjen e punëve rreth përkujdesjes ndaj fëmijës, që njëri prind t'i kryhej disa punë, tjetri punët tjera, por kuptohet gjithmonë më marrëveshje.

Por kuptimin e dispozitës duhet zgjeruar ashtu që jo gjithmonë dhe për çdo veprim domosdoshmërisht të kërkohet pëlqimi i të dy prindërve.¹³²

Kur njëri prind është i vdekur e drejta e ushtrimit të kujdesit prindëror i takon prindit tjetër.

Në raste e mos kujdesit apo keqpërdorimit të të drejtave prindërore mund të ndodh që njërit prind ti hiqet e drejta prindërore edhe në raste të tilla të drejtën prindërore e ushtron prindi tjetër. Në raste kur njëri prind është i pa aftë për të vepruar për shkak së i është marrë aftësia e veprimit, kujdesin prindëror e ushtron prindi tjetër.

Ushtrimi i kujdesit nga Organi i Kujdestarisë

Më dispozitë e nenit 138 të LFK-së, është para ushtrimi i kujdesit nga Organi i Kujdestarisë. Sipas kësaj dispozitë parashihet së Organi i Kujdestarisë vendo në emër të interesave të fëmijës vetëm më kërkesën e njërit ose të dy prindërve, me kërkesën e personit të tretë, në rastet kur kujdesi i fëmijës është nën mbikëqyrjen e tij ose me vendimin e gjykatës.

Ligji për Familjen në nenin 6 përcakton se organ kompetent për mbrojtjen institucionale të të drejtave është Organi i Kujdestarisë. Rolë të veçantë Organi i Kujdestarisë ka në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror (kujdestaria, strehimi familjar, strehimi rezidencial dhe adoptimi), të cilët siç e kemi cekur më lartë gëzojnë mbrojtje të posaçme shoqërore. Në këtë drejtim neni 158 i LFK-së normon se vendimin mbi zbatimin e cilësdo formë të mbrojtjes së fëmijëve pa kujdes prindëror merret pas shqyrtimit të hollësishëm të secilit rast individualisht, ndërsa organi kompetent do të nxjerrë përfundim për formën e mbrojtjes së familjes për fëmijën që i plotëson kërkesat e fëmijës në masë të madhe.

Edhe Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare (me ndryshimet e tij), në nenin 7 ndër të tjera përcakton rolin e Qendrave për Punë Sociale dhe obligimin e kësaj të fundit që të themelojë Organin e Kujdestarisë¹³³. Gjithashtu ky ligj përcakton detyrimet e QPS-le, gjegjësisht Organit të Kujdestarisë në lidhje me shërbimet që duhet të ofrojnë për fëmijët pa kujdes prindëror, ndërsa në parag. 1 të nenit 9 të këtij ligji theksohet detyrimi i këtyre institucioneve që në të gjitha çështjet lidhur me ofrimin e shërbimeve për fëmijë dhe familje, interesi më i mirë i fëmijës duhet të jetë

¹³¹Haxhi Gashi/Abdullah Aliu/Adem Vokshi, "Kommentar" Ligji për Familjen i Kosovës, fq.318.

¹³²Po aty, fq.318-319.

¹³³ Shih Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare, Ligji Nr. 02/L-17, neni 7 par.2

konsiderata e parë dhe më e rëndësishme. Kjo është në përputhje edhe me kërkesat që dalin nga Konventa për të drejtat e fëmijës. Posaçërisht me këtë ligj është përcaktuar detyrimi i Organit të Kujdestarisë që të zbatojë masat mbrojtëse institucionale në të gjitha rastet kur janë në pyetje të drejtat e fëmijëve pa kujdes prindëror.

Ushtrimi i kujdesit mund të bëhet më kërkesën e njërit apo të dy prindërve, pastaj më kërkesën e personit të tret, me vendimin e gjykatës dhe ex officio nga organi i kujdestarisë.

Besimi, ruajtja dhe kujdesi i fëmijëve si dhe kontakti

Çështje më rëndësishme procedurën e shkurorëzimit në mes të bashkëshortëve është besimi i fëmijëve. Rëndësia e kësaj çështje konsiston edhe në faktin se bashku më shkurorëzimin vendoset edhe për çështjen e besimit të fëmijëve. Pra në procedurën e njëjtë dhe me vendimin e njëjtë. Sipas dispozitës së nenit 140 par 1, të LFK-së, përcaktohet se: kur gjykata kompetente në kontestet martesore e merr aktgjykimin me të cilin zgjidhet ose anulohet martesa me atë aktgjykim gjykata do të vendos për ruajtjen dhe edukimin e fëmijëve të mitur. Në raste të tilla në qoftë se panderit nuk janë marrë vesh për besimin e fëmijëve apo në qoftë se marrëveshja e tyre nuk i përgjigjet interesave të fëmijëve, gjykata pasi të marrë mendimin e Organit të Kujdestarisë dhe të hetoj të gjitha rrethanat, do të vendos: që të gjithë fëmijët të mbetën për ruajtje dhe edukim të njëri prind, që disa të mbesin të nëna, kurse disa tek i ati, që të gjithë ose disa fëmijë t'i besohen ndonjë personi të tretë.¹³⁴

Çështje me rëndësi përveç besimit të fëmijëve është edhe caktimi i kontaktit të fëmijës më prindin tjetër. Çështje e besimit të fëmijës sipas dispozitave të LFK-së, përveç në mes të prindërve mund të paraqitet edhe në raport me personin e tretë.

Besimi i fëmijëve në mes të prindërve, në raport me personin e tretë dhe caktimi i kontaktit në mënyrë specifike do të trajtohet në vijim të këtij punimi.

Vendimi i gjykatës për ushtrimin e te drejtave prindërore

Gjykata gjatë procedurës së shkurorëzimit shqyrton njëkohësisht edhe çështjen e besimit të fëmijëve e cila duhet të vendoset më aktgjykimin me të cilin vendoset për zgjidhjen e martesës. Është detyrë e gjykatës që nëse prindërit nuk merren vesh për besimin e fëmijëve atëherë zyrtarisht gjykata të vendos për besimin e fëmijëve. Gjykata para se të marr vendimin për besimin e fëmijëve duhet të marrë mendimin dhe propozimin e organit të kujdestarisë shqyrton të gjitha rrethanat që janë me rëndësi për zhvillimin e drejtë psikik dhe fizik si dhe për edukimin e drejtë të fëmijës, siç janë: nevojat emocionale të fëmijëve, dëshira e fëmijës nëse i ka mbushur dhjete vjet, moshja e fëmijës, gjendjen shëndetësore të fëmijës dhe të prindit dhe vetit e ndryshme të prindërve.¹³⁵

¹³⁴Neni 140 par 2, i LFK-së.

¹³⁵Gani Oruçi, vepra e cituar, fq.107.

Prindërit kanë detyrim ligjor të ofrojnë mbajtje për fëmijët e tyre të mitur, të kujdesën për për shëndetin, edukimin, arsimimin dhe për aftësimin e tyre për punë të pavarur derisa të mbushin moshën madhore, ndërsa në kushte të përcaktuara ligjore edhe pas moshës madhore (deri në moshën 26 vjeçare nëse vazhdojnë shkollimin).¹³⁶

Ligji për Familjen i Kosovës në nenin 140 përcakton vendimet të cilat i merr gjykata në rastet kur është në pyetje ushtrimi i të drejtave dhe detyrave prindërore. Në këtë drejtim përcaktohet se në rastet kur gjykata kompetente në kontestin martesor e merr aktgjykimin me të cilin zgjidhet apo anulohet martesa, me të njëjtin aktgjykim gjykata do të vendosë për ruajtjen dhe edukimin e fëmijëve të mitur.

Nëse prindërit nuk janë marrë vesh për rastin e përmendur më lartë, ose nëse marrëveshja e tyre nuk u përgjigjet interesave të fëmijëve, gjykata pasi të marrë mendimin dhe propozimin e Organit të Kujdestarisë dhe të hetojë të gjitha rrethanat, do të vendosë që të gjithë fëmijët të mbeten për ruajtje dhe edukim te njëri prind, që disa të mbesin te nëna, kurse disa tek babai, ose të gjithë apo disa fëmijë t'i besohen ndonjë personi tjetër. Gjithashtu nëse prindi i cili e ushtron kujdesin prindëror pengon kontaktet personale të fëmijës me prindin tjetër, gjykata me aktgjykim do të rregullojë edhe mënyrën e mbajtjes së kontakteve personale të fëmijës me prind, i cili nuk e ushtron kujdesin prindëror, nëse vlerësimi i të gjitha rrethanave të rastit tregon se kjo është e domosdoshme për mbrojtjen e fëmijës.

Po ashtu gjykata me kërkesën e njërit prind ose të OK, do të ndryshojë vendimin mbi kujdestarinë, nëse për këtë gjë e kërkojnë rrethanat e ndryshuara. Gjithsesi mendimi i fëmijës, i cili është i aftë të jap pikëpamjet e tij, do të merret parasysh nga gjykata në çdo procedurë që i përket atij, ndërsa mendimit të tij do t'i jepet pesha e duhur në pajtim me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar.

Në të gjitha procedurat e përmendura më lartë, gjykata duhet të ketë në konsideratë parësore interesin më të mirë të të miturit, i cili gjen zbatim edhe përmes zgjidhjes së shpejtë e pa vonesa të këtyre problemeve, pa zvarritje nga ana e gjykatës. Kjo do të thotë që gjykata duhet të vendosë brenda një afati optimal në rastet e një vendimi mbi arsimimin, përgjegjësinë prindërore, përkujdesjen, kontaktet me prindin, kujdestarinë, masat urgjente që duhen marrë etj.

Kjo mund të arrihet përmes një menaxhimi të rastit, jo vetëm profesionalisht, por edhe brenda një kohe sa më të shkurtër. Kohëzgjatja e procedurave gjyqësore, në rastet e konflikteve ose mosmarrëveshjeve familjare, konsiderohet edhe si një shkelje e nenit 8 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, sepse respektimi efektiv i jetës familjare kërkon që marrëdhëniet e ardhshme ndërmjet prindërve dhe fëmijës të përcaktohen jo duke kapërcyer afate kohore, që do të çonte në një zgjidhje de facto të çështjes përpara asaj de jure.

¹³⁶Neni 290 par 1 dhe 2, i LFK-së.

Besimi i fëmijës ndërmjet prindit dhe caktimi i kontaktit për tjetrin

Edhe pas zgjidhjes së martesës qoftë me shkurorëzim apo anulim fëmijët e ruajnë statusin e fëmijëve martesor. Konsiderohet se fëmija ka lindur në martesë, nëse prindërit e tij janë të martuar në kohën e lindjes së fëmijës (neni 100 i LFK-së). Po ashtu konsiderohet fëmijë martesor edhe fëmija që ka lindur brenda 300 ditësh pas zgjidhjes së martesës.

Çështje më rëndësishme procedurën e shkurorëzimit në mes të bashkëshortëve është besimi i fëmijëve. Rëndësia e kësaj çështje konsiston edhe në faktin se bashku me shkurorëzimin vendoset edhe për çështjen e besimit të fëmijëve. Pra në procedurën e njëjtë dhe me vendimin e njëjtë. Sipas dispozitës së nenit 140 par 1, të LFK-së, përcaktohet së: kur gjykata kompetente në kontestet martesore e merr aktgjykimin me të cilin zgjidhet ose anulohet martesa me atë aktgjykim gjykata do të vendos për ruajtjen dhe edukimin e fëmijëve të mitur. Ky përcaktim ligjor paraqet një detyrim për gjykatën që me rastin vendosjes në procedurën e shkurorëzimit të bashkëshortëve ex officio me vendimin e njëjtë të vendos edhe për besimin e fëmijëve. Ky detyrim i gjykatës duhet të përmbushet nga anën e gjykatës pavarësisht nëse ka apo nuk ka kërkesë të bashkëshortëve. Kjo procedurë e vendosjes për besimin e fëmijëve vlen edhe në rastet e shkurorëzimit të martesës edhe në rastet e anulimit të martesës, sepse pavarësisht së martesa anulohet fëmijët konsiderohen fëmijë martesor.

LFK në paragrafin 2 të nenit 140 parasheh së: nëse prindërit nuk janë marr vesh për rastin e cekur në paragrafin (1) ose nëse marrëveshja e tyre nuk u përgjigjet interesave të fëmijëve, gjykata, pasi të marr mendimin dhe propozimin e Organit të Kujdestarisë dhe të hetoj të gjitha rrethanat, do të vendos: që të gjithë fëmijët të mbeten për ruajtje dhe edukim të njëri prind, që disa të mbesin të nën, kurse disa tek ati, që të gjithë ose disa fëmijë ti besohen ndonjë personi të tretë. Në vështrim të dispozitës së lartë cituar rrjedh së bashkëshortet në procedurën e shkurorëzimit mund të merren vesh për besimin e fëmijëve, por gjykata duhet të ketë vëmendjen e duhur nëse marrëveshja e prindërve është në interes të fëmijëve, në të kundërtën gjykata nuk duhet ta pranoj marrëveshjen e prindërve për besimin e fëmijëve. Në raste të tilla gjykata duhet të marrë mendimin e Organit të Kujdestarisë dhe të hetoj të gjitha rrethanat e pastaj të vendos së kujt t'i besohen fëmijët.

Ekziston edhe mundësia që të gjithë fëmijët mos ti besohen njërit apo bashkëshortit tjetër por disa ti besohen njërit e disa tjetrit, por në praktikën gjyqësore janë raste të rralla kur gjykatat vendosi ti ndajnë fëmijët, përveç kur gjykata vlerëson së është në interesin e fëmijëve që disa ti besohen njëri prind e disa prindit tjetër.

Në paragrafin 3 të nenit 140 të LFK-së, është rregulluar mënyra e caktimit të kontaktit ashtu që: nëse prindi i cili ushtron kujdesin prindëror pengon kontakte personale të fëmijës me prindin tjetër, gjykata me aktgjykim do të rregulloj edhe mënyrë e mbajtjes së kontakteve personale të fëmijës me prindin i cili nuk e ushtron kujdesin prindëror, nëse vlerësimi i të gjitha rrethanave të rastit

tregon së kjo është e domosdoshme për mbrojtjen e fëmijës. Pra në raste kur pengohen kontakte e fëmijës me prindin i cili nuk e ushtron kujdesin prindërore, atëherë gjykata më aktgjykim do të vendos edhe për kontaktin e fëmijës me prindin. Në praktikë vendosja për kontaktin e fëmijës me prindin i cili nuk e ushtron kujdesin prindërore është pothuajse pjesë e çdo aktgjykimi me të cilin vendoset për shkursorëzimin e bashkëshortëve dhe për besimin e fëmijëve, kur raste janë iniciuar me padi në gjykatë ndërsa të raste më propozim të përbashkët në shumë raste gjykatat nuk vendosin për kontakte e fëmijës më prindin i cili nuk e ushtron kujdesin prindëror sepse këto kontakte nuk pengohen nga prindi i cili e ushtron kujdesin prindëror.

Lejohet mundsia e ndryshimit të vendimit për besimin e fëmijëve më kërkesën e njërit prind apo të organit të kujdestarisë, nëse këtë e kërkojnë rrethanat e ndryshuara. Në praktikë ka raste kur kërkohet të ndryshohet vendimi për besimin e fëmijëve për shkak të ndryshimit të rrethanave dhe në raste të tilla në qoftë së si rezultat i ndryshimit të rrethanave ka ndryshuar edhe interesi i fëmijëve gjykata do ta ndryshoj vendimi për besimin e fëmijëve.

Besimi i fëmijës personit të tretë

LFK parasheh dy mundsi për besimin e fëmijës personit të tretë dhe atë: a) besimin e përkohshëm të fëmijës personit të tretë dhe b) besimin e fëmijës njërit prind apo personit të tretë.

LFK me dispozitat e nenit 142 e ka rregulluar mundsin e besimit të përkohshëm të fëmijës nga prindërit palës së tretë, ndërsa me dispozitat e nenit 143 e ka rregulluar mundsinë e besimit të fëmijës prindërit apo personit të tretë. Kështu më dispozitën e nenit 142 par 1, parashihet së: kur e kërkojnë interesat e fëmijës, prindi ose prindërit munden përkohësisht t'ia besojnë fëmijën palës së tretë për kujdes dhe edukim, nëse ky person i plotëson kushtet e kujdestarit, ndërsa në paragrafin 2, parashihet së: nëse prindërit ose prindi i cili e ushtron kujdesin prindëror shkojnë përkohësisht në vend tjetër të banimit brenda apo jashtë Kosovës, ata ose ai mund t'ia besojnë për kujdes dhe edukim vetëm personit i cili i plotëson kushte e kujdestarit.

Në vështrim të dispozitës së cituar (paragrafi 1) rrjedh së është në të drejtën e prindërve që vet ata të ja besojnë fëmijën përkohësisht një personi të tretë, por më kusht që këtë besim të përkohshëm të fëmijës ta kërkojnë interesat e fëmijës dhe personi të cilit i besohet përkohësisht fëmija ti plotësoj kushte e kujdestarit. Qëllimi i kësaj dispozite është që fëmija të përfitoj një kujdes me të mirë gjatë periudhës së kujdesit të përkohshëm nga personi i tretë. Vetëm në këtë mënyrë mund të justifikohet qëllimi i dispozitës sipas interesit të fëmijës. Personi të cilit i besohet përkohësisht fëmija duhet ti plotësoj kushte e kujdestarit të cilat LFK i ka përcaktuar me dispozita e nenit 236. Sipas dispozitës së nenit 236 par 1 të LFK-së, parashihet së: si kujdestar mund të jetë çdo person i cili i ka cilësitë personale dhe aftësitë e nevojshme për përmbushjen e detyrave të kujdestarit dhe i cili me parë jep pëlqimin që të bëhet kujdestar.

Sa i përket besimit të fëmijës prindërit apo personit të tretë LFK me dispozitën e nenit 143 par 1 parasheh së: në rast të vdekjes së prindit i cili e ka ushtruar vetë kujdesin prindëror sipas vendimit të gjykatës ose vendimit të Organit të Kujdestarisë ose sipas marrëveshjes me prindin tjetër, si dhe në rast kur ai prind e humb aftësinë për të vepruar ose e braktisë fëmijën, prindi tjetër ka të drejtë të kërkoj që personi të cilit i ndodhet fëmijë për ruajtje dhe edukim. Me paragrafin 2 të nenit 143 parashihet së: në rast të kontestit ndërmjet prindërve dhe personit të tretë, gjykata kompetente mund të vendos që fëmija t'i besohet për ruajtje dhe edukim personit të i cili ndodhet fëmija, ndonjë personi ose institucioni tjetër, nëse në bazë të mendimit dhe propozimit të marrë nga Organi i Kujdestarisë, pasi ti hetoj të gjitha rrethanat, konstaton së interesat e fëmijës e kërkojnë një gjë të tillë.

Vdekja e njërit prind tek të cili ndodhet fëmija në kujdesej i jep të drejtë prindit tjetër të kërkoj kujdesin e fëmijës dhe kjo është njëmendësi ligjore për prindin që ti besohet fëmija.

Në rastin kur prindi të cilit i është besuar fëmija e humb aftësinë e veprimit të prindit kujdestar, prindi tjetër ka të drejtën që të kërkoj që ti besohet fëmija. Humbja e aftësisë së veprimit të një personi e bën të pamundur atë person të kryejë në mënyrë të pavarur të drejtat dhe detyrat në emër deh në llogari të vet. Si rrjedhojë, kjo reflekton edhe të përkujdesja ndaj fëmijës, sepse personi që ka humbur aftësinë e veprimit nuk mund të ushtroj kujdesin ndaj fëmijës.¹³⁷

Situatë tjetër është braktisja e fëmijës nga prindi kujdestar e cila është rrethanë që prindi tjetër të kërkoj besimin pasi që fëmija ka mbet pa përkujdesje.

Ekziston edhe mundsi e ekzistimit të kontesti në mes të prindërve dhe personit të tretë. Kontesti i tillë gjithmonë supozohet së ekziston lidhur më përkujdesjen, mbajtjen, edukimin dhe shkollimin e fëmijës. Në raste të tilla nevojitet vendimi i gjykatës për të vendosur së ku do të mbete fëmija në përkujdesje, të ai person ku gjendet fëmija, të ndonjë person tjetër ose në ndonjë institucion për përkujdesjen e fëmijëve.¹³⁸Në të gjitha kontestet familjare sidomos tek ato ku përfshihen fëmijët dhe interesi i tyre ftohet Organi i Kujdestarisë të jep mendimin profesional.

Në këto raste sipas dispozitave të lartë cituara përveç mendimit profesional të Organit të Kujdestarisë, gjykata gjatë procedurës së vendosjes duhet të shqyrtoj të gjitha provat e nevojshme për të mbrojtur interesat e fëmijëve dhe për të vendosur se ku do të mbete fëmija. Si rrethana të cilat duhet të merren në vlerësim nga ana e gjykatës duhet të jenë rrethanat që janë me rëndësi për zhvillimin e drejt psikik dhe fizik dhe për edukimin e fëmijës.¹³⁹ Në rast së fëmija është mbi moshën 10 vjeç, gjykata do të marrë parasysh posaçërisht nevojat emocionale dhe dëshirat e

¹³⁷Haxhi Gashi/Abdullah Aliu/Adem Vokshi, "Kommentar" Ligji për Familjen i Kosovës, fq.334.

¹³⁸Po aty, fq.335.

¹³⁹Neni 144 par 1, I LFK-së.

fëmijës. Nëse e mendon të rëndësishëm gjykata mund të marrë parasysh edhe mendimin e ekspertëve.¹⁴⁰

Roli i Organit të Kujdestarisë në procedurën e besimit të fëmijës

LFK me dispozita e nenit 6 ka përcaktuar mbrojtjen institucionale të të drejtave të fëmijëve nga Organi i Kujdestarisë. Neni 6 par 1, i LFK-së, përcakton së punët e mbrojtjes dhe të ndihmës familjare do ti ushtroj organi kompetent i administratës komunale i cili është kompetent për punët e mbrojtjes sociale. Në paragrafin 4 të nenit 6 të LFK-së, parashihet së Organi i Kujdestarisë pjesëmarrës në procedurë është i autorizuar të bëj propozime për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, të praqes fakte të cilat nuk janë përfshirë, të propozoj dhe të administrimin e provave të domosdoshme, të ushtroj mjetet juridike dhe të ndërmarr veprime tjera gjyqësore.

Gjykata është e obliguar të ftoj në gjykatën Organin e Kujdestarisë pjesëmarrës në procedurë në të gjitha seanca gjyqësore dhe ti dorëzojë ati të gjitha vendimet. në vështrim të këtyre dispozitave rezulton se pjesëmarrja e Organit të Kujdestarisë në procedurat gjyqësore ku përfshihen fëmijët është e domosdoshme.

Organi i kujdestarisë si organ i specializuar, ka përgjegjësi dhe të drejte të ndërmarr veprime procedurale që kanë të bëjnë me paraqitjen e fakteve dhe provave të cilat nuk janë paraqitur në seancë gjyqësore, të përdor mjete juridike (padi, ankesë ose mjete e jashtëzakonshme) për të mbrojtur interesat e fëmijëve në të gjitha procedurat gjyqësore.¹⁴¹

Në procedurën e besimit të fëmijëve roli i Organit të Kujdestarisë përcaktohet edhe në mënyrë specifike, pasi që me dispozitën e nenit 144 para 1, parashihet së Gjykata ose Organi i Kujdestarisë, i cili merr vendim mbi besimin e fëmijës për ruajtje dhe edukim, ka për detyrë që në mënyrë të përshtatshme ti hetoj të gjitha rrethanat që janë më rendësi për zhvillimin e drejt psikik dhe fizik dhe për edukimin e fëmijës. Pra në këtë rast këtij organi me ligj i është dhënë një përgjegjësi e rëndësishme për besimin e fëmijëve, ashtu që roli i tij është me rendësi vendimtare sepse një numër rrethanash gjykata do ti hetoj përmes këtij organi dhe rrjedhimisht edhe vendimi i gjykatës për besimin e fëmijëve në masë të madhe do të varët në rrethanat e hetuar nga ky organ.

Në procedurën e besimit të fëmijës njërit ose personit të tretë, roli i Organit të Kujdestarisë, është tejet i rëndësishëm pasi që me dispozitën e nenit 143 par 2, të LFK-së, parashihte së në rast kontesti ndërmjet prindërve deh personit të tretë, gjykata kompetente mund të vendos që fëmija ti besohet për ruajtje dhe edukim personit të i cili ndodhet fëmija, ndonjë personi ose institucioni tjetër, në bazës të mendimit dhe propozimit të marrë nga Organi i Kujdestarisë, pasi ti hetoj të gjitha rrethanat, konstaton së interesat e fëmijës e kërkojnë një gjë të tillë. Nga kjo rezulton së në një

¹⁴⁰Neni 144 par 2, I LFK-së.

¹⁴¹Haxhi Gashi/Abdullah Aliu/Adem Vokshi, “Kommentar” Ligji për Familjen i Kosovës, fq.37.

procedurë të tillë mendimi profesional i Organit të Kujdestarisë është i domosdoshëm dhe me rëndësi esenciale për vendosjen e gjykatës.

Alimentacioni

Mbajtja e fëmijëve nga prindërit nënkupton përgjegjësin e të dy prindërve që të sigurojnë rregullisht fëmijës të mira materiale për plotësimin e nevojave për jetë.¹⁴²Mbajtja e fëmijëve është detyrim ligjor për prindërit. LFK, më dispozitën e nenit 290 par 1 përcakton se “prindërit janë të detyruar të ofrojnë mbajtje financiare për fëmijët e mitur”, ndërsa më dispozitën e paragrafit 2 parashihet se “nëse fëmija nuk e ka përfunduar shkollimin deri në moshën madhore, prindërit kaun detyrim të ofrojnë mbështetjen e nevojshme për të siguruar shkollimin, respektivisht edukimin në fakultet deri në moshën 26 vjeçare”.

Mbajtja e fëmijëve nga prindërit është njeri nga detyrimet ligjore të prindërve, i cili duhet të përmbushet siç përcakton ligji. Mbajtja financiare e fëmijës është obligim prindëror si për fëmijët martesor ashtu edhe për fëmijët jashtë martesor, gjithashtu si në rastet kur prindërit jetoj në bashkësi më familje ashtu edhe në rastet kur prindërit nuk jetojnë në bashkësi me familjet. Prindërit janë të detyruar të sigurojnë mbajtje financiare fëmijëve të mitur pa marrë parasysh gjendjen financiare të tyre, mendohet edhe kur nuk janë në marrëdhënie pune, por kanë mjete të tjera, gjithmonë duhet marrë parasysh mundsit reale të prindërve, mendohet edhe kur krijojnë të radhuar në forma tjera përveç marrëdhënies së punës.¹⁴³

Zbatimi i parimeve të përgjegjësisë së prindërve

E drejta prindërore është tërësi rregullash juridike me të cilat rregullohen marrëdhëniet midis prindërve dhe fëmijëve, midis adoptuesit dhe të adoptuarit, midis kushërinjve dhe personave të tjerë në gjini.¹⁴⁴Në kuadrin e të drejtës prindërore ekziston edhe përgjegjësia prindërore e cila është po ashtu e rregulluar më norma pozitive të LFK-së, dhe atë nga neni 128 e deri të neni 145.

LFK me dispozita e nenit 128 parasheh parimet e përgjegjësisë prindërore si në vijim:

1. Përgjegjësia prindërore rezulton fillimisht nga e drejta për kujdes prindëror
2. Fëmija është nën përgjegjësi prindërore deri në moshën madhore.
3. Prindërit janë të detyruar të sigurojnë në çdo kohë që parimet e përcaktuara në nenin 125 të këtij Ligji përdoren për mbrojtjen e fëmijëve të tyre të mitur.
4. Përgjegjësia prindërore përfshin të drejtat dhe detyrat që kanë për qëllim të sigurojnë mirëqenien emocionale, sociale dhe materiale të fëmijës, duke u kujdesur

¹⁴² Gani Oruçi, vepra e cituar, fq.125

¹⁴³ Haxhi Gashi/Abdullah Aliu/Adem Vokshi, “Komentar” Ligji për Familjen i Kosovës, fq.597

¹⁴⁴Hamdi Podvorica, vepra e cituar, fq.173.

për të, duke mbajtur raporte vetjake me të, duke i siguruar atij mirërritjen, edukimin, arsimimin, përfaqësimin ligjor dhe administrimin e pasurisë.

5. Duke i zbatuar këto parime, prindërit duhet t'i kenë në konsiderim aftësitë, prirjet dhe dëshirat e fëmijëve të tyre.

Parimi i parë i përgjegjësisë prindërore i referohet detyrimit të prindërve kujdesit prindëror që nënkupton detyrimin ligjor të prindërve për mbajtjen, strehimin, edukimin, shkollimin etj. Përgjegjësia prindërore konsiderohet edhe si e drejtë prindërore pasi që janë prindërit ata që kaun të dejtë të kujdesën për fëmijët e tyre dhe mbi këtë bazë edhe kanë të drejtën që të ndërmarrin disa veprime në emrin dhe fëmijëve siç është përfaqësimi i fëmijëve, administrimi i pasurisë së fëmijëve, mbledhja dhe tjetërsimi i fryteve nga pasuria e fëmijëve etj.

Pari i dytë i referohet kufizimit të së drejtës prindërore përkatësisht përgjegjësisë prindërore me arritjen e moshës madhore të fëmijës. Sipas këtij parimi prindërit kanë përgjegjësisë prindërore deri në arritjen e moshës madhore të fëmijës. Me arritjen e moshës madhore fëmija fiton aftësinë e veprimit rrjedhimisht të drejtën që i pavarur të ndërmerr veprim në emër dhe për llogari të vet. Përjashtim nga arritja e moshës madhore për fëmijën bën emancipimi i fëmijës para moshës madhore në këtë rast e drejta prindërore përkatësisht përgjegjësia prindërore kufizohet me emancipimin e fëmijës para moshës madhore.

Parimi i tretë i referohet realizmit të drejtave dhe detyrave lidhur më përkujdesjen prindërore të cilën detyrohen ta sigurojnë prindërit duke respektuar parimet sipas neni 125 të LFK-së, që më gjerësisht janë trajtuar të pjesa mbrojtja e të drejtave të fëmijëve. Kuptimi i këtij parimi qëndron në domosdoshmërinë së gjatë ushtrimit të të drejtave prindërore, çdo veprim ose çdo e drejtë dhe detyrë duhet të ketë këndvështrimin në parimet themelore të përcaktuar në nenin 125, të cilat përcaktojnë së cilat veprime duhet ndërmarr për mbrojtjen e interesave dhe personalitetit të fëmijëve.¹⁴⁵

Parimi i katërt i referohet disa të drejtave dhe detyrave të prindërve ndaj fëmijëve të cilat janë numëruar në mënyrë taksative si sigurimi i mirëqenies emocionale, mirëqenies materiale, përkujdesjes, mbajtjes së raporteve vetjake dhe mirëmbajtjes së fëmijëve, përkujdesjes për edukim dhe arsim, përfaqësimin ligjor dhe administrimit të pasurisë së fëmijëve.

Të drejta dhe detyrimet e prindërve të përcaktuar sipas parimit të katërt kanë kuptim specifike dhe të rëndësishme për përgjegjësin prindërore. Në këtë kuptim sipas këtij parimi prindërit janë të detyruar të sigurojnë mirëqenie emocionale për fëmijët. Mirëqenia emocionale mund të ketë kuptim relativ sa i përket vëllimit të mirëqenies emocionale që duhet të ofrojnë prindërit për fëmijët. Mirëpo gjithsesi kjo nënkupton detyrimin e prindërve që të krijojnë qetësi shpirtërore për fëmijët e tyre. Qetësia shpirtërore përfshin edhe ndjenjat emocionale duke nënkuptuar që ata të

¹⁴⁵ Haxhi Gashi/Abdullah Aliu/Adem Vokshi, "Komentar" Ligji për Familjen i Kosovës, fq.302

ndihen të qetë, p frikë, dhe të siguritë në një mjedis familjar ku nuk ka trauma ose trazime me ndjenjat e fëmijëve.¹⁴⁶

Sigurimi i mirëqenies sociale dhe materiale sipas këtij parimi nënkupton po ashtu një detyrim specifik për prindërit në raport me fëmijët i cili duhet kuptuar si detyrimi i prindërve për të siguruar kushte për zhvillim normal të fëmijës dhe rrjedhimisht edhe kushte materiale për jetesën e fëmijëve. Prindërit duhet që fëmijëve tu sigurojnë kushtet e nevojshme fiziologjik, higjienik, shëndetësore si dhe me fëmijët e tyre të zhvillojnë marrëdhënie dashurie, besimi e mirëkuptimi reciprok.¹⁴⁷ Aspekti i mirëqenies materiale sipas këtij parimi i referohet detyrimit të prindërve për të siguruar të mira materiale për nevojat e fëmijëve e të cilat në radhë të parë kanë të bëjnë me ushqimin, veshmbathjet, mjekimin, shkollimin etje.

Detyrimi i përkujdesjes, mbajtjes së raporteve vetjake dhe mirërritjes së fëmijëve sipas parimit të katërt nënkupton së jeta dhe shëndeti, siç dihet janë gjerat më të vlefshme për fëmijët, prandaj prindërit kanë detyrë dhe të drejtë që ti ruajnë fëmijët e mitur, sidomos të ruajnë jetën dhe shëndetin e tyre. Prindërit kanë për detyrë që fëmijës ti ruajnë jetën nga rreziqet e ndryshme që mund ti kanosen atij.¹⁴⁸ Ruajtja dhe mirërritja e fëmijëve nënkupton edhe të drejtën e prindërve që të jetojnë në bashkësi me fëmijët e tyre, sepse kjo rrethanë është parakusht themelor për realizmin real të detyrave dhe të drejtave ndaj fëmijëve.¹⁴⁹ Mbajtja e raporteve vetjake të prindërve më fëmijët nënkupton detyrimin e të dy prindërve pavarësisht situatës që të njëjti të vendosin raporte personale me fjetet e tyre përkatësisht të kenë kontakt duke u kushtuara atyre kohë të mjaftueshme për përkujdesje, biseda, këshillime, plotësim të kërkesave të ndryshme por që gjithsesi duhet të jenë kërkesa të pranueshme për moshën e tyre, etj.

Kjo mund të shpjegohet në aspektin e ndërtimit të aftësisë prind-fëmijë dhe shijimin e ndjenjës emocionale që e ka fëmija ndaj prindit, kjo edhe ndikon pozitivisht në mirërritjen e tij, kurse detyrimi për mirërritjen e fëmijës si përkujdesje e prindërve që fëmija të ketë një rritej dhe zhvillim të shëndosh p brenga dhe me mundsi të plotësimin të nevojave të tij.¹⁵⁰

Përkujdesja për edukim dhe arsim-është po ashtu një nga përgjegjësit ligjore të prindërve në raport me fëmijët tyre. Prindërit duhet ti edukojnë fëmijët dejtë në mënyrë që atë të përvetësojnë sistemin e vlerave pozitive. Fjala vjen prindërit duhet ti edukojnë fëmijët që ata t'i pranojnë rregullat që janë përgjithësisht të pranueshme në një shoqëri, si psh. ta duan njeriun, ta duan drejtësinë, të vërtet, atdheun, etj.¹⁵¹ Arsimimi i fëmijëve është njëra ndër përgjegjësit kryesore të prindërve pasi që prindërit kanë detyrim ligjor tu mundsojnë fëmijëve shkollimin dhe ti mbështesin edhe pas moshë madhore deri në moshën 26 vjeçare nëse fëmijët vijon shkollimin. Më ligjet e aplikueshme

¹⁴⁶Po aty, fq.303.

¹⁴⁷Gani Oruçi, vepr e cituar, fq.124.

¹⁴⁸Po aty, fq.124.

¹⁴⁹Po aty, fq.124.

¹⁵⁰Haxhi Gashi/Abdullah Aliu/Adem Vokshi, "Kommentar" Ligji për Familjen i Kosovës, fq.303

¹⁵¹Gani Oruçi, vepra e cituar, fq.125

shkollimi në vendin tonë arsimit fillor dhe i mesëm është i obliguar për secilin fëmijë, prandaj përgjegjësia e prindërve duhet të jete në relacion edhe strategjitë shtetërore për arsimin fillor dhe të mesëm.

Përfaqësimi i fëmijës- prindërit janë përfaqësuesit ligjor të fëmijës dhe të njëjtit kanë të drejtën të kryejnë veprime juridike për llogari të fëmijëve e të cilëve u mungon zotësia e veprimit. Në çdo rast prindërit janë përfaqësuesit ligjor të fëmijës dhe kanë të gjitha të drejta që në fakt i ka fëmija, por në asnjë rast nuk guxojnë që të keqpërdorin cilësinë e përfaqësuesit ligjor pasi që mund të merren edhe masa ligjore nga ana e institucioneve të cilat kanë për detyrim të merren më mbrojtjen e interesit ma të mirë të t'miturit.

Administrimi i pasurisë së fëmijës- fëmija i mitur mund të ketë pasuri të tij personale të fituar, fjala vjen, nga trashëgimi, nga dhurimet, nga puna ose në ndonjë mënyrë tjetër të ligjshme.¹⁵² Administrimi i pasurisë së fëmijës nënkupton detyrën e prindërve që si shtëpiak i mirë ti marrin të gjitha masat e nevojshme për ruajtjen dhe përmirësimin e pasurisë së fëmijës.¹⁵³ Kur bëhet fjalë për tjetërsimin, apo ngarkimin e pasurisë së fëmijës, si për shembull shitjen apo ngarkimin me hipotekë ose ndonjë të drejtë tjetër sendore, prindërit mund ta bëjnë këtë vetëm me pëlqimin e Organit të Kujdestarisë.

Tjetërsimi dhe ngarkimi i pasurisë së fëmijës mund të bëhet vetëm për mbajtjen, kujdesin apo edukimin e fëmijës. Ky përcaktim dhe kufizim ligjor parashihet me dispozitën e nenit 135 par 2 të LFK-së.

Parimi i pestë i referohet detyrimit të prindërve që duke i zbatuar parimet e lartë cituara duhet të kenë në konsideratë aftësitë, prirjet dhe dëshirat e fëmijëve të tyre. Kjo nënkupton së prindërit duhet tu përmbahen parimeve nga neni 128 i LFK-së dhe duke zbatuar parimet e përcaktuara të vlerësojnë në secilin rast së cilat aftësitë e fëmijëve të tyre, prirjet dhe dëshirat e tyre. Duhet theksuar së vlerësimi duhet të jetë specifik në secilin rast si për shembull nëse një fëmijë ka aftësi për muzikë duhet ti mundsohet marrja me këtë aktivitet, nëse tjetri fëmijë ka dëshirë të merre me art ose sport duhet ti mundsohet por në secilin rast aftësitë, prirje dhe dëshirat duhet të jenë brenda kornizave që përcaktojnë parimet nga neni 128 i LFK-së.

Parimet për caktimin e alimentacionit

LFK me dispozita e nenit 330 e i ka përcaktuar parimet për përcaktimin e mbajtjes dhe alimentacionit. LFK me dispozitë e nenit 330 par 1 përcakton se detyrimi për të dhënë mbajtje financiare ose alimentacion përcaktohet në proporcion me të gjitha mjete e të paditurit dhe brenda kufijve të nevojave të paditësit. Sipas kësaj dispozite rrjedhe së gjykata me rastin e vendosjes në

¹⁵²Po aty, fq.128.

¹⁵³Po aty, fq.128.

raste të tilla duhet të ketë në vlerësim dy rrethana të rëndësishme dhe atë mundsin e të paditurit dhe nevojat e paditësit dhe në proporcion me to të vendos. Me rastin e caktimit të lartësisë së kontributit për mbajtje gjykata duhet të marrë në vlerësim jo vetëm të ardhurat personale të të paditurit por edhe honorarët dhe të gjitha të ardhurat në forma tjera të realizuara nga i padituri.

Me rastin e vendosjes mbi lartasin e kontributit për mbajtje gjykatat gjithnjë duhet do të ketë parasysh gjendjen financiare të të paditurit, aftësinë e tij për punë (është apo jo i padituri i aftë për të punuar fakt ky i cili duhet argumentuar me dokumentacione mjekësore), mundsin faktike për përmirësimin e tij (mund të jetë i aftë i padituri për punë, por nuk mund të gjej punë apo refuzon punë e ofruar respektivisht bën zgjedhjen e punës), kushte shëndetësore, nevojën e tij personale, detyrimet ligjore të të paditurit (mund të ketë kredi të ndryshme- varësisht për çka janë siguruar, mund të ketë obligime ligjore për mbajtje të personave të tjerë e kështu me radhë) si dhe kushte tjera relevante të cilat do të ishin në ndikim në vlerësimin e mundsisë së të paditurit për dhënien e kontributit dhe lartësisë së këtij kontributi.¹⁵⁴

Në rastet kur alimentacioni kërkohet për fëmijë, gjykata merr parasysh moshën e fëmijës dhe të gjitha nevojat për edukim dhe arsimit.¹⁵⁵ Vlerësimi i këtyre nevojave bahet varësisht edhe nga rrethanat tjera të cilat mund të jenë në ndikim të këtyre nevojave. Nuk mund të quhet nevojë normale e edukimit të fëmijës regjistrimi i tij në një shkollë private, kur shpenzimet janë enorme nëse kemi për bazë në anën tjetër, së kontributin për mbajtje duhet ta jap një person i cili është mësimdhënës në një shkollë dhe me të ardhura të veta mezi mbulon shpenzimet elementare të familjes së vet.¹⁵⁶

Mbajtja financiare dhe ushqimi (alimentacioni)

Të çështja e mbajtjes financiare dhe ushqimit LFK, ka përcaktuar së parimet e përgjithshëm të përgjegjësisë prindërore të parashikuar me LFK, do të aplikohen në rast se nuk është rregulluar ndryshe. Në mënyrë specifike LFK me dispozitë e nenit 290 par 1, ka përcaktuar se prindërit janë të detyruar të ofrojnë mbajtje financiare për fëmijët e tyre të mitur. Nëse fëmija nuk kanë përfunduar shkollimin deri në moshën madhore, prindërit kanë detyrim të ofrojnë mbështetjen e nevojshme për të siguruar shkollimin, respektivisht edukimin në fakultet deri në moshën 26 vjeçare.¹⁵⁷

Nëse fëmija i moshës madhore nuk është në gjendje të punoj për shkak të sëmundjes, të metave fizike dhe mentale, dhe i cili nuk ka sasi të mjaftueshme të mjeteve financiare për shpenzimet e

¹⁵⁴ Haxhi Gashi/Abdullah Aliu/Adem Vokshi, “Komentar” Ligji për Familjen i Kosovës, fq.676.

¹⁵⁵ Neni 330 par 2, i LFK-së.

¹⁵⁶ Haxhi Gashi/Abdullah Aliu/Adem Vokshi, “Komentar” Ligji për Familjen i Kosovës, fq.676.

¹⁵⁷ Neni 290 par 2, i LFK-së.

tij financiare, prindërit kanë detyrim të sigurojnë ndihmë financiare derisa një sasi e tillë të mbaroj.¹⁵⁸

LFK me dispozitë e nenit 299 ka përcaktuar Ushqimin për kujdesin e fëmiut, në atë mënyrë që” bashkëshorti i ndarë mund të bëj kërkesë për ushqim ndaj bashkëshortit tjetër përderisa ai do të kujdeset dhe e mban fëmiun e përbashkët dhe për këtë arsye i bëhet e pamundur të punoj. Sipas kësaj dispozite bashkëshorti i ndër mund të kërkoj ushqim për kujdesin e fëmijës së përbashkët por për të cilin kujdesin prindëror e ushtron prindi i cili kërkon ushqimin ndaj bashkëshortit tjetër. Praktika gjyqësore një çdo ditë e më shumë rate të natyrave të tilla dhe është e nevojshme që gjykata të kenë qasje më të kujdesshme për shkak të detyrimit që kanë gjykata për interesin ma të mirë të fëmijës së përfshirë në procedurë.

Vendimi ex officio i gjykatës

Në çdo rast që të jetë e mundshme, vendimet për mbrojtën dhe mbajtjen e fëmijëve në kontestet martesore duhet të jenë ex officio.¹⁵⁹ Pra është detyrë e gjykatës që pavarësisht ka pasur apo nuk ka pasur kërkesë nga prindërit për mbrojtjen dhe mbajtjen e fëmijëve, gjykata sipas detyrës zyrtare të caktoj mbrojtjeje dhe mbajtjeje fëmijëve.

Gjykata duhet të pranoj një marrëveshje të prindërve për mbajtjen financiare në përputhje më këtë ligje vetëm nëse marrëveshja është në përputhje me dispozita e këtij ligji mbi çështjet për mbajtjen financiare.¹⁶⁰ Këtu duhet të shikohet parimi i interesit më të mirë të fëmijës. Nuk mund të pranoj gjykata një marrëveshje për mbajtje në qoftë së konsideron së ajo do të i dëmtoj interesat e fëmijës.

Gjykata vendos ex officio për mbajtjen financiare të fëmiut vetëm nëse është vërtetuar së i padituri është baba i fëmiut, respektivisht është e vërtetuar së e paditura është nënë e fëmiut.¹⁶¹

Masat e përkohshme

Ligji për Familjen, në nenin 327 parasheh caktimin ex officio të masave të përkohshme për mbajtjen financiare të fëmijëve të mitur kur është filluar kontesti për kujdestarinë dhe në kontestet ku mbajtja financiare e fëmijës vendoset sipas detyrës zyrtare. Gjykata pranë secilës ka filluar procedura që ndonjë personi t’i hiqet zotësia për të vepruar apo procedura për mbajtjen financiare

¹⁵⁸ Neni 291, i LFK-së.

¹⁵⁹ Neni 325 par 1, i LFK-së.

¹⁶⁰ Neni 325 par 2, i LFK-së.

¹⁶¹ Neni 325 par 3, i LFK-së.

të fëmijës, ka për detyrë që menjëherë pas njoftimit për iniciimin e një procedure të tillë, e në rastin kur të dy prindërit nuk kontribuojnë efektivisht në mbajtjen financiare të fëmijës, të merr zyrtarisht vendim për obligimin e këtyre të fundit që të kontribuojnë financiarisht në mbajtjen e fëmijëve të tyre.

Në rastet kur prindi i cili në bazë të vendimit të gjykatës është i detyruar që të ofrojë shumën e përcaktuar për mbajtje financiare, nuk e kryen detyrimin rregullisht, atëherë Organi i Kujdestarisë në bazë të kërkesës së prindit tjetër apo sipas detyrës zyrtare duhet të ndërmerret të gjitha masat e domosdoshme për t'i ofruar fëmijës mbajtje financiare të përkohshme në përputhje me dispozitat mbi mbrojtjen sociale të fëmijës¹⁶². Ndërsa këto masa zgjasin për aq sa prindi nuk i përmbush detyrimet e tij, kurse ndaj këtij të fundit do të iniciohet zbatimi i masave nëse vlerësohet se është e domosdoshme (par. 4 i nenit 327 të LFK).

Neni 328 i LFK-së parasheh mundsinë e nxjerrjes së masave të përkohshme për alimentacionin e fëmijëve madhorë, por në këto raste gjykata vendos vetëm me kërkesë të paditësit, respektivisht përfaqësuesit të saj, e jo sipas detyrës zyrtare. Këto situata mund të paraqiten në rastet kur një fëmijë edhe pse ka mbushur moshën madhore i është zgjatur kujdesi prindëror për shkak të sëmundjes psikike të diagnostifikuar, apo në situatën kur fëmija nuk e ka përfunduar shkollimin deri në moshën madhore, për të cilin prindërit kanë detyrim të ofrojnë mbështetjen e nevojshme për të siguruar shkollimin derisa fëmija të mbush moshën 26 vjeç¹⁶³.

LFK-ja në nenin 329 e detyron Organin e Kujdestarisë që të inkurajojë fëmijët dhe prindërit që të lidhin marrëveshje jashtëgjyqësore.

PROCEDURA GJYQËSORE PËR PJESËTIMIN E PASURISË SË PËRBASHKËTË TË BASHKËSHORTVE

Procedura gjyqësore për pjesëtimin e pasurisë së përbashkëte iniciohet nga njëri apo të dy bashkëshortet (*të dy bashkëshortet kur paraqitet padi dhe kundërpadi*) në raste kur njëri apo të dy bashkëshortët dëshirojnë të bëjnë pjesëtimin e pasurisë së përbashkët, por nuk kanë gjetur mirëkuptimin e tyre që pjesëtimin ta bëjnë në procedurë jashtëgjyqësore.

Me dispozitën e nenit 58 paragraf 2, të LFK-së, përcaktohet se: *”Gjykata kompetente vendos po ashtu në rast të mosmarrëveshjes lidhur me pjesët e pasurisë së bashkëshortëve të parapara sipas këtij neni”*. Kjo nënkupton se në çdo rast kur bashkëshorte nuk arrijnë marrëveshje për vlerësimin e pasurisë së përbashkët, atëherë është gjykata kompetente e cila me kërkesën e njëres palë do të shqyrtoj dhe vendos çështjen kontestuese.

¹⁶² Shih LFK, neni 327 paragraf 2

¹⁶³ Shih LFK, neni 290 paragraf 2

E drejta për të kërkuar mbrojtje gjyqësore për të drejtat subjektive lidhur me kërkesat që lindin nga rastet e cenimit të drejtave absolute apo kërkesave të arritura për të drejtat relative është drejtë e çdo individit dhe si e tillë mund të ushtrohet në çdo rast dhe çdo kohe. Kjo vlen edhe për raste gjyqësore të kontesteve për vlerësimin dhe pjesëtimin e pasurisë së përbashkët.

Në kontestet gjyqësor për pjesëtimin e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve si çështje paraqitet edhe barazia gjinore dhe mos diskriminimi. Në këtë kontekst është shume e rëndësishme që të garantohet barazia gjinore në procedurë gjyqësore.

Barazia e palëve në procedurë gjyqësore

Në Republikën e Kosovës, barazia e palëve në procedurë është e garantuar me Kushtetutë, me Konventa Ndërkombëtare dhe me ligjet e brendshme.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, sipas nenit 24.1, përcaktohet se: *“Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim”*.

Kjo dispozitë kushtetuese është bazë për të garantuar barazinë e të gjithë qytetarëve para ligjit¹⁶⁴.

Në të vërtetë, kuptimi i këtij neni është ndalimi kushtetues i diskriminimit, si parakusht themelor i sigurimit të respektimit të të gjitha të drejtave të tjera të njeriut që i garanton Kushtetuta dhe realizmit të tyre në kushte të barabarta¹⁶⁵.

Për ta qartësuar ndalimin e diskriminimit para ligjit dhe të drejtën e mbrojtjes së barabartë para ligjit, me dispozitën e nenit 24.2, të Kushtetutës, përcaktohet se: *“Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjerë, prejardhje kombëtare, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksuale, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër”*.

Me dispozitën e nenit 24.2, të Kushtetutës, përcaktohet pamundësia e diskriminimit për barazinë para ligjit dhe për të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, duke u theksuar se askush nuk mund të diskriminohet mbi asnjë bazë¹⁶⁶.

Përkritazi me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në mënyrë specifike, me dispozitën e nenit neni 31.1, përcaktohet se: *“Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike”*.

Dispozita e nenit 31.1, e Kushtetutës, nuk është përsëritje e dispozitës së nenit 24.1, sepse me dispozitën e nenit 24.1, garantohet e drejta e mbrojtjes së barabartë para ligjit, ndërsa me dispozitën

¹⁶⁴ Dispozita e cituar, përveç që garanton barazinë e të gjithëve para ligjit, e njëjta përcakton dhe garanton edhe të drejtën e tyre për mbrojtje të barabartë ligjore pa u diskriminuar.

¹⁶⁵ Enver Hasani & Ivan Cukalovic, “Komentari” Kushtetuta e Republikës së Kosovës, botimi I, Prishtinë 2013, fq.86.

¹⁶⁶ Ky koncept i garantimit të barazisë para ligjit dhe i të drejtës për mbrojtje të barabartë për secilin qytetar, duke e ndaluar diskriminimin në çfarëdo baze, paraqet një parim themelor për çfarëdo procedure gjyqësore.

e nenit 31.1, garantohet mbrojtja e barabartë e të drejtave në procedura para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

Kjo dispozitë kushtetuese është parim përcaktues për të gjitha procedurat gjyqësore, pavarësisht nga përmbajtja e dispozitave ligjore. Në çdo rast, secila gjykatë në secilën procedurë duhet të respektoj dhe të garantojë që procedura të zhvillohet sipas këtij parimi për barazinë e pjesëmarrësve në procedurë lidhur me mbrojtjen e kërkuar. Mbrojtja e të drejtave të barabarta në procedurë në këtë rast përfaqëson një garanci shumë të rëndësishme kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive individuale lidhur me të drejtën për gjykim të drejtë.

Po ashtu, me dispozitën e nenit Neni 54, të Kushtetutës përcaktohet se: *“Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është e shkelur”*.

Për shkak të rëndësisë së statusit të të drejtave të njeriut në sistemin kushtetues dhe juridik, përveç dispozitave të përgjithshme për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, janë vendosur edhe garancitë kushtetuese të së drejtës për mbrojtjen e të drejtave njerëzore¹⁶⁷.

Me kushtetutë, mbrojtja e të drejtave të garantuara, parimisht bëhet në gjykatë. Me dispozitën e nenit 54 të Kushtetutës, garantohet edhe e drejta për mjete efektive ligjore nëse konstatohet se është shkelur ndonjë e drejtë e tillë. Nga kjo del se, secilit i është garantuar e drejta për gjykim të pavarur, të paanshëm dhe të bazuar në ligj, që do të thotë së në këtë mënyrë është garantuar e drejta për gjykim të drejtë (*neni 31 i Kushtetutës*) dhe e drejta për mbrojtje të barabartë në gjykata, në organet e tjera shtetërore, bartësit e autorizimeve publike dhe organet e njëjësive të vetëqeverisjes lokale (*neni 24, paragrafi 1 dhe neni 32 i Kushtetutës*)¹⁶⁸.

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, neni 6.1, përcakton se: *“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për besueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij....”*

Nuk ka një garantim të shprehur mbi të drejtën e aksesit-časjes në gjykatë në tekstin e Nenit (6) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive Themelore të Njeriut por Gjykata Evropiane është shprehur se kjo dispozitë siguron për këdo të drejtën për të bërë çdo lloj pretendimi në lidhje me të drejtat e tij/saj civile dhe detyrimet përpara një gjykate apo tribunali.

Neni 6 përfshinë të drejtën për të paraqitur në gjykatë, në të cilën e drejta për akses, që do të thotë e drejta për të filluar seancat gjyqësore përpara gjykatës në çështje civile, përbën vetëm një aspekt.

¹⁶⁷ Enver Hasani & IvanCukalovic, “Komentar” Kushtetuta e Republikës së Kosovës, botimi I, Prishtinë 2013, fq.204.

¹⁶⁸ Po aty, fq.204.

Pra, Neni 6, paragrafi 1, i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive Themelore të Njeriut, i garanton secilit të drejtën për t'i parashtruar gjykatës për gjykim, çfarëdo pretendimi, që i'u referohet të drejtave dhe detyrimeve me karakter civil¹⁶⁹.

Neni 6 paragrafi 1, i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive Themelore të Njeriut, në lidhje me të drejtën e procesit të rregullt gjyqësor, i referohet edhe detyrimit për një gjykim të pavarur, të paanshëm, për një proces gjyqësor publik, brenda një afati të arsyeshëm kohor, për një proces gjyqësor të besueshëm, etj.

Koncepti “gjykatë” karakterizohet në kuptim material, nga funksioni i saj gjyqësor, pra nga zgjidhja e çështjeve që janë në kompetencë të saj, në pajtim me parimin e rendit të së drejtës dhe në një proces, të zhvilluar në pajtim me një procedurë ligjërisht të përcaktuar¹⁷⁰.

Në mënyrë konkrete dhe specifike, Ligji për Gjykatat, në Nenin 7.1, përcakton se: “Gjykatat trajtojnë të gjithë personat në mënyrë të barabartë, askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare apo shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, gjendjes sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal”¹⁷¹.

Me dispozitën e nenit 7.2 të Ligjit për Gjykatat, përcaktohet se: “Çdo person ka qasje të barabartë në gjykata dhe askujt nuk i mohohet e drejta në gjykim të drejtë në përputhje me procedurën e rregullt ligjore ose të drejtë në mbrojtje të barabartë me ligj. Çdo person fizik apo juridik ka të drejtë në gjykim të drejtë dhe brenda afatit të arsyeshëm kohor.”

Në këtë rast, dispozita e nenit 7.2, e Ligjit për Gjykatat është në harmoni me dispozitat kushtetuese të cituara më lart në këtë kapitull dhe gjithashtu edhe me nenin 6.1, të Konventës Evropiane. Përmes kësaj dispozite ligjore i garantohet çdo personi e drejta e çasjes në gjykatë, në përputhje me procedurën e rregullt ligjore, e drejta në mbrojtje të barabartë ligjore, e drejta në gjykim të drejtë dhe brenda një afati të arsyeshëm.

Në procedurën kontestimore, me dispozitat e LPK-së, nuk parashihet në mënyrë të shprehur çështja e barazisë së palëve në procedurë, natyrisht që dispozitat ligjore në LPK-së janë në harmoni me dispozitat kushtetuese dhe Konventën Evropiane, për të drejtën e secilit person për një proces të drejtë gjyqësor por që kjo e drejtë në mënyrë eksplicite garantohet me Ligjin për Gjykatat, i cili përmban disa dispozita thelbësisht të rëndësishme për procedurën civile, me të cilat përcakton kompetencën, përbërjen e gjykatës, barazinë e palëve në procedurë dhe gjithashtu përcakton bazat e ndalimit të diskriminimit.

¹⁶⁹ Po aty, fq.75.

¹⁷⁰ Marek Antoni Noëicki, Rreth Konventës Evropiane, Tiranë 2003, fq.181-182.

¹⁷¹ Kjo dispozitë e përfshirë në Ligjin për Gjykata, është dispozitë bazë për të gjitha procedurat gjyqësore, civile, penale, administrative, ekonomike, të kundërvajtjes dhe si e tillë garanton dhe promovon të drejtën e secilit person që të jetë i barabartë, pa u diskriminuar në asnjë bazë. Kjo dispozitë përjashton mundsinë e diskriminimit mbi çfarëdo baze dhe në këtë kuptim në mënyrë specifike i është referuar të gjitha dallimeve që mund të ekzistojnë në mes njerëzve.

Detyrimi i respektimit të parimit të barazisë së palëve në procedurë, është adresuar edhe me Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtarë. Kodi i Etikës Profesionale për Gjyqtarë.

Pjesëtimi i pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve

LFK, me dispozitat e nenit 56 e ka rregulluar këtë çështje ku në paragrafin 1 të nenit 56 është përcaktuar se: “ *Ndarja e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve mund të kërkohet gjatë martesës dhe pas pushimit të saj*”, ndërsa në paragrafin 2, të nenit të njëjtë ka përcaktuar se: “ *Të drejtën që të kërkojnë pjesëtimin e pasurisë së përbashkët e kanë: bashkëshortët, trashëgimtarët e bashkëshortit të vdekur ose bashkëshortit të shpallur të vdekur, si dhe kreditori i njërit prej bashkëshortëve, nëse kërkesa e kreditorit nuk mund të realizohet nga pasuria e pjesëtuar e atij bashkëshorti*”.

Është më se e qartë se pjesëtimi i pasurisë së përbashkët mund të kërkohet gjatë martesës dhe pas pushimit të saj. Kjo vlen jo vetëm për bashkëshortët por edhe për subjektet tjerë që kanë të drejtë sipas paragrafit 2, të nenit 56 të LFK-së. Natyrisht nga trashëgimtarët mund të kërkohet vetëm pas vdekjes së bashkëshortit.

Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve mund të ndahet me kërkesën e njërit prej bashkëshortëve ose sipas marrëveshjes se përbashkët të tyre.¹⁷² Bashkëshortët në çdo kohë mund të pjesëtojnë pasurinë e tyre të përbashkët me marrëveshje.¹⁷³ Kjo nënkupton se bashkëshortët nëse kanë marrëveshje gjatë gjithë kohës së zgjatjes së martesës kanë të drejtë dhe mundsi që pasurinë e përbashkët ta shndërrojnë në pasuri të veçantë.

Bashkëshortët me marrëveshje, për dallim nga pjesëtimi me vendim gjyqësor mund t'i ndajnë sendet që janë objekt i pronësisë së përbashkët bashkëshortore dhe kështu që të krijohet e drejta e pronësisë në sendin e caktuar dhe përjashtohet instituti i bashkëpronësisë. Përndryshe, gjykata do ta bënte pjesëtimin e pronësisë së përbashkët jo duke i ndarë sendet, por duke përcaktuar pjesët e njërit bashkëshortë në pasurinë e përbashkët, në pasurinë e tërësishme që quhet pasuri e përbashkët bashkëshortore¹⁷⁴.

Në paragrafin 2 të nenit 53 të LFK-së, përcaktohet se: “*Pjesëtimi i pasurisë së përbashkët mund të bëhet kur bashkëshortët caktojnë ose kërkojnë t'u caktohen pjesët e tyre në pasurinë e përbashkët dhe kështu bëhen pronar në pjesë të caktuara*”, ndërsa në paragrafin 3, të nenit të njëjtë përcaktohet se: “*Marrëveshja nga paragrafi 1 dhe 2 e këtij neni duhet të bëhet medoemos me shkrim në pajtim me kërkesat formale, të përcaktuara me ligjin në fuqi mbi pasurinë për arritjen e marrëveshjeve të tilla*”. Nga dispozita e cituara parashihet se për pjesëtimin e pasurisë së përbashkët me marrëveshje është me rëndësi të plotësohen dy kushtet. Ekzistimi i marrëveshjes për pjesët e pjesëtuara apo kërkesa për pjesëtimin e pasurisë dhe marrëveshja të bëhet në formën e paraparë

¹⁷² Bedri Bahtiri, Aspektet Nacionale dhe Ndërkombëtare të Regjimit Pasuror Martesor të Bashkëshortëve, Prishtinë 2018, fq.209.

¹⁷³ Shihe nenin 53 paragrafi 3, i LFK-së.

¹⁷⁴Haxhi Gashi, Abdullah Aliu & Adem Vokshi, “Komentar” Ligji për Familjen i Kosovës, Prishtinë 2012, fq.145.

ligjore. Nëse plotësohen këto kushte atëherë bashkëshortët pas implementimit të marrëveshjes bëhen pronar në pjesë të caktuara dhe disponojnë individualisht secili me pjesët e tyre.

Vlerësimi i pasurisë së përbashkët në rast të mosmarrëveshjes

Marrëveshja për ndarjen e pasurisë së përbashkët është një mundsi ligjore e cila në jetë reale nuk shfrytëzohet shumë për shkak se zakonisht pjesëtimi i pasurisë së bashkëshortëve bëhet në fazën kur marrëdhëniet e tyre janë në fazë kritike, prandaj edhe mosmarrëveshjet për pasurinë janë po ashtu në fazë kritike. LFK me dispozita nga neni 54, e ka përcaktuar mundsinë e vlerësimit të pasurisë së përbashkët në rast të mosmarrëveshjes nga ana e gjykatës.

Kështu me dispozitën e nenit 54 paragrafi 1, është përcaktuar se: *“Nëse nuk arrihet marrëveshja në kohën kur pjesa e secilit prej bashkëshortëve i takon pasurisë së përbashkët, ajo vendoset nga gjykata. Vendimi duhet të bazohet në kontributin e bashkëshortëve, përmes vlerësimit të të gjitha rrethanave dhe jo duke marrë parasysh vetëm të ardhurat personale dhe të hyrat e tjera të secilit bashkëshort, por edhe ndihmën e njërit prej bashkëshortëve të ofruar bashkëshortit tjetër, si kujdesin për fëmijët, udhëheqjen e punëve të shtëpisë, përkujdesjen dhe mirëmbajtjen e pasurisë si dhe çfarëdo forme tjetër të punës dhe të bashkëpunimit lidhur me administrimin, mirëmbajtjen dhe shtimin e pasurisë së përbashkët”.*

Një prej detyrave të vështira në procedurën e pjesëtimit të pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve është vlerësimi i pasurisë së përbashkët dhe pastaj vjen edhe pjesëtimi i saj.

Konstatimi se çka është pasuri e përbashkët dhe cili është kontributi i bashkëshortëve në krijimin e pasurisë së përbashkët është sfidë në çdo proces gjyqësor. Vlerësimi i kontributit është një detyrë jo e lehtë për gjyqtarin, sepse kontribut nuk konsiderohet vetëm puna që sjell fitime monetare, por edhe i gjithë aktiviteti për mirëmbajtjen, administrimin e pasurisë, si dhe edukimi dhe rritja e fëmijëve, përgatitja e ushqimit etj.

Disa legjislacione kërkojnë nga bashkëshortët që me rastin e lidhjes së martesës t’i rregullojnë marrëdhëniet e tyre me kontratë të veçantë dhe nëse këtë nuk e bëjnë konsiderohet se bashkëshortët janë pajtuar që pasuria e tyre të rregullohet me normat juridike që rregullojnë të drejtën e bashkëpronësisë¹⁷⁵.

Para fillimit të pjesëtimit, gjykata ka për detyrë pikësëpari të caktojë masën e pasurisë së përbashkët e cila duhet ndarë¹⁷⁶. Pra gjyqtari së pari bën spastrimin e llogaritjeve ndërmjet pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve dhe pasurisë së veçantë të tyre¹⁷⁷. Për vlerësimin e kontributit të bashkëshortëve në krijimin e pasurisë së përbashkët gjykata i merr në vlerësim të gjitha rrethanat në jetën e përbashkët të bashkëshortëve dhe nuk kufizohet vetëm në kontributin financiar siç mund të jenë të ardhurat personale dhe të hyrat tjera monetare të secilit bashkëshort, por edhe ndihmën e njërit bashkëshort ofruar bashkëshortit tjetër.

¹⁷⁵ Po aty, fq.148.

¹⁷⁶Hamdi Podvorica, E Drejta familjare, Prishtinë 2011, fq.250.

¹⁷⁷ Gani Uruçi, Doracak për të Drejtën Familjare dhe Trashëgimore, 2011, fq. 138.

Me ndihmën e njërit prej bashkëshortëve të ofruar bashkëshortit tjetër ligji e numëron, kujdesin për fëmijët, udhëheqjen e punëve të shtëpisë, përkujdesjen dhe mirëmbajtjen e pasurisë, si dhe çfarëdo forme tjetër të punës dhe të bashkëpunimit lidhur me administrimin, mirëmbajtjen dhe shtimin e pasurisë së përbashkët.

Vlerësimi i të gjitha rrethanave, bëhet me qëllim që të provohet se pjesët e tyre të pronësisë së përbashkët a do të shpallën si të barabarta në pajtim me nenin 47 paragrafi 4, i LFK-së¹⁷⁸, ku thuhet *“bashkëshortët janë pronar të përbashkët në pjesë të barabarta të pasurisë së përbashkët nëse nuk janë marrë vesh ndryshe”*, ose do të caktohen pjesët e pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve në bazë të kontributit, që do të thotë se njëri do të ketë më shumë pjesë të veçantë dhe tjetri më pak. Për të ndodhur kjo, bashkëshorti pretendues duhet të argumentojë kontributin e tij më të madh në bazë të të cilit kërkon edhe t'i takoj pjesa më e madhe nga pronësia e përbashkët¹⁷⁹.

Para ndryshim plotësimi të Ligjit për Familjen të Kosovës, për një vendim gjyqësor të drejtë, të bazuar dhe të ligjshëm ishte shumë me rëndësi që gjykata në procedurën e pjesëtimit të pasurisë së përbashkët, mos të fokusohet vetëm te kontributi monetar, por të vlerësojë çdo lloj kontributi. Për shembull mund të jetë rast që njëri prej bashkëshortëve ka punuar gjatë tërë martesës supozojmë 15 vite, ndërsa bashkëshorti tjetër nuk ka punuar fare një punë nga e cila do të realizonte të ardhura monetare, por gjatë kësaj periudhe është kujdesur për 4 fëmijë. Në këtë rast aq sa është e rëndësishme të provohet rrethana e kontributit financiar në krijimin e pasurisë së përbashkët supozojmë ndërtimi i një shtëpie, aq është me rëndësi të provohet se bashkëshorti tjetër tërë kohën është kujdesur për fëmijën, shtëpinë, pastërtinë dhe gjëra tjera si ushqimi etj. Në këtë rast gjykata duhet të vlerësojë të dy mënyrat e kontributit. Në kontekstin e dispozitave ligjore gjykata duhet të tërheqë një paralel në mes të dy mënyrave të kontributit dhe të vlerësojë se a janë të baraspeshuara këto mënyra të kontributit në krijimin e pasurisë së përbashkët apo ekziston ndonjë diferencë që është pastaj përcaktuese për vëllimin e pjesës së veçantë të secilit bashkëshort.

Detyrimin e vlerësimit të secilit kontribut e përcakton edhe përmbajtja e dispozitës së nenit 54 paragrafi 1 të LFK-së, sipas të cilës përcaktohet se vendimi duhet të bazohet në vlerësimin e të gjitha rrethanave dhe jo vetëm të ardhurave personale, por edhe ndihmën e njërit bashkëshort ofruar tjetrit, kujdesin për fëmijët, ushqimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e pronës etj.

Për rastet e vlerësimit të kontributit financiar në krijimin e pasurisë së përbashkët gjykata mundet edhe pa propozimin e palëve të bëjë marrjen e provës me ekspertizë përkatëse në mënyrë që të konstatojë faktet se në çfarë vëllimi në kuptimin financiar kanë kontribuar bashkëshortët në krijimin e pasurisë së përbashkët.

Përveç provës me ekspertizë gjykata nuk mund të marrë prova tjera sipas detyrës zyrtare por duhet të ftojë palët që ti paraqesin ato. Është me rëndësi që të mos nënvlerësohet asnjë mënyrë e kontributit dhe sipas kësaj logjike edhe të bëhet marrja e provave sepse nëse nënvlerëson disa mënyra të kontributit në krijimin e pasurisë së përbashkët, përveç asaj financiare, atëherë mundsitë

¹⁷⁸ Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 2004/32 për familjen i Kosovës, neni 1, për riformulimin e nenit 47

¹⁷⁹Haxhi Gashi, Abdullah Aliu & Adem Vokshi, “Kommentar” Ligji për Familjen i Kosovës, Prishtinë 2012, fq.145

për një vendim të ligjshëm dhe të drejtë janë të vogla. Kjo për arsye se është gjykata që vendos se cilat prova do të administrohen dhe në këtë kuptim nëse nënvlerësohen disa mënyra të kontributit, atëherë mund të ndodh që nuk do të administrohen provat për të provuar çfarëdo lloj kontributi.

Në praktikën gjyqësore rastet e pjesëtimit të pasurisë shpesh herë paraqiten me mjaft kompleksitet, ngase në disa raste vlerësimi i kontributit në krijimin e pasurisë së përbashkët nuk i referohet ekskluzivisht pasurisë që është pronësi e bashkëshortëve. Pra, ekzistojnë raste kur vlerësimi i kontributit duhet të bëhet lidhur me një pasuri e cila nuk është ekskluzivisht pronësi e bashkëshortëve, por kanë pjesëmarrje edhe subjekte të tjerë. Këto situata përveç se janë mjaft të vështira për të vlerësuar kontributin e secilit në krijimin e pasurisë së përbashkët janë gjithashtu shumë të vështira për ta bërë edhe pjesëtimin. Disa shembuj kompleks nga praktika gjyqësore mund të jenë:

- Për shembull toka ku është e ndërtuar shtëpia figuron si pronësi e prindërve të ndonjërit prej bashkëshortëve, ndërsa shtëpia është ndërtuar me kontributin e bashkëshortëve;
- Kur prona ka ekzistuar në momentin e lidhjes së martesës dhe e njëjta është pronësi jo e bashkëshortëve por e familjarëve të bashkëshortëve, por pas martesës me kontributin e bashkëshortëve janë bërë investime dhe është rritur vlera e pronës;
- Kur gjatë martesës është krijuar pasuri e përbashkët, shembull një objekt banimi, por në krijimin e saj përveç bashkëshortëve kanë kontribuar edhe subjekt tjerë, zakonisht familjar të bashkëshortëve (*në fakt njërit prej bashkëshortëve*).

Duke i marrë në konsideratë këto raste komplekse për të cilat gjykatat duhet të vendosin dhe duhet ta bëjnë pjesëtimin e pasurisë është shumë me rëndësi që gjatë shqyrtimit dhe vendosjes të merren në konsideratë edhe disa çështje që diktohen nga kompleksiteti i këtyre rasteve.

Për shembull, në rastin kur duhet të vlerësohet kontributi në krijimin e pasurisë së përbashkët e cila nuk është ekskluzivisht si pronësi e bashkëshortëve, kush duhet të jetë palë në procedurë? Pra, a mund të bëhet pjesëtimi i pasurisë së përbashkët për pronën në të cilën kanë kontribut edhe subjekt tjerë pa qenë të përfshirë edhe ata si palë në procedurë? Pastaj si do të bëhet pjesëtimi i pasurisë mbi sendin që është në pronësi të ndonjë subjekti tjetër por në të cilën kanë kontribut bashkëshortët? Si do të vlerësohet kontributi i bashkëshortëve në sendin që edhe të tjerët kanë kontribut? Nëse do të vendoset që të kompensohet kontributi për shkak të pamundsisë së pjesëtimit të sendit kush do ta kompensojë kontributin nëse sendi nuk i mbetet në pronësi bashkëshortit tjetër?

Pjesëtimi i pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve para ndryshim/plotësimit të LFK

Ligji i Familjes i Kosovës, Nr. 2004/32, para ndryshim plotësimit, me dispozitat e nenit 47, përcaktonin se:

1. *“Pasuri e përbashkët e bashkëshortëve është pasuria e fituar me punë gjatë vazhdimin të martesës, si edhe të hyrat që rrjedhin nga pasuria e tillë;*
2. *Pasuria e përbashkët mund të përfshijë gjithashtu të drejtat sendore dhe të detyrimeve;*

3. *Pasuria e bashkëshortëve e fituar bashkërisht përmes lojërave të fatit konsiderohet pasuri e përbashkët.*
4. *Bashkëshortët janë pronarë të përbashkët në pjesë të barabarta të pasurisë së përbashkët nëse ndryshe nuk janë marrë vesh”.*

Nga interpretimi i dispozitave të cituara më sipër rezulton se pasuria e përbashkët e bashkëshortëve është pasuri e fituar në radhë të parë nga puna gjatë vazhdimit të martesës, pa përjashtuar edhe të hyrat që rrjedhin nga një pasuri e tillë. Vërehet qartë se ligjdhënësi punës gjatë vazhdimit të martesës i kishte dhënë peshë përcaktuese për ta definuar konceptin e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve.

Përmbajtja e dispozitës në paragrafin 1 të nenit 47 të LFK-së, përcakton po ashtu se që kushti i parë për ta definuar pasurinë e përbashkët është ekzistimi i martesës dhe rrjedhimisht fitimi i pasurisë së përbashkët gjatë vazhdimit të martesës. Pra, do të kualifikohej si pasuri e përbashkët vetëm nëse është fituar me punë gjatë vazhdimit të martesës, përndryshe puna e përbashkët nëse nuk ekziston martesë e vazhdueshme mund të definohej si formë tjetër e pronësisë.

Karakterit i të drejtave për pasuri të përbashkët të bashkëshortëve sipas dispozitës nga paragrafi 2 të nenit 47 të LFK-së, përfshinë të drejtat sendore dhe të drejtat e detyrimeve. Karakteri i të drejtave sendore i referohet në këtë rast të drejtave absolute që rregullohen me Ligjin për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, ndërsa të drejtat e detyrimeve përfshijnë të drejtat e karakterit relativ që rregullohen me Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve, siç mund të jenë kompensimi i dëmit, pasurimin pa bazë, fitimin e munguar etj.

Përveç të cekurave nga përmbajtja e dispozitës së paragrafit 2 të nenit 47 të LFK-së, ligjdhënësi në pasurinë e përbashkët përveç pronës si koncept përfshinë edhe të drejtat. Thënë thjeshtë pasuria e përbashkët nuk nënkupton vetëm pronën si të drejtë, siç shpesh herë referohet edhe në literaturë por edhe në praktikë gjyqësore.

Me dispozitën e paragrafit 3 të nenit 47 të LFK-së, përcaktohej se pasuri e përbashkët e bashkëshortëve është edhe pasuria e fituar përmes lojërave të fatit. Në praktikën gjyqësore përmbajtja e kësaj dispozite është e qartë sepse nënkupton që bashkëshortet kanë luajtur në lojëra të fatit me pasurinë e përbashkët. Nëse ndonjëri pretendon se pasuria e fituar nga lojërat e fatit është pasuri e veçantë, atëherë këtë pretendim duhet ta provojë para gjykatës.

Me dispozitën e paragrafit 4 të nenit 47 të LFK-së, përcaktohej se bashkëshortët janë pronar të përbashkët në pjesë të barabarta të pasurisë së përbashkët nëse nuk janë marrë vesh ndryshe. Përmbajtja e kësaj dispozite jo rastësisht përcakton se bashkëshortët do të jenë pronar të përbashkët të pasurisë në pjesë të barabarta nëse nuk janë marrë vesh ndryshe, sepse vetëm përmes një procesi gjyqësor pas kontestimit të pjesës së njërit apo tjetrit bashkëshort do të mund të provohej që pjesët nuk janë të barabarta.

Është me rëndësi të theksohet po ashtu, se për këtë situatë ligjdhënësi e përdor terminologjinë “*pronar të përbashkët në pjesë të barabarta*”, dhe nuk e përdor terminologjinë “*bashkëpronar*”. Kjo për shkak se po të përdorej terminologjia “*bashkëpronar*”, kjo do të paracaktonte se pjesët e

secilit prej bashkëshortëve dihen, ndërsa sipas terminologjisë “*pronar të përbashkët*”, nënkupton se pjesën janë të barabarta vetëm deri në momentin kur kontestohen.

Dispozitat e nenit 47 të LFK-së, para ndryshim plotësimi të ligjit e kanë definuar pasurinë e përbashkët të bashkëshortëve dhe të drejtat mbi pasurinë e përbashkët të bashkëshortëve deri në momentin kur do të kontestohet pjesa e pasurisë së njërit prej bashkëshortëve. Kjo për shkak se në rast të kontestimit, respektivisht në rast të mosmarrëveshjeve atëherë vlerësimi do të bëhet sipas dispozitave nga neni 54 i LFK-së.

Me dispozitën e nenit 54 paragrafi 1 të LFK-së, përcaktohet se: “*Nëse nuk arrihet marrëveshja në kohën kur pjesa e secilit prej bashkëshortëve i takon pasurisë së përbashkët, ajo duhet të vendoset nga gjykata. Vendimi duhet të bazohet në kontributin e bashkëshortëve, përmes vlerësimit të të gjitha rrethanave dhe jo duke marrë parasysh vetëm të ardhurat personale dhe të hyrat e tjera të secilit bashkëshort, por edhe ndihmën e njërit prej bashkëshortëve të ofruar bashkëshortit tjetër, si kujdesin për fëmijët, udhëheqjen e punëve të shtëpisë, përkujdesjen dhe mirëmbajtjen e pasurisë si dhe çfarëdo forme tjetër të punës dhe të bashkëpunimit lidhur me administrimin, mirëmbajtjen dhe shtimin e pasurisë së përbashkët*”.

Çështja e parë që përcaktohet me dispozitën e sipërcituar është se çfarëdo kontesti që i takon pasurisë së përbashkët nëse nuk ekziston marrëveshja e bashkëshortëve, ajo duhet të vendoset nga gjykata.

Çështja e dytë dhe shumë me rëndësi që përcaktohet me dispozitën e sipërcituar është se me ligj gjykatës i paracaktohet korniza e rrethanave që duhet t’i marrë në vlerësim për ta bazuar vendimin e saj mbi vlerësimin e pasurisë së përbashkët.

Në këtë rast shfaqet karakteristika se vendimi i gjykatës nuk duhet të bazohet vetëm në të ardhurat personale dhe të hyrat tjera të secilit bashkëshort, por duhet të merren në vlerësim edhe rrethanat tjera të cilat ndikojnë që të përcaktohet se çka është pasuri e përbashkët. Në këtë kontekst si rrethana tjera të rëndësishme sipas dispozitës së cituar rrjedh se janë ndihma e njërit bashkëshort ofruar bashkëshortit tjetër, kujdesi për fëmijët, udhëheqja e punëve të shtëpisë, përkujdesja dhe mirëmbajtja e pasurisë si dhe çfarëdo forme tjetër e punës dhe bashkëpunimit lidhur me administrimin, mirëmbajtjen dhe shtimin e pasurisë së përbashkët. Pra, gjykata për ta vlerësuar pasurinë e përbashkët duhet t’i marrë në vlerësim të gjitha format e kontributit në një bashkësi martesore, pa paragjykuar se cili prej bashkëshortëve ka dhënë cilën formë të kontributit.

Vlerësimi i këtyre rrethanave sigurisht që nënkupton një proces gjyqësor në të cilin përmes mjeteve të përshatshme provuese do të vlerësohet me kujdes secila formë e kontributit të dhënë në krijimin e pasurisë së përbashkët, e që konsiderohet kontribut sipas dispozitës së cituar. Vet fakti se vlerësimi i këtyre rrethanave do të bëhet në një proces gjyqësor nënkupton se gjykata duhet të thellohet në masë të mjaftueshme në kontestin e palëve ndërgjyqësore për të provuar secilin fakt përcaktues për secilën formë të kontributit në krijimin e pasurisë së përbashkët.

Për dallim prej formave tjera të pronësisë së përbashkët siç është p.sh. pronësia e përbashkët e familjeve të mëdha, ku në mënyrë parimore si kontribut konsiderohet vetëm puna dhe kontributi

financiar i dhënë direkt në krijimin e pronësisë së përbashkët, tek pasuria e përbashkët e bashkëshortëve, qartazi konkludohet se përveç punës dhe kontributit financiar në krijimin e pasurisë së përbashkët, vlerësohen edhe kontributet tjera.

Këtu veçanërisht vlerësohet kontributi për kujdesin e fëmijëve, udhëheqjen e punëve të shtëpisë dhe administrimin, mirëmbajtjen e pasurisë së përbashkët. Praktika gjyqësore e ndërtuar për vlerësimin e pasurisë së përbashkët nuk tregon se i ka dhënë konsideratë të veçantë kontributit financiar, respektivisht të hyrave të njërit apo tjetrit bashkëshort kur ato të hyra nuk kanë qenë esencialisht me diferencë të madhe, por i ka dhënë vlerësim të balancuar secilës formë të kontributit në krijimin e pasurisë së përbashkët.

Vlerësimi i kontributit në krijimin e pasurisë së përbashkët në procedurë gjyqësore nënkupton një procese në të cilin merren prova për secilën formë të kontributit. Por, ajo që është e rëndësishëm dhe që diktohet nga praktika gjyqësore ka të bëjë me llojin e mjeteve provuese, varësisht nga mënyrë e dhënies së kontributit në krijimin e pasurisë së përbashkët.

Ekspertiza si mjet provuese nuk do të shfrytëzohet për të përcaktuar eventualisht valorizimin e kujdesit të njërit prej bashkëshortëve për fëmijët. Kjo për shkak se kujdesi për fëmijët nuk duhet të shikohet me vlerën financiare të punës që bënë një edukatore, por duhet të shikohen në kontekstin e nderjes së përgjegjësisë që kanë prindërit për mirërritjen e fëmijëve duke siguruar edhe lidhjen emocionale dhe të sigurisë tek fëmijët. Prandaj një formë e tillë e kontributit nuk valorizohet përmes një ekspertize financiare.

E njëjta gjë vlen edhe për format tjera të kujdesit, si kujdesi për bashkëshortit, për shtëpinë apo për mirëmbajtjen e pasurisë. Këto janë forma të kontributit që duhet të kenë një çmuarje të kujdesshme nga ana e gjykatës dhe sipas një konsiderate që del nga përmbajta e dispozitave ligjore dhe jo nga vlera e nxjerr me një ekspertizë financiare.

Kur bëhet fjalë për kontributin financiar, atëherë është e natyrshme marrja e provës me ekspertizë financiare, nëse gjykata nuk ka material faktike të mjaftueshëm për të konstatuar faktet thelbësore lidhur me krijimin e pasurisë së përbashkët.

Me dispozitën e nenit 54 paragrafi 1 të LFK-së, përcaktohet se: *“Gjykata kompetente vendos po ashtu në rast të mosmarrëveshjes lidhur me pjesët e pasurisë së bashkëshortëve të paraparë sipas këtij neni”*.

Pra, nga kjo dispozitë nënkuptohet se procesi i vlerësimit të pasurisë së përbashkët është ndarë nga procesi i pjesëtimit të pasurisë së përbashkët. Kjo për shkak se në paragrafin 1 të nenit 54 të LFK-së, përcaktohet kompetenca e gjykatës për ta bërë vlerësimin e pasurisë së përbashkët, ndërsa në paragrafin 2 të të njëjtit nen përcaktohet kompetenca e gjykatës për ta bërë pjesëtimin e pasurisë së përbashkët. Megjithatë është e rëndësishme të theksohet se procesi i vlerësimit i pasurisë së përbashkët dhe procesi i pjesëtimit të pasurisë së përbashkët bëhet në të njëjtën çështje gjyqësore, por që nënkupton se gjykata konstaton dhe vlerëson se çka është pasuri e përbashkët dhe pasi që ta konstatojë fondin e pasurisë së përbashkët vendos për pjesëtimin e saj.

Në procesin e vlerësimit gjykata administron prova për të vlerësuar të gjitha faktet kontestuese që lidhen me krijimin e pasurisë së përbashkët, ndërsa pjesëtimi varet edhe nga lloji i kërkesës që parashtron pala e cila e ka iniciuar procesin gjyqësor. Ligjdhënësi ka përcaktuar se në mënyrë parimore në rast të mosmarrëveshjeve, bashkëshortët përmes procedurës gjyqësore mund t'i zgjidhin mosmarrëveshjet dhe atë duke përcaktuar se cili është fondi i pasurisë së përbashkët dhe si duhet të bëhet pjesëtimi i saj.

Pra, në mënyrë parimore në procedurë gjyqësore duhet të bëhet pjesëtimi i pasurisë dhe kjo nënkupton se në rastet kur pasuria e përbashkët përbëhet nga prona të paluajtshme pjesëtimi duhet të bëhet duke përcaktuar pjesën e secilit fillimisht si bashkëpronësi, e pastaj edhe përmes pjesëtimin fizik. Mirëpo në shumë raste natyra e kërkesës është kompensimi i kontributit në krijimin e pasurisë së përbashkët dhe që nënkupton se nuk do të ketë proces fizik të pjesëtimin të pasurisë së përbashkët, por do të ketë kompensim për kontributin në krijimin e pasurisë së përbashkët.

Përcaktimi i pjesëve

LFK me dispozitat e nenit 55, ka përcaktuar mënyrën e përcaktimit të pjesëve të pasurisë së bashkëshortëve. Me dispozitën e nenit 55 paragrafi 1, të LFK-së, është përcaktuar se: *“Pjesa e pasurisë së bashkëshortëve përcaktohet duke përdor kriteret e njëjta ashtu siç janë përcaktuar në nenin 54 (1)”*. Përcaktimi i pjesëve në pasurinë e përbashkët të bashkëshortëve gjithmonë do të nisët nga parimi se ata janë të barabartë deri sa njëri prej bashkëshortëve nuk deklarohej se pjesët e tyre të mos jenë të barabarta, por të përcaktohen në bazë të kontributit të dhënë për fitimin e asaj pasurie të përbashkët të bashkëshortëve. Pjesët konsiderohen se janë të barabarta derisa nuk kërkohet diçka tjetër, sepse kjo parashihet në nenin 47, paragrafi 4 të LFK-së, i cili paragraf bazën e ka në parimin barazisë së bashkëshortëve¹⁸⁰ si dhe në parimin e solidaritetit në mes të bashkëshortëve¹⁸¹.

Në rastin kur njëri prej bashkëshortëve kërkon që pjesët e tyre të mos jenë të barabarta, atëherë është detyrë e gjykatës që të caktoj pjesët e tyre, por është shumë me rëndësi veçanërisht tani me ndryshim plotësim të Ligjit të Familjes që gjykatat të marrin në konsideratë udhëzimet ligjore për mënyrën e pjesëtimin të pasurisë.

Dispozita e nenit 55 paragrafi 1 e LFK-së, e udhëzon gjykatën që të udhëhiqet nga kriteret e përcaktuara në nenin 54 paragrafi 1, por që tani është në kundërshtim me dispozitën e nenit 47 paragraf 3. Asnjëra nga rrethanat e përcaktuara në neni 54 paragraf 1, të LFK-së, nuk mund të nënvlerësohen në rastet gjyqësore për pjesëtimin e pasurisë siç ndodh shpesh nga ana e gjykatave duke u fokusuar vetëm kontributin financiar. Në rastet e pjesëtimin të pasurisë së përbashkët, kontributi financiar në krijimin e pasurisë së përbashkët është vetëm njëra prej rrethanave respektivisht kriterëve vlerësuese.

¹⁸⁰ LFK me dispozitën e nenit 42, paragrafi 1, ka përcaktuar se: “Bashkëshortët në martesë janë të barabartë, në të gjitha marrëdhëniet personale dhe pronësore”.

¹⁸¹ Haxhi Gashi, Abdullah Aliu & Adem Vokshi, “Komentar” Ligji për Familjen i Kosovës, Prishtinë 2012, fq.151-152.

Me dispozitën e nenit 55 paragrafi 2 të LFK-së, përcaktohet se: *“Pjesa më e madhe e pasurisë së bashkëshortit në një send apo në të drejtën e caktuar, mund të përcaktohet nga gjykata vetëm nëse ai send ose e drejtë ekonomikisht është e pavarur në krahasim me sendet apo të drejtat e tjera në pasurinë e përbashkët, dhe bashkëshorti për fitimin e atij sendi apo të drejte ka marrë pjesë me të hyra nga pasuria e veçantë”*. Kjo nënkupton se në disa raste mund të kemi ndarjen e pasurisë së përbashkët në të gjitha sendet bashkërisht, por lejohet mundësia që për ndonjë send të veçantë të ketë proporcion në ndonjë send apo të drejtë të caktuar, p.sh. e drejta e pronësisë së përbashkët në banesë do të veçohet nga pronësia e përbashkët me sendet tjera ose e drejta e pronësisë në një *(makinë shtëpiake)* me vlerë më të madhe ekonomike do të veçohet nga sendet tjera të përbashkëta.

Kjo do të thotë se në tërësinë e sendeve që paraqesin pasuri të përbashkët do të kishim proporcion të barabartë ndërsa për një send tjetër të veçuar do të kishim përpjesëtim tjetër të pjesëve të pronësisë mbi atë send¹⁸². Praktikisht kjo mund të shprehet për sendin e veçuar për shembull 2/3, ndërsa për pjesën tjetër 1/3.

Përgjegjësitë dhe detyrat - Në paragrafi 2, të dispozitës së nenit 57 të LFK-së, janë përcaktuar përgjegjësitë dhe detyrat e bashkëshortëve që rezultojnë nga pasuria e përbashkët. Me dispozitën e nenit 57 paragrafi 1, është përcaktuar se: *“Bashkëshortët janë përgjegjës për detyrimet e tyre personale që rezultojnë nga pasuria e pjesëtuar dhe detyrimet e tyre që rezultojnë nga pjesët e tyre në pasurinë e përbashkët”*, ndërsa në paragrafin 2, të nenit të njëjtë përcaktohet se: *“Të dy bashkëshortët janë të ngarkuar me detyrimet e përbashkëta dhe individuale përmes pasurisë së tyre të përbashkët dhe të pjesëtuar, për detyrimet që njëri nga bashkëshortët duhet të përmbushë kundrejt personave të tretë si dhe detyrimet që duhet të përmbushen nga të dy bashkëshortët”*.

Në paragrafin e parë shihet qartë se bashkëshortët mund të kenë dy lloje detyrimesh, detyrimet e veçanta të tyre për pjesët e veçanta të pronësisë dhe detyrimet e përbashkëta, respektivisht detyrimet që dalin nga pjesa e tyre e pasurisë së përbashkët. Si obligime të përbashkëta mund të jenë pagimi i qirasë për banesën, ndërsa si detyrim i veçantë mund të jetë ndonjë shpenzim për të përkrahur ndonjë anëtar të familjes jashtë bashkësisë familjare¹⁸³.

Detyrimet për të cilat bashkëshortët janë të ngarkuar në raport me pasurinë e përbashkët dhe të pjesëtuar si dhe në raport me personat e tretë që ka njëri bashkëshort apo të dy bashkëshortët. Varësisht se a rrjedhin detyrimet nga pasuria e përbashkët apo e veçantë përcaktohet edhe fakti se a do të zbriten në pasurinë përbashkët apo në pasurinë veçantë.

Nëse njëri prej bashkëshortëve nga pasuria e tij e veçantë e ka përmbushur detyrimin solidar, ka të drejtë të kërkojë nga bashkëshorti tjetër shpërblim për pjesën e tij të detyrimit.

Marrëdhëniet pasurore pas shkurorëzimit

Nga neni 89 deri 95 të LFK-së, përfshihen dispozitat ligjore për rregullimin e marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve pas zgjidhjes së martesës. Me dispozitën e nenit 90 paragrafi 1, është

¹⁸² Po aty, fq.154

¹⁸³ Po aty, fq.157

rregulluar çështja e ndarjes së borxhit të përbashkët me rastin e pjesëtimit të pasurisë së përbashkët, duke përcaktuar se: “*Me rastin e pjesëtimit të pasurisë së përbashkët, borxhi i pasurisë së përbashkët do të llogaritet në pjesën e secilit bashkëshort*”. Nga kjo rrjedh se me rastin e pjesëtimit të pasurisë do të bëhet edhe ndarja e borxheve. Dispozita nuk ka saktësuar se si do të ndahen borxhet por natyrisht se ndarja e borxhit bëhet në proporcion me ndarjen e pasurisë¹⁸⁴.

Me dispozitën e nenit 90 paragrafi 1, është rregulluar çështja e ndarjes së sendeve të cilat i shërbejnë profesionit të njërit prej bashkëshortëve, duke përcaktuar se: “*Kur bëhet pjesëtimi i pasurisë me kërkesën e njërit prej bashkëshortëve të një martesë ligjërish të regjistruar, duhet kushtuar vëmendje për të siguruar që pjesa e tij/saj përfshinë ato sende të pasurisë së përbashkët, të cilat i shërbejnë zanatit të tij/saj*”, ndërsa në paragrafin 3 të nenit të njëjtë përcaktohet se: “*Nëse vlera e sendeve nga paragrafi 2, i këtij neni është jo proporcionalisht e madhe në krahasim me vlerën e pasurisë së përgjithshme të përbashkët, do të bëhet pjesëtimi edhe i atyre sendeve, përveç nëse bashkëshorti të cilit këto pjesë duhet t’i takojnë nuk ia siguron bashkëshortit tjetër pagimin përkatës në para ose të përafërt ose nuk ia cedon bashkëshortit tjetër sipas pëlqimit të tij sendet e tjera me vlerë përkatëse ose të përafërt. Për këto kompensime qëllimi kërkohet të miratohet nga të dy bashkëshortët*”.

Kur pjesëtimi i pasurisë bëhet për bashkëshortët të cilat kanë pasur një martesë të ligjshme të regjistruar, atëherë pjesëtimi i pasurisë duhet të bëhet në atë mënyrë që sendet të cilat i shërbejnë njërit prej bashkëshortëve për ta ushtruar profesionin e tij/saj t’i takojnë atij/asaj. Bashkëshortit tjetër i takon kundërvlera e atyre sendeve të cilat janë të nevojshme për profesionin e tjetrit. Qëllimi i dispozitës është që të mos dëmtohet ushtrimi i profesionit për shkak të ndarjes së sendeve që i nevojitet për ta ushtruar profesionin përkatës.

Në paragrafin 3 të nenit 90 është përcaktuar edhe përjashtimi respektivisht detyrimi që edhe sendet të cilat përdoren për ushtrimin e profesionit të ndahen nëse vlera e tyre është joproporcionale me masën e pasurisë tjetër të përbashkët e cila duhet të ndahet. Edhe në këtë rast qëllimi i ligjdhënësit ka qenë që të mos dëmtohet profesioni i njërit prej bashkëshortëve për shkak se duhet të ndahen sendet të cilat përdoren për ushtrimin e profesionit, andaj i ka dhënë mundsi bashkëshortit të cilit i nevojiten sendet e caktuar që kundërvlerën të i’u kompensoj bashkëshortit tjetër, ose t’i cedoj pasuri tjetër në vlerën përkatëse ose të përafërt. Në këtë rast për t’u realizuar kompensimi në vend të ndarjes së sendeve të caktuara nevojitet pëlqimi i të dy bashkëshortëve.

Në paragrafin 4, të nenit 90 të LFK-së, është rregulluar edhe çështja e ndarjes së sendeve në përdorim ekskluziv personal, me ç’rast dispozita ka përcaktuar se: “*Kur pjesëtimi fillon me kërkesën e njërit bashkëshort, atij do t’i dorëzohen ato sende të pasurisë së përbashkët që i shërbejnë ekskluzivisht përdorimit të tij personal*”. Sendet personale janë sendet që shërbejnë për përdorim të përditshëm siç mund të jenë rrobat, etj. Në këtë rast bëhet fjalë për sendet personale

¹⁸⁴ Për shembull, nëse pasuria është ndarë më nga 1/2 për secilin bashkëshort, edhe borxhet ndahen me nga 1/2 për secilin. Nëse pasuria është ndarë 2/3 për njërin dhe 1/3 për tjetrin bashkëshortë, atëherë edhe ndarja e borxheve është në këtë proporcion.

në përdorim të përditshëm e të cilat nuk janë objekt i ndarjes me rastin e pjesëtimit të pasurisë së përbashkët.

Pagimi në para

Në rast se pjesa e njërit bashkëshort në pasurinë e përbashkët është “jo” proporcionalisht më e vogël se pjesa e bashkëshortit tjetër, gjykata me kërkesën e njërit nga bashkëshortët, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat dhe vlerën e pasurisë së tij, atij bashkëshorti mund t’i caktoj shpërblimin në të holla sipas vlerës së pjesës së tij¹⁸⁵.

Sipas kësaj dispozite bashkëshortit që i është ndarë më pak pasuri nga pasuria e përbashkët, ka të drejtë të kërkojë nga gjykata shpërblim nga bashkëshorti tjetër. Gjukata duke pasur parasysh të gjitha rrethanat, në veçanti vlerën e pasurisë mund të caktojë këtë shpërblim. Gjithmonë, duke pasur parasysh se situata e tillë krijohet kur bashkëshortët nuk pajtohen për ndarjen e pasurisë dhe kërkojnë që pjesët e tyre të jenë të barabarta ose së paku në vlera të përafërta¹⁸⁶.

Sendet e luajtshme

Secili prej bashkëshortëve mund të kërkojë që sendet e luajtshme në pasurinë e përbashkët t’i ndahen në emër të pjesës në pasurinë e përbashkët bashkëshortit tjetër i cili ato sende i ka ndaluar pas ndërprerjes së bashkësisë së jetës dhe ka qenë në posedim të tyre të qetë të pandërprerë së paku 3 vjet, (neni 92 (1) i LFK-së). Në zbatim të këtij neni bashkëshorti tjetër mund të kërkojë t’i ofrohet pjesa përkatëse e sendeve të luajtshme dhe nëse vlera e këtyre sendeve nuk është e mjaftueshëm ka të drejtë edhe në kompensim, (neni 92 (2) i LFK-së). Në këtë situatë përcaktohet e drejta e bashkëshortit posedues të sendeve të luajtshme nëse ato i ka poseduar në tre vitet e fundit që të njëjtat të kërkojë t’i ndahen, natyrisht me të drejtë që bashkëshorti tjetër të kompensohet me sende tjera ose me para.

Mbrojtja e pasurisë së fëmijëve

Në lidhje me pjesëtimin e pasurisë së përbashkët LFK-ja e ka rregulluar edhe çështjen e mbrojtjes së fëmijëve duke përcaktuar me dispozitën e nenit 93 paragrafin 1 se: *“Bashkëshorti që i janë besuar fëmijët e përbashkët për ruajtje dhe edukim përveç pjesës së tij, i jepen edhe sendet që i shërbejnë vetëm fëmijëve ose që janë të destinuara vetëm për përdorimin e tyre të drejtpërdrejtë, përveç nëse vlera e tyre jo proporcionalisht e madhe në krahasim me vlerën e pasurisë së përgjithshme të përbashkët”*.

Kjo dispozitë është konkrete, e qartë dhe natyrisht është në funksion të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve. Sendet që i shërbejnë fëmijëve do t’i takojnë bashkëshortit që i janë besuar fëmijët, përjashtimisht ky rregull nuk do të zbatohet nëse vlera e sendeve është shumë e madhe në krahasim me vlerën e pasurisë së përbashkët. Në praktikën gjyqësore gjithmonë duhet kushtuar kujdes

¹⁸⁵ Shih nenin 91 të LFK-së.

¹⁸⁶ Haxhi Gashi, Abdullah Aliu & Adem Vokshi, “Komentar” Ligji për Familjen i Kosovës, Prishtinë 2012, fq.233.

mbrojtjes dhe realizimit të të drejtave të fëmijëve në pajtim me legjislacionin e brendshëm dhe Konventën për të Drejtat e Fëmijëve.

Vendimi gjyqësor mbi mosmarrëveshjet

Nëse bashkëshortët në procedurën e shkurorëzimit nuk pajtohen mbi atë se kujt duhet t'i jepet e drejta që të jetojnë në të ardhmen në banesën nga martesë ose për ndarjen e paisjeve të shfrytëzuara bashkarishtë dhe gjërave të tjera që i takojnë shtëpisë, vendimi duhet të nxirret nga gjykata me kërkesë të njërit apo të bashkëshortëve, (neni 95 paragrafi 1 i LFK-së). Për këtë situatë gjykata do të vendos duke pasur parasysh çdo rast individual, e në veçanti rastet kur vendimi prek mirëqenien e fëmijëve dhe pozitën sociale të bashkëshortëve (paragrafi 2 neni 95, i LFK-së).

Dispozita e nenit 95 të LFK-së, në praktikën gjyqësore përfaqëson një sfidë të vërtetë për të vendosur sepse ligjdhënësi nuk ka sqaruar se për këtë çështje a duhet të vendos së bashku me procedurën e shkurorëzimit apo të vendoset në procedurën e pjesëtimit të pasurisë.

Pastaj nëse vendoset në procedurën e shkurorëzimit a do të vendoset vetëm për të drejtën për të jetuar në banesën nga martesë apo ky vendim është përfundimtar sa i përket bazës nga martesë dhe e njëjta nuk mund të jetë objekt pastaj në procedurën e pjesëtimit të pasurisë. Vlerësojmë se në këtë rast bëhet fjalë për ndarjen e pasurisë së përbashkët dhe mbajtja e banesës është vetëm njëra nga kërkesat që paraqiten në procedurën pjesëtimit të pasurisë. Përndryshe nëse do të bëhej fjalë vetëm për të drejtën për të jetuar në banesë nga martesë, atëherë çështja do të komplikohet se deri në çfarë kohëzgjatje vlen ky vendim. Prandaj vlerësojmë se kjo kërkesë është për procedurën e pjesëtimit të pasurisë së përbashkët. Natyrisht kushti referues në paragrafin 2, të nenit 95 është i natyreshëm sepse i referohet njëres prej rrethanave që duhet të marrë në konsideratë gjykata, e që ka të bëjë me interesin e fëmijëve.

Pjesëtimi i pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve sipas ndryshim/plotësimit të LFK-së

Ligji për Familjen i Kosovës është ndryshuar me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.2004/32 për Familjen i Kosovës, ashtu që është riformuluar neni 47. Sipas nenit 1 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.2004/32 për Familjen i Kosovës, është riformuluar neni 47 dhe përcaktohet se:

- “1. Pasuri e përbashkët e bashkëshortëve është pasuria e fituar me kontribut të përbashkët gjatë vazhdimit të martesës, si dhe të hyrat që rrjedhin nga pasuria e tillë.*
- 2. Kontribut i përbashkët i bashkëshortëve gjatë vazhdimit të martesës konsiderohet:*
 - 2.1. të ardhurat personale dhe të hyrat e tjera të secilit bashkëshort;*
 - 2.2. ndihma e bashkëshortit e afuar bashkëshortit tjetër, siç është kujdesi për fëmijët, udhëheqja e punëve të shtëpisë, përkujdesja dhe mirëmbajtja e pasurisë, si dhe çfarëdo forme tjetër e punës dhe e bashkëpunimit lidhur me administrimin, mirëmbajtjen dhe shtimin e pasurisë së përbashkët.*

3. *Kontributi i përbashkët i bashkëshortëve gjatë vazhimit të martesës për fitimin e pasurisë së përbashkët konsiderohet i barasvlershëm.*
4. *Bashkëshortët janë pronarë të përbashkët në pjesë të barabarta të pasurisë së përbashkët, nëse nuk janë marrë vesh ndryshe.*
5. *Pasuria e bashkëshortëve e fituar bashkërisht përmes lojërave të fatit konsiderohet pasuri e përbashkët.*
6. *Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve mund të përfshijë të drejtat sendore dhe të detyrimeve.”*

Paragrafi 1 i ndryshim plotësimit të nenit 47 të LFK-së, është po thuajse identike me përmbajtjen që kishte paragrafi 1 i nenit 47 të LFK-së, para ndryshim plotësimit, por me një ndryshim të terminologjisë dhe atë, para ndryshim plotësimit ligji përcaktonte se pasuria e përbashkët e bashkëshortëve është pasuria e fituar *“me punë gjatë vazhimit të martesës”*, ndërsa ndryshim plotësimi përcakton se pasuria e përbashkët e bashkëshortëve është pasuria e fituar *“me kontribut të përbashkët gjatë vazhimit të martesës”*.

Zëvendësimi i terminologjisë nga *“punë e përbashkët”*, në *“kontribut të përbashkët”*, interpretohet se me ndryshim plotësimet e ligjit, ligjdhënësi e ka përcaktuar kuptimin e *“kontributit të përbashkët”* dhe e ka zgjeruar rrethin e rrethanave të cilat mund të konsiderohen kontribut në krijimin e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve. Në këtë logjikë *“puna e përbashkët”*, rezulton të jetë koncept më i ngushtë i rrethanave që mund të kualifikohen si punë në krijimin e pasurisë së përbashkët, ndërsa *“kontributi i përbashkët”*, e nënkupton edhe punën e përbashkët por edhe format tjera të kontributit që jo domosdoshmërisht janë punë e lidhur drejtpërdrejtë në krijimin e pasurisë së përbashkët.

Në paragrafin 2 të ndryshim plotësimit të nenit 47 të LFK-së, definohet se çka në fakt është kontributi i përbashkët në krijimin e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve. Në nënparagrafin 2.1 të paragrafit 2 të nenit 47 është përcaktuar se kontribut i bashkëshortëve gjatë vazhimit të martesës janë të ardhurat personale dhe të hyrat e tjera të secilit bashkëshort, ndërsa në nënparagrafin 2.2 të paragrafit 2 të nenit 47 është përcaktuar se kontribut i bashkëshortëve gjatë vazhimit të martesës janë edhe ndihma e bashkëshortit afruar bashkëshortit tjetër, siç është kujdesi për fëmijët, udhëheqja e punëve të shtëpisë, përkujdesja dhe mirëmbajtja e pasurisë, si dhe çfarëdo forme tjetër e punës dhe e bashkëpunimit lidhur me administrimin, mirëmbajtjen dhe shtimin e pasurisë së përbashkët.

Nën paragrafi 2.2 i paragrafi 2 të nenit 47 të ndryshim plotësimit të nenit 47 të LFK-së, është ndryshim esencial nga dispozitat e nenit 47 para ndryshim plotësimit, sepse me ndryshim plotësimin është përcaktuar se çka nënkupton kontributi i përbashkët në krijimin e pasurisë së bashkëshortëve gjatë vazhimit të martesës.

Riformulimi i nenit 47 paragrafi 2 nënparagrafin 2.2 është përmbajtje pothuajse identike me dispozitën e nenit 54 paragrafi 1 të LFK-së, ku përcaktohet vlerësimi i pasurisë së përbashkët në rast të mosmarrëveshjes. Pra, duket se ligjdhënësi në paragrafin 2 nënparagrafin 2.2 të nenit 47 të riformuluar, nuk e ka bërë dallimin në mes të përcaktimit se çka është pasuri e përbashkët dhe vlerësimi të pasurisë së përbashkët në rast të mosmarrëveshjes, por të dy këto koncepte i ka unifikuar sipas definimit se çka konsiderohet pasuri e përbashkët gjatë vazhdimi të martesës.

Problematika shfaqet sepse në praktikën gjyqësore gjyqtarët mund të kenë dilemë nëse duhet të zbatohen dispozitat e LFK-së, sipas interpretimit dhe zbatimit sistematik të përmbajtjes së secilës dispozitë, apo dispozitat e nenit 47 sipas riformulimit e përjashtojnë zbatimin e dispozitave të nenit 54 dhe nenit 55 të LFK-së.

Me ndryshim plotësimet e Ligjit të Familjes, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 2004/32 për familjen i Kosovës, neni 1, është paraqitur një sfidë e vërtetë për praktikën gjyqësore, sepse neni 47 i riformuluar në paragrafin 3 përcakton se: *“Kontributi i përbashkët i bashkëshortëve gjatë vazhdimi të martesës për fitimin e pasurisë së përbashkët konsiderohet i barasvlershëm”*.

Pyetja logjike që shtrohet në këtë rast është: A janë në kundërtënie të plotë dispozita e nenit 54 paragrafi 1, me dispozitën e nenit 47 paragrafi 3, i LFK-së ?

Dispozita e nenit 54 paragrafi 1, e LFK-së, përcakton se: *“Nëse nuk arrihet marrëveshja në kohën kur pjesa e secilit prej bashkëshortëve i takon pasurisë së përbashkët, ajo duhet të vendoset nga gjykata. Vendimi duhet të bazohet në kontributin e bashkëshortëve, përmes vlerësimit të të gjitha rrethanave dhe jo duke marrë parasysh vetëm të ardhurat personale dhe të hyrat e tjera të secilit bashkëshort, por edhe ndihmën e njërit prej bashkëshortëve të ofruar bashkëshortit tjetër, si kujdesin për fëmijët, udhëheqjen e punëve të shtëpisë, përkujdesjen dhe mirëmbajtjen e pasurisë si dhe çfarëdo forme tjetër të punës dhe të bashkëpunimit lidhur me administrimin, mirëmbajtjen dhe shtimin e pasurisë së përbashkët”*, ndërsa dispozita e nenit 47 paragrafi 3 i riformuluar, përcakton se: *“Kontributi i përbashkët i bashkëshortëve gjatë vazhdimi të martesës për fitimin e pasurisë së përbashkët konsiderohet i barasvlershëm”*, atëherë logjikisht pyetet pse duhet të vlerësohet kontributi nëse është i barabartë.

Ligjdhënësi nuk ka qenë i kujdesshëm që të bëjë ndryshim plotësimin e ligjit në mënyrë sistematike dhe unike duke evituar çdo kolizion të secilës dispozitë të LFK-së, duke riformuluar përmbajtjen apo duke e shfuqizuar. Kjo nënkupton se po të riformuloheshin dispozitat nga neni 54 dhe potencialisht neni 55 të LFK-së, do të evitohet çdo kolizion i dispozitave dhe do të mundsohej realizimi i të drejtës lidhur me pasurinë e përbashkët dhe pjesëtimin e saj, ashtu siç ka qenë vullneti i ligjdhënësit.

Nëse qëllimi dhe vullneti i ligjdhënësit ka qenë siç mund të kuptohet nga përmbajtja e riformuluar e dispozitave të nenit 47 të LFK-së, që pasuria e përbashkët e fituar gjatë vazhdimi të martesës të jetë e barabartë dhe të pjesëtohet në mënyrë të barabartë, atëherë si mund të arsyetohet edhe më tutje ekzistimi i dispozitës së nenit 54 paragrafi 1 të LFK-së.

Me dispozitën e nenit 55 paragrafi 1 përcaktohet se: *“Pjesa e pasurisë së bashkëshortëve përcaktohet duke përdorur kriteret e njëjta ashtu siç janë përcaktuar në nenin 54 (1).”* ndërsa në paragrafin 1 të nenit 54 përcaktohet se: *“Nëse nuk arrihet marrëveshja në kohën kur pjesa e secilit prej bashkëshortëve i takon pasurisë së përbashkët, ajo duhet të vendoset nga gjykata. Vendimi duhet të bazohet në kontributin e bashkëshortëve, përmes vlerësimit të të gjitha rrethanave dhe jo duke marrë parasysh vetëm të ardhurat personale dhe të hyrat e tjera të secilit bashkëshort, por edhe ndihmën e njërit prej bashkëshortëve të ofruar bashkëshortit tjetër, si kujdesin për fëmijët, udhëheqjen e punëve të shtëpisë, përkujdesjen dhe mirëmbajtjen e pasurisë si dhe çfarëdo forme tjetër të punës dhe të bashkëpunimit lidhur me administrimin, mirëmbajtjen dhe shtimin e pasurisë së përbashkët”*

Nga analiza ligjore e nenit 47 paragrafi 3 të riformuluar, dhe dispozitës së nenit 55 paragrafi 1 lidhur me dispozitën e nenit 54 paragrafi 1 të LFK-së, qartazi rezulton se ekziston kolizion i hapur i dispozitave ligjore. Kjo për shkak se siç u theksua edhe më lartë në nenin 47 paragrafi 3 i riformuluar paracaktohet se kontributi i përbashkët i bashkëshortëve gjatë vazhdimit të martesës për fitimin e pasurisë së përbashkët konsiderohet i barasvlershëm, ndërsa në paragrafin 1 të nenit 54 lidhur me nenin 55 paragrafi 1 të LFK-së, paracaktohet se gjykata në rast të mosmarrëveshjes duhet ta vlerësojë kontributin i cili nga procesi i të provuarit në procedurë gjyqësore mund të rezultojë që nuk është i barabartë.

Do të mbetet në diskrecionin e praktikës gjyqësore që të vendos, se a do të merret kontributi i barabartë apo do të vlerësohet kontributi në krijimin e pasurisë së përbashkët. Zgjidhja mbetet te vlerësimi se cila prej dispozitave duhet të merret si përcaktuese (neni 47 i riformuluar, apo neni 55 paragrafi 1 lidhur me nenin 54 paragrafi 1 të LFK-së).

Duke e marrë në konsideratë tërë legjislacionin dhe përpjekjen për të arritur standardet e barazisë gjinore, mund të vlerësohet se praktika gjyqësore pas ndryshimeve të fundit të Ligjit për Familjen i Kosovës, do ta marrë si të barabartë kontributin e bashkëshortëve në krijimin e pasurisë së përbashkët dhe rrjedhimisht në çdo rast pjesëtimi i pasurisë së përbashkët të bëhet në mënyrë të barabartë. Nëse me dispozitë ligjore është paracaktuar se kontribut i bashkëshortëve gjatë martesës në krijimin e pasurisë së përbashkët është i barabartë, rrjedh se edhe pjesëtimi do të jetë i barabartë.

Megjithatë duhet të krijohet praktikë gjyqësore e kontesteve të kësaj natyre të cilat referojnë në dispozitat ligjore pas ndryshim plotësimi të LFK-së, për të parë nëse do të jetë përcaktuese për pjesëtimin e pasurisë së përbashkët përmbajtja e dispozitave nga neni 47 i riformuluar i LFK-së, apo do të jetë përcaktuese interpretimi dhe zbatimi sistematik i të gjitha dispozitave që i referohen pasurisë së përbashkët, vlerësimit për pasurinë e përbashkët dhe pjesëtimin e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve.

Fakti se është paracaktuar se vlera e kontributit të bashkëshortëve në krijimin e pasurisë së përbashkët është e barabartë, nuk i pengon bashkëshortet që me marrëveshje të zgjedhin çfarëdo mënyre të pjesëtimit, përndryshe nëse mbetet në procedurë gjyqësore, atëherë gjykata nuk ka alternative tjetër përveç zbatimit të ligjit.

Zbatimi i plotësim-ndryshimeve të Ligjit për Familjen i Kosovës, mund ta ndryshoj praktikën e deritanishme nëse përmbajtja e ndryshimeve është paracaktuese për pjesëtimin e pasurisë së përbashkët. Kjo mbetet të shihet në të ardhmen nëse gjykatat do të pranojnë kërkesa të bashkëshortëve fillimisht për të vlerësuar kontributin në krijimin e pasurisë së përbashkët, apo gjykatat do të pranojnë kërkesat e bashkëshortëve që kontributin ta pranojnë si të barabartë, pa e vlerësuar paraprakisht kontributin dhe për rrjedhojë pjesëtimi i pasurisë të jetë i barabartë.

Nëse pranohet ndryshim plotësimi pavarësisht kolizionit ekzistues të dispozitave, kontestet gjyqësore të paraqitura pas plotësim ndryshimit do të përfshihen në të provuarit e rrethanave se cila pasuri është krijuar gjatë vazhdimit të martesës, ndërsa pjesëtimi do të jetë i barabartë. Kjo nënkupton se proceset e mundimshme gjyqësore me shume mjete provuese tani do të reduktohen nga shkaku se nuk është e nevojshme që të matet kontributi, por vetëm të konstatohet se cila është pasuria për tu pjesëtuar.

Nga praktika e deritanishme e Gjykatës së Apelit¹⁸⁷, shihet se në procedurën para gjykatave të shkallës së parë, ka praktika nga më të ndryshmet. Gjykatat e shkallës së parë vendosin lidhur me kontributin e bashkëshortëve në krijimin e pasurisë së përbashkët pa e vërtetuar më parë faktin vendimtar se cila pasuri e përbashkët është krijuar gjatë bashkësisë martesore, pastaj sa është vlera e kontributit të secilit bashkëshort veç e veç në krijimin e pasurisë së përbashkët dhe nuk bëhet dallimi në mes të pasurisë së veçantë apo pasuri e përbashkët etj.¹⁸⁸

Gjykata e Apelit, thekson se për të hequr të gjitha dilemat që paraqitën në vendosjen para gjykatave të shkallës së parë, praktika gjyqësore në Gjykatën e Apelit e dhënë vlerësimin dhe zgjidhjen për rastet e paraqitura. Kjo praktikë vlerëson se, që të bëhet fjalë për pasurin e përbashkët të bashkëshortëve dhe madhësinë e saj, që do të duhej t'i takonte secilit bashkëshortet me rastin e ndarjes se kësaj pasurie, duhet që së pari të ekzistoj pasuria e përbashkët e bashkëshortëve. Pa ekzistimin e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve nuk mund t bëhet fjalë për ndarjen e pasurisë së përbashkët, e aq më tepër për lartësinë e kontributit të secilit bashkëshort në krijimin ekësaj pasurie¹⁸⁹.

Pikëpamja e shprehur e Gjykatës së Apelit, e trajton një çështje mjaftë serioze dhe të ndjeshme e cila është shfaqur në raste të caktuara në praktikë gjyqësore, e që ka të bëjë më kërkesat për kompensim të kontributit kur nuk është krijuar pasuri gjatë martesë. Nga pikëpamja e shprehur me sipër, qartazi konstatohet në praktikën gjyqësore se për të ndodh pjesëtimi i pasurisë së përbashkët duhet të ekzistoj pasuria e përbashkët. Nëse nuk është krijuar pasur gjatë martesës, atëherë nuk mund të realizohet asnjë kërkesë për kompensimin e kontributit.

Çështja e mënyrës se vlerësimit të pasurisë së përbashkët, mbetet çështje e hapur në praktikën gjyqësore, sepse nëse nuk pranohen ndryshim plotësimet për shkak të kolizionit ekzistues të dispozitave, atëherë kontestet gjyqësore të paraqitura pas plotësim ndryshimit të LFK-së, përsëri

¹⁸⁷ Praktika e Gjykatës së Apelit e Fokusuar në Çështjet e Kthyera në Rishqyrtim, Prishtinë, 2019, fq. 120-121.

¹⁸⁸ Po aty, fq.121.

¹⁸⁹ Po aty, fq. 121.

do të jenë të fokusuar në konstatimin e fakteve që lidhen me identifikimin e pasurisë së krijuar gjatë vazhdimin të martesës, në konstatimin e kontributit për krijimin e pasurisë së përbashkët dhe rrjedhimisht pjesëtimin e saj.

Përmbajtja kolizive e dispozitave sigurisht që nuk do të ndihmojë në lehtësimin e proceseve gjyqësore për shkak se potencialisht në praktikën gjyqësore do të paraqiten pikëpamje të ndryshme mbi atë se cilat dispozita janë paracaktuese për vlerësimin e pasurisë së përbashkët të krijuar gjatë vazhdimin të martesës, gjë që do të ndikojë në kohëzgjatjen e krijimit të një praktike unike. Sigurisht zgjidhja më e mirë e mundur do të ishte rishikimi i sërishëm i përmbajtjes së dispozitave ligjore të cilat janë në kolizion, në mënyrë që përmes ndryshim plotësimeve të evitohen të gjitha kundërthëniet të cilat e vështirësojnë zbatimin e dispozitave në praktikën gjyqësore dhe rrjedhimisht të qartësohen edhe më tutje qëllimet e ligjdhënësit.

Gjatë hulumtimit për hartimin e këtij raporti, ka rezultuar se nuk ka raste me vendim të formës së prerë, e që i referohet rasteve të shqyrtuara pas aprovimit të ndryshim plotësimeve të LFK-së.

USHQIMIA

E drejta e bashkëshortëve në ushqimi është një e drejtë e cila ekziston midis bashkëshortëve deri sa janë në martesë apo bashkëjetesë, por edhe pas zgjidhjes së martesës nën kushtet e përcaktuara me ligj.

Baza ligjore për rregullimin e ushqimisë është Ligji për Familjen (LFK), i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2006 dhe i cili është ndryshuar dhe plotësuar në vitin 2019. Rrjedhimisht edhe pjesa që ka të bëjë me ushqimin ka qenë në fokus të ndryshimeve. Neni 2 i Ligjit për Ndryshimet dhe Plotësimet të LFK-së i referohet paragrafit 1 të nenit 298 të LFK-së, ku ky nen në tërësi është riformuluar. Në nenin 3 të Ligjit për Ndryshim dhe Plotësimin e LFK-së, fjala “bashkëshort i shkukurëzuar” që është përdorur në nenet 301, 302, 303, 304, 309, 312 dhe 316, të ligjit bazik, zëvendësohet me fjalën “ish-bashkëshort”, në ndërkohë që nenet 309, 311, 312, 313 të LFK-së riformulohen në tërësi. Kurse në nenin 315 fjala “alimentacion”, zëvendësohet me fjalën “ushqimi”.

Ushqimia apo mbajtja martesore siç njihet ndryshe me ligj, është e paraparë nga neni 297 e deri tek neni 316 të LFK-së. Me dispozitën e nenit 297 të LFK-së, është dhënë definicioni i ushqimisë, me ç'rast përcaktohet se: “*Ushqimia është mbajtje financiare e bashkëshortëve apo ish-bashkëshortëve*”. Ushqimia është detyrim ligjor për bashkëshortët apo ish bashkëshortët nën plotësimin e kushteve të caktuara ligjore e cila e ka cilësinë e të drejtës personale. Dispozita e cituar e definon qartë se ushqimia është mbajtje financiare e bashkëshortëve apo ish bashkëshortëve dhe përjashton format tjera të detyrimit siç mund të jenë edukimi, shkollimi etj.

Sipas Nenit 297 të LFK-së, ushqimia është mbajtje financiare e bashkëshortëve apo ish-bashkëshortëve. Mbajtja financiare në kuptimin e ligjit në fjalë nënkupton detyrim financiar dhe material¹⁹⁰. Në rastin e bashkëshortëve dhe ish-bashkëshortëve, ushqimia është një përkujdesje që paraqitet ndërmjet ish-bashkëshortëve si domosdoshmëri për një jetesë në kushte normale.

¹⁹⁰ Ligji për Familjen i Kosovës, nr. 2004/32, 01 shtator 2006, neni 278, par. 1.

Rrjedhimisht, ligji i mundson ish-bashkëshortit/es të kërkoj mbajtje kur ekziston nevoja për një gjë të tillë. Qëllimi i ushqimisë është të mbroj personalitetin e bashkëshortit apo ish-bashkëshortit lidhur me plotësimin e kërkesave të tyre të domosdoshme¹⁹¹. Përkitazi me këtë nen, ushqimia definohet si ofrim i ndihmës materiale ish-bashkëshortit/es, nën kriteret e cekura në ligj.

Me dispozitën e nenit 298 paragrafi 1 të LFK-së, para ndryshim plotësimin të ligjit përcaktohej se: *“Bashkëshorti i cili nuk ka mjete të mjaftueshme për mbajtje financiare, i cili nuk është i aftë të punojë ose që për arsye tjera nuk mund të punësohet, ka të drejtë në mbajtje financiare nga bashkëshorti tjetër në proporcion me mundsitë e tij financiare”*, ndërsa pas ndryshimit të ligjit me dispozitën e nenit 298 paragrafi 1 përcaktohet se: *“Bashkëshorti i cili nuk është i aftë të punojë ose për ndonjë arsye tjetër nuk mund të punësohet dhe nuk ka mjete materiale të mjaftueshme për ekzistencë ka të drejtë në ushqim nga bashkëshorti tjetër në proporcion me mundsitë e tij”*.

Dispozitat e cituara në kuptimin e zbatimit praktik duket se nuk kanë diferencë të madhe në përmbajtje dhe rrjedhimisht vlerësohet se nuk do të ndikoj në ndryshime të praktikës gjyqësore. Është e rëndësishme të theksohet se gjykata do të vlerësoj kërkesën për ushqimi, duke vlerësuar dispozitën nga paragrafi 1 të nenit 298 të LFK-së, të ndërlidhur me paragrafin 2 të nenit 298 ku përcaktohet se: *“Gjykata duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit mund të refuzojë kërkesën për ushqimi, nëse ushqimia është kërkuar nga bashkëshorti me keqbesim ose nëse ai e ka braktisur bashkëshortin pa ndonjë arsye të bazuar”*.

Është e rëndësishme të theksohet që ushqimia për ish-bashkëshortin përveç kushteve ligjore nga të cilat varet e drejta për ushqimi, njëkohësisht varet edhe nga mundsitë financiare të bashkëshortit që jep ushqimi. Pra, detyrimi ligjor i dhënies së ushqimisë është i kushtëzuar nga mundsia e dhënies së ushqimisë. Ky kushtëzim është i ndërlidhur proporcionalisht me nevojat dhe mundsinë. Pra, edhe nëse ekziston nevoja ushqimi ligjor nuk do të jepet nëse nuk ekziston mundsia e ish-bashkëshortit tjetër.

Detyrimet reciproke të bashkëshortëve për ushqimi parimisht nënkuptojnë përmbushje vullnetare të detyrimeve dhe evitim të çfarëdo shtate e cila përbën kontest, megjithatë nuk përjashtohen as rastet kur ushqimia do të realizohet përmes rrugës gjyqësore të cilën e shfrytëzon bashkëshorti i cili ka nevojë për ushqimi.

Nga intepretimi i dispozitave të cituara konkludohet se e drejta në ushqimi e përcaktuar me dispozitat e nenit 298 paragrafi 1 të LFK-së, përjashtohet nga rrethanat e përcaktuara në nenin 298 paragrafi 2 të LFK-së. Paragrafi 2 i nenit 298 të LFK-së, i referohet refuzimit të kërkesës për ushqimi nga bashkëshorti i cili është me keqbesim dhe që nënkupton se kërkesa për ushqimi nuk ka mbështetje të provuar dhe rrjedhimisht i mungon baza. Nevoja për ushqimi duhet të jetë nevojë reale e cila provohet në procedurë gjyqësore, përndryshe keqbesimi nënkupton përpjekjen e njërit bashkëshort që ta paraqesë si nevojë reale ushqimin edhe kur nuk ekziston kjo nevojë.

¹⁹¹ Haxhi Gashi, Abdulla Aliu, Adem Vokshi, *Komentar i Ligjit për Familje të Kosovës*, Prishtinë, GIZ dhe Ministria e Drejtësisë. 2012, fq. 619.

Problematikë në praktikën gjyqësore paraqitet edhe fakti se në procedurën e zgjidhjes së martesës për aprovimin e kërkesës për zgjidhjen e martesës gjykata mjaftohet nga konstatimi i faktit se njëri prej bashkëshortëve i mungon vullneti për të qëndruar më tutje në martesë. Mirëpo mungesa e vullnetit për të qëndruar edhe më tutje në martesë nuk nënkupton se ky bashkëshort nuk ka të drejtë në ushqimi, pasi që kërkesa për zgjidhjen e martesës mund të jetë pasojë e dhunës, tradhtisë bashkëshortore, lënies qëllimkeqe etj. Kjo nënkupton se në këto raste nuk mund të konsiderohet se bashkëshorti si kërkues i zgjidhjes së martesës e ka braktisur bashkëshortin tjetër.

Përveç të cekurave lidhur me nevojshmërinë për ushqimi, Ligji për Familjen me nenin 304 përcakton se: *“Ish-bashkëshorti nuk mund të kërkojë ushqiminë për derisa ai është në gjendje të mbaj vetën nga të ardhurat apo nga pasuria e tij”*. Dispozita në fjalë e ka definuar në mënyrë eksplicite se në çdo rast kur të ardhurat apo pasuria ekzistuese janë të mjaftueshme për ta mbajtur veten ish-bashkëshorti që kërkon ushqimi, kërkesa e tillë do të refuzohet si e pathemeltë.

Ligji për Familjen i Kosovës me dispozitat nga neni 299, 300, 301 dhe 302, ka përcaktuar në mënyrë specifike rastet e detyrimit për ushqimi.

Kështu me nenin 299 të LFK-së, është përcaktuar ushqimia për kujdesin e fëmijës. Me nenin 300 të LFK-së, është përcaktuar ushqimia për shkak të moshës, ndërsa me nenin 301 të LFK-së, është përcaktuar ushqimia për shkak të sëmundjes apo paaftësisë. Përfundimisht me nenin 302 të LFK-së, është përcaktuar ushqimia për shkak të papunësisë.

Ushqimia për kujdesin e fëmijës sipas dispozitës së nenit 299 të LFK-së, nënkupton se: *“Bashkëshorti i ndarë mund të kërkojë ushqiminë nga bashkëshorti tjetër përderisa ai do të kujdeset dhe e mban fëmiun e përbashkët dhe për këtë arsye i bëhet e pamundur të punoj”*.

Në goftë se bashkëshortët janë të ndarë nënkuptohet që fëmijët e përbashkët nuk mund të jetojnë njëkohësisht me të dy prindërit, prandaj, fëmijët i besohen njërit prej bashkëshortëve. Në rastin kur fëmijët i besohen njërit prind atëherë bashkëshorti të cilit i besohen fëmijët për shkak të kujdesit ndaj fëmijës mund të kërkojë nga bashkëshorti tjetër ushqiminë. Kjo për shkak se gjatë kohës kur ish-bashkëshorti kujdeset për fëmijën e ka pamundur që të punësohet. Pra, nëse rrethana e kujdesit ndaj fëmijës e pamundson punësimin atëherë ish-bashkëshorti e ka të drejtën për ushqimi.

Në praktikën gjyqësore në rastet e kërkesave për ushqimi për shkak të mbajtjes dhe kujdesit të fëmijëve, mund të shfaqën paqartësi me kërkesat për alimentacion për fëmijët.

Gjykatat duhet t'i trajtojë në mënyrë specifike kërkesën për ushqimi për shkak të kujdesit dhe mbajtjes së fëmijëve dhe kërkesën për alimentacion për fëmijët.

Ushqimi është kërkesë e bashkëshortit, ndërsa alimentacioni është kërkesë për fëmijët. Në këtë kontekst duhet theksuar se mbajtja e fëmijëve nga prindërit nënkupton përgjegjësinë e të dy

prindërve që t'i sigurojnë rregullisht fëmijës të mira materiale për plotësimin e nevojave për jetë.¹⁹² Mbajtja e fëmijëve është detyrim ligjor për prindërit.

Me dispozitën e nenit 290 par. 1 të LFK-së përcaktohet se: “prindërit janë të detyruar të ofrojnë mbajtje financiare për fëmijët e mitur”, ndërsa me dispozitën e paragrafit 2 parashihet së “nëse fëmija nuk e ka përfunduar shkollimin deri në moshën madhore, prindërit kanë detyrim të ofrojnë mbështetjen e nevojshme për të siguruar shkollimin, respektivisht edukimin në fakultet deri në moshën 26 vjeçare”. Mbajtja e fëmijëve nga prindërit është njëri nga detyrimet ligjore të prindërve, i cili duhet të përmbushet siç përcakton ligji. Mbajtja financiare e fëmijës është obligim prindëror si për fëmijët martesor ashtu edhe për fëmijët jashtë martesor, gjithashtu si në rastet kur prindërit jetojnë në bashkësi me familje ashtu edhe në rastet kur prindërit nuk jetojnë në bashkësi me familjet. Prindërit janë të detyruar të sigurojnë mbajtje financiare fëmijëve të mitur pa marrë parasysh gjendjen financiare të tyre, mendohet edhe kur nuk janë në marrëdhënie pune, por kanë mjete të tjera, gjithmonë duhet merren parasysh mundsitë reale të prindërve, mendohet edhe kur krijojnë të ardhur në forma tjera përveç marrëdhënies së punës.¹⁹³

Ushqimia për shkak të moshës sipas dispozitës së nenit 300 të LFK-së, nënkupton se: “Bashkëshorti i ndarë mund të bëjë kërkesë për ushqimi ndaj bashkëshortit tjetër që nga momenti i:

1. shkurorëzimit
2. mbarimit të kujdesit dhe mbajtjes së fëmiut të përbashkët
3. përfundimit të kushteve të parashikuara në nenin 301 dhe 302 të këtij ligji ai nuk mund të pranohet në marrëdhënie të punës për shkak të moshës së tij”.

Dispozitat e cituara përcaktojnë situatën e të drejtës së ish-bashkëshortit pas shkurorëzimit, pas mbarimit të kujdesit dhe mbajtjes së fëmiut të përbashkët, dhe për shkak se nuk mund të punësohet për shkak të sëmundjes, paaftësisë apo të metave psikike apo mentale. Kjo e drejtë e ish-bashkëshortit mund të realizohet sipas kushteve nga neni 302 të LFK-së, e që nënkupton ushqimin për shkak të papunësisë. Situatat e përsëritura në nenin 300 të LFK-së, i referohen përjashtimeve për të drejtën e ushqimisë për shkak të moshës, gjithmonë kur mbajtja nuk mund të sigurohet për shkak të papunësisë.

Ushqimia për shkak të sëmundjes apo paaftësisë sipas dispozitës së nenit 301 të LFK-së, nënkupton se: “ish-bashkëshorti mund të bëjë kërkesë për ushqimi nga bashkëshorti tjetër nëse dhe që nga momenti i shkurorëzimit, mbarimit të kujdesit dhe mbajtjes së fëmiut të përbashkët dhe përfundimit të kushteve të parashikuara në nenin 302 të këtij ligji ai nuk mund të pranohet në marrëdhënie të punës për shkak të sëmundjes, paaftësisë apo të metave të tija psikike apo mentale”.

¹⁹² Gani Oruçi, vepra e cituar, fq.125

¹⁹³ Haxhi Gashi/Abdullah Aliu/Adem Vokshi, “Komentar” Ligji për Familjen i Kosovës, fq.597

Përmbajtja e dispozitës i referohet situatës kur ish-bashkëshorti edhe pas mbarimit të kushteve të përcaktuara me nenin 302 të LFK-së, ka të drejtën e ushqimisë nga shkaku se nuk mund të pranohet në marrëdhënie pune për shkak të sëmundjes, paaftësisë apo të metave të tija psikike apo mentale.

Ushqimia për shkak të papunësisë sipas dispozitës së nenit 302 të LFK-së, nënkupton se :

1. *“ Për aq sa ushqimia nuk mund të sigurohet nën dispozitat e parashikuara në nenet 299- 301, ish-bashkëshorti mund të kërkojë ushqimi nëse dhe për aq sa ai nuk është në gjendje të gjejë punësim pas momentit të shkurorëzimit.*
2. *Në rast se të hyrat nga punësimi nuk i plotësojnë nevojat dhe ai nuk ka të drejtë për ushqimi nga nenet 298-301, ai ka të drejtë të kërkojë ndryshimin si ushqimi për të arritur mbajtje financiare.”*

Me dispozitën e nenit 300 paragrafi 1 të LFK-së, është përcaktuar situata, respektivisht e drejta e ish-bashkëshortit për të kërkuar ushqimi për aq sa ai nuk është në gjendje të gjejë punësim pas momentit të shkurorëzimit. Në këtë rast e drejta për ushqimi lidhet ekskluzivisht me rrethanën që ish-bashkëshorti nuk mund të gjej punësim dhe jo me shkaqet tjera. Me paragrafin 2 të nenit 300 të LFK-së, është përcaktuar situata kur të hyrat e ish-bashkëshortit nga punësimi nuk i plotësojnë nevojat dhe ai nuk ka të drejtë për ushqim nga neni 298-301 të LFK-së, atëherë ai ka të drejtë të kërkojë ndryshimin e ushqimit për të arritur mbajtjen financiare.

E DREJTA E PUNËS

Kontestet nga marrëdhënia e punës sipas ligjit të punës

Siç dihet deri në miratimin e Ligjit të Punës (Ligji Nr.03/L-212), i cili ka hyrë në fuqi me datë 16 dhjetor 2010, Kosova nuk ka pasur ligj unik me të cilin do të rregulloheshin marrëdhëniet e punës. Si rrjedhojë dispozitat të cilat e kanë rregulluar këtë fushë kanë qenë të shpërndara në shumë ligje dhe rregullore, të cilat janë nxjerr dhe miratuar në rrethana të ndryshme ekonomike, shoqërore dhe politike.

Në këtë drejtim Rregulloret e UNMIK-ut nr. 1999/24 dhe 2000/59, kanë përcaktuar legjislacionin në fuqi, ku ligje në fuqi në Kosovë janë ligjet që kanë qenë në fuqi deri më datë 22.03.1989 dhe Rregulloret e UNMIK-ut, andaj sipas këtyre rregulloreve legjislacion në fuqi në lëminë e punës kanë qenë Ligji për Marrëdhënien e Punës i KSA të Kosovës i vitit 1989, Ligji i Punës i ish Jugosllavisë i vitit 1977, si dhe Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë, e datës 08 tetor 2001.

Kjo gjendje e infrastrukturës ligjore në sferën e punës dhe të marrëdhënieve të punës e ka imponuar nevojën e një angazhimi të shtuar profesional të gjyqtarëve, për të identifikuar normën juridike të cilën duhet zbatuar në secilin rast konkret, në mënyrë që të aplikohet drejtë edhe e drejta materiale. Duke marr parasysh faktin se Ligji i ri i Punës (edhe ligjet tjera) nuk kanë efekt prapaveprues, atëher rezulton se ende në gjykatat e Kosovës ka konteste të punës në të cilat duhet të aplikohet legjislacioni i lartcekur, ndërsa për kontestet e inicuar pas datës 16 dhjetor 2010, aplikohen dispozitat e ligjit të ri të Punës që është në fuqi.

Fusha e zbatimit të Ligjit të Punës

Ligji i Punës rregullon të drejtat dhe detyrimet në mes të punëdhënësit dhe punëmarrësit, si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik në Republikën e Kosovës, si dhe për të punësuarit dhe punëdhënësit, punësimi i të cilëve rregullohet me ligj të veçantë, nëse ligji i veçantë nuk parashikon zgjidhje për çështje të caktuara të punës. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për të punësuarit me shtetësi të huaj dhe personat pa shtetësi, të cilët janë të punësuar tek punëdhënësit në territorin e Republikës së Kosovës, nëse me ligj nuk është rregulluar ndryshe.

Ndërsa dispozitat e këtij ligji nuk janë të aplikueshme për marrëdhëniet e punësimit brenda misionëve ndërkombëtare, misionëve diplomatike dhe konsullore të shteteve të huaja, Pranisë Ushtarake Ndërkombëtare të vendosur në Republikën e Kosovës në bazë të Propozimit Gjithëpërfshirës për Statusin dhe organizatat ndërkombëtare qeveritare ^(neni 2 i Ligjit të Punës¹⁹⁴).

Megjithatë, rëndësia e Ligjit të Punës qëndron në faktin se i njëjti bënë rregullimin e disa të drejtave të punëtorëve (sidomos atyre në sektorin privat) që janë shkelur në masë të madhe në Kosovë që

¹⁹⁴ Në nenin 2 të Ligjit të Punës është e paraparë fusha e zbatimit të këtij ligji.

nga paslufta, sikurse pushimi i lehonisë, pushimi mjekësor, orari i punës etj. Ligj, i cili ka gjithsej 100 nene, ka marrë parasysh një varg kërkesash të sindikalistëve duke bërë që: kontrata e punës të jetë vetëm në formë të shkruar, puna provuese të zgjatë më së shumti 6 muaj, orari i punës të jetë 40 orë në javë, punëtori të ketë të drejtën për pauzë prej 30 minutash, të ketë pushim vjetor prej 4 javësh, kurse femrave iu garantohet pushim i lehonisë prej 12 muajsh, 9 nga të cilët me pagesë.

Gjithësesi Ligji i Punës parasheh edhe dispozita të veçanta të cilat punëtorëve ju garantojnë mbrojtjen e të drejtave nga marrëdhënia e punës si brenda punëdhënësit (mjetet juridike të brendshme), ashtu edhe të drejtën që në rast se është i pakënaqur me vendimin e organeve të punëdhënësit me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, të kërkoj mbrojtje gjyqësore, më saktësisht të inicoj kontest pune në gjykatën kompetente, brenda afatit të paraparë ligjor.

Llojet e kontratave të punës sipas Ligjit të Punës

Ligji i Punës, kontratën e punës e përkufizon si akt individual e cila lidhet ndërmjet punëdhënësit dhe të punësuarit, me të cilën rregullohen të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga marrëdhënia e punës në pajtim me këtë ligj, me Kontratën Kolektive dhe me Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit (neni 3 pika 1.11 e Ligjit të Punës). Ligji i Punës parasheh se me rastin e themelimit të marrëdhënies së punës punëdhënësi ka për obligim që me punëmarrësin të lidhë kontratën e punës, e cila lidhet në formë të shkruar dhe nënshkruhet nga punëdhënësi dhe i punësuarit. Se cilat elemente duhet t'i përfshijë kontrata e punës e rregullon neni 11 i këtij ligji.

Me dispozitën e nenit 10 parag. 2 të Ligjit të Punës, përcaktohet se kontrata e punës mund të lidhet për një: *1. periudhë të pacaktuar, 2. periudhë të caktuar dhe 3. për punë dhe detyra specifike*. Më tutje përcaktohet se kontrata e punës që nuk përmban kurrfarë hollësish për kohëzgjatjen e vet, duhet të konsiderohet si kontratë në periudhë të pacaktuar (parag. 3 i nenit 10 të LP). Ndërsa ky ligj ka përcaktuar edhe kufizimin kohor për të cilën mund të lidhet kontrata për periudhë të caktuar, e cila sipas parag. 4 nuk mund të lidhet për një periudhë më të gjatë se dhjetë (10) vite.

Ligji i Punës ka paraparë një garanci shtesë për punëtorët të cilët punojnë tek punëdhënësit me kontratë në kohë të caktuar, mirëpo kanë punuar në vazhdimësi tek i njëjti punëdhënës për më shumë se 10 vite, ku në këto raste konsiderohet se i njëjti është duke punuar me kontratë në kohë të pacaktuar. Kështu që Ligji i Punës në parag. 5 të nenit 10 shprehimisht thotë: *”Kontrata për një periudhë të caktuar që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetëkuptueshme për një periudhë të punësimit më të gjatë se dhjetë (10) vite, konsiderohet si kontratë për një periudhë të pacaktuar kohore”*.

Kontrata për një detyrë specifike, nuk mund të jetë më e gjatë se njëqindnjëzet (120) ditë brenda një (1) viti, ndërsa personi që ka lidhur kontratë të punës për një afat të caktuar ose për një detyrë specifike, i ka të gjitha të drejtat dhe detyrimet e parapara me këtë ligj, përveç nëse është paraparë ndryshe me ligj. Të punësuarit për një punë specifike, nuk i takon e drejta në pushim vjetor dhe të

drejtat e tjera të përcaktuara me Kontratë Kolektive dhe Kontratën e Punës. Me Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit, përcaktohet koha në rastet kur me të punësuarin mund të themelohet marrëdhënia e punës në kohë të caktuar dhe punë specifike, në pajtim me LP¹⁹⁵.

Shkaqet e shkëputjes së marrëdhënies së punës sipas Ligjit të Punës

Para se të flitet në lidhje me procedurën për mbrojtjen gjyqësore të të drejtave të punës, duhet të shtjellohen edhe shkaqet të cilat qojnë në ndërprerjen e marrëdhënies së punës sipas Ligjit të Punës, pasi që njohja e këtyre shkaqeve e lehtëson në masë të madhe punën e gjyqtarëve, bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor në zbatimin e të drejtës materiale për sa i përket dhënjës së mbrojtjes gjyqësore tek kontestet e punës.

Në këtë drejtim Ligji i Punës në kreun e VIII fletë për rastet dhe shkaqet, si pasojë e të cilave vie deri tek ndërprerja e marrëdhënies së punës. Kështu neni 67 i këtij ligji përcakton rastet se kur ndërprehet kontrata e punës sipas fuqisë ligjore dhe atë: *1). me vdekjen e të punësuarit, 2). me vdekjen e punëdhënësit, kur puna e kryer apo shërbimet e ofruara nga puntori janë të natyrës personale, atëherë kur kontrata nuk mund të vazhdohet me pasardhësit e punëdhënësit, 3). me skadimin e kohëzgjatjes së kontratës, 4). kur i punësuarit e mbush moshën e pensionimit, prej 65 vitësh, 5). në ditën e dorëzimit të aktvendimit të plotëfuqishëm për vërtetimin e humbjes së aftësisë për punë, 6). nëse i punësuarit shkon në vuajtje të dënimit i cili do të zgjasë më tepër se gjashtë (6) muaj, 7). me vendimin e gjykatës kompetente, vendim që pason ndërprerjen e marrëdhënies së punës, 8). me falimentimin dhe likuidimin e ndërmarrjes dhe 9). rastet tjera të përcaktuara sipas ligjeve në fuqi.*

Nga shkaqet e përmendura më lartë çështja e skadimit të kontratës së punës apo edhe mos vazhdimi i kontratës së punës nga ana e punëdhënësit kanë qenë dhe janë rastet më të shpeshta të kontesteve të inicuar në gjykatë nga ana e punëmarrësve dhe për të cilat raste ka pasur praktika të ndryshme të gjykatave me rastin e vendosjes.¹⁹⁶

Më tutje nenet 68 dhe 69, parashohin rastet e ndërprerjes së kontratës së punës me marrëveshje dhe ndërprerjen e kontratës së punës nga i punësuarit, mirëpo sigurisht që kjo mënyrë e ndërprerjes së kontratës së punës nuk ka pasoja të mëdha në shkeljen e të drejtave të punës së punëmarrësit, edhe pse ky i fundit ka për obligim që me rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës të respektojë procedurën ligjore në drejtim të respektimit të afateve ligjore për këtë çështje.

¹⁹⁵ Shih Ligjin e Punës, nenin 10, parag. 6,7,8 dhe 9.

¹⁹⁶ Në praktikën gjyqësore ka pasur vendime të ndryshme për sa i përket mënyrës së vendosjes tek rastet e ndërprerjes së marrëdhënies së punës për shkak të skadimit të kohëzgjatjes së kontratës dhe mos vazhdimit të kontratës së punës, edhe pse në kohën e fundit ka tendencë të unifikimit të kësaj praktike gjyqësore.

Në anën tjetër në nenin 70 të Ligjit të Punës janë paraparë rastet e tjera se kur punëdhënësi mund t'ia ndërprejë kontratën e punës të punësuarit, ndërsa janë të ndara rastet e ndërprerjes së kontratës së punës me paralajmërim dhe pa paralajmërim. Në këtë drejtim paragrafi 1 pika 1.1 dhe 1.2 i këtij neni përcaktojnë se punëdhënësi mund t'ia ndërprejë kontratën e punës të punësuarit me një periudhë paralajmërimi, atëherë kur ndërprerja e tillë arsyetohet për arsye ekonomike, teknike dhe organizative, si dhe në rastin kur i punësuarit nuk është i aftë t'i kryejë detyrat e punës.

Mirëpo në pikën 1.3 të paragrafit të lartcekur janë paraparë edhe kushtet shtesë të cilat duhet t'i respektojë punëdhënësi para se t'i ndërprejë kontratën e punës të punësuarit sipas pikës 1.1 dhe 1.2, dhe atë nëse nuk është e përshatshme për punëdhënësin që ta tranferojë të punësuarin në një vend tjetër të punës, apo ta trajnojë, ta kualifikojë atë për kryerjen e ndonjë pune tjetër.

Nga kjo rezulton se para se t'i ndërpresë kontratën e punës të punësuarit sipas paragrafëve të lartcekur, duhet të plotësohen në mënyrë kumulative kushtet e parapara në pikën 1.3 të cekur më lartë. Më tutje në pikën 1.4 të parag. 1 të nenit 70 të këtij ligji është paraparë se punëdhënësi mund t'ia ndërprejë kontratën e punës të punësuarit në periudhën e kërkuar të paralajmërimit dhe atë në rastet e rënda të sjelljes së keqe të puntorit (pika 1.4.1), si dhe për shkak të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës (pika 1.4.2), kurse pika 1.5 e obligon punëdhënësin që menjëherë ta njoftojë të punësuarin për largimin nga puna. Më tutje pika 1.6 i përcakton rastet kur punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit pa periudhën e kërkuar të paralajmërimit të ndërprerjes dhe atë: kur i punësuarit është fajtor për përsëritjen e një sjellje të keqe më pak serioze ose të shkelje të detyrimeve (pika 1.6.1), si dhe kur performanca e të punësuarit mbetet e pakënaqshme përkundër paralajmërimit me shkrim (pika 1.6.2).

Mirëpo në paragrafin 2 të nenit 70, janë paraparë edhe kushtet shtesë të cilat duhet t'i respektojë punëdhënësi para se t'i ndërprejë kontratën e punës të punësuarit sipas pikës 1.6, dhe atë vetëm kur i punësuarit ka marr përsëritjen në formë të shkruar të performancës së pakënaqshme, një afat kohor brenda të cilit i punësuarit duhet ta përmirësojë performancën e vet, si dhe një deklaratë dështimi për përmirësimin e performancës do të rezultojë me largim nga puna pa asnjë paralajmërim të mëtejshëm me shkrim. Më tutje paragrafi 3 i nenit 70 përcakton obligimin e punëdhënësit që të mbajë takim me të punësuarin për t'ia shpjeguar arsyet e ndërprerjes së kontratës së punës, si dhe të drejtën e punëtorit që në këtë rast të shoqërohet me një përfaqësues sipas dëshirës së vet¹⁹⁷.

Ligji i punës nuk përmban dispozita me të cilat do të specifikoheshin llojet e sjelljeve të këqija ose shkeljeve të detyrimeve të cilat bëjnë që i punësuarit t'i nënshtrohet ndërprerjes së kontratës së punës pa periudhë paralajmërimi, qoftë për një rast të vetëm apo për shkelje të përsëritura, pasi që do të ishte e pamundur që të përmendëshin në mënyrë taksative këto lloje shkeljesh.

¹⁹⁷ Më gjerësisht referoju nenit 70 të Ligjit të Punës.

Mirëpo paragrafi 4 i nenit 70 të Ligjit të Punës këtë çështje e lë në kompetencë të punëdhënësve që përmes akteve të brendshme të tij (rregullore, urdhëresave etj) t'i specifikojë këto lloje të sjelljeve të këqija ose llojet e shkeljeve të detyrimeve, të cilat do të kishin për pasojë ndërprerjen e kontratës së punës së puntorit. Gjithashtu ky paragraf parasheh që edhe me marrëveshje kolektive të specifikohen llojet e këtyre shkeljeve.

Gjithësesi që këto lloje të shkeljeve duhet të jenë në formë të shkruar dhe të miratuara nga ana e organit përgjegjës të çdo punëdhënësi dhe duhet të jenë në pajtim me Ligjin e Punës dhe dokumentet ndërkombëtare të lëmisë së punës, pasi që në të kundërtën do të ishin të pavlefshme dhe do të kishin për pasojë anulimin e vendimit të punëdhënësit.

Procedura para ndërprerjes së kontratës së punës nga ana e punëdhënësit

Ligji i Punës ka paraparë procedurë strikte e cila duhet të respektohet nga ana e punëdhënësit me rastin e ndërprerjes së kontratës së punës. Kjo është garanci që ligjvënasi ka parashikuar në favor të punëmarrësit, si pala më e "dobët" në kontratën e punës, që në kushtet e ekonomise se tregut, duhet të jetë më e mbrojtur përballë punëdhënësit. Në këtë drejtim në nenin 71 të Ligjit të Punës është paraparë koha e njoftimit që duhet të respektoj punëdhënësi me rastin e ndërprerjes së kontratës së punës në kohë të pacaktuar punëmarrësit, në atë mënyrë që nëse punëmarrësi është i punësuar tek punëdhënësi prej 6 muajsh deri në dy vite, tridhjetë ditë kalendrike, prej dy deri në dhjetë vite punësim, dyzetepesë ditë kalendrike, mbi dhjetë vite punësim, 60 ditë kalendrike.

Gjithashtu me paragrafin 2 të nenit të lartcekur është paraparë edhe koha e njoftimit të punëmarrësit që duhet të respektoj punëdhënësi me rastin e ndërprerjes së kontratës së punës në kohë të caktuar, apo qëllimit që mos të ripërtërijë kontratën e punës, e që është periudha prej 30 ditësh para skadimit të kontratës së punës, ndërsa është paraparë edhe sanksioni për punëdhënësin nëse nuk e respekton këtë detyrim, e që është zgjatja e tridhjetë ditëve kalendrike shtesë me pagë të plotë.

Më tutje neni 72 përcakton procedurën që duhet të ndjek punëdhënësi para se të ndërprejë kontratën e punës. Ky nen ndër të tjera përcakton se vendimi për të ndërprerë kontratën e punës duhet të bëhet me shkrim dhe duhet të përfshijë arsyetimin për ndërprerje, kurse ky vendim është përfundimtar ditën kur i dorëzohet të punësuarit, si dhe faktin se punëdhënësi ka për obligim që të bëjë pagesën e pagës dhe të ardhurave të tjera deri në ditën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës. Gjithashtu neni 76 i Ligjit të Punës e përcakton procedurën e ndërprerjes së kontratës së punës, tek rastet që konsiderohen largime kolektive nga puna.

Procedura gjyqësore për mbrojtjen e të drejtave të punës

Procedurat për realizimin e të drejtave nga marrëdhënia e punës, parashihen në kreun e IX të Ligjit të Punës, e të cilat ndahen në procedurat e brendshme të cilat zhvillohen brenda punëdhënësit dhe

procedurat që inicohen dhe zhvillohen në gjykatën kompetente, apo siç njihet si mbrojtja gjyqësore e marrëdhënies së punës.

Secila nga procedurat e përmendura më lartë janë me rëndësi të posaçme, pasi që të dyjat kanë për qëllim ofrimin e mbrojtjes qoftë brenda punëdhënësit ashtu edhe jashtë tij, në mënyrë që puntorit t'i garantohen të drejtat e tij nga lëmia e punës. Gjithësesi shtjellimi i këtyre dy procedurave është me rëndësi, ngase kanë lidhmëri njëra me tjetrën, pasi që nga respektimi dhe zbatimi i procedurës së ndërprerjes së kontratës së punës nga ana e punëdhënësit, varet edhe lloji i vendimit të gjykatës me rastin inicimit të kontestit të punës.

Mbrojtja e të drejtave për të punësuarit brenda organeve të punëdhënësit

Kjo çështje është e paraparë me nenin 78 të Ligjit të Punës, ku në paragrafin 1 thuhet se i punësuarit i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë te punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura. Më tutje parag. 2 përcakton obligimin e punëdhënësit për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afat prej pesëmbëdhjetë ditëve nga pranimi i kërkesës, kurse parag. 3 i këtij neni përcakton që vendimi i marr sipas paragrafit 2 të nenit në fjalë i dorëzohet të punësuarit në formë të shkruar brenda afatit prej 8 ditësh.

Gjithësesi Ligji i Punës përcakton edhe procedurën që duhet të zhvilloj punëdhënësi me rastin e shqiptimit të masave disiplinore për shkeljet e detyrave të punës. Në këtë drejtim neni 85 i këtij ligji si masa disiplinore për të punësuarit për shkelje të detyrave të punës, parasheh vërejtjen me gojë, vërejtjen me shkrim, ulje në pozitë, suspendim të përkohshëm dhe ndërprerje të marrëdhënies së punës. Ndërsa tri masa e para disiplinore sipas paragraf. 3 të nenit të lartcekur mund të shqiptohen vetëm kur konstatohen shkelje të lehta të detyrave të punës, ndërsa dy masat e fundit mund të shqiptohen vetëm për shkelje të rënda të detyrave të punës.

Se çka konsiderohet shkelje e lehtë dhe e rëndë e detyrave të punës, përcaktohet me aktet e brendshme të punëdhënësit apo me akte të tjera. Se kush mund të shqiptojë masat disiplinore dhe procedurën që zhvillohet lidhur me to, e rregullon neni 86 i Ligjit të Punës, i cili përcakton se vendimin mbi shqiptimin e masave disiplinore për shkeljet e detyrave të punës e nxjerr organi kompetent i punëdhënësit apo punëdhënësi, si dhe punëdhënësi i cili nuk e ka statusin e personit juridik, ose personit të cilin ai e autorizon, kurse ky autorizim duhet të jepet në formë të shkruar.

Më tutje përcaktohet se vendimi i punëdhënësit duhet të bëhet me shkrim, duke theksuar arsyetimin dhe këshillën për mjetet juridike ndaj masave të shqiptuara. Është për diskutim çështja se për masat disiplinore të përmendura më lartë, përveç ndërprerjes së marrëdhënies së punës, të shqiptuara ndaj të punësuarit, a mund të kërkohet mbrojtje gjyqësore në gjykatë, meqenëse nuk kemi përfundim të marrëdhënies së punës.

Mbrojtja e të punësuarit në Gjykatë

Çështjen e mbrojtjes gjyqësore të drejtave nga marrëdhënia e punës, e parasheh neni 79 i Ligjit të Punës, i cili përcakton se çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit të paraparë me nenin 78 parag. 2 të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të iniciojë kontest pune në Gjykatën kompetente. Se cila gjykatë ka kompetencë lëndore për të gjykuar në kontestet e punës (sipas Ligjit të Punës) e përcakton dispozita e parag. 1 të nenit 11 të Ligjit për Gjykatat, e cila thotë se: *“Gjykatat Themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe”*. Më tutje kompetencën territoriale tek këto konteste e përcakton neni 49 i Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK).

Është interesant fakti se Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë që ka qenë në fuqi deri më 16 dhjetor 2010, nuk përmban asnjë dispozitë e cila e rregullon çështjen e mbrojtjes gjyqësore të të drejtave nga marrëdhënia e punës.

Ndërsa nëse i referohemi nenit 27 të këtij ligji, i cili thotë se kjo rregullore shfuqizon çdo dispozitë të ligjit në fuqi që është në kundërshtim me të, atëherë mund të vijmë në përfundim se për mbrojtjen e të drejtave nga marrëdhënia e punës në gjykatë, kanë vlejto dispozitat e Ligji për Marrëdhënien e Punës i KSA të Kosovës i vitit 1989, Ligji i Punës i ish Jugosllavisë i vitit 1977, të cilat siç e kemi cekur më lartë kanë qenë në fuqi krahas kësaj rregullore, bazuar në Rregulloret e UNMIK-ut nr. 1999/24 dhe 2000/59, të cilat kanë përcaktuar legjislacionin në fuqi, ku ndër të tjera ligje në fuqi në Kosovë janë ligjet që kanë qenë në fuqi deri më datë 22.03.1989.

Në praktikë ka pasur mjaftë paqartësi në zbatimin e ligjeve të lartcekura dhe shpeshëherë puntorëve nuk i është garantuar mbrojtje adekuate gjyqësore nga ana e gjykatave. Në këtë drejtim mund të përmendim rastet kur punëdhënësit i kanë ndërprerë marrëdhënien e punës puntorit pa zhvilluar kurrfarë procedure disiplinore ashtu siç është paraparë p.sh. me nenet 111, 112, 113 etj të Ligjit për Marrëdhënien e Punës i vitit 1989, por duke u mjaftuar vetëm me njoftimin e puntorit për shkëputjen e kontratës së punës, bazuar në nenin 11 parag.5 të Rregullorës së UNMIK-ut 2001/27.

Siç e cekëm edhe më lartë në gjykatat e Kosovës ka pasur praktika të ndryshme për sa i përket kësaj çështje, përfshirë këtu edhe vet Gjykatën Supreme të Kosovës si pushtet më i lartë gjyqësor në Kosovë. Mirëpo kohëve të fundit kemi një unifikim të këtyre praktikave nga ana e Gjykatës së Apelit dhe të asaj Supreme, pasi që tani është ardhur në përfundim se punëdhënësit me rastin e shkëputjes së marrëdhënies së punës punëtorit, duhet të zbatojnë patjetër procedurën disiplinore të paraparë me ligjet e lartpërmendura dhe në rastet kur dyshohet se puntori ka bërë shkelje të detyrave të punës, këto shkelje duhet të vërtetohen përmes inicimit dhe mbajtjes së procedurës disiplinore nga organi kompetent i punëdhënësit, e pastaj varësisht nga konstatimi i këtyre shkeljeve puntorit t’i shqiptohen masat adekuate disiplinore, përfshirë këtu edhe masën më të rëndë siç është ndërprerja e marrëdhënies së punës.

Konsiderojmë se në të gjitha kontestet e punës në të cilat gjykata konstaton se punëdhënësi ka dështuar të respektojë procedurën ligjore me rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, vendimet e punëdhënësit në raport me punëtorët duhet të anulohen si të paligjshme.

Gjithësesi për mbrojtjen gjyqësore të të drejtave nga marrëdhënia e punës, duhet që paraprakisht në mënyrë kumulative të përmbushen dy parakushte apo prezumime procedurale, e të cilat janë: që puntori paraprakisht t'i ketë shteruar procedurat interne për mbrojtjen e të drejtave dhe që padia në gjykatë të jetë dorëzuar brenda afatit të caktuar.

Procedura gjyqësore në kontestet e punës hynë në radhën e të ashtuquajturave procedura të veçanta. Tek kontestet e punës përveç rregullave të përgjithshme të procedurës kontestimore, zbatohen edhe disa rregulla të veçanta të cilat edhe e bëjnë të veçantë këtë procedurë. Kështu që Ligji i Procedurës Kontestimore (LPK) në kreun e XXVI, parasheh procedurën e kontesteve nga marrëdhënia e punës, ndërsa në nenin 474, thuhet se nëse nuk ekzistojnë dispozita të posaçme, në kontestet e punës zbatohen dispozitat e këtij ligji, e nga kjo rezulton se në këto konteste zbatohen të gjitha rregullat e përgjithshme të LPK-së, përveç atyre që janë të posaçme për këtë procedurë. Më tutje në nenin 475, është përcaktuar natyra urgjente e kontesteve të punës, sidomos me rastin e konvokimit të seancave gjyqësore, gjykata duhet të ketë parasysh nevojën e zgjidhjes së shpejtë të këtyre kontesteve.

Kjo është e kuptueshme nëse marrim parasysh se janë në pyetje të drejtat personale të puntorëve që rrjedhin nga marrëdhënia e punës dhe nga realizimi i këtyre të drejtave varet edhe mirëqenia e puntorit dhe familjes së tij, pasi që janë pyetje realizimi i të ardhurave personale, nga të cilat varet ekzistenca e tyre. Si rrjedhojë, tek këto konteste edhe afatet për ndërmarrjen e veprimeve procedurale duhet dhe janë më të shkurta se sa në kontestet e tjera.

Kështu që neni 476 i LPK-së përcakton se në aktgjykimin me të cilin urdhërohet përmbushja e ndonjë detyrimi gjykata cakton afat 7 ditor (afati paritiv), ndërsa afati për paraqitjen e ankesës kundër aktgjykimit apo aktvendimit është poashtu 7 ditor (neni 477). Siç edhe është cekur më lartë, tek kontestet e punës zbatohen të njëjtat parime dhe rregulla të parapara me LPK, ashtu si në kontestet e tjera, duke përfshirë këtu pjesën e shqyrtimit paraprak të padisë, dërgimit të përmirësim dhe plotësim, mbajtjen e seancës përgatitore e kryesore, mjetet provuese etj.

Gjatë procedimit të kontesteve të punës shpeshëherë ka pasur paqartësi lidhur me atë se çka vlerëson gjykata me rastin e shqyrtimit dhe vendosjes në këto konteste, a e vlerëson gjykata vetëm ligjshmërinë e vendimit kundër të cilit është ngritur padia, apo edhe mund të lëshohet edhe në vlerësimin e asaj se a është vërtetuar gjendja faktike nga ana e punëdhënësit me rastin e shpërbërjes së marrëdhënies së punës puntorit. Konsiderojmë se gjykata në procedurën kontestimore sipas padisë së ushtruar nga punëtori e vlerëson ligjshmërinë e vendimit, kundër të cilit është ngritur

padia dhe varësisht nga shkeljet e konstatuara, si dhe nga lloji i kërkesës së paditësit merr vendimin përkatës në formë të aktgjykimit.

Kësisoj në rastet kur kërkesëpadia ka të bëjë me vërtetimin e një fakti gjykata merr aktgjykim vërtetues, kur kërkohet anulimi i ndonjë vendimi, gjykata merr aktgjykim konstitutiv, ndërsa kur kërkesa ka të bëjë me detyrimin e punëdhënësit, atëherë gjykata merr aktgjykim detyrues. Në praktikë shpeshëherë me një padi parashtrohen disa kërkesa me karakteristika të ndryshme, çka imponon edhe marrjen e vendimit gjyqësor miks.

Gjithësesi është me rëndësi të theksohet se nuk është e mjaftueshme që punëdhënësi vetëm të respektoj procedurën e paraparë ligjore për shkëputjen e marrëdhënies së punës punëtorit dhe ky vendim automatikisht nga gjykata të konsiderohet i ligjshëm, pasi që nuk mjafton vetëm të respektohet një procedurë ligjore dhe të ndërmerren veprime në zbatim të kësaj procedure, por gjithësesi kësaj duhet t'i paraprijë vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike, ndërsa vetëm kur të arrihet kjo nga punëdhënësi atëherë vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës mund të jetë i drejtë dhe i ligjshëm.

Vendimet e gjykatës në rastet kur konstatohet paligjshmëria e ndërprerjes së kontratës së punës

Se çfarë vendime mund të merr gjykata nëse konstaton se ndërprerja e kontratës së punës nga ana e punëdhënësit është joligjore, në bazë të Ligjit të Punës, kontratës Kolektive ose Kontratës së Punës, rregullohet me nenin 80 të Ligjit të Punës. Kështu në paragrafin 1 pika 1.1 të këtij ligji parashihet se nëse gjykata konstaton se ndërprerja e kontratës së punës nga ana e punëdhënësit është joligjore në bazë të rregullativës ligjore të përmendur më lartë, atëherë do të urdhërojë punëdhënësin që të përmbush njërën prej këtyre dëshmipërblimeve: *“t'i paguajë të punësuarve kompensimin, përveç shtesave dhe shumave të tjera të cilat i takojnë punonjësit në bazë të këtij ligji, Kontratës së Punës, Kontratës Kolektive ose Aktit të Brendshëm, në shuma të tilla që gjykata i konsideron të drejta dhe adekuate, por të cilat nuk duhet të jenë më pak se dyfishi i vlerës së çdo dëshmipërblimi që i takon punonjësit në kohën e shkarkimit”*, ndërsa në pikën 1.2 të parag. 1 të nenit të lartcekur parashihet se: *“nëse largimi nga puna vlerësohet si i paligjshëm sipas nenit 5 të këtij ligji, Gjykata mund ta rikthejë të punësuarin në vendin e tij të punës dhe urdhëron kompensimin e të gjitha pagave dhe përfitimeve tjera të humbura gjatë gjithë kohës së largimit të paligjshëm nga puna”*. Kurse paragrafi 2 i nenit 80 parashihet detyrimi i punëdhënësit që në afatin e caktuar të zbatoj vendimin e gjykatës kompetente.

Formulimi i tillë ligjor i nenit 80 të Ligjit të Punës, ka shkaktuar jo pak dilema dhe paqartësi në zbatimin e tij në praktikë nga ana e gjykatës, por ndoshta edhe vet punëtorët apo përfaqësuesit e tyre kanë pasur dilema se cilat do të ishin kërkesat e tyre, për të cilat do të kishin mundsi ligjore që të kërkojnë mbrojtje gjyqësore në gjykatë. Kjo edhe për faktin se që nga hyrja në fuqi e Ligjit të Punës e deri më tani, nuk ka pasur ndonjë interpretim apo komentim nga organet kompetente,

apo udhëzim se si duhet të zbatohet më së miri në praktikë ky nen, edhe pse kjo është mëse e domosdoshme në mënyrë që të eliminohen të gjitha paqartësitë nga zbatuesit e këtij ligji, siç janë në rastin konkret gjykatat kompetente, të cilat edhe e kanë interpretuar këtë nen në mënyrën e vet dhe kështu edhe janë krijuar praktika jo të unifikuara gjyqësore.

Gjithësesi sipas mendimit tonë, në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 80, ligjdhënësi ka autorizuar gjykatat që në rastet kur konstatojnë faktin se ndërprerja e kontratës së punës nga ana e punëdhënësit është joligjore apo në kundërshtim me rregullativën ligjore, atëherë do të urdhërojë punëdhënësin që të punësuarit t'i paguajë kompensimin në shumën të cilat gjykata i konsideron adekuate dhe të drejta, që do të thotë se shumën e kompensimit i është lënë në vlerësimin e lirë të gjykatës, gjithmonë duke u bazuar në analizimin dhe vlerësimin e të gjitha rrethanave të rastit konkret.

Mirëpo ligjdhënësi vetëm e ka përcaktuar kufirin minimal të kompensimit, nën të cilin gjykata nuk mund të gjykojë, e që është se kompensimi nuk mund të jetë më pak se dyfishi i vlerës së çdo dëmshpërblimi që i takon puntorit në kohën e shkarkimit, ndërsa kjo sigurisht është bërë me qëllim që puntorëve si kategori më e dobët karshi punëdhënësit t'i garantohet kompensim adekuat dhe i drejtë, me rastin e ndërprerjes së kontratës së punës. Gjithësesi edhe tek këto konteste gjykata nuk mund ta tejkalojë kërkesëpadinë e parashtruar nga paditësi, mirëpo brenda asaj që është kërkuar dhe duke marr për bazë të gjitha rrethanat e rastit konkret, të gjykojë shumën adekuate të kompensimit.

Me rastin e gjykimit të shumave që i takojnë të punësuarit për shkak të ndërprerjes së paligjshme të kontratës së punës, gjykata duhet që këtë ta bëjë sipas bindjes së lirë, sigurisht duke zbatuar nenin 323 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, i cili nen shprehimisht thotë: *“Po që se vërtetohet se palës i takon e drejta që t'i shpërblehet dëmi me të holla apo me sende të zëvendësueshme, por pa mundsi që të caktohet shumën e të hollave, apo sasia e sendeve të tilla, apo se një gjë e tilla do të mund të bëhet me vështirësi shumë të mëdha, gjykata për këtë do të vendosë sipas çmuarjes së lirë”*.

Çështja që ka ngritur më shumë dilema brenda komunitetit të gjyqtarëve është fakti se a mundet në çdo rast kur vërtetohet nga gjykata se ndërprerja e kontratës së punës të punësuarit nga ana e punëdhënësit është joligjore, të detyrojë këtë të fundit që ta kthejë në vendin e tij të punës punëtorin. Nëse i referohemi pikës 1.2 të paragrafit 1 të nenit 80, atëherë mund të vijmë në përfundim se ligjdhënësi i ka kufizuar rastet se kur gjykata mund të urdhërojë punëdhënësin që ta kthejë punëtorin në vendin e tij të punës, dhe atë vetëm nëse vlerësohet se largimi nga puna është i paligjshëm sipas nenit 5 të këtij ligji, duke urdhëruar në të njëjtën kohë edhe kompensimin e të gjitha pagave dhe përfitimeve të tjera. Në këtë drejtim neni 5 i Ligjit të Punës flet për ndalimin e të gjitha llojeve të diskriminimit, ndërsa në pikën 5 të tij përcakton se dispozitat e Ligjit nr.2004/3 kundër diskriminimit, do të zbatohen drejtpërsëdrejti tek marrëdhëniet e punës.

Andaj, mund të vijmë në përfundim se gjykata mund të urdhëroj punëdhënësin që ta kthejë të punësuarin në vendin e tij të punës, nëse gjatë procedurës gjyqësore vërtetohet se ky i fundit është diskriminuar në vendin e tij të punës, për cilëndo nga llojet e diskriminimit që janë paraparë me neni 5 të këtij ligji, apo me dispozitat e Ligjit kundër Diskriminimit të përmendur më lartë.

Në të gjitha rastet e tjera gjykata është e autorizuar vetëm të gjykojë kompensim në shumë adekuate të të hollave (kur vërtetohet se vendimi mbi ndërprerjen e kontratës së punës është i paligjshëm, por jo edhe urdhëroj punëdhënësin ta kthejë të punësuarin në vendin e tij të punës.¹⁹⁸ Konsiderojmë se kjo mund të jetë e drejtë, nëse marrim parasysh faktin se për krijimin e marrëdhënies së punës, lidhjen dhe përtëritjen e kontratës së punës duhet të ekzistoj vullneti i të dy palëve si punëdhënësit ashtu edhe punëmarrësit, ndërsa me vet faktin se punëdhënësi ka shprehur vullnetin e tij me rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës punëdhënësit, atëherë edhe mund të konkludohet se i njëjti nuk ka më vullnet të tillë për vazhdimin e marrëdhënies së punës punëtorit.

Është me rëndësi të veçantë që gjykata me rastin e vendosjes rreth kontesteve të punës, të respektoj nevojën që këto konteste të zgjidhen në procedurë urgjente dhe pa vonesa, si dhe vendimet gjyqësore të jenë të qarta dhe të plota. Sidomos duhet t'i kushtohet rëndësi pjesës së dispozitivit të aktgjykimit, në mënyrë që i njëjti të jetë plotësisht i qartë dhe i përmbarueshëm, pasi që paqartësia e tyre shpeshherë shkakton vështirësi me rastin e përmbarimit të dhunshëm të tyre.

Ndërsa vlen të përmendet fakti se në rastet kur gjykata në procedurë kontestimore nuk i përcakton shumën e kompensimit që i takon të punësuarit për shkak të ndërprerjes së kundërligjshme të kontratës së punës (për shkak të urgjencës së procedurës etj), por vetëm e anulon vendimin me të cilin është ndërprerë kontrata e punës dhe e obligon punëdhënësin që psh, punëtorit t'i paguaj të gjitha pagat nga data e largimit nga puna deri në ekzekutimin definitiv të aktgjykimit, por siç e tham pa u cekur shuma e këtij kompensimi, atëherë zgjidhjen për këtë e japin dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore.

Respektimi i afateve ligjore për të kërkuar mbrojtje gjyqësore

Siç e kemi cekur edhe më lartë për të realizuar mbrojtjen gjyqësore të të drejtave nga marrëdhënia e punës, duhet që paraprakisht në mënyrë kumulative të përmbushen dy parakushte apo prezumime procedurale, të cilat janë: që punëtori paraprakisht t'i ketë shteruar procedurat interne për mbrojtjen e të drejtave dhe që padia në gjykatë të jetë dorëzuar brenda afatit të caktuar ligjor. Duke marr parasysh faktin se të dy prezumimet procedurale kanë një rëndësi të veçantë në mbrojtjen gjyqësore të të drejtave që rrjedhin nga marrëdhënia e punës,

¹⁹⁸ Në praktikën gjyqësore jo gjithmonë është respektuar dhe zbatuar drejtë neni 80 i Ligjit të Punës, sidomos për pjesën që ka të bëjë me kthimin e puntorit në vendin e tij të punës, ku në shumicën e rasteve është obliguar punëdhënësi që ta kthejë të punësuarin në vendin e tij të punës, edhe pse nuk janë plotësuar kushtet ligjore nga pika 1.2 që ka të bëjë me vërtetimin e ndonjërit prej llojeve të diskriminimit. Mirëpo vështirësitë kanë ndodhur sidomos me rastin e përmbarimit me dhunë të këtyre vendimeve, ku pas rikthimit në vendin e punës, pas një kohe të shkurtër sërish të njëjtëve i ndërpritet marrëdhënia e punës.

nga përmbushja apo mospërmbushja e të cilave rrjedhin edhe pasoja juridike pozitive apo negative në raport me punëmarrësit, atëherë është e nevojshme që secili prej këtyre prezumimeve të trajtohet në mënyrë të veçantë.

Shterimi i mjeteve të brendshme juridike për të kërkuar mbrojtje gjyqësore

Shterimi i mjeteve të brendshme juridike është parakushti i parë të cilin punëtori duhet të plotësojë, para se të fitoj të drejtën që të kërkojë realizimin e të drejtave të tij që rrjedhin nga marrëdhënia e punës, përmes mbrojtjes gjyqësore në Gjykatë. Se punëtori duhet të kërkojë mbrojtjen e të drejtave të tij nga marrëdhënia e punës fillimisht brenda organeve të punëdhënësit, e parasheh neni 78 i Ligjit të Punës, të cilin e kemi elaboruar më lartë (ky nen përcakton edhe afatet brenda të cilit punëdhënësi duhet të vendos lidhur me kërkesën e punëtorit).

Edhe pse Ligji i Punës nuk ka ndonjë dispozitë e cila shprehimisht e përcakton shtjerimin e mjeteve juridike të brendshme nga ana e punëtorit para se t'i drejtohet gjykatës, kjo indirekt parashihet me neni 79 të këtij ligji, i cili përcakton se çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit 78 parag. 2 të këtij ligji, brenda afatit të caktuar mund të iniciojë kontest pune në Gjykatën Kompetente. Nga kjo nënkuptohet se punëtori patjetër duhet t'i shfrytëzojë mjetet juridike të brendshme (interne) brenda punëdhënësit, nëse dëshiron që të ketë mbrojtje gjyqësore në fazën e mëvonshme.

Gjykata me rastin e pranimit të lëndëve që kanë për objekt marrëdhëniet e punës, gjatë shqyrtimit paraprak të padisë, duhet të vërtetojë faktin se a i ka shtjeruar të gjitha mjetet juridike të brendshme punëtori brenda punëdhënësit, në mënyrë që të njëjtit t'i jepet mbrojtja gjyqësore e kërkuar. Në të gjitha rastet kur gjykata konstaton se punëtori ka dështuar t'i shfrytëzojë këto mjete të brendshme juridike, atëherë me aktvendim padinë duhet ta hedhë poshtë si të parakohshme. Gjithësesi punëtori nuk e humb të drejtën që përsëri t'i drejtohet gjykatës me padi, pasi që t'i shfrytëzojë mjetet e brendshme juridike brenda organeve të punëdhënësit, sigurisht duke respektuar edhe afatin ligjor për parashtrimin e kësaj padie në Gjykatë.

Pasojat juridike të mos respektimit të afatit ligjor për të kërkuar mbrojtje gjyqësore sipas Ligjit të Punës

Respektimi i afatit ligjor për parashtrimin e padisë në gjykatë tek kontestet e punës është parakushti apo prezumimi i dytë që punëtori duhet të plotësojë, për të kërkuar mbrojtje gjyqësore për realizimin e të drejtave të tij që rrjedhin nga marrëdhënia e punës. Kjo është paraparë me neni 79 të Ligjit të Punës të cilin e kemi shtjelluar më lartë, ndërsa referuar këtij neni i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës, atëherë në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh mund të iniciojë kontest pune në Gjykatën Kompetente.

Nëse i referohemi Ligjit për Marrëdhënien e Punës i KSA të Kosovës i vitit 1989 dhe Ligjit të Punës së ish Jugosllavisë, të cilët kanë qenë në fuqi deri në miratimin e Ligjit të Punës (në bazë të Rregulloreve të UNMIK-ut të cilat i kemi përmendur më lartë), atëherë vijmë në përfundim se me Ligjin e Punës është paraparë afat më i gjatë për parashtrimin e padisë në Gjykatë.

Kështu me nenin 83 të Ligjit për Marrëdhënien e Punës të KSA të Kosovës dhe nenin 181 të Ligjit të Punës së ish Jugosllavisë, afati për parashtrimin e padisë në gjykatë në kontestet e punës ka qenë 15 ditor. Sigurisht përcaktimi i afatit 30 ditor për parashtrimin e padisë në Gjykatë sipas Ligjit të Punës, është bërë me qëllim që punëtorët të kenë me shumë kohë për dorëzuar padinë në gjykatë, duke marr parasysh faktin se ky afat është prekluziv, me humbjen e të cilit edhe humb e drejta për të kërkuar mbrojtje gjyqësore.

Gjykata me rastin e pranimit të padisë që ka për objekt mbrojtjen e të drejtave që rrjedhin nga marrëdhëniet e punës, gjatë shqyrtimit paraprak të padisë, duhet të vërtetoj faktin se padia e paditësit (punëtorit) a është parashtruar brenda afati të parapar ligjor, apo jo. Në të gjitha rastet kur gjykata konstaton se punëtori ka dështuar ta dorëzojë padinë brenda afati të caktuar, atëherë me aktvendim padinë duhet ta hedhë poshtë si të palejueshme (pas afatshme), ashtu siç është paraparë me nenin 391 pika f). të LPK, i cili shprehimisht thotë se *“pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata e hedhë poshtë padinë si të palejueshme, po që se konstaton se padia është paraqitur pas skadimit të afatit, po që se me dispozita të posaçme është parashikuar afati për paraqitjen e saj”*. Në këtë rast punëtori e humb të drejtën që të ketë mbrojtje gjyqësore, për shkak se siç e cekëm edhe më lartë afati për parashtrimin e padisë në Gjykatë është prekluziv (nuk mund të shtyhet), me humbjen e të cilit humb edhe e drejta për të kërkuar mbrojtje gjyqësore në Gjykatë.

Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej 3 vitesh nga dita e paraqitjes së kërkesës (neni 87 i LP). Në këto raste gjykata duhet të merr aktgjykim me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, për shkak të parashkrimit të kërkesës, e jo ta hudhë si të pas afatshme padinë sikurse në rastet e cekura më lartë.

Mbrojtja gjyqësore kur i referohet diskriminimit

Mbrojtja gjyqësore e të punësuarve kur i referohet diskriminimit sipas dispozitave të Ligjit të Punës, i jep mundsi gjykatës për rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës sipas diskriminimit, të kthej të punësuarin në vendin e punës dhe ta detyroj punëdhënësin në pagesën e pagave.

Në qoftë se analizohen mirëfilli dispozita e Ligjit të Punës, rezulton se ndërprerja e marrëdhënies së punës sipas bazës së diskriminimit është e vetmja bazë ligjore për ta rikthyer të punësuarin në vendin e tij të punës dhe për ta detyruar punëdhënësin në pagesën e pagave. Pra në çdo rast që gjykatat konstatojnë rrethanën e diskriminimit si shkak i mohimit apo cenimit të ndonjë të drejtë nga marrëdhënia e punës, duhet që të punësuarit t'i ofrojnë mbrojtjen maksimale dhe adekuate.

Në praktikë rastet me të shpeshta janë rastet e rekrutimit për një vend të caktuar të punës, pastaj rastet e diskriminimit në pagë, pozitë dhe të drejta terja nga marrëdhënia e punës, si dhe rastet e procedurave disiplinore.

Në procedurën e rekrutimit veçanërisht duhet dalluar raste e të punësuarve të cilët realizojnë pagë nga buxheti i shtetit sepse këto raste janë me të shpeshta. Në praktikën gjyqësore bëhen gabime nga ana e gjykatave kur në procedurën rekrutimit për ndonjë vend pune kandidati i cili nuk është përzgjedhur kërkon mbrojtje gjyqësore dhe gjykatat anulojnë në tërësi procesin e rekrutimit për atë vend pune.

Është me rëndësi që edhe në rastet kur ndonjë person është trajtuar në mënyrë të pabarabartë mbrojtja gjyqësore të ofrohet deri në masë që e mënjanon shkeljen, për shembull nëse në mënyrë të kundërligjshme nuk është përzgjedhur personi që kërkon mbrojtje gjyqësore, atëherë nuk është e nevojshme të anulohet konkursi por procesi i përzgjedhjes, e forma të tilla. Pra evitohen shkelje deri në masën që palës i ofrohet garancioni i trajtimit të barabartë¹⁹⁹.

¹⁹⁹ Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin C.nr.2784/11, të datës 21.01.2013, ka konstatuar se ka pasur diskriminim me rastin e përzgjedhjes së kandidatit për vend pune. Shih nga arsyetimi i aktgjykimit në fjalë: *"Nuk ka qenë kontestuese së paditësi sipas konkursit me datë 04.05.2011 aplikacionin me të gjitha dëshmitë për plotësimin e kushteve të konkursit për asistent në Departamentin e Gjeografisë, i ka dorëzuar. Gjykata ka gjetur së paditësi disa here në forma të ndryshme me shkrim dhe elektronike i është drejtuar të paditurit për të marrë informacion për rrjedhën e konkursit, mirëpo vetëm me datë 08.07.2011, është informuar së raportet e komisionit vlerësues kanë qenë publike nga data 21.06.2011 e deri me 08.07.2011. Pastaj paditësi me datë 21.09.2011, i është drejtuar senatit të të paditurit me kërkesë për rishqyrtim të procesit të rekrutimit të asistentëve në Departamentin e Gjeografisë. Komisionit për Ankesa i të paditurit Universiteti i Prishtinës, me raportin e tij i nënshkruar nga kryetari i komisionit Dr.Sc. _____, i cili ka shqyrtuar ankesën e kandidatit _____, kundër vendimit të senatit me të cilin kandidati nuk zgjidhet asistentë, ka aprovuar ankesën e _____ si të bazuar. Këtë vendim komisioni e ka marrë pasi që ka vlerësuar në mënyrë të hollësishme dokumentacionin e prezantuar nga kandidati. Gjithashtu komisioni ka vendosur që çështja ti kthehet në rishqyrtim senatit pasi që kandidati i plotëson kushtet konform dispozitës së nenit 185 të statutit të UP-së. Raportin e komisionit të ankesave të të paditurit gjykata e ka pranuar si të besueshëm e rrjedhimisht i ka pranuar si të besueshëm të gjitha rrethanat që i paraqet ky raport. Senati i të paditurit me vendimin 2/42, dt.19.07.2012, ka vendosur që raportin e komisionit të ankesave të ja dërgoj komisionit të studimeve, me qëllim që ky raport të marrë edhe një konfirmim nga komisioni i studimeve, pastaj sipas këtij vendimi komisioni i studimeve është i detyruar që këtë raport të ja kthej senatit, mirëpo derisa gjykata ka vendosur për këtë çështje i paditurit nuk e ka njoftuar gjykatën se ka ndërmarrë ndonjë hap për ta vendosur përfundimisht këtë çështje. Në kuptim të cekurave gjykata vlerëson së paditësi është diskriminuar në kuptim të dispozitave nga neni 5 i Ligjit të Punës. Sipas dispozitës së nenit 5.1 të Ligjit të Punës parashihet së: "diskriminimi është i ndaluar në punësim dhe profesion, lidhur me rekrutimin në punësi, trajnim, promovimin e punësimit, kushtet e punësimit, masat disiplinore, ndërprerjen e kontratës së punës ose çështje të tjera nga marrëdhënia e punës të rregulluara me këtë ligj dhe me ligjet tjera në fuqi". Diskriminimi në këtë rast i referohet trajtimit jo objektiv të çështjes së paditësit në procedurën e rekrutimit të stafit akademik nga i paditurit. Po ashtu paditësi është diskriminuar edhe në kuptim të dispozitave nga neni 8.2 i Ligjit të Punës. Sipas dispozitës së nenit 8.2 të Ligjit të Punës parashihet së: "konkursi duhet të jetë i barabartë për të gjithë kandidatet e synuar, pa asnjë lloj diskriminimi, ashtu siç parashihet me këtë ligj dhe me aktet tjera në fuqi". Gjykata vlerëson se diskriminimi i të paditurit në raport me paditësin vazhdon të shprehet edhe në mos trajtimin me kohë të vete raportit të komisionit të ankesave të të paditurit. Faktin së i paditurit ka bërë shkelje kur ka refuzuar rekrutimin e paditësit si asistent në Departamentin e Gjeografisë e konfirmon vetë*

Në procedurë e shkeljeve të ndonjë të drejte nga marrëdhënia e punës gjykatat duhet të analizojnë dhe shqyrtojnë me kujdes çdo kërkesë sipas një baze të tillë. Zakonisht këto kërkesa për trajtim të pabarabartë vlerësohen në relacion me të drejtat e garantuara me ligj dhe aktet tjera nën ligjore si dhe në relacion me të drejtat që gëzojnë punëtorët tjerë për pozita të njëjta apo për punë të njëjta²⁰⁰ Në rastet e procedurave disiplinore po ashtu është me rëndësi që trajtimi i punonjësve të jetë i barabartë dhe në përputhje me dispozitat ligjore. Nëse gjykata gjen se ka bazë për të kualifikuar veprimet e punëdhënësit si veprime që konsumojnë elementet e diskriminimit, atëherë duhet të ofrohet mbrojtja gjyqësore e kërkuar²⁰¹

komisioni i ankesave i të paditurit, i cili ka konstatuar së paditësi i plotëson kushtet konform statutit të UP-së, ndërsa mos trajtimi i çështjes sipas vlerësimit të komisionit të ankesave paraqet shkeljen e radhës nga i padituri në dëm të paditësit”.

²⁰⁰ Gjykata e Apelit me aktgjykimin Ac.nr. 3533/13, datë 12.05.2016, ka konstatuar se ka pasur diskriminim për shkak të kompensimit të pabarabartë në mes të të punësuarve. Pjesë nga arsyetimi i aktgjykimit: “Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të fakteve të provuara në këtë çështje juridike kontestuese me të drejtë ka arritur në përfundimin se kërkesëpadija e paditëses është e bazuar, pasi që nga provat e administruara në mënyrë të pakontestueshme është provuar fakti se paditësja ka kryer punët dhe detyrat e punës si bashkëpunëtore e filatelisë në kuadër të Departamentit të Filatelisë dhe atë me autorizim të menaxheres së këtij departamenti, për të cilën pozitë është caktuar grada 7, ndërsa e njëjta për këtë punë është kompensuar duke e realizuar pagën sipas gradës 4, të cilën pagë e realizonte sipas kontratës së punës për pozitën nëpunëse e këmbimeve postare. Komisioni i ankesave i të paditurës, lidhur me ankesën e paditëses për sistemim adekuat në vendin e punës, me vendimin e datës 17.03.2009, Nr.01-1077/09, kishte vendosur aprovimin e ankesës së paditëses duke vendosur që paditësja të sistemohet në pozitën konform punëve që i kryen, të kompensohet në mënyrë retroaktive dhe në të ardhmen sipas gradës për vendin dhe detyrat e punës ku do të sistemohet. Ky vendim i të paditurës nuk është implementuar sa i përket kompensimit pavarësisht se nga provat e administruara rezulton se paditësja deri në pensionim ka kryer punët dhe detyrat e punës si bashkëpunëtore e filatelisë. Në këtë kuptim Gjykata e Apelit vlerëson se veprimet e të t’paditurës për mos kompensimin e paditëses edhe pse kishte një vendim të t’paditurës kualifikohen në kuptim të dispozitës së nenit 5 paragrafi 1 të Ligjit të Punës me të cilën dispozitë përcaktohet se: “Diskriminimi është i ndaluar në punësim dhe profesion, lidhur me rekrutimin në punësim, trajnimin, promovimin e punësimin, kushtet e punësimin, masat disiplinore, ndërprerjen e kontratës së punës ose çështjeve të tjera nga marrëdhënia e punës të rregulluara me këtë ligj dhe ligjet tjera në fuqi”. Në këtë rast paditësja është diskriminuar lidhur me kompensimin pasi që për nevoja të t’paditurës me kërkesën dhe autorizimin e të t’paditurës ka kryer punë dhe detyrat e punës për të cilat është dashtë që të kompensohet sipas gradës 7”.

²⁰¹ Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin C.nr.2302/11, të datës 08.02.2013, ka konstatuar se ka pasur diskriminim për shkak të trajtimit jo objektiv të çështjes së paditësit në procedurën disiplinore. Shih nga arsyetimi i aktgjykimit në fjalë: “Duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat gjykata vlerëson së në vet vete moszbatimi i urdhrit nga ana e paditësit mund të kualifikohet si shkelje, por kur vlerësohen rrethanat nën të cilat është kundërshtar ky urdhër atëherë shkelja minimizohet tërësisht apo eliminohet krejtësisht. Në këtë kuptim masa e shqiptuar ndaj paditësit është e kundërligjshme. Në kuptim të cekurave gjykata vlerëson së paditësi është diskriminuar në kuptim të dispozitave nga neni 5 i Ligjit të Punës. Sipas dispozitës së nenit 5.1 të Ligjit të Punës parashihet se “ diskriminimi është i ndaluar në punësim dhe profesion, lidhur me rekrutimin në punësi, trajnim, promovimin e punësimin, kushtet e punësimin, masat disiplinore, ndërprerjen e kontratës së punës ose çështje të tjera

E DREJTA PRONËSORE

nga marrëdhënia e punës të rregulluara me këtë ligj dhe me ligjet tjera në fuqi". Diskriminimi në këtë rast i referohet trajtimit jo objektiv të çështjes së paditësit në procedurën disiplinore".

MBROJTJA GJYQËSORE NGA PENGIM POSEDIMI

Natyra e Posedimit

Nocioni i posedimit

Roli që posedimi luan për të drejtën i ka inspiruar njerëzit ndër shekuj, ndërkohë që filozofët e së drejtës janë munduar që në punën e tyre ta përkufizojnë atë në mënyrë ligjore. Në këtë përpjekje ata kanë konstatuar gjithnjë një vështirësi për dhënien e një përkufizimi të saktë juridik për natyrën e posedimit. Kjo vështirësi vjen nga fakti që posedimi është një term me një përhapje të zakonshme pa asnjë përcaktim signifkativ në të drejtë.²⁰²

Përkundër vështërsive për përkufizimin e saktë juridik të natyrës së posedimit, të mbrojtjës gjyqësore nga akti i pengimit të posedimit, poseduesi me padi e cila në fakt paraqet një veprim procedural me të cilin vihet në veprim procesi kontestimor nga gjykata kërkon mbrojtjen e të drejtës subjektive të cilën ajo e realizon me nxjerrjen e vendimit të saj. Prandaj në këtë procedurë element qenësor është kuptimi i posedimit.

Posedimin e ka ai person i cili e ka pushtetin faktik mbi sendin. Për dallim nga pronësia e cila përcakton pushtetin juridik, posedimin e përcakton pushtetin faktik mbi sendin. Posedimi me vetë këtë humbet me pushimin faktik të pushtetit mbi sendin. Personi i cili e ka posedimin pa marrë parasysh se e ka pushtetin faktik në sendet, e gëzon të drejtën në mbrojtje juridike. Andaj, posedimi është gjendja faktike juridikisht e mbrojtur. Posedimi nuk është e drejtë, por pa marrë parasysh për këtë i njëjti prodhon pasoja juridike shumë të rëndësishme. Posedimi është bazë themelore për fitimin e disa të drejtave reale, për këtë posedimi faktik tek personi i caktuar, ndryshimi i tij përkatësisht pushimi qenësisht kanë ndikim në fitimin dhe pushimin e drejtave reale të caktuara.

Ligji ynë e përkrahë konceptin objektiv të posedimit sipas të cilit posedues është secili person i cili ushtron pushtetin faktik mbi sendin, pa marrë parasysh se me këtë rast pushtetin e kryen për veten apo për tjetërkënd.

Vullneti të posedimi nuk mund të apstrahohet dhe nuk mund të jetë irelevant, kjo për arsye se posedimi është njëherit edhe një lloj raporti social, gjersa vullneti si akt psikik i çdo personi duhet të jetë i qartë dhe i drejtuar ndaj subjekteve tjera. Prandaj kur themi se posedimi paraqet pushtetin faktik mbi sendet, do të thotë se duhet të ekziston një akt i vullnetit pa të cilin nuk kishte me pas pushtet faktik mbi sendin në raport me personin tjetër. Posedimi i sendit është pushteti faktik mbi sendet dhe nuk është i domosdoshëm vullneti i poseduesit që sendin ta mban si të veten. Në të vërtetë posedimi përmbahet në realizimin e ndonjë interesi, ekonomik apo tjetër për çfarë arsye

²⁰² Pollock, Frederick & Wright Rober Samuel, An Essaz in Possession in Common Law, Oxford, Clarendon Press, 1888, fq 1

për ekzistimin e posedimit është i nevojshëm vullneti i përgjithshëm i poseduesit që ta mbaj sendin për realizimin e ndonjë interesi.²⁰³

Elementin e vullnetit e aprovon edhe Ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore. Elementi i vullnetit nuk duhet të jetë te posedimi në bazë të trashëgimisë përkatësisht te bashkësia trashëguese e cila nuk është gjendje faktike nga se posedimi trashëgimtarëve u takon në bazë të Ligjit në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit.²⁰⁴

Objekti i Posedimit

Objekt i posedimit është e drejta apo pushteti faktik që një person ka mbi një send. Objekt i posedimit mund të jenë sendet e luajtshme dhe të paluajtshme, individualisht të përcaktuara. Këtu bëjnë pjesë edhe frytet e shkëputura. Sendi për të qenë objekt i posedimit duhet të dalë në qarkullim juridik, kjo bëhet me punë juridike. Sendet që janë në përdorim të përgjithshëm nuk mund të jenë objekt i posedimit, p.sh. rrugët, parqet publike etj. Nëse mbi një send është i mundshëm fitimi i pronësisë ose e drejta e shfrytëzimit është i mundshëm edhe posedimi ndaj tij.

Përveç posedimit të sendeve ekziston edhe posedimi i të drejtave. Kur dikush nuk e ka pushtetin e plotë faktik ndaj sendit, por vetëm pushtetet apo të drejta të atilla që është përmbajtje e ndonjë të drejte sendore tjetër, ai ka posedimin e të drejtave. Te ky lloj posedimi është e drejta, që do të thotë se objekt mund të jetë edhe një e drejtë servituti, e drejta në barrën reale, e drejta e obligacionit, që janë rezultat e ndonjë pune juridike.

Sipas Ligjit nr. 03/L-054 për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, nga posedimi i së drejtës kemi vetëm posedimin e së drejtës së servituteve reale (neni 252 i të njëjtit ligj). Posedimi i të drejtave që përmbajnë dy elemente corpusin dhe animusin, quhet posedim i drejtë i cili gëzon mbrojtje juridike. Corpusi tek posedimi i të drejtave d.m.th kryerja faktike e përmbajtjes esenciale të ndonjë të drejte. Animusi, tek posedimi i të drejtave d.m.th vullneti që të ushtrohet përmbajtja e ndonjë të drejte, si e drejtë e tij.²⁰⁵

Ligji për pronësinë dhe të drejtat sendore parasheh se posedimin e së drejtës së servitutit real e ka personi që faktikisht shfrytëzon pasurinë e paluajtshme të personit tjetër në vëllimin që i përgjigjet përmbajtjes së këtij servituti. Poseduesi i të drejtave është kryerje faktike e përmbajtjes esenciale të ndonjë të drejte të lidhur me vullnetin që përmbajtja e asaj të drejte të kryhet për veti (si e drejtë e tij). Posedimin e të drejtës së servitutit e ka personi i cili faktikisht është duke shfrytëzuar sendin e paluajtshëm që i takon personit tjetër.²⁰⁶

²⁰³ Isa Kelmendi, Padia për mbrojtjen nga akti i pengim posedimit, material trajnimi, IGJK 2013.

²⁰⁴ Ligji nr. 03/L-054 Për Pronësinë Dhe Te Drejtat Tjera Sendore, fq 18, neni 106.

²⁰⁵ E Drejta Civile, pjesa e dytë, SENDET,2007/036, Prizren-Kosovë.

²⁰⁶ Ligji nr. 03/L-054 Për Pronësinë Dhe Te Drejtat Tjera Sendore, fq 46, neni 261.

Elementet e posedimit

Sipas doktrinës bashkëkohore që ka zanafillën e vet në të drejtën Romake, posedimi ka apo përbëhet nga dy elemente që janë:

- a. Corpus- elementi trupor (material) dhe
- b. Animus-vullneti (shpirti) ose qëllimi për ta mbajtur sendin.²⁰⁷

Pavarësisht se dispozitat ligjore në fuqi që janë në Kosovë të cilat rregullojnë institutin e posedimit, shprehimisht nuk përmendin elementin e dytë të posedimit, animus-vullnetin ose qëllimin për ta mbajtur sendin, një gjë e tillë është paraparë me nenin 169 të Kodit Civil të Shqipërisë, i cili nen nëpërmjet shprehjes „*duke u sjellë si pronar*“ ka lënë të kuptohet se posedimi i sendit mund të realizohet nëpërmjet ekzistencës së dy elementeve përbërëse të tij corpus dhe animus, që do të thotë se poseduesi e posedon sendin vetëm në rast të plotësimit të këtyre dy elementeve përbërëse të lartëcituara, elementit fizik që manifestohet në sundimin (mbajtjen) efektive të sendit (*corpus*) dhe elementit psikologjik që manifestohet në vullnetin e poseduesit për të poseduar sendin (*animus domini*)²⁰⁸

Llojet e Posedimit

Posedimi ndahet në disa lloje:

Posedimi i drejtpërdrejtë dhe posedimi i tërthortë (indirekt).

- a. Posedimi i drejtpërdrejtë ekziston atëherë kur personi drejtpërdrejtë ose përmes të autorizuarit ushtron pushtetin faktik mbi sendin.
- b. Posedimi indirekt ekziston atëherë kur personi pushtetin faktik mbi sendin e ushtron përmes një personi tjetër, i cili në bazë të frytë gëzimit, kontratës mbi pengun, qirasë, shërbimit e ka sendin në posedim të drejtpërdrejtë. Te posedimi indirekt kërkohet që sendi të përdoret në bazë të punës juridike dhe i njëjti të kthehet te poseduesi në posedim të drejtpërdrejtë, pas kalimit të kohës së paraparë me punën juridike. Psh. Qiramarrësi e kthen sendin te qiradhënësi.

²⁰⁷ Ivo Puhan, Vep. Cit fq 254 si dhe Dr. A. Mandro, E Drejta Romake, Tiranë 1998, fq 197.

²⁰⁸ Kodi Civil i Shqipërisë, nenin 169& Altin Shkurti, Disertacion për mbrojtjen e gradës shkencore „Doktor“, në temën Posedimi dhe Mbrojtja e tij, Tiranë Tetor 2015.

Posedimi i ligjshëm apo jo i ligjshëm.

- a. Posedimi i ligjshëm është posedimi i cili mbështetet në bazë juridike të vlefshme (punët juridike, vendimet, okupimi etj.)
- b. Posedimi i pa ligjshëm është posedimi i cili nuk mbështetet në ndonjë bazë juridike.

Posedimi i vërtetë dhe jo i vërtetë.

- a. Posedimi i vërtetë është ai i cili fitohet me bazë të rregullt (në mënyrë të rregullt), me dorëzim të lejueshëm të sendit në pushtet faktik.
- b. Posedimi i pa vërtetë është ai që fitohet me forcë, dhunë dhe mashtrim, p.sh. Dikujt i jepet biçikleta që ta përdorë dhe me pastaj ai nuk e kthen.

Posedimi me mirëbesim dhe me keqbesim.

- a. Posedues me mirëbesim, është ai që nuk din apo nga rrethanat e arsyeshme nuk duhet të dinte se sendin që e posedon nuk është i tij.
- b. Poseduesi me keqbesim është ai i cili e ka ditur se pa autorizim e posedon sendin e huaj, ose nga rrethanat ekzistuese është dashur ta dinte se nën pushtetin e vetë faktik ka sendin e huaj. Posedues me keqbesim është edhe poseduesi me mirëbesim pas marrjes së padisë për kthimin e sendit, me kusht që poseduesi ta humbë kontestin në Gjykatë. Pra, mirëbesimi ndërpritet në momentin kur poseduesi merr dijeni se posedimi nuk i takon atij.²⁰⁹

Posedimi i pavarur (autonom) dhe bashkë posedimi

- a. Te posedimi autonom, poseduesi i përjashton të gjithë personat e tjerë nga pushteti faktik ndaj sendit (neni 108 i LPDTS).
- b. Të bashkë posedimi disa persona e ushtrojnë pushtetin faktik mbi sendin, në mënyrë që çdonjëri bashkë posedues është i kufizuar me pushtetin faktik të bashkë poseduesve tjerë (neni 108 i LPDTS).

²⁰⁹ Isa Kelmendi, Padia për mbrojtjen nga akti i pengim posedimit, material trajnimi, IGJK 2013.

Fitimi dhe humbja e posedimit

Fitimi i Posedimit

Në të drejtën sendore rëndësi të veçantë paraqet momenti i konstituimit të ndonjë të drejte sendore. Posedimi edhe pse nuk është e drejtë, krijimi saj lidhet për faktin e caktuar. Posedimi i cili paraqet pushtetin faktik mbi sendin, respektivisht mbi të drejtën, lindë me konstituimin e pushtetit faktik ndaj sendit që është objekt i posedimit.

Posedimi mund të fitohet në dy mënyra:

- a. Mënyrë origjinere dhe
- b. Mënyrë derivative.

Fitim origjiner i posedimit, do të thotë fitimi i posedimit pa ose kundër vullnetit të poseduesit të deritanishëm. Në këtë rast fitimi bëhet pa marrë parasysh paraardhësin, (posedimi në bazë të ligjit kur p.sh. kujdestari kujdeset për pasurinë e një të mituri i cili nuk e ka arritur moshën madhore dhe pushtimi kur p.sh. një person nga një rezervat ka marrë një tufë kuajsh të egër më qëllim që t'i përvetësoj për vete).

Fitimi derivativ është mënyrë tjetër e fitimit të posedimit, ku fitimi i posedimit bëhet me vullnetin e poseduesit paraardhës, që nënkupton kalimin e posedimit nga një posedues në poseduesin tjetër. Fitimi derivativ bëhet pra me dorëzimin e sendit dhe dorëzimi i sendit nënkupton konstituimin e posedimit, si p.sh. (**më anë te veprimet juridik** si psh. kontratës mbi qiranë , **aktit administrativ** si psh. vendimi i organit komunal që një ngastër në pronësi të Komunës ti jepet në shfrytëzim një personi të caktuar dhe **trashëgimisë** si psh. kur bëhet shqyrtimi i trashëgimisë së trashëgimlënësit dhe pasuria e tij i takon një apo me shumë personave)

Dallojmë edhe bashkë posedimin i cili është i mundshëm tek të gjitha të drejtat që mund të kenë më shumë titullar, p.sh. edhe tek e drejta e pronësisë, servituti, bashkë posedimi, ku bashkë poseduesit pushtetin faktik të posedimit e ushtrojnë sipas pjesëve alikuote.

Përveç bashkë posedimit ekziston edhe posedimi i përbashkët, kur dy e më shumë persona e ushtrojnë pushtetin faktik mbi sendin dhe nuk dihet vëllimi i ushtrimit të pushtetit faktik derisa të ndahet sendi i përbashkët.²¹⁰

²¹⁰ Altin Shkurti, Disertacion për mbrojtjen e gradës shkencore „Doktor“, në temën Posedimi dhe Mbrojtja e tij, Tiranë Tetor 2015 & E Drejta Civile, pjesa e dytë, SENDET,2007/036, Prizren-Kosovë.

Humbja (shuarja) e posedimit

Posedimi është pushtet faktik mbi sendin. Me humbjen e pushtetit faktik mbi sendin shuhet edhe posedimi. Posedimi shuhet kur poseduesi heq dorë nga pushteti faktik mbi sendin ose në ndonjë mënyrë e humb pushtetin faktik.²¹¹

Shuarja e posedimit mund të bëhet sipas dëshirës dhe kundër dëshirës së poseduesit të deriatëhershëm. Sipas dëshirës është nëse poseduesi e braktis sendin, ndërsa kundër dëshirës posedimi shuhet nëse personi i tretë ja marr sendin nga posedimi (vjedhja) ose nëse e humb sendin që e ka pasur ne posedim.

Në praktikë dallojmë disa mënyra të shuarjes se posedimit e ato janë:

- a. Humbja e posedimit me mungesën e corpus-it dhe animus-it
- b. Humbja e posedimit me mungesën e corpus-it
- c. Humbja e posedimit me mungesën vetëm të animus-it dhe
- d. Humbja e posedimit me anë të përfaqësuesit

Humbja e posedimit me mungesën e corpus-it dhe animus-it

Posedimi humbet me mungesën e të dy elementeve përbërës (corpus) dhe (animus) ose dhe vetëm me mungesën e njërit prej tyre. Të dy elementet përbërës të posedimit mungojnë, kur poseduesi humbet si sundimin efektiv mbi sendin, ashtu edhe vullnetin për të mbajtur sendin si të vetin p.sh. shitja e sendit etj.

Humbja e posedimit me mungesën e corpus-it

Kur pronari humbet sundimin efektiv mbi sendin, por ruan vullnetin e tij për ta poseduar sendin, vullneti i tij është pa ndonjë dobi, sepse mungon objekti. Humbja e posedimit realizohet kur pronari pengohet që të ushtrojë sundimin efektiv të tij mbi sendin, në mënyrë të qëndrueshme nga ndonjë shkak ndalues, i cili mund të vijë ose nga vetë sendi ose nga një ngjarje e natyrës si p.sh. humbja e sendit, largimi i tufës së bletëve, shkëputja e një cope toke të ngjitur në bregun e lumit dhe transportimi i saj

Humbja e posedimit me mungesën vetëm të animus-it

Posedimi humbet kur poseduesi shpreh vullnetin për të mos e poseduar me sendin, si p.sh. kur sendi shitet, dhurohet, shkëmbehet, hiqet nga posedimi me vendim të formës së prerë etj. Posedimi i sendit humbet edhe në rastin kur pronari deklaron se këtë e tutje nuk do të posedojë në emër të tij, por në emër të tjetrit.

²¹¹ Ligji nr. 03/L-054 Për Pronësinë Dhe Te Drejtat Tjera Sendore, fq 18, neni 107.

Humbja e posedimit me anë të përfaqësuesit

Posedimi i sendit i realizuar nëpërmjet përfaqësuesit, gjithashtu mund të humbet kur mungon vullneti i të përfaqësuarit, si dhe kur vullneti për ta mbajtur sendin kalon nga i përfaqësuari tek përfaqësuesi, p.sh. qiramarrësi, uzufuktari, depozitari etj. ndryshon vullnetin për ta mbajtur sendin për vete (intersersio possessionis) . Posedimi i realizuar nëpërmjet përfaqësuesit mund të humbas kur nëpërmjet humbjes së sundimit efektiv të sendit të poseduar, p.sh. uzufuktari, depozitari etj. zhvishet nga posedimi i sendit.²¹²

Mbrojtja e posedimit

Posedimi gëzon mbrojtjen juridike. Posedimi është një gjendje faktike, kurse parimi i përgjithshëm juridik i cili ka rëndësi jo vetëm në të drejtën civile por edhe në degë tjera të drejtësisë është se një gjendje ekzistuese, faktike duhet të mbrohet. Askush nuk mund të cenoj pushtetin faktik në mënyrë arbitrare, por vetëm me ndihmën e organeve kompetente. Poseduesi i sendit ka të drejtë në mbrojtje nga shqetësimet (pengimet) ose nga marrja e sendit nga posedimi, ku në këtë rast poseduesi zhvishet nga posedimi i sendit.²¹³

Kompetenca

Në kontestet për shkak të pengim posedimit ligjërisht në pikëpamje territoriale ekskluzivisht kompetente është gjykata në territorin e së cilës ndodhet sendi i paluajtshëm në të cilin ekziston posedimi.²¹⁴

Kur pengimi i posedimit ka të bëjë me sendin e luajtshëm, kompetenca është e zgjidhshme nga paditësi. Në këtë rast paditësi mund të paraqesë padinë ose në gjykatën e kompetencës tokësore të përgjithshme (gjykata në territorin ku i padituri ka vendbanimin ose vendqëndrimin , neni 37 dhe 38 i LPK) ose në gjykatën në territorin e të cilës është bërë pengimi.²¹⁵

Llojet e padive dhe afati për paraqitjen e padisë

Për mbrojtjen e posedimit ekzistojnë dy padi:

- a. Padia për pengim të posedimit dhe
- b. Padia për kthimin e posedimit.

²¹² Altin Shkurti, Disertacion për mbrojtjen e gradës shkencore „Doktor ‘, në temën Posedimi dhe Mbrojtja e tij, Tiranë Tetor 2015

²¹³ Isa Kelmendi, Padia për mbrojtjen nga akti i pengim posedimit, material trajnimi, IGJK 2013.

²¹⁴ Ligji nr. 03/L-006 për procedurën kontestimore (LPK) fq. 11, neni 41.1.

²¹⁵ Ligji nr. 03/L-006 për procedurën kontestimore (LPK) fq. 14 , neni 52 & Faik Brestovci, E drejta Procedurale Civile II, Prishtinë, 2006, fq. 128.

Me Ligjin për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore parashihet se secili mbajtës i sendit dhe i drejtës gëzon mbrojtje juridike qoftë nga privimi nga posedimi apo edhe nga pengimi në posedim.²¹⁶ Kjo do të thotë se pengimi i posedimit mund të kryhet si me privimin nga posedimi mbi një send apo marrjen e sendit, e po ashtu edhe me pengim në posedimin e qetë mbi një send. Me privimin nga posedimi vjen gjerë tek ndërrimi i posedimit, ku ish poseduesi përjashtohet nga posedimi përkatësisht pushteti faktik mbi sendin dhe pushtetin faktik e kryen poseduesi i ri. Andaj me marrjen e sendit e nënkuptojmë marrjen e përhershme të pushtetit nga poseduesi, gjersa pengimi në posedimin e qetë mbi një send është çdo pengim tjetër që poseduesit të sendit mund t'i bëhet të cilit do t'i vështirësohej shfrytëzimi apo posedimin i qetë i atij sendi, por që nuk ka për pasojë marrjen e sendit apo privimin nga posedimi mbi sendin.

Me Ligjin mbi pronësinë dhe të drejtat tjera sendore është paraparë se poseduesi i sendit ka të drejtë që të kërkojë mbrojtje gjyqësore nga pengimi apo se posedimi në afat prej 30 ditësh (afati subjektiv) nga marrja e dijenisë për pengimin dhe penguesin, e me së voni brenda afatit një vjeçar (afati objektiv) nga dita e pengimit.²¹⁷ Pas kalimit të afatit objektiv padia nuk mund të ngritet, edhe pse ndoshta ende nuk ka kaluar afati subjektiv. Afatet e përmendura janë afate prekluzive të së drejtës materiale, ku për respektimin e tyre gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare. Në qoftë se padia paraqitet pas kalimit të tyre, kërkesëpadija refuzohet. Në rast se pengimi i posedimit përsëritet, afati për padi fillon nga marrja e dijenisë për çdo pengim të ri.²¹⁸

Edhe pse ligjërisht dhe parimisht afatet për paraqitjen e padisë për shkak të pengim posedimit janë afate prekluzive të së drejtës materiale, ku në rast se padia ushtrohet pas kalimit të këtyre afateve atëherë gjykata duhet të refuzoj kërkesëpadinë, një gjë e tillë deri diku është në kundërshtim me dispozitën e nenit 391 parag. 1 pika f) të LPK më të cilën dispozitë shprehimisht është përcaktuar se „*Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se padia është paraqitur pas skadimit të afatit, po që se me dispozita te posaçme është parashikuar afati për paraqitjen e saj*“²¹⁹

Po ashtu me nenin 393 të LPK është përcaktuar se „*Gjykata në qoftë se konsideron se nuk ka material procedural të mjaftueshëm për dhënien e aktvendimit mbi ndonjë çështje që është paraqitur gjatë shqyrtimit paraprak të padisë, do te vendos lidhur më këtë pasi ti arrijë përgjigja ne padi e të paditurit ose gjatë seancës përgatitore apo në seancën e shqyrtimit kryesor të çështjes, po që se nuk është mbajtur seanca përgatitore*“²²⁰

Në kuptim të dispozitave ligjore te nenit 391 dhe 393 të LPK, mund të konkludohet se gjykata nuk ka pengesa që padinë për shkak të pengim të posedimit ta hedhë poshtë si të palejueshme edhe pas

²¹⁶ Ligji nr. 3/L-154 për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, fq. 19, neni 113 paragrafi 1 dhe 2.

²¹⁷ Ligji nr. 3/L-154 për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, fq. 19, neni 114.

²¹⁸ Prof. Dr. Faik Brestovci, E Drejta Procedurale Civile II, Prishtinë, 2006, fq. 128

²¹⁹ Ligji nr. 03/L-006 për procedurën kontestimore (LPK) fq. 111, neni 391.

²²⁰ Ligji nr. 03/L-006 për procedurën kontestimore (LPK) fq. 112, neni 393.

arritjes së përgjigjes ne padi, gjatë seancës përgatitore por edhe gjatë seancës së shqyrtimit kryesor nëse nuk është mbajtur seanca përgatitore, nëse gjatë këtyre fazave procedurale ka siguruar material të mjaftueshëm se padia është paraqitur pas kalimit të afatit ligjor (subjektiv dhe objektiv).

Mirëpo duke pasur parasysh se afatet për paraqitjen e padisë për shkak të pengim posedimit ligjorisht janë afate prekluzive të së drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare, sipas mendimit tonë në rastet kur gjykata gjatë seancës përgatitore apo të shqyrtimit kryesor siguron material të mjaftueshëm në bazë të së cilit konstaton se padia është paraqitur pas afatit kohor ligjor (subjektiv apo objektiv), ajo duhet të marrë vendim për refuzimin e kërkesëpadisë, e jo vendim për hedhjen poshtë të padisë si të palejuar.

Urgjenca

Me rastin e caktimit të afateve dhe konvokimit të seancave gjykata gjithmonë duhet t'i kushtojë kujdes nevojës së zgjidhjes së ngutshme të kontesteve për shkak të pengim posedimit, por duke marrë parasysh natyrën e secilit rast konkret.²²¹

Përparësi duhet dhënë provave të cilat mund të shfrytëzohen shpejt. Nëse vendoset marrja e provës më anë të këqyrjes së drejtpërdrejtë, duhet shfrytëzuar mundsinë eventuale që aty për aty të jepet vendimi meritor për kërkesëpadinë. Seanca gjyqësore mund të mbahet edhe pa kaluar fati tetë ditë nga dita në të cilën palës i është dorëzuar letërthirrja. Vetëm mbrojtja e shpejtë dhe efikase mund të jetë e dobishme në këto lloje kontestesh.²²²

Objekti i shqyrtimit

Ne rastet e padive për shkak të pengim posedimit e gjithë veprimtaria procedurale pranë gjykatës duhet drejtuar kah konstatimi i gjendjes së fundit të posedimit dhe kah konstatimi i pengimit. Është përjashtuar shqyrtimi i të drejtës mbi posedimin, bazës juridike të posedimit, ndërgjegjshmërisë së poseduesit, kërkesës për dëmshpërblim për dëmin e shkaktuar me anë të veprimeve më të cilat është bërë pengimi i posedimit etj. Pengimi i posedimit është çdo veprim me vetëdije të personit të tretë me të cilin veprim poseduesi i sendit është i shqetësuar në shfrytëzimin e sendit ashtu siç e ka bërë më parë. Në këtë procedurë Gjykata shqyrton dhe vendos lidhur me padinë vetëm për mbrojtjen faktike të posedimit.²²³

Në padinë për pengim-posedimin duhet në mënyrë precize të përcaktohet-përshkruhet pengimi i posedimit, mënyra (akti dhe koha e pengimit) si dhe çka i urdhërohet të paditurit. Padia e cila nuk përmban të tëra këto nuk është e plotë dhe si e tillë nuk është e përshtatshme për shqyrtim në

²²¹ Ligji nr. 03/L-006 për procedurën kontestimore (LPK) fq. 133, neni 479.

²²² Faik Brestovci, E drejta Procedurale Civile II, Prishtinë, 2006, fq. 128-129.

²²³ Ligji nr. 03/L-006 për procedurën kontestimore (LPK) fq. 133, neni 480 &. Faik Brestovci, E drejta Procedurale Civile II, Prishtinë, 2006, fq. 129

kuptim të nenit 102 të LPK. Andaj Gjykata padinë e tillë duhet t'ia kthej paditësit që në afat të caktuar t'i eliminoj mangësitë nën kërcënim të hedhjes së padisë.

Pas përfundimit të shqyrtimit lidhur me padinë Gjykata merr aktvendim me të cilin vendos se kërkesëpadia është e bazuar apo është e pa bazuar. Dispozitivi i aktvendimit për pengimin e posedimit duhet të përmbajë të gjitha elementet si dhe padia, kjo do të thotë se te kontesti për pengim të posedimit ekziston identiteti i kërkesave, kjo është me rëndësi te pengimi i posedimit të serishëm në procedurën përmbartimore, kur duhet aplikuar dispozitat e kësaj procedure.²²⁴

Te pengimi i posedimit legjimiteti në kontest paraqet raportin materialo-juridik të palëve ndaj lëndës së kontestit. Paditësi ka legjimitet aktiv po që se është bartës i të drejtave që është lëndë e kontestit, gjersa i padituri ka legjimitet pasiv po që se në të ekziston detyrimi që i përgjigjet kësaj të drejte. Në kontekst me këtë i padituri i cili nuk e ka krye pengimin e posedimit nuk mund të ketë legjimitetin pasiv në kontest. Paditësi në këto konteste duhet të dëshmoj se ishte në posedim të sendit apo të drejtës dhe që i padituri në sendin e caktuar në mënyrën e caktuar dhe në kohën e caktuar e ka penguar në posedim. Si i paditur në padi përcaktohet personi i cili e ka krye pengimin apo marrjen e sendit të poseduar, e po ashtu personi në interes të cilit është kryer pengimi i posedimit.

Kjo do të thotë se padia mund të parashtrohet edhe kundër kryesit të tërthortë e po ashtu edhe kundër personit në interesin e të cilit kjo është bërë. Parashtruesin e padisë nuk e intereson raporti mes këtyre dy personave dhe për këtë Gjykata në këtë kontest nuk shqyrton lidhur me këtë. Kryesi i drejtë për drejtë dhe indirekt i aktit të pengimit të posedimit nuk janë bashkë ndërgjyqës unik si të paditur. Kjo do të thotë se janë pasivisht të legjitimuar se personi i cili ka dhënë urdhër për kryerjen e veprimit të pengimit si dhe personi që e ka kryer pengimin. Mirëpo po që se pengimi i posedimit është kryer nga dy apo më shumë persona të cilët kanë punuar së bashku si bashkë kryes në këtë rast këta persona janë bashkë-ndërgjyqës unik dhe duhen të përfshihen me padi.

Me rastin e vendosjes për padi për shkak të pengimit të posedimit, Gjykata është e detyruar të vërtetoj se me veprimin e pengimit, poseduesi është privuar nga posedimi në mënyrë të kundërligjshme apo në mënyrë të kundërligjshme vetëm është penguar në posedimin e një sendi apo të drejte.²²⁵

Poseduesi ka të drejtë në vetëgjyqësi për mbrojtjen e të drejtës së posedimit në bazë të nenit 112 të Ligjit për pronësi dhe të drejtat tjera sendore ndaj personit i cili e shqetëson në posedim ose e ka marrë posedimin por kjo realizohet me kusht që rreziku duhet me qenë i drejtpërdrejtë, që vetëmbrojtja të është e nevojshme dhe mënyra e kryerjes së saj ti përgjigjet rrethanave në të cilat ekziston rreziku. Kjo formë e mbrojtjes së posedimit nënkupton realizimin dhe sigurimin e mbrojtjes subjektive nga vetë titullari i saj i cili për këtë qëllim e përdor forcën fizike. Në këtë

²²⁴ Isa Kelmendi, Padia për mbrojtjen nga akti i pengim posedimit, material trajnimi, IGJK 2013.

²²⁵ Isa Kelmendi, Padia për mbrojtjen nga akti i pengim posedimit, material trajnimi, IGJK 2013.

kontest mbrojtja juridiko-civile mundson një mbrojtje më të plotë të drejtës së pronësisë e cila edhe është në përputhje me përmbajtjen e asaj të drejte. Kështu poseduesi i sendit të drejtën e vetë e mbron me padi juridiko-civile kur i merret sendi apo pengohet në posedimin e tij.²²⁶

Praktika ka treguar disa raste të pengim posedimit , e të cilat janë:

- a. Pengim posedimi në të mirën publike
- b. Pengimi i posedimit në mënyrë verbale

Në raste se akti i pengim posedimit është kryer në rrugë publike ekziston kompetenca paralele të Organit të Administratës dhe gjykatës së rregullt dhe në raste të tilla shfrytëzuesi i rrugës mund të kërkoj si mbrojtje administrative ashtu edhe mbrojtje gjyqësore.

Pengimi i posedimit kryhet edhe në mënyrë verbale me kërcënim serioz. Kërcënimi është detyrim psikik dhe ajo paraqet deklarament me të cilin paralajmërohet ndonjë e keqe që do t'i shkaktohet poseduesit drejtpërdrejt apo indirekt, po që se do të silltet ndryshe (kundërtën) e asaj që kryesi i pengim posedimit kërkon.

Gjykata ofron mbrojtjen gjyqësore të mënyrës verbale, vetëm nëse një shqetësim i tillë është serioz dhe ka shkakuar gjerë të pushimi i posedimit të sendit apo kryerjes së të drejtës së posedimit. Kërcënim serioz i posedimit ekziston kur personi i tretë poseduesit të sendit apo të drejtës i bën të ditur dhe të mundshëm se do të rrezikoj jetën apo trupin e tij, pasurinë apo që të njëjtit do t'i shkaktoj ndonjë të keqe më të madhe p.sh. I padituri i cili me telefon apo me telegram ia tërheq vërejtjen paditësit që po që se e lëvtron parcelën lëndore dhe hynë në të, do të detyrohet në mbrojtje gjyqësore dhe t'i ndërmerret veprimet e caktuara me ligj, për mbrojtje të pasurisë së vetë, nuk e kryen aktin e pengim posedimit nga se tërheqja e vërejtjeve si më lartë nuk është kundërligjore dhe jo serioze dhe nuk kanë për pasojë gjerë të pushimi i posedimit.

Në praktikë dallojmë edhe:

- a. Mbrojtjen e posedimit të ndërtesës
- b. Mbrojtjen e posedimit të banesës dhe
- c. Mbrojtjen poseduese të hapësirës ajrore

Ndërtesën banesore mund ta ndërtojnë më shumë persona së bashku, ashtu që në një moment njëri nga ndërtuesit mund t'i ndërpres punimet ndërtimore, e tjetri të njëjtat t'i vazhdoj në ndërtesën të cilën kanë filluar së bashku ta ndërtojnë. Pasi që në pyetje është bashkë posedimi i ndërtesës së filluar e duke marrë parasysh se palët posedimin e vetë në ndërtesë e kanë manifestuar në mënyrë që ndërtesën e kanë punuar bashkë e sipas mundsive financiare vetanake gjykata nuk do të ja ofroj mbrojtjen poseduese paditësit i cili ka ndërprerë punët ndërtimore e i cili me padi kërkon ndalimin e punëve të mëtejshme ndërtuesit tjetër.

²²⁶ Ligji nr. 3/L-154 për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, fq. 19, neni 112.

Kur bashkëshortët jetojnë në ndërtesën e përbashkët dhe njëri prej tyre e ndërron çelësin e banesës në derën hyrëse, ashtu që i pa mundson bashkëshortit tjetër shfrytëzimin e ndërtesës familjare në mënyrë të tillë kryen pengim posedimin. I padituri në këtë mënyrë bënë ndryshimin në mënyrën e shfrytëzimit të banesës e pa pëlqimin e paditësit andaj sjellja e tij i jep të drejtë bashkëshortit tjetër të parashtron padi për pengim posedimin.

Nëse pronari i një patundshmërie me pëlqimin e pronarit të patundshmërisë tjetër përkufizuese i ndërton themelet e ndërtesës në megjë, ashtu që me ndërtimin e kulmit në ndërtesë streha dhe ollukët hyjnë në hapësirën ajrore të pronarit, por jo aq që pronarin e parcelës përkufizuese pengon që pa pengesa të kryen ndërtesën në afërsi të megjës, tani hlykata këtij personi nuk do t'i ofroj mbrojtje poseduese, për arsye se fqiu e ka lejuar në ndërtimin e themeleve të ndërtesës në megjë dhe me evitimin e strehës për pronarin e ndërtesës do t'i shkaktojnë shpenzime si dhe me evitimin e strehës mund të shkaktohen dëmtimet e murit të ndërtesës për shkak të reshurave atmosferike.

Gjykata pronarit të patundshmërisë përkufizuese-fqinjësore do t'ia ofroj mbrojtjen gjyqësore vetëm me rastin që pronari i ndërtesës të njëjtën e bënë ashtu që uji nga të reshurat shkon në patundshmërinë e fqinjit.²²⁷

Vendimi për kërkesëpadinë

Në procedurën për shkak te pengim posedimit, lidhur me kërkesëpadinë e paditësit gjykata vendos me vendim që ka formë të aktvendimit. Në këtë drejtim me siguri ka ndikuar karakteri provizor i mbrojtjes juridike e cila jepet në gjykimet e llojit të tillë. Nëse gjykata konstaton se kërkesa e paditësit është e themeltë, gjykata me aktvendim kondemnator (detyrues) e detyron të paditurin (varësisht prej kërkesës) që ta kthejë sendin e marrë, që ta rivendos gjendjen e mëparshme apo që të përmbahet nga veprimet e drejtuara kah shqetësimi, pengimi apo marrja e sendit.²²⁸

Afatin për përmbushjen e detyrimeve që u janë caktuar palëve me rastin e vendosjes lidhur me kërkesëpadinë ne rastet e pengim posedimit, gjykata e cakton varësisht nga rrethanat e çdo rasti konkret.²²⁹ Mirëpo zakonisht në praktikën gjyqësore të gjykatave të Republikës së Kosovës si afat për përmbushjen e detyrimeve në mënyrë vullnetare nga ana e palëve jepet afati prej 7 ditësh duke llogaritur nga dita e marrjes së aktvendimit, qe sipas mendimit tonë është afat i arsyeshëm dhe jo i shkurt, për shkak te natyrës urgjente qe ka procedura lidhur me pengim posedimin.

Masat e përkohshme

Që nga momenti i arritjes së padisë në gjykatë, gjykata nuk ka pengesa ligjore qe sipas propozimit të palës paditëse të shqiptojë masë të përkohshme edhe pa e dëgjuar apo marrë në pyetje palën e paditur, në rast se situata faktike e dikton një gjë të tillë.²³⁰

²²⁷ Isa Kelmendi, Padia për mbrojtjen nga akti i pengim posedimit, material trajnimi, IGJK 2013.

²²⁸ Faik Brestovci, E drejta Procedurale Civile II, Prishtinë, 2006, fq. 129.

²²⁹ Ligji nr. 03/L-006 për procedurën kontestimore (LPK) fq. 133, neni 481 paragrafi 1.

²³⁰ Faik Brestovci, E drejta Procedurale Civile II, Prishtinë, 2006, fq. 129.

Me dispozitat ligjore te nenit 478-483 të LPK të cilat kanë rregulluar procedurën në kontestet për shkak të pengim posedimit, nuk është paraparë shprehimisht mundsia e caktimit të masës së përkohshme siguroese, mirëpo dispozita e nenit 478 të LPK ka përcaktuar shprehimisht se „ *Po që së në këtë kapitull nuk ekzistojnë dispozita të posaçme, në kontestet për shkak te pengim posedimit zbatohen dispozitat tjera të këtij ligji* ‘‘²³¹

Në kuptim të dispozitës së nenit 478 të LPK, gjykata gjatë procedurës lidhur me pengim posedimin nuk ka pengesa ligjore, që nga momenti i arritjes së padisë por edhe gjatë mbajtjes se seancës se shqyrtimit kryesor sipas propozimit të palës paditëse të caktojë masat siguroese për sigurimin e kërkesëpadisë ashtu siç është përcaktuar me dispozitat ligjore nga neni 296-318, nëse për një gjë të tillë e diktojnë rrethanat faktike të rastit konkret dhe plotësohen kushtet ligjore të cilat decidivishtë i parasheh dispozita e nenit 297 të të njëjtit ligj.²³²

Mirëpo sipas mendimit tonë tek rastet e pengim posedimit, pasi që kjo procedurë ligjërishit është e karakterit urgjent dhe gjykata ka për detyrim që këto raste t'i trajtoj në afat sa më të shkurtër kohor, është e udhës që gjykata sa më tepër tu shmanget caktimit të masave siguroese, përjashtimisht vetëm për raste kur situata faktike e dikton një gjë të tillë për shkak të natyrës së pengimit të bërë, dhe në ato raste kur gjykata cakton masën siguroese duhet pasur gjithnjë kujdes që të mos prejudikohet përfundimi lidhur më çështjen kryesore.

Mjetet e goditjes se vendimit meritor

Tek rastet e pengim posedimit aktvendimi më të cilin pranohet apo refuzohet kërkesëpadia mund të goditet me ankesë të posaçme. Ankesa ka efekt suspensiv, por gjykata për shkaqe të rëndësishme mund të vendos që ankimi të mos e pengojë ekzekutimin e vendimit më të cilin është pranuar si e themeltë kërkesëpadia. Afati për paraqitjen e ankesës është afati 7 ditor.²³³

Kundër aktvendimeve të dhëna në kontestet për shkak të pengim posedimit revizioni nuk është i lejuar, ndërsa përsëritja e procedurës së përfunduar me vendim të formës së prerë lejohet vetëm nga shkaqet e përcaktuara me neni 232 pika a) dhe b) të LPK, dhe atë vetëm brenda afatit prej 30 ditësh nga dita në të cilën është bërë i formës së prerë aktvendimi përfundimtar.²³⁴

²³¹ Ligji nr. 03/L-006 për procedurën kontestimore (LPK) fq. 133, neni 478.

²³² Ligji nr. 03/L-006 për procedurën kontestimore (LPK) fq. 87-94 nenet 296-318.

²³³ Faik Brestovci, E drejta Procedurale Civile II, Prishtinë, 2006, fq. 129-130 & Ligji nr. 03/L-006 për procedurën kontestimore (LPK) fq. 133-134 neni 481 paragrafi 2 dhe 3 .

²³⁴ Ligji nr. 03/L-006 për procedurën kontestimore (LPK) fq. 134 nenet 483 paragrafi 4 dhe 483.

Afati për ekzekutim të detyrueshëm të vendimit

Ekzekutimi i detyrueshëm në bazë të aktvendimit të dhënë në kontestin për shkak të pengimit të posedimit mund të kërkohej vetëm brenda afatit 30 ditor nga dita e kalimit të afatit paritiv. Afati paritiv për përmbushje vullnetare të detyrimit të caktuar me vendim meritore caktohet varësisht nga rrethanat e rastit konkret. Kjo do të thotë se ai mund të jetë më i gjatë apo më i shkurtër se afati për ankim.²³⁵

I përshtatshëm për ekzekutim të detyrueshëm është vendimi kondemnator (detyrues) më të cilin të paditurit i është urdhëruar që të kryejë një veprim të caktuar, si p.sh. të heq pengesat nga rruga nëpër të cilën kalon paditësi, të hap kanalën e ujitjes të cilin e ka mbyllur e përmes të cilit kanal paditësi ujit kopshtin, etj. Vendimi më të cilin pranohet kërkesëpadia e ka rëndësinë e dokumentit ekzekutiv dhe i njëjti sipas propozimit të paditësit mund të përmbahet nga organi përmbaues sipas rregullave të Ligjit të procedurës përmbaimore (LPP), në rast se i padituri brenda afatit paritiv në mënyrë vullnetare nuk e përmbush detyrimin e përcaktuar më anë të vendimit të dhënë.²³⁶

Për të vendosur për propozimin përmbaimore në qoftë se debitori në bazë të dokumentit përmbaues ka për detyrë të kryej veprimin e caktuar apo t'i duroj veprimet e caktuar, ose të përmbahet nga veprimi i caktuar, përmbauesi privat ka kompetencë për të vendosur mbi propozimin përmbaimore dhe të zbatojë përmbaimin.²³⁷

Në qoftë se në bazë të dokumentit përmbaimore të nxjerrë sipas padisë për shkak të pengimit të posedimit, është kryer përmbaimi apo në qoftë se debitori e ka përmbushur vullnetarisht detyrimin e vet, kurse pas kësaj përsëri e bënë pengimin e posedimit i cili në esencë nuk dallohet nga pengimi i mëparshëm, organi përmbaues me propozimin e kërkuarit të përmbaimit, në bazë të dokumentit përmbaues të njëjtë, do të nxjerrë aktvendim të ri për përmbaimin apo urdhrin përmbaues, me qëllim të rivendosjes së gjendjes së mëparshme nëse kjo është e nevojshme dhe do të kërcënohet debitori me gjobitje (neni 15 dhe 16 i LPP) nëse përsëri kryen pengim posedimi, ku në këtë rast në mënyrë të përshtatur zbatohen edhe dispozitat e nenit 290 të këtij ligji, për shkak se gjoba ndaj debitorit sipas nenit 15 të LPP mund të shqiptojë vetëm gjykata qoftë sipas detyrës zyrtare, apo me propozim të përmbauesit privat nëse në procedurën që zhvillohet pranë përmbauesit privat janë plotësuar kushtet për shqiptimin e gjobës. Propozimin për përmbaimin në rast të ri-pengimit të serishëm, kërkuari i përmbaimit mund ta parashtrijë brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita kur ka marrë dijeni për ri-pengimin e posedimit, por jo më vonë se brenda një (1) viti nga pengimi i përsëritur.²³⁸

²³⁵ Faik Brestovci, E drejta Procedurale Civile II, Prishtinë, 2006, fq. 130 & Ligji nr. 03/L-006 për procedurën kontestimore (LPK) fq. 34 neni 482.

²³⁶ Ligji nr. 04-L139 për procedurën përmbaimore, neni 21 dhe 22 paragrafi 1 pika 1.1.

²³⁷ Po aty, neni 291

²³⁸ Po aty, neni 299.

SERVITUTET DHE MBROJTJA GJYQËSORE

Servituti si një e drejtë sendore mbi sendin e huaj

Me Ligjin për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore nr. 03/L-154, që ka hyrë në fuqi më 20 gusht të vitit 2009, është rregulluar fushëveprimi i ligjit, sipas nenit 1 paragrafi rregullohet „1. Ky ligj rregullon, krijimin, përmbajtja, bartja, mbrojtjen si dhe shuarja e të drejtave sendore. 2. Ky ligj rregullon pronësinë si dhe të drejtat sendore të kufizuara si posedimin, të drejtat sendore të sigurimit si dhe të drejtat sendore të shfrytëzimit. Këto të drejta sendore të kufizuara mund të krijohen në pronësi apo në të drejta sendore të tjera që mund të jenë të përshtatshme për këtë qëllim”.

Sipas kësaj rrjedh se servituti si një e drejtë sendore sipas ligjvënësit trajtohet në kuadër të drejtave sendore të shfrytëzimit. Në kuadër të kësaj të drejte pra rregullohet edhe servituti sendor në pjesën e pestë të Ligjit. Servituti si një e drejtë sendore mbi sendin e huaj – titullari i servitutit ka për objekt sendin e huaj, që dallon nga e drejta subjektive e titullarit të pronësisë mbi sendin e vetë.

Objekti i servitutit

Si objekti i servitutit janë objektet dhe të drejtat . Pra si objekt është gjithëherë një send i qarkullueshëm i cili mund të jetë në pronësi të personit tjetër, por që përdoret në atë mënyrë që sendi i titullarit të servitutit të shfrytëzohet në mënyrën më të mirë ose në mënyrën më të lehtë . Të drejtat janë drejtat e titullarit të servitutit që ta përdorë sendin e në pronësitë të tjetrit ose të gëzoi frutat që rrjedhin nga sendi.

Subjektet e servitutit

Si subjekt i servitutit përcaktohet në bazë të faktit se kush është i autorizuari i të drejtës subjektive që të përdorë apo të gëzoi frutat nga sendi që është në pronësi të tjetrit, p.sh. te servituti sendor si subjekt i servitutit është pronari aktual i paluajtshmerisë dominante, e kur si titullar të paluajtshmerisë dominante janë më shumë persona, pra kemi të bëjmë me bashkëpronarë ose pronarë të përbashkët atëherë këta janë si subjekt- bashkëtitullar, sikundër është edhe pronari aktual i paluajtshmerisë shërbyese. Pra si subjekt janë personat fizik dhe personat juridike .

Ndarja e servituteve

Si kriter për ndarjen e servituteve merret, nëse servituti krijohet në dobi të një pronari të paluajtshmerisë apo në dobi të një personi. Nëse krijohet në dobi të pronarit të paluajtshmerisë, atëherë quhet si servituti sendor, e nëse krijohet në dobi të një personi, atëherë quhet si servituti personal.

Servitutet sendore janë të shumta dhe ato krijohen në vazhdimësi varësisht nga dinamika e zhvillimit ekonomiko- shoqëror.

Sipas traditës servitutet sendore ndahen në servitutet urbane (shtëpiake) dhe në servitutet fushore (tokësore).

Servitutet urbane, të cilat si paluajtshmeri dominante është ndërtesa (shtëpi individuale ose objekt kolektiv i banimit) dhe toka për rreth ndërtesave e në ngarkim të paluajtshmerisë shërbyese. Këto servitute konsiderohen si servituti i mbështetjes së shtëpisë së vetë, në shtëpinë e tjetrit, e drejta që trarin ta mbështet në murin e huaj, hapja e dritares në murin e huaj, për shkak të dritës apo për shkak të shikimit, e drejta e kalimit të tymit, nëpër oxhakun e tjetrit, e drejta e kalimit të ujërave të ndryshme nëpër tokën e huaj, ndërtimi i instalimeve nëtokësore, ndërtimi i instalimeve mbi tokësore ose detyrimi që shtëpinë e vetë të mos e ndërtoj mbi një lartësi të caktuar etj.

Servitutet fushore (tokësore) në të cilat nuk është e thënë që paluajtshmeria dominuese dhe shërbyese të mos jenë në fqinjësi gjë që edhe këtu nuk mund të numërohen të gjitha , por si më të shpeshta janë: servituti i rrugës, servituti i nxjerrjes së ujit, servituti i kullotës së kafshëve, në tokën e huaj, servituti i nxjerrjes së rërës, servituti i prerjes së drunjtëve. P.sh. te servituti i rrugës, e kemi të drejtën e kalimit në këmbë, me kafshë ose me mjete motorike .

Servitutet personale sipas traditës janë ndarë dhe atë: frytëzimi (usufruktus), e drejta e përdorimit (usus) dhe e drejta e banimit (habitatio).

Mënyrat e fitimit të servitutit

Në lidhje me fitimin (krijimin) apo themelimin e servituteve është e nevojshme të dallohet situata kur krijohet një e drejtë subjektive që nuk ka ekzistuar, me situatën kur ka ekzistuar, pra kemi situatën e themelimit të servitutit që nuk ka ekzistuar deri më tani, p.sh. krijimi i servitutit me kontratë, ose me vendim dhe situatën kur servituti ka ekzistuar faktikisht e që sipas ligjit fitohet.

Në lidhje me fitimin (krijimin) e servitutit sendor, Ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, sipas nenit 253 paragrafi 1 rregullon “Servituti sendor krijohet në bazë të një pune juridike, një vendimi të organit **shtetëror ose me ligj**”.

Ligji mbi marrëdhëniet themelore juridiko pronësore (LMTHJP) me nenin 51 rregullon: “Servituti real (sendor) vendoset me veprim juridik , vendim të organit shtetëror dhe me anë të parashkrimit fitues” .

Sipas Ligjit për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore si bazë e tretë e fitimit të drejtës së servitutit e parasheh me ligji, ndërsa sipas LMTHJP si bazë e tretë është baza e parashkrimit fitues, e që me Ligjin për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore (LPDS) një mënyrë e tillë e fitimit të servitutit nuk njihet.

Fitimi i servitutit në bazë të punës juridike

Fitimi i servitutit në bazë të punës juridike, bëhet në dy mënyra dhe atë :

- me kontratë dhe
- me testament

Fitimi i servitutit në bazë kontratës

Me dispozitën e nenit 253, paragrafi 2, të LPDS rregullohet “Për krijimin e një servitutit sendor sipas punës juridike është e nevojshme një kontratë dhe regjistrimi në Regjistrin e të drejtave në paluajtshmëritë. Me kontratë palët duhet të merren vesh për krijimin dhe përmbajtjen e servitutit” Me paragrafin 3, rregullohet “Dispozitat nga paragrafi 1 dhe 2 të këtij neni do të zbatohen në të gjitha rastet përveç nëse me vendim administrativ ose me ligj të veçantë parashihet ndryshe”.

Me dispozitën e nenit 52 të LMTHJ, për fitimin e servitutit sipas bazës së kontratës, rregullohet „ Në bazë të veprimit juridik servituti real fitohet me regjistrimin në librin publik ose në mënyrën tjetër përkatëse të caktuar me ligj ”.

Të dy këto ligje, LPDS sikundër LMTHJP për fitimin e servitutit kërkojnë që kontrata të jetë e hartuar me shkrim, e nënshkruar nga palët dhe e regjistruar në regjistër. Kjo mënyrë derivative e fitimit të servitutit kërkohe të jetë formale iustus - titulus (kontrata e hartuar me shkrim dhe e vërtetuar në gjykatë ose, pas nxjerrjes së ligjit për noterin, te noteri) dhe modus aquirendi (regjistrimi në regjistër të paluajtshmerive).

Prandaj për tu krijuar servituti sendor në bazë të kontratës është e nevojshme që pronari i sendit dominant dhe pronari i sendit shërbyes të pajtohen për elementet esenciale të kontratës në lidhje me krijimin e servitutit dhe në lidhje me të drejtat dhe obligimet e secilës palë. Në kontratë duhet të përfshihet edhe pëlqimi i pronarit të pronës shërbyese që kontrata të regjistrohet në regjistrin e të drejtave të paluajtshmerive. Kur si bashkëpronarë të pronës shërbyese kemi më shumë persona, atëherë të gjithë bashkëpronaret duhet të japin pëlqimin për krijimin e drejtës së servitutit, pra të gjithë bashkëpronarët duhet të jenë si palë kontraktuese. Pastaj kontrata për fitimin e servitutit mund të jetë me shpërblim (barrësore), kur pronari i sendit dominant paguan ndonjë shumë parash pronarit – bashkëpronarëve të sendit shërbyes dhe pa shpërblim (jo barrësore).

Sipas këtyre dispozitave ligjore, rrjedh se servituti nuk mund të krijohet sipas kontratës jo formale, sepse kontrata jo formale për krijimin e servitutit nuk prodhon efekt juridik. Por në ato raste kur kontrata jo formale përmbushet dy anshëm nga palët, ngritët, çështja se kontrata a mund të prodhoj efekt juridik .

Në rastin konkret shtrohet pyetja se çfarë efekti ka kontrata me të cilën krijohet servituti në mes pronarit të paluajtshmeris dominante, me pronarin e paluajtshmeris shërbyese , në rast se kjo

kontratë nuk është lidhur në formën e paraparë me ligj , ndërsa e njëjta është përmbushur dy anshëm .

Shtrohet pyetja se për rastin konkret a mundet të bëhet shmangia nga zbatimi i dispozitës së nenit 253, paragrafi 2 i LPDS, sipas të cilës kërkohet që kontrata për krijimin e servitutit të jetë e vërtetuar dhe e regjistruar .

Nëse sipas rastit praktik supozojmë se kemi kontratë formale të krijimit të servitutit sendor, të instalimit të rrjetit nëntokësor të kanalizimit dhe të ujësjellësit, servituti nuk është regjistruar mirëpo pronari i ngastrës shërbyese për shkak të rrjetit nëntokësor, nuk mund të fillojë punimet për ndërtimin e shtëpisë së tij, ndërsa sipas klauzules kontraktuese është kontraktuar se e drejta e zhvendosjes nuk mund të lejohet. Sipas pozitës së ngastrës dhe të lejes për dhënien e kushteve urbanistike të ndërtimit, pozita për ndërtim të objektit të shtëpisë në ngastër nuk mund të ndryshoi, ndërsa sipas konfiguracionit në teren ekziston mundësia e zhvendosjes së rrjetit nëntokësor.

Kontrata formale e servitutit a mund të shërbej si bazë juridike për të kufizuar të drejtën e pronarit të ngastrës shërbyese, në realizimin e të drejtës së tij për ndërtimin e objektit të banimit. Për rastin konkret a mund të gjejë zbatim dispozita e nenit 256, paragrafi 2 i Ligjit për pronësinë dhe drejtat tjera sendore sipas të cilës e drejta e zhvendosjes së servitutit nuk mund të përjashtohet apo të kufizohet me punë juridike.

Fitimi i servitutit sendor në bazë të testamentit

Servituti sipas testamentit mund të krijohet me shprehje të njëanshme të vullnetit të fundit. Servituti mund të krijohet me testament si një akt formal juridik ose si një urdhër i trashëgimlënësit me të cilin përcakton ndarjen e pasurisë së tij në personat në të cilët do të trashëgojnë, pas vdekjes. Që testamenti të jetë i vlefshëm është e nevojshme të jetë i përpiluar në formën e paraparë me ligj. Forma e testamentit është e rregulluar me Ligjin për trashëgimin nr. 2004/26, me dispozitat e nenit 74, kur hartohet nga vet testatori, me nenin 75 kur hartohet me dëshmitar dhe nenin 76, kur hartohet para gjykatës.

Me nenin 92 të Ligjit për trashëgimin rregullohet “Testatori mund të lerë një ose më shumë lege”.

Sipas kësaj servituti mund të krijohet me testament si legat ose me dispozitë mbi legatin. Në bazë të dispozitës mbi legatin, legatori mund të kërkojë nga trashëgimtari ligjor ose jo ligjor krijimin e servitutit dhe regjistrimin. Kjo nënkupton se pronari i sendit shërbyese me testament të urdhërojë të krijohet servituti sendor në dobi të pronarit aktual të sendit dominant i cili tani paraqitet si legatar, ose të krijoj servitutin personal. P.sh. nga shitja e një publikimi – botimi të librit, mjetet e realizuara të shkojnë për rritjen e fondit të librave në bibliotekë . Në rastin konkret fjala është për shprehjen e vullnetit të fundit të testatorit për krijimin e servitutit dhe mirret se këtë mund ta bëjë vetëm pronari i sendit ose i krijimtarisë intelektuale. Prandaj vetëm pronari i sendit shërbyes mund

të krijoj servitutin me testament në dobi të legatarit . Gjithashtu testatori mund të urdhërojë trashëgimtarin e tij, që në sendet e lëna nga pasuria e tij trashëgimore, të krijohet servituti në dobi të legatarit.

Si shembull mund të kemi rastin kur testatori, me testament e urdhëron trashëgimtarin e tij ligjor që ta lejoj fqin e tij, të marrë ujë nga pusi që është hapur në pronën e tij për plotësimin e nevojave për pije.

Ose shembulli tjetër është rasti tjetër kur testatori, legatarit, me testament ja njeh servitutin e banimit në banesën në Prishtinë ta shfrytëzojë derisa është në jetë.

Fitimi i servitutit sendor sipas vendimit të organit shtetëror

Sipas ligjit për pronësinë dhe të drejtat sendore, në lidhje me fitimin e drejtës sendore në servitut në bazë të vendimit të organit shtetëror, nuk kemi asnjë dispozitë që rregullon në mënyrë konkrete krijimin e kësaj të drejte. Sipas nenit 253, paragrafi 1 “Servituti sendor krijohet në bazë të një pune juridike, një vendimi të organit shtetëror ose një ligji”.

Për dallim nga LPDS, LMTHJP, këtë çështje e rregullon me nenin 53 par.1 parasheh se “Me vendimin e gjykatës mbi pjesëtimin e sendit ose me vendimin e organit tjetër shtetëror servituti real vendoset kur pronari i pronës sunduese në tërësi ose pjesërisht nuk mund të shfrytëzojë këtë të pronë pa shfrytëzimin përkatës të pronës shërbyese si dhe në rastet tjera të caktuara me ligj. Sipas par.2 “Servituti nga paragrafi 1 i këtij neni fitohet ditën që merr formën e prerë vendimi, po që se me ligj nuk është caktuar ndryshe. Ndërsa sipas par.3, “Me kërkesën e pronarit të tokës shërbyese organi kompetent shtetëror përcakton edhe kompensimin përkatës të cilin pronari i pronës sunduese, ka për detyrë t’ia paguaj pronarit të pronës shërbyese”

Sipas ligjit në fuqi, servituti sendor krijohet me vendimin e organit shtetëror, e që këtu nënkupton vendimin e gjykatës ose të organit administrativ. Kjo nuk është ndonjë risi e krijimit të servituti me vendim sepse edhe para hyrjes në fuqi të Ligjit mbi marrëdhëniet themelore juridiko pronësore, këtë mënyrë e kanë njohur edhe rregullat juridike që janë zbatuar para këtij ligji. Këtë mënyrë e njohin edhe kodet civile në të drejtën bashkëkohore.

Për krijimin e stërviturit sipas vendimit gjyqësor ose të organit të administratës, ka pikëpamje se kjo mënyrë e fitimit është iustus titullus, pra është vetëm titull juridik prandaj është e nevojshme edhe regjistrimit sepse regjistrimi ka efekt të themelimit të servitutit. Sipas pikëpamjes tjetër për krijimin e servitutit nuk ka nevojë modusi, por mjafton vetëm vendimi (aktgjykimi- aktvendimi) i formës së prerë. Këtë pikëpamje e ka përvetësuar edhe Ligji mbi marrëdhëniet themelore juridiko pronësore , pasi përcakton se servituti krijohet në ditën kur vendimi të bëhet i formës së prerë. Dhe ky vendim i formës së prerë ka karakter të themelimit, pra është me efekt konstitutiv.

Megjithatë, për kundër faktit se servituti themelohet me vendi të organit shtetëror, prapse prapë, vendimi për themelim duhet të regjistrohet në Regjistër të pronave të paluajtshme, sepse kjo kërkohet me Ligjin nr. 2002/5, për themelimin e regjistrit të drejtave të pronës së paluajtshme, siç kërkohet me nenin 2, paragrafi 1 dhe 2 .

Sipas ligjit nuk kemi ndonjë dallim sa i përket fuqisë juridike të vendimit gjyqësor ose vendimit administrativ. Sipas ligjit edhe vendimi i organit administrativ ka efektin e konstituimit të servituti. Ajo që vlerësojmë se është e nevojshme të thuhet është se kur servituti krijohet me vendim të gjykatës, këtu mungon vullneti i palëve për konstituim, që do të thotë, se servituti krijohet si rezultat i vlerësimit të provave në lidhje me vërtetimin e gjendjes faktike dhe të zbatimit të ligjit material. Shpeshherë, në procedurë jo kontestimore, kur vendoset për ndarjen e paluajtshmerisë së bashkëpronësisë, gjykata me rastin e ndarjes ajo edhe vendos për krijimin e servitutit sendor, për shfrytëzimin më të mirë të secilës pjesë të ndarë për krijimin e servituti të rrugës, servitutit të instalimeve nëntokësorë, ose mbi tokësore etj.

Servituti mund të krijohet me vendim të formës së prerë të organit shtetëror, në rastet kur kjo përcaktohet me ligj. Kështu organi i administratës sipas planit urbanistik të aprovuar nga Kuvendi i Komunës mundt që në tokën ndërtimore të krijoj servitutin e rrugës, servitutin e instalimeve nëntokësorë ose mbi tokësore, në dobi të pronarit të pronës dominante në të cilën ndërtohen objekte ndërtimore.

Rasti tjetër është kur edhe Agjencia e Pyjeve të Kosovës, mundet që me vendim të krijoj servitutin e rrugës për kalimin e domosdoshëm në pronën e personit tjetër, për periudhën e marrjes së prodhimeve pyjore gjatë vjeljeve. Në këto raste kur krijohet servituti, organi i administratës, përcakton edhe lartësinë e kompensimit për shkak të krijimit të servitutit në bazë të kërkesës së palës. Më herët është e njohur se gjatë zhvillimit të procedurës së komasacionit, organi i administratës të krijoj servitutin sendor të rrugës për punimin e tokës bujqësore.

Gjithashtu krijimi i servituteve nga organi i administratës me vendim është e mundur edhe në procedurën e shpronësimeve, sipas Ligjit për shpronësime të pronës së paluajtshme nr. 03/L 139, ose sipas Ligjit për energjinë elektrike , nr. 2004/10, dhe nr. 05/L- 085, kur organi i administratës me vendim e krijon servitutin në dobi të operatorit të sistemit shpërndarës në instalimin e rrejtit nëpër paluajtshmeri shërbyese.

Si përfundimi te fitimi (krijimi) i servituti qoftë me vendim të gjykatës ashtu edhe me vendim të organit të administratës, me kërkesën e pronarit të tokës shërbyese mund të caktohet edhe kompensimi të cilin do ta paguaj pronari i pronës dominante. Ky kompensim caktohet për shkak të dëmit material si pasoj e krijimit të servitutit të tokës-sendit shërbyes.

Fitimi i servitutit në bazë të ligjit

Si mënyrë tjetër e fitimit të servituti, sipas LPDS është paraparë mënyra e fitimit në bazë të ligjit, ndërsa sipas LMTHJP është përpara mënyra e parashkrimit. Kështu sipas nenit 54 par.1, LMTHJP, rregullon: “Servituti real fitohet me anë të parashkrimit fitues kur pronari i pronës sunduese ka realizuar faktikisht servitutin gjatë kohës prej 20 vjetësh, kurse pronari i pronës shërbyese këtë nuk e ka kundërshtuar.”

Fitimi i servitutit në bazë të ligjit, është në ato raste kur me ligj rregullohet fitimi (krijimi) i servitutit në dobi të një personi juridik që atij personi t’i mundsohet më lehtë në ushtrimin e veprimtarisë së tij, e cila veprimtari është me interes shoqërorë. Kjo është kështu kur është i nevojshëm përdorimi i sendit që është në pronësi të tjetrit (pronë private apo pronë shoqërore aty ku nuk është kryer procesi i privatizimit, në pronë shtetërore), ose në rastet kur pronarët e tokave shërbyese janë të obliguar të durojnë dhe të mos marrin aktivitete në pronën e tyre sepse me ligj e kanë të ndaluar, për shkak se ua vështirësojnë ushtrimin e veprimtarisë ndërmarrjes dhe për shkaqe të mënjanimin të rrezikut.

Për shkak të kohës së shkurtë që kemi në deponim, do të trajtojmë vetëm krijimin e servitutit në bazë të Ligjit për Energjinë, nr. 03/L -184, dt. 15 Nëntorit të vitit 2010, dhe udhëzimeve administrative për zbatimin e këtij ligji, por që ky ligj tani nuk është më në fuqi, pasi në fuqi është Ligji për Energjinë nr. 05/L-081, që është shpallur me dekret të Presidentit, më datë 01.07.2016, por që dallime të ligjit të vitit 2010 me atë të vitit 2016, mund të themi lirisht se nuk ka.

Fitimi i servituteve personale

Meqenëse ju është kushtuar rëndësi më të madhe mënyrës së fitimit të servitutit sendor, ne shkurtimisht do t’i kushtojmë kohë edhe mënyrës së fitimit të servituteve personale. Te servitutet personale si karakteristike është se servituti është i lidhur për personin e caktuar si titullar i servitutit që mund të jetë person fizik ose juridik, sikundër edhe kohëzgjatja e tij është e lidhur me jetën e titullarit që do të thotë se servituti personal nuk trashëgohet. Si karakteristik tjetër është se servituti personal mund të krijohet për nevojat e më shumë personave.

Fitimi i servitutit të frytëgëzimit

Me nenin 220 të Ligjit për pronësinë dhe të drejtat sendore rregullohet “Një frytëgëzim mund të krijohet në bazë të një kontrate ose të një vendimi gjyqësor”

Sipas kësaj dispozite fitimi i frytëgëzimit, si servituti personal bëhet në dy baza juridike, baza e parë është kontrata dhe baza e dytë është vendimi gjyqësor. Kështu si është formuluar kjo normë, ne shtrojmë pyetje se mos kemi ndonjë gabim teknik në formulimin e normës, sepse ne vlerësojmë se në vend të formulimit, në bazë të një kontrate mos është dashur të jetë e formuluar dispozita e

nenit 220 në bazë të një pune juridike, si një formulim më i gjerë që përfshinë, kontratën dhe testamentin e kësaj në lidhje me dispozitën e nenit 92 të Ligjit për trashëgiminë.

Për fitimin e frytëgjimit mbi sendet e luajtshme, është e nevojshme që pronari i sendit, t'ia dorëzon në posedim sendin frytëgjuesit dhe të ekzistoj pajtimi i të dyve që frytëgjimi të bartet te frytëgjuesi.

Shembull si send i frytëgjimit mund të jetë makina për qepje që do të shërben, për qepje të rrobave.

Për fitimin e frytëgjimit në rastet ku si objekt është sendi i paluajtshëm është e nevojshme kontrata me shkrim që tregon se pronari dhe frytëgjuesi kanë për qëllim krijimin e frytëgjimit dhe regjistrimi i frytëgjimit në regjistrin për të drejtat në paluajtshmeri. Pra të ekzistojë titulli juridik dhe mënyra e fitimit.

Fitimi i servitutit të përdorimit

Në lidhje me krijimin e servitutit të përdorimit, Ligji për pronësinë dhe të drejtat sendore me dispozitën e nenit 261, paragrafi 2, ka rregulluar „ Dispozitat e neneve 253 deri 259 të këtij ligji zbatohen përshtatshmerisht për servitutet personale”. Sipas kësaj rrjedh se edhe për krijimin e servitutit të përdorimit (usus) përshtatshmerisë zbatohet dispozita e nenit 253 të ligjit për pronësinë.

Fitimi i servitutit të banimit

Sipas nenit 264 të Ligjit për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, sa i përket mënyrës së krijimit të këtij servituti , zbatohet përshtatshmerisht dispozitat për krijimin e servitutit të frytëgjimit që më lartë është shtjelluar kjo çështje.

Shuarja e servitutit

Shuarja e servitutit sendor

Me dispozitën e nenit 260 të LPDS, është paraparë se për shuarjen e servitutit sendor është e nevojshme dhënia e deklaratës së pronarit të paluajtshmerisë dominante (titullarit të servitutit) për heqjen dorë nga servituti sendor dhe regjistrimi në Regjistrat e të drejtave në paluajtshmeri. Deklarata e njëanshme e dhënë nga pronari i paluajtshmerisë dominante (sunduese) me të cilën heqë dorë nga servituti nuk është e mjaftueshme për shuarjen e servitutit, por kjo deklaratë është e nevojshme që të dorëzohet edhe në Zyrën e Kadastrit, që servituti të fshihet nga Regjistri i paluajtshmerive.

Me rastin e dhënies së deklaratës së njëanshme për heqje dorë (renoncim) nuk kërkohet pëlqimi i pronarit aktual të pronës shërbyese. Nëse servituti është i pa pjesëtueshëm vetëm me deklaratën

e njërit prej bashkëpronarëve të pronës dominante për heqje dorë nga servituti, servituti nuk mund të shuhet, por duhet të sigurohet edhe pëlqimi i bashkëpronarëve të tjerë.

Shtrohet pyetja se servituti a mund të shuhet edhe në mënyrë të heshtur, siç është rasti kur titullari i servitutit lejon ndryshime të tilla në pronën shërbyese që e bëjnë të pa mundur edhe ushtrimin e të drejtës së servitutit ose kur lejohet të tjetërsohet sendi shërbyes te frytëgëzimi.

Si mënyrë tjetër e shuarjes sipas ligjit është edhe mënyra sipas kërkesës së pronarit të sendit shërbyes, nëse servituti sendor nuk është më i nevojshme ose nëse kanë ndryshuar rrethanat në mënyrë substanciale, që kanë pasur ndikim në krijimin e servitutit, që në rastin konkret përsëri nevojitet që për shlyerje të behet regjistrimi.

Edhe pse me ligj nuk janë paraparë mënyrat e tjera të shuarjes së servitutit, janë të njohura edhe rastet tjera të shuarjes së servitutit si vijon :

- Me kalimin e kohës, në qoftë se është caktuar afati kohor i krijimit të servitutit;
- Me shkatërrimin e sendit ose humbjen e sendit, si dominues ashtu edhe shërbyes;
- Me vendimin e organit shtetëror;
- Me bashkim kur pronari i sendit dominant, bëhet edhe pronarë i sendit shërbyes, ose e kundërta;
- Me mos ushtrim të servitutit.

Shuarja e servituteve personale

Sipas nenit 263, në lidhje me nenin 235, të Ligjit të pronësisë dhe të drejtave tjera sendore, janë paraparë, dy mënyra dhe atë :

- Me vdekjen e personit fizik,
- Me shuarjen e personit juridik ose të ortakisë.

E DREJTA E DETYRIMEVE

PAVLEFSHMËRIA ABSOLUTE DHE RELATIVE E KONTRATAVE

NOCIONI I KONTRATËS DHE KUSHTET PER LIDHJËN E KONTRATËS

Me kontratë nënkuptohet marrëveshja e dy apo më shumë personave të cilët krijojnë, ndryshojnë apo shuajnë një marrëdhënie të detyrimit. Kontrata në fakt përfaqëson një marrëdhënie juridike e cila është e rregulluar sipas së drejtës.

Kontratat hyjnë në grupin e punëve juridike të dy anëshme.

Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve - (LMD), në mënyrë decidive nuk e ka përcaktuar nocionin e kontratës, por në dispozitën e nenit 15 përcakton së: “kontrata është e lidhur kur palët kontraktuese janë marrë vesh për elemente thelbësore të kontratës”. Nga përmbajtja e kësaj dispozite shihet qartë se në mënyrë parimore LMD nuk përcakton një moment formal si moment për tu konsideruar së është lidhë kontrata, por përcakton se kontrata është e lidhur kur palët kontraktuese janë marrë vesh për elementet thelbësore të kontratës.

Me qenë se me kontratë rregullohen marrëdhëniet e pjesëmarrësve në qarkullimin e mallrave dhe shërbimeve, rezulton së fusha e zbatimit të kontratave të jetë shumë e gjerë.

Kontratat zbatohen gati në të gjitha fushat e së drejtës, duke përjashtuar të drejtën penale. Kontrata gjen zbatim në të drejtën e detyrimeve, të drejtë reale, të drejtën trashëgimore, të drejtën familjare, në të drejtën e punës, në të drejtën ndërkombëtare private, në të drejtën tregtare-afariste, në të drejtën e autorit, në të drejtën e pronësisë industriale dhe në të drejtën financiare.

Terminologjia – për kontrata në të drejtat nacionale të vendeve të ndryshme përdoren terma të ndryshëm. Përveç termit kontratë përdoren edhe terma tjerë si marrëveshje, dakordim, pakt, konventë, traktat etj. Shprehja kontratë (contractus) është termi që më së tepërmi përdoret për të përcaktuar kontratën gjegjësishtë njërin ndër burimet me të rëndësishme materiale të së drejtës së detyrimeve.

Kontrata është njëri ndër burimet materiale më të rëndësishme, në mesin e pesë burimeve të së drejtës së detyrimeve e që janë: kontrata, shkaktimi i dëmit, pasurimi pa bazë, kryerja e punëve të huaja pa porosi dhe shprehja e një anshme e vullnetit.

Me qenë së kontrata përfaqëson njërin ndër burimet me të rëndësishme materiale të së drejtës detyrimeve, për shkak të rëndësisë që përfaqëson dhe për shkak të fushës së gjerë të zbatimit, ndryshe njihet si e drejtë kontraktore.

E drejta kontraktore ngërthen në vete disa parime të rëndësishëm të cilat ndryshe njihen si parimet e së drejtës kontraktore.

Këto parime janë: liria e kontraktimit, parimi i konsensualizimit, i dokeve të mira afariste, i ndershmërisë dhe i ndërgjegjshmërisë.

Kushtet për lidhjen e kontratës- paraqesin kushtet të cilat duhet të plotësohen me rastin e lidhjes së kontratës, në mënyrë që kontrata e lidhur të jetë e vlefshme. Në doktrinën juridike kushtet për lidhjen e kontratave mund të klasifikohen në kushte të përgjithshme për lidhjen e kontratave dhe në kushte të veçanta për lidhjen e kontratave.

Në grupin e kushteve të përgjithshme përfshihen: aftësia punuese e palëve kontraktuese, pëlqimi i vullnetit, lënda e kontratës dhe baza e kontratës. Në grupin e kushteve të veçanta për lidhjen e kontratës bëjnë pjesë: lidhja e kontratës me dorëzimin e sendit, dhënia e pëlqimit për lidhjen e kontratës, dhënia e pëlqimit për lidhjen e kontratës nga personi i tretë dhe forma e kontratës.

Nëse i referohemi LMD-së, sa i përket parimeve të së drejtës kontraktore dhe kushteve për lidhjen e kontratave do të shohim së LMD, me dispozita të veçanta ka përcaktuar këto parime dhe këto kushte.

LMD, me dispozita të veçanta ka përcaktuar edhe kushte për lidhjen e kontratave, kështu me depozitën e nenit 41 paragrafi 1, parashihet se: *“Për lidhjen e kontratës së vlefshme nevojitet që kontraktuesi të ketë zotësinë për të vepruar që kërkohet për lidhjen e kësaj kontrate”*, në paragrafin 2 të nenit të njëjtë parashihet se: *“Personi me zotësi të kufizuar për të vepruar mundet pa lejen e përfaqësuesit të vet ligjor të lidhë vetëm ato kontrata, lidhja e të cilave i lejohet nga ligji”*, ndërsa në paragrafin 3 parashihet se: *“Kontratat e tjera të këtyre personave janë të rrëzueshme, në qoftë se janë lidhur pa lejen e përfaqësuesit ligjor, por mund të fuqizohen me aprovimin e mëvonshëm të të njëjtave”*.

Kur i referohemi parimit të konsensualizimit në fakti referohemi dakordimit të vullnetit të palëve për të krijuar marrëdhënien kontraktuese. Vullneti i palëve edhe si parim edhe si kusht për lidhjen e kontratës rregullohen me dispozitat e nenit 18 të LMD-së, ku përcaktohet së: *“Vullneti për ta lidhur kontratën mund të shprehet me fjalë, me shenja të rëndomta ose me ndonjë sjellje tjetër nga e cila mund të konkludohet me siguri për ekzistimin e tij”*.

Autonomia vullnetit/ Liria e kontraktimit, përcaktohet me dispozitat e nenit 2 të LMD-ës, ashtu që në nenin 2 paragrafi 1, përcaktohet se: *“Pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimeve janë të lirë, që në pajtim me dispozitat urdhëruese, të rendit publik dhe të dokeve të mira, t'i rregullojnë marrëdhëniet e veta sipas vullnetit të tyre”*, ndërsa në paragrafin 2, të nenit 2 përcaktohet se: *“Pjesëmarrësit mund t'i rregullojnë marrëdhëniet e tyre të detyrimeve ndryshe nga ajo që është paraparë me këtë ligj, për derisa nuk rezulton diçka tjetër nga dispozitat e këtij ligji ose të kuptimit dhe qëllimit të tyre. “ Pra, sipas nenit 2 të LMD-ës, përcaktohet autonomia e vullnetit/liria e kontraktimit si njëri ndër parimet bazë të së drejtës kontraktore.*

Liria e kontraktimit konsiderohet e domosdoshme për lidhjen e kontratave dhe dhënien e shërbimeve. Konkretisht, liria e kontraktimit do të thotë se rendi juridik u ofron mundsi palëve kontraktues, duke i vlerësuar interesat e tyre në suazat e caktuara me ligj, që të caktojnë pavarësisht

regjimin juridik të punëve të veta, të caktojnë se cilat punë do t'i ndërmarrin, çfarë detyrimesh për t'a do të rrjedhin nga punët e tilla.

Kufizimi i lirisë së kontraktimit vjen në shprehje në rastet e kufizimeve nga neni 2 i LMD-së, por me referencë në depozitën e nenit 37 të LMD-ës, ku përcaktohet se: *“Lejueshmëria e lëndës së kontratës është cilësia e tretë që kërkohet për vlerën e kontratës së lidhur”*. Dispozita e nenit 37 të LMD-së, është karakterizim i parimit të autonomisë së vullnetit-lirisë së kontraktimit, si parim më i rëndësishëm i përmbajtur në nenin 2.

Pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimit lirisht mund të krijojnë marrëdhënie të detyrimit, por nuk mund të krijojnë marrëdhënie të detyrimit që janë në kundërshtim me dispozita urdhëruese, të rendit publik dhe të dokeve të mira (*neni 2 i LMD-së*).

Objekti i detyrimit është i palejueshëm, në qoftë së është në kundërshtim me dispozitat e rendit publik, dispozita tjera urdhëruese dhe moralin e shoqërisë. Detyrimi kontraktues mund të përbëhet nga dhënia, veprimi, mosveprimi ose durimi, ndërsa detyrimi duhet të jetë i mundshëm, i lejueshëm, i caktuar përkatësisht i caktueshëm.

Baza e kontratës duhet të ekzistojë në çdo kontratë në çastin që lidhet, dhe është njohur nga ai çast, p.sh., në kontratën e shitblerjes ose në rastet kur baza është e panjohur për subjekt të tjerë, siç ndodhë në dorëzimin e kambialit, çekut si detyrime abstrakte. Në lidhjen e kontratës baza paraqet qëllimin e detyrimit, kurse lënda-detyrimin që e kemi borxh. Nuk ka kontratë të vlefshme pa bazë juridike.

Sipas dispozitës së nenit 39 paragrafi 1, parashihet së: *“secili detyrim kontraktues duhet të ketë bazë të lejueshme”*, me depozitën e nenit 39 paragrafi 2 parashihet së: *“baza është e palejueshme në rast së është në kundërshtim me dispozitat e rendit publik, dispozitat tjera urdhëruese dhe me moralin e shoqërisë”*, ndërsa me depozitën e nenit 39 paragrafi 3 parashihet së: *“konsiderohet së detyrimi ka bazë, edhe në rast se kjo nuk është e shprehur”*.

Me depozitën e nenit 39 paragrafi 4, të LMD-së, parashihet se: *“në rast se nuk ka bazë ose baza është e palejueshme, kontrata është nul dhe absolutisht e pavlefshme”*.

Forma e kontratës është manifestim i jashtëm i përmbajtjes së kontratës. Për disa kontrata përveç kushteve të përgjithshme, nevojitet që kontrata të lidhet në një formë të caktuar. Forma për këto kontratat është kusht i veçantë për lidhjen e saj dhe ajo parashikohet shprehimisht në ligj. Ekziston një varg kontratash për lidhjen e të cilave parashikohet forma si kusht qenësor.

EFEKTET, INTERPRETIMI DHE KONVALIDIMI I KONTRATAVE

Efektet e kontratave- krijohen midis palëve kontraktuese dhe ne raste të caktuar ndaj personave të tretë dhe atë në krijimin, ndryshimin dhe shuarjen e marrëdhënieve kontraktore. Raporti juridik civil (kontraktual sepse mund të jetë edhe jokontraktuale) krijohet, ndryshohet por edhe shuhet mbi bazën e një marrëdhënie juridike kontraktuale e cila mbështet mbi vullnetin e palëve për të përcaktuar efektet e një raporti përkatës.

LMD efektet e përgjithshme të kontratës i përcakton me dispozita e nenit 130. Sipas dispozitës së nenit 130 paragrafi 1, të LMD-ës përcaktohet së: “ *kontrata krijon të drejta dhe detyrime për palët kontraktuese*”, ndërsa me paragrafin 2, të nenit të njëjtë përcaktohet së:

“ *Kontrata krijon efekte te veta edhe për pasardhësit juridik universal te palëve kontraktuese, përveç nëse është kontraktuar diçka tjetër apo nëse diçka tjetër rezulton nga vete natyra e kontratës*”, kurse në paragrafin 3 të nenit të njëjtë përcaktohet së: “ *Me kontratë mund të krijohet e drejta në dobi të personit të tretë*”.

Për palët kontraktuese kontrata është ligj, prandaj ato duhet t’i përmbushin obligimet tyre. Kontrata është vepër e palëve, prandaj edhe thuhet se kontrata krijon efekt midis palve kontraktuese.²³⁹

Siç u theksua efektet e kontratave shprehen edhe ndaj personave të tretë, LMD, këtë çështje e rregullon me dispozita e nenit 131.

Sipas dispozitës së nenit 131 paragraf 1, parashihet së:” *Kur dikush kontrakton në emër të tij ndonjë kërkesë në dobi të personit të tretë, atëherë personi i tretë fiton të drejtën vetjake dhe të drejtpërdrejtë ndaj debitorit, në qoftë se nuk është kontraktuar diç tjetër ose nuk del nga rrethanat e punës*”. Me dispozitën e nenit 131 paragraf 2, përcaktohet së:” *Kontraktuesi ka të drejtë të kërkojë që debitori të kryejë ndaj personit të tretë atë që është kontraktuar në dobi të atij personit të tretë*”. Tek përmbajta e dispozitave nga neni 130 vërehet se cilësia e kreditorit në raport me debitorin ju jepte edhe kontraktueset por edhe personit të tretë.

Interpretimi- në jetën e përditshme shpeshherë ndodhë që të lindin në mes të palëve kontraktues mospajtme të ndryshme rreth kontratës. Kjo ndodhë për faktin së zakonisht në rastet e tilla palët kontraktues i kuptojnë në mënyra të ndryshme kushte e kontratës.

Interpretimi i kontratës nënkupton gjetjen e kuptimit të vërtetë të kontratës gjegjësisht të dispozitave kontraktuese. Kjo vjen në shprehje kur dispozitat e kontratës për palët kontraktues janë të pa qarta apo kuptohen në forma të ndryshme.

²³⁹ Skender Gojani & Granit Curri, E Drejta Kontraktore, Prishtinë, 2020, fq. 111.

Parimisht interpretimin e kontratës e bën gjykata kompetente, por ka raste kur interpretimin e kontratës e bën edhe ndonjë person i tretë që nuk është i përfshirë në kontratë. Pra interpretimi i kontratës mund të jetë gjyqësor dhe jashtë gjyqësor.

Me interpretimin gjyqësor nënkuptohet interpretimin i bërë nga ana e gjykatës, ndërsa me interpretimin jashtë gjyqësor nënkuptohet interpretimi i bërë nga personi i tretë pranë arbitrazhit.

LMD interpretimin e kontratës e ka rregulluar me dispozita nga neni 85 deri 88.

Me dispozitat e nenit 85 të LMD-ës, është parapa aplikimi i dispozitave dhe interpretimi i dispozitave kontraktuese. Në paragrafin një të nenit 85 parashihet së: *“Dispozitat e kontratës zbatohen ashtu sikundër e kanë përmbajtjen”*, ndërsa në pikën 2 të nenit 99 parashihet së: *“Me rastin e interpretimit të dispozitave kontestuese nuk duhet lidhur vetëm për domethënien tekstuale të shprehjeve të përdorura, por duhet hulumtuar qëllimi i përbashkët i kontraktuesve dhe dispozita të kuptohet ashtu sikundër u përgjigjet parimeve të së drejtës së detyrimeve të përcaktuara me këtë ligj”*.

Me dispozitë e nenit 86 të LMD-ës, përfshihet përparësia e dispozitave në rastet e veçanta. LMD përparësinë e dispozitave të veçanta e rregullon në këtë mënyrë duke përcaktuar se:

“Në rastin kur kontrata është lidhur sipas përmbajtjes së shtypur që më parë, ose kur kontrata ka qenë në ndonjë mënyrë e përgatitur dhe e propozuar nga njëra palë kontraktuese, dispozitat e paqarta do të interpretohen në dobi të palës tjetër”.

Me dispozitën e nenit 87 LMD, parasheh rregullat plotësues duke përcaktuar se: Dispozitat e paqarta në kontratën pa shpërblim duhet interpretuar në kuptimin që dispozita e rëndon më pak debitorin, ndërsa te kontrata me shpërblim në kuptimin me të cilin realizohet një marrëdhënie e drejtë e prestimeve reciproke.”

Interpretimi jashtëgjyqësor i kontratës rregullohet me dispozitat e nenit 88.

Me dispozitën e nenit 88 paragrafi 1, i LMD-ës, përcaktohet se: *“Palët kontraktuese mund të parashikojnë se, në rastin e mospajtimit lidhur me kuptimin dhe sferën e dispozitave kontraktuese, një i tretë do ta interpretojë kontratën”*, ndërsa në pikën 2 të nenit 88 parashihet së: *“Në këtë rast, në qoftë se me kontratë nuk është parashikuar ndryshe, palët nuk mund të fillojnë kontestin para gjykatës ose para organit tjetër kompetent, derisa mos e marrin më parë interpretimin e kontratës, përveç nëse personi i tretë refuzon ta japë interpretimin e kontratës”*.

Konvalidimi- i kontratës sipas dispozitës së nenit 58 të LMD-ës, parashihet së kontrata që u mungon forma mund të konvalidohen. Sipas kësaj dispozite parashihet se: *“Kontrata, për lidhjen e së cilës kërkohet forma me shkrim është e vlefshme edhe pse nuk është lidhur në këtë formë, në qoftë se palët kontraktuese detyrimet i kanë përmbushur në tërësi ose në pjesën më të madhe që dalin nga kontrata, përveç nëse qartë del ndryshe nga qëllimi për të cilin është parashikuar forma”*.

Është e rëndësishme të vlerësohet mirë se çka është gjegjësisht çka nënkupton përmbushja në pjesën dërmuese të kontratës formale, për të cilën faktikisht nuk është zbatuar kushti i formës së paraparë. Në fakt me përmbushjen në pjesën dërmuese të kontratës duhet të kuptohet fakti se kontrata është përmbushur në pjesën prej 80%, 90% apo më shumë.

Sipas vlerësimit tonë të rastet e qarkullimit të patundshmërive nuk mund të aplikohet dispozita për konvalidimin e kontratës sipas nenit 58 të LMD-ës.

PAVLEFSHMËRIA E KONTRATËS

KONTRATA NULE

Kontratat absolutisht të pavlefshme- janë kontratat që janë në kundërshtim me rregullat e rendit juridik.

LMD me dispozitat e nenit 89, parasheh nulitetin e kontratave duke përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 89 se: *“kontrata që është në kundërshtim me rendin publik, dispozitat urdhëruese, ose moralin e shoqërisë është nule, në qoftë se qëllimi i rregullës së cenuar nuk udhëzon në ndonjë sanksion tjetër apo në qoftë se ligji në rastin e caktuar nuk parashikon diç tjetër”*, ndërsa në paragrafin 2, përcaktohet se: *“në qoftë se lidhja e kontratës së caktuar është e ndaluar vetëm për njërën palë, kontrata do të jetë e vlefshme, në qoftë se në ligj nuk është parashikuar ndryshe për rastin e caktuar, ndërsa pala që e ka cenuar ndalesën ligjore do të pësojë pasoja përkatëse”*.

Pavlefshmërinë absolute të kontratës mund t’ a kërkoj pala kontraktuese e dëmtuar. Përveç palës kontraktuese të dëmtuar, pavlefshmërinë mund ta kërkojnë edhe trashëgimtarët e gjithashtu edhe personat e tretë që kanë interes mund t’ a kërkojnë pavlefshmërinë e kontratës.

Këto kontrata anulohen sipas detyrës zyrtare *ex-officio*. Sipas dispozitës së nenit 95 të LMD-së, parashihet se: *“për nulitetin gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe në atë mund të thirret çdo person i interesuar”*. E drejta e theksimit të nulitetit nuk parashkruhet (nenin 96 i LMD-së).

Pavlefshmërinë e kontratës e shkakton mungesa e njërit prej kushteve të nevojshme që kërkohen sipas ligjit. LMD me dispozitën e nenit 39 paragraf 1, ka përcaktuar se: *“secili detyrim kontraktuese duhet të ketë bazë të lejueshme”*, ndërsa në paragrafin 2 të nenit të njëjtë ka përcaktuar se: *“Baza është e palejueshme në rast se është në kundërshtim me dispozitat e rendit publik, dispozitat tjera urdhëruese dhe moralin e shoqërisë”*.

Në paragrafin 4, të nenit 39 të LMD-së, përcaktohet se: *“Në rast se nuk ka bazë ose baza është e palejueshme, kontrata është nul dhe absolutisht e pavlefshme”*. Nga përmbajtja e dispozitave të cituara, qartë konstatohet se kontrata është absolutisht nule nëse baza është e palejueshme, është në kundërshtim me dispozitat e rendit publik, dispozitat tjera urdhëruese apo me moralin e shoqërisë.

Baza e kontratës është shkaku, arsyeja për të cilën debitori merr detyrim.²⁴⁰

Përveç bazës juridike kontratën e bënë absolutisht të pavlefshme edhe kur objekti i detyrimit është i pamundur, i pacaktuar ose i cili nuk mund të caktohet.

Me dispozitat e nenit 34 të LMD-së, është rregulluar objekti i detyrimit. Me dispozitën e nenit 34 paragrafi 1, të LMD-së, përcaktohet së: *“Detyrimi kontraktues mund të përbëhet nga dhënia, veprimi, mosveprimi ose durimi”*, ndërsa në paragrafin 2, të nenit të njëjtë përcaktohet së: *“Detyrimi duhet të jetë i mundshëm, i lejueshëm, i caktuar përkatësisht i datueshëm”*.

Pasoja e objektit të pamundur, të palejueshëm, të pacaktuar apo që nuk mund të caktohet, përcaktohet me dispozitën e nenit 35 të LMD-së: *“Kur objekti i detyrimit është i pamundur, i palejueshëm, i pacaktuar ose i cili nuk mund të caktohet, kontrata është absolutisht e pavlefshme”*.

Objekti është i palejueshëm, në qoftë se është në kundërshtim me dispozita e rendit publik, dispozita tjera urdhëruese dhe moralin e shoqërisë.

Objekti i detyrimit është i datueshëm në qoftë se kontrata përmban të dhëna me ndihmen e të cilave mund të caktohet objekti, apo nëse palët ia lënë personit të tretë që ta caktoj objektin, por nëse personi i tretë nuk dëshiron apo nuk mund ta caktoj objektin, atëherë kontrata është nule.

Pasojat e nulitetit- Në rastin e nulitetit të kontratës secila palë kontraktuese ka për detyrë t’ia kthej palës atë që ka marrë në bazë të kontratës së tillë, e në rast se kjo është e pamundshme apo nëse kthimi parandalohet nga natyra e asaj që është plotësuar, duhet të bëhet kompensimi përkatës në të holla sipas çmimeve në kohën e nxjerrjes së vendimit gjyqësor, përveç nëse përcaktohet ndryshe me ligj.

Në rast se kontrata është nul për shkak se sipas përmbajtjes ose qëllimit të vet është në kundërshtim me parimet themelore morale, gjykata mund të refuzojë tërësisht ose pjesërisht kërkesën e palës së pandërgjegjshme për kthimin e asaj që i ka dhënë palës tjetër; në marrjen e vendimit, gjykata do të ketë parasysh shkallën e veprimit në mirëbesim të njëjës ose të të dy palëve dhe rëndësinë e interesave që cenohen.

Nuliteti i pjesshëm - Nuliteti i ndonjë dispozite të kontratës nuk mund të ketë si pasojë nulitetin edhe të vetë kontratës, në qoftë se ajo mund të qëndrojë pa dispozitën nule, dhe në qoftë se ajo nuk ka qenë kusht apo motiv vendimtar për lidhjen e saj. Megjithatë, kontrata do të jetë e vlefshme edhe atëherë kur dispozita nule ka qenë kusht ose motiv vendimtar i kontratës në rastin kur nuliteti është konstatuar pikërisht që kontrata të lirohej prej kësaj dispozite dhe të vlejë pa te.

Konversioni i kontratës së pavlefshme -Kur kontrata nule i plotëson kushtet për vlefshmërinë e ndonjë kontrate tjetër, atëherë midis kontraktuesve do të vlejë kjo e dyta, në qoftë se kjo do të ishte në përputhje me qëllimin të cilin kontraktuesit e kanë pasur parasysh kur e kanë lidhur kontratën

²⁴⁰ Komentari i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve i Kosovës, Libri I, Prishtinë 2013, fq52.

dhe në qoftë se mund të merret se këta do ta lidhin këtë kontratë po të ishin në dijeni për nulitetin e kontratës së tyre.

Shuarja e mëvonshme e shkaqeve të nulitetit-1. Kontrata nule nuk bëhet e vlefshme, nëse ndalesa ose ndonjë shkak tjetër i pavlefshmërisë zhduket më vonë. Mirëpo, në qoftë se ndalesa ka qenë me rëndësi të vogël, ndërsa kontrata është zbatuar, atëherë nuk mund të kërkohet nuliteti.

Përgjegjësia e personit fajtor për nulitetin e kontratës-Kontraktuesi që është fajtor për lidhjen e kontratës nule i përgjigjet bashkë kontraktuesit të tij për dëmin që pëson për shkak të nulitetit të kontratës, në qoftë se ky nuk ishte në dijeni apo sipas rrethanave nuk do të duhej te ishte në dijeni për ekzistimin e shkakut të nulitetit.

Kërkimi i nulitetit-Për nulitetin gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe në atë mund të thirret çdo person i interesuar.

Kërkimi i pakufizuar i nulitetit-E drejta e paraqitjes së kërkesës të nulitetit nuk shuhet.

Kontrata relativisht të pavlefshme- Kontrata relativisht të pavlefshme ekzistojnë kur kontratën e ka lidhur personi me aftësi të kufizuara punuese, kur në lidhjen e saj kanë ekzistuar mungesa në pikëpamje të vullnetit të palëve si dhe kur me ligj dhe me ndonjë dispozitë të veçantë është caktuar se kemi të bëjmë me kontratë relativisht të pavlefshme. LMD me dispozitën e nenit 97 parasheh kontratat e rrëzueshme.

Anulimin e kontratës mund t'a kërkojë pala kontraktuese e cila ka interesin e së cilës është vërtetuar rrezueshmëria, mund të kërkojë që kontrata të anulohet, mirëpo kontraktuesi tjetër mund të kërkojë nga pala që në afat të caktuar, por jo më shkurt se 30 ditë që të deklarohet se a ngelë pranë kësaj kontrate që është relativisht e pavlefshme, sepse në të kundërtën do të konsiderohet se kontrata është anuluar. Në qoftë se pala kontraktuese e ftuar në afat të caktuar nuk deklarohet ose nëse deklaron se nuk ngelë pranë kësaj kontrate, do të konsiderohet se kontrata është anuluar (*dispozitat e nenit 98 të LMD-së*).

Me dispozitat e nenit 102 të LMD-së, parashihet pushimi i të drejtave. Sipas dispozitës nga paragrafi 1 i nenit 102, parashihet se: *“E drejta për të kërkuar anulimin të një kontrate të rrëzueshme shuhet me skadimin e afatit prej një (1) viti nga dita kur të jetë ditur shkak i rrëzueshmërisë, përkatësisht prej pushimit të dhunës”,* ndërsa në pikën 2 parashihet së: *“kjo e drejtë në çdo rast pushon me skadimin e afatit prej 3 vjetësh nga data e lidhjes së kontratës”*.

Numri i rasteve për anulimin e kontratave si për shkaqet absolute, ashtu edhe për shkaqet relative është i shpeshtë në praktikën gjyqësore, prandaj me qëllim që të kemi një ide sa më të qartë se si klasifikohen shkaqet për anulimin e kontratave në ato absolute-relative, paraqesim opinionin si në vijim:

Shkaqet për anulimin e kontratave lidhur me kushtet për lidhjen e kontratave, dhe atë veçanërisht me kushtet e përgjithshme për lidhjen e kontratës. Në qoftë se e apstrahojmë për një moment përmbajtjen e dispozitës së nenit 89 i LMD-së, dhe përmbajtjen e nenit 97 të LMD-së, atëherë do

të theksonim se janë: “aftësia punuese e palëve kontraktuese, vullneti i palëve kontraktuese për lidhjen e kontratës, lënda e kontratës dhe baza e kontratës”, si kushte për lidhjen e kontratës, por edhe si shkaqe për anulimin e kontratave. Në qoftë se i marrim një nga një si shkaqe për anulimin e kontratave në mënyrë parimore do të kishim këtë ndarje:

Mungesa e vullnetit parimisht konsiderohet si shkak për rrëzueshmërinë e kontratës, baza dhe lënda e kontratës konsiderohen si shkak për anulimin e kontratës, ndërsa aftësia punuese e palëve kontraktuese varësisht nga rasti mund të kualifikohet edhe si shkak për rrëzimin e kontratës edhe si shkak për anulimin e kontratës.

Forma e kontratës është kusht i veçantë tek puna juridike e transferimit të pronësisë, por edhe te situatat tjera, por zakonisht në praktikën gjyqësore është shumë i rrallë rasti kur gjykata i jep vlerësimet mbi themelësinë e kërkesëpadisë, nisur nga shkak i mungesës së formës së kontratës, kjo për shkak se një punë juridike pa formë nuk ka mundur të shërbej si bazë për transferimin e pronësisë dhe rrjedhimisht nuk është as objekt kontesti anulimi i saj. Kjo nuk i përjashton situatat për shembull tek kontrata e ndërtimit apo edhe tek rastet tjera kur kërkohet forma e kontratës.

Vullneti si kusht për lidhjen e kontratës është normuar me dispozitën e nenit 18 të LMD-së, dhe në mënyrë parimore është shkak për rrëzueshmërinë e kontratës në çdo rast kur në procedurë gjyqësore do të konstatohej se në momentin e lidhjes së kontratës kanë ekzistuar mungesa sa i përket vullnetit të deklaruar për shkak të lajthimit, mashtrimit, kërcënimit apo dhunës.

Meqenëse mungesa e vullnetit konsiderohet si shkak për rrëzimin e kontratës, atëherë na rezulton se për këtë shkak kërkesa mund të parashkruhet. Nga kjo rrjedh se përveç të tjerave rrëzimin e kontratës, për shkak të mungesës së vullnetit mund t’ a kërkojë vetëm pala ndaj të cilës është shtrirë efekti i kontratë (*efekti interpartes*), dhe rrjedhimisht e njëjta nuk mund të anulohet sipas detyrës zyrtare.

Për nevojat e praktikës gjyqësore theksohet se në rastet gjyqësore të cilat i referohen kërkesave për anulimin e kontratave për shkak se është i falsifikuar autorizimi i pronarit të sendit, gjykatat, rastet e tilla i kanë kualifikuar si kontrata absolutisht të pavlefshme. Nuk ka asnjë dyshim që autorizimi i falsifikuar për pronarin dhe transferimi i titullit të pronësisë sipas autorizimit të falsifikuar, përveç të tjerave paraqet edhe mungesë të vullnetit të pronarit (*i kualifikuar si shkak relativ-rrëzueshmëria e kontratës*), por mbrojtja gjyqësore në praktikë në rastet e tilla nuk është dhënë duke e vlerësuar vetëm mungesën e vullnetit të pronarit për transferimin e titullit të pronësisë, por duke e vlerësuar në tërësi punën juridike për të cilën konkludimi është se e njëjta është në kundërshtim me rendin juridik.

Paaftësia për të vepruar si shkak për anulimin e kontratës. Siç e theksuam më lartë zotësia e veprimit është kusht i përgjithshëm për lidhjen e kontratës, për njëkohësisht është edhe shkak për anulimin e kontratës, në rast se kjo zotësi e veprimit ka munguar në momentin e lidhjes së kontratës. Në qoftë se punën juridike për transferimin e titullit të pronësisë e ka lidhur personin nën moshën 14 vjeçare, në këtë rast kontrata konsiderohet e kualifikuar si absolutisht nule, ndërsa

në qoftë se kontratën (*për shembull për transferimin e pronësisë*) e ka lidhur personi mbi moshën 14 vjeçare, në këtë rast kontrata konsiderohet e kualifikuar si relativisht nule. Përveç këtyre dy situatave përkitazi me të miturit, ekziston edhe situata kur madhorit i është hequr zotësia e veprimit, dhe në qoftë se punën juridike e ka lidhur personi i tillë, varësisht nga vëllimi i zotësisë së hequr të veprimit do të varet edhe kualifikimi i punës juridike në atë se e njëjta është relativisht e pavlefshme apo absolutisht e pavlefshme.

Përmbajtja e sipër theksuar është e rëndësishme për shkak se varësisht nga kapaciteti i zotësisë së veprimit, përveç që do të kualifikohet puna juridike në relativisht e pavlefshme apo absolutisht e pavlefshme, do të varet edhe afati i parashkrimit të kërkesës dhe rrethi i subjekteve që mund të parashtrijnë kërkesën për anulimin e punës juridike.

Lënda e kontratës si shkak për anulimin e kontratës. Lënda e kontratës mund të jetë shkak për anulimin e kontratës në qoftë se transferimi i titullit të pronësisë është në kundërshtim me rendin juridik. Lënda e kontratës si shkak për anulimin e kontratës është situatë e rrallë në praktikën gjyqësore, për shkak se me rastin e vërtetimit të kontratës organi kompetent sigurohet paraprakisht që lënda e kontratës të jetë e lejueshme, dhe rrjedhimisht edhe e disponueshme për palët kontraktuale.

Baza e kontratës si shkak për anulimin e kontratës. Në teorinë juridike baza e kontratës definohet si qëllimi juridik të cilën e pretendojnë palët. LMD përmban dispozitë të veçantë për bazën e palejueshme të kontratës si shkak për pavlefshmërinë absolut të kontratës.

Nga praktika gjyqësore na paraqiten raste të ndryshme të kërkesave për anulimin e kontratave.

Ashtu siç e theksuam më lartë kanë qenë të shpeshta rastet kur është kërkuar anulimi i kontratës për shkak se është transferuar titulli i pronësisë mbi sendin e paluajjtshëm me autorizim të falsifikuar.

Specifike e këtyre rasteve ka qenë se puna juridike i është përmbajtur formës, në atë mënyrë që e njëjta është vërtetuar në gjykatë, apo tek noteri, dhe rrjedhimisht edhe është regjistruar në regjistrin për regjistrimin e të drejtave në patundshmëri. Ka raste kur blerësi formal edhe është futur në posedim të pronës duke e shfrytëzuar mos posedimin e pronarit, por ka pasur raste edhe kur nuk ka mundur të futet në posedim. Përveç të cekurave ka mundur të ndodhë që blerësi formal edhe e ka bërë pagesën e çmimit të shitblerjes, por çmimin e ka pranuar personi i cili e ka falsifikuar autorizimin e pronarit.

Këto raste paraqesin konteste mjaftë sensitive dhe komplekse, për shkak se konflikti i palëve zakonisht është i ashpër, dhe pretendimet e palëve po ashtu paraqiten me një lloj ashpërsie në atë mënyrë që blerësit pretendojnë se kanë paguar çmimin dhe e kanë blerë pronën në mënyrë të rregullt, ndërsa paditësit pretendojnë se pronën nuk e kanë shitur asnjëherë. Gjykatat duhet të jenë të kujdesshme në raste të tilla dhe të thellohen në hetimin e çështjes në masë të mjaftueshme, për të konstatuar të gjitha rrethanat faktike të rëndësishme për të vendosur në mënyrë meritore për themelësinë e kërkesëpadisë.

Pra, gjykatat duhet që në procesin e të provuarit të konstatojnë në mënyrë objektive figurën e çështjes kontestuese në mënyrë që të kenë mundsi që të vlerësojnë të gjitha kërkesat dhe pretendimet e palëve sipas peshës që ato kanë për të përcaktuar fatin e çështjes kryesore. Natyrisht që është mjaftë sfiduese për gjykatën të vlerësojë në njërën anë pretendimet e të paditurit se pronën e ka blerë në mënyrë të rregullt, për të njëjtën ka paguar çmimin ekuivalent dhe është futur në posedim, dhe në anën tjetër të vlerësojë pretendimin e paditësit që prona e tij është shitur me autorizim të falsifikuar dhe se i njëjti as që e ka pasur qëllim t'a shes patundshmërinë e tij. Në mënyrë parimore nga praktika gjyqësore mund të konkludohet se kontratat e lidhura me autorizim të falsifikuar konsiderohen si kontrata absolutisht të pavlefshme, për shkak se janë në kundërshtim me rendin juridik, megjithatë ky është vetëm një vlerësim parimor dhe në çdo rast i mbetet gjykatës të peshojë secilën rrethanë faktike e cila mund të jetë me ndikim në vendosjen meritore.

Praktika gjyqësore në vitet e fundit ka njohur shumë raste të kërimit të anulimit të kontratave për shkak se çmimi i shitblerjes nuk ka qenë ekuivalent dhe rrjedhimisht ka munguar vullneti për lidhjen e kontratave të tilla. Këto raste kryesisht i janë referuar shitblerjeve që kanë ndodhur në mes personave fizik dhe kooperativave bujqësore. Konkluzionet përfundimtare nga praktika gjyqësore për çështje të tilla janë se këto raste kualifikohen në grupin e kontratave relativisht të rrëzueshme për të cilat kërkesa parashkruhet brenda afateve ligjore. Në këtë kuptim në shumicën e rasteve gjykatat kanë vendosur për refuzimin e kërkesave, për shkak se kërkesat janë parashkruar. Pra, përfundimet nuk kanë qenë duke u mbështetur në vlerësimin e rrethanave të cilat potencialisht kontratën e bëjnë relativisht të pavlefshme, por duke u mbështetur në faktin se kanë kaluar afatet ligjore për të kërkuar mbrojtjen gjyqësore sipas kësaj baze.

Pasoja e anulimit - Në rast se në bazë të kontratës se rrëzueshme që është anuluar është përmbushur diçka, duhet të bëhet kthimi; në rast se kjo është e pamundshme apo në rast se kthimi ndalohet nga natyra e asaj që është përmbushur, duhet të bëhet kompensimi përkatës në të holla.

Kompensimi në të holla jepet sipas çmimeve në kohën e kthimit ose në kohën e nxjerrjes së vendimit gjyqësor.

Përgjegjësia për anulimin e kontratës -Kontraktuesi, në anën e të cilit është shkak i rrëzueshmërisë, i përgjigjet bashkë kontraktuesit për dëmin që pëson për shkak të anulimit të kontratës, nëse ky nuk ishte në dijeni dhe as që duhej të ishte në dijeni për ekzistimin e shkakut të rrëzueshmërisë së kontratës.

Përgjegjësia e personit me aftësi të kufizuar për të vepruar -Personi me aftësi të kufizuar për të vepruar përgjigjet për dëmin e shkaktuar me anulimin e kontratës, në qoftë se me dinakëri e ka bindur bashkë kontraktuesin e tij se është i aftë për të vepruar.

MJETE PËR SIGURIMIN E EKZEKUTIMIT TË KONTRATAVE

Esenca e lidhjes së kontratave gjegjësisht arsyeja e lidhje së tyre është ekzekutimi i tyre. Ekzekutimi i kontratave mund të bëhet në mënyrë vullnetare por edhe duke zbatuar sanksionet juridike. Ekzistimi i sanksioneve juridike ndikon që kontratat të ekzekutohen në masë të madhe vullnetarisht. E drejta kontraktore parasheh edhe garancione tjera gjegjësisht mjete tjera për të siguruar ekzekutimin e kontratës kur palët nuk kanë besimin e duhur për ekzekutimin e kontratës. Pavarësisht së në mënyrë parimore mund të thuhet së çdo marrëdhënie kontraktuese është është e siguruar nga sanksioni juridike, Ligji i Marrëdhëneve Detyrimore, ka parapa mjete të ndryshme për ekzekutimin e kontratave.

Në radhë ta parë çdo marrëdhënie kontraktuese garantohet nga sanksioni që ne fakt nenkupton normen juridike sipas së cilës edhe është e rregulluar mënyrë e themelimit të një një marrëdhënie juridike kontraktore dhe mënyra e përmbushjës së detyrimeve reciproke të palve të përfshira në marrëdhënie kontraktuese.

Pavarësisht së sanksioni parashe përmbushën e detyrimit të kontraktuar në mënyrë të dhunshme në rastet kur nuk respektohet përmbushja vullnetare, megjithatë ka raste kur kreditori nuk ka besimin e duhur ndaj palës tjetër kontraktuese, atëherë kreditori ka në dispozicion mjete të caktuara që në mënyrë të drejtpërdrejtë të siguroj se kontrata do të përmbushet. Kryesisht mjetet e sigurimit të ekzekutimit të kontratës kërkohen në ato kontrata që përmbushja e tyre do të zgjas për një kohë me të gjatë. Mjetet e ekzekutimit të kontratës sipas natyrës së tyre ato ndahen në mjetet e sigurimit real të ekzekutimit të kontratave dhe në mjetet e sigurimit personal të ekzekutimit të kontratave.

Mjetet reale të sigurimit të ekzekutimit të kontratave janë: pengu, hipoteka, kapari, kaucioni, ndersamjett e sigurimit personal të ekzekutimit të kontratës janë: pendimi, kushti penal dhe dorëzania. Karakteristikë kryesore e këtyremjeteve është se janë kontrata aksesore sepse ekzistojnë pranë kontratës kryesore, madje këto mjete të sigurimit të ekzekutimit të kontratës kanë lëndë të njëjtë ose vlerë pasurore që mund të jetë sendi, e drejta ose i parashikon ndonjë llogari të caktuar njëherë palë ose i krijon në bazë të kontratës.

Disa prej këtyre mjeteve bëjnë presion në debitorin në përmbushjen e kontratës (kushti penal, kapari, kaucioni, pendimi), ose disa prej tyre përveç debitorit që paraqitet për përmbushje e kontratës paraqitet edhe dikush tjetër (dorëzani), kurse në disa tjera detrimi kontraktor përpara fillon të përmbushet (avansi).

Sa i përket terminologjisë shkenca juridike që mbulon këtë materje është gati unike duke përdorë terminologjin, mjetet për sigurimin e ekzekutimit të kontratës apo terminologjin tjetër që njihet si përforcimi i kontratës. Në vijim do të trajtohen mjetet reale dhe mjetet personale të sigurimit të

ekzekutimit të kontratës duke përjashtuar pengun dhe hipotekën të cilat nuk rregullohen me Ligjin e Marrëdhënieve Detyrimore.

MJETËT REALE PËR SIGURIMIN E EKZEKUTIMIT TË KONTRATËS

Kapari

Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), me dispozitën e nenit 67 par 1, ka paraparë se: “në qoftë se në çastin e lidhjes së kontratës njëra palë ja ka dhënë palës tjetër një shumë të hollash ose një sasi sendesh tjera të zëvendësueshme si shenjë se kontrata është lidhur (kapari), kontrata konsiderohet e lidhur kur kapari të jetë dhënë, në qoftë se nuk është kontraktuar diçka tjetër”.

Me dispozitën e nenit 67 par 2 të LMD-së, parashihet se: “kapari llogaritet në përmbushjen e detyrimit, në qoftë se kjo nuk është e mundur atëherë ai (kapari) duhet të kthehet në çastin e përmbushjes”. Në interpretimin e këtyre dispozitave mund të kuptohet se në rastin kur kapari nuk kontraktohet të kthehet në momentin e përmbushjes së kontratës atëherë mund të konsiderohet si avancë, ndërsa në rastin kur kontraktohet që kapari të kthehet në momentin e përmbushjes së kontratës atëherë nuk mund të konsiderohet si avancë. Kontrata e kaparit është kontratë aksesore ngase ekziston pranë kontratës kryesore dhe ndan fatin e saj. Kapari është një sigurim real të sigurimit të ekzekutimit të kontratës së lidhur. Kjo kontratë konsiderohet e lidhur në momentin e dorzimit të kaparit.

Në qoftë se nuk është kontraktuar diçka tjetër, pala që ka dhënë kaparin nuk mund të heqë dorë nga kontrata, duke ia lënë kaparin palës tjetër, e as që mund ta bëjë këtë palë tjetër duke ja kthyer kaparin e dyfishuar. Ky është një përcaktim dhe detyrim ligjor i paraparë me dispozitën e nenit 67 par.3 të LMD-së.

Në qoftë se për mos përmbushjen e kontratës është përgjegjëse pala që ka dhënë kaparin, palë tjetër mundt, sipas vullnetit të saj të kërkojë përmbushjen e kontratës, në qoftë se kjo është ende e mundur dhe të kërkojë shpërblimin e dëmit. Ajo mundet kaparin ta kompensojë me shpërblimin e dëmit ose ta kthejë ose pala mundet të pajtohet me kaparin e marrë.

Në qoftë se për mos përmbushjen e kontratës është përgjegjëse pala që e ka marrë kaparin, pala tjetër mundet, sipas zgjidhjes së saj të kërkojë përmbushjen e kontratës, po të jetë ende e mundur ose të kërkojë shpërblimin e dëmit dhe kthimin e kaparit, ose të kërkojë kthimin e kaparit të dyfishuar, sidoqoftë kur pala tjetër, kërkon zbatimin e kontratës, ajo ka të drejtën edhe për shpërblimin e dëmit që pëson për shkak të vonesës.

Gjykata mundet me kërkesën e palës së interseuar, ta zvoglojë kaparin tepër të lartë.

Në rastet kur vjen në shprehje e drejta e kompsnimit të dëmit gjithmonë kjo e drejtë mund të realizohet vetëm me kërkesën e palës së dëmtuar. Pala e dëmtuar këtë të drejtë mund ta realizoj

me referencë në dispozitën e nenit 245 paragraf 2 të LMD-së, ku parashihet së: “kur debitori nuk e përmbushë detrimin ose vonohet në më përmbushjën e tij, kreditori ka të drejtë të kërkoj edhe shpërblimin e dëmit që ka pësuar për këtë shkak” dhe me referencë në dispozita e nenit 249 të LMD-së, ku përcaktohet vëllimi i shpërblimit të dëmit.

Në rast të përmbushjës së pjesëshme të detyrimit, kreditori nuk mund ta mbajë kaparin, por mund të kërkoj përmbushjën e detyrimit të mbetur dhe shpërblimin e dëmit për shkak të vonesës apo të kërkoj shpërblimin e dëmit për shkak të përmbushjës jo të plotë, por në të dy rastet kapari llogaritet në shpërblimin e dëmit, (neni 69 par 1 i LMD-së).

Në këtë rast e drejta e shpërblimit të dëmit realizohet si e drejtë alternative, prandaj edhe këtu në pikëpamje të shpërblimit të dëmit dhe vëllimit të dëmit vlejnjë rregullat nga neni 246 i LMD-së, ku përcaktohet se: “debitori lirohet nga përgjegjësia për dëmin në qoftë së provon se nuk ka mundur ta përmbush detyrimin e tij, përkatësisht është vonuar me përmbushjën e detyrimit për shkak të rrethanave të krijuara pas lidhjes së kontratës të cilat nuk ka mundur t’i parandaloj, t’i evitoj ose t’i shmang” dhe me referencë në dispozita e nenit 249 të LMD-së.

Në qoftë së kreditori e zgjedh kontratën dhe e kthen atë që ka marrë si përmbushje të pjesëshme, ai mund të zgjedhë midis kërkesave të tjera që i takojnë njëres palë kur kontrata ka mbetur e pa përmbushur me faj të tjetres, (neni 69 paragrafi 2 i LMD-së).

Paradhënja (avanci)

Paradhënja është mjet real i sigurimit të ekzekutimit të kontratës. Në shkencë ka dy pikëpamje për paradhënjen ashtu që një grup shkenctarësh mendojnë së paradhënja është mjet real i sigurimit të ekzekutimit të kontratës, ndërsa grupi tjetër paradhënjen e fusin në grupin e mjeteve tjera, por shumica mban qëndrimin se paradhënja është mjet real i sigurimit të ekzekutimit të kontratës. Natyrisht edhe avanci lidhet si kontratë aksesore.

Avanci jepet në momentin e lidhjes së kontratës si ndihmë palës tjetër që me lehtë të përmbush kontratën. Kjo dhënje është ekzekutim i pjesshëm i kontratës. Parimisht jepet në sasi të hollash por mund të jetë edhe send i luajtshëm që ka vlerë pasurore. Me rastin e dhënjes së avancit dhënësi i avancit nuk mund të kërkoj kthimin e avancit ngase avanci konsiderohet përmbushje e pjesëshme e kontratës.

Avanci mund të kontraktohet që suksesivisht të jepet gjerë në përmbushjën e plotë të kontratës. Kjo vlenë kryesisht të kontratat e ndërtimit, sepse zgjatja kohore e përmbushjës së kësaj kontrate mund të ketë vështërsi të ndryshme, andaj paradhënja në këtë drejtim ndihmon shumë për tu realizuar parimi pacta sunt servanda. Nese ndodhë që për shkaqe të ndryshme kontrata të zgjidhet, atëhere shuarja e kësaj kontrate nuk ndikon që avanci të humbet, por ai i kthehet dhënesit të tij.

Kaucioni

Kontrata për akucionin është kontratë akcesore ngase lidhet për arsye se ekziston kontrata kryesore. Kaucioni është mjet real i sigurimit të ekzekutimit të kontratës, përndryshe jepet në të holla ose në ndonjë send të luajtshme por që ka vlerë. Fusha e zbatimit të kaucionit është e ngushtë. Rëndom përdoret në blerjen e disa gjërave të përditshme të furnizimit të qytetarve ose të konsumatorevr, p.sh. deponimi i kaucionit për kthimin e ambalazhit. Këtë si mjet e shfrytëzojnë kryesisht personat juridik që ushtrojnë veprimtari afariste dhe që kanë për qëllim të pengojnë subjektet jo serioze të marrin pjesë në ankande të ndryshme. Në qoftë se dhënesi i kaucionit nuk e lidhë kontratën edhe pse kushtet e pritura janë plotësuar, atëhere kaucioni i tij humbet në dobi të marrësit.

MJETËT PERSONALE PËR SIGURIMIN E EKZEKUTIMIT TË KONTRATËS

Pendimi

Me marrëveshjen e palve kontraktues mund të autorizohet njëra ose secila palë që të heq dorë nga kontrata duke e dhënë pendimin.

Kur pala në dobi të së cilës është kontraktuar pendimi i deklaron palës tjetër se do ta jap pendimin, ajo nuk mund të kërkoj me përmbushjen e kontratës.

Pala e autorizuar për të hequr dorë ka për detyrë të jep pendimin njëkohësisht me deklaratën për heqjen dorë.

Në qoftë së kontraktuesit nuk e kanë caktuar afatin brenda të cilit pala e autorizuar mund të heqë dorë nga kontrata, ajo mund ta bëjë këtë gjithnjë gjersa të mos kalojë afati i caktuar për përmbushjen e detyrimit të saj. Kjo e drejtë e heqjes dorë nga kontrata mbaron edhe kur pala në favor të së cilës është kontraktuar, fillon t'i përmbush detyrimet nga kjo kontratë ose të pranojë përmbushjen nga pala tjetër.

Këto përcaktime ligjore parashihen me dispozita nga neni 70 i LMD-së.

Rrjedh se pendimi është mjet personal i sigurimit të ekzekutimit të kontratës, sepse ai premtohet por nuk jepet në momentin e lidhjes së kontratës. Është kontratë akcesore midis palve kontraktuese rreth kontratës kryesore dhe ndan fatin e saj. Pendimi kontraktohet me klauzol të veçantë në kontratë ose si kontratë e veçantë. Me pendim nënkuptohet premtimi i shumës së caktuar në të holla ose të ndonjë vlerë tjetër pasurore që do të paguaj njëra apo të dy palët përkatësisht ata që japin këtë shumë në rast të dorëheqjes së kontratës. Pala e cila i ka qëndruar besnik kontratës ka të drejtë të kërkoj nga pala tjetër pendesën pavarësisht nese ka pësuar dëm apo jo.

Për tu zbatuar rregullat e pendimit duhet të zbatohen disa kushte, në radhë të parë të lidhet kontrata me shpërblim, duhet të caktohet pendesa në momentin e lidhjes së kontratës për tërheqje nga

kontrata, duhet që pendesa të paguhet nga pala që tërheqet nga kontrata, duhet që pala e cila tërheqet nga kontrata të jep deklaratë për këtë dhe duhet ta bëjë këtë (tërheqjen) në afat të caktuar.

Kapari si pendim

LMD me dispozitën e nenit 71 paragraf 1 ka paraparë se: “kur bashkë me kaparin është kontraktuar e drejta e heqjes dorë nga kontrata, atëherë kapari konsiderohet si pendim dhe secila palë mund të heq dorë nga kontrata.

Me paragrafin 2 të nenit 71 të LMD-së, parashihet se: “në qoftë së heq dorë pala që e cila ka dhënë kaparin, kjo e humb atë, e në qoftë së heq dorë pala që e ka marrë kaparin, ajo e kthen të dyfishuar”.

Kushti penal

Kushti penal është mjet personal i sigurimit të ekzekutimit të kontratës. Ky mjet më së shumti përdoret në të drejtën kontraktore por edhe në të drejtat tjera. LMD kushtin penal e ka rregulluar me dispozitat nga neni 253 deri 260.

Kushti penal ekziston kur debitori dhe kreditori merren vesh që debitori të paguaj një shumë të caktuar të hollash ose të jap ndonjë vlerë tjetër pasurore në qoftë së nuk e përmbush detyrimin e vet ose atë e përmbush në mënyrë të parregullt. Kjo marrëveshje e debitorit dhe kreditorit është marrëveshje aksesore e tyre sepse lidhet pranë kontratës kryesore.

Sipas dispozitës së nenit 254 paragraf 1 të LMD-së, parashihet se: “palët kontraktuese mund ta caktojnë lartësinë e dëmit sipas vullnetit të tyre, në një shumë të përgjithshme, në përqindje ose për çdo ditë vonese, ose në ndonjë mënyrë tjetër”. Paragrafi 2 i nenit 254 përcakton se: “ajo duhet të jetë e kontraktuar në formën e parashikuar me kontratën nga e cila është krijuar detyrimi me të cilin ka të bëjë përmbushja”.

Aksesoriteti i kësaj kontrate nënkupton se e njëta e ndan fatin juridik të detyrimit me sigurimin e të cilës ka të bëjë.

Kreditori mund të mos kërkoj dënim kontraktuese në rast se mos përmbushja nga vonesa ka ndodhur për arsye për të cilën debitori nuk është përgjegjës.

Kur dënimi kontraktues është kontraktuar për rast të mos përmbushjes së detyrimit, kreditori mund të kërkoj ose përmbushjen e detyrimit ose dënimin kontraktues. Ai e humb të drejtën për të kërkuar përmbushjen e detyrimit, në qoftë së ka kërkuar pagimin e dënimin kontraktues. Kur dënimi është kontraktuar për rast të mos përmbushjes, debitori nuk ka të drejtë të paguaj dënimin kontraktues dhe të heq dorë nga kontrata, përveç nëse kjo ka qenë qëllimi i kontraktuesve kur e kanë kontraktuar dënimin.

Kur dënimi është kontraktuar për rastin kur debitori vonohet më përmbushjen, kreditori ka të drejtë të kërkoj edhe përmbushjen e detyrimit dhe dënimin kontraktues.

Kreditori nuk mund të kërkoj dënim kontraktues për shkak të vonesës, në qoftë së e ka pranuar përmbushjen e detyrimit e nuk ja ka komunikuar pa shtyerje debitorit të drejtën e tij në dënimin kontraktues.

Sipas dispozitës së nenit 258 të LMD-së, parashihet se: “grykëta me kërkesë të debitorit do të zvoglojë shumën e dënimin kontraktues në qoftë se gjen se ai është jo përpjestimisht i lartë, duke marrë parasysh vlerën dhe rëndësinë e objektit të detyrimit”.

Kreditori ka të drejtë të kërkoj dënimin kontraktues edhe kur shuma e tij e tejkalon lartësinë e dënimin që ai e ka pësuar si dhe kur nuk ka pësuar kurfarë dëmi. Në qoftë së dëmi të cilin e ka pësuar kreditori është me i madh nga sa është shuma e dënimin kontraktues, ai ka të drejtë të kërkoj diferencën deri në shpërblimin e plotë të dëmit.

Me dispozitën e nenit 260 të LMD-së, përcaktohet shpërblimi i caktuar me ligj dhe dënimin kontraktues duke përcaktuar se: “në qoftë se për mos përmbushjen e detyrimit ose për rastin e vonesës në përmbushjen, lartësia e shpërblimit e caktuar me ligj nën emërtimin e penaliteteve, dënimin kontraktues, shpërblimit ose në ndonjë emërtim tjetër, ndars palët kontraktuese megjithatë e kanë kontraktuar dënimin, kreditori nuk ka të drejtë të kërkoj njëkohësisht dënimin kontraktues dhe shpërblimin e caktuar me ligj, përveç nese kjo lejohet nga vet ligji”.

Është specifike së kushti penal nuk mund të kontraktohet për detyrimet në të holla, sepse për detyrimet në të holla mos ekzekutimi ose vonesa në ekzekutim, sipas rregullës krijon obligimin e pagimit të kamatës.

Dorëzania

Dorëzania është sigurim personal në qarkullimin juridik. Ajo është kontratë aksesore ngase lidhet bashkë me kontratën kryesore, me klauzol të veçantë në kontratën kryesore ose si kontratë e veçantë. Me kontratën mbi dorëzanimin obligohet dorëzani ndaj kreditorit se do ta përmbushë detyrimin e plotfuqishëm të debitorit të rrjedhur për pagesë, në qoftë se ky nuk e bën këtë.

Me kontratën mbi dorëzanimin obligohet dorëzani vetëm në qoftë se deklaratën mbi dorëzanimin e ka bërë me shkrim. Dorëzania mund të jepet për çdo detyrim të vlefshëm pavarësisht nga përmbajtja e tij. Mund të hyhet dorëzanimi edhe për detyrimin e kushtëzuar, si dhe për detyrimin e caktuar të ardhshëm. Dorëzania për detyrimin e ardhshëm mund të revokohet para se të lind detyrimi, në qoftë se nuk është parashikuar afati në të cilin ai duhet të lind. Dorëzania mund të jepet edhe për detyrimin e ndonjë dorëzanimi tjetër (dorëzani i dorëzimit).

Nga doktrina juridike, qëndrimet nga praktika gjyqësore dhe nga natyra e rregullimit të dorëzimit si mjet personal i sigurimit të ekzekutimit të kontratës rrjedh se kemi disa lloje të dorëzimit dhe atë dorëzani supsidiar, dorëzani pages, bashkëdorëzanimi, dorëzani i dorëzimit dhe dorëzani për shpërblimin e dëmit.

Detyrimi i dorëzimit nuk mund të jetë më i madh nga sa është detyrimi i debitorit kryesor, e në qoftë se është kontraktuar që të jetë më i madh, ai reduktohet në masën e detyrimit të debitorit. Dorëzimi përgjigjet për përmbushjen e krejt detyrimit për të cilin ka qenë dorëzimi, në qoftë se përgjegjësia e tij nuk është e kufizuar në ndonjë pjesë të tij, ose në ndonjë mënyrë tjetër i është nënshtruar kushteve më të lehta. Ai ka për detyrë t'i kompensojë shpenzimet e nevojshme që i ka bërë kreditori për arkëtimin e borxhit nga debitorit kryesor.

Dorëzimi përgjigjet edhe për çdo shtim të detyrimit i cili do të krijohej nga vonesa e debitorit ose për faj të debitorit, në qoftë se nuk është kontraktuar ndryshe. Ai përgjigjet vetëm për atë kamatë të kontraktuar e cila ka rrjedhur për pagesë pas lidhjes së kontratës mbi dorëzimin.

Në dorëzimin e cila e ka plotësuar kërkesën e kreditorit kalon kjo kërkesë me të gjitha të drejtat aksesore dhe me garancitë e përmbushjes së saj. Prej dorëzimit mund të kërkohej përmbushja e detyrimit vetëm pasi debitorit kryesor të mos e përmbush brenda afatit të caktuar në thirrjen e drejtuar me shkrim (dorëzania subsidiare). Mirëpo, kreditori mund të kërkojë përmbushjen nga dorëzimi megjithëse nuk e ka thirrur më përpara debitorin kryesor në përmbushjen e detyrimit, në qoftë se s'ka dyshim se prej mjeteve të debitorit kryesor nuk mund të realizohet përmbushja e detyrimit apo në qoftë se debitorit kryesor ka rënë në falimentim.

Në qoftë se dorëzimi është obliguar si dorëzim pagues, i përgjigjet kreditorit si debitorit kryesor për krejt detyrimin dhe kreditori mund të kërkojë përmbushjen e tij si nga debitorit kryesor ashtu edhe nga dorëzimi apo nga të dy njëkohësisht (dorëzania solidare). Dorëzimi për detyrimin e lindur nga kontrata në ekonomi përgjigjet si dorëzim pagues, në qoftë se nuk është kontraktuar diçka tjetër.

Me dispozitat nga neni 1017 parashihet solidariteti i dorëzimeve.

Disa dorëzime të një borxhi përgjigjen solidarisht, pavarësisht a kanë hyrë dorëzime bashkarishtë ose secili prej tyre ka marrë përsipër detyrimin ndaj kreditorit veç e veç, me përjashtim kur në kontratë përgjegjësia e tyre është rregulluar ndryshe. Në qoftë se debitorit e ka humbur të drejtën në afat të caktuar për përmbushjen e detyrimit të tij, kreditori megjithatë nuk mund të kërkojë përmbushjen nga dorëzimi para skadimit të këtij afati, në qoftë se nuk është kontraktuar ndryshe.

Në rastin e falimentimit të debitorit kryesor, kreditori ka për detyrë t'i lajmërojë kërkesat e veta në falimentim dhe për këtë gjë ta njoftojë dorëzimin, ndryshe i përgjigjet dorëzimit për dëmin të cilin do ta pësonte ky për këtë gjë.

Pakësimi i detyrimit të debitorit kryesor në procedurën e falimentimit ose në procedurën e kompensimit nuk pas sjell edhe pakësimin përkatës të detyrimit të dorëzimit, kështu që dorëzimi i përgjigjet kreditorit për krejt shumën e detyrimit të vet. Dorëzimi përgjigjet për krejt shumën e detyrimit për të cilën ka hyrë dorëzim edhe në rastin kur nga trashëgimtari i debitorit do të mund të kërkohej pagimi vetëm i asaj pjese të tij që i përgjigjet vlerës së pasurisë të trashëguar.

Me dispozitën nga neni 1021 parashihën kundërshtimet e dorëzimit. Dorëzimi mund të ushtroj kundër kërkesës së kreditorit të gjitha kundërshtimet e debitorit kryesor, duke përfshirë edhe prapësimin e kompensimit, por jo edhe kundërshtime të tjera thjesht personale të debitorit heqje dorë e debitorit nga kundërshtimet, si dhe njohja e tij e kërkesave të kreditorit, nuk ka efekt ndaj dorëzimit.

Dorëzimi mund të ushtroj kundër kreditorit edhe kundërshtimet e veta personale, për shembull, nulitetin e kontratës mbi dorëzimin, parashkrimin e kërkesave të kreditorit ndaj tij, prapësimin e kompensimit të kërkesave reciproke.

Në qoftë se debitori nuk përmbush detyrimin e vet në kohë, kreditori ka për detyrë që për këtë gjë ta njoftojë dorëzimin, përndryshe do t'i përgjigjet për dëmin të cilin dorëzimi do ta pësonte për këtë.

Dorëzimi shkarkohet nga përgjegjësia në qoftë se kreditori, me thirrjen e tij pas rrjedhjes për pagesë të kërkesës, nuk kërkon përmbushjen nga debitori kryesor brenda një (1) muaji nga data e kësaj thirrjeje. Kur afati i përmbushjes nuk është caktuar, dorëzimi shkarkohet nga përgjegjësia në qoftë se kreditori, me thirrjen e tij pas skadimit të një (1) viti nga lidhja e kontratës mbi dorëzimin, nuk bën brenda një (1) muaji nga data e kësaj thirrjeje deklaratë të nevojshme për caktimin e datës së përmbushjes.

Në qoftë se kreditori heq dorë nga pengu ose cilëndo e drejtë tjetër me të cilën ka qenë siguruar përmbushja e kërkesës së tij, ose e humb nga pakujdesia dhe në këtë mënyrë bën të pamundur kalimin e kësaj të drejte në dorëzimin, ky shkarkohet nga detyrimi i vet ndaj kreditorit për aq sa do të mund të fitonte nga ushtrimi i kësaj të drejte. Rregulla e paragrafit paraprak vlen si në rastin kur është fjala për të drejtën e lindur para lidhjes së kontratës mbi dorëzimin, ashtu edhe në rastin kur ka lindur pas kësaj.

E drejta për të kërkuar kompensimin nga debitori

Dorëzimi që ka përmbush detyrimin ndaj kreditorit, mund të kërkojë nga debitori t'i kompensojë të gjitha ato që i ka paguar në llogari të tij si dhe kamatën nga data e pagesës. Ai ka të drejtë në kompensimin e shpenzimeve të krijuara në konteste me kreditorin që nga momenti kur e ka njoftuar debitorin mbi këtë konteste, si dhe në shpërblimin e dëmit në qoftë se ka ekzistuar.

Dorëzimi i një prej disa debitorëve solidarë mund të kërkojë prej cilido prej tyre që t'i kompensojë aq sa i ka paguar kreditorit, si dhe shpenzimet. Edhe para se ta përmbush kërkesën e kreditorit, dorëzimi që është obliguar me dijen ose me pëlqimin e debitorit, ka të drejtë të kërkojë nga debitori t'i japë sigurim të nevojshëm për kërkesat e tij eventuale në rastet që vijojnë: në qoftë se debitori nuk e ka përmbushur detyrimin e vet në afatin e rrjedhjes për pagesë, po që se kreditori ka kërkuar në rrugë gjyqësore arkëtimin nga dorëzimi dhe në qoftë se gjendja pasurore e debitorit është keqësuar mjaft pas lidhjes së kontratës mbi dorëzimin.

Debitori mund të përdorë kundër dorëzanit, i cili pa dijen e tij ka bërë pagimin e kërkesës së kreditorit, të gjitha mjetet juridike me të cilat në momentin e kësaj pagese ka mundur të refuzojë kërkesën e kreditorit.

Dorëzani që ka paguar kërkesën e kreditorit, ndërsa për këtë gjë nuk e ka njoftuar debitorin, kështu që edhe ky në padijeni për këtë pagesë e ka paguar përsëri të njëjtën kërkesë, nuk mund të kërkojë kompensim nga debitori, por ka të drejtë të kërkojë nga kreditori që t'ia kthejë atë që ia ka paguar.

Dorëzani i cili pa dijen e debitorit e ka paguar kërkesën e kreditorit, e cila më pas me kërkesën e debitorit është anuluar ose shuar me anë të kompensimit, mund vetëm të kërkojë nga kreditori kthimin e pjesës së paguar.

E drejta e kompensimit nga dorëzanët tjerë

Kur ekzistojnë disa dorëzanë, ndërsa njëri prej tyre paguan kërkesën e rrjedhur për pagesë, ai ka të drejtë të kërkojë prej dorëzanëve të tjerë që secili prej tyre t'ia kompensojë pjesën që i takon atij. Me dispozita nga neni 1031 parashihet instituti i parashkrimit. Me parashkrimin e detyrimit të debitorit kryesor shuhet edhe detyrimi i dorëzanit.

Kur afati për parashkrimin e detyrimit të debitorit kryesor është më i gjatë se dy (2) vjet, detyrimi i dorëzanit parashkruhet pasi të kenë kaluar dy (2) vjet nga afati i rrjedhjes për pagesë të detyrimit të debitorit kryesor, përveç nëse dorëzani përgjigjet solidarisht me debitorin.

Ndërprerje e parashkrimit të kërkesave ndaj debitorit kryesor ka efekt edhe ndaj dorëzanit vetëm në qoftë se ndërprerja është shkaktuar nga ndonjë veprim i kreditorit para gjykatës kundër debitorit kryesor. Ngecja e parashkrimit të detyrimit të debitorit kryesor nuk ka efekt ndaj dorëzanit.

Marrëdhëniet që krijohen rreth kontratës së dorëzanisë kanë karakter pasuror dhe për këtë arsye zbatohen rregullat e parashkrimit. LMD me rregulla të detajuara ka paraparë të përkthyer si më lartë ka paraparë parashkrimin për këtë çështje.

PROCEDURA GJYQËSORE NË RASTET E KOMPENSIMIT TË DËMIT DHE KRITERET E VLERËSIMIT

Shkaktimi i dëmit dhe përgjegjësia e shkaktuesit të dëmit

Shkaktimi i dëmit paraqet njërin prej burimeve kryesore të së drejtës së detyrimeve. Dëmi mund të shprehet në forma të ndryshme në çdo fushë të së drejtës, tek marrëdhëniet juridiko civile, kontraktore, ekonomike etj, madje e drejta për shpërblimin e dëmit lind edhe jashtë marrëdhënieve juridiko-civile siç është rasti te dëmi i shkaktuar nga veprat penale, kundërvajtjet etj.

Me vetë faktin e shkaktimit të dëmit të të dëmtuarit, krijohet marrëdhënia e detyrimit dhe më këtë rast krijohet detyrimi i dëmtuesit për shpërblimin e dëmit të dëmtuarit²⁴¹. Detyrimet që lindin në

²⁴¹Dr. Nerxhivane Dauti, E drejta e detyrimeve, Pjesa e përgjithshme dhe e veçantë, Prishtinë, 2007, fq. 145.

bazë të shkaktimit të dëmit janë detyrime jo vullnetare sepse mungon vullneti i palëve për shkaktimin e dëmit²⁴². Në shumicën e rasteve shkaktimi i dëmit bëhet me veprime aktive pra dëmtuesi ndërmerr veprime për shkaktimin e dëmit e në disa raste abstenon nga kryerja e një veprimi të caktuar, në të dy rastet mund të rezultojë me shkaktim të dëmit.

Përveç dëmit që shkaktohet me veprim ose mosveprim, ekzistojnë raste kur një person ka shkaktuar dëmin e për atë përgjigjet ndonjë person tjetër, këto janë rastet e përgjegjësisë për të tjerët (prindërit për të miturit, personat juridik për organet e veta apo punëtorët e vet). Po ashtu, dëmin mund ta shkaktojnë edhe sendet, për këtë lloj dëmi përgjigjet përdoruesi apo pronari i sendeve.

Edhe në marrëdhënien juridike të krijuar nga shkaktimi i dëmit paraqiten dy palë, dëmtuesi (debitori) dhe i dëmtuari (kreditori). Ligji është baza kryesore juridike nga i cili i dëmtuari fiton të drejtën e shpërblimit të dëmit. Përveç ligjit, edhe kontrata është bazë juridike në të cilën pala e dëmtuar mund të thirret lidhur me të drejtën e shpërblimit të dëmit, në disa raste palët mundën me kontratë ta përcaktojnë edhe lartësinë e shpërblimit të dëmit e në raste tjera i drejtohen gjykatës për caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit i cili rrjedh nga mos përmbushja e kontratës.

Shkaqet e shkaktimit të dëmit dhe llojet e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar

Dëmi mund të shkaktohet në rrethana të ndryshme. Subjektet e së drejtës duhet të kujdesen për mënjanimin e rrezikut nga i cili mund të shkaktohet dëmi. Dëmi mund të shkaktohet nga sjelljet e njerëzve, nga sendet, nga veprimtaritë e rrezikshme dhe nga ngjarjet.

Shkaktimi i dëmit me veprimin e njerëzve

Personat fizikë dhe juridik janë subjekte potenciale për shkaktimin e dëmit. Dëmi i shkaktuar nga personat fizikë krijon përgjegjësinë subjektive. Këta subjekte mund të shkaktojnë dëm duke vepruar ose duke mosvepruar. Me veprim aktiv dëmi shkaktohet kur subjekti ndërmerr veprime të caktuara kurse me veprim pasiv dëmi shkaktohet kur subjekti i caktuar nuk ndërmerr veprim të caktuar²⁴³. Parimisht secili që shkakton dëm përgjigjet për veprimet e tij, përjashtimisht për dëmin e shkaktuar përgjigjet subjekti tjetër, këto raste janë të rregulluara në mënyrë të veçantë me dispozitat e LMD.

²⁴² Dr. Abdulla Aliu, E Drejta Civile, Pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2013, fq. 322.

²⁴³ Po aty, fq. 146.

Shkaktimi i dëmit nga sendet

Përveç subjekteve të së drejtës, edhe sendet mund të bëhen shkaktarë për shkaktimin e dëmit.

Në këtë rast kemi të bëjmë me sajimin e përgjegjësisë objektive e cila krijohet me vetë faktin e shkaktimit të dëmit. LMD parasheh që, *“për dëmin e shkaktuar nga sendet nga të cilat rrjedh rreziku i shtuar i dëmit për rrethin përgjigjet pavarësisht nga faji”*²⁴⁴.

Rregullat ligjore krijohen rreth njerëzve (personae), rreth sendeve (res) dhe rreth veprimeve (actiones)²⁴⁵, siç shihet, sendet paraqesin një rëndësi të veçantë në marrëdhëniet e detyrimeve. Ato mund të krijojnë, ndryshojnë apo edhe të shuajnë një marrëdhënie juridike të karakterit detyrimor.

Për dëmin e shkaktuar nga sendet përgjigjet zotëruesi i tij²⁴⁶, ky është një rregull parimore që parasheh përgjegjësinë e pronarit për dëmin e shkaktuar nga sendi i tij, mirëpo ka raste kur dikush me sendin që nuk është pronë e tij shkakton dëm, në këtë rast përgjigjet poseduesi qoftë me mirëbesim apo keqbesim. Po ashtu mund të ndodhë që pronarit i është marrë sendi në mënyrë të kundërligjshme, në këtë rast në qoftë se pronarit i është marrë sendi i rrezikshëm në mënyrë të kundërligjshme, për dëmin që rrjedh nga kjo, nuk përgjigjet ai, por ai që ia ka marrë sendin e rrezikshëm, në qoftë se pronari nuk është përgjegjës për këtë²⁴⁷

Dëmi mund të shkaktohet edhe nga mjetet motorike të cilat konsiderohen sende të rrezikshme mirëpo të rëndësishë së veçantë ekonomike. Zhvillimi i madh tekniko teknologjik dhe ekonomik ka bërë që edhe rregullat e sigurimit nga përgjegjësia të zhvillohen shumë. Rastet më të shpeshta të shkaktimit të dëmit nga sendet konsiderojmë së janë rastet e shkaktimit të dëmit nga mjetet motorike (veturat) dhe për këtë arsye sigurimi i autopërgjegjësisë është i detyrueshëm për pronarët dhe për shfrytëzuesit e automjeteve²⁴⁸.

Për dëmin e shkaktuar nga mjetet motorike në lëvizje mund të përgjigjet një person nëse ai është fajtor, dy e më shumë persona nëse faji është i dyanshëm, në qoftë se nuk ka fajësi, në asnjërin anë, atëherë pronarët përgjigjen në pjesë të barabarta. E për dëmin që u shkaktohet personave të tretë, pronarët përgjigjen solidarisht²⁴⁹

²⁴⁴ Neni 136, paragrafi 2 i LMD

²⁴⁵ Geoffrey Samuel. PhD, Law of Obligations and Legal Remedies, Second Edition, London, 2001, fq. 113.

²⁴⁶ Neni 155 i LMD

²⁴⁷ Neni 156 i LMD

²⁴⁸ Ligji Nr.04/L-018 Për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, neni 3.

²⁴⁹ Neni 159 i LMD.

Shkaktimi i dëmit nga veprimtaritë e rrezikshme

Shkaktimi i dëmit nga veprimtaritë e rrezikshme për dallim nga llojet e tjera të shkaktimit të dëmit, mund të konsiderohet më i vonshëm në aspektin kohor kjo për shkak se zhvillimi i teknologjisë lidhet me shekullin IX dhe XX. Rëndësia e madhe ekonomike dhe varësia e ekonomisë nga këto mjete dhe veprimtari e arsyeton shfrytëzimin e tyre, pa marrë parasysh shkallën e dëmit që mund të shkaktojnë. Dëmi i shkaktuar nga veprimtaritë e rrezikshme duhet të shpërblehet. Në rastet kur kemi dëm të shkaktuar nga sendet e rrezikshme, përgjigjet pronari i sendit, kurse për dëmin e shkaktuar nga veprimtaritë e rrezikshme, përgjigjet personi që merret me atë veprimtari²⁵⁰.

Ky rregull është parimor - parimisht pronari i sendit të rrezikshëm përgjigjet për dëmin e shkaktuar nga sendet e rrezikshme. Ky rregull ndryshon atëherë kur sendi i rrezikshëm është në shfrytëzim të një personi të tretë si në huapërdorje apo qira. Po ashtu, përjashtim paraqet edhe rasti kur dëmi shkaktohet nga sendi me të meta, i prodhuar më të meta - në këtë rast përgjigjet prodhuesi²⁵¹.

Rrezikshmëria mund të jetë rezultat i sendeve që përdor subjekti, i mjeteve të transportit, i mjeteve të prodhimit, makinerive, pajisjeve, i energjisë që shfrytëzon subjekti për të vënë në lëvizje këto mjete (energji elektrike, termike, bërthamore, etj.), i llojit të veprimtarisë që kryen ai e të tjera²⁵². Rrezikshmëria në një nga format e përmendura mund të drejtohet kundër njerëzve, pasurisë, kafshëve, bimëve, mallrave e të tjera²⁵³.

Për të ekzistuar përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga sendet e rrezikshme dhe veprimtaritë e rrezikshme, duhet të plotësohen disa kushte. Shkurtimeisht do t'i shtjellojmë një nga një.

Kushti i parë ka të bëjë më ekzistencën e dëmit. Pa ekzistencën e dëmit nuk mund të ekzistojë përgjegjësia për shpërblimin e tij²⁵⁴. Ky është kushti themeltar dhe i cili paraqitet te të gjitha llojet e dëmit. Pa ekzistimin e dëmit as që bëhet fjalë për krijimin e marrëdhënies juridike respektivisht lindjen e obligimit për shpërblimin e dëmit. Në marrëdhëniet juridiko-civile të krijuara me shkaktimin e dëmit nuk ekziston tentativa, pra për veprimin i cili ka mbetur në tentative nuk përgjigjet askush.

Kushti i dytë që duhet plotësuar është që dëmi të shkaktohet nga sendi i rrezikshëm apo nga veprimtaria e rrezikshme. Ky është kusht që e karakterizon vetëm këtë lloj të përgjegjësisë. Disa sende janë të rrezikshme sipas vetë pozitës që kanë, disa janë të rrezikshme për nga përbërja, e disa sipas vetive që kanë, kurse veprimtari e rrezikshme është ajo veprimtari nga e cila krijohet rreziku për dëmin dhe është burim i rrezikut të shtuar²⁵⁵.

²⁵⁰Neni 155 i LMD

²⁵¹Neni 160 i LMD.

²⁵² Dr. Mariana Tutulani-Selimi, E drejta e detyrimeve dhe e Kontratave, Tiranë, 2006, fq. 275

²⁵³ Po aty, fq. 275

²⁵⁴ Po aty, fq. 253.

²⁵⁵ Dr. Nerxhivane Dauti, E drejta e detyrimeve, Pjesa e përgjithshme dhe e veçantë, Prishtinë, 2007, fq. 168.

Kushti i tretë dhe jo më pak i rëndësishëm është lidhja kauzale midis veprimit të kundërligjshëm dhe dëmit të shkaktuar²⁵⁶. Edhe ky është një kusht i përgjithshëm që përsëritet te të gjitha llojet e dëmit-përgjegjesisë.

Kushti i katërt është veprimi i kundërligjshëm. Edhe veprimin e kundërligjshëm e gjejmë te të gjitha llojet e përgjegjesisë civile. Veprimi i kundërligjshëm është ai veprim njerëzor me anë të të cilit cenohet ndonjë normë juridike, ose ndonjë normë e moralit njerëzor²⁵⁷. Ka raste kur dëmi shkaktohet, ekziston lidhja kauzave, mirëpo mungon veprimi kundërligjor. Për të ekzistuar përgjegjësia juridiko civile për sendet apo veprimtaritë e rrezikshme, duhet që të gjitha kushtet të plotësohen kumulativisht.

Nga kushtet e përmendura shohim se nuk figuron faji si kusht që duhet plotësuar në këtë rast, kjo sepse për dëmin që shkaktohet nga sendet e rrezikshme dhe veprimtaritë e rrezikshme nuk kërkohet që të vërtetohet faji, për këtë arsye edhe quhet përgjegjësi pa faj - objektive. Në këto raste gjykata vërteton rrezikshmërinë e sendit apo veprimtarisë dhe sigurisht kushtet tjera që i përmendëm më sipër.

Shkaktimi i dëmit nga ngjarjet natyrore

Dëmi i shkaktuar nga ngjarjet natyrore paraqitet në forma të ndryshme. Rastet më të shpeshta të shkaktimit të dëmit nga ngjarjet natyrore janë vërshimet, temperaturat e larta, zjarret, reshjet e mëdha të borës, ortekët, tërmetet, stuhitë etj.

Në disa prej tyre, tërthorazi mund të ketë përgjegjësi edhe individi, p.sh. te zjarret, nga pakujdesia hedh cigaren në një vend të thatë dhe të ekspozueshëm rrezeve të diellit. Pastaj, edhe te vërshimet, vetë individi dhe institucionet mund të kenë peshën e tyre të fajit, duke mos ndërmarrë masa paraprake për mënjanimin e dëmit.

Nëse shkaktohet dëmi nga ndonjëri prej rasteve të mësipërme, atëherë themi se dëmi është shkaktuar nga fuqia madhore (vis maior) dhe në këto raste kemi përjashtim të përgjegjesisë për dëmin e shkaktuar. Nëse provojmë të definojmë fuqinë madhore atëherë duhet të ndalemi tek elementet që e karakterizojnë atë. Fuqia madhore është ngjarje e jashtme që nuk është paraparë, ose që nuk mund të parashihet saktësisht se kur do të ndodhë dhe që nuk mund të përballohet ose të shmanget²⁵⁸.

²⁵⁶ Po aty, fq. 154.

²⁵⁷ Po aty, fq. 156.

²⁵⁸Dr. Nerxhivane Dauti, E drejta e detyrimeve, Pjesa e përgjithshme dhe e veçantë, Prishtinë, 2007, fq. 163.

Dëmi, kuptimi dhe llojet e dëmit

Secili person ka për detyrë të përmbahet nga veprimi që mund t'i shkaktoj dëm tjetrit²⁵⁹. Kjo paraqet një rregull parimor të përcaktuar nga LMD, mirëpo jo gjithmonë respektohet nga subjektet e së drejtës. Shkaktimit të dëmit nuk i paraprinë ekzistenca e ndonjë marrëdhënieje juridike. Në këto raste kemi të bëjmë me shkaktimin e dëmit nga veprimet e ndaluara respektivisht deliktet. Detyrimi për zhdëmtimin e dëmit mund të rrjedh edhe nga kontrata: kontraktuesi që nuk përmbushë detyrimet që rrjedhin nga kontrata, është përgjegjës për dëmet që mospërmbushja i ka shkaktuar kontraktuesit tjetër²⁶⁰.

Në këtë rast paraprakisht ekziston një kontratë dhe nga mos përmbushja apo përmbushja jo e rregullt e saj i shkaktohet dëm palës tjetër kontraktuese, atëherë në këto raste si parakusht për ekzistimin e dëmit është ekzistimi i kontratës valide. Çdo mosrespektim apo cenim i kontratës, palës së dëmtuar i jep të drejtën ligjore për shpërblimin e dëmit. Në rastin e parë kemi të bëjmë më përgjegjësinë deliktore kurse në rastin e dytë kemi të bëjmë më përgjegjësinë kontraktore.

Dëmi paraqet njërin prej burimeve materiale kryesore të së drejtës së detyrimeve. Rastet e shumta të marrëdhënieve juridike që krijohen me faktin e shkaktimit të dëmit, bëjnë që rregullat e këtij burimi juridik të jenë në numër të madh. Nga kjo arsye nëse dëmin provojmë ta definojmë vetëm nga aspekti juridik, sigurisht se ai definicion nuk do të ishte i plotë, prandaj definicioni i plotë i dëmit ka karakter juridik dhe ekonomik.

Në kuptimin ekonomik, dëmi është humbje e pasurisë, pa marrë parasysh mënyrën e humbjes. Kurse, në kuptimin juridik, dëmi është humbje e të mirave të cilat juridikisht janë të mbrojtura²⁶¹. Kuptimi ekonomik i dëmit është më i gjer sepse përfshin të gjitha llojet e dëmit pa marrë parasysh a janë të mbrojtura juridikisht ato të mira apo jo, kurse kuptimi juridik është diçka më i ngushtë sepse përfshin vetëm ato të mira që janë juridikisht të mbrojtura.

Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (*dëm i zakonshëm*) dhe pengimi i rritjes së saj (*fitim i humbur*), si dhe shkaktimi i dhimbjes fizike tjetrit, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jomaterial)²⁶². Ky është një definicion ligjor i përcaktuar nga LMD dhe është pothuajse më i kompletuari, megjithatë me dispozitën e nenit 188 paragrafi 1, i LMD përcaktohet se: “*Për dhembjet e pësuarara fizike, për dhembjet e pësuarara shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të drejtave të personalitetit, të vdekjes se personit të afërm, si dhe frikës,*”.

Nga definicionet e paraqitura më sipër vërejmë se ka ndryshime mirëpo në qëllim dhe përmbajtje nuk paraqesin vështirësi në zbatimin praktik.

²⁵⁹ Neni 9 i LMD

²⁶⁰ Francesco Galgano, E Drejta Private, Tiranë, 2006, fq. 418

²⁶¹ Dr. Nerxhivane Dauti, E drejta e detyrimeve, Pjesa e përgjithshme dhe e veçantë, Prishtinë, 2007, fq. 151

²⁶² Neni 137 i LMD

Llojet e dëmit

Dëmi është dy llojesh, ai material (pasurorë) dhe jomaterial (moral). Kjo ndarje bëhet duke marrë parasysh karakterin e të mirave, të cilave u është shkaktuar dëmi. Këto janë dy llojet e dëmit të paraparë edhe më LMD.

Një tjetër ndarje e dëmeve mund të jenë edhe dëmet apo humbjet në para, që thjeshtë janë humbje financiare, dhe dëmet apo humbjet jo në para, që do të thotë humbjet e tjera përveç atyre në para. Shembull i humbjeve financiare do të ishte humbja e të ardhurave si rezultat i dëmit etj. Humbjet (dëmet) jo në para përfshijnë dhimbjet dhe vuajtjet pas një lëndimi dhe ajo që quhet prishje e komoditetit, që do të thotë humbja e aftësisë për ta shijuar jetën si me parë²⁶³.

Dëmi material

Dëm material është kur të dëmtuarit i dëmtohet një send, apo nga dëmtimi ai send bëhet jofunksional, apo edhe i zhduket krejt. Pastaj, dëm material kemi edhe atëherë kur të dëmtuarit i shkaktohet lëndim trupor apo i vdes ndonjë i afërm, po ashtu edhe kur dikush përhap fakte të pavërteta për të dëmtuarin apo cenon dinjitetin e tij.

Subjektet e së drejtës çdo ditë ballafaqohen me rreziqe të cilat mund të rezultojnë me shkaktim të dëmit. Këto rreziqe mund të cenojnë drejtpërdrejt bazën materiale të të dëmtuarit, shëndetin, të afërmit e tij, etj. Nga kjo arsye e ballafaqimit të përditshëm me rreziqe të ndryshme edhe kanë lindur shoqata, fonde e kompani të ndryshme të cilat si detyrë kryesore kanë sigurimin e rrezikut me qëllim që dëmi i shkaktuar personit të jetë sa më i vogël dhe shpërblimi i dëmit për subjektin të jetë sa më i plotë.

Llojet më të shpeshta të dëmit material që njohin shumica e të drejtave janë; dëmi i vërtetë (damnumemergens), fitimi i munguar (lucrumcessans), dëmi abstrakt, dëmi konkret, dëmi i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë, dëmi ekzistues dhe i ardhshëm, dëmi i paraparë dhe jo i paraparë etj.

Llojet e mësipërme të dëmit material nuk do të thotë që përfshinë të gjitha llojet e mundshme të dëmit. Teoria juridike njeh edhe dëmet personale (sa për emër), ky lloj i dëmit shpërblehet atëherë kur padia aprovohet, por paditësi nuk ka pësuar ndonjë humbje²⁶⁴. Paditësi në këtë rast do të shpërblehet me një shumë simbolike, që ka për qëllim t'i tregojë publikut të gjerë se paditësi e ka fituar rastin²⁶⁵. Një shembull i tillë paraqitet te rastet e shpërblimit të dëmit jomaterial për personin jurduik.

²⁶³Catherine Elliott & Frances Quinn, Tort Law, Seventh Edition, London, 2009, fq. 392

²⁶⁴Vivienne Harpwood, Modern Tort Law, Seventh Edition, London and New York, 2009, fq. 423

²⁶⁵Po aty, fq. 423

Pastaj, një lloj tjetër i dëmit që shtjellohet nga shkenca juridike është edhe dëmi i kompensueshëm. Shumica e dëmeve janë të destinuara që të jenë të kompensueshme - qëllimi është që paditësi (*i dëmtuari*) të shpërblehet për humbjet e pësuar. Nëse dëmi mund të llogaritet saktësisht, atëherë ai përshkruhet si dëm special, kurse llojet tjera të dëmeve të cilat nuk mund të llogariten saktë financiarisht, quhen dëme të përgjithshme. Në këtë lloj përfshihen dhimbjet dhe vuajtjet, shqetësimet, frika etj²⁶⁶.

Dëmi i vërtetë (damnumemergens)

Dëmi i vërtetë paraqet llojin kryesor të dëmit material.

Edhe LMD e parasheh këtë lloj të dëmit dhe atë e emërton si dëm i zakonshëm – zvogëlim i pasurisë së dikujt²⁶⁷. Përveç emërtimit dëm i vërtetë, për këtë lloj të dëmit përdoren edhe emërtimet si dëm i thjeshtë, dëm i zakonshëm, dëm në kuptimin e ngushtë, dëm pozitiv etj.

Për ta kuptuar më lehtë dëmi i vërtetë apo i zakonshëm është ajo vlerë pasurore apo dallimi që ekziston midis pasurisë së të dëmtuarit para shkaktimit të dëmit dhe pas tij. Pra, në lartësinë e atij dallimi është varfëruar i dëmtuari. Ky lloj dëmi mund të haset në të gjitha lëmit e së drejtës; në lëmin e së drejtës kontraktore, në lëmin e së drejtës së punës, në lëmin e së drejtës administrative, në lëmin e së drejtës penale etj.

Fitimi i munguar (lucrumcessans)

Fitimi i munguar paraqet një lloj të dëmit material shumë të pranishëm në praktikën gjyqësore. Ligji i ri për marrëdhëniet e detyrimeve përdor emërtimin fitimi i humbur dhe e definon si pengim i rritjes së pasurisë së dikujt²⁶⁸.

Ky lloj i dëmit pothuajse në të gjitha rastet paraqitet bashkë me ndonjë lloj tjetër të dëmit material dhe zakonisht shpërblehet kumulativisht me llojin tjetër të dëmit. Zakonisht fitimi i munguar shkaktohet atëherë kur dëmi ka të bëjë më vetë subjektin e së drejtës dhe nga ky dëm subjektin i është vështirësuar ose i është pamundësuar realizimi i të hyrave të zakonshme. Dhe, rasti tjetër jo më pak i shprehur është kur dëmi shkaktohet në mjetin e punës. Edhe në këtë rast vështirësohet apo pamundësohet ushtrimi i veprimtarisë ekonomike për subjektin që rezulton me humbje ekonomike respektivisht fitimin e munguar.

Fitimi i munguar sidomos është shumë më i shprehur te marrëdhëniet tregtare, kur subjektet ekonomike me veprimet e tyre jolojale shkëlin rregullat e konkurrencës

²⁶⁶ Po aty, fq. 423-424

²⁶⁷Neni 137 i LMD

²⁶⁸ Neni 137 i LMD.

Dëmi konkret

Është lloj i dëmit material. Bëhet fjalë për këtë lloj të dëmit material atëherë kur subjektet e së drejtës dëmin e shkaktuar e shprehin në të holla sipas vlerës së tregut të sendit të dëmtuar. Kjo mënyrë e llogaritjes së dëmit konsiderohet si mënyrë konkrete e llogaritjes së dëmit.

Një formë e tillë e llogaritjes së dëmit sot është shumë e shprehur te kompanitë e sigurimeve. Për çdo formë të paraqitjes së dëmit e sidomos dëmit material, këto institucione shpërblimin apo vlerën e dëmit e shprehin në të holla, duke e krahasuar me vlerën e tregut.

Dëmi abstrakt

Dëmi abstrakt është një lloj dëmi material që caktohet në mënyrë abstrakte²⁶⁹. Caktohet qoftë në shumë paushallë, qoftë me përqindje. Ky lloj i dëmit material më së shumti vjen në shprehje të marrëdhëniet tregtare sepse këto marrëdhënie dhe vetë dinamika e zhvillimit ekonomik nuk përkojnë shumë me procedurat dhe formalitetet deri në shpërblimin e plotë të dëmit dhe për këtë arsye subjektet ekonomike shpesh në formë paushalli parashohin lartësinë e dëmit që në të vërtetë ende nuk është shkaktuar.

Dëmi i drejtpërdrejtë

Dëmi i drejtpërdrejtë është ai dëm i cili rezulton direkt nga veprimi antijuridik i dëmtuesit.

Kjo do të thotë se dëmi i shkaktuar është rezultat i veprimit konkret antijuridik dhe jo edhe ndonjë rrethanë tjetër e cila ka mundur të ndikojë në shkaktimin e dëmit. P.sh. vozitësi në kushte normale të vozitjes, nga pakujdesia e tij shkel këmbësorin duke kaluar rrugën në vendin e paraparë.

Në këtë rast nuk kanë ndikuar rrethanat e tjera që kanë çuar deri te aksidenti siç kanë mundur të jenë lagështia e rrugës, dukshmëria e zvogëluar, kalimi i rrugës së këmbësorit në vendin e paraparë etj. por ekskluzivisht pakujdesia e vozitësit duke mos iu përshtatur kushteve të vozitjes. Ky lloj i dëmit shkakton humbje të drejtpërdrejtë të pasurisë së subjektit të së drejtës i cili rezulton nga një dëmtim fizik, nga shkatërrimi i pasurisë së subjektit etj. Ky lloj i dëmit quhet edhe humbje e drejtpërdrejtë dhe në këtë rast kemi lidhjen shkak – pasojë.

Dëmi i tërthortë

Me dëm të tërthortë kuptojmë dëmtimin e vlerave apo shkaktimin e humbjeve të dëmtuarit nga veprimi antijuridik i dëmtuesit, i cili rezulton nga një veprim apo sjellje paraprake. Në këtë rast, përveç dëmit kryesor, si rrjedhojë mund të paraqiten edhe dëme të tjera nga po i njëjti veprim p.sh. si dëm i tërthortë konsiderohet edhe fitimi i munguar, sepse në këtë rast kemi dëmin e

²⁶⁹Dr. Nerxhivane Dauti, E drejta e detyrimeve, Pjesa e përgjithshme dhe e veçantë, Prishtinë, 2007, fq. 153

drejtpërdrejtë i cili shkaktohet nga veprimi i dëmtuesit dhe si rrjedhojë paraqitet edhe dëmi i tërthortë. P.sh. nëse një taksisti i shkatërrohet mjete i punës, në këtë rast e kemi edhe dëmin e drejtpërdrejtë, pra shkatërrimin e mjetit dhe dëmin e tërthortë apo fitimin e munguar i cili është pamundësia e realizimit të të hyrave me mjetin e punës.

Shembull tjetër mund të jetë edhe humbja e qirasë për shkak të dëmtimit apo shkatërrimit të pronës apo të mirave të dhëna më qira. Humbjet e tërthorta hasen edhe si shpenzime të pashmangshme shtesë që bën pronari i një biznesi. P.sh. për të rimëkëmbur një lokal të goditur nga një grindje, konflikt, sulm terrorist etj, për të mos humbur klientelën, për të vijuar biznesin etj. Shpeshherë, siguruesit ngurrojnë të sigurojnë dëmin e tërthortë (consequentialloss), andaj ndodh që në një policë sigurimi të haset klauzola e “përjashtimit të mbulimit të humbjeve të tërthorta”. Këtu kemi lidhjen shkak – rrjedhojë e pasojës²⁷⁰.

Demit jomaterial

Shpërblimi i dëmit të shkaktuar, shpeshherë përfshinë përveç dëmit material edhe dëmin jomaterial, apo moral. Dëmi jomaterial zakonisht shkaktohet kur cenohen të drejtat e personalitetit, siç janë: jeta e njeriut, liria e lëvizjes dhe fjalës, integriteti trupor, nderi dhe reputacioni dhe të gjitha të mirat tjera jopasurore që lidhen me personalitetin e njeriut dhe që garantohen nga rendi juridik i çdo vendi. Kështu edhe LMD ka paraparë shpërblimin e dëmit ndaj personave fizik, përveç kur i cenohen të drejtat e karakterit pronësor, edhe me rastin e cenimit të vlerave personale.

Në kuadër të vlerave personale të personit fizik, për të cilat ligji në fjalë garanton të drejtën e shpërblimit të dëmit material dhe jomaterial, në rast cenimi të tyre, përfshihen: Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës.²⁷¹

Gjithashtu, ngjashëm sikurse për personat fizik, këto të drejta u garantohen edhe personave juridik, me përjashtim të të drejtave personale të karakterit biologjik të cilat vlejnë vetëm për personat fizik. Kjo, pasi, në praktik ndodhë shpesh herë që edhe personave juridik tu cenohet emri i mirë apo reputacioni.²⁷²

Kompensimi i dëmit, llojet e kompensimit

Shpërblimi i dëmit paraqet pjesën më të rëndësishme tek shkaktimi i dëmit si burim material. Pjesa e parë merret me konstatimin e ekzistimit të dëmit, verifikimi se a janë plotësuar kushtet ligjore për ekzistimin e dëmit, kushtet e përgjegjësisë etj. Pastaj fillon pjesa e cila shtjellon shpërblimin e dëmit që është më e rëndësishmja në tërë këtë proces. LMD nga neni 136 e deri tek neni 168

²⁷⁰Ilir Hoti, *Industria e Sigurimeve dhe Menaxhimi i Rrezikut*, Tiranë, 2008, fq. 10-11

²⁷¹ Neni 183 i LMD-së.

²⁷² Neni 187 i LMD-së.

parasheh çështjet që kanë të bëjnë me bazën e përgjegjësisë, përgjegjësinë për tjetrin, përgjegjësinë e punëdhënësit për punëmarrësin, përgjegjësinë nga sendet dhe veprimtaritë e rrezikshme, përgjegjësinë për mjetet motorike, përgjegjësinë për të metat e produkteve etj. Kurse nga neni 169 e deri të neni 193 rregullon çështjet që kanë të bëjnë me shpërblimin e dëmit siç janë: shpërblimi i dëmit material, vëllimin e shpërblimit, shpërblimin e dëmit material në rast vdekjeje, lëndimit trupor dhe dëmtimit të shëndetit, shpërblimin e dëmit jomaterial etj.

Për t'u shpërblyer dëmi i shkaktuar nga dëmtuesi, duhet të ketë një vendim gjyqësor të plotfuqishëm, ujdj gjyqësore apo të paktën një pajtim të të dëmtuarit dhe dëmtuesit për dëmin e shkaktuar, lartësinë e shpërblimit të tij dhe formën e shpërblimit.

Është temë diskutimi në teorinë e së drejtës se kur krijohet detyrimi i shpërblimit të dëmit, në momentin e shkaktimit të dëmit apo pas marrjes së vendimit gjyqësor të plotfuqishëm. LMD pranon momentin e parë ashtu që detyrimi i shpërblimit të dëmit konsiderohet se ka arritur, për pagesë që nga momenti i shkaktimit të dëmit²⁷³.

Bazën ligjore kryesore ku çdo kërkesë për shpërblimin e dëmit dhe çdo vendim gjyqësor në lidhje me kërkesën duhet të mbështetet në të e gjejmë në dispozitat e LMD-së. Fillimisht është dispozita parimore ajo e cila obligon çdo person të përmbahet nga veprimi që mund t'i shkaktojë dëm tjetrit²⁷⁴. Pastaj për të vazhduar me dispozitat ligjore kryesore nga neni 136 e deri të neni 193 të cilat rregullojnë shkaktimin e dëmit dhe shpërblimin e dëmit.

Përveç këtyre dispozitave kemi edhe shumë dispozita tjera ligjore si nga e drejta kontraktore (kontratat), pasurimi pa bazë, gjerimi i punëve të huaja pa porosi etj, që në raste të caktuara i referohen dispozitave për shpërblimin e dëmit. Po ashtu kemi edhe dispozita ligjore të fushave të ndryshme që kanë të bëjnë me shkaktimin e dëmin. P.sh. në marrëdhëniet e punës²⁷⁵, tek mbrojtja e konsumatorit, tek e drejta e autorit, e tek shumë e shumë fusha tjera.

Nocioni dhe qëllimi i shpërblimit të dëmit

Me shpërblim të dëmit kuptojmë detyrimin ligjor të dëmtuesit që të bëjë shpërblimin e dëmit për të dëmtuarin. Ky detyrim buron nga dispozitat ligjore të LMD e po ashtu edhe nga dispozitat tjera që kanë të bëjnë me shpërblimin e dëmit. Domethënia esenciale e këtij obligimi konsiston në çështjen që dëmtuesi duhet të bëjë riparimin e dëmit me anë të shpërblimit që të krijojë atë gjendje e cila ekzistonte para kryerjes së veprimit të dëmshëm²⁷⁶.

²⁷³ Neni 170 i LMD.

²⁷⁴ Neni 9 i LMD

²⁷⁵ Ligji i Punës i Republikës së Kosovës Nr.03/L-212, Gazeta Zyrtare Nr.90, datë 01.12.2010, dhe i cili ka hyrë në fuqi më datë 16.12.2010, në nenin 63, 64, 65 dhe 66 parasheh shpërblimin e dëmit nga i punësuar, shpërblimin proporcional, shpërblimin e dëmit për punëdhënësin dhe shpërblimin sipas dispozitave tjera të aplikueshme.

²⁷⁶ Dr. Mehdi Hetemi, E Drejta me Njohuritë Themelore të së Drejtës Afariste, Prishtinë, 2002, fq. 281

Për shpërblimin e dëmit nevojitet që i dëmtuarit të veprojë respektivisht të vë në lëvizje procedurën civile duke ushtruar kërkesë për shpërblimin e dëmit, në këtë rast po flasim për procedurën e rregullt ligjore sepse në jetën e përditshme shumë dëme shkaktohen dhe shumë shpërblime bëhen pa filluar fare procedura civile.

Nëse i dëmtuari nuk ushtron kërkesë për shpërblimin e dëmit atëherë dëmi i shkaktuar mbetet pa u shpërblyer sepse procedura civile për shpërblimin e dëmit nuk inicohet sipas detyrës zyrtare.

Për të ardhur deri të shpërblimi i dëmit duhet të ndodhin disa fakte paraprakisht. Fillimisht duhet të ndodhë dëmi nën kushtet ligjore të parapara, pastaj të pasojë me veprimin juridik të palës së dëmtuar që është ushtrimi i kërkesës dhe nga e gjithë kjo të rezultojë vendimi gjyqësor për shpërblimin e dëmit dhe krejt në fund veprimet konkrete rreth shpërblimit të dëmit siç janë rivendosja e gjendjes fillestare nëse është e mundur, riparimi, shpërblimi në të holla etj.

Qëllimi i shpërblimit të dëmit si në të drejtën tonë ashtu edhe në të drejtat tjera është i njëjtte. Nëse vështrojmë rrjedhën e dispozitave ligjore të LMD-së për shpërblimin e dëmit, fillimisht parashihet detyrimi i personit përgjegjës për rivendosjen e gjendjes e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi²⁷⁷, pra qëllim primar i shpërblimit të dëmit është rivendosja e gjendjes para shkaktimit të dëmit.

Pastaj nëse kjo nuk është e mundur e që zakonisht është e pamundur të bëhet rikthimi i plotë i gjendjes së mëparshme, atëherë personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë shpërblim në të holla²⁷⁸. Pra siç shihet LMD përparësi i ka dhënë shpërblimit të dëmit në natyrë e pastaj shpërblimit të dëmit në të holla edhe pse në praktikën gjyqësore shumë më shumë zbatohet shpërblimi i dëmit në të holla.

Kompensimi i dëmit material

Me shpërblim të dëmit material nënkuptojmë tërësinë e veprimeve juridike-procedurale që ndërmerr i dëmtuari për të realizuar shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga dëmtuesi. Pra siç shihet këtu duhet të kemi së paku dy subjekte, pastaj duhet të jetë shkaktuar dëmi dhe në fund veprimet procedurale juridike të palës së dëmtuar.

LMD njeh dy mënyra të shpërblimit të dëmit. Mënyra e parë e shpërblimit është kthimi në gjendjen e mëparshme. Nëse kjo nuk është e mundur apo nuk mund të kthehet në tërësi gjendja e mëparshme atëherë pason shpërblimi i dëmit material në të holla.

²⁷⁷ Neni 169 paragrafi 1 i LMD

²⁷⁸ Neni 169 paragrafi 2 i LMD

Shpërblimi i dëmit në natyrë

Shpërblimi i dëmit në natyrë bëhet me kthimin e sendit në atë gjendje në të cilën ka qenë para se të shkaktohet dëmi²⁷⁹ respektivisht kthimi i gjendjes së të dëmtuarit para momentit të shkakimit të dëmit. Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve këtë formë të shpërblimit të dëmit e parasheh si parësore dhe vetëm atëherë kur një gjë e tillë nuk është e mundur apo nuk mund të bëhet kthimi i gjendjes në tërësi aplikohet shpërblimi i dëmit në të holla.

Shpërblimi i dëmit në natyrë në raste të caktuara mund të bëhet si i vetëm, në raste të caktuara bashkë edhe më shpërblimin në të holla, e në raste të caktuara mund të përjashtohet në tërësi nëse këtë e kërkon kreditori sepse kjo formë e shpërblimit të dëmit bëhet në interes të kreditorit dhe si detyrim për debitorin.

Edhe në të drejtën e sigurimeve shpërblimi i dëmit material në natyrë është i shpeshtë, duke mos përjashtuar këtu edhe formën tjetër të shpërblimit të dëmit e cila çdo ditë e më tepër po gjen përkrahje më të madhe.

E drejta jonë pozitive parasheh që personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi²⁸⁰ gjendje kjo që nënkupton si gjendjen materiale qoftë ndonjë ndreqje, riparim apo zëvendësim të sendit, ashtu edhe gjendjen financiare. Në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë shpërblim në të holla²⁸¹. Kjo dispozitë i kombinon të dyja format e shpërblimit të dëmit që në praktikën e përditshme gjen aplikim më së shumti sepse pothuajse në shumicën e rasteve është e pamundur të bëhet kthimi i gjendjes së mëparshme në tërësi dhe si rezultat i kësaj lind nevoja edhe e shpërblimit të dëmit në të holla.

Shpërblimi i dëmit në natyrë tentohet të bëhet te të gjitha llojet e dëmit. Në shumë raste mund të ketë sukses p.sh. si shkatërrimi i një ndërtimi, ose kur dëmi i padrejtë konsiston në një shpifje, që cenon të drejtën e nderit, ose kur konsiston në përhapjen e lajmeve, që synojnë të drejtën e fshehtësisë së jetës personale, gjykatësi mund të urdhërojë shkatërrimin e materialeve (të letrave, të filmave etj), me anë të të cilave është realizuar shpifja, ose cenimi i të drejtës së fshehtësisë të jetës personale²⁸².

Për shembull nëse në një aksident komunikacioni dëmtohet lehtë automjeti i cili mund të riparohet atëherë sigurisht se do të aplikohet shpërblimi në natyrë. Por, nëse në rastin e njëjtë kemi edhe dëmtim të automjetit dhe ky automjet ka shërbyer si mjet pune për të dëmtuarin me ç'rast sa ka zgjatur riparimi ka pasur edhe fitim të humbur si pasojë e mosshfrytëzimit të mjetit të

²⁷⁹Dr. Nerxhivane Dauti, E drejta e detyrimeve, Pjesa e përgjithshme dhe e veçantë, Prishtinë, 2007, fq. 190

²⁸⁰Neni 169 paragrafi 1 i LMD

²⁸¹Neni 169 paragrafi 2 i LMD

²⁸²F. Galgano, vep. e cit., fq. 438

punës, atëherë në këtë rast aplikohet forma e kombinuar e shpërblimit në natyrë dhe e shpërblimit në të holla.

Shpërblimi i dëmit me para

Me shpërblim të dëmit në të holla nënkuptohet shpërblimi në të holla i vlerës së sendit të dëmtuar, të zhdukur apo sendit të marrë²⁸³. Kjo formë e shpërblimit jo vetëm të dëmtimi i sendeve por është shumë e shprehur edhe tek cenimi i të mirave personale që rezultojnë me dëm jo material. LMD shpërblimin e dëmit në të holla e parasheh si mënyrë subsidiare të shpërblimit sepse aplikohet vetëm atëherë kur rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk mund të realizohet.

Sipas LMD, shpërblimi i dëmit në të holla fillimisht bëhet në formë të kombinuar me shpërblimin në natyrë, kjo bëhet në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë shpërblimin në të holla²⁸⁴. Tek në fund kur rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundur, apo kur gjykata konstaton se nuk është e domosdoshme që këtë ta bëjë personi përgjegjës, gjykata do të caktojë që personi përgjegjës t'i paguajë të dëmtuarit shumën përkatëse në të holla në emër të shpërblimit të dëmit²⁸⁵.

Rast tjetër kur shpërblimi i dëmit në të holla favorizohet në raport me shpërblimin në natyrë është kur i dëmtuari kërkon që shpërblimi të bëhet në të holla dhe gjykata të vendosë për këtë kërkesë. Gjukata mund të vendosë ndryshe nëse rrethanat e rastit konkret e arsyetojnë rivendosjen e gjendjes së mëparshme²⁸⁶.

Përkundër faktit se LMD shpërblimin e dëmit në para e parasheh si detyësor, në praktikën gjyqësore më shumë zbatohet kjo mënyrë e dëmshpërblimit për shkak se është më e përshtatshme dhe në disa raste shërben si e vetmja mënyrë e dëmshpërblimit²⁸⁷.

Dëmi që shkaktohet, në disa raste krijon pasoja të vazhdueshme për një kohë të caktuar e në disa raste edhe pasoja të përhershme. Për këtë lloj të dëmit as që mund të bëhet fjalë për rikthimin e gjendjes së mëparshme e po ashtu për shpërblimin e dëmit në të holla në një shumë të tërësishme. Në këto raste e drejta jonë pozitive ka paraparë një formë të shpërblimit që quhet shpërblimi i dëmit në formë të rentës në të holla. Kjo vjen në shprehje në raste e vdekjes apo edhe raste e lëndimeve me pasoja të përhershme. Në rast të vdekjes, lëndimit trupor, shpërblimi caktohet në formë të rentës në të holla, për gjithë jetën ose për një kohë të caktuar²⁸⁸.

²⁸³Dr. M. Hetemi, vep. e cit., fq. 281

²⁸⁴Neni 162, paragrafi 2 i LMD

²⁸⁵Neni 162, paragrafi 3 i LMD

²⁸⁶Neni 169, paragrafi 4 i LMD

²⁸⁷Dr. Nerxhivane Dauti, E drejta e detyrimeve, Pjesa e përgjithshme dhe e veçantë, Prishtinë, 2007, fq. 191

²⁸⁸Neni 172, paragrafi 1 i LMD

Vepronet kështu sepse pasojat kanë të bëjnë me dëmtimin trupor, humbjen apo zvogëlimin e aftësisë punuese, humbjen ose zvogëlimin e të ardhurave etj, të gjitha këto e vështirësojnë jetën e të dëmtuarit e renta në këtë rast caktohet me qëllim të sigurimit të ekzistencës së të dëmtuarit.

Vëllimi i dëmit material

Vëllimi i dëmit sikur kriteret tjera ndikojnë në lartësinë e dëmshpërblimit, madje vëllimi i dëmit material mund të konsiderohet kriteri kryesor për caktimin e lartësisë së dëmshpërblimit në të holla.

Vlerësimi i dëmit, sipas rregullës, kryhet sipas kriterit objektiv: merret parasysh vlera objektive e sendit të asgjësuar ose të dëmtuar. Kriteri objektiv i caktimit të vëllimit të dëmit material ka të bëjë me vlerën e tregut të sendit të dëmtuar, kurse kriteri subjektiv ka të bëjë me vlerën që ka sendi i dëmtuar ndaj të dëmtuarit. Këto dy kriteret mund të merren parasysh vetëm të dëmet pasurore të cilat mund të vlerësohen sipas çmimeve të tregut, apo vlera afeksionale e sendit ndaj të dëmtuarit mund të shprehet në para, mirëpo jo edhe te dëmet personale siç janë lëndimet trupore apo dëmtimi i shëndetit etj.

LMD i njeh të dy këto kriteret. Kriteri objektiv për shpërblimin e dëmit është rregull dhe aplikohet në të gjitha rastet, kurse kriteri subjektiv është përjashtim dhe aplikohet kur sendi është shkatërruar me vepër penale të kryer me dashje, në këtë rast gjykata mund të caktojë lartësinë e shpërblimit sipas vlerave që ka pasur sendi i dëmtuar për të dëmtuarin²⁸⁹.

Vëllimi i dëmit mund të përfshijë si dëmin e vërtetë ashtu edhe fitimin e humbur dhe vetëm në këtë rast mund të konsiderohet që llogaritja e dëmit është e plotë dhe nëse bëhet dëmshpërblimi i këtyre dy formave të dëmit atëherë është bërë maksimumi për kthimin e gjendjes materiale të dëmtuarit para gjendjes së shkaktimit të dëmit dhe në këtë rast llogaritet që është bërë dëmshpërblimi i plotë.

Gjykata me kujdes të veçantë do të vendosë që shpërblimi i dëmit t'i përgjigjet në mënyrë adekuate pasojës së shkaktuar. Vendimi për shpërblimin e dëmit nuk duhet të paraqes pasurim të të dëmtuarit, e as imponim të varfërisë të subjektit përgjegjës.

Vendimi gjyqësor, përkundrazi duhet të pasqyrojë qëllimin e shpërblimit të dëmit, të evitohet pasojat e dëmshme dhe të krijojë gjendjen që ka ekzistuar te i dëmtuari para shkaktimit të dëmit. Shpërblimi i dëmit material duhet t'i afrohet sa më shumë ekuivalencës së lartësisë së pasojës së shkaktuar. Kurse, shpërblimi i dëmit jomaterial duhet t'i mbrojë vlerat personale, të drejtat e njeriut e të tjera. Këto, në mënyrë precize, duhet t'i përmbajë dispozitivi i vendimit gjyqësor.

Varësisht nga rasti dhe situatat e shkaktimit të dëmit material, gjykata duhet të vendosë që shpërblimi i dëmit material të realizohet ose me kthim në gjendjen e mëparshme ose me shpërblim në të holla të dëmit.

²⁸⁹ Neni 173, paragrafi 4 i LMD

Shkalla e fajit

Një rrethanë tjetër shumë me rëndësi që mund të ndikojë, si në lartësinë, ashtu edhe në zvogëlimin e shumës së dëmshpërblimit është edhe shkalla e fajit. E drejtë ndoshta do të ishte që sa më e lartë të jetë shkalla e fajësisë, aq më i lartë të jetë dëmshpërblimi, mirëpo jo në të gjitha të drejtat dhe rastet merret parasysh faji respektivisht shkalla e fajit. As LMD nuk ka paraparë ndonjë dispozitë që sipas shkallës së fajit të bëhet edhe shpërblimi i dëmit përveç dispozitës që ka të bëjë me rastet e dëmit të shkaktuar me vepër penale të kryer me dashje, në këtë rast gjykata mund të caktojë lartësinë e shpërblimit të dëmit sipas vlerës që ka pasur sendi për të dëmtuarin, e sigurisht në këtë rast lartësia e çmimit apo dëmshpërblimit do të jetë më e madhe sesa çmimi real në treg.

Kur flasim për fajin vlen të përmendet edhe rasti kur i dëmtuari me sjelljen e tij ka ndikuar në lartësinë e dëmit, pra në këtë rast edhe i dëmtuari me fajin e tij ka ndikuar në lartësinë e dëmit dhe bart përgjegjësinë që i takon sipas ligjit. Kur konstatohet nga gjykata, ky fakt atëherë dëmshpërblimi bëhet proporcionalisht me kontributin e të dëmtuarit. Kjo sipas LMD-së quhet përgjegjësi e ndarë²⁹⁰ dhe në praktikën gjyqësore është shumë e shprehur.

Faji është kusht i veçantë i përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar, themi kështu sepse është element konstituiv tek përgjegjësia deliktore, përgjegjësia për të tjerët, përgjegjësia kontraktore dhe nuk është element konstituiv tek përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga sendet e rrezikshme ose veprimtaritë e rrezikshme. Tek dy llojet e fundit të përgjegjësisë, mjafton fakti i shkaktimit të dëmit që të bëhet shpërblimi i dëmit, prandaj kjo përgjegjësi quhet përgjegjësi pa faj²⁹¹.

Faji mund të jetë i shkallëve të ndryshme, duke filluar nga më i rëndi që është dashja për të vazhduar më shkallën më të ulët që është pakujdesia. Edhe LMD konstaton se fajësia ekziston kur dëmtuesi shkakton dëmin me dashje apo nga pakujdesia²⁹².

Dashja është shkalla më e rëndë e fajit, ekziston atëherë kur dëmtuesi qëllimisht i ka shkaktuar dëm të dëmtuarit. Në këtë rast dëmtuesi duhet të ketë ditur për pasojat që do të shkaktohen nga sjellja e tij dhe ta ketë pranuar e t'i dëshirojë pasojat e dëmshme të sjelljeve të tij. Siç shihet për të ekzistuar dashja duhet të plotësohen disa kushte, fillimisht duhet të jetë shkaktuar dëmi, ai të jetë shkaktuar nga një veprim ose mosveprim i qëllimshëm, kjo nënkupton atë elementin subjektiv-emocional të dëmtuesit, vullnetin e shprehur për të shkaktuar dëmin. Pastaj vije në shprehje elementi psikik që ka të bëjë me aftësinë e dëmtuesit për t'i ditur pasojat që do të shkaktohen. Nëse dëmtuesi nuk i ka ditur dhe as nuk ka pasur mundsi t'i dijë pasojat e veprimit dhe mosveprimit të tij atëherë sigurisht nuk kemi dëm të shkaktuar me dashje. Dhe në fund prapë kemi një element emocional që ka të bëjë me dëmtuesin që është pranimi i dëmit respektivisht fajit dhe ta dëshirojë

²⁹⁰ Neni 176 i LMD

²⁹¹ Dr. Nerxhivane Dauti, E drejta e detyrimeve, Pjesa e përgjithshme dhe e veçantë, Prishtinë, 2007, fq. 168

²⁹² Neni 140 i LMD

pasojën. Këto janë disa elemente që duhet vërtetuar nga gjykata në secilin rast veç e veç me rastin e caktimit të shkallës së fajësisë. Dashja mund të jete dashje direkte²⁹³ dhe dashje eventuale.²⁹⁴

Pakujdesia është forma e dytë e fajit dhe është po aq e rëndësishme dhe e përhapur në praktikën gjyqësore sa dashja. Pakujdesia është formë më e lehtë e fajit dhe marrë në përgjithësi ekziston atëherë kur dëmtuesi nuk e dëshiron dëmin e shkaktuar respektivisht pasojën, pra në këtë rast dëmi shkaktohet kundër vullnetit të tij. Edhe pakujdesia në teorinë e së drejtës dhe praktikën gjyqësore paraqitet në disa lloje apo shkallë. Pakujdesia e rëndë është shkalla më e lartë e pakujdesisë. Formë tjetër e pakujdesisë është pakujdesia e rëndomtë e cila për nga pesha e fajit është më e lehtë se sa pakujdesia e rëndë.

Zvogëlimi i lartësisë së kompensimit për shkak të gjendjes materiale të dëmtuesit dhe të dëmtuarit si dhe për shkak të përgjegjësisë së ndarë

Gjendja materiale e dëmtuesit dhe e të dëmtuarit- Gjendja materiale e dëmtuesit apo e të dëmtuarit është një kriter tjetër që mund të ndikojë në zvogëlimin e shpërblimit. Në këtë rast gjykata mundet, duke pasur kujdes për gjendjen materiale të të dëmtuarit, ta gjykojë personin përgjegjës ta paguajë shpërblimin më të vogël nga shuma e dëmit, në qoftë se dëmi nuk është shkaktuar as me dashje e as nga pakujdesia e rëndë, ndërsa personi përgjegjës është në gjendje të rëndë materiale, kështu që pagimi i shumës së plotë do ta sjellë në skamje²⁹⁵. Siç mund të shihet kjo dispozitë i mundson gjykatës që të gjykojë shumën më të vogël të shpërblimit të dëmit nëse paraprakisht plotësohen disa kushte. Pra në këtë rast kemi të bëjmë me disa çështje paraprake që nevojitet të vërtetohen nga ana e gjykatës.

Fillimisht gjykata vërteton shkallën e fajit, a është shkaktuar dëmi me dashje apo nga pakujdesia e rëndë, në këtë rast dëmtuesi do të humbiste të drejtën që të kërkonte zvogëlimin e shpërblimit të dëmit, pastaj gjykatës i duhet të vërtetojë gjendjen materiale të dëmtuesit respektivisht aftësinë e tij për pagimin e shumës së caktuar për shpërblimin e dëmit, në këtë fazë të procedurës vetë dëmtuesi është ai që ka rolin aktiv duke ofruar dëshmi për gjendjen e rëndë materiale të tij. Pas vërtetimit të këtyre fakteve, nëse gjykata konstaton se dëmi nuk është kryer nga dashja apo

²⁹³ Dashja direkte si forma më e rëndë e fajit ekziston atëherë kur dëmtuesi me vetëdije të plotë dhe më qëllim ndërmerr veprim ose mosveprim me çka rezulton pasoja e dëmshme. Siç shihet kemi dy elemente të cilat e karakterizojnë dashjen direkte. Elementi intelektual (vetëdija) që do të thotë se dëmtuesi në momentin e shkaktimit të dëmit të ketë qenë me vetëdije të plotë, po ashtu edhe pas shkaktimit të dëmit ai ta kuptojë dëmin që e ka shkaktuar. Elementi tjetër është ai i dëshirës apo vullnetit që të shkaktohet dëmi, kjo do të thotë që dëmtuesi me veprimin apo mosveprimin e tij ka dëshiruar t'i shkaktojë dëm të dëmtuarit.

²⁹⁴ Dashja eventuale paraqitet si shkallë më e lehtë e fajësisë edhe pse ka ngjashmëri të madhe me dashjen direkte. Dashja eventuale ekziston kur kryesi është i vetëdijshëm se me veprimin apo mosveprimin e tij mund të shkaktohet dëmi dhe më vetëdije pajtohet që dëmi të shkaktohet, dallimi i vetëm me dashjen direkte është se të dashja eventuale dëmtuesi nuk ka për qëllim të shkaktojë dëmin dhe sigurisht se nuk e dëshiron pasojën edhe pse e pranon si të tillë. Mund të vërehet se ndryshimi i vetëm nga dashja direkte është elementi i vullnetit.

²⁹⁵ Neni 175, paragrafi 1 i LMD

pakujdesia e rëndë dhe nëse dëmtuesi është në gjendje të rëndë materiale ku nëse do të ekzekutohej shuma e plotë e gjykuar, do ta sillte atë në skamje duke mos pasur mjete për jetesë dhe kujdes familjar, atëherë shuma e gjykuar do të ishte më e vogël se shuma e plotë.

Zvogëlimi i shpërblimit mund të bëhet edhe në rastin kur dëmtuesi ka shkaktuar dëm duke punuar diçka për dobi të të dëmtuarit, në këtë rast gjykata mund të caktojë shpërblim më të vogël, duke pasur parasysh kujdesin që tregon dëmtuesi në punët vetjake (LMD neni 175, paragrafi 2). Pra në këtë rast dëmtuesi duhet të ketë qenë i punësuar tek i dëmtuari apo duke kryer ndonjë punë në llogari të tij dhe dëmtuesi duhet të ketë treguar kujdesin e rëndomtë ose sikur të kryejë punët e tije.

Përgjegjësia e ndarë- Përgjegjësia e ndarë është po ashtu një rrethanë e cila ndikon drejtpërdrejt në lartësinë e dëmshpërblimit të gjykuar për dëmtuesin, ajo ka të bëjë me kontributin e të dëmtuarit në dëmin e shkaktuar, në këtë rast përgjegjësia është e ndarë në lartësinë e kontributit të të dyja palëve në dëmin e shkaktuar²⁹⁶.

Këto janë disa rregulla ligjore të cilat janë paraparë nga Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve të cilat për qëllim kanë caktimin e lartësisë së dëmshpërblimit respektivisht udhëzimin e gjykatës në punën e tyre në rastet e shpërblimit të dëmit. Mirëpo si praktika gjyqësore ashtu edhe doktrina juridike ndër kriteret më të rëndësishme që i merr parasysh me rastin e caktimit të lartësisë së dëmshpërblimit material janë: lartësia e dëmit, shkalla e fajit, gjendja materiale e dëmtuesit dhe e të dëmtuarit²⁹⁷ për të cilat do të flasim veç e veç shkurtimisht.

Lirimi nga përgjegjësia

LMD me dispozita e nenit 158 ka përcaktuar raste e lirimit nga përgjegjësia.

Zotëruesi lirohet nga përgjegjësia në rast se provohet që dëmi rrjedh nga ndonjë shkak që ka ndodhur jashtë sendit dhe efekti i të cilit nuk ka mundur të parashihet, të mënjanohet ose të evitohet.

Zotëruesi i sendit lirohet nga përgjegjësia edhe në rast se provohet se dëmi është shkaktuar vetëm nga veprimi i palës së dëmtuar ose i personit të tretë gjë të cilën ai nuk ka mundur të parashihte dhe pasojat e të cilit nuk ka mundur t'i shmangë ose t'i mënjanoje.

Zotëruesi lirohet nga përgjegjësia pjesërisht në rast se pala e dëmtuar pjesërisht ka kontribuar në shkaktimin e dëmit.

Në rast se në shkaktimin e dëmit ka kontribuar pjesërisht personi i tretë, ky person i përgjigjet palës së dëmtuar solidarisht bashkë me zotëruesin e sendit.

Personi që e ndihmon zotëruesin në përdorimin e sendit nuk konsiderohet si person i tretë.

²⁹⁶ Neni 176 i LMD

²⁹⁷Dr. Nerxhivane Dauti, E drejta e detyrimeve, Pjesa e përgjithshme dhe e veçantë, Prishtinë, 2007, fq. 192

Kompensimi i dëmit jomaterial

Kompensimi i dëmit jomaterial, paraqet një nga mënyrat për zhdëmtimin e palës së dëmtuar, për rastet e dëmtimit të të mirave personale. Kështu, cenimi i të mirave personale sipas të drejtës objektive ekziston kur me veprimin antijuridik ose të kundërligjshëm dikush i cenon të drejtat personale të personit tjetër. Cenimi i të mirave personale ekziston kur cenohet nderi i dikujt, kur përhapen fakte të pavërteta ndaj dikujt, ose kur cenohet e drejta në jetë, integriteti trupor, shëndeti, dukja e jashtme, interesi personal i dëmtuarit ndaj njeriut, ose ndaj sendit të caktuar.

Zhdëmtimi i dëmit jomaterial me të holla, nuk bëhet për të riparuar ndonjë cenim të ndonjë vlere pasurore të cenuar, e as për të dënuar shkaktuesin e dëmit, por i njëjti jepet si satisfaksion për personin e dëmtuar. Shpërblimi i dëmit jomaterial jepet pavarësisht shpërblimit të dëmit material.

Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit²⁹⁸, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm²⁹⁹, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material.³⁰⁰

Këto dhe raste të tjera që mund të numërohen shkaktojnë pasoja jo materiale të dëmtuarit, sepse cenimi i nderit, vdekja e të afërmit, invaliditeti i lartë, shëmtimet e ndryshme, frika etj., lënë dhe mund të lënë gjurma të rënda personit të dëmtuar në jetën e tij dhe në të ardhmen. Për këto dhe raste të tjera të cenimeve të të mirave personale mund të jepet shpërblimi i dëmit jo material.

Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit

²⁹⁸ Neni 185 i LMD-së, përcakton së: E drejta e shpërblimit të dëmit në të holla për shkak të dhembjeve shpirtërore të pësuar i takon personit, i cili me anë të mashtrimit, dhunës ose të shpërdorimit të ndonjë raporti nënshtrimi ose varësie, është shtytur në marrëdhënie të dënueshme seksuale ose në veprim të dënueshëm seksual të panatyrshëm, si dhe personi ndaj të cilit është kryer ndonjë vepër tjetër penale

kundër dinjitetit të personalitetit dhe moralit

²⁹⁹ Neni 184 par 1, i LMD-së, përcakton së: në rast vdekjeje të ndonjë personi, gjykata mund t'ua caktojë anëtarëve të familjes së tij të ngushtë (bashkëshortit, fëmijët dhe prindërit) shpërblim të drejtë në të holla për dhembjen e tyre shpirtërore.

Neni 184 par 2, përcakton së: Ky shpërblim mund t'ua caktohet edhe vëllezërve dhe motrave në qoftë se ndërmjet tyre dhe personit të vdekur ka ekzistuar bashkëjetesa e vazhdueshme.

Neni 184 par 3, përcakton së: Në rast të invaliditetit tejet të rëndë ose shëmtimit në shkallë të lartë të ndonjë personi, gjykata mund t'ua caktojë bashkëshortit, fëmijëve dhe prindërve shpërblim të drejtë në të holla për dhembjet e tyre shpirtërore

³⁰⁰ Neni 183, paragrafi 1 i LMD

i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me te mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror.³⁰¹

Kriteret për caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit

Caktimi i lartësisë së dëmshpërblimit në të holla është njëri prej procedurave më komplekse dhe të rëndësishme që udhëheqë gjykata. Themi kështu sepse shpesh nuk mjafton dija profesionale e gjyqtarit dhe kërkohet edhe mendimi i ekspertit gjyqësor nga fusha përkatëse, ekspertit financiar për caktimin e vlerës së dëmit, mjekut për caktimin e lëndimeve trupore, psikologut apo psikiatrit për vuajtjet apo frikën e përjetuar, ekspertit të komunikacionit etj. Në këtë fazë të procedurës pala paditëse gjithmonë para gjykatës propozon prova përmes të cilave synon të vërtetojë lartësinë e dëmit që i është shkaktuar, në praktikë kjo realizohet përmes ekspertizave, të cilat i cakton gjykata, sipas propozimeve të palëve.

Për caktimin e lartësisë së dëmit ndikojnë një sërë rrethanash, disa prej tyre ndikojnë në lartësinë e dëmshpërblimit, disa në zvogëlimin e dëmshpërblimit. LMD ka bërë një radhitje të këtyre fakteve si në vijim.

E para ka të bëjë me vëllimin e kërkesës për dëmshpërblim, se a kërkohet vetëm dëmshpërblimi i rëndomtë apo edhe fitimi i humbur³⁰².

Pastaj një çështje tjetër e cila drejtpërdrejt është e lidhur me lartësinë e dëmshpërblimit është çmimi i tregut i sendit të dëmtuar, sepse gjykata është e obliguar që dëmshpërblimin ta caktojë sipas çmimit të tregut në kohën e nxjerrjes së vendimit gjyqësor³⁰³.

Lartësia e dëmit caktohet duke pasur parasysh kriterin objektiv dhe subjektiv³⁰⁴, kriteri objektiv ka të bëjë me vlerësimin e dëmshpërblimit sipas vlerës reale në treg siç u përmend më sipër, kurse kriteri subjektiv gjen shprehjen te rastet kur dëmi material me vepër penale të shkaktuar me dashje, në këtë rast gjykata mund të caktojë lartësinë e dëmshpërblimit sipas vlerës që ka pasur sendi për të dëmtuarin³⁰⁵. Nëse vlerësimi i dëmit bëhet sipas kriterit subjektiv atëherë sigurisht se lartësia e dëmshpërblimit do të jetë më e madhe se çmimi real i tregut që do të kishte dëmshpërblimi eventual.

Në procedurën gjyqësore, palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla³⁰⁶.

³⁰¹ Neni 183 paragrafi 2 i LMD

³⁰² Neni 173, paragrafi 1 i LMD

³⁰³ Neni 173, paragrafi 2 i LMD

³⁰⁴ Dr. Nerxhivane Dauti, E drejta e detyrimeve, Pjesa e përgjithshme dhe e veçantë, Prishtinë, 2007, fq. 192

³⁰⁵ Neni 173, paragrafi 4 i LMD

³⁰⁶ Neni 7 i LPK

Kushtet për shpërblimin e dëmit jo material

Që të realizohet shpërblimi i dëmit jomaterial në të holla duhet që të plotësohen disa kushte. Kushtet kryesore për ekzistimin e dëmit jomaterial janë që së pari duhet që të ekzistojë dëmi, pastaj faj i dëmtuesit për dëmin e shkaktuar, kurse dëmi të cenojë vlerat e njeriut.

Te dëmi jomaterial sulmimi i vlerave personale të njeriut, siç janë: autoriteti, nderi, liria, integriteti trupor, përpos dëmit material mund të shkaktojnë edhe dëmin jopasuror i cili, sipas rregullave, paraqitet si shqetësim psikik i personit, si shqetësim i gjendjes normale shpirtërore dhe si pësim i vuajtjeve shpirtërore dhe fizike. Ky dëm mund të jetë si rrjedhim i veprës penale ose i veprimit deliktor ose nga cenimi i kontratës. Dëmi jomaterial është rrjedhim nga vepra penale kur kryesi shkakton privimin e dikujt nga jeta, kjo mund të shkaktojë edhe vuajtje psikike të anëtarëve të afërm të familjes së të vdekurit.

Dëmi jomaterial është si rrjedh e veprimit të kundërligjshëm kur shkaktohet frika te personi i dëmtuar nga veprimi antijuridik i dëmtuesit, p.sh. frika për jetë. Ndërsa dëmi jomaterial me cenimin e kontratës ekziston po qe se nuk përmbushet kontrata, p.sh., kur porositësi dhe kryesi i punës merren vesh prodhojnë mobilie për një dasmë. Mobiliet nuk kryhen me kohë, pra për dasmë, porositësi zgjidh kontratën dhe kërkon shpërblimin moral për turpin që ka pësuar nga se mobiliet nuk kanë qenë gati për dasmë³⁰⁷.

Dëmi jomaterial themi se ekziston në qoftë se cenohen vlerat personale të njeriut. Vlerat personale që cenohen duhet të jenë me intensitet të lartë dhe me pasoja të caktuara për personin e dëmtuar. Këto zakonisht janë kategori abstrakte që gjykata duhet t'i vlerësojë në çdo rast konkret. Mund të thuhet se në praktikën gjyqësore në mënyrë të rreptë çmohet se kur ekziston cenimi i nderit ose integritetit trupor, ose vuajtjes psikike, dhembjes shpirtërore, dëmtimi i shëndetit etj.

Kushtet e lartpërmendura të shpërblimit të dëmit në të holla duhet të plotësohen në mënyrë komulative. Pos këtyre kushteve gjykata duhet të ketë parasysh edhe gjendjen pasurore të dëmtuesit dhe të dëmtuarit, pastaj cili cenim është në pyetje në rastin konkret, çfarë pasojash konkrete ka i dëmtuari për shkak të këtij cenimi.

Këto edhe rrethanat tjera siç janë baza materiale e shoqërisë, rregullat përkatëse, mund të ndikojnë në realizimin e shpërblimit të këtij dëmi, si dhe në lartësinë e këtij shpërblimi.

³⁰⁷ Alajdin Alishani, E drejta e detyrimeve, fq 752.

Rastet e shpërblimit të dëmit jomaterial

Shpallja e aktgjykimit ose ndreqja e gabimit (neni 182 i LMD-së)

Me këtë dispozitë ligjore parashikohet mënyra e shpërblimit të dëmit jomaterial të shkaktuar në rast të cenimit të së drejtës së personalitetit. Zbatimi i saj veçanërisht gjen zbatim në rast të cenimit të të drejtave të personalitetit nëpërmjet përhapjes së të pavërtetave ndaj personave fizik apo juridik, me të cilat dëmtohet nderi dhe prestigji i tyre. Duke u nisur nga fakti se edhe riparimi i të mirës së cenuar mund të bëhet jo vetëm me pagesën e shumës së caktuar në të holla, me shpërblimin e dëmit në këtë formë tentohet që të arrihet qëllimi përfundimtar i zhdëmtimit duke u bërë kthimi në gjendjen e mëparshme. Shpërblimi i dëmit në këtë formë, mund të behët në disa mënyra:

- me urdhër gjykate bëhet shpallja publike e aktgjykimit të plotfuqishëm penal, me të cilin personi përgjegjës është shpallur fajtor dhe është dënuar për ndonjë vepër penale të cenimit të të drejtave të personalitetit;
- me shpalljen publike të aktgjykimit civil, me të cilin personi përgjegjës në bazë të nenit 183 të LMD-së, është detyruar të paguaj dëmin jomaterial në të holla;
- me urdhër gjykate, dëmtuesi e tërheqë deklaratën, me të cilën është cenuar e drejta e personalitetit ose të ndërmarr diçka tjetër, ashtu që varësisht nga rrethanat e rastit konkret, kërkit publik të faljes ose nëpërmjet pendimit publik, të mund të mënjanohet cenimi i të drejtës së personalitetit³⁰⁸.

Paraqitja e kërkesës dhe të vendosurit për shpalljen e aktgjykimit ose korigjimin e gabimit nuk e përjashton mundsinë e paraqitjes së kërkesës për shpërblimin e dëmit jomaterial në rast se cenimi i të drejtës së personalitetit të dëmtuarit t'i ketë shkaktuar të dëmtuarit edhe dhimbje fizike dhe psikike si dhe frikë. Duhet theksuar gjithashtu se, në rast të cenimit të së drejtës së personalitetit në formë të shpifjes ose fyerjes i dëmtuari ka të drejtën e realizimit të shpërblimit në bazë të dispozitave të përcaktuara me Ligjin Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes.

Shpërblimi në të holla (neni 183 i LMD-së)

Baza juridike për shpërblimin e dëmit jo material është cenimi i të drejtës së personalitetit i shprehur në formë të dëmit jomaterial është parashikuar me ligj. Në nenin 183(1) LMD ka përcaktuar se: “Për dhembjet e pësura fizike, për dhembjet e pësura shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të

³⁰⁸ Komentari i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Libri I, Prishtinë, 2013, fq. 251.

drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe mungesa e dëmit material”.

Duke analizuar dispozitën e nenit 183 të LMD-së, shohim se ligdhënësi një për një parashikon arsyet për të cilat do të gjykohet shpërblimi i drejtë në të holla, ne emër të shpërblimit të dëmit jo material.

Dhimbjet fizike- paraqiten si pasojë e dëmtimit të integritetit dhe shëndetit trupor, të cilat i përjeton i dëmtuari.

Me rastin e vendosjes lidhur me shpërblimin e drejtë në të holla për çdo rast konkret, gjykata duhet pasur parasysh intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve fizike. Kjo do të përcaktohet me ndihmën e ekspertizës mjekësore, ndërsa praktika gjyqësore ka treguar se dhimbjet fizike shfaqen në formë të intensitetit të lartë, të mesëm dhe të ulët.

Përpos dhimbjeve fizike në dispozitën e sipërcituar ligjore është përcaktuar se shpërblimi i drejtë i takon të dëmtuarit për dhembjet shpirtërore për shkak të: *zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, shëmtimit, cenimit të autoritetit, nderit, të lirive dhe të drejtave të personalitetit, vdekjes së personit të afërm si dhe të frikës.*

Shpërblimi i dëmit jomaterial për shkak të shkaktimit të vdekjes

Me shkaktimin e vdekjes së të afërmit, anëtarët e familjes së ngushtë të të ndjerit pësojnë vuajtje psikike. Kështu është kur shkaktohet vdekja e prindit, bashkëshortit, fëmijës së dikujt. Këtë shqetësim mund ta kenë edhe vëllezërit dhe motrat e viktimës si dhe bashkëshorti legjitim në qoftë se me viktimën kanë pasur bashkësi të përhershme jete. Prindërit kanë të drejtën e shpërblimit në të holla për shkak të humbjes së fëmijës pavarësisht nëse kanë jetuar ose jo në një bashkësi familjare. Prindërit kanë të drejtën e shpërblimit edhe në rast të humbjes së fëmijës së zënë, ende të pa lindur. Fëmijët kanë të drejtën e shpërblimit në të holla për shkak të humbjes së prindërve të tyre, pavarësisht a kanë jetuar bashkë ose jo. Çështje për diskutim mbetet se a do të duhej që moshë e fëmijës të jetë përcaktuese lidhur me lartësinë e shpërblimit të dëmit.

Ndonëse praktika komparative gjyqësore flet në drejtim të asaj që fëmijëve në moshë sa më të re do të duhej që tu caktohej një shpërblim më i lartë, në praktikën gjyqësore në Kosovë nuk vërehen dallime të tilla. Përderisa praktika komparative këtë e bazon në atë se fëmija dhimbjet shpirtërore do t’i përjetojë përgjatë zhvillimit të tij jetësor, në Kosovë caktimi i shumave të tilla të shpërblimit bëhen në mënyrë lineare duke u caktuar shumë të njëjta për fëmijët dhe shumë po ashtu të njëjta për bashkëshortin dhe prindërit.

Të drejtën e shpërblimit të drejtë në të holla për humbjen e të afërmit do ta kenë edhe gjyshërit dhe gjyshet, nipat dhe mbesat, thjeshtri dhe njerku ose njerka do ta kenë vetëm në rastet kur në mes tyre ka ekzistuar bashkësi e jetës dhe kur marrëdhëniet ekzistuese mes tyre, për arsye të ndryshme,

mund të barazohen me marrëdhëniet ndërmjet prindërve dhe fëmijëve. Nëse një person ka të drejtë apo jo në të holla për shkak të dhimbjeve shpirtërore të pësuar në rast vdekjeje apo invaliditetit të rëndë ose shëmtimi të lartë të të afërmit të tij dhe në çfarë shume, nuk ka nevojë të bëhet ekspertiza mjekësore. Për shkak të lidhjeve ekzistuese familjare, në rast vdekjeje ose invaliditeti të personit të afërm, dhembjet shpirtërore janë evidente, andaj edhe nuk ka nevojë të vërtetohet ekzistimi i tyre. Në këto raste gjykata është e autorizuar të vendosë në bazë të njohurisë dhe përvojës që e ka, duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat të cilat, në bazë të logjikës, çojnë në përfundim nëse i dëmtuari ka pësuar ose jo dhe nëse do të pësojë në të ardhmen dhimbje shpirtërore.

Shpërblimi i dëmit jomaterial në rast të të invaliditetit tejet të rëndë ose shëmtimit të lartë të personit të afërm

LMD ka përcaktuar edhe të drejtën e shpërblimit në rast të invaliditetit tejet të rëndë ose shëmtimit në shkallë të lartë të personit të afërm. Me invaliditet tejet të rëndë dhe shëmtim në shkallë të lartë duhet nënkuptuar gjendjen shëndetësore e të lënduarit e cila ka pësuar ndryshime të theksuara edhe në mënyrën e sjelljes dhe jetës së tij. Kjo gjendje e rënduar e të afërmit shkakton dhembje shpirtërore tek të afërmit dhe krijim të ndjenjës së keqardhjes për të afërmin e tij.

Ligji ka përcaktuar një për një personat të cilët mund të zhdëmtoheshin në raste të tilla (bashkëshortin, fëmijët dhe prindërit), por vlerësojmë se në rastin konkret me përdorimin e analogjisë do të mund të zhdëmtoheshin edhe personat tjerë të afërm në po të njëjtën mënyrë sikurse në rast të vdekjes së ndonjë personi. Kjo aq më tepër kur kihet parasysh fakti se dhembjet shpirtërore për këtë do të jenë të pranishme për një kohë më të gjatë, gjatë gjithë jetës së personit të afërm të lënduar³⁰⁹.

Shpërblimi i dëmit jomaterial për shkak të shëmtimit

Shpërblimi i dëmit jomaterial mund të kërkohet për dhembjet të pësuar fizike, ose shpirtërore për shkak të shkakimit të shëmtimit të personit të dëmtuar. Kështu, ndodh kur personi i dëmtuar pëson deformim të konsiderueshëm */laesio deformis/* e që ekziston kur deformohet fytyra, humbet dora ose këmba. Me fjalë tjera deformimi shkakton humbjen e bukurisë së personit të dëmtuar. Për shembull, femra e dëmtuar e cila për shkak të bukurisë së vet, ka qenë e punësuar në ndonjë agjenci mode apo industri të filmit, ose personi i deformuar, për shkak të deformimit nuk mundet që të realizojë si duhet ose realizon me vështirësi kënaqësinë jetësore. Personat e tillë, pësojnë vuajtje psikike me intensitet të lartë dhe më kohëzgjatje gati të përhershme.

Me këto dhe në raste të tjera, shëmtimi i shkakuar mund të shkaktojë të dëmtuarit dhembje fizike, shpirtërore dhe një çrregullim psikik, andaj këtyre iu takon e drejta në shpërblimin e këtij dëmi jomaterial.

³⁰⁹ Komentari i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Libri I, Prishtinë, 2013, fq. 258.

Në disa raste ky dëmtim shfaqet edhe më i rëndë si p.sh. humbja e syrit shkakton pasoja të përhershme dhe e cila përveç pamjes estetike, zvogëlon edhe mundsitë jetësore dhe vështirëson jetën e të dëmtuarit (*nuk mundet që të lexojë, shoh TV, marr pjesë në punë dhe aktivitete hulumtuuese shkencore, etj*), ose humbja e këmbës që pamundson lojtarin e mirë që të luaj futboll etj.

Për realizimin e këtij shpërblimi të dëmit së pari duhet që të shkaktohet shëmtimi, deformimi trupor në personin e dëmtuar, pastaj shëmtimi të shkaktojë vuajtje shpirtërore me intensitet dhe kohëzgjatje të caktuar. Këto rrethana gjykata duhet që t'i vërtetojë me ndihmën e ekspertit mjekësor sepse pa ndihmën e tij me vështirësi mundet që të vlerësohet në mënyrë objektive ky shpërblim i dëmit jomaterial. Pasojat e shkakimit të deformimit tek i dëmtuari janë të shumta, mirëpo për këtë dëm është me rëndësi të ekzistojë vuajtja psikike, dhembja shpirtërore që shkaktohet tek i dëmtuari.

Shpërblimi i dëmit në të holla në raste të veçanta (Cenimi i dinjitetit)

LMD në nenin 185 ka përcaktuar se: *“E drejta e shpërblimi të dëmit në të holla për shkak të dhembjeve shpirtërore të pësuarra i takon personit, i cili me anë të mashtrimit, dhunës ose shpërdorimit të ndonjë raporti nënshtrimi ose varësie, është shtyrë në marrëdhënie të dënueshme seksuale ose veprim të dënueshëm seksual të panatyrshëm, si dhe personi ndaj të cilit është kryer ndonjë vepër tjetër penale kundër dinjitetit të personalitetit dhe moralit”*. Cenimi i dinjitetit personal dhe i moralit paraqet një formë të cenimit të integritetit personal. Andaj shpërblimi i dëmit në këtë rast nuk mund të realizohet duke e bërë kthimin në gjendje të mëparshme, siç është rasti tek shpërblimi i dëmit nga neni 182 i LMD-së. Për këtë arsye në praktikën gjyqësore komparative në një vendim thuhet që satisfakcioni për pasojat e lëndimit trupor nuk është as shpërblim i të dëmtuarit, as dënim për dëmin, por paraqet një kënaqësi për të dëmtuarin.

Në këto raste, natyra e vlerës së dëmtuar është e ndjeshme. Këtu kemi të bëjmë me femrat të cilave mund t'u shkaktohet cenimi i dinjitetit, andaj edhe nga ky pësim ose për këtë pësim mund të jipet satisfakcion i caktuar.

Rastet e mashtrimit të femrave për të kryer marrëdhënie intime me personin e caktuar, kur dëmtuesi këtë e ka bërë duke i premtuar martesën ose lidhjen e kurorës dhe pas deflorimit e dëmtuara është përzënë nga shtëpia e tij, paraqesin cenim të personalitetit të saj. Raste të kësaj natyre paraqiten edhe në rastet e tentimit të aktit të dhunimit apo vetë dhunimi.

Praktika gjyqësore komparative në një rast ka vlerësuar se dhembja shpirtërore dhe frika e personit femëror mbi të cilin është tentuar akti i dhunimit, paraqesin dy baza të veçanta për shpërblimin e dëmit. Në këtë rast gjykata në vendimin gjyqësor ka konstatuar se paditësja në këtë rast ka pësuar frikë, për çka ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit jo material, nga ana tjetër për shkak se është tentuar akti i dhunimit në të dhe nga shkak se për këtë akt kanë ditur edhe personat e tretë shokët e saj ajo ka pësuar edhe dhembje shpirtërore, për çka ka të drejtë në shpërblimin e dëmit jo material. Edhe akti i dhunimit mbi femrën e caktuar është bazë për shpërblimin e dëmit jo material.

Me këtë ajo ka reperkusion negativ në jetën e saj të mëvonshme si dhe me të mbulohet personaliteti i saj. Në këto raste merret që mbrojtja penalo-juridike nuk mjafton, prandaj shpërblimi i dëmit jomaterial për arsyen e aktit të dhunimit është në përputhje me parimin e Kushtetutës për mbrojtjen e personalitetit³¹⁰.

Shpërblimi i dëmit të ardhshëm jomaterial

LMD në nenin 186 ka parashikuar se: “Gjykata, me kërkesën e të dëmtuarit do të caktojë shpërblimin për dëmin e ardhshëm jomaterial në qoftë se sipas rrjedhës së rregullt është e sigurt se ai do të vazhdojë edhe në të ardhmen”. Dëmi i ardhshëm është kur shkaktohet në momentin e shkakimit të dëmit ekzistues, mirëpo pasoja e këtij dëmi do t’i shkaktohet të dëmtuarit në të ardhmen. Këto pasoja duhen të shkaktohen me siguri sepse nuk mund të realizohet ndryshe ky shpërblim i dëmit, p.sh. do të shkaktohet invaliditeti i përhershëm. Varësisht nga koha kur mund të paraqitet dhe mundësia e paraqitjes, dëmi i ardhshëm mund të shfaqet në tri mënyra:

- dëmi i ardhshëm i pavarur
- dëmi i ardhshëm kontinuel
- dëmi i ardhshëm eventual

Dëmi i ardhshëm i pavarur ekziston kur shkaktohet tani, kurse pasojat shkaktohen më vonë, si dëm i ardhshëm dhe i pavarur, pasi që nuk dihet kur shkaktohen këto pasoja me shfaqjen e tyre në të ardhmen. p.sh. shëmtimi me acid i një vajze dhjetëvjeçare, shëmtim ky që do të zgjasë përherë, këtë pasojë do ta kuptojë më vonë se çka ka ndodhur dhe fillon edhe vuajtja psikike.

Dëmi i ardhshëm kontinuel ekziston kur shkaktohet ashtu që fillojnë edhe të paraqiten pasojat meqë këto do të shkaktohen në kontinuitet, p.sh. shkaktohet deformimi në fytyrë ose në trupin e femrës së rritur, vuajtja psikike në këtë rast vjen gjithnjë duke u shtuar.

Dëmi eventual i ardhshëm ekziston kur shkaktohet në të ardhmen, por është e pasigurte se a do të shkaktohet apo jo. Meqë në qoftë se shkaktohet i dëmtuari ka të drejtë ta kërkojë këtë dëm, duke kërkuar shpërblimin e tij³¹¹.

Shpërblimi në të holla për personin juridik

Sipas nenit 188 të LMD-së personi juridik ka të drejtën e shpërblimit të drejtë në të holla për shkak të dëmit jomaterial. Këtë shpërblim gjykata i’ a pranon në rastet kur, me veprimin apo mosveprimin e tjetrit, është cenuar reputacioni ose emri i mirë i personit juridik.

³¹⁰Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 23 ka përcaktuar se: “Dinjiteti i njeriut është pa cenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut”.

³¹¹Alajdin Alishani, E drejta e detyrimeve, fq.767.

Pavarësisht nga dëmi material, personi juridik ka të drejtën e shpërblimit në të holla në qoftë se këtë e arsyetojnë rrethanat e rastit.

Trashëgimi dhe cedimi i kërkesës së shpërblimit të dëmit jomaterial

E drejta e shpërblimit të drejtë të dëmit jomaterial i kalon trashëgimtarit, në qoftë se në momentin e vdekjes së të dëmtuarit, lidhur me këtë të drejtë të shpërblimit është vendosur me aktgjykim të formës së prerë ose me marrëveshje me shkrim të arritur ndërmjet të dëmtuarit dhe personit përgjegjës për shpërblimin e dëmit. Kjo shumë e caktuar mundet që të jetë objekt i cedimit, shpërblimit dhe përmbarimit të dhunshëm (neni 188 i LMD-së).

Parashkrimi

Parashkrimi paraqet njërën prej formave të shuarjes së detyrimeve dhe është nga rastet që shkaktohet në kundërshtim me vullnetin e pjesëmarrësve në një marrëdhënie juridike. LMD ka paraparë dispozita për parashkrimin, për afatet e parashkrimit, ndaljen e parashkrimit, ndërprerjen e parashkrimit etj³¹².

Rregullat e parashkrimit kanë për qëllim që kreditorin ta shtyjnë që kërkesat e veta t'i realizojë në kohë, në të kundërtën nëse kalon koha e caktuar ato shuhen. Kalimi i afatit nuk do të thotë se kreditori nuk ka të drejtë të kërkojë nga debitori përmbushjen e detyrimit, mirëpo nuk ka të drejtë që kërkesën e tij ta realizojë me mjete juridike. Me kalimin e afatit të paraparë sipas detyrës zyrtare gjykata nuk mund të thirret në rregullat e parashkrimit, nëse debitori nuk thirret në to si palë e interesuar³¹³.

Në këtë rast me rëndësi është të dihet momenti se kur fillon të rrjedh parashkrimi, parashkrimi fillon të rrjedh ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit³¹⁴. Sipas kësaj dispozite parashkrimi lidhet me arritshmërinë e kërkesës. Nuk mundet kreditori të kërkojë përmbushjen e kërkesave të paarritshme, këto kërkesa gjykata i refuzon si të parakohshme³¹⁵. Në qoftë se detyrimi konsiston në mosbërje ose pësim, parashkrimi fillon të rrjedh ditën e parë pas ditës kur debitori të ketë vepruar në kundërshtim me detyrimin³¹⁶. Nga kjo dispozitë rezulton se për detyrimet negative afati i parashkrimit fillon të rrjedh prej momentit kur debitori pengon kreditorin apo kryen veprimin që nuk është dashur ta kryente.

Pyetjes se çka ndodhë nëse debitori përmbushë një detyrim të parashkruar i përgjigjet dispozita ligjore e LMD-së, e cila parasheh se në qoftë se debitori e përmbush një detyrim të parashkruar, ai nuk ka të drejtë të kërkojë që t'i kthehet ajo çka ka dhënë edhe atëherë kur nuk e ka ditur se

³¹² Nenet 341-374 të LMD

³¹³ Neni 341, paragrafi 1, 2, 3 i LMD

³¹⁴ Neni 342, paragrafi 1 i LMD

³¹⁵ Neni 144, paragrafi 3 i LPK

³¹⁶ Neni 342, paragrafi 2 i LMD

detyrimi është parashkruar³¹⁷. Nëse detyrimi është parashkruar nuk do të thotë se është parashkruar borxhi në tërësi, është parashkruar vetëm e drejta që me mjete juridike të kërkohet përmbushja e detyrimit, kështu që nëse debitori ka paguar borxhin që ka ekzistuar më herët nuk ka të drejtë të kërkojë kthimin e tij as sipas rregullave të pasurimit pa bazë e as të thirret se ka dhuruar diçka, mirëpo ka paguar një borxh që kreditori nuk do mund ta realizonte në rrugë gjyqësore.

Afati i përgjithshëm i parashkrimit është (5) pesë vite, në qoftë se me ligj nuk është caktuar ndonjë afat tjetër i parashkrimit³¹⁸.

Kjo dispozitë parasheh afatin e përgjithshëm të parashkrimit sipas së cilës të gjitha kërkesat parashkruhen në afat prej (5) pesë vitesh, përjashtimisht nëse ligji ka paraparë afate të tjera.

LMD ka paraparë edhe afate me të shkurtra dhe më të gjata se afati prej (5) pesë vitesh. Kështu për kërkesat periodike që rrjedhin vit për vit ose në afate më të shkurtra, qofshin ato kërkesa periodike aksesore, siç janë kërkesat e kamatës, apo kërkesa e ushqimit, parashkruhen për (3) vite nga arritja e secilës dhënie të veçantë për pagesë³¹⁹.

Edhe kërkesa për shpërblimin e dëmit i nënshtrohet afateve të parashkrimit. Afati i përgjithshëm i parashkrimit të kërkesës për shpërblimin e dëmit është (5) pesë vite nga shkaktimi i dëmit³²⁰. Sipas kësaj dispozite të gjitha kërkesat për shpërblimin e dëmit parashkruhen për (5) pesë vite nga momenti i shkaktimit të dëmit. Kohë më e gjatë e parashkrimit të kërkesës për shpërblimin e dëmit parashihet në rastin kur dëmi është shkaktuar nga akti i abuzimit seksual me të mitur, në këtë rast kërkesa parashkruhet për (15) pesëmbëdhjetë vite pasi personi i mitur të ketë arritur moshën madhore.

Po ashtu afat më i gjatë i parashkrimit të kërkesës për shpërblimin e dëmit parashihet edhe në rastin kur dëmi shkaktohet më vepër penale dhe për ndjekje penale parashihen afate me të gjata të parashkrimit, në këtë rast kërkesa për shpërblim të dëmit parashkruhet kur të skadojë koha e caktuar e parashkrimit të ndjekjes penale. Ndodh kështu, sepse vendimi i gjykatës civile është i lidhur me vendimin e gjykatës penale.

Përveç afatit (5) pesë vjeçar LMD ka paraparë edhe afate të veçanta të parashkrimit të kërkesës për shpërblim të dëmit. Kështu për (3) vite nga data kur i dëmtuari ka marrë dijeni për dëmin dhe për personin, i cili e ka shkaktuar dëmin parashkruhet kërkesa për shpërblimin e dëmit. Në këtë rast është më rëndësi elementi subjektiv, pra momenti kur kreditori ka kuptuar për dëmin që i është shkaktuar.

³¹⁷ Neni 348 i LMD

³¹⁸ Neni 352 i LMD

³¹⁹ Neni 353, paragrafi 1 i LMD

³²⁰ Neni 357, paragrafi 2 i LMD

FILLIMI I PROCEDURËS KONTESTIMORE

Kuptimi i padisë

Padia është veprimi i parë procedural me të cilën vihet në veprim procesi kontestimor.

Ngritja e padisë. Procedimi civil vihet në lëvizje me parashtrimin e padisë si akt hyrës (fillestar) procedural, në të cilin theksohet një kërkesë e caktuar pa marrë parasysh se si kuptohet ai termin mbi të cilin gjykata duhet të vendosë³²¹.

Padia trajtohet në dy aspekte: aspekti material dhe formal i padisë.

Padia në aspektin material përbën kërkesën e paditësit që gjykata me vendim të përmbajtjes se caktuar të detyroj të paditurin për kryerjen e prestimit në dobi të tij, ose të konstatoj se ekziston apo nuk ekziston raporti materialo-juridik i caktuar, ose të ndryshoj një situatë juridike.³²²

Padia në aspektin formal është vetë parashtrësja. Sipas dispozitës së nenit 99 paragrafi 1, i LPK-së, parashihet së: “ *padia, përgjigjja në padi, mjetet e goditjes së vendimit dhe deklaratat tjera, propozimet dhe njoftimet, që bëhen jashtë seancave gjyqësore, paraqitën me shkrim (parashtrësat)...*”. Thënë thjeshtë padia në kuptimin formal është parashtrësja.

Përmbajtja e padisë

Padia pavarësisht nga lloji i saj duhet të përmbajë:

- kërkesën e caktuar në pikëpamje të çështjes kryesore dhe kërkesave aksesore;
- faktet mbi të cilat paditësi e bazon kërkesën;
- provat me të cilat vërtetohen faktet e tilla;
- vlerën e kontestit;
- bazën juridike dhe
- të dhënat e tjera që duhet t'i ketë çdo parashtrësja (*neni 99 i këtij ligji*).³²³

Kërkesa e caktuar në pikëpamje të çështjes kryesore dhe kërkesat aksesore Ky element i padisë nënkupton kërkesën e palës paditëse drejtuar gjykatës për nxjerrjen e një vendimi me përmbajtje të caktuar. Paditësi në kërkesëpadi duhet të pasqyroj përmbajtjen e dispozitivit të vendimit të dëshiruar. Gjykata gjatë vendosjes së një çështje juridike është e lidhur tekstualisht me përmbajtjen e kërkesëpadiisë përkatësisht vendimit të dëshiruar nga pala. Ky element i padisë vlen për të gjitha llojet e padive. Caktimi i kërkesëpadiisë është kusht i domosdoshëm sepse mbi bazën e saj do të dihet se cili do të jete prestimi apo detyrimi që duhet ta përmbush pala e paditur.

³²¹ Enver Hasani, *Ne Bis In Idem në Procedurën Kontestimore*, Prishtinë, 2009, fq.17.

³²² Faik Brestovci, *E Drejta Procedurale Civile I*, Prishtinë 2006, fq.145

³²³ Neni 99 paragrafi 2, i LPK-së.

Kërkesëpadia - (Petitumi) Me anë të kërkesëpadisë paditësi e formulon mendimin se si duhet të duket dispozitivi i aktgjykimit me të cilin pranohet ajo.³²⁴ Pra kërkesëpadia duhet t'i përgjigjet tekstualisht vendimit të dëshiruar, sepse varësisht nga kjo kërkesëpadia do të nxjerrët edhe vendimi i gjykatës, natyrisht nëse padia është e lejueshme dhe e themeltë.³²⁵

Padia duhet ta përmbaj gjithmonë kërkesën e përcaktuar lidhur me çështjen kryesore dhe kërkesat aksesore, (neni 253 paragrafi 1, pika a), e LPK-së).

Është më rendësi që paditësi të saktësoj kërkesën e padisë sepse gjykata është e detyruar që të kufizohet brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse dhe në këtë kuptim pas përfundimit të procesit gjyqësor me vendim merititor të vendos nëse kërkesëpadia është e themeltë.

Praktikisht është e nevojshme që kërkesëpadia të saktësohet në pikëpamje objektive (të caktohet objekti i kontestit), në pikëpamje subjektive (të përcaktohet se kush janë palët në kontest) dhe në pikëpamje të sasisë/vëllimi të se drejtës subjektiv për mbrojtjen e të cilës është paraqite padia. Propozimi i padisë (petitiumi) është propozimi se si duhet të jetë dispozitivi i aktgjykimit sipas mendimit të paditësit, mirëpo gjykata mund ta strukturoj ndryshe dispozitivin e aktgjykimit pavarësisht nga propozimi i paditësit, por gjithmonë duke e ruajtur me saktësi përmbajtjen e propozimit.

Rast praktik: Paditësi në propozim të padisë ka kërkuar kompensimin e dëmit për shkak të lëndimeve trupore dhe atë në emër të kompensimit për dhimbje fizike, për frikë, për shëmtim, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, për zvogëlim të aftësisë punuese, për shpenzime të mjekimit, për ushqim të përforcuar dhe për ndihem e personit të tretë, duke i paraqitur të gjitha këto kërkesa më një (I) paragraf në petitiumin e padisë. Gjukata duhet të vendos për kërkesën e padisë duke vendosur për të gjitha kategoritë e dëmit siç ka kërkuar paditësi me padi, por dispozitivin e aktgjykimit mund ta strukturoj në dy (II), tre (III) apo ma shumë paragrafë, e jo siç e ka paraqit paditësi me një (I) paragraf.

Kërkesëpadia e caktuar është e nevojshme edhe për faktin e sigurimit të kufizimit të qartë të objektit të efektit të vendimit të formës në kuptimin material. Pra, të dihet qartë në rast të nxjerrjes se vendimit, se cila çështje është zgjidhur dhe se tanimë ajo çështje e zgjidhur është e formës se prerë si në kuptimin formal ashtu edhe në kuptimin material.

Objekti i kontestit. Objekt i kontestit është çështja në lidhje me të cilën ekziston mosmarrëveshja (kontesti) mis paditësit dhe të paditurit. Objekti i padisë është ajo që kërkohet si efekt i padisë d.m.th. zbatimi i ligjit dhe realizimi i se drejtës se shkelur, p.sh. kthimi i sendit, pagimi i qirasë,

³²⁴Faik Brestovci, *E Drejta Procedurale Civile I*, Prishtinë 2006, fq.147.

³²⁵ Iset Morina & Selim Nikçi, *Komentari i Ligjit për Procedurën Kontestimore*, fq.457-458.

apo pronësia mbi sendin. Prej këtej del se objekti i padisë, duhet dalluar nga objekti material (*sendi*) që është objekt i se drejtës. P.sh. për një objekt material (*send*) mund të paraqiten disa lloj padie, si padia për kthimin e sendit, padia për pronësinë e sendit, për kompensimin e shfrytëzimit të sendit etj.

Faktet mbi të cilat paditësi e bazon kërkesën. Kusht tjetër i domosdoshëm i padisë është edhe detyrimi që paditësi në padi të paraqes faktet mbi të cilat e bazon kërkesëpadinë e tij. Sipas kësaj paditësi duhet të paraqes të gjitha faktet shkurtimisht dhe një nga një në mënyrë që nga faktet e paraqitura të del edhe pasoja e caktuar juridike.

Provat me të cilat vërtetohen faktet e padisë Paditësi duhet të paraqesë në padi provat me të cilat në mënyrë të qartë dhe konkrete ofrohen për secilin fakt të paraqitur në padi. Duhet të qartësohet për praktikën gjyqësore se nëse paditësi i ka propozuar provat (kur ato janë materiale) duhet t'i bashkëngjiten padisë dhe ky detyrim është kusht për rregullsinë e padisë,³²⁶ ndërsa në rastin kur paditësi nuk ka propozuar provat, atëherë detyrimi për t'i paraqitur provat nuk është kusht i domosdoshëm. Në këtë kuptim nuk mund t'i kthehet padia në rregullim.

Vlera e kontestit- Vlera e objektit të kontestit është element i padisë i përcaktuar me ligj por nuk është kusht i domosdoshëm i padisë. Sipas kësaj edhe në rastet kur pala nuk e ka caktuar vlerën e objektit të kontestit gjykata nuk do ta hedh poshtë padinë dhe as nuk do t'ia kthejë paditësit padinë në përmirësim.

Në raste të tilla kur paditësi nuk e ka caktuar vlerën e objektit të kontestit, kur e caktuar të ultë ose si shumë të lartë, atëherë gjykata sipas detyrës zyrtare, apo sipas prapësimit të palës së paditur më se voni në seancën përgatitore e nëse nuk është mbajtur seanca përgatitore para së të filloj shqyrtimi kryesor do të caktoj në përshtatshme vlerën e objektit të kontesti duke i marrë parasysh rrethanat objektive (sidomos lartasin e kërkesës).³²⁷ Në raste të tilla gjykata duhet të vendos me aktvendim ndaj të cilit nuk lejohet ankesë e veçantë.

Me ligj parashihet që kamatat, shpenzimet procedurale, penalitetet e kontraktuara dhe kërkesat tjera aksesore nuk merren parasysh me rastin e caktimit të vlerës së objektit të kontestit.³²⁸

³²⁶ Neni 99.2 dhe 102, i LPK-së.

³²⁷ Neni 36 i LPK-së, përcakton se nëse paditësi nuk e ka përmendur fare vlerën e objektit të kontestit në padinë e paraqitur, apo në qoftë se ai vlerën e tillë e ka caktuar tepër të lartë apo shumë më të vogël se që është ajo realisht; atëherë gjyqtarët do ta caktojnë vlerën më së voni në seancën përgatitore, e nëse kjo nuk është mbajtur, atëherë para fillimit të seancës për shqyrtimin kryesor të çështjes.

³²⁸ Neni 30.2 i LPK-së, përcakton se kamatat, shpenzimet procedurale, penalitetet e kontraktuara dhe kërkesat tjera aksesore nuk do të merren parasysh nëse vlera e objektit të kontestit nuk është caktuar për kërkesën kryesore. Neni 36 mundson përcaktimin e vlerës së objektit të kontestit nga gjyqtari më vonë gjatë procedurës.

Baza juridike. Kualifikimi juridik i fakteve, në të cilat paditësi e mbështetë kërkesëpadinë, e përbën bazën juridike të kërkesëpadisë.³²⁹

Të dhënat e tjera që duhet t'i ketë çdo parashtrësë. Të dhënat tjera që duhet ti përmbaj padia sikurse çdo parashtrësë janë:

- Emrin e gjykatës (*përfshi edhe departamentin përkatës, përveç kur padia dorëzohet në degën e ndonjë gjykatë me ç 'rast në vend të departamentit shënohet emri i degës së gjykatës themelore*),
- Emrin dhe mbiemrin (*për personin fizik*), ndërsa për personin juridik emërtimin e personit juridik,
- Vendbanimin apo vendqëndrimin (*për personin fizik*), ndërsa për personin juridik (*selinë e personit juridik*) palëve,
- Vendbanimin apo vendqëndrimin e përfaqësuesve ligjor apo me prokurë, (*në qoftë se palët kanë përfaqësues*),
- Objektin e kontestit,
- Përmbajtjen e deklaratës dhe
- Firmën e parashtruesit.

Taksa gjyqësore për padi

Paditësi ka për detyrë që padisë t'ia bashkëngjisë vërtetimin mbi taksën gjyqësore të paguar.³³⁰ Ligjdhënësi detyrimit të paditësit për pagesën e taksës gjyqësore i ka dhënë cilësinë e prezumimit procedural (kusht nga i cili varet lejueshmëria e procesit gjyqësor) në atë mënyrë që nga fakti nëse është paguar taksa gjyqësore për padi do të varët vazhdimi i mëtejme i zhvillimit të procesit gjyqësor.

Llojet e padive

Ekzistojnë kritere të ndryshme për klasifikimin e padive por kriteri më i pranuar është kriteri varësisht nga tipi dhe përmbajtja e mbrojtjes juridike që kërkohet me to. Sipas këtij kriteri kemi tri lloje të padive: padi detyrimi, vërtetimi dhe ndryshimi.

³²⁹ Edhe pse me dispozitën e nenit 253 par 1 pika (e) e LPK-së, është përcaktuar edhe baza juridike si element i padisë, ky element i padisë ka cilësinë e elementit fakultativ ngase gjykata nuk është e lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë e gjithashtu gjykata do veprojë edhe sipas padisë edhe kur paditësi nuk e ka treguar bazën juridike të kërkesëpadisë.

³³⁰ Neni 253 paragrafi 5, i LPK-së.

Padi detyrimi

Me këtë lloj padie paditësi kërkon nga gjykata që me aktgjykim të urdhërojë të paditurin që në dobi të paditësit të përmbushë një prestim.

Shembull praktik: Detyrimi ose prestimi mund të konsistojë në dorëzimin e një sendi, kryerjen e një pune, pagimin e një shume, etj. Praktikisht si prestim që lidhet me dorëzimin e sendit mund të jetë: dorëzimi i shtëpisë, dorëzimi i veturës, dorëzimi i makinerive të ndryshme, etj. Si prestim në lidhje me kryerjen e një pune mund të jetë kërkesa për përmbushjen e kontratës për kryerjen e punëve në objekte ndërtimore, infrastrukturore, etj. Si prestim në lidhje me pagesën e një shume të caktuar mund të jenë kërkesat në raportet juridike civile kontraktuale dhe jokontraktuale si p.sh., pagesa e borxhit nga kontrata e huas (raport juridik civil kontraktual) apo detyrimi i kompensimit të dëmit (raport jokontraktual).

Padi vërtetimi

Me këtë lloj padie paditësi nga gjykata kërkon që me aktgjykim të konstatohet se ekziston apo nuk ekziston marrëdhënia juridike civile e caktuar, e drejta subjektive e përmbajtjes së caktuar, apo a është një dokument autentik ose nuk është.³³¹

Shembull praktik: Padia e paditësit për njohjen e atësisë është padi vërtetimi ose deklarimi pozitiv dhe e kundërta padia për kundërshtimin e atësisë është padi vërtetimi negativ; padia për njohjen e paditësit si trashëgimtar të një trashëgimlënësi, është padi vërtetimi pozitiv dhe e kundërta; padia për përjashtimin e një personi si trashëgimtar të një personi që ka lenë pasuri – decujusit, është padi vërtetimi negativ.

Padi ndryshimi

Me këtë lloj padie paditësi kërkon që me anë të vendimit gjyqësor të themelohet një raport juridik, ndryshimin e përmbajtjes së raportit ekzistues apo anulimin e tij.

Shembull praktik: I detyruari me ushqim, kërkon me padi pakësimin e detyrimit për ushqim për shkak të ndryshimit të rrethanave; padia për zgjidhjen ose anulimin e martesës; padia për pjesëtimin e pasurisë së përbashkët etj.

³³¹ Shih nenin 254 të LPK-së.

Interesi juridik për padi

Mbrojtja gjyqësore për të drejtën subjektive është e arsyeshme dhe mund t'i pranohet vetëm personit, interesi subjektiv i të cilit në aspektin shoqërorë është i pranueshëm.

Mbrojtja juridike nga gjykata duhet dhënë vetëm në ato raste në të cilat pa intervenimin e saj subjekti i së drejtës nuk mund ta realizoj interesin që i është pranuar me ligj. Nga kjo mund të përfundohet se interesi për mbrojtje juridike është nocion procedural-juridik, i ndryshëm nga e drejta subjektive (materiale) e kuptuar si interes i mbrojtur me ligj.³³²

Interesi juridik për të kërkuar mbrojtje gjyqësore është prezumim procedural që duhet të ekzistoj në çdo gjykim e për të cilin gjykata duhet të kujdeset ex officio. Interesi juridik duhet të jetë konkret dhe duhet ti takoj palës e cila kërkon mbrojtje juridike në gjykatë.

Parimisht interesi juridik për padi detyrimi dhe padi ndryshimi nuk ka nevojë të provohet (*nënkuptohet interesi juridik*) ndërsa të padia vërtetuese shprehimisht me dispozitën e nenit 254 paragrafi 2, i LPK-së, kërkohet interesi juridik.

Situata kur objekti i kërkesëpadsisë nuk është bërë i kërkueshëm. Po që se premtimi që është objekt i kërkesëpadsisë nuk është bërë i kërkueshëm deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, gjykata e hedhë poshtë padinë si të parakohshme.³³³

Shembull praktik: Nuk mund të kërkohet me padi nga gjykata për kthimin e shumës së dhënë hua nga i padituri para se të plotësohet afati i caktuar në kontratë për kthimin e të hollave, për arsye se ende nuk është vërtetuar ai fakt juridik (nuk ka mbaruar afati) që përbën shkak që cenon ose shkel të drejtën subjektive të paditësit, për kthimin e huas.

Padia e paafatshme

Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedhë padinë si të palejueshme po që se konstaton se – padia është paraqitur pas skadimit të afatit, po që se me dispozita të posaçme është parashikuar afati për paraqitjen e saj.³³⁴

³³² Faik Brestovci, *E Drejta Procedurale Civile I*, Prishtinë 2006, fq.161. Po ashtu me dispozitën e nenit 2 paragrafi 4 i LPK-së, përcaktohet se: “Pala duhet të ketë interes juridik për padinë dhe për veprimet procedurale tjera që mund të kryhen në procedurë”.

³³³ Neni 144 paragrafi 3, i LPK.

³³⁴ Neni 391 pika f. e LPK-së.

Janë të pakta rastet kur paraqitja e padisë lidhet me afat e që afatet janë paraparë me dispozita të posaçme. Kjo vjen në shprehje p.sh. në rastet e pengim posedimit (Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore (LPDTS), me dispozitën e nenit 114, e përcakton afatin për ngritjen e padisë në gjykatë³³⁵), kontestet nga marrëdhënia e punës/mbrojtja e të punësuarit në gjykatë, (Ligji i Punës me dispozitën e nenit 79 e përcakton afatin për ngritjen e padisë në gjykatë³³⁶) etj.

Njëherit paraqitja e padisë pas afatit është prezumim procedural për të cilin gjykata gjatë fazës së shqyrtimit paraprak të padisë kujdeset sipas detyrës zyrtare. Në mungesë të materialit procedural të mjaftueshëm për këtë prezumim mund të kujdeset edhe pasi t'i arrijë përgjigja në padi ose gjatë seancës përgatitore apo në seancën për shqyrtim kryesor të çështjes, po që se nuk është mbajtur seanca përgatitore (neni 393 LPK).

Kundërpadia

Kundërpadia është padi e të paditurit kundër paditësit e parashtruar në procesin të cilin i dyti e ka vënë në veprim kundër të parit. Me kundërpadi i padituri (në procesin e iniciuar sipas padisë paditësit) në të njëjtën gjykatë dhe në të njëjtin gjykim e parashtron kërkesëpadinë e tij të veçantë. Me kundërpadi themelohet edhe një raport proceduralo-juridik, me role të kundërta të palëve. Kundërpadia është paraparë si një e drejtë e të paditurit i cili mund ta shfrytëzojë deri në një fazë të caktuar të procesit dhe assesi si detyrim i të paditurit³³⁷. I padituri kërkesën e njëjtë që e parashtron me kundërpadi mund ta parashtrorë me padi, prandaj nuk është detyrim i të paditurit paraqitja e kundërpadisë.

Llojet dhe shembujt e kundërpadive Ekzistojnë tri lloje të kundërpadisë dhe atë: kundërpadia konkekse, kundërpadia kompensuese dhe kundërpadia prejudiciale.

Kundërpadia konekse. Kundërpadinë konekse i padituri mund ta paraqesë në qoftë së në mes të kërkesës së përfshirë me kundërpadi dhe asaj të përfshirë me padi nuk ka dallim në pikëpamje të bazës juridike dhe asaj faktike.

Shembull i kundërpadisë konekse: Në qoftë së në mes të subjektit X dhe Y ekziston marrëdhënia kontraktuese e shitblerjes së sendit. Në qoftë se subjekti X-paditësi me padi kërkon dorëzimin e sendit, subjekti Y me kundërpadi mund të kërkojë pagesën e çmimit kontraktues; Ose kur shitësi me padi kërkon nga blerësi, pagimin e çmimit dhe ky me kundërpadi kërkon shpërblimin e demit

³³⁵ Me dispozitën e nenit 114 të LPDTS përcaktohet së: “ *kërkesa mund të parashtrohet vetëm në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, pasi që poseduesi e merr dijeni lidhur me privimin apo pengimin e posedimit të tij. Kërkesa shuhet pas kalimit të një viti nga privimi ose pengimi i posedimit*”.

³³⁶ Me dispozitën e nenit 79 të Ligjit të Punës përcaktohet së: “ *Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejta e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2, të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj contest punë në Gjykatën Kompetente*”.

³³⁷ Faik Brestovci, *E Drejta Procedurale Civile I*, Prishtinë 2006, fq. 220.

për shkak se sendi nuk i përgjigjet cilësisë së përcaktuar në kontratë, etj. Nga shembulli i paraqitur kuptohet se kundërpadia duhet të ketë bazë juridike dhe faktike të njëjtë me padinë.

Kundërpadia kompensuese Këtë kundërpadi i padituri mund ta paraqes në qoftë së kërkesa e tij mund të kompensohet me kërkesën e paditësit. Kjo kundërpadi do të ishte e lejueshme nëse kërkesat e kundërpadisë do të mund të kompensoheshin me kërkesat e padisë në procesin kryesor. Nëse këto kërkesa mund të kompensohen varet nga norma e të drejtës materiale. Këtë dispozitë e gjejmë në neni 317 të LMD-së³³⁸

Kompensimi është një ndër mënyrat e shuarjes së detyrimeve duke bërë llogaritjen e kërkesave reciproke. Kompensimi ndodh gjithmonë kur debitori bëhet kreditor i kreditorit të vet dhe në mes këtyre dy personave ekzistojnë kërkesa të ndërsjella të njëkohshme dhe ato mund të shuhen pa u përmbush asnjëra prej tyre, pra kompensohen.

Shembulli i kundërpadisë kompensuese: Në qoftë se subjekti X dhe subjekti Y për shkak të raporteve të tyre kontraktuese dhe për shkak të detyrimeve të ndërsjella të pa përmbushura kanë parashtruar para gjykatës padi dhe kundërpadi, në atë mënyrë që subjekti X me padi kërkon nga subjekti Y shumën prej 1000€, në emër të borxhit për verën që ia kishte shitur subjektit Y, ndërsa subjekti Y si kultivues i rrushit me kundërpadi kërkon që të detyrohet subjekti X që t'ia paguajë shumën prej 900€ për rrushin që ia kishte shitur subjektit X. Në këtë rast kërkesat reciproke mund të kompensohen deri në vlerën e së cilës kërkesë; Ose qiradhënësi me padi kërkon pagimin e qirasë se banesës, ndërsa i padituri me kundërpadi kërkon nga paditësi pagimin e shpenzimeve të nevojshme.

Kundërpadia prejudiciale

I padituri kundërpadinë prejudiciale mund ta paraqes kur të paditurit i takon e drejta që të kërkoj konstatimin se nuk ekziston raporti juridik apo të drejtat subjektive që janë bërë kontestuese gjatë gjykimit, e nga ekzistimi apo mos ekzistimi i tyre varet pjesërisht apo plotësisht vendimi për kërkesëpadinë.

Shembulli i kundërpadisë prejudiciale: Në qoftë së subjekti X me padi kërkon dorëzimin e sendit kundër subjekti Y- i paditur, atëherë i padituri-subjekti Y me kundërpadi mund të kërkojë nga gjykata që me aktgjykim të konstatojë se sendi, kthimin e të cilit paditësi e kërkon në bazë të pronësisë, është i tij e jo i paditësit.

Fazat dhe kushtet për lejimin e kundërpadisë. I padituri ka të drejtë të paraqesë kundërpadi derisa nuk ka përfunduar seanca përgatitore, gjegjësisht seanca e parë për shqyrtim kryesor, kur

³³⁸ Debitori mund ta kompensoj kërkesën që ka ndaj kreditorit me atë që kërkon ky prej tinë qoftë se të dy kërkesat kanë si objekt të hollat ose sendet tjera të zëvendësueshme të të njëjtit lloj se të së njëjtës cilësi dhe në qoftë se të dyja kanë arritur për pagesë.

nuk është mbajtur seanca përgatitore, ndërsa pas mbajtjes së seancës përgatitore apo të shqyrtimit kryesor, mund të lejohet vetëm me pëlqimin e paditësit.³³⁹

Palët në proces sipas kundërpadisë duhet të jenë identike me palët në procesin kryesor. Në procesin sipas kundërpadisë vetëm ndërrohen rolet e palëve ashtu që pala e paditur e merr rolin e palës paditëse kurse palë paditëse rolin e palës së paditur.

Kundërpadia është e palejueshme nëse për të nuk është kompetente e njëjta gjykatë para së cilës zhvillohet procesi kryesor sipas padisë së parë. Lidhur me kundërpadinë duhet që gjykata të jetë kompetente si në pikëpamje lëndore ashtu edhe në pikëpamje tokësore.

Gjykata mund të vendos ndarjen e procedimit sipas kundërpadisë kur e kërkojnë shkaqet ekonomike sa i përket kundërpadisë konekse.

Pavarësisht se ligji e lejon ndarjen e procedurës sipas kundërpadisë konekse është e arsyeshme që ndarja të ndodh si përjashtim pasi që gjykata në parim duhet gjithmonë të zhvillojë një proces të vetëm lidhur me padinë dhe kundërpadinë.

Ndryshimi i padisë

Padia konsiderohet e ndryshuar, kur në të ndryshohen elementet esenciale të saj, ashtu që padia e ndryshuar nuk është më e njëjtë me atë të paren. Elementet nga të cilat varet ndryshimi i padisë janë: Kërkesëpatria dhe ndryshimi i të paditurit.

Ndryshimin e njëjtësisë së kërkesëpadisë. Ndryshimi i njëjtësisë së kërkesëpadisë ekziston atëherë kur ndryshohet baza e padisë përkatësisht gjendja faktike ose faktet në të cilat bazohet kërkesa e palës paditëse.

Shembuj praktik: Në qoftë së subjekti X me padi ka kërkuar përmbushjen e prestimit duke u bazuar në kontratën e shitjes, e më vonë kërkon përmbushjen e prestimit për shkak të kontratës së huas; ose

Në qoftë se subjekti X me padi ka kërkuar kthimin e sendit të luajtshëm nga baza e pronësisë e më vonë kërkon kompensimin e vlerës së sendit për shkak të humbjes së sendit.

³³⁹ Neni 256 par.1 i LPK-së.

Zmadhimi i kërkesëpadisë

Zmadhimi i kërkesëpadisë e nënkupton zgjerimin e kërkesëpadisë në kuptimin kuantitativ dhe kualitativ.

Shembuj praktik: Në qoftë se subjekti X me padi fillimisht ka kërkuar shumën prej 5000 Euro në emër të kompensimit të dëmit, ndërsa me ndryshimin e padisë kërkon shumën e 8000 Euro (zmadhimi i kërkesëpadisë në kuptimin kuantitativ); ose

Në qoftë se subjekti X me padi fillimisht ka kërkuar dorëzimin e sendit i cili ka cilësitë e produktit të klasës III, ndërsa me ndryshim të padisë kërkon dorëzimin e sendit i cili ka cilësitë e produktit të klasës I (Zmadhimi i kërkesëpadisë në kuptimin kualitativ).

Zvogëlimi i kërkesëpadisë

Zvogëlimi i kërkesëpadisë nuk konsiderohet ndryshim i padisë dhe rrjedhimisht gjykata nuk ka nevojë ta lejoj ndryshimin.

Shembull praktik: Në qoftë se paditësi me padi ka kërkuar kompensimin në lartësi prej 5.000€, ndërsa gjatë shqyrtimit kryesorë e zvogëlon kërkesën në shumë prej 4.000. Në këtë rast nuk kemi të bëjmë me ndryshim të padisë dhe shqyrtimi zhvillohet pa nevojën për të nxjerrë vendim të veçantë.

Nga praktika: Nuk konsiderohet shkelje e procedurës edhe në qoftë se paditësi e ka bërë zvogëlimin e kërkesëpadisë në seancën e shqyrtimit kryesor në të cilën nuk ka marrë pjesë i padituri dhe në të cilën është përfunduar shqyrtimi pa ju dhënë mundsi të paditurit që të deklarohet në lidhje me zvogëlimin e kërkesëpadisë nga ana e të paditurit.

Për më tepër duhet theksuar së zvogëlimi i kërkesëpadisë është në diskrecionin e plotë të paditësit dhe në lindshmëri me këtë deklarami i të paditurit nuk ka ndonjë rendësi.

Për rastet kur zvogëlimi i kërkesëpadisë bëhet në seancë gjyqësore, në të cilën nuk merr pjesë i padituri është me rendësi për procesin gjyqësor që i padituri të jetë ftuar në mënyrë të rregullt dhe mungesën të mos e ketë arsyetuar.

Nëse zvogëlimi i kërkesëpadisë ndodh në seancë gjyqësor, i padituri mund të deklarohet dhe nëse kërkon që të deklarohet duhet ti jepet mundsia e deklaramit, por vazhdimi i shqyrtimit duhet të ndodh sikur në rastin kur s'ka fare zvogëlim të kërkesëpadisë.

Parashtrimi edhe i një kërkesë krahas kërkesës ekzistuese. Kur paditësi gjatë procedurës krahas kërkesës ekzistuese parashtron edhe kërkesa të tjera.

Shembull praktik: Kemi situatën kur subjekti X krahas kërkesës për kthimin e sendit paraqet edhe kërkesën për shpërblimin e dëmit për shkak të dëmtimit të tij; ose në qoftë së subjekti X me padi ka kërkuar kompensimin e dëmit për dëmin e pësuar në pronën e tij (lokal afarist) me veprime të paligjshme të të paditurit si uzurpues i pronës ndërsa me ndryshimin e padisë krahas kësaj kërkesë kërkon edhe kompensimin për shkak të pasurimit të pabazë të të paditurit.

Ndryshimi i padisë në kuptimin subjektiv. Deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor të çështjes juridike paditësi mund ta ndryshojë padinë e vet duke e paditur personin tjetër në vend të të paditurit të parë.³⁴⁰ Kjo ndodh për arsye se zhvillimi i procesit kontestimor mund të sjell në pyetje saktësinë e legjitimitetit pasiv të palës së paditur më parë.

Kushti i parë dhe kryesor që të lejohet ndryshimi i padisë në kuptimin subjektiv është që të pajtohet pala që do të hyjë në proces përkatësisht në gjykim në vend të t'paditurit, ndërsa nëse i padituri ka filluar të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes kryesore nevojitet edhe pëlqimi i tij.

Personi i cili hyn në gjykim në vend të palës së paditur duhet ta pranoj atë në gjendjen në të cilën ndodhet në momentin kur hyn në të.

Pëlqimi i të paditurit për ndryshimin e padisë është i nevojshëm në raste kur ndryshimi bëhet pas përfundimit të seancës përgatitore ose më së voni në fillim të seancës për shqyrtim kryesor, nëse seanca përgatitore nuk është mbajtur fare.

Në raste të tilla pëlqimi i të paditurit justifikohet me faktin se i padituri mund të ketë interes juridik që çështjen e filluar ta përfundojë me vendim meritore dhe paditësi mos të ketë mundsi që të inicioj prapë procesin e njëjtë kundër tij.

Praktikisht mund të ndodhë që i padituri jep pëlqimin për ndryshimin e padisë në kuptimin subjektiv, por ka të drejtë t'i kërkojë shpenzimet e procedurës të krijuara deri në momentin kur gjykata vendos për ndryshimin e padisë. Në këtë rast gjykata duhet me aktvendim të veçantë ndaj të cilit lejohet ankesë e veçantë t'i njoh të paditurit shpenzimet e procedurës.

Fazat në të cilat mund të bëhet ndryshimi i padisë

Ndryshimi i padisë si çështje e natyrës procedurale mund të paraqitet praktikisht në dy faza të procesit gjyqësor dhe atë ndryshimi i padisë deri në seancën përgatitore/të shqyrtimit kryesor (kur

³⁴⁰ Neni 258 par.1 LPK-së.

nuk mbahet seanca përgatitore) dhe ndryshimi i padisë pas përfundimit të seancës përgatitore apo fillimit të seancës për shqyrtim kryesor.³⁴¹

Ndryshimi padisë deri në seancën përgatitore - seancën e shqyrtimit kryesor. Paditësi mund ta ndryshojë pa pëlqimin e të paditurit padinë deri në përfundimin e seancës përgatitore apo deri në fillimin e seancës për shqyrtim kryesor në qoftë se nuk është caktuar fare seanca përgatitore.³⁴²

Ndryshimi i padisë pas përfundimit të seancës përgatitore apo fillimit të seancës për shqyrtim kryesor. Paditësi mund ta ndryshojë padinë pas përfundimit të seancës përgatitore ose fillimit të seancës për shqyrtim kryesor por vetëm me pëlqimin e palës së paditur.³⁴³

Në raste të tilla gjykata do ta lejojë ndryshimin e padisë vetëm po që se konstaton se ndryshimi nuk ka për qëllim zvarritjen e gjykimit.

Konsiderohet se ekziston pëlqimi i të paditurit për ndryshimin e padisë po që se ai fillon të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes sipas padisë së ndryshuar, pa e kundërshtuar më parë ndryshimin.

Nëse paditësi e ndryshon padinë duke kërkuar nga e njëjta bazë faktike sendin tjetër apo një shumë të hollash, i padituri nuk mund ta kundërshtojë atë nëse ndryshimi është pasojë e rrethanave të krijuara pas ngritjes së padisë.

Përshkrimi i një situate praktike: rast tipik është kur pala paditëse në vend të sendit borxh kërkon një send tjetër ose kërkon shpërblimin e dëmit, për shkak të humbjes ose shkatërrimit të sendit i cili ka qenë objekt i kërkesëpadisë dhe i cili është shkatërruar apo është humbur pas ngritjes së padisë.

Nëse padia është ndryshuar në seancën në të cilën nuk ka qenë prezent pala e paditur atëherë gjykata duhet ta shtyjë seancën dhe t'ia dërgojë palës së paditur një kopje të procesverbalit të seancës.

Nga praktika: Në qoftë se subjekti X në cilësinë e paditësit në seancën e shqyrtimit kryesor në të cilën nuk është i pranishëm i padituri e ndryshon padinë, atëherë gjykata duhet ta shtyjë seancën

³⁴¹ Neni 258 par 1 dhe 2 të LPK-së

³⁴² Neni 258 par. 1 i LPK-së përcakton: “Paditësi mund ta ndryshojë padinë më së voni deri në përfundimin e seancës përgatitore apo deri në fillimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes, nëse seanca përgatitore nuk është caktuar fare. Në rast të këtillë gjykata të paditurit duhet t’i jep kohë të nevojshme që të përgatitet për shqyrtim të padisë së ndryshuar”.

³⁴³ Neni 258 par. 2 i LPK-së përcakton: “Pas përfundimit të seancës përgatitore, e më së voni deri në mbylljen e seancës për shqyrtim kryesor, gjykata mund ta lejojë ndryshimin e padisë vetëm nëse konstaton se ndryshimi nuk ka për qëllim zvarritjen e gjykimit dhe nëse i padituri pajtohet me ndryshimin e padisë”

dhe një kopje të procesverbalit t'ia dërgoi të paditurit subjektit-Y, me qëllim që të paditurit t'i jepet kohë që të deklarohet në ndryshimin e padisë.

Në rastet e tilla gjykata nuk ka nevojë të merr ndonjë vendim me të cilin e detyron të paditurin që të deklarohet rreth ndryshimit të padisë, por mjafton që të njëjtit t'i dërgohet një kopje e procesverbalit të seancës në të cilën është bërë ndryshimi.

Ligji për Procedurën Kontestimore nuk ka paraparë ndonjë afat të caktuar se brenda cilës kohë duhet i padituri të deklarohet në ndryshimin e padisë, mirëpo konsiderojmë se gjykata duhet të marrë në konsideratë dispozitën e nenit 402 paragrafi 2 të LPK-së, sipas të cilës rezulton se palët për seancën e radhës njoftohen të paktën 7 ditë më herët. Pra në këtë rast i padituri mund të deklarohet për ndryshimin e padisë para seancës së radhës apo drejtpërdrejtë në seancën e radhës. Gjykata vetëm në seancën e radhës vendos lidhur me ndryshimin e padisë.

Lejimi i ndryshimit të padisë pa pëlqimin e të paditurit

Në situata të caktuara gjykata do ta lejojë ndryshimin e padisë edhe nëse pala e paditur nuk e ka dhënë pëlqimin, me kusht që në mënyrë kumulative të plotësohen këto kushte:

- Që pala paditëse pa fajin e saj nuk ka pasur mundsi ta ndryshojë padinë më parë, dhe
- Që i padituri ka mundsi të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes sipas padisë së ndryshuar pa e shtyrë seancën kryesore.

Në praktikën gjyqësore ka shumë raste kur gjykata lejon ndryshimin e padisë pa e marrë pëlqimin e të paditurit.

Shembuj praktik: P.sh., dihet së ekziston dëmi por nuk dihet lartësia e dëmit, dihet së ekziston dëmi por nuk dihen kategoritë e dëmit, etj. Këto raste ndodhin për faktin së p.sh. lartësia e kërkesës dhe kategoritë e dëmit varen nga ekspertizat profesionale të cilat si provë direkte mund të nxirren vetëm në gjykatë me kusht që të kenë cilësinë e provës së vlefshme. Pra, në raste të tilla paditësi detyrohet ta bëjë ndryshimin padisë gjatës shqyrtimit gjyqësore dhe më qëllim që të mos vije deri të një proces tjetër gjyqësor, gjykata e lejon ndryshimin pavarësisht së i padituri nuk e ka dhen pëlqimin.

Në të gjitha rastet e ndryshimit të padisë si në kuptimin objektiv dhe subjektiv, gjykata vendos me aktvendim me të cilin e lejon ose refuzon ndryshimin e padisë. Varësisht nga faza e procedurës në të cilën bëhet ndryshimi i padisë gjykata mund të vendos në seancë dhe jashtë seancës gjyqësore. Kundër një aktvendimi të tillë nuk lejohet ankesë e veçantë.

Tërheqja e padisë

Tërheqja e padisë është veprim procedural i palës paditëse, me të cilin veprim përfundon procesi gjyqësor civil sipas veprimit vullnetar të palës paditëse. Padia e tërhequr konsiderohet se nuk është paraqitur asnjëherë dhe mund të paraqitet në gjykatë përsëri.

Tërheqja e padisë nga paditësi mund të bëhet nën kushte të caktuara në dy faza të procedurës dhe atë: tërheqja e padisë deri në momentin e dhënies së përgjigjes në padi nga pala e paditur dhe tërheqja e padisë deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor.

Tërheqja e padisë deri në momentin e dhënies së përgjigjes në padi nga pala e paditur. Në rast se paditësi e tërheq padinë para se pala e paditur të paraqet në gjykatë përgjigje në padi, atëherë nuk është e nevojshme që nga pala e paditur të kërkohet pëlqimi për tërheqjen e padisë. Në raste të tilla gjykata nuk e njofton fare palën e paditur me vendimin me të cilin konstatohet se është tërhequr padia.³⁴⁴

Tërheqja e padisë deri në përfundim të shqyrtimit kryesor. Paditësi mund ta tërheq padinë edhe pas dorëzimit të përgjigjes në padi, në gjykatë dhe atë deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në qoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë.

I padituri duhet të njoftohet se paditësi e ka tërhequr padinë, në mënyrë që i padituri të deklarohet lidhur me tërheqjen e padisë. Pas njoftimit për tërheqjen e padisë, i padituri mund ta jep pëlqimin shprehimisht për tërheqjen e padisë, por edhe në qoftë se i njëjti brenda 7 ditësh nuk deklarohet për tërheqjen e padisë konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë.³⁴⁵

Në raste të tilla aktvendimi me të cilin konstatohet se është tërhequr padia i dërgohet paditësit dhe të paditurit. Kundër aktvendimit me të cilin konstatohet se është tërhequr padia nuk lejohet ankesë.

Gjyqëvarësia (litispēndēnca)

Gjyqëvarësia krijohet në momentin në të cilin të paditurit i dorëzohet padia, ndërsa për kërkesat e parashtruar gjatë zhvillimit të procedurës, gjyqëvarësia krijohet në momentin në të cilin është njoftuar pala kundërshtarë për kërkesën e tillë³⁴⁶.

Si raste të gjyqëvarësisë së krijuar gjatë zhvillimit të procedurës mund të përmenden ndryshimi i padisë dhe paraqitja e kundërpadisë. Gjatë kohës së ekzistimit të gjyqëvarësisë për të njëjtën kërkesëpadia nuk mund të iniciohet gjykim i ri midis palëve të njëjta.³⁴⁷ Gjykata kujdeset sipas

³⁴⁴ Neni 261 par 1 i LPK-së.

³⁴⁵ Neni 261 par 2 i LPK-së.

³⁴⁶ Neni 262 par 1 i LPK-së

³⁴⁷ Neni 262 par 3 i LPK-së

detyrës zyrtare por edhe mund të njoftohet nga palët ose ndonjë pjesëmarrës tjetër, nëse është në zhvillim e sipër gjykim tjetër për të njëjtën kërkesëpadi midis palëve të njëjta.³⁴⁸

Në rast se konstatohet se ekziston gjyqëvarësia për të njëjtën çështje dhe midis palëve të njëjta, atëherë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë.

Kundër aktvendimit me të cilën hedhet poshtë padia për shkak të gjyqëvarësisë lejohet ankesë e veçantë.

Hedhja poshtë e padisë për shkak të gjyqëvarësisë, në qoftë së kontesti tjetër në mes të palëve të njëjta nuk përfundon me vendim meritator apo me pajtim gjyqësor, nuk do të konsiderohet si çështje e gjykuar.

³⁴⁸ Neni 262 par 4 i LPK-së

SHQYRTIMI PARAPRAK I PADISË

Zbatimi i rregullave të procedurës

Si një qasje e drejtë dhe efikase e zbatimit të rregullave të procedurës nga ana e gjykatës përkitazi me paraqitjen e padive do të ishte kontrollimi i menjëhershëm i parashtrësave, nxjerrja e menjëhershme e urdhrave përkatës gjyqësor që kërkojnë nga palët që t'i respektojnë rregullat brenda afateve të caktuara sipas Ligjit për procedurën kontestimore, m njoftim për pasojat ligjore kur palët nuk veprojnë në përputhje me urdhrin. Kjo qasje i ka të paktën tri pjesë:

kontrollimi i menjëhershëm i padisë dhe parashtrësave për të parë nëse janë respektuar rregullat e procedurës;

nxjerrja e menjëhershme e aktvendimeve gjyqësore (duke përdorur format apo formularët sipas nevojës) me të cilët nga paditësi kërkohet që ta korrigjojë padinë brenda afatit të paraparë me ligj; dhe

ndërmarrjen e menjëhershëm të veprimeve procedurale, duke përfshirë këtu hedhjen poshtë të padisë apo ta konsiderojë atë si të tërhequr, nëse paditësi nuk e zbaton urdhrin.

Caktimi i menjëhershëm i gjyqtarit të çështjes Hapi i parë është caktimi i menjëhershëm rastësor i gjyqtarit të çështjes për çdo lëndë të re. Duke pasur parasysh se ekziston afati i detyrueshëm 15-ditor³⁴⁹ që gjykata ta njoftojë të paditurin për ekzistimin e padisë (llogaritur nga data e regjistrimit), është e rëndësishme që gjyqtarit t'i ndahet lënda e re gjatë procesit të regjistrimit të saj. Përndryshe, do të ishte e pamundur që gjyqtari të kryej ose ta mbikëqyrë secilin veprim që duhet të ndërmerret para se të kalojë afati i njoftimit. Mirëpo, aktualisht gjykatat zakonisht e zbatojnë procesin e ndarjes së lëndëve një herë në muaj (përveç kërkesave për masa të përkohshme, të cilat u ndahen gjyqtarëve menjëherë në mënyrë rastësore), që do të thotë se lëndët mund të mbesin në Zyrën për menaxhimin e lëndëve pa asnjë veprim gjyqësor deri në 30 ditë.

Çka parashihet me dispozita e LPK-së, për këtë fazë të procedurës?

Sipas dispozitës së nenit 386 paragrafi 1, i LPK-së parashihet së: “ *gjykata menjëherë pasi t'i arrij padia i fillon përgatitjet për shqyrtim kryesor të çështjes*”, ndërsa me paragrafin 2 të nenit 286 parashihet së: “ *përgatitjet e tilla përfshijnë ekzaminimin paraprak të padisë³⁵⁰, dërgimin e padisë palës së paditur për përgjigje të domosdoshme, mbajtjen e seancës përgatitore dhe caktimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes*”.

³⁴⁹ Neni 394 i LPK-së përcakton afatin e detyrueshëm 15 ditor për njoftimin e të paditurit për padinë dhe përgjigje në padi, nga dita kur është paraqitur në gjykatë padia e rregullt dhe e plotë).

³⁵⁰ Shqyrtimi paraprak i padisë është nen fazë e detyrueshme e përgatitjes së shqyrtimit kryesor të çështjes juridike. Ky aktivitet procedural duhet të kryhet menjëherë posa ta paraqes padinë paditësi në gjykatë.

Ky aktivitet përbëhet nga verifikimi se a janë përmbushur prezumimet procedurale, në qoftë se ato mund të konstatohen me vetë leximin e padisë. Ky verifikim bëhet në bazë të të dhënave që i përmban shkresa e padisë, si dhe në bazë të fakteve që i di vetë gjykata siç përcakton dispozita e nenit 17.2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Çfarë vlerësimesh bën gjykata në një çështje juridike kontestimore?

Gjykata civile në një çështje juridike kontestimore i bën dy lloj vlerësimesh dhe atë:

- Vlerësimet e rrethanave nga të cilat varët lejueshmëria e procesit gjyqësor (prezumimet procedurale)³⁵¹, dhe pastaj
- Vlerësimin rrethanave nga të cilat varët bazueshmëria e kërkesëpadisë (vendosja meritore).

Verifikimi i kompetencës

Prezumimet procedurale të klasifikuara në grupin e prezumimëve procedurale që lidhën me gjykatën kryesisht janë grupi i dispozitave ligjore që i referohen kompetencës.³⁵²

Kompetenca e Gjykatave Themelore. Gjykata Themelore u krijua me Ligjin për Gjykatat- Ligji nr.03/2-19, i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin nr.04/L-171 dhe me Ligjin nr.05/L-032, ku sipas nenit 9 të tij, kjo gjykatë është gjykatë e shkallës së parë.

Gjykatat Themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe.

Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore gjykon në shkallë të parë të gjitha çështjet, përveç nëse kjo është kompetencë e një departamenti tjetër të Gjykatës Themelore.

Me dispozita e nenit 11 të Ligjit për Gjykatat, përcaktohet juridiksioni i Gjykatës Themelore sipas lëndës. Në paragrafin 1 (një) të nenit 11 (njëmbëdhjete) përcaktohet se: “*Gjykatat Themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe*”, ndërsa në paragrafi 2 (dy) të nenit të njëjtë përcaktohet së:”. *Gjykatat themelore janë*

³⁵¹ Prezumimet procedurale ndahen në: Prezumimet procedurale lidhur me gjykatë; Prezumimet procedurale lidhur me palët; Prezumimet procedurale lidhur me objektin e kontestit; Prezumimet procedurale lidhur me padinë.

³⁵² Struktura e dispozitave ligjore që i referohen prezumimëve procedurale që lidhen me gjykatën mund të jetë si në vijim: kompetenca lëndore e gjykatës në raport ndonjë gjykate tjetër, kompetenca e gjykatës në raport me organin administrativ, kompetenca e gjykatës në raport me gjykatën e huaj, kompetenca e gjykatës në raport me kompetencë e arbitrazhit, kompetenca e gjykatës në raportin e procedurës kontestimore më jokontestimore, kompetenca territoriale e gjykatës në raport me gjykatën tjetër, Përbërja e rregullt e gjykatës (kompetenca funksionale) dhe detyrimi i përjashtimit të gjyqtarit në raste të caktuara.

kompetente për të dhënë ndihmë juridike ndërkombëtare dhe për të vendosur për pranimin e vendimeve të gjykatave të huaja”.

Nga dispozitat e sipërcituara kuptohet së në juridiksionin e Gjykatës Themelore-Departamenti i Përgjithshëm, përfshihen të gjitha çështjet përveç nëse me ligj përcaktohet ndryshe. Në fakt në juridiksionin e Departamentit të Përgjithshëm, siç vërehet nga dispozita e cituara nuk janë të numëruara çështjet sipas lëndës në mënyrë taksative, por nga juridiksionet e departamenteve tjera kuptohet së cilat çështje nuk janë kompetencë e Departamentit të Përgjithshëm.

Në një përpjekje teorike për të identifikuar çështjet që potencialisht mund të trajtohen në Gjykatën Themelore-Departamentin e Përgjithshëm, mund të themi se juridiksioni i Departamentit të Përgjithshëm, i referohet çështjeve civile sipas padive civile, familjare dhe të Punës (*ky identifikim është sipas padive në pikëpamje të së drejtës materiale*).

Kompetenca Lëndore

Kompetenca lëndore është ajo në bazë të së cilës gjykatat e një kategorie kanë të drejtë dhe detyrë të gjykojnë disa çështje juridike për shkak të llojit, natyrës dhe vlerës së objektit të kontestit.

Vlerësimi i kompetencës lëndore. Edhe në rastet kur çështja e kompetencës nuk është ngritur nga palët, gjyqtari i çështjes duhet që menjëherë pas marrjes së padisë dhe gjatë gjithë procedurës, ta shikoj dhe të kujdeset se zgjidhja e kontestit hyn apo jo në kompetencën lëndore të gjykatës në të cilën është paraqitur.

Përcaktimi i kompetencës lëndore është kusht i domosdoshëm, ngase nga kjo varet lejueshmëria e procesit gjyqësor, që do të thotë se në rast se gjykata për çështjen e shtruar para saj nuk është kompetente, atëherë nuk mund të kryejë asnjë veprim procedural rreth asaj çështje.

Detyrimi i gjykatës që ta vlerësoj zyrtarisht kompetencën menjëherë pas marrjes së padisë dhe gjatë gjithë procesit gjyqësor përcaktohet me dispozitat nga neni 17.1, 18.1 dhe 19, 20.1 dhe 21.1 të LPK-së.

Gjykatësi e vlerëson kompetencën lëndore duke u bazuar në thëniet e paditësit dhe në bazë të fakteve që i ka të njohura vet gjykatësi.

Në të gjitha rastet e jo kompetencës lëndore, gjyqtari i çështjes duhet të vendosë me aktvendim. Ky lloj vendimi gjyqësor parashihet me dispozitën e nenit 387 par 1, pika u) të LPK-së.

Kriteret që e rregullojnë kompetencën lëndore. Për caktimin e kompetencës lëndore janë të njohura dy kritere:

- Objekti i kontestit dhe
- Vlera e Objektivit të Kontestit (vetëm për përdorim të mjetit të jashtëzakonshëm-revizioni).

Këto kritere konsiderohen në bazë të përmbajtjes së padisë. Kompetenca e gjykatës paraqet prezumim procedural ngase në mungesë të këtij kushti gjykata nuk mund të lëshohet në themelësinë e kërkesëpadisë.

Jo kompetenca lëndore e gjykatave mund të paraqitet si në vijim:

Jo kompetenca lëndore në raport me gjykatën tjetër. Ky rast praktikisht ndodhë kur çështja është shtruar para Gjykatës Themelore-Departamentit të Përgjithshëm ndërsa kompetent mund të jetë Departamenti për Çështje Administrative, Departamenti për Çështje Ekonomike apo Dhoma e Veçante e Gjykatës Supreme të Kosovës.

Gjyqtari i çështjes ka kompetencë që menjëherë pas marrjes së padisë dhe gjatë zhvillimit të procedurës ta shikojë kompetencën lëndore dhe në rast se vlerëson se çështja e shtruar nuk është në kompetencë të gjykatës para të cilës është shtruar, por e ndonjë gjykate tjetër, atëherë me aktvendim e shpallë gjykatën jo kompetente dhe lëndën ja dërgon gjykatës për të cilën mendon se është kompetente për gjykimin e çështjes së ngritur me padi.

Jo kompetenca lëndore në raport me organin administrativ. Në praktikë mund të ndodhë që pranë gjykatës të paraqiten çështje për të cilat nuk është kompetente gjykata por ndonjë organ administrativ.

Nëse pas shqyrtimit paraprak të padisë dhe gjatë gjithë zhvillimit të procedurës gjyqtari arrin në vlerësimin se çështja e ngritur me padi nuk hynë në kompetencë gjyqësore por është çështje për të cilën kompetent është organi administrativ, atëherë nxjerr aktvendim për inkompetencë dhe padinë e hedhë si të palejueshme.

Në qoftë së gjykata është lëshuar në shqyrtim dhe ka ndërmarrë veprime procedurale, atëherë nxjerrë aktvendim për inkompetencë, i anulon veprimet e ndërmarra dhe padinë e hedhë si të palejueshme.

Në këto raste lënda nuk i dërgohet organit administrativ për të vendosur lidhur me çështjen e shtruar në padinë e paraqitur në gjykatë.

Jo kompetenca e gjykatës së vendit

Në praktikë ndodhë që para gjykatës të shtrohen çështje me element të huaj, ku vlerësimi i kompetencës lëndore ka të bëjë me atë që zgjidhjen e çështjes duhet ta ndërmer gjykata e vendit apo ndonjë gjykatë e vendit të huaj.

Nëse gjyqtari konstaton se për zgjidhjen e kontestit kompetente është ndonjë gjykatë e ndonjë vendi tjetër e jo gjykata vendore, atëherë gjyqtari me aktvendim e shpallë gjykatën vendore inkompetente, anulon veprimet procedurale të kryera deri në atë fazë dhe padinë e hedhë poshtë. Gjykatësi nuk do të veprojë kështu në rastet kur i padituri jep pëlqimin që gjykata vendore mund të shqyrtojë dhe të vendosë në lidhje me çështjen.³⁵³

Jo kompetenca lëndore kur palët kanë kontraktuar arbitrazhin

Gjykatat mund të përballen me situata ku palët për zgjidhjen e një kontesti të caktuar e kanë kontraktuar arbitrazhin. Gjykata, të cilës i është paraqitur padia për të njëjtin kontest midis palëve të njëjta, sipas kundërshtimit të palës së paditur për kompetencën do të shpallet in-kompetente, do t'i anulojë veprimet e kryera në procedurë dhe do ta hedhë poshtë padinë.

Gjykata nuk vepron kështu vetëm po që se konstaton se kontrata mbi arbitrazhin nuk është e vlefshme, se ka pushuar vlefshmëria e saj apo se nuk mund të realizohet.³⁵⁴

Jo kompetenca në rastet e procedurave jokontestimore

Në këto raste, gjykata gjatë zhvillimit të procedurës konstaton se procedura do të duhej të zhvillohej sipas rregullave të procedurës jokontestimore.

Nëse gjyqtari gjatë shqyrtimit të lëndës mbi çështjen kryesore konstaton se procedura do të duhej të zhvillohej sipas rregullave të procedurës jokontestimore, me anë të aktvendimit për in kompetencë do të përfundojë procedurën kontestimore. Në këto raste gjyqtari nuk e hedhë poshtë padinë por çështjen e dërgon tek gjykata kompetente për zhvillimin e procedurës jokontestimore. Duhet të kihet parasysh se veprimet e kryera nga gjykata gjatë procedurës kontestimore (këqyrja direkte, ekspertiza, dëgjimet e dëshmitarëve etj.), si dhe vendimet e marra nga kjo gjykatë nuk shpallen të pavlefshme dhe nuk do të kryhen rishtas.³⁵⁵

³⁵³ Neni 18.3 i LPK-së,

³⁵⁴ Neni 20.1 i LPK-së,

³⁵⁵ Neni 21 të LPK-së.

Kompetenca Territoriale

Kompetenca territoriale përcakton së cila gjykatë e kompetencës lëndore brenda ndonjë territori të caktuar do të vendos lidhur më një rast konkret. Kompetenca territoriale mund të jetë si kompetencë e përgjithshme e gjykatës dhe kompetencë e veçantë.

Kompetenca e përgjithshme territorial. Edhe në të drejtën tonë procedurale për kompetencën tokësore të përgjithshme është pranuar rregulli *actor sequitur forum rei*. Sipas këtij rregulli për gjykimin e një çështjeje juridike e kompetencës së përgjithshme tokësore është gjykata e cila për palën e paditur është e kompetencës së përgjithshme tokësore.³⁵⁶

Si e përcakton LPK-ja, kuptimin e kompetencës së përgjithshme territoriale?

Sipas dispozitës së nenit 37 paragraf 1, të LPK-së, përcaktohet se: “*Në qoftë se me ligj nuk është caktuar kompetenca ekskluzive territorial e ndonjë gjykate tjetër, për procedimin e çështjes është kompetente gjykata e kompetencës së përgjithshme territoriale*”.

Si e përcakton LPK-ja, përjashtimin e kompetencës së përgjithshme?

Sipas dispozitës së nenit 37 paragraf 2, të LPK-së, përcaktohet se: “*Në rastet e përcaktuara me këtë ligj, për procedimin e çështjes është kompetente, përpos gjykatës së kompetencës së përgjithshme territoriale edhe gjykata tjetër e caktuar*”.

Çfarë kriteri përcakton LPK-ja, për përcaktimin e kompetencës së përgjithshme territoriale?

Sipas dispozitës së nenit 38 paragraf 1, të LPK-së, përcaktohet se: “*Për procedimin e çështjes juridike është e kompetencës së përgjithshme territoriale gjykata në territorin e të cilës i padituri e ka vendbanimin*”, ndërsa në paragrafin 2 të nenit të njëjtë përcaktohet se: “*Në qoftë se i padituri nuk ka vendbanim, e kompetencës së përgjithshme territoriale është gjykata në territorin e të cilës i padituri e ka vendbanimin*”.

Vlerësimi i kompetencës së përgjithshme territoriale. Gjyqtari më rastin e marrjes në shqyrtim të rastit e vlerëson kompetencën e përgjithshme territoriale të gjykatës duke marrë për bazë vendbanimin apo vendqëndrimin e palës së paditur, ndërsa kur bëhet fjalë për personat juridik kompetenca e përgjithshme territoriale përcaktohet në bazë të territorit të selisë së personit juridik.

Kur para gjykatës jo kompetente paraqitet për objekt shqyrtimi ndonjë çështje e kompetencës së përgjithshme territoriale, atëherë gjyqtari i çështjes mund të marrë aktvendim me të cilin gjykatën

³⁵⁶Faik Brestovci, E Drejta Procedurale Civile I, Prishtinë 2006, fq.57.

e shpallë jo kompetente vetëm pas prapësimit të palës së paditur dhe atë më së voni deri në seancën përgatitore e në rast së nuk mbahet seanca përgatitore deri në seancën e shqyrtimit kryesor. Nëse tërhiqet propozimi konsiderohet së nuk është paraqitur fare.

Në rastet e përcaktuara me Ligjin për Procedurën Kontestimore, për procedimin e çështjes është kompetente, përpos gjykatës së kompetencës së përgjithshme territoriale edhe gjykata tjetër e caktuar, e cila ndërlidhet më kriteret për caktimin e kompetencës së veçantë.

Kompetenca e veçantë territoriale

Për gjykimin e disa kontesteve të caktuara LPK-ja, e përjashton kompetencën e përgjithshme territoriale, sipas vendbanimi apo vendqëndrimit (*përkatësisë selisë së personit juridik*) të të paditurit, duke përcaktuar si kompetente gjykatë tjetër.

Kompetenca e veçantë territoriale mund të paraqitet si në vijim:

Kompetenca territoriale ekskluzive. Kompetenca territoriale ekskluzive e përjashton kompetencën e përgjithshme territoriale dhe asnjë gjykatë tjetër nuk mund të gjykojë në kontestet e tilla. Kompetenca territoriale ekskluzive paraqitet si në vijim:

- Kompetenca në kontestet lidhur me sendet e paluajtshme;³⁵⁷
- Kompetenca në kontestet lidhur me mjete e fluturimit;³⁵⁸
- Kompetenca për kontestet në procedurën përmbaruese dhe të falimentimit;³⁵⁹

Rastet kur vjen në shprehje kompetenca territoriale ekskluzive e gjykatës janë përcaktuar me nenin 41, 42 dhe 43 të LPK-së:

Nëse ndonjëri prej këtyre rasteve paraqitet si objekt shqyrtimi para gjykatës e cila nuk ka kompetencë territoriale ekskluzive, atëherë gjyqtari i çështjes sipas detyrës zyrtare pa prapësimin e palës merr aktvendim me të cilin gjykatën e shpallë jo kompetente dhe lëndën ja dërgon gjykatës për të cilën mendon së është kompetente.

³⁵⁷ Kontestet lidhur me pronësinë dhe të drejtat sendore mbi sendet e paluajtshme; kontestet për shkak të pengim posedimit mbi sendet e paluajtshme dhe kontestet nga raportet e qiradhënies së palujtshmërisë, ose nga kontratat për shfrytëzimin e banesave apo të lokaleve të punës.

³⁵⁸ Kontestet lidhur me të drejtën e pronësisë apo të drejtave sendore të tjera mbi mjetin e fluturimit dhe Kontestet nga raporti i qiradhënies së mjetit të fluturimit.

³⁵⁹ Kontestet që lidin gjatë dhe lidhur me procedurën e përmbarimit gjyqësor dhe administrativ, gjegjësisht gjatë dhe lidhur me procedurën e falimentimit, në pikëpamje territoriale është ekskluzivisht kompetente vetëm gjykata në territorin e së cilës ndodhet gjykata, e cila është duke e zhvilluar procedurën përmbaruese apo të falimentimit, gjegjësisht gjykata në territorin e së cilës është duke e kryer përmbarimin administrativ.

Kompetenca territoriale e zgjedhur

Në rastet e kompetencës territoriale të zgjedhur, pala paditëse mund të zgjedh se ku dëshiron të paraqes padinë dhe atë në gjykatën e kompetencës së përgjithshme tokësore ose ndonjë gjykatë tjetër që mund të jetë kompetente sipas kompetencës tokësore të zgjedhur. Kompetenca territoriale e zgjedhur paraqitet si në vijim:

- Kompetenca territoriale e zgjedhur në kontestet martesore.³⁶⁰
- Kompetenca në kontestet për vërtetimin apo kundërshtimin e atësisë apo amësisë.³⁶¹
- Kompetenca në kontestet për ushqimin ligjor.³⁶²
- Kompetenca në kontestet për shpërblimin e dëmit.

Edhe te ky rast i kompetencës pala paditëse ka mundsi që ta zgjedhë kompetencën tokësore duke ju drejtuar gjykatës së kompetencës së përgjithshme apo gjykatës tjetër kompetente.³⁶³

Këto rregulla vlejné për rastet e auto-përgjegjësisë:³⁶⁴

³⁶⁰ Konstatimi i ekzistimit dhe mosekzistimit të martesës, anulimi i martesës dhe zgjidhja e martesës.

Në këto dy raste pala paditëse ka të drejtë të zgjedhë se a do ta paraqes padinë në gjykatën e cila është e kompetencës së përgjithshme territoriale apo në gjykatën ku palët kanë pasur vendbanimin e fundit të përbashkët.

³⁶¹ Në kontestet e tilla kur palë paditëse është fëmija, atëherë fëmija ka të drejtë që të paraqesë padi ose në gjykatën e kompetencës së përgjithshme ose në gjykatën, në territorin e së cilës paditësi e ka vendbanimin ose vendqëndrimin. Ky rregull për kompetencën e zgjedhur vlen vetëm në qoftë së fëmija është palë paditëse, ndërsa në qoftë se palë paditëse është i ati ose e ëma atëherë vlejné rregullat e kompetencës së përgjithshme.

³⁶² Në kontestet e tilla paditësi që kërkon alimentacion ka të drejtë që padinë ta paraqesë përveç në gjykatën e kompetencës së përgjithshme edhe në gjykatën ku paditësi e ka vendbanimin gjegjësisht vendqëndrimin.

³⁶³ Lidhur me këtë kompetencë paraqiten dy situata: *Situata e parë*: i referohet kontesteve lidhur me përgjegjësinë jokontraktuale për dëmin nga e cila rrjedh se përveç gjykatës së kompetencës së përgjithshme territoriale, kompetente është edhe gjykata në territorin e së cilës është kryer veprimi dëmtues apo gjykata në territorin e së cilës ka lindur pasoja e dëmit. *Situata e dytë*: i referohet kontesteve kur dëmi është shkaktuar për shkak të vdekjes apo lëndimit të rëndë trupor nga e cila rrjedh se përveç kompetencës si në situatën e parë kompetente është edhe gjykata në territorin e së cilës paditësi ka vendbanimin respektivisht vendqëndrimin.

³⁶⁴ Përshkrimi praktik i situatës së parë:

Subjekti X me vendbanim nga Prishtina përderisa lëvizë me veturën e tij në qytetin e Pejës, rruga “Haxhi Zeka”, për shkak të pakujdesisë del nga rruga duke u përplasur në murin e jashtëm të shtëpisë së subjektit Y, me ç’rast subjektit Y i shkaktohet dëm material.

Në këtë rast subjekti Y, në cilësinë e paditësit, ka mundsi që të zgjedhë nëse padinë do ta paraqesë para gjykatës së kompetencës së përgjithshme në Prishtinë (sipas vendbanimit të të paditurit) apo para gjykatës së zgjedhur në Pejë (sipas vendit ku është kryer veprimi dëmtues).

Përshkrimi praktik i situatës së dytë:

Subjekti X, me vendbanim në Prishtinë, përderisa lëvizë me veturën e tij në qytetin e Prizrenit, rruga “Lidhja e Prizrenit”, për shkak të shpejtësisë së madhe humb kontrollin mbi veturë dhe përplasët me një shtyllë elektrike ku si pasojë e përplasjes vije deri të lëndimi i rëndë i bashkudhëtarit Y i cili është me vendbanim nga Gjilani.

Në këtë rast subjekti Y, në cilësinë e paditësit, ka mundsi që të zgjedhë nëse padinë do ta paraqesë para gjykatës së kompetencës së përgjithshme në Prishtinë (sipas vendbanimit të të paditurit), para gjykatës së zgjedhur në Prizren

Kompetenca në kontestet për mbrojtjen e së drejtës në bazë të garancisë së prodhuesit.

Për gjykim në konteste të tilla përveç gjykatës së kompetencës së përgjithshme (selia e të paditurit) është kompetente edhe gjykata me kompetencë territoriale për shitësin (vendi ku është shitur sendi), kur rasti ka të bëjë me garancinë shkresore.³⁶⁵

Kompetenca në kontestet nga marrëdhënia e punës.

Për gjykim në kontestet e tilla kur paditës është punëtori, përpos gjykatës së kompetencës së përgjithshme territoriale për të paditurin, kompetente është edhe gjykata në territorin e së cilës kryhet puna ose është kryer, respektivisht gjykata në territorin e së cilës puna është dashur të kryhet, si dhe gjykata në territorin e së cilës është themeluar marrëdhënia e punës.³⁶⁶

Kompetenca sipas vendit të pagesës

Paditësi si posedues i kambialit ose çekut mund të vendos nëse dëshiron që për konteste lidhur me kambialin ose çekun të paraqes padi në gjykatën e kompetencës së përgjithshme tokësore për nënshkruesin ose në gjykatën në territorin e së cilës duhet të bëhet pagesa nga kambiali dhe çeku.³⁶⁷

(sipas vendit ku është kryer veprimi dëmtues), apo para gjykatës tjetër të zgjedhur në Gjilan (sipas vendbanimit të palës paditëse).

³⁶⁵ Rast praktik i situatës që ka të bëjë me këtë kompetencë:

Subjekti X, me seli në Gjilan merret me prodhimin e radiatorëve të cilët kanë garancion pesë vjeçar. Radiatorët e prodhuar në Gjilan janë shitur nga kompania Y, në Gjakovë e të cilët i ka blerë kompania Z sipas garancionit të prodhuesit X. Pas vendosjes së radiatorëve në punë ka rezultuar se të njëjtit kanë të meta pasi që e rrjedhin ujin.

Në këtë rast subjekti Z (blerësi), në cilësinë e paditësit, ka mundsi që të zgjedhë nëse padinë do ta paraqesë para gjykatës së kompetencës së përgjithshme në Gjilan (sipas selisë së të paditurit) apo para gjykatës së zgjedhur në Gjakovë (sipas vendit ku është shitur sendi).

³⁶⁶ Rast praktik i situatës që ka të bëjë me këtë kompetencë:

Subjekti X nga Peja, është punësuar në ndërmarrjen publike KEK-Prishtinë, mirëpo marrëdhënien e punës e ka themeluar në distriktin e Pejës të kësaj ndërmarrje, ndërsa detyrat e punës si instalues i njehsorëve elektrikë i kryen në territorin e Komunës së Klinës. Subjektit X i është ndërprerë marrëdhënia e punës nga punëdhënësi për shkak të performancës së dobët.

Në këtë rast subjekti X për mbrojtjen e të drejtave të tij nga marrëdhënia e punës në cilësinë e paditësit, ka mundsi që të zgjedhë nëse padinë do ta paraqesë para gjykatës së kompetencës së përgjithshme në Prishtinë, (sipas selisë së të paditurës), para gjykatës së zgjedhur në Pejë (sipas vendit ku ka themeluar marrëdhënien e punës) apo në Klinë (sipas vendit ku ka kryer punët).

³⁶⁷ Rast praktik i situatës që ka të bëjë me këtë kompetencë:

Subjekti X, është posedues i kambialit apo çekut të lëshuar nga subjekti Y me seli në Prishtinë, si nënshkrues i kambialit apo çekut, ndërsa në kambial apo çek është shënuar vendi i pagesës Gjilan. Nëse vije deri të mos realizimi i pagesës, në këtë rast subjekti X si posedues i kambialit apo çekut, ka të drejtë të paraqes padinë kundër nënshkruesit të kambialit apo çekut-subjektit Y dhe atë në gjykatën e kompetencës së përgjithshme në Prishtinë, (selia e të paditurit) apo në gjykatën e zgjedhur në Gjilan (vendi i pagesës).

Kompetenca sipas vendit ku ndodhet njësia e personit juridik

Në kontestet kundër personit juridik paditësi ka të drejtën e paraqitjes së padisë në gjykatën e kompetencës së përgjithshme tokësore ose në gjykatën, në territorin e secilës ndodhet njësia e personit juridik.³⁶⁸

Kompetenca në konteste për shkak të pengim-posedimit mbi sendin e luajtshëm

Në këtë rast paditësi si person i penguar në posedimin e fundit të sendit të luajtshëm, mund të zgjedhë që padinë ta paraqesë në gjykatën e kompetencës tokësore të përgjithshme ose në gjykatën, në territorin e së cilës është bërë pengimi.³⁶⁹

Kompetenca në konteste nga marrëdhëniet kontraktuese, dhe atë lidhur me:

- ekzistimin ose mosekzistimin e kontratës;
- me përmbushjen ose zgjidhjen e kontratës;
- lidhur me zhdëmtimet e shkaktuara nga mos përmbushja e kontratës.

Në raste të tilla paditësi mund të zgjedhë që padinë ta paraqesë në gjykatën e kompetencës së përgjithshme tokësore apo në gjykatën në territorin e të cilës pala e paditur ka marrë për obligim që ta përmbushë prestimin në bazë të kontratës.³⁷⁰

³⁶⁸ Rast praktik i situatës që ka të bëjë me këtë kompetencë:

Subjekti X, nga Mitrovica, ka lidhur kontratë me Postën dhe Telekomin e Kosovës Prishtinë-(PTK), njësia në Mitrovicë që PTK të shpërndajë rrjetin kabllor në objektin e subjektit X i cili gjendet në Mitrovicë, ku sipas kontratës parashihet se shpërndarja e rrjetit kabllor për internet duhet të përfundojë brenda një muaji nga dita e nënshkrimit të kontratës, në të kundërtën për çdo ditë vonese është kontraktuar kushti penal 0.001 % të vlerës së kontratës. PTK është vonuar pa fajin e subjekti X, në kohëzgjatje prej 10 ditësh. Në këtë rast subjekti X ka të drejtë të paraqesë padinë kundër PTK-së, në gjykatën e kompetencës së përgjithshme në Prishtinë, (selia e të paditurës) apo në gjykatën e zgjedhur në Mitrovicë (vendi ku gjendet njësia e të paditurës).

³⁶⁹ Rast praktik i situatës që ka të bëjë me këtë kompetencë:

Subjekti X, nga Prishtina, në territorin e komunës së Gjilanit, subjektit Y ja ka marrë automjetin e markës Audi, tipi 80, të cilin e ka pasur në posedim deri në atë kohë. Në këtë rast subjekti Y ka drejtë të paraqesë padinë kundër X, në gjykatën e kompetencës së përgjithshme në Prishtinë, (vendbanimi apo vendqëndrimi i të paditurit) apo në gjykatën e zgjedhur në Gjilan (vendi ku ka ndodhur pengimi i posedimit).

³⁷⁰ Rast praktik i situatës që ka të bëjë me këtë kompetencë:

Subjekti X, nga Prishtina ka lidhur kontratë me subjektin Y nga Prishtina, sipas të cilës subjekti Y për llogari të subjektit X do të bëjë çmontimin e pajisjeve për përpunimin e zhavorrit nga lokacioni i njohur me emrin “Kulla në Ferizaj” dhe të njëjtat pajisje duhet t’i montojë në lokacionin tjetër të njohur me emrin “Kodra” në Ferizaj.

Subjekti Y ka dështuar në përmbushjen e kontratës.

Në këtë rast subjekti X ka të drejtë që për përmbushjen e kontratës të paraqesë padi në gjykatën e kompetencës së përgjithshme në Prishtinë, (vendbanimi apo vendqëndrimi i të paditurit) apo në gjykatën e zgjedhur në Ferizaj (vendi i përmbushjes së kontratës).

Kompetenca në konteste nga marrëdhëniet trashëgimore - juridike

Në konteste të tilla paditësi ka të drejtë të paraqes padinë përveç gjykatës së kompetencës së përgjithshme tokësore edhe në territorin e gjykatës që zbaton procedurën trashëgimore.

Në rastet e tilla padia rëndom do duhej të paraqitet para gjykatës e cila është me kompetencë të përgjithshme territoriale, mirëpo dispozita e nenit 54 të LPK-së, lejon mundsinë që padia të paraqitet edhe në territorin e gjykatës e cila zbaton procedurën trashëgimore. Janë të mundshme situatat kur kontesti mund të iniciohet edhe para gjykatës e cila nuk është e kompetencës së përgjithshme territoriale por është gjykatë e zgjedhur pasi që sipas dispozitës së nenit 128.2 të Ligjit për Procedurën Jokontestimore (LPJK) parashihet mundësia që në rastin kur trashëgimlënësi në momentin e vdekjes nuk ka pasur vendbanim e as vendqëndrim të territorin e Kosovës, si kompetente territoriale për shqyrtimin e trashëgimisë të jetë gjykata ku gjendet pasuria trashëgimore e tij.³⁷¹

Kompetenca territoriale ndihmëse

Nëse lidhur me çështjen që do të paraqitet para gjykatës nuk gjejmë zgjidhje se cila gjykatë do të jetë kompetente sipas dispozitave që rregullojnë kompetencën tokësore të përgjithshme, ekskluzive dhe të zgjedhur atëherë vijnë në shprehje dispozitat që kanë të bëjnë me kompetencën territoriale ndihmëse që i mundsojnë palës paditëse realizimin e të drejtës në mënyrë më të lehtë. Kompetenca territoriale ndihmëse mund të paraqite si në vijim:

- Kompetenca territoriale ndihmëse për bashkë-ndërgjyqësit

Në rastet kur në cilësinë e palës së paditur paraqitën disa bashkë-ndërgjyqës, kompetenca tokësore e lidhur më njëjërën palë të paditur vlen për të gjitha palët tjera të paditura, që paraqitën në cilësinë e bashkë-ndërgjyqësve.

³⁷¹ Rast praktik i situatës që ka të bëjë me këtë kompetencë:

Në qoftë se subjekti X ka vdekur në Francë dhe i njëjti ka masë trashëgimore në Kosovë por nuk ka vendbanim e as vendqëndrim në Kosovë, atëherë procedura e shqyrtimit të trashëgimisë mund të fillojë në territorin e gjykatës ku gjendet masa trashëgimore. Deri sa nuk përfundon me vendim të formës së prerë procedura e trashëgimisë e iniciuar para gjykatës ku gjendet masa trashëgimore, për gjykim në konteste nga marrëdhënia trashëgimore si dhe në kontestet lidhur me kërkesat e kreditorëve ndaj trashëgimlënësve përpos gjykatës me kompetencë të përgjithshme (vendbanimi apo vendqëndrimi i trashëgimlënësit - Francë) është kompetente edhe gjykata në territorin e së cilës ndodhet gjykata që zbaton procedurën trashëgimore-Kosovë.

Rregullat e kësaj kompetence gjejnë zbatim vetëm për bashkë-ndërgjyqësit pasiv, kur paraqiten si të paditur.³⁷²

- Kompetenca territoriale ndihmëse në kontestet martesore

Në këto konteste kompetenca ndihmëse vjen në shprehje ngase përveç kompetencës së përgjithshme territoriale (ku i padituri e ka vendbanimin përkatësisht vendqëndrimin në Kosovë), kompetencës së zgjedhur (ku palët e kanë pasur vendbanimin e fundit të përbashkët përkatësisht vendqëndrimin në Kosovë), vjen në shprehje kompetenca ndihmëse e cila përcakton mundsinë që pala paditëse ta paraqesë padinë në vendin ku e njëjta e ka vendbanimin.

- Kompetenca territoriale ndihmëse në kontestet e raporteve pasurore-juridike të bashkëshortëve

Në konteste të natyrës së tillë kompetenca tokësore ndihmëse vjen në shprehje pasi që padia mund të paraqitet në territorin e Kosovës përkatësisht në gjykatën në territorin e së cilës pala paditëse e ka vendbanimin ose vendqëndrimin në kohën e paraqitjes së padisë edhe nga shkak i pasurisë e bashkëshortëve ndodhet në Kosovë.

- Kompetenca territoriale ndihmëse në kontestet për vërtetimin apo kundërshtimin e amësisë apo atësisë

Kjo kompetencë i referohet kontesteve me element të huaj por që kompetente është gjykata e vendit tonë, për shkak se pala paditëse e ka vendbanimin ose vendqëndrimin në Kosovë në momentin e ngritjes së padisë, ndërsa kompetenca brenda vendit tonë përcaktohet sipas kriterit se ku paditësi e ka vendbanimin (në territorin e cilës gjykatë brenda Kosovës).

- Kompetenca territoriale ndihmëse në kontestet për ushqim ligjor

Kjo kompetencë i referohet kontesteve me element të huaj por që kompetente është gjykata e vendit tonë, për shkak se pala paditëse e ka vendbanimin ose vendqëndrimin në Kosovë në

³⁷² Rast praktik i situatës që ka të bëjë me këtë kompetencë: Subjekti X ka një ordinancë stomatologjike në Prishtinë dhe nga puna e stomatologut ka realizuar të hyra mujore në shumë prej 5000 Euro. Subjektet Y dhe Z me veprimet e tyre të përbashkëta kanë përhapur të dhëna të rrejshme për veprimtarinë e subjektit X gjoja se i njëjti nuk është i kualifikuar për punën që bënë dhe për shkak të këtyre të dhënave të rrejshme, subjekti X i është zvogëluar puna, ashtu që tani realizon vetëm 1000 Euro të hyra mujore. Subjekti Y e ka vendbanimin në Ferizaj ndërsa subjekti Z e ka vendbanimin në Gjiilan. Në këtë rast për shkak të cilësisë së bashkë ndërgjyqësve pasiv që kanë të paditurit, subjekti Y dhe Z, atëherë paditësi, subjekti X mundet që padinë ta paraqes qoftë në gjykatën Themelore në Ferizaj ose në gjykatën Themelore në Gjiilan.

momentin e ngritjes së padisë, ndërsa kompetenca brenda vendit tonë përcaktohet sipas kriterit se ku paditësi e ka vendbanimin (në territorin e cilës gjykatë brenda Kosovës).

Po që se kjo kompetencë është e gjykatës së vendit tonë nga shkaku se i padituri e ka pasurinë në Kosovë, nga e cila mund të realizohet ushqimi ligjor, atëherë kompetenca brenda vendit tonë përcaktohet sipas kriterit se ku ndodhet pasuria e të paditurit nga e cila mund të realizohet ushqimi ligjor.

- Kompetenca territoriale ndihmëse për personat për të cilët në Kosovë nuk ekziston gjykata e kompetencës territoriale

Në qoftë së kjo kompetencë i referohet kërkesave pasurore juridike kundër personit, për të cilin nuk mund të përcaktohet kompetenca ndërkombëtare e vendit tonë, kompetente është gjykata në territorin e së cilës ndodhet çfarëdo pasurie e palës së paditur apo sendi që kërkohet me padi.

Në qoftë së kjo kompetencë i referohet shkakut se detyrimi është krijuar gjatë qëndrimit të palës së paditur në Kosovë, atëherë është kompetente gjykata në territorin e së cilës është krijuar detyrimi.

Në qoftë së kjo kompetencë i referohet vendit të përmbushjes, atëherë kompetente do të jetë gjykata në territorin e së cilës detyrimi do të përmbushet.

- Kompetenca territoriale ndihmëse sipas vendit ku ndodhet përfaqësia e personit juridik

Për të vendosur lidhur me kontestet kundër personave fizikë apo edhe juridik, të cilët e kanë vendbanimin respektivisht selinë jashtë territorit të Republikës së Kosovës, por detyrimet janë krijuar apo duhet të përmbushën në Kosovë, atëherë kompetente do të jetë gjykata në territorin e së cilës ndodhet përfaqësia e këtij personi të huaj juridik apo qendra e ndonjë organi të këtij personi juridik, organ të cilit i është besuar kryerja e punëve të tij.

Kjo kompetencë përveç se është ndihmëse, është e karakterit subsidiar që do të thotë se mund të aplikohet vetëm në qoftë se për subjektin e cekur më lartë nuk mund të themelohet kompetenca sipas cilësdo kompetencë të veçantë.

Caktimi i kompetencës territoriale nga gjykata e lartë

Caktimi i kompetencës të një gjykate nga ana e një gjykate më të lartë ose nga ana e gjykatës supreme realizohet përmes institucioni të delegimit dhe ordinimit.

Delegimi i domosdoshëm i kompetencës

Në praktikë mund të paraqiten raste kur gjykata kompetente për shkak të përjashtimit të gjyqtarëve apo për shkaqe tjera nuk mund të procedoj me çështjen. Në këto raste gjykata e cila nuk mund të procedojë me çështjen duhet ta njoftojë gjykatën e shkallës më të lartë me qëllim që e njëjta të caktojë gjykatë tjetër nga territori i vet, por që është e kompetencës lëndore për çështjen konkrete. Rastet më të shpeshta praktike të delegimit të domosdoshëm të kompetencës:

- kur kryetari i gjykatës apo ndonjë gjyqtar është palë në procedurë;
- kur ndonjë punëtorë i gjykatës është palë në procedurë;
- kur gjyqtarët për shkak të përfshirjes në procedura tjera nuk u lejohe të marrin pjesë në gjykimin e çështjes, (gjyqtari që ka marrë pjesë në pajtimin gjyqësor me të cilin ka përfunduar procedura, nuk mund të vendos sipas padisë për anulimin e pajtimit gjyqësor dhe nëse nuk ka gjyqtar tjerë atëherë lënda dërgohet për delegim) etj.

Në këto raste por edhe në raste tjera të mundshme gjyqtari i çështjes duhet që përmes kryetarit të gjykatës të kërkojë nga gjykata më e lartë delegimin e lëndës.

Pasi që lënda t'i dërgohet gjykatës më të lartë për delegim, kryetari i gjykatës me të lartë (për gjykatat themelore vendos Gjykata e Apelit – Kryetari i Gjykatës së Apelit) me aktvendim vendos për delegimin e lëndës tek gjykata tjetër kompetente.

Delegimi i arsyeshëm. Përveç rasteve të cekura te delegimi i domosdoshëm mund të paraqiten rrethana të cilat bëjnë që shqyrtimi i çështjes nga një gjykatë tjetër të ishte shumë më i lehtë dhe më efikas.

Si rrethana të cilat e bëjnë një gjykatë tjetër më efektive për shqyrtimin e çështjes mund të jenë: kur provat ose shumica e provave gjenden në territorin e gjykatës ku delegohet çështja, p.sh. këqyrja e drejtpërdrejtë e objektit nga gjykata të cilës i është deleguar çështja.

Kur paraqiten arsytet apo rrethanat për delegim të arsyeshëm, propozimin për delegim të arsyeshëm mund ta paraqet pala apo gjykata kompetente. Për të vendosur sipas propozimit të palës apo edhe të vet gjykatës kompetente, kompetente është vetëm Gjykata Supreme e Kosovës.

Delegimi i një çështje juridike prej një gjykate kompetente në ndonjë gjykatë tjetër mund të bëhet vetëm në pikëpamje të kompetencës tokësore dhe jo në aspektin lëndorë. Sipas kësaj nuk mund të bëhet bartja e lëndës nga Departamenti i Përgjithshëm në Departamentin për Çështje Administrative apo në atë për Çështje Ekonomike.

Ordinimi

Koncepti i ordinimit vjen në shprehje dhe është i lejueshëm vetëm në rastet kur dihet me saktësi se gjykata e vendit tonë është kompetente në pikëpamje lëndore por nuk dihet se cila gjykatë është kompetente në pikëpamje tokësore.

Procedura për ordinimin vihet në lëvizje në bazë të kërkesës së palës paditëse. Kompetent për të paraqitur këtë kërkesë është vetëm pala paditëse, që mund të jetë edhe prokurori i shtetit.

Gjykata Supreme pasi që t'i vlerësoj rrethanat e paraqitura në kërkesën për ordinim dhe ato sipas detyrës zyrtare, me anë të aktvendimit vendos që ta caktojë gjykatën kompetente në pikëpamje territoriale për të vendosur.

Marrëveshja mbi kompetencën territoriale

Palët mund të merren vesh që çështjen e tyre juridike ta gjykojë gjykata, e cila sipas rregullave ligjore për kompetencën tokësore nuk do të ishte kompetente për një gjë të tillë. Palët mund të merren vesh vetëm për kompetencën territoriale të gjykatës dhe asnjëherë për kompetencën lëndore të gjykatës.

Rastet kur palët mund ta kontraktojnë kompetencën:

- kompetenca mund të kontraktohet vetëm në pikëpamje territoriale,
- për çështjet që nuk janë kompetencë ekskluzive e një gjykate tjetër,
- për çështjet që kompetente janë dy gjykata territoriale të vendit tonë.
- gjykata për të cilën kontraktohet kompetenca duhet të jetë kompetente lëndore.

Kushtet për kontraktim të kompetencës:

- marrëveshja e vlefshme e palëve
- marrëveshja t'i bashkëngjitet padisë

Konflikti në lidhje me kompetencën

Paraqitet në rastet kur gjykata së cilës i është dërguar lënda për vendosje konsideron se nuk është kompetente për të vepruar sipas saj, por që është kompetente për të vepruar gjykata e cila ja ka dërguar lëndën ose ndonjë gjykatë tjetër.

Në këtë rast gjykata të cilës i është dërguar lënda, pa dhënë aktvendim për in-kompetencën e saj, nxjerr aktvendim me të cilin e hap konfliktin e kompetencës, dhe në afatin brenda tri ditësh ja

dërgon lëndën gjykatës më të lartë në mënyrë që ajo të vendosë lidhur me konfliktin e kompetencës.

Nga praktika: Në qoftë së konflikti i kompetencës ka lindur në mes të dy gjykatave themelore apo degëve të këtyre gjykatave, atëherë lënda i dërgohet gjykatës së Apelit si gjykata me e lartë për të dy gjykata, ndërsa në qoftë së konflikti është hapur në mes të Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit, atëherë lënda i dërgohet Gjykatës Supreme të Kosovës si gjykata me e lartë për të dy gjykatat. Në praktik shumë rrallë mund të ndodhë që të hapët konflikti i kompetencës në mes të gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë pasi që me riorganizimin e sistemit gjyqësore është e qartë së gjykatat e shkallës së parë i shqyrtojnë të gjitha çështjet në shkallë të parë ndërsa në gjykata e Apelit, çështjet dërgohen sipas mjeteve të goditjes.

Mundësia e gjykatës që të mos kërkojë që të vendoset lidhur me konfliktin e kompetencës

Në rastin kur ka ndodh ndonjë gabim i hapur nga gjykata e parë për kompetencën (kjo vjen në shprehje te rastet e kompetencës territoriale ekskluzive), ku qartazi shihet se kompetente do të ishte ndonjë gjykatë tjetër.

Në vazhdim do të paraqitet një rast praktik kur gjykata ka mundsi që ta rikthejë lëndën te gjykata e shkallës së parë apo te gjykata tjetër pa hapur konflikt për kompetencë.³⁷³

Veprimi obligativ i vendimit të gjykatës së shkallës së dytë lidhur me kompetencën

Nëse pala ka bërë ankesë kundër aktvendimit të gjykatës e cila është shpallë jo-kompetente në pikëpamje tokësore dhe lëndën ja ka dërguar gjykatës kompetente dhe nëse ky vendim bëhet i formës së prerë për shkak se është vërtetuar me vendimin e shkallës më të lartë, atëherë vendimi i gjykatës së shkallës së lartë e obligon edhe gjykatën e dytë te e cila është dërguar lënda nga gjykata e parë.

Kur gjykata nxjerr vendim lidhur me inkompetencën lëndore dhe pala ka bërë ankesë kundër atij vendimi, nëse gjykata kompetente lidhur me konfliktin e kompetencës e refuzon ankesën e palës dhe e vërteton aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë, atëherë ky aktvendim i gjykatës së shkallës së parë lidhur me konfliktin për kompetencën i obligon të gjitha gjykatat.

³⁷³ Rast praktik i një situate të tillë: Nëse Gjykata Themelore në Prishtinë ja ka dërguar lëndën Gjykatës Themelore në Pejë, edhe pse kompetente do të ishte Gjykata Themelore në Prizren, për shkak se kontesti ka të bëjë me paluajtshmërinë që gjendet në territorin e kësaj gjykate, atëherë Gjykata Themelore e Pejës, mundet lëndën t'ia kthejë Gjykatës Themelore në Prishtinë, pa hapur konflikt të kompetencës pasi që ta vërejë se Gjykata Themelore e Prishtinës, gabimisht e ka dërguar lëndën në Gjykatën Themelore në Pejë.

Zgjidhja e konfliktit për kompetencën

Në praktikë ndodhë që konflikti për kompetencën të lindë në atë mënyrë kur dy gjykata pretendojnë se janë kompetente lidhur me shqyrtimin e një çështje kryesore (ky konflikt në shkencën juridike njihet si konflikti pozitiv) ose nëse gjykatat pretendojnë se nuk janë kompetente për zgjidhjen e një çështje konkrete (si konflikti negativ).

Lindja e konfliktit të kompetencës në mes të gjykatave të llojit të njëjtë

Në rast se lindë konflikti lidhur me kompetencën në mes të gjykatave të llojit të njëjtë atëherë kompetente për të vendosur lidhur me këtë është gjykata më e lartë dhe e përbashkët për gjykatat në konflikt.³⁷⁴

Në rast të lindjes së konfliktit lidhur me kompetencën në mes të gjykatave themelore, kompetent për të vendosur lidhur me këtë do të jetë Gjykata e Apelit. Në të njëjtën mënyrë do të veprohet edhe në rastet e konfliktit të kompetencës në mes të departamenteve të të njëjtës Gjykatë.

Lindja e konfliktit të kompetencës në mes të gjykatave të llojit të ndryshëm

Nëse konflikti i kompetencës lindë në mes të gjykatave të llojit të ndryshëm, kompetent për të vendosur lidhur me zgjidhjen e këtij konflikti është Gjykata Supreme e Kosovës.

Një situatë e tillë do të vije në shprehje nëse lindë konflikti për kompetencën në mes të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore.

Duhet të kihet parasysh se deri sa është i hapur konflikti lidhur me kompetencën, gjykata e cila e ka pranuar lëndën nga gjykata e parë duhet të ndërmer veprimet e duhura procedurale, nëse ato janë të ngutshme dhe nëse në rast të mosndërmarrjes së këtyre veprimeve procedurale do të shkaktoheshin dëme të pa riparueshme për palët. Një rast i tillë mund të vije në shprehje të çështja e sigurimit të provës, nga e cila provë varet zgjidhja e kontestit ose sqarimi i tij, kur ka rrezik që të zhduket ose të vështirësohet marrja e saj.

Gjykata kompetente për të vendosur lidhur me konfliktin për kompetencën ka mundësi që të vendos pa shqyrtim gojor të çështjes, pra mund të vendos për konfliktin e kompetencës edhe nëse palët fare nuk janë deklaruar lidhur me kompetencën.

³⁷⁴ Nga praktika: Në mes të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës Themelore në Ferizaj, atëherë për konfliktin e kompetencës do të vendos Gjykata e Apelit si gjykatë me e lartë për të dy gjykatat.

Kundër aktvendimit me të cilin vendoset për konfliktin për kompetencën nuk lejohet përdorimi i mjeteve juridike të rregullta apo të jashtëzakonshme.

Përbërja e rregullt e gjykatës (kompetenca funksionale).

Më përbërje të gjykatës kuptojmë përbërjen në të cilën ajo gjykon, që domethënë vendos për themelin e kërkesëpadisë, apo për mjetin e goditjes së vendimit gjyqësor.

Përbërjen e gjykatës shkallë së parë, të dytë dhe të tretë, për çështje civile përcaktohet me dispozita e Ligjit për Gjykatat, Ligjit për Procedurën Kontestimore, Ligjit për Përmbartimore dhe Ligjit për Familjen.

Përbërja e gjykatës në shkallë të parë

Në procedurën e shkallës së parë dhe në procedurën sipas propozimit për përsëritjen e procedurës, vendos gjyqtari individual (i vetëm).³⁷⁵

Në procedurën e shkallës së në kontesteve martesore dhe në konteste e ushqimisë e zhvillon dhe i merr vendimit kolegji i përbërë prej një gjyqtari dhe dy gjyqtarëve porotë, kurse në shkallë e dytë kolegji prej tre gjyqtarëve.³⁷⁶

Përbërja e gjykatës në shkallë të dytë

Në procedurën e shkallës së dytë dhe procedurën sipas revizionit vepron trupi gjykues prej tre gjykatësve³⁷⁷.

Përbërja e gjykatës në shkallë të tretë

Gjykata Supreme shqyrton dhe gjykon lëndët në kolegji me nga tre (3) gjyqtar profesionist, me përjashtim kur me ligj parashihet një numër me i madh i gjyqtarëve.³⁷⁸

Përjashtimi dhe rekuizimi i gjyqtarit nga gjykimi.

³⁷⁵ Neni 15 paragrafi 1, i LPK-së.

³⁷⁶ Neni 73 dhe 324, i Ligjit për Familjen i Kosovës.

³⁷⁷ Neni 15 paragrafi 2, i LPK-së.

³⁷⁸ Neni 21 paragrafi 6, i Ligjit për Gjykatat.

Më qëllim që të sigurohet sidomos paanësia e gjykatës LPK ka rregulluar çështjen e përjashtimit të gjyqtarit apo të rekuizimit të gjyqtarit nga gjykimi.³⁷⁹

Përveç dispozitave të LPK-së, për përjashtimin e gjyqtarit nga gjykimi, një rendësi jashtëzakonisht të madhe për sigurimin e paanësisë së gjykatës e ka edhe Kodi i Etikës Profesionale për Gjyqtar³⁸⁰ dhe Rregullorja për Përcaktimin e Sjelljeve të Pahijshme³⁸¹.

Kodi i Etikës Profesionale për Gjyqtar, me dispozitën e nenit 2, përcakton se: “*Gjyqtari gjatë ushtrimit të funksionit të tij i trajton të gjitha palët në procedurë në mënyrë të barabartë pa favorizime, anime dhe paragjykime. Gjatë gjithë kohës gjyqtari duhet të jetë dhe duhet të duke i paanshëm. Paanshmëria ka të bëjë jo vetëm më vendimin, por edhe në procedurën e marrjes së vendimit*”. Ndërsa me dispozitën e nenit 2.5 përcaktohet se: “*Gjyqtari do të kërkoj përjashtimin e tij nëse të publiku mund të krijojë përshtypjen, ose kur e vlerëson vetë, se nuk është në gjendje të vendos në lidhje me lëndën në mënyrë të paanshme*”. Përveç që përcaktohet detyrimi i gjyqtari për të kërkuar përjashtimin e tij, në rast së gjyqtari nuk e kërkon përjashtimin parashihet edhe sanksione disiplinore ndaj tij/saj.

Me dispozita e nenit 5 të Rregullores për Përcaktimin e Sjelljeve të Pahijshme përcaktohen shkeljet e rënda, ndërsa në mënyrë specifike me dispozitën e nenit 5.1.9 përcaktohet si shkelje e rëndë e gjyqtarit : “*Nëse nuk kërkon që të përjashtohet nga lëndët në të cilat ekzistojnë arsytet që vënë në dyshim mundsin e vendimeve të anshme gjyqësore që nënkuptojnë lidhjet familjare, miqësore, afariste, sociale dhe lidhjet tjera me palët dhe përfaqësuesit e tyre*”.

Qëllimi i përcaktimit si shkelje e rëndë nga ana e gjyqtarit në rast së nuk kërkon përjashtimin e tij, nën kondita e përcaktuara me dispozitë e sipër cituar, është që gjyqtarët që kenë kujdesin e duhur në ruajtjen e paanësisë. Paanësia e gjykatës është mekanizimi kryesor i nxitjes s besimit të publikut në sistemin gjyqësor.

³⁷⁹ Me dispozitën e 7 paragrafi 1, i Ligjit për Gjykata parashihte se: “Gjykata trajtojnë të gjithë personat në mënyrë të barabartë, askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal”. Megjithatë, pavarësisht këtij detyrimi të gjykatës, ekzistojnë situata praktike kur mund të vije në pikëpyetje pavarësisë, paanësia, objektiviteti dhe besimi i publikut në gjykatë, për shkak të rrethanave që mund ta ndikojnë gjyqtarin apo që mund të krijojnë përshtypjen së gjyqtari është i ndikuar apo i njëanshme.

³⁸⁰ Kodi i Etikës Profesionale për Gjyqtarët, është miratuar me vendimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr.20/2016, datë 02.03.2016, i ndryshuar me vendimin e KGJK-së, nr.50/2016, datë 11.05.2016, në fuqi nga datë 01.09.2016.

³⁸¹ Rregullorja 04/2016, Për Sjelljet e Pahijshme, është miratuar me vendimin e KGJK-së, nr.21/2016, datë 02.03.2016, në fuqi nga data 01.09.2016.

Rrethanat të cilat qojnë deri të përjashtimi i gjyqtarit nga gjykimi

LPK-ja, i ka numëruar në mënyrë taksative rrethanat që përbejnë shkak që gjyqtari të përjashtohet domosdoshmërishtë. Rrethanat të cilat qojnë deri të përjashtimi i gjyqtarit nga gjykimi janë përcaktuar me nenin 67 të LPK-së.

Gjyqtari nuk mund ta procedojë çështjen juridike:

- *nëse është vetë palë, përfaqësues ligjor apo me prokurë i palës, apo nëse me palën është bashkëkreditor apo bashkëdebitor ose i obliguar për regresim, apo nëse në të njëjtën çështje është dëgjuar si dëshmitar ose si ekspert;*
- *nëse pala ose përfaqësuesi ligjor apo me prokurë i saj është kushëri gjaku në vijën vertikale deri në cilëndo shkallë, kurse në vijën horizontale deri në shkallë të katërt, apo nëse është bashkëshort, apo gjini e krushqisë deri në shkallë të dytë, pavarësisht nëse martesa ka pushuar ose jo;*
- *nëse është kujdestar, adoptues ose i adoptuar i palës, i përfaqësuesit të saj ligjor ose me prokurë;*
- *nëse në të njëjtën çështje ka marrë pjese në dhënien e vendimit të gjykatës më të ulët, ose të organit tjetër, ose në procedurën e ndërmjetësimit;*
- *në qoftë se ka vepruar në çështjen në të cilën është bërë ujdia gjyqësore, e me padinë e ngritur kërkohet anulimi i ujdisë së këtillë;*
- *nëse është aksionar apo anëtar i shoqërisë tregtare që është palë në procedurën e iniciuar me padi;*
- *Nëse ekzistojnë rrethana të tjera që e vejnë në dyshim paanësinë e tij.*

Këto janë rrethana të cilat sipas dispozitës ligjore të lartshënuar janë numëruar shprehimisht dhe taksativisht e që duhen të merren për bazë me rastin e përjashtimit të një gjyqtari nga një rast konkret. Për këto rrethana pika a)-f), është detyrë e gjyqtarit të çështjes që t'i paraqesë me kërkesë për përjashtimin e tij nga gjykimi para kryetarit të gjykatës.

Rrethanat nga neni 67 pika g), i referohen rrethanave që nuk janë të numëruara por që në procedurë mund të paraqiten në forma të ndryshme, andaj ndryshe njihen si rrethana që qojnë deri të rekuizimi i gjyqtarit.

Përveç këtyre rasteve të numëruara në mënyrë taksative kur gjyqtari duhet përjashtuar nga gjykimi, me dispozitave të LPK-së, ekziston edhe një situatë kur parashihet përjashtimi gjyqtarit në mënyrë taksative, e që i referohet rastit kur lejohet përsëritja e procedurës. Sipas dispozitës së nenit 241 paragrafi 1, i LPK-së, përcaktohet se: “Në *procedurën e përsëritur në gjykatën e shkallë së parë nuk mund të veprojnë gjyqtari që ka dhen vendimin në procedurën e me parashme*”.³⁸²

Rrethanat të cilat qojnë deri të rekuizimi i gjyqtarit nga gjykimi

Paragrafi g) i nenit 67 të LPK, nuk ka rregulluar as shprehimisht as taksativisht rastet e rekuizimit të gjyqtarit, por vetëm ka përmendur faktin nëse ekzistojnë rrethana të tjera që e vënë në dyshim paanësinë e gjyqtarit në vendosjen e çështjes të shtruar para tij.

Mund të ekzistojnë rrethana të tjera të cilat nuk klasifikohen si shkaqe që në mënyrë automatike gjyqtari të përjashtohet nga gjykimi (rrethanat e parapara nga paragrafi a) deri te paragrafi f), të nenit 67 të LPK) por janë rrethana të tilla që mund të sjellin në dyshim paanësinë dhe jo objektivitetin e tij në proces gjyqësor. Në këto raste, nëse gjyqtari i çështjes vlerëson se janë paraqitur rrethana për të cilat duhet të përjashtohet gjyqtari, gjithmonë duke e pasur në vëmendje edhe standardin e kodit të etikës, përmes kërkesës së arsyetuar duhet të kërkojë nga Kryetari i Gjykatës përjashtimin e vet nga gjykimi.

Nga praktika: Për rrethanat që njihen si rrethana për rekuizim të gjyqtarit, në praktikën gjyqësore ka një standard sipas të cilit në mënyrë parimore dihet se kur do të përjashtohet një gjyqtar nga gjykimi dhe kur nuk do të përjashtohet. Në këtë kuptim gjyqtarët asnjëherë nuk guxojnë ta përdorin mundsinë e përjashtimit të gjyqtarit nga gjykimi më qëllim që tu shmangën dosjeve komplekse, por mundsia e përjashtimit të gjyqtarit gjithmonë duhet të vije në shprehje në rastet kur ekzistojnë arsye të vërteta që e sjellin në dyshim paanësinë dhe objektivitetin e gjykatës.

Si rrethana të cilat mund të vlerësohen si të mjaftueshme për rekuizimin e gjyqtarit nga një proces, mund të jenë:

- Fakti së kryetari i asaj gjykate ka një çështje në gjykatë;
- Fakti së një gjyqtar i asaj gjykate ka rastin e tij në gjykatë,
- Fakti që gjyqtari qëndron në miqësi apo armiqësi me palën;
- Fakti që gjyqtari ka shprehur mendimin e tij se si do të përfundojë procesi para gjykatës (këtu duhet të përfshihet edhe mendimi i dhënë në ambientet private);

³⁸² Rast praktik i një shtate të tillë: Në qoftë së në gjykatën e shkallë së parë gjyqtari “X”, e ka shqyrtuar dhe e ka vendosur në mënyrë meritore një çështje juridike kontestuese me palë paditëse subjektin “AA” dhe të paditur subjektin “BB”, nën supozimin se vendimi ka marrë formën e prerë dhe ndaj të njëjtit gjykata e shkallë së dytë e ka lejuar përsëritjen e procedurës sipas kërkesës së njëres prej palëve ndërgjyqësore, atëherë në rishqyrtim në shkallë të parë këtë çështje nuk mund ta vendos gjyqtari”“X (që ka vendos më herët).

- Fakti që gjyqtari më herët ka marrë pjesë në negociim në mes të palëve, lidhur me të njëjtën çështje që është objekt shqyrtimi në procesin konkret;
- Shoqëria shumë e ngushtë në mes të gjyqtarit dhe personit, i cili ka vendosur lidhur me të njëjtën çështje juridike.

Këto janë disa nga rrethanat të cilat me ligj nuk janë paraparë shprehimisht dhe taksativisht por si të tilla u japin mundsi palëve në procedurë që të kërkojnë rekuizimin e gjyqtarit nga procesi gjyqësor.

Procedura

Pala duke nënkuptuar edhe secilin bashkë-ndërgjyqës dhe vet-ndërrhyrësin ka të drejtë të paraqes kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit kur ka mësuar se ekziston ndonjëri nga shkaqet për përjashtim. Këtë të drejtë pala mund ta shfrytëzoj deri në përfundim të shqyrtimit kryesor apo deri në nxjerrjen e vendimit meritor. Pala mundet që edhe në mjetin e goditjes së vendimit përfundimtar por edhe në përgjigje të mjetit të goditjes t'i theksojë rrethanat që kanë të bëjnë me përjashtimin e gjyqtarit nga një proces gjyqësor.

Edhe vet gjyqtari ka për detyrë që të vlerësoj ex officio se a ekzistojnë shkaqe për përjashtimin e tij nga një proces konkret.³⁸³

Kur janë në pyetje rrethanat për përjashtimin e gjyqtarit sipas pikës a), deri te pika f), të nenit 67 të LPK, mjafton vetëm paraqitja e të dhënave që dëshmojnë ekzistimin e raportit që është paraparë në ligj. Ndërsa kur janë në pyetje rrethanat nga pika g) , i këtij neni, që ka të bëjë me arsyet për rekuizimin e gjyqtarit, nga pala që kërkon rekuizimin e gjyqtarit duhet që të paraqes fakte të ndryshme dhe prova për ta dëshmuar se ekziston baza për rekuizimin e gjyqtarit.

Gjyqtari ka për obligim që ta ndërpres çdo veprim procedural posa ta kuptoj se është shtruar kërkesa rrethanë për përjashtimin e tij (kjo ka të bëjë vetëm me rrethanat nga pika a) deri te pika f) e nenit 67 të LPK) dhe për këtë ta njoftoj Kryetarin e Gjykatës.³⁸⁴

Kur kërkohet përjashtimi i gjyqtarit për rrethanat e parapara në nenin 67 pika g), që kanë të bëjnë me rekuizimin e gjyqtarit, gjyqtari i çështjes për këtë e njofton kryetarin e gjykatës por ka mundsi që të ndërmarr veprime të caktuara, nëse ndërmarrja e atyre veprimeve nuk mund të shtyhet.

³⁸³ Nëse gjyqtari konstaton se ekzistojnë rrethanat për të cilat ai duhet të përjashtohet nga gjykimi, duhet të paraqes kërkesë me shkrim për përjashtim nga gjykimi. Kërkesa i paraqitet kryetarit të gjykatës.

³⁸⁴ Neni 71.1 i LPK.

Autoriteti kompetent për të vendosur lidhur me kërkesën për përjashtimin dhe rekuizimin e gjyqtarit

Autoriteti kompetent që vendos për përjashtimin e gjyqtarit nga një proces nuk duhet të pranojë shumë lehtë kërkesa për përjashtim, përndryshe palët do të kenë sukses për të ndikuar në mënyrë efektive në zgjedhjen e gjyqtarit në rastin e tyre.

Para se të vendoset lidhur me kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit, merret deklarata e gjyqtarit me qëllim të vërtetimit të rrethanave sipas rregullit të të provuarit, rezultati i të cilit e bën të besueshëm ekzistimin e shkakut për përjashtimin e gjyqtarit nga gjykimi konkret. Lidhur me kërkesën për përjashtimin dhe rekuizimin e gjyqtarit vendos kryetari i gjykatës pranë së cilës gjykatë është shtruar çështja.

Nëse kërkohet përjashtimi apo rekuizimi i kryetarit të gjykatës për këtë vendos kryetari i gjykatës më të lartë. P.sh. nëse kërkohet përjashtimi ose rekuizimi i Kryetarit të Gjykatës Themelore në Prishtinë për këtë vendos Kryetari i Gjykatës së Apelit. Ndërsa lidhur me kërkesën për përjashtimin e Kryetarit të Gjykatës së Apelit vendos Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës, ndërsa për kërkesën për përjashtimin e Kryetarit të Gjykatës Supreme vendos Seanca e Përgjithshme e Gjyqtarëve të Gjykatës Supreme. Kundër aktvendimit me të cilin aprovet apo refuzohet kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit nuk lejohet ankesa.

Kërkesat e palejuara

Në praktikë ndodh që palët me qëllim të zvarritjes së procesit dhe ndërprerjes së punës së gjykatës të bëjnë kërkesa të ndryshme për përjashtim dhe rekuizim të gjyqtarit, dhe atë:

- kërkojnë përjashtimin e të gjithë gjyqtarëve të gjykatës së caktuar që të gjykojnë në një kontest të caktuar;
- kërkesën për të cilën është vendosur njëherë, si dhe
- kërkesa që nuk përmbajnë arsyetim lidhur me kërkesën për përjashtimin ose rekuizimin e gjyqtarit.

Lidhur me këto kërkesa të palejuara kompetent për të vendosur është gjyqtari që është duke e proceduar çështjen. Gjyqtari bie aktvendim të veçantë me të cilin e hudh kërkesën për përjashtim, kundër të cilit vendim nuk lejohet ankesë e veçantë.

Palët në procedurë

Prezumimet procedurale lidhur me palët i gjejmë në ato dispozita të LPK-së, që i referohen:

- ekzistimit të palës,
- zotësisë për të qenë palë ndërgjyqëse,
- zotësisë procedurale të palëve,
- përfaqësimi ligjor i rregullt në rast të mungesës së zotësisë procedurale,
- përfaqësimi i rregullt i personit juridik dhe ekzistimi i prokurës së rregullt,
- autorizimi procedural për ndjekjen e çështjes në gjykatë.

Kuptimi i palëve në procedurën kontestimore

Procedura kontestimore është procedurë dy paleshe. Asaj i paraprinë kontesti në mes të palëve lidhur me të drejtat dhe obligimet e tyre nga marrëdhënia e caktuar juridike. Në fakt, Ligji për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtutjeshëm LPK), nuk e përkufizon në mënyrë të qartë termin palë, por merret ajo se:

- **Paditësi**, është ai i cili nga gjykata kërkon mbrojtjen e të drejtës së tij subjektiv, ndërsa
- **I padituri**, ai ndaj të cilit kjo mbrojtje realizohet ³⁸⁵.

Edhe me nenin 2 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, është e paraparë se shprehja palë nënkupton kreditorin apo debitorin në procedurën përmbarimore ³⁸⁶.

Kush mund të jetë palë në procedurën kontestimore

Secili person fizik dhe juridik mund të jetë palë në procedurën kontestimore. Kjo është ajo që njihet si *aftësia juridike* e cila tek personat fizik arrihet me lindje (bile edhe para lindjes të marrëdhëniet juridike – trashëgimore nëse fëmiju lindë i gjallë), ndërsa tek personat juridik kjo aftësi fitohet në bazë të rregullave të veçanta materialo juridike, përkatësisht me regjistrimin e personit juridik pranë organit kompetent.

Personat juridik duhet të kenë pasurinë e tyre e cila është e përshtatshme për përmbarim gjyqësor, si dhe që përmes akteve të përgjithshme, këtij personi juridik t'i jetë pranuar cilësia e tillë (e personit juridik) si bartës i pavarur i të drejtave dhe detyrimeve në qarkullimin juridik.

³⁸⁵“Praktikum za parnicu”, Vukasin Ristic, Milosin Ristic, Beograd, 2000, faqe 35

³⁸⁶Neni 2 i Ligjit për Procedurën Përmbarimore

Cilësinë e personit juridik e kanë edhe komunat si njësi administrativo – territoriale³⁸⁷, përmes të cilave realizohet vetëqeverisja lokale, ndërmarrjet publike, si dhe entitetet e tjera, përkatësisht bashkësitë e tjera të personave të cilat në bazë të ligjit mund të jenë palë në procedurë, apo ato forma të bashkimit të cilave gjykata ua njihet cilësinë e palëve, me kusht që ato forma të bashkimit t'i përmbushin kushtet e nevojshme që të jenë bartës të pavarur të drejtave dhe obligimeve marrëdhëniet juridiko civile dhe që të disponojnë me pasuri e cila mund të jetë e përbarueshme³⁸⁸.

Sipas mendimit juridik të Seancës së Përgjithshme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, pranë departamentit për Çështje Ekonomike të Gjykatës Themelore në Prishtinë, përkatësisht Departamentit për Çështje Ekonomike pranë Gjykatës së Apelit, si palë mund të paraqiten edhe:

- biznesi individual;
- ortakët e shoqërisë së ortakërisë, ortakët e përgjithshëm dhe të kufizuar të shoqërisë komandite;
- shoqëria me përgjegjësi të kufizuar;
- shoqëria aksionare;
- drejtori apo drejtorët menaxhues të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, dhe
- bordi i drejtorëve të shoqërisë aksionare³⁸⁹.

Gjykata është e obliguar që gjatë të gjithë procedurës, sipas detyrës zyrtare, të kujdeset në lidhje me zotësinë juridike të palëve respektive. Nëse palët nuk e kanë këtë zotësi, atëherë procedura nuk mund zhvillohet më tutje dhe nëse edhe përkundër ftesës së gjykatës, kjo mangësi nuk evitohet, padia do të hidhet poshtë, ndërsa veprimet e ndërmarra më parë, do të abrogohen³⁹⁰.

Nga praktika: Konsiderohet si e parregullt padia me të cilën paditësi i'a le në vendosje gjykatës, që mbi bazën e gjendjes faktike të vërtetuar në procedurë, ta përcaktoj të paditurin kryesor, përkatësisht personin i cili më së shumti i ka dhënë shkas ngritjes së padisë. Në këtë rast gjykata do ta ftoj paditësin që brenda afatit ligjor ta rregulloj padinë, e në rast se padia përsëri nuk rregullohet, e njëjta nga ana e gjykatës do të hidhet poshtë si e palejuar.³⁹¹

Përveç zotësisë juridike, si parakusht procedural për zhvillimin e procesit kontestimor, paraqitet edhe *zotësia për të vepruar*, përmes të cilës pala mundet që vetë dhe në mënyrë të pavarur të ndërmerr veprime në procedurën kontestimore (e cila ndryshe njihet edhe si zotësia procedurale).

³⁸⁷Neni 5 i Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale

³⁸⁸Neni 73.3 i LPK-së

³⁸⁹Mendimi juridik i Gjykatës Supreme të Kosovës nr.217/13, i datës 25.03.2013

³⁹⁰Neni 78.4 i LPK-së

³⁹¹ Shembull praktik: Nuk është i mundur kontesti në mes të dy njëjësive të ndërmarrjes së njëjtë, sepse ato konsiderohen si pjesë të personit të njëjtë juridik. E njëjta gjë vlen edhe për organet shtetërore, përkatësisht ministrinë.

Zotësia për të vepruar tek personat fizik përputhet në tërësi me zotësinë e plotë punuese e cila rregullohet me dispozitat materialo juridike.

Personi fizik zotësinë për të vepruar dhe zotësinë e plotë punuese e arrin në moshën 18 vjeçare, apo para kësaj, nëse në bazë të lejes të gjykatës kompetente lidhë martesë.

LPK parasheh se i mituri i cili nuk e ka fituar plotësisht zotësinë për të vepruar, ka zotësi procedurale brenda kufijve në të cilët i njihet zotësia për të vepruar³⁹². Deri në moshën 14 vjeçare, personi fizikë nuk e ka zotësinë punuese (nuk e ka zotësinë procedurale), e pasi që të mbushë 14 deri 18 vite, ai është pjesërisht i aftë. Me arritjen e moshës 15 vjeçare, i mituri mund të themeloj marrëdhënie pune, të disponoj me të ardhurat, si dhe mundet që para gjykatës të paraqitet si palë, apo të përpiloj testament.

Kur personi madhor privohet në tërësi nga zotësia e tij për të vepruar, ai më nuk e ka as zotësinë procedurale dhe i njëjti barazohet me personin e mitur nën 14 vjet. Por personi madhor të cilit i është kufizuar pjesërisht zotësia për të vepruar, e ka zotësinë procedurale në kufijtë e zotësisë së tij për të vepruar (neni 74.2 i LPK). Në këto raste, organi i kujdestarisë³⁹³ i cakton punët juridike të cilat ky person mund t'i ndërmerr në mënyrë të pavarur, si dhe përcakton se për cilat veprime ai e posedon zotësinë procedurale.

Kush e përfaqëson palën me pazotësi procedurale

Palën e cila nuk e ka zotësinë procedurale, e përfaqëson përfaqësuesi i saj ligjor. Ai përcaktohet me ligj apo me aktin e organit shtetëror kompetent të marrur në bazë të ligjit³⁹⁴.

Në anën tjetër, pala e cila e ka zotësinë procedurale, veprimet në procedurë mund t'i ndërmerr personalisht apo nëpërmes të personit të cilin e autorizon (i autorizuari).

Personat juridik nuk e kanë zotësinë procedurale. Ata në procedurë i përfaqësojnë përfaqësuesit e tyre të cilët caktohen në bazë të ligjit dhe rregullave të tjera. Komunitat i përfaqësojnë Avokatët Publikë, si përfaqësues ligjor në bazë të Ligjit mbi Avokaturën Publike Komunale³⁹⁵, ndërsa organet qendrore shtetërore, divizioni për përfaqësime i Ministrisë së Drejtësisë. Pas aprovimit të Ligjit nr.04/L-157 për Avokaturën Shtetërore, i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës nr.8, të datës 08.04.2013, autoritetet publike të Republikës së Kosovës, pranë organeve gjyqësore, të arbitrazhit apo ato administrative, i përfaqësojnë Avokati i Përgjithshëm Shtetëror,

³⁹²Neni 74.3 i LPK-së

³⁹³ Organi i Kujdestarisë në kuadër të Qendrave për Punë Sociale

³⁹⁴Neni 75.2 i LPK-së

³⁹⁵ Ligji për Avokaturën Publike (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.9/83)

avokati shtetëror, apo personi i autorizuar i punësuar pranë Avokaturës Shtetërore apo pranë organit tjetër të administratës shtetërore, e i cili e ka të dhënë provimin e jurisprudencës ³⁹⁶.

Personat fizik madhor të cilët në tërësi janë të privuar nga zotësia për të vepruar, i përfaqësojnë kujdestarët të caktuar nga ana e organeve të kujdestarisë, kurse kujdestari mund të caktohet edhe për personat të cilët pjesërisht janë të privuar nga zotësia për të vepruar, varësisht nga lloji i kontestit i cili mund të zhvillohet para gjykatës.

Personat e mitur, në rastet kur ata janë plotësisht të paaftë në aspektin e veprimit (u mungon zotësia procedurale), apo kur kjo është e nevojshme për mbrojtjen e interesave të tyre, sipas ligjit i përfaqësojnë prindërit e tyre.

Përfaqësuesi ligjor

Sipas rregullit, përfaqësuesi ligjor i ka të gjitha autorizimet dhe detyrimet e palës në procedurën kontestimore. Por në rastet e caktuara, me rregulla të veçanta mund të parashihet që përfaqësuesi ligjor duhet të ketë autorizim të veçantë për ndërmarrjen e veprimeve individuale kontestimore, të cilat kanë ndikim esencial në rrjedhën dhe fatin e procedurës. Rastet e tilla janë p.sh., në:

- parashtrimin apo tërheqjen e padisë;
- pranimin apo heqjen dorë nga kërkesëpadia;
- lidhjen e ujdisë dhe të tjera, kur përfaqësuesi ligjor për ndërmarrjen e këtyre veprimeve duhet të ketë autorizim të posaçëm ³⁹⁷.

Gjykata është e detyruar që gjatë gjithë procedurës të kujdeset sipas detyrës zyrtare se a janë përmbushur prezumimet procedurale në raport të zotësinë juridike dhe atë të veprimit (zotësinë procedurale) të palës në procedurë, në rregullsinë e përfaqësimit të palës e cila nuk e ka zotësinë e veprimit nga ana e përfaqësuesit ligjor, në rregullsinë e autorizimit të tij të veçantë në rastet kur ky autorizim është i nevojshëm dhe të ndërmerr masat e nevojshme që këto mangësi të mënjanohen. Procedura nuk mund të vazhdojë deri sa këto mangësi nuk eliminohen sepse çfarëdo vendimi gjyqësor i cili do të përmbante këto mangësi, do të prishej nga ana e gjykatës së shkallës së dytë për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat janë të parapara me nenin 182 par.2 pika (k) të LPK-së. Për këtë arsye në këto raste gjykata do të duhej t'i abrogonte veprimet e ndërmarra deri atëherë dhe ta hudhë padinë ³⁹⁸.

³⁹⁶Nenet 8, 9 dhe 10 të Ligjit nr.04/L-157 për Avokaturën Shtetërore, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.8, e datës 08.04.2013

³⁹⁷Neni 77 i LPK-së

³⁹⁸Neni 78.4 i LPK-së.

Përfaqësuesi i përkohshëm

Nëse procedura rreth caktimit të përfaqësuesit ligjor për personin (të paditurin) me pazotësi të veprimit (pazotësi procedurale) nga ana e organit të kujdestarisë do të zgjaste shumë dhe do të mund të prodhonte pasoja të dëmshme për cilëndo palë, LPK ka paraparë mundsinë që gjykata e shkallës së parë t'ia caktojë atij (të paditurit pra) përfaqësuesin e përkohshëm.

Përfaqësuesi i përkohshëm në procedurë i ka të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përfaqësuesit ligjor dhe këto të drejta dhe detyrime i ushtron derisa i padituri apo i autorizuari i tij nuk paraqiten në gjykatë, respektivisht deri sa organi i kujdestarisë nuk e informon gjykatën se e ka caktuar kujdestarin.

Gjykata do t'ia caktojë të paditurit përfaqësuesin e përkohshëm në rastet të cilat janë të saktësuara me ligj dhe për këtë do ta njoftojë menjëherë organin kompetentë të kujdestarisë si dhe palët kur një gjë e tillë është e mundshme.

Nëse të paditurit i caktohet përfaqësuesi i përkohshëm nga arsyeja se vendbanimin e ka të panjohur, kurse nuk ka të autorizuar, si dhe nëse ai dhe përfaqësuesi i tij ligjor gjenden në botën e jashtme kurse nuk kanë të autorizuar në territorin e Republikës së Kosovës, si dhe nëse dorëzimi nuk ka mundur të kryhet, gjykata brenda afatit prej shtatë (7) ditësh do të jap shpallje e cila do të botohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, ndërsa që shpallja do të afishohet edhe në tabelën e shpalljeve të gjykatës së çështjes, e sipas nevojës edhe në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme. Në këtë rast procedura do ta vazhdoj deri sa i padituri nuk lajmërohet në gjykatë respektivisht deri sa organi i kujdestarisë nuk e informon gjykatën se e ka caktuar kujdestarin.

Gjykata e cakton përfaqësuesin e përkohshëm nga radha e avokatëve.

Shpenzimet e shpalljes për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm në rastet e parapara sikurse në nenin 79.3 të LPK-së, (shpenzimet e botimit të shpalljes në ndonjë gazetë), duhet t'i deponojë paditësi. Në këtë rast, paditësi duhet t'i deponojë edhe shpenzimet për pagesën e përfaqësuesit të përkohshëm për pjesëmarrje në seancat gjyqësore, të llogaritura sipas tarifës zyrtare të Odës së Avokatëve të Kosovës, për shpërblimet dhe kompensimin e shpenzimeve për punën e avokatëve, përkatësisht nr. tarifor 7, të ekstraktit të bashkëngjitur kësaj tarife.

Emërimi i përfaqësuesit të përkohshëm. Ligji u jep gjyqtarëve autorizime lidhur me emërimin e përfaqësuesit të *përkohshëm* për palët³⁹⁹ me qëllim të mbrojtjes të të drejtave të palës së munguar dhe për të shmangur vonesat potencialisht të rëndësishme në procedurën gjyqësore. Ligji, në mënyrë specifike i udhëzon gjyqtarët që palës t'ia caktojë përfaqësuesin e përkohshëm në rrethanat si në vijim:

³⁹⁹Neni 387.1(q) i LPK-së, e autorizon gjyqtarin që ta emërojë përfaqësuesin e përkohshëm.

Caktimi i përfaqësuesit të përkohshëm të paditurit adresa e të cilit është e panjohur apo të paditurit që mungon

Gjyqtari është i autorizuar t'i caktojë palës së paditur përfaqësuesin e përkohshëm kur vendqëndrimi i të paditurit është i panjohur kurse i padituri nuk ka përfaqësues të autorizuar.⁴⁰⁰ Pala paditëse i bartë shpenzimet e caktimit të përfaqësuesit të përkohshëm mbi këto baza.⁴⁰¹

Caktimi i përfaqësuesit të përkohshëm për të paditurin që mungon

Gjyqtari do t'i caktojë përfaqësuesin e përkohshëm të paditurit ose përfaqësuesit të tij ligjor të cilët ndodhen jashtë shtetit, dhe kur nuk ka përfaqësues të autorizuar të cilit mund t'i dërgohen shkresat.⁴⁰² Paditësi i bartë shpenzimet e përfaqësimit të përkohshëm në këto rrethana.⁴⁰³

Në praktikë, në rastet kur i padituri jeton jashtë Kosovës, gjyqtari me aktvendim i kërkon paditësit që ta korrigjojë apo plotësojë padinë duke i kërkuar informata plotësuese që kanë të bëjnë me adresën e huaj ku jeton i padituri. Nëse paditësi e njofton gjykatën se nuk ka tjetër adresë për të paditurin, përveç asaj që e ka shënuar në padi, atëherë gjykata do t'i drejtohet me kërkesë Zyrës komunale të regjistrimit civil, Zyrës komunale për komunitete dhe kthim, Policisë së Kosovës dhe Agjencisë Kosovare të Pronës, për të kërkuar verifikimin e adresës për palën e paditur. Nëse kjo procedurë rezulton e pasuksesshme (duke përfshirë rastet kur pala e paditur është serb dhe me sa duket është zhvendosur nga Kosova në Serbi), gjykata do të dërgojë kërkesë për ndihmë në Ministrinë e Drejtësisë (Zyrën për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet civile) për dërgimin e njoftimit të gjykatës për padi dhe për të drejtën e paraqitjes së përgjigjes në padi.

Në rastet kur nuk ekziston marrëveshja bilaterale me shtetin e huaj, kërkesa nuk do t'i dërgohet Ministrisë derisa gjykata ta sigurojë adresën e plotë të të paditurit.

Nëse këto veprime rezultojë të pasuksesshme, atëherë gjykata do t'ia caktojë përfaqësuesin e përkohshëm të paditurit nga lista e avokatëve të Odës së Avokatëve të Kosovës. Vendimi për

⁴⁰⁰Neni 79.3 i LPK-së, e autorizon gjyqtarin, në mes tjerash, që t'i caktojë palës së paditur përfaqësuesin e përkohshëm kur vendqëndrimi i të paditurit është i panjohur kurse i padituri nuk ka përfaqësues të autorizuar.

⁴⁰¹Neni 81.2 i LPK-së, e përcakton që pala paditëse i bartë shpenzimet e caktimit të përfaqësuesit të përkohshëm mbi bazën se vendqëndrimi i të paditurit është i panjohur dhe se i padituri që mungon nuk e ka përfaqësuesin ligjor.

⁴⁰²Neni 79.3 i LPK-së, autorizon gjyqtarin që të paditurit t'i caktojë përfaqësuesin e përkohshëm kur ai/ajo dhe/ose përfaqësuesi ligjor i tij/saj gjenden jashtë vendit dhe nuk e ka përfaqësuesin e autorizuar të cilit mund t'i dërgohen shkresat.

⁴⁰³Neni 81.2 i LPK-së, përcakton që paditësi ka për detyrë t'i bartë shpenzimet e përfaqësuesit të përkohshëm të caktuar për shkak se i padituri apo përfaqësuesi i tij/saj ligjor gjendet jashtë vendit dhe nuk ka përfaqësues të autorizuar të cilit mund t'i dërgohen shkresat.

caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm publikohet në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës në tri gjuhë (shqip, serbisht dhe anglisht).

Caktimi i përfaqësuesit të përkohshëm të paditurit pa përfaqësues ligjor dhe pa zotësinë procedurale

Gjyqtari është i autorizuar që t'i caktojë të paditurit që nuk e ka përfaqësuesin ligjor, përfaqësuesin e përkohshëm kur i padituri nuk e ka zotësinë procedurale të përfaqësimit të vetvetes në procedurën gjyqësore apo nëse ekzistojnë interesa të kundërta të të paditurit dhe të përfaqësuesit ligjor të tij/saj.⁴⁰⁴ Pala e paditurit bartë shpenzimet e përfaqësuesit të përkohshëm.⁴⁰⁵

Caktimi i përfaqësuesit të përkohshëm për të paditurin në rastet kur caktimi i përfaqësuesit ligjor do të zgjaste shumë

Gjyqtari është i autorizuar t'i caktojë të paditurit përfaqësuesin e përkohshëm kur caktimi i përfaqësuesit ligjor për të paditurin do të zgjaste shumë kohë dhe kur mund të lindin pasoja të dëmshme për njërin apo për të dy palët.⁴⁰⁶

Caktimi i përfaqësuesit të përkohshëm për paditësin që ka paraqitur padi të pakuptueshme

Gjyqtari është i autorizuar t'i caktojë përfaqësuesin e përkohshëm paditësit kur padia e tij është e pakuptueshme dhe kur nevojitet të sqarohet në mënyrë që gjyqtari të konstatojë nëse padia e paditësit është e vlefshme.⁴⁰⁷

Caktimi i përfaqësuesit të përkohshëm trashëgimtarit të palës së vdekur

Gjyqtari është i autorizuar t'i caktojë përfaqësuesin e përkohshëm trashëgimtarit të palës së vdekur po qe se konstaton se procedura trashëgimore mund të zgjasë shumë kohë deri

⁴⁰⁴ Neni 79.2 i LPK-së, e autorizon gjyqtarin që t'i caktojë të paditurit që nuk e ka përfaqësuesin ligjor, përfaqësuesin e përkohshëm kur i padituri nuk e ka zotësinë procedurale të përfaqësimit të vetvetes në procedurën gjyqësore apo nëse ekzistojnë interesa të kundërta të të paditurit dhe të përfaqësuesit ligjor të tij/saj.

⁴⁰⁵ Neni 81.2 i LPK-së, përcakton që i padituri ka për detyrë t'i bartë shpenzimet e përfaqësuesit të përkohshëm.

⁴⁰⁶ Neni 79.1 i LPK-së, e autorizon gjyqtarin që t'i caktojë përfaqësuesin e përkohshëm të paditurit kur caktimi i përfaqësuesit ligjor për të paditurin do të zgjaste shumë kohë dhe kur mund të lindin pasoja të dëmshme për njërin apo për të dy palët.

⁴⁰⁷ Neni 390 i LPK-së, e autorizon gjyqtarin që t'i caktojë përfaqësuesin e përkohshëm paditësit dhe të paditurit kur konstaton se padia është e pakuptueshme apo jo e plotë, apo se ekzistojnë mungesa që kanë të bëjnë me zotësinë e paditësit apo të paditurit që të bëhet palë ndërgjyqëse, apo me përfaqësimin ligjor të tyre, apo mungesa që i përkasin autorizimit të përfaqësuesit që ta iniciojë procedurën kontestimore, kur autorizimi i tillë kërkohet me ligj.

në zgjidhjen e saj.⁴⁰⁸ Mirëpo, në praktikë, pas vdekjes së palës gjyqtarët e pushojnë procedurën duke u bazuar në nenin 277.1 dhe nenin 282.3 deri në atë kohë kur trashëgimtarët ligjor të palës së vdekur i ndërmarrin veprimet e nevojshme për ta vazhduar procedurën gjyqësore.

Caktimi i përfaqësuesit të përkohshëm për palën e munguar gjatë procedurës për sigurimin e provës

Gjyqtari mund të urdhërojë sigurimin e provës gjatë seancës apo para saj kur pala demonstroi se ekziston mundësia e zhdukjes së saj apo se do të vështirësohet marrja e saj nëse ajo provë nuk sigurohet tani.⁴⁰⁹ Gjyqtari është i autorizuar ta caktojë përfaqësuesin e përkohshëm për palën e panjohur apo adresë të cilës është e panjohur me qëllim që të marrë pjesë në seancën e caktuar për marrjen e provës dhe t'i përfaqësojë interesat e palës së munguar në këtë seancë.⁴¹⁰

Caktimi i përfaqësuesit të përkohshëm për personin juridik

Gjyqtari është i autorizuar t'i caktojë përfaqësuesin e përkohshëm personit juridik mbi të njëjtat baza sikurse ato që janë paraparë për personat fizikë nga neni 79.⁴¹¹ Në praktikë, me sa duket, gjyqtarët nuk ua caktojnë përfaqësuesin e përkohshëm personave juridik në rastet pronësore juridike.

Burimi i përfaqësuesve të përkohshëm

Gjyqtari është i autorizuar ta caktojë përfaqësuesin e përkohshëm nga radhët e avokatëve apo profesionistëve tjerë.⁴¹²

Të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit të përkohshëm

Përfaqësuesi i përkohshëm i ka në procedurë të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjor.⁴¹³

⁴⁰⁸Neni 282.3 i LPK-së, e autorizon gjyqtarin që t'i caktojë përfaqësuesin e përkohshëm trashëgimtarit të palës së vdekur po qe se konstaton se procedura trashëgimore mund të zgjasë shumë kohë deri në zgjidhjen e saj.

⁴⁰⁹Neni 379.1 i LPK-së, autorizon gjyqtarin që të urdhërojë sigurimin e provës gjatë seancës apo para saj kur pala demonstroi se ekziston mundësia e zhdukjes së saj apo se do të vështirësohet marrja e saj nëse ajo provë nuk sigurohet tani.

⁴¹⁰Neni 383.2 i LPK-së, e autorizon gjyqtarin që ta caktojë përfaqësuesin e përkohshëm për palën e panjohur apo adresë të cilës është e panjohur me qëllim që të marrë pjesë në seancën e caktuar për marrjen e provës dhe t'i përfaqësojë interesat e palës së munguar në këtë seancë).

⁴¹¹Neni 80 (autorizon gjyqtarin që t'i caktojë përfaqësuesin e përkohshëm personit juridik mbi të njëjtat baza sikurse ato që janë paraparë për personat fizikë nga neni 79.

⁴¹²Neni 81.1 i LPK-së, e autorizon gjyqtarin ta caktojë përfaqësuesin e përkohshëm nga radhët e avokatëve apo profesionistëve tjerë.

⁴¹³Neni 82.1 i LPK-së, përcakton që përfaqësuesi i përkohshëm i ka në procedurë të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjor.

Shpallja e emërimit të përfaqësuesit të përkohshëm në rrethana të caktuara

Nëse gjyqtari ia cakton të paditurit përfaqësuesin e përkohshëm për shkak se vendbanimi i tij nuk është i njohur dhe nuk ka përfaqësues të autorizuar, apo për shkak se i padituri apo përfaqësuesi ligjor i tij/saj gjendet jashtë vendit dhe nuk ka përfaqësues të autorizuar, gjykata brenda afatit prej shtatë ditësh do të japë shpallje e cila do të botohet në gazetën zyrtare dhe afishohet në tabelën e shpalljeve të gjykatës.⁴¹⁴

Kohëzgjatja e emërimit të përfaqësuesit të përkohshëm

Përfaqësuesi i përkohshëm të drejtat dhe detyrimet e veta i ushtron derisa të paraqiten në gjykatë i padituri apo përfaqësuesi i tij i autorizuar (apo, deri kur organi i kujdestarisë e njofton gjykatën se palës ia ka caktuar kujdestarin).⁴¹⁵

Përfaqësimi i rregullt i personit juridik

Personat juridik marrin pjesë në qarkullimin juridik me anë të personave fizik, të cilët kryejnë veprime relevante. Personat fizikë, që veprojnë në emër të personave juridike, janë zakonisht organe të tyre, të caktuara me anë të statutit.

LPK-ja, me dispozitën e nenit 75 paragrafi 3, përcakton së: “*Përfaqësuesi i personit juridik caktohet me ligj apo me aktin e përgjithshëm të personit juridik*”. Përfaqësuesi i personit juridik ose i etnitetit tjetër autorizimin e nxjerr nga akti, me të cilin rregullohet konstituimi dhe qarkullimi juridik i personit juridik apo i etnitetit tjetër.⁴¹⁶

⁴¹⁴Neni 83 i LPK-së, përcakton që nëse gjyqtari ia cakton të paditurit përfaqësuesin e përkohshëm në bazë të nenit 79.3 për shkak se vendbanimi i tij nuk është i njohur dhe nuk ka përfaqësues të autorizuar, apo për shkak se i padituri apo përfaqësuesi ligjor i tij/saj gjendet jashtë vendit dhe nuk ka përfaqësues të autorizuar, gjykata brenda afatit prej shtatë ditësh do të japë shpallje e cila do të botohet në gazetën zyrtare dhe afishohet në tabelën e shpalljeve të gjykatës.

⁴¹⁵Neni 82.2 i LPK-së, përcakton që përfaqësuesi i përkohshëm të drejtat dhe detyrimet e veta i ushtron derisa të paraqiten në gjykatë i padituri apo përfaqësuesi i tij i autorizuar (apo, deri kur organi i kujdestarisë e njofton gjykatën se palës ia ka caktuar kujdestarin).

⁴¹⁶ Raste nga praktika: Përfaqësuesi i personit juridik i caktuar nga ligji është për shembull përfaqësimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, nga Ministria e Drejtësisë. Përfaqësuesi i personit juridik i caktuar me aktin e themelimit/organizmit të personit juridik, për shembull përfaqësuesi i një banke, përfaqësuesi i një Kompanie të Sigurimeve, etj.

Përfaqësuesit e autorizuar të palëve (me prokurë)

Në të drejtën tonë nuk është i paraparë detyrimi i palëve që të drejtat e tyre medoemos duhet t'i realizojnë përmes të autorizuarve, të cilët janë persona me kualifikime profesionale – avokatët. Ata mundën që vetë ta udhëheqin kontestin, respektivisht në rastet kur janë të paditur, mbrojtjen dhe kundërshtimet t'i paraqesin personalisht apo nëpërmes të të autorizuarve.

Shpjegim praktik: Kështu edhe përfaqësuesi i pa autorizuar mund ta ketë pozitën e përfaqësuesit, sepse autorizimi duhet të ekzistoj që përfaqësimi të jetë i vlefshëm dhe mungesa e autorizimit i bënë të pavlefshme dhe të paefektshme të gjitha veprimet procedurale të ndërmarra në emër të palës. Por këto veprime mund edhe të fuqizohen dhe të merren si të mirëqena, po qesë pala më vonë i aprovon ato.

Aktgjykimi nuk i drejtohet të autorizuarit të palës, e as që ka kurrfarë efekti ndaj tij. Pasi që përfaqësuesi vepron në interes të palës të cilën e përfaqëson, nuk është e lejuar që i njëjti person të jetë përfaqësues i të dy palëve (paditësit dhe të paditurit) në një procedurë gjyqësore.

Të autorizuar të palëve mund të jenë të gjithë personat madhor dhe personat me aftësi të veprimit (procedurale) të cilët nuk merren me *pseudo shkresari*⁴¹⁷.

Mospërfaqësimi i duhur i palës nga ana e avokatit apo personit tjetër

Ekziston detyrimi i gjykatës që ta informoj palën me pasojat e dëmshme të cilat mund të lindin për të, në rastet kur atë e përfaqëson në mënyrë jo të duhur i autorizuari i cili nuk është avokat⁴¹⁸.

Por edhe në rastet kur gjykata konstaton se përfaqësuesi i palës i cili është avokat, nuk e kryen detyrën në pajtim me Ligjin mbi Avokaturën, mbi të rëndon detyrimi që për një gjë të tillë ta njoftojë Odën e Avokatëve.

Mënyrat e dhënies së autorizimit

Pavarësisht faktit se kënd e autorizon, pala mund ta jep autorizimin në dy mënyra:

- me shkrim, apo
- me gojë në procesverbal para gjykatës.

⁴¹⁷ Në ligjin e ri të Procedurës Kontestimore, *ad literam* nuk është paraparë një ndalesë e tillë, për dallim nga ligji i vjetër i LPK-së, i ish RSFJ-së, i cili në nenin 90 të tij e kishte të ndaluar një gjë të tillë

⁴¹⁸Neni 88 i LPK-së

Pala e cila nuk di shkrim/lexim ose e cila nuk është në gjendje të nënshkruhet, do të vejë në autorizimin e shkruar shenjën e gishtit tregues. Nëse një autorizim i këtillë i jepet personit i cili nuk është avokat, është e nevojshme që të jenë prezentë dy dëshmitarë të cilët do të nënshkruhen në autorizim⁴¹⁹.

Në rastet kur dyshohet në vërtetësinë e autorizimit, gjykata me aktvendim kundër të cilit nuk lejohet ankesa, do të urdhëroj që të parashtrahet autorizim i verifikuar⁴²⁰. Kur pala ka të autorizuar, gjykata është e detyruar që dorëzimin t'ia bëjë të autorizuarit.

Pala mund të ketë më shumë përfaqësues të autorizuar, të cilët janë të autorizuar që në mënyrë të pavarur t'i ndërmarrin veprimet kontestimore, e të cilat veprime nuk mund të jenë në kundërshtim me veprimet e të autorizuarve të tjerë. Në këtë raste dorëzimi i shkresave mjafton që t'i bëhet vetëm njërit nga të autorizuarit⁴²¹.

Te rastet e administrimit të provave edhe përmes dëgjimit të palëve, dorëzimi i ftesës për këtë seancë duhet t'i bëhet personalisht palëve⁴²².

Veprimet kontestimore në procedurë për palën i ndërmerr i autorizuari i tij, por gjykata mund ta ftojë palën që të deklarohet personalisht lidhur me faktet të cilat duhet të vërtetohen. Është e drejtë e palës që të kërkoj nga gjykata që t'i mundsoj dhënien e deklaratave lidhur me lëndën e kontestit edhe pranë deklaratës së dhënë nga i autorizuari i tij.

Revokimi i deklaratës së të autorizuarit nga ana e vetë palës

Pala mundet që deklaratën e të autorizuarit të saj të dhënë në seancë:

- ta ndryshoj, apo
- ta revokoj.

Mund të ndodhë që i autorizuari në seancë e ka pranuar ndonjë fakt, të cili pala nuk ka qenë prezentë apo e ka pranuar në parashtrësë, e pas kësaj pala këtë pranim ta ndryshojë apo revokojë. Në këtë rast gjykata sipas vlerësimit të lirë, e duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret, do të vendos se cilës deklaratë do t'ia fal besimin, e cilës jo⁴²³.

⁴¹⁹ Ligji për Noterinë

⁴²⁰Nenin 92.3 i LPK-së

⁴²¹Neni 107.2 i LPK-së

⁴²²Neni 376 i LPK-së

⁴²³Neni 87 i LPK-së

Vëllimi dhe përmbajtja e autorizimit

Se cilat veprime do të jetë i autorizuar t'i ndërmarrë përfaqësuesi i autorizuar i palës, varet nga vëllimi i autorizimit të cilin e cakton pala si autorizimdhënës.

Autorizimi mund të jetë:

- i përgjithshëm (gjeneralë), apo
- i veçantë.

Në rastet kur bëhet fjalë për autorizimin e përgjithshëm, autorizimet e të autorizuarit sipas përmbajtjes janë të ndryshme, varësisht nga fakti se a është personi i autorizuar avokat, apo jo.

I autorizuari i cili është avokat dhe i autorizuar me autorizim të përgjithshëm, ka të drejtë t'i kryej të gjitha veprimet në procedurë, e sidomos:

- a. ta parashtrorë dhe ta tërheq padinë;
- b. të parashtrorë përgjigjen në padi;
- c. që të pohoj kërkesëpadinë apo të heq dorë nga ajo;
- d. që të lidh pajtim gjyqësor;
- e. që të parashtrorë mjetin e goditjes së vendimit si dhe të heq dorë nga kjo e drejtë, apo ta tërheqë mjetin e parashtruar;
- f. të propozoj caktimin e masave të përkohshme (dhe) të sigurimit të kërkesave;
- g. të parashtrorë kërkesë për ekzekutimin ose sigurimin dhe të kryej veprime të nevojshme lidhur me kërkesat e tilla;
- h. që nga pala kundërshtarë t'i pranoj shpenzimet procedurale të caktuara nga gjykata,
- i. të autorizojë avokatin tjetër me shkrim që të kryej disa veprime të caktuara procedurale, por jo edhe që të veprojnë në seancën për shqyrtimin kryesor të çështjes.

Për paraqitjen e propozimit për përsëritjen e procedurës, avokatit i nevojitet autorizim i veçantë, vetëm nëse nga koha kur vendimi është bërë i formës së prerë ka kaluar më shumë se gjashtë muaj.

Avokatin mund ta zëvendësojë praktikanti që është duke punuar tek ai, por vetëm para gjykatës së shkallës së parë⁴²⁴. Por nëse i autorizuari i palës nuk është avokat, ndërsa që pala në autorizim nuk ia ka caktuar atij më hollësisht autorizimet, i autorizuari në këtë rast mund t'i kryej të gjitha veprimet procedurale, por gjithmonë i nevojitet autorizim shprehimor për:

- a. tërheqjen e padisë;

⁴²⁴Neni 90 i LPK-së

- b. për pohimin apo heqjen dorë nga kërkesëpadia;
- c. për lidhjen e pajtimit gjyqësor;
- d. për heqje dorë nga drejta e paraqitjes së mjetit të goditjes së vendimit,
- e. apo për tërheqjen e tij dhe për kalimin e autorizimit një personi tjetër, si dhe
- f. parashtrimin e mjeteve të jashtëzakonshme të goditjes së vendimeve ⁴²⁵.

Përfaqësues i autorizuar i palës mund të jetë çdo person që ka zotësi të plotë për të vepruar (zotësi procedurale).

Parashtrimi i autorizimit

I autorizuari i palës është i detyruar që me rastin e kryerjes së veprimit të parë në procedurë, ta paraqes autorizimin (me rastin e parashtrimit të padisë, përgjigjes në padi etj). Gjykata mund t'ia lejoj personit të tillë përfaqësimin e palës edhe pa parashtrimin e autorizimit, mirëpo do t'ia caktoj atij një afat të caktuar që ta parashtrroj autorizimin.

Nëse ky person nuk vepron sipas urdhrit të gjykatës, procedura do të vazhdoj sikurse ai fare të mos ishte paraqitur para gjykatës në cilësinë e të autorizuarit të palës dhe pa i marrë në konsideratë veprimet e kryera nga ai.

Veprimet të cilat i ka ndërmarr ky person në procedurë gjykata do t'i anulojë, me përjashtim të atyre për të cilat pala më vonë e jep pëlqimin ⁴²⁶.

Shkelja e këtyre rregullave paraqet shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pika (k) të LPK, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe si pasojë e të cilave shkelje do të duhet që të priset vendimi i gjykatës së shkallë së parë. Po ashtu për shkak të kësaj shkelje mund të paraqitet edhe mjeti i jashtëzakonshëm juridik – revizioni ⁴²⁷.

Revokimi dhe denoncimi i autorizimit

Pala mund të revokoj autorizimin kurse i autorizuari të denoncojë atë në çdo kohë. Revokimi dhe denoncimi i autorizimit bëhet në mënyrë të shkruar apo gojarisht në procesverbali para gjykatës pranë së cilës zhvillohet procedura, kurse prodhon efekt juridik kundrejt palës së kundërt, nga koha kur asaj i është komunikuar. Megjithatë, i autorizuari i palës, është i detyruar që edhe për 15 ditë të kryej veprime procedurale për palën që e ka autorizuar atë, po që se është nevoja që të evitohet ndonjë dëm që mund t'i shkaktohet palës brenda kësaj kohe ⁴²⁸.

⁴²⁵Neni 91 i LPK-së

⁴²⁶Neni 93.4 i LPK-së

⁴²⁷Neni 9 i Ligjit për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit për Procedurën Kontestimore nr.04L-118

⁴²⁸Neni 94.4 i LPK-së

Me vdekjen e personit fizik, gjegjësisht me shuarjen e personit juridik shuhet edhe autorizimi të cilën ai e ka dhënë ⁴²⁹. Në rastin e falimentimit, autorizimi i dhënë nga debitori në falimentim shuhet në momentin në të cilin sipas dispozitave në fuqi shkaktohen pasojat juridike të hapjes së procedurës për falimentim ⁴³⁰.

E drejta e ndjekjes së çështjes në gjykatë (legetimatio ad processum)

Legjitimi procedural në radhë të parë u takon subjekteve të cilët janë pjesëmarrës të raportit materialo-juridik kontestuese dhe kreditor, përkatësisht debitor të së drejtës të përfshirë me anë të kërkesëpadisë. Zakonisht autorizimin e tillë e kanë pjesëmarrësit e raportit të kontestuar materialo- juridik. Thënë thjeshtë, e drejta e ndjekjes së çështjes në gjyq u takon subjekteve të cilat në procesin kontestimor janë të legjitimuar realisht. Legjitimi real mund të jete legjitimim real aktiv dhe legjitim real pasiv.

Nga praktika: Legjitimiteti aktiv- padia për njohjen ose rivendosjen e një të drejte të shkelur ose të mohuar mund të paraqitet vetëm prej ati që i përket e drejta e shkalur, ose e mohuar prej një tjetri.

Rast praktik i legjitimit pasiv, P.sh., padia mund të paraqitet vetëm kundër atij që me qëndrimin ose veprimin e tij shkel ose mohon të drejtën subjektive të paditësit. P.sh., kreditori si paditëse e ka legjitimitetin aktiv për të paraqit padi kundër personit, i cili nuk e përmbush ose e mohon detyrimin ndaj paditësit/kreditorit. Ky i fundit e ka legjitimitetin pasiv.

Në disa raste e drejta e ndjekje së çështjes në gjyq është e ndarë nga titullari i së drejtës subjektive dhe kalon në një person të tretë. Në këto raste personi i tretë paraqitet në gjykim si palë dhe vepron në emër të vet, por për të mbrojtur të drejtën subjektive të huaj.

Kur dikush kontraktin në emër të tij ndonjë kërkesë në dobi të personit të tretë, atëherë personi i tretë fiton të drejtën vetjake dhe të drejtpërdrejtë ndaj debitorit, në qoftë se nuk është kontraktuar diç tjetër ose nuk del nga rrethanat e punës.

Përfundim nga rregulla se kontrata ka efekt juridik vetëm ndaj palëve kontraktuese përbën edhe kontrata e lidhur në dobi të personit të tretë.⁴³¹

⁴²⁹Neni 95 i LPK-së, si dhe nenin 18 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e LPK-së nr.04L-118

⁴³⁰Neni 95.2 i LPK-së

⁴³¹ Rast nga praktika: Si rast i një situate të tillë kur personi i tretë e fiton të drejtën vetjake dhe të drejtpërdrejtë është kontrata e sigurimit të jetës në dobi të personit të tretë.

Prezumimet procedurale lidhur me objektin e kontestit

Prezumimet procedurale lidhur me objektin e kontestit i gjejmë në ato dispozita të LPK-së, që i referohen:

- Mosekzistimit të gjyqëvarësisë (litispencës) së dyfishtë,
- Mosekzistimit të vendimit të formës së prerë,
- Të mos ketë hequr dorë paditësi nga kërkesëpadia,
- Mos ekzistimi i ujdisë procedurale lidhur me objektin e kontestit, dhe
- Ekzistimit të interesit për mbrojtje juridike.

Vështrim i përgjithshëm. LPK-ja, me dispozitat e nenit 391, ka përcaktuar së: *“pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejuar po që se konstaton se: pika- c) për çështjen e ngritur me padi ekziston gjyqëvarësia (litispencia), pika- d) çështja është e gjë e gjykuar (res judicata), pika- e) për objektin e kontestit është lidhur ujdia gjyqësore, se paditësi në gjykatë ka heq dorë nga kërkesëpadia, se nuk ekziston interesi juridik i paditësit për padi vërtetimi”*. Nga dispozita e cituar rrjedh se në çdo rast kur konstatohet se ekziston gjyqëvarësia e dyfishtë, ekziston vendimi i formës së prerë, ekziston ujdia gjyqësore e palëve, paditësi ka heq dorë nga kërkesëpadia dhe se nuk ekziston interesi juridik i paditësit për padi vërtetimi, padia duhet të hedhet si e palejuar.

Nga praktika: Dispozita e sipërcituar përcakton se vlerësimi i kushteve nga të cilat varet lejueshmëria e procesit gjyqësor e në mënyrë specifike i kushteve që lidhe me objektin e kontestit bëhen në fazën e shqyrtimit paraprak të padisë. Duhet theksuar se prezumimet procedurale që i referohen objektit të kontestit gjykata praktikisht ka mundsi ti vlerësoj vetëm pas pranimit të përgjigjes në padi, apo në seancën përgatitore kur paraprakisht të paditurit nuk i është dërguar padia për përgjigje, sepse nga leximi i padisë përkatësisht referati apo thëniet në padia gjykata nuk mund të konstatoj pothuajse asnjërin nga prezumimet e procedurale që i referohen objektit të kontestit përveç përditshmërisë së të drejtës subjektive dhe interesit për mbrojtje juridike.

Rëndom është i padituri a’i që e vë gjykatën në dijeni për ndonjërin nga pengesat e mundshme procedurale për shkak të t’cilave nuk mund të zhvillohet procesi gjyqësor, e që në këtë rast kanë të bëjnë me objektin e kontestit.

Mosekzistimi i gjyqëvarësisë (litispencës) së dyfishtë.

Sipas dispozitës së nenit 262 paragraf 1, të LPK-së, përcaktohet se: *“Gjyqëvarësia krijohet që në momentin në të cilin të paditurit i dorëzohet padia”*.

Gjatë kohës së ekzistimit të gjyqëvarësisë për të njëjtën kërkesëpadia nuk mund të iniciohet gjykim i ri midis palëve të njëjta. Gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare por edhe mund të njoftohet nga palët ose ndonjë pjesëmarrës tjetër, nëse është në zhvillim e sipër gjykim tjetër për të njëjtën kërkesëpadi midis palëve të njëjta.

Sipas dispozitës së neni 262 paragrafi 1, i LPK-së, si moment i krijimit të gjyqëvarësisë përcaktohet momenti i dorëzimit të padisë palës së paditur, mirëpo në praktikën gjyqësore parimisht vlerësohet se gjyqëvarësia krijohet në momentin e dorëzimit të padisë në gjykatë. Edhe dispozita e neni 252 e LPK-së, përcakton se: “Gjykimi i një çështje në gjykatë fillon me paraqitjen e kërkesëpadisë me shkrim (padi detyrimi, vërtetimi dhe ndryshimi)”.

Nëse merren për bazë këto dy dispozita shihet se ka mospërputhje lidhur me momentin e krijimit të gjyqëvarësisë, mirëpo në praktikën gjyqësore parimisht si moment të krijimit të gjyqëvarësisë konsiderohet momenti i dorëzimit të padisë në gjykatë. Ndodh kështu sepse në disa raste pala paditëse mund të paraqes në gjykata dy padi identike (me subjekte dhe objekt të njëjtë) për të cilat nuk ka dije pala e paditur, mirëpo nëse gjykata gjen se ekzistojnë këto dy padi identike, atëherë gjykata edhe pa e njoftuar palën e paditur do ta hedh një të njërit prej tyre, (zakonisht padinë e regjistruar me vonë në gjykatë).

Gjykata gjatë të gjitha fazave të shqyrtimit të çështjes kontestuese do të hedh padinë për të cilën ekziston gjyqëvarësia e dyfishtë.⁴³²

Mosekzistimi i vendimit të formës së prerë. Një prej prezumimeve procedurale që lidhet me objektin e kontestit është mosekzistimi i vendimit të formës së prerë. Gjykata për këtë prezumim procedural kujdeset kryesisht gjatë gjithë procedurës dhe nëse gjen se procedura është iniciuar për kërkesën për të cilën ekziston vendimi i formës së prerë, padinë duhet ta hedh poshtë si të palejueshme. Një veprim i tillë i gjykatës përcaktohet me dispozitë e neni 391 pika d), e LPK-së, sipas të cilës gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që së konstaton së çështja është gjë e gjykuar.

Një detyrimi i tillë për gjykatë që të kujdeset sipas detyrës zyrtare përcaktohet edhe me dispozitë e neni 166 paragrafi 2, i LPK-së.⁴³³

Të mos ketë heq dorë paditësi nga kërkesëpadia. Të mos ketë heq dorë paditësi nga kërkesëpadia është prezumim procedural i lidhur me objektin e kontestit, për të cilin gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare gjatë të gjitha fazave të procedurës. Kjo për arsye së kur pala heq dorë nga

⁴³² Një veprim i tillë i gjykatës përcaktohet me dispozitë e neni 391 pika c), e LPK-së, sipas të cilës gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që së konstaton së për çështjen e ngritur ekziston gjyqëvarësia (litispendenca).

⁴³³ Një venim i formës së prerë bëhet në disa mënyra: nëse ndaj vendimit nuk lejohen mjete e goditjes; nëse ka kaluar afati për paraqitjen e mjetit të goditjes; kur hiqet dorë nga mjeti i goditjes; kur e tërheq mjetin e paraqitur të goditjes dhe kur vendimi vërtetohet nga gjykata e instancës me të larët.

kërkesëpacia gjykata nxjerr aktgjykim në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpacia, me të cilin e refuzon kërkesëpacinë e paditësit si të pabazuara.⁴³⁴

Të mos ekzistoj pajtimi gjyqësor lidhur me objektin e kontestit. Pajtimi gjyqësor në esencë i ka karakteristikat e aktgjykimit të plotfuqishëm dhe si i tillë i prodhon të njëjtat efekte juridike, sikundër edhe aktgjykimi, prandaj si rrjedhojë lidhur me çështjen juridike për të cilën palët kanë lidhur pajtim gjyqësor, nuk mund të zhvillohet kontesti dhe nëse kontesti i tillë është iniciuar gjykata do ta hedh poshtë padinë.⁴³⁵

Ekzistimi i interesit për mbrojtje juridike. Ekzistimi i interesit juridik përfaqëson prezumim procedural vetëm të paditë vërtetuese, sepse a'i të paditë kondemnatore dhe konstitutive vetëm presupozohet. Si rrjedhojë, të paditë vërtetuese gjykata ka për detyrë që gjatë gjithë procedurës të kujdeset nëse ekziston interesi juridik për vërtetimin e të drejtë apo të raportit juridik i cili është objekt i kërkesëpadisë dhe nëse konstaton se nuk ekziston interesi i tillë, do ta hedh poshtë padinë.⁴³⁶

Prezumimet procedurale lidhur me padinë

Prezumimet procedurale lidhur me padinë i gjejmë në ato dispozita të LPK-së, që i referohen rregullsisë formale të padisë.

Vlerësimi i rregullsisë formale të padisë. Padia është veprimi i parë procedural i paditësit më të cilën iniciohet fillimi i procedurës kontestimore dhe si e tillë është parashtrësë mjaft formale elementet/përmbajta e të cilës është e përcaktuar nga ligji.

Ashtu siç është përshkruar edhe me parë sipas dispozitës së nenit 253 paragrafi 1, i LPK-së, padia duhet të përmbajë:

- kërkesën e caktuar në pikëpamje të çështjes kryesore dhe kërkesave aksesore;
- faktet mbi të cilat paditësi e bazon kërkesën;
- provat me të cilat vërtetohen faktet e tilla;
- vlerën e kontestit;
- bazën juridike dhe
- të dhënat e tjera që duhet t'i ketë çdo parashtrësë (neni 99 i këtij ligji).⁴³⁷

⁴³⁴ Një veprim i tillë i gjykatës përcaktohet me dispozitë e nenit 391 pika e), e LPK-së, sipas të cilës gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që së konstaton së paditësi ka heq dorë nga kërkesëpacia (bëhet fjalë për heqjen dorë nga kërkesëpacia në një gjykim të mëparshëm).

⁴³⁵ Një veprim i tillë i gjykatës përcaktohet me dispozitë e nenit 391 pika e), e LPK-së.

⁴³⁶ Një veprim i tillë i gjykatës përcaktohet me dispozitë e nenit 391 pika e), e LPK-së.

⁴³⁷ Të dhënat e tjera që duhet t'i ketë çdo parashtrësë sipas dispozitës së nenit 99 paragrafi 2, të LPK-së, janë: Emrin e gjykatës (përfshi edhe departamentin përkatës, përveç kur padia dorëzohet në degën e ndonjë gjykatë me ç' rast në vend të departamentit shënohet emri i degës së gjykatës themelore); Emrin dhe mbiemrin (për personin fizik), ndërsa për personin juridik emërtimin e personit juridik; Vendbanimin apo vendqëndrimin (për personin fizik), ndërsa për personin juridik (selinë e personit juridik) palëve; Vendbanimin apo vendqëndrimin e përfaqësuesve ligjor apo me

Sa i përket prezumimeve për rregullsinë e padisë, gjykata në kuptimin formal padinë duhet ta vlerësoi sipas elementeve që kërkohen për çdo parashtrësë, por edhe sipas elementeve specifike që parashihen për padinë.

Në rastet kur parashtrësja nuk përmban elementët e përcaktuar me ligj, atëherë neni 102.1, i LPK-së përcakton se: *“Kur një parashtrësë nuk është e kuptueshme dhe e plotë, siç kërkohet në paragrafin 2 të nenit 99, gjykata do ta kërkojë nga dërguesi që ta korrigjojë ose ta plotësojë. Në një rrethanë të tillë, gjykata e udhëzon palën për kryerjen e korrigjimeve dhe plotësimeve duke i caktuar një afat prej tre (tre) ditësh për korrigjimin dhe për plotësimin e parashtrësës”.*

Edhe dispozita e nenit 390 e LPK-së, parasheh se: *“Nëse gjykata konstaton se padia është e pakuptueshme apo jo e plotë, apo se ekzistojnë mungesa që kanë të bëjnë me zotësinë e paditësit apo të paditurit që të bëhet palë ndërgjyqëse, apo me përfaqësimin ligjor të tyre, apo mungesa që i përkasin autorizimit të përfaqësuesit që ta iniciojë procedurën kontestimore, kur autorizimi i tillë kërkohet me ligj, gjykata me qëllim të heqjes së mungesave të tilla i ndërmerr masat e nevojshme të përcaktuara me këtë ligj (neni 79 dhe 102 i këtij ligji)”.*

Për mos veprim sipas detyrimit nga dispozita e cituar pasoja juridike për palën parashihet me dispozitën e nenit 102. 3 të LPK-së, ku përcaktohet se: *“Parashtrësja do të konsiderohet e tërhequr nëse nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar në par. 1 të këtij neni, e nëse i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, e njëjta do të hidhet poshtë”.*

Të meta formale për të cilat padia kthehet në plotësi/korrigjim. LPK-ja dhe praktika gjyqësore janë mjaft të qarta dhe pa dilema se padia duhet të kthehet në plotësim gjithmonë kur asaj i mungojnë elemente qëduhet ti përmbaj padia si çdo parashtrësë(dispozita e nenit 99 paragrafi 2, i LPK-së).

Përkitazi me elementet tjera që duhet të përmbaj padia sipas dispozitave nga neni 253 paragrafi 1, pika a), b), c), d), dhe e) e LPK-së, praktika gjyqësore dhe LPK-ja, nuk janë në koherencën përkatësisht ekzistojnë dallime nëse padia duhet të kthehet në plotësim/korrigjim për të gjitha elementet. Përderisa LPK-ja i trajton si të domosdoshme të gjitha elemente e padisë të përcaktuar me dispozita e nenit 253 paragrafi 1, për të cilat padia duhet të kthehet në plotësim/korrigjim, në pajtim me dispozitën e nenit 102 paragrafi 1, e në lidhmëni me këtë edhe ne pajtim me dispozitën e nenit 390, praktika gjyqësore ka dallim dhe nuk i trajtoj të gjitha elemente e padisë sipas dispozitave nga neni 253 paragrafi 1, si elemente të domosdoshme për të cilat padia kthehet në plotësim/korrigjim.

Për arsye praktike në vijim do ti trajtojmë të gjitha elemente e padisë veç e veç.

prokurë, (në qoftë se palët kanë përfaqësues); Objektin e kontestit; Përmbajtjen e deklaratës dhe Firmën e parashtruesit.

Si do të veprohet nëse padisë i mungon kërkesa e caktuar në pikëpamje të çështje kryesore dhe kërkesave aksesore?

Sa i përket kërkesës/ave të caktuar në pikëpamje të çështjes kryesore dhe kërkesave aksesore edhe LPK-ja, edhe praktika gjyqësore janë në harmoni të plotë duke e trajtuar si pengesë formale mos përcaktimin e kërkesave në padi. Në këtë kontekste duhet theksuar së në çdo rast gjyqtari i çështjes nëse konstaton së padisë i mungon elementi i përcaktimit të kërkesës/ave duhet ta kthej padinë në plotësim/korrigjim, sipas dispozitës së nenit 102 paragrafi 1i LPK-së.

Është me rëndësi të theksohet së praktika gjyqësore sa i përket këtij elementi të padisë është ma formale se vet LPK-ja, pasi që LPK-ja, formalisht nuk e përcakton se kërkesa e padisë duhet të formulohet në një formë të caktuar, ndërsa praktika gjyqësore këtë element të padisë e kërkon të jetë i formuluar në formën e një “petitiumi” i cili në fakt është propozim për përmbajtjen e dispozitivit të vendimit merititor.

Kjo mënyrë e veprimet në praktikën gjyqësore është në pajtim me logjikën e një procesi gjyqësor civil sepse nuk është kontestuese se procesi kontestimorë inicohet me qëllim që gjykata ti jep paditësit mbrojtje gjyqësore të përmbajtjes së caktuar. Aq më tepër kjo ka kuptim nëse ndërlihet edhe detyrimi për gjykatën që të vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqësore, (neni 2, paragrafi 1, i LPK-së).

Nga praktika: Pavarësisht se kërkesa e padisë në pikëpamje të çështjes kryesore dhe aksesore është element formal-i domosdoshme i padisë, ka raste kur gjykata nuk duhet ta kthej në plotësim/korrigjim padinë për këtë element. Arsyeja pse gjykata në disa raste nuk duhet ta kthej padinë në plotësim/korrigjim ka të bëjë me aspekte praktike të përcaktimit të saktë të kërkesës sidomos të vëllimit të kërkesës.

Shembuj:

Nëse X personi ka pësuar lëndime të renda trupore më pasoja të përhershme të kufizimit të aftësisë për punë dhe për këtë kategori të dëmit materia paraqet padi. X personi si paditës e ka krejt të pamundur të përcaktoj me saktësi kërkesën kryesore dhe aksesore sidomos lidhur me lartësinë e dëmi/kompensimit, sepse lartësi e dëmit do të mund të përcaktohet vetëm pas administrimit të provave përkatëse për lartësinë e dëmit.

Nëse X personi është larguar nga puna në mënyrë të kundërligjshme dhe i njëjti parqet padi për kompensimin e pagave deri në kthimin e tij në punë, nën supozimin se ka kaluar një kohe nga data e largimit nga vendi i punës, i njëjti nuk mund të përcaktoj lartësinë e të ardhurave/pagave, bonuseve dhe komtës derisa nuk administrohen provat përkatës si ekspertiza financiare apo ndonjë provë tjerë nga e cila në mënyrë të pakontestueshme provohet lartësi e kërkesës.

Nëse X personi paraqet padi për krijimin e servitut në pronë shërbyes për favorin e pronës sunduese, i njëjti nuk ka mundsi me përcaktua kërkesën në mënyrë të saktë derisa nuk nxjerrët prova përkatës ekspertiza e xheodezisë.

Nëse X personi paraqet padi për pengimin e posedimin në një pjesë të pronës se tij, i njëjti nuk mund ta paraqes në mënyrë të saktë kërkesën derisa nuk administrohen provat përkatës këqyrja në vend dhe ekspertiza.

Si do të veproj gjykata nëse padisë i mungojnë faktet mbi të cilat paditësi e bazon kërkesë?

Sipas dispozitës së nenit 253 paragrafi 1, pika b) e LPK-së, del së faktet mbi të cilat paditësi e bazon kërkesën paraqesin njërin prej elemente të domosdoshme të padisë. Në fakt nëse i referohemi dispozitës së nenit 102 paragrafi 1, i LPK-së, del së gjykata do ta kthej padinë në plotësim për të dhënat që duhet të përmbaj padia si parashtrere, përmbajtja e të cilës është përcaktuar me dispozitën e nenit 99 paragrafi 2, i LPK-së. Në dispozitën e nenit 99 paragrafin 2, përveç të tjerave përcakton së parashtrera duhet të ketë edhe përmbajtjen e deklaratë, ndërsa në paragrafin 3 të neni 99, përcaktohet së:” *në qoftë së deklarata përmban ndonjë kërkesë, pala duhet në parashtrësë t’i tregoj faktet mbi të cilat e bazon kërkesën, si dhe provat kur është nevoja për një gjë të tillë*”.

Nga praktika: Gjykata duhet të jenë të kujdesshme kur vendosin që padinë ta kthejnë në plotësim duke kërkuar nga paditësi paraqitjen e fakteve mbi të cilat paditësi e bazon kërkesën e tij. Këshillohet që gjykatat ta kthejnë padinë në plotësim për këtë element vetëm në rastet kur në padi nuk është prezantuar asnjë fakt mbi të cilin/at paditësi e bazon kërkesën e tij. Këshillohet të veprohet në këtë formë sepse nëse paditësi nuk prezanton fakte sipas detyrimit të përcaktuar nga gjykata për plotësimin e padisë, atëherë gjykata do ta konsideroj të tërhequr padinë.

Në një situatë të tillë shtrohet pyetja logjike, a do të mund të kishte sukses padia e paditësit edhe me ato pak fakte të paraqitura në padi që sipas gjykatës nuk kanë qenë të mjaftueshme për tu konsideruar se paditësi i ka paraqitur faktet mbi të cilat e bazon kërkesën e tij. Përgjigjja është prapë logjike dhe do të mund të konstatojmë së padia e paditësit do të mund të kishte sukses, ndoshta duke u nisur nga mundësia që i paditur mund ta pohoj kërkesën e padisë. Prandaj themi është paditësi a’i i cili i dinë të gjitha fakte e çështjes dhe është po a’i që zgjedh vet se cilat fakte dëshiron ti paraqes për ta provuar themelësinë e kërkesëpadisë, ndërsa gjykata nuk mund të jetë e sigurt në asnjë rast përveç kur në padi nuk është paraqitur asnjë fakt, së paditësi nuk i ka paraqitur të gjitha fakte e çështjes.

Në fund të fundit themi, ma e drejtë do të jetë që gjykata ta refuzoj si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit në mungesë të themelësisë së sa, se sa, t’ia pamundsoj paditësit shqyrtimin e çështjes vetëm për shkak se gjykata është e bindur që paditësi nuk i ka prezantuar të gjitha fakte e çështjes.

Nuk duhet harruar edhe mundsintjetër që ka gjykata që në seancë përgatitore të parashtroj pyetje palët përfshirë edhe çështjen e fakteve dhe provave.

Si do të veprohet në rast së padisë i mungojnë provat për të vërtetuar fakte e paraqitura në padi?

Sipas dispozitës së nenit 253 paragrafi 1, pika c) e LPK-së, del së provat mbi të cilat paditësi e bazon kërkesën paraqesin njërin prej elemente të domosdoshme të padisë, megjithatë në praktikën gjyqësore gjykatat janë mjaft të kujdesshme për ta konsideruar paraqitjen e provave si element të domosdoshëm të padisë.

Edhe për provat si element i padisë nëse i referohemi dispozitave të LPK-së nga neni 102 paragrafi 1, 99 paragrafi 2 dhe 3, do të mund të konstatojmë së paditësi është i detyruar që në padi të paraqes provat, megjithatë në praktikën gjyqësore paraqitja e provave nuk konsiderohet si kusht i domosdoshme, prandaj gjykata nuk mund ta kthejë padinë në plotësim, me detyrim për paditësin që i njëjti ta plotësojë padinë duke i paraqitur provat me të cilat vërtetohen faktet e paraqitura në padi.

Praktika gjyqësore është mjaftë e qartë për këtë situatë, ashtu që mbizotëron mendimi së edhe nëse në padi nuk janë propozuar provat, e njëjta duhet të konsiderohet e rregullt dhe të vazhdohet me procesin e vendosjes meritore. Kjo për faktin së edhe në mungesë të provave mund të nxirret aktgjykimi në bazë të pohimit por në fund të fundit mund të vendoset në mënyrë meritore duke e refuzuar kërkesëpadinë si të pabazuar.

Pra thënë thjeshtë gjykata nuk duhet ta zhvillojë procedurën e përmirësimit të padisë për shkak të mungesës së provave.

Si do të veprojnë gjykatat në rast së padisë i mungon vlera e objektit të kontestit?

Me dispozitën e nenit 253 paragrafi 1, pika d) e LPK-së, është parapa se padia duhet të përmbajë edhe vlerën e objektit të kontestit, por në praktikë gjyqësore nuk konsiderohet element i domosdoshme pa të cilin nuk mund të zhvillohet procesi gjyqësor.

Nëse paditësi nuk e ka përmendur fare vlerën e objektit të kontestit në padi, apo në qoftë së a'i vlerën e tillë e ka përcaktuar tepër të larët apo shumë të vogël, atëherë gjykata sipas detyrë zyrtare apo sipas prapësimit të palës së paditur, me së voni në seancën përgatitore, e në qoftë së kjo nuk është mbajtur, atëherë në seancën për shqyrtim kryesor, por para së të fillojë shqyrtimi shpejt dhe në mënyrë të përshtatshme do ta caktoj vlerën e objektit të kontestit.

Duhet theksuar së gjykata nuk do të nxjerr ndonjë ekspertizë për ta caktuar vlerën e objektit të kontestit, por varësisht nga ajo së çka është objekt kontesti do ta caktoj edhe vlerën.⁴³⁸

Vlera e objektit të kontestit ka rendësi sepse në bazë të vlerës përcaktohet nëse pala do të mund ta paraqes revizionin kundër aktgjykimit/aktvendimit, sipas vlerës përcaktohet edhe detyrimi për taksën gjyqësore dhe lartësia e shpenzimeve të përfaqësimit për përfaqësuesin që është avokat.

Si do të veprojnë gjykata në rast së padisë i mungon baza juridike?

Me dispozitën e nenit 253 paragrafi 3, të LPK-së, përcaktohet së: “ *gjykata do të vendos sipas padisë edhe kur paditësi nuk e ka treguar bazën juridike të kërkesëpadisë*”.

Nga kjo dispozitë rrjedh se baza juridike është element fakultativ i padisë edhe pa të cilën procesi gjyqësor zhvillohet. Rëndësia e bazës juridike si element i padisë është evidente sepse po të jetë e caktuar baza juridike sipas të cilës paditësi e ka bërë kualifikimin juridike të fakteve do ta ndihmojë gjykatën në orientimin e procesit së të provuarit.⁴³⁹

⁴³⁸ Shembull: Varësisht nga natyra/lloji i kërkesëpadisë përcaktohet vlera e objektit të kontestit. Në kërkesat në të holla vlera është ajo që është kërkesë e padisë, prandaj gjykata shpejt e cakton duke e marrë të njëjtën. Në kërkesat pasurore –juridike që nuk janë në të holla gjykata merr për bazë vlerën e përafërt të objektit të kontestit, p.sh., nëse kërkohet dorëzimi i sendit (*pronës së paluajtshëm*) vlerën e përafërt të pronës (themi të përafërt sepse gjykata nuk nxjerr një ekspertizë përkatëse për ta vërtetuar vlerën) por fillimisht gjykata kërkon që paditësit ta caktoj e nëse nuk e cakton paditësi e cakton vet gjykata.

Në këtë rast gjykata vendos me aktvendim ndaj të cilit nuk lejohet e drejta e ankesës. Nëse gjykata nuk ka vendosur jashtë seancës për vlerën e objektit të kontestit dhe një veprim të tillë e merr në seancë, atëherë aktvendimi për vlerën e objektit të kontestit konstatohet në procesverbal dhe nuk nevojitet një aktvendim i arsyetuar.

⁴³⁹ Shembull: Nëse paditësi me padi ka kërkuar vërtetimin e së drejtës së pronësisë sipas bazës së mbajtjes gjykata do ta orientojë procesin e shqyrtimit dhe të provuarit sipas kësaj baze, ndërsa nëse paditësi të drejtën e pronësisë e kërkon sipas bazës së trashëgimisë, atëherë gjykata shqyrtimin dhe të provuarit i orientojnë sipas kësaj baze.

SIGURIMI I KËRKESËPADISË

SIGURIMI I KËRKESËPADISË

Gjykata u jep subjekteve të së drejtës mbrojtje juridike sipas propozimit të tyre, në ato situata në të cilat ekziston rreziku, se pa caktimin e masave pala kundërshtare do të mund të pamundsonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës përmes tjetërsimit të pasurisë, fshehjes së saj, apo ndryshimit të gjendjes ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit. Kur plotësohen rrethanat e caktuara me ligj, masat e sigurisë mund të shqiptohen jo vetëm gjatë zhvillimit të procesit kontestimor, por edhe para vënies së saj në veprim. Mirëpo, edhe pse kemi të bëjmë me dhënien e mbrojtjes juridike, duhet theksuar se ajo ka karakter të përkohshëm. Ajo zgjatë derisa gjykata në procedurën kontestimore ta jap vendimin me të cilin e refuzon si të pathemeltë kërkesën për mbrojtje juridike, apo derisa të mos e realizojë kreditori kredinë e tij ndaj debitorit. Realizimi faktik i të drejtave subjektive merr zakonisht kohë relativisht të gjatë. Pra, deri te realizimi faktik i së drejtës subjektive private kalon kohë e gjatë, në të cilën pala e pandërgjegjshme dhe i cili nuk ka vullnet për ta përmbushur premtimin në mënyrë vullnetare mund të përdorë metoda të ndryshme për të vështirësuar realizimin e kërkesës së palës paditëse.

Kushtet për caktimin e masave të sigurimit

Bazuar në dispozitën e nenit 297 të LPK-së, masa e sigurimit mund të caktohet: a) në qoftë se propozuesi i sigurimit e bën të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të drejtës subjektive të tij, si dhe b) në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtare do të pamundsonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër me të cilën do të ndryshonte gjendja ekzistuese e gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit. Këto dy kushte duhet të plotësohen në mënyrë kumulative.

Në lidhje me kushtin e parë, se çka nënkuptohet me ekzistim të kërkesës apo të drejtës subjektive, sipas kësaj dispozite propozuesi i masës së sigurimit, duhet ta dëshmojë atë përmes ndonjë vendimi të më hershëm të gjykatës apo të ndonjë organi administrativ, testamenti, kontrate, ndonjë dokumenti përmbarimor, të drejte tjetër të fituar në bazë të dispozitave ligjore, respektivisht ndonjë titulli tjetër juridik. Ndërsa sa i përket kushtit të dytë, propozuesi i masës së sigurimit duhet të bëjë të besueshëm dhe konkret rrezikun që pala kundërshtare do të mund të bënte tjetërsimin e pasurës së vet, ta fsheh atë, ta vë në ngarkim qoftë me peng apo nën hipotekë etj.

Po që se nuk është përcaktuar ndryshe me ligj, është e paraparë se gjykata mund të caktojë masën e sigurimit vetëm në kushtet kur propozuesi i sigurimit brenda afatit të caktuar nga gjykata paguan shumën e caktuar të garancionit në masën dhe llojin e caktuar nga gjykata, për dëmin që mund t'i shkaktohet palës kundërshtare me caktimin dhe përmbarimin e asaj mase. Sidoqoftë me dispozita ligjore është e paraparë se me kërkesën e propozuesit gjykata mund ta lirojë atë nga detyrimi i dhënies së garancisë, po që se konstatohet se ai nuk ka mundsi financiare për një gjë të tillë. Po që

se propozuesi nuk e paguan garancionin në masën dhe afatin e caktuar nga gjykata, kjo e fundit do ta refuzojë propozimin për caktimin e masës së propozuar të sigurimit⁴⁴⁰. Bashkësitë e pushtetit lokal, respektivisht të gjithë personat juridik të së drejtës publike janë të përjashtuara nga detyrimi i pagesës së garancionit. Një gjë e tillë është e paraparë edhe me dispozitat e LPP-së ri⁴⁴¹.

LLOJET E MASAVE TË SIGURIMIT

Me dispozitat ligjore të LPK-së është e paraparë se mund të bëhet sigurimi i: Kërkesës në të holla, sigurimi i kërkesës i drejtuar kah sendi i caktuar apo nga një pjesë e tij, si dhe sigurimi i të drejtave të tjera apo për ruajtjen e gjendjes ekzistuese të rrethanave.

Për sigurimin e kërkesës në të holla mund të caktohen këto masa të sigurimit me:

- a. Ndalimin e kundërshtarit të sigurimit që ta tjetërsojë, fshehë, ngarkojë apo disponojë me pasurinë e caktuar me vlerë të mjaftueshme për sigurimin e kërkesës së propozuesit të sigurimit, i cili ndalim regjistrohet në regjistrin publik përkatës,
- b. ruajtja e pasurisë me të cilën ka të bëjë ndalimi nga pika e mësipërme, nga gjykata në depozitën e saj, kur ka mundsi për një gjë të tillë, apo duke ia dhënë atë në posedim propozuesit të sigurimit apo personit të tretë,
- c. ndalimi i debitorit të kundërshtarit të sigurimit që këtij të fundit t'i përmbushet kërkesa apo dorëzohet sendi, si dhe ndalimi i kundërshtarit të sigurimit që ta pranojë sendin, ta realizojë kërkesën apo të disponojë me të,
- d. parashënimi i të drejtës së pengut mbi sendin e paluajtshëm të kundërshtarit të sigurimit, apo mbi të drejtën e regjistruar mbi sendin e paluajtshëm deri në vlerën e kërkesës kryesore, me kamata dhe shpenzime procedurale për të cilën është dhënë aktgjykimi i cili ende nuk është bërë i ekzekutueshëm.

Për sigurimin e kërkesës së drejtuar ka sendi i caktuar apo ka një pjesë e tij, mund të caktohen këtë masa sigurimi:

- a. Ndalimi i kundërshtarit të sigurimit që ta tjetërsoj, fsheh, ngarkoj apo disponoj me pasurin kah e cila është drejtuar kërkesa, me ç'rast ky ndalim do të evidentohet në regjistrin publik përkatës;
- b. Ruajtja e pasurisë të cilës i përket ndalimi nga pika a e këtij paragrafi dhe atë duke e depozituar në gjykatë nëse kjo është e mundshme, apo duke ju dorëzuar në posedim propozuesit të sigurimit apo personit të tretë;
- c. Ndalimi i kundërshtarit të sigurimit të kryej veprime me të cilat mund të dëmtohet pjesa e pasurisë kah e cila është drejtuar kërkesa, apo urdhri i

⁴⁴⁰Neni 297.3 i LPK-së

⁴⁴¹Neni 297.4 i LPK-së, dhe neni 14.2 i LPP të ri.

kundërshtarit të sigurimit që t'i kryej veprimet e caktuara të nevojshme për tu ruajtur pasuria apo për tu ruajtur gjendja ekzistuese e rrethanave.

d. Autorizimi i propozuesit të sigurimit që t'i kryej aktivitete e caktuara.

Vlen të ceket se masat e lartcekura të sigurimit të cilat janë të drejtuara ka sendi i caktuar apo ka një pjesë e tij e të cilat zakonisht gjenden tek pala kundërshtare, nuk guxojnë ta përfshijnë në tërësi kërkesën që sigurohet me anë të tyre ⁴⁴². Kjo nënkupton se me rastin e caktimit të ndonjërës nga këto lloj masa, gjykata nuk mund të vendos që këto masa ta sigurojnë në tërësi kërkesën e propozuesit të sigurimit në aspektin e vlerës të asaj kërkesë. E në rastet kur kërkesa e propozuesit të sigurimit ka një vlerë të caktuar, atëherë masa e sigurimit e cila është drejtuar ka sendi i caktuar apo ka një pjesë e tij, nuk guxon të përfshijë në tërësi atë vlerë të kërkesës.

Përfundimisht, për sigurimin e të drejtave të tjera apo për ruajtjen e gjendjes ekzistuese të rrethanave mund të caktohen masat siguroese si në vijim:

- a. ndalim i kundërshtarit të sigurimit që t'i kryej aktivitetet e caktuara, apo urdhri që t'i kryej aktivitetet, me qëllim të ruajtjes së gjendjes ekzistuese apo pengimit të dëmtimit të palës kundërshtare,
- b. autorizim i propozimit të sigurimit që t'i ndërmarrë aktivitetet e caktuara,
- c. lënia e pasurisë së caktuar të kundërshtarit të sigurimit për ruajtje dhe përkujdesje personit të tretë,
- d. masat tjera të cilat i cakton gjykata si të domosdoshme për sigurimin e kërkesëpadisë së propozuesit të sigurimit.

Pra rasti i caktimit të ndonjërës nga ky grup i masave për sigurimin e kërkesëpadisë, ka të bëjë në situatat kur objekt i sigurimit nuk janë as kërkesat në të holla, e as kërkesat e tjera të drejtuara nga sendi apo pasuria e kundërshtarit të sigurimit, por janë të drejtat e tjera, apo kur kërkohet ruajtja e gjendjes ekzistuese të rrethanave. Ajo që i dallon këto lloje të masave nga dy grupet e tjera të lartpërmendura, është se derisa dy llojet e para janë të numëruara në mënyrë taksative, ky lloje i tretë i masave për sigurimin e kërkesëpadisë nuk është i përmbyllur në mënyrë taksative në nenin 301 të LPK-së, kështu që në këtë rast ekziston hapësirë për gjykatën që të caktoj edhe masa të tjera, nëse kjo e fundit e sheh të nevojshme dhe të domosdoshme për sigurimin e kërkesëpadisë së propozuesit të masës përkatëse të sigurimit ⁴⁴³.

Po ashtu duhet të ceket se gjykata mundet që kur ka nevojë për një gjë të tillë, t'i caktoj dy apo më tepër masa të sigurimit⁴⁴⁴, duke vepruar sipas propozimit përkatës të propozuesit, i cili propozim mban në vete kërkesën për caktimin e disa e masave siguroese, gjykata mundet të caktoj një masë siguroese të propozuar, apo dy e më tepër masa të propozuara, për shembull për veç masës për

⁴⁴²Neni 300.3 i LPK-së.

⁴⁴³Neni 301 pika (d) e LPK-së

⁴⁴⁴Nenin 303 i LPK-së

ndalimin e tjetërsimit të ngastrës kadastrale kontestuese, të caktoj edhe masën tjetër të propozuar e cila ka të bëjë me ndalimin e çfarëdo ndryshimi të gjendjes faktike të ngastrës në fjalë.

KOMPETENCA PËR TË VENDOSUR PËR MASAT E SIGURIMIT TË KËRKESËPADISË

Me ligjin për procedurën kontestimore, nenin 296, është paraparë momenti kohor se kur mund të paraqitet kërkesa për sigurimin e kërkesëpadisë. Sipas kësaj dispozite del se ky propozim mund të bëhet para se të jetë ngritur padia për fillimin e procedurës kontestimore, por edhe gjatë procedurës së tillë. Në bazë të po këtij neni përcaktohet edhe gjykata e cila është kompetente për caktimin e masave të sigurisë, e që del të jetë gjykata kompetente për shqyrtimin e padisë dhe të kërkesëpadisë, përkatësisht gjykata e cila vepron sipas padisë që do të thotë se me kompetencë janë Gjykatat Themelore. Përfundimisht sipas këtij neni rregullohet edhe mënyra dhe forma e vendosjes lidhur me propozimin për sigurimin e kërkesëpadisë. Kësisoj përkitazi me lejimin e sigurimit të kërkesëpadisë, apo refuzimin propozimit, gjykata vendos me aktvendim.

Me kompetencë për të vendosur lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurisë, është edhe Gjykata e Apelit kur procedura zhvillohet sipas mjeteve të rregullta juridike, por vetëm në rastet kur propozimi për sigurimin e kërkesëpadisë është paraqitur pasi që lënda sipas ankesës, ka kaluar për shqyrtim në atë gjykatë.

Vlen të ceket se dhe në rastet kur kemi të bëjmë me aktgjykim të formës së prerë, kompetente për të vendosur lidhur me propozimin për caktimin e masës siguruuese, është gjykata e cila do të ishte kompetente për vendosje për kërkesëpadinë në shkallë të parë, apo gjykata kompetente për shqyrtimin e padisë. Megjithatë kjo ka të bëjë vetëm me rastet kur ende nuk ka filluar procedura e përmbarrimit ngase pasi që të filloj procedura e përmbarrimit, kompetente për të vendosur lidhur me masën përkatëse për sigurimin e kërkesëpadisë, është gjykata përmbarrimore.

Mënyra e paraqitjes dhe përmbajtja e propozimit për caktimin e masës për sigurimin e kërkesëpadisë

Propozimi për caktimin e masës së sigurisë mund të paraqitet:

- a. në formë të shkruar, apo edhe
- b. në formë gojore në rast se procesi gjyqësor është në zhvillim e sipër ⁴⁴⁵.

Në propozimin për caktimin e masave të sigurimit, propozuesi i sigurimit duhet ta cek në të:

- a. kërkesën për sigurimin e të cilës bën propozim;
- b. masën e sigurimit që e propozon;
- c. mjetet dhe objektin e masës së sigurimit.

⁴⁴⁵Neni 304 i LPK-së

d. Si dhe faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadisë dhe provat që i mbështesin këto pretendime.

Me dispozita ligjore është paraparë se në propozim duhet të tregohen edhe faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia, si dhe të propozohen mjetet provuese me të cilat mund të provohen pretendimet e parashtruara në propozim, e të cilat mjete, sipas mundsive propozuesi duhet t'ia bashkëngjisë propozimit për caktimin e masës së sigurisë, apo të përcaktoj se ku mund të sigurohen të njëjtat.

Njoftimi i kundërshtarit të propozimit në lidhje me masën e propozuar. Përveç rasteve të përcaktuara me LPK, masa përkatëse e sigurimit nuk mund të caktohet po që se kundërshtari i sigurimit nuk ka pasur mundsi që të deklarohet për propozimin për caktimin e saj.

Propozimin për caktimin e masës së sigurisë, gjykata bashkë me shkresat që i janë bashkangjitur, i'a dërgon kundërshtarit të sigurimit me njoftimin se mund të paraqes përgjigjeje të shkruar brenda afatit 7 ditor ⁴⁴⁶.

Mosdhënia e mundsisë që kundërshtari i sigurimit të deklarohet për propozimin për caktimin e masës së sigurimit mund të ndodh vetëm përjashtimisht për rastet të cilat vet ligji parasheh një mundsi të tillë.

Përmbajtja e aktvendimit mbi caktimin e masës së sigurimit

Në aktvendimin mbi caktimin e masës së sigurimit, gjykata përcakton llojin e masës së sigurimit, mjetet me të cilat ajo do të realizohet dhunshëm dhe objektin e masës së sigurimit, duke i aplikuar përshtatshmërisht rregullat e procedurës përmbartimore. Lloji i masës së sigurimit varet nga lloji i kërkesave për të cilat kërkohet siguri. Gjkata sipas detyrës zyrtare ia dërgon një aktvendim mbi caktimin e masës së sigurimit gjykatës përmbartuese kompetente me qëllim të ekzekutimit të tij të dhunshëm si dhe regjistrin publik me qëllim të regjistrimit në të.

LPK-ja ka përcaktuar në mënyrë të veçantë masat e sigurimit për kërkesat me të holla, për ato të drejtuara ka sendi apo një pjesë e caktuara e sendit, si dhe llojet e masave të sigurimit për kërkesat lidhur me të drejtat e tjera.

Aktvendimi mbi caktimin e masës së sigurimit, po ashtu duhet të përcaktoj edhe mjetet me të cilat realizohet dhunshëm kërkesa e caktuar dhe objekti i masës së sigurimit.

Kur është fjala për mjetet me të cilat do të realizohet dhunshëm kërkesa e caktuar lidhur me objektin e masës së sigurimit, aplikohen përshtatshmërisht rregullat e procedurës përmbartimore të cilat parashohin edhe aplikimin e mjeteve dhe masave të dhunshme në rastet kur personat e obliguar sipas vendimeve të gjykatës refuzojnë të kryejnë veprimet e parapara me ato vendime. Poqë se me qëllim të realizimit të urdhëresës apo ndalimit të caktuar duhet ndryshuar mjetet apo

⁴⁴⁶Neni 305 i LPK-së

objektet e sigurimit, propozuesi i sigurimit mund të propozoj ndryshimin e tillë në të njëjtën procedurë dhe në bazë të urdhëresës apo ndalimit ekzistues.

Aktvendimi me të cilin është caktuar masa e sigurimit, ka efekt të aktvendimit mbi përmbarimin nga Ligji për Procedurën Përmbarimore. Aktvendimi duhet ta ketë edhe pjesën e vet arsyetuese⁴⁴⁷, duke dhënë arsye lidhur me plotësimin e kushteve të parapara me neni 297 të LPK-së, si dhe me cilat prova dhe rrethana ka vërtetuar faktin se caktimi i masës siguroese është bërë i domosdoshëm bazuar në dispozitat e ligjit të procedurës kontestimore.

Efektet e aktvendimit për caktimin e masës përkatëses për sigurim, nuk përfshijnë vetëm palët e përfshira në procedurë, por edhe palët e treta, të cilët mund të kenë ndërlidhje me palët e procesit apo të çështjes, me kusht që palët ndërgjyqëse apo edhe palët e treta, të jenë të njoftuar me përmbajtjen e aktvendimit të tillë.

Mundësia e caktimit të masës së sigurimit para se të jetë ngritur padia. Me dispozitat ligjore të LPK-së, është e paraparë mundësia që masa e sigurimit të caktohet edhe para se të jetë ngritur padia⁴⁴⁸. Në situatë e tillë mund të ndodh sidomos në rastet kur kemi rrezik objektiv dhe serioz për pamundsinë e realizimit të kërkesëpadisë së paditësit. Por në këtë rast, duhet që me vendimin me të cilin caktohet masa e sigurimit, të caktohet edhe afati jo më i shkurtër se 30 ditë, brenda të cilit afat, propozuesi i sigurimit duhet të ngritë padinë. Në këto raste propozuesi i masës së sigurisë duhet që gjykatës t'ia paraqet provën nga e cila shihet se ka vepruar në pajtim me të lartcekurat.

Me rasti e caktimit të masës së sigurimit nga gjykata, duhet të caktohet edhe kohëzgjatja, për shembull deri në marrjen e vendimit të formës së prerë sipas kërkesëpadisë. Zakonisht masa e sigurisë mbetet në fuqi derisa gjykata të mos merr ndonjë vendim tjetër mbi masën e sigurimit. Në këtë rast kemi të bëjmë me vendim tjetër të gjykatës mbi masën e sigurisë, i cili e shfuqizon dhe rrjedhimisht e zëvendëson vendimin e mëparshëm mbi masën e sigurisë.

Edhe në rast të mos aprovimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet që me aktgjykimin përmes të cilit e refuzon kërkesëpadinë e paditësit, të vendos që ta lejë në fuqi masën e caktuar të sigurimit, deri sa aktgjykimi i shkallës së parë të mos bëhet i formës së prerë⁴⁴⁹. Kjo për faktin se edhe përkundër aktgjykimit të dhënë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, palëve u është garantuar e drejta e ankesës, brenda afatit ligjor 15 ditor nga dita e pranimit të tij, andaj rrjedhimisht kjo ndikon që aktgjykimi të mos e merr formën e prerë brenda këtij afati.

Gjykata mundet që me propozim të kundërshtarit të sigurimit, ta përfundoj procedurën e filluar dhe t'i anuloj veprimet e kryera, po që se rrethanat për shkak të të cilave është caktuar masa përkatëse e sigurimit, kanë ndryshuar esencialisht më vonë duke e bërë të panevojshme atë masë⁴⁵⁰.

⁴⁴⁷ Neni 307.4 i LPK-së.

⁴⁴⁸ Neni 296, 304 dhe 308 i LPK-së

⁴⁴⁹ Neni 309 i LPK-së

⁴⁵⁰ Neni 313 i LPK-së

Gjykata sipas propozimit të kundërshtarit të sigurimit e përfundon procedurën dhe i anulon veprimet e kryera edhe po që se:

- a. Kundërshtari i sigurimit e deponon në gjykatë shumën e detyruar të kërkesës që sigurohet me kamata dhe shpenzime;
- b. Kundërshtari i sigurimit e bën të besueshëm pretendimin se kërkesa në momentin e dhënies së aktvendimit mbi caktimin e masës së sigurimit është realizuar apo se ka qenë mjaftueshëm e siguruar ;
- c. Me vendim të formës së prerë është vërtetuar se kërkesa nuk është krijuar, apo se e njëjta është shuar.

Shpenzimet e shkaktuara përgjatë procedurës për sigurimin e kërkesëpadisë

Shpenzimet e shkaktuara gjatë procedurës për caktimin e masës së sigurimit i bartë paraprakisht propozuesi i sigurimit. Në rast se propozimi për caktimin e masës së sigurimit paraqitet gjatë zhvillimit të procedurës kontestimore apo të ndonjë procedure tjetër gjyqësore, gjykata kompetente për vendosje mbi kërkesëpadinë, apo mbi kërkesën tjetër, do të vendosë se kush i bartë shpenzimet e caktimi dhe të zbatimit të masës së sigurisë.

Pasojat e mosrespektimit të masës për sigurimin e kërkesëpadisë

Propozuesi i sigurimit ka të drejtë që sipas rregullave të përgjithshme së drejtës pasurore, të kërkojë që t'i kompensohet dëmi që i është shkaktuar për shkak të mosrespektimit të aktvendimit mbi masën siguruese të caktuar ⁴⁵¹. Pra, pasojat e mosrespektimit të masës me të cilën është siguruar kërkesëpadia, janë të natyrës civile, e jo penale. Bazuar në natyrën e masave përmes të cilave sigurohet kërkesëpadia, del se në përgjithësi ato detyrojnë kundërshtarin e masës në ndërmarrjen e ndonjë veprimi të caktuar, pra në veprim, apo në moskryerjen e ndonjë veprimi të caktuar, që d.m.th. edhe në mosveprim.

Edhe pse në këtë rast fjala është për një dëm paksa më specifik, për shkak se ky dëm është shkaktuar si pasojë e mosrespektimit të masës përkatëse, prapë se prapë edhe në këtë rast do të vlejné rregullat e përgjithshme të së drejtës pasurore, përkatësisht ato të së drejtës civile. Në fakt për këto raste zbatohen rregullat apo dispozitat ligjore civile të cilat rregullojnë institutin e dëmit, i cili institut rregullohet me dispozitat ligjore të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD). E sipas këtyre dispozitave parashihet se në rast të shkaktimit të dëmit, propozuesi i sigurimit ka të drejtë si për kompensimin e dëmit të thjeshtë, e njashtu edhe për kompensimin e fitimit të humbur. Normalisht që së pari kundërshtari i sigurimit do të detyrohej që të rivendos gjendjen e mëparshme që ka ekzistuar para se të shkaktohej dëmi, e në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, atëherë për pjesën tjetër të dëmit mund të kërkohet të jepet shuma e caktuar e kompensimit në të holla. Në anën tjetër edhe kundërshtari i sigurimit ka të drejtë që sipas rregullave të përgjithshme të së drejtës pasurore, të kërkojë nga propozuesi i sigurimit që t'i

⁴⁵¹Neni 315 i LPK-së

kompensoj dëmin e shkaktuar nga masa e caktuar e sigurimit të kërkesëpadisë, e për të cilën masë është vërtetuar se ka qenë e pa bazë apo të cilën masë nuk e ka justifikuar propozuesi i sigurimit⁴⁵². Pra derisa më sipër bëhej fjalë për të drejtën e kompensimit të dëmit propozuesit të sigurimit për shkak të mos respektimit të masës nga ana e kundërshtarit të sigurimit, tani fjala është për dëmin i cili i është shkaktuar kundërshtarit të sigurimit përmes zbatimit të masës përkatëse për sigurimin e kërkesëpadisë, e cila ka qenë e masë e pa bazë dhe e pajustificuar. Edhe në këtë rast zbatohen rregullat e përgjithshme të së drejtës civile, përkatësisht rregullat dhe dispozitat e LMD-së.

Është e rëndësishme të ceket se kërkesa për shpërblimin e dëmit nga të dy rastet e sipërpërmendura, parashkruhen brenda afatit prej 1 viti nga dita e mbarimit të efektit të aktvendimit me të cilin është caktuar masa e sigurimit.

Ekzekutimi i masave të sigurimit

Masat e sigurimit të kërkesëpadisë i zbaton gjykata që do të ishte kompetente për ekzekutimin e aktgjykimit të formës së prerë⁴⁵³. Në këtë rast duhet të qartësohet se nuk është fjala për ndonjë gjykatë të veçantë, por për llojin e veçantë të procedurës, respektivisht atë të procedurës përmbartimore. Pra zbatimi i masës së sigurimit bëhet nga gjykata themelore, respektivisht gjykatësi i procedurës përmbartimore pranë kësaj gjykate.

Pasojat e mosrespektimit të masave me të cilat sigurohet kërkesëpadia

Kundërshtari i sigurimit i cili vepron në kundërshtim me aktvendimin për ndalimin e tjetërsimit, fshehjes, ngarkimit apo disponimit me pasurinë, përgjigjet sipas rregullave të së drejtës civile.

Propozuesi i sigurimit ka të drejtë që sipas rregullave të përgjithshme të së drejtës pasurore, t'i kompensohet dëmi që i është shkaktuar me mosrespektimin e aktvendimit mbi caktimin e masës së sigurimit.

Duke pasur parasysh natyrën e masave të sigurimit del se ato përgjithësisht detyrojnë kundërshtarin e sigurimit në ndërmarrjen e një veprimi të caktuar, apo në moskryerjen e një veprimi të caktuar në lidhje me sendin e caktuar.

Në rast të shkaktimit të dëmit për shkak të mos respektimit të masës së sigurimit, propozuesi i sigurimit ka të drejtë që në bazë të rregullave të parapara me Ligjin mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), të kërkojë kompensimin e dëmit të thjeshtë, si dhe kompensimin e fitimit të humbur. Në fakt kundërshtari i sigurimit fillimisht do të obligohet që ta rivendos gjendjen e mëparshme e cila ka ekzistuar para se të shkaktohej dëmi, e në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, atëherë për pjesën tjetër të dëmit mund të kërkohej një kompensim në të holla.

⁴⁵²Neni 316 i LPK-së

⁴⁵³Neni 318 i LPK-së

Kompensimi i tërësishëm në të holla do të vihej në shprehje edhe në rastet kur nuk është e mundshme që të kthehet gjendja e mëparshme, apo kur gjykata konsideron se rikthimi në gjendjen e mëparshme nuk është i domosdoshëm⁴⁵⁴.

Me dispozitat ligjore të LPK-së, është garantuar e drejta e kompensimit të dëmit edhe për kundërshtarit e masës së sigurimit për dëmin i cili i është shkaktuar atij si rezultat i zbatimit të masës së sigurimit e cila ka qenë e vendosur pa bazë, apo e cila ka qenë e pajustificuar. Edhe në këtë rast parashihet se lidhur me kompensimin e dëmit do të aplikohen rregullat e përgjithshme të së drejtës pasurore, përkatësisht rregullat dhe dispozitat ligjore të parapara me LMD.

Ligji për procedurën kontestimore përcakton që pala e cila e shkel vendimin e gjykatës për masën e sigurimit me të cilën mbrohet pasuria apo të drejtat e paditësit, bartë përgjegjësi civile në rast të shkeljes, dhe nuk janë të vlefshme shitjet apo ngarkimet e pasurisë me detyrime për shkak se ato transaksione nuk mund të regjistrohen në librat publik pasi të ketë marrë formën e prerë vendimi për caktimin e masës së sigurisë (dhe të jetë regjistruar në librin përkatës publik.⁴⁵⁵

MASAT E PËRKOHSHME TË SIGURIMIT

Me dispozitat e Ligjit të procedurës kontestimore nenit 306 të LPK-së, parashihen vetëm rrethanat e caktuara të cilat mund ta determinojnë masën e përkohshme të sigurimit, pasi sipas kësaj dispozite *“me propozim të propozuesit të sigurimit të paraqitur me propozim për caktimin e masës së sigurimit gjykata mund ta caktojë masën e përkohshme të sigurimit pa njoftim dhe dëgjim paraprak të kundërshtarit të sigurimit, po që se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshëm pretendimin se masa e sigurimit është e bazuar dhe urgjente dhe se me veprim ndryshe do të humbte qëllimi i masës së sigurimit.”*.

Sipas këtij kuptimi, “masën e përkohshme” të sigurimit, e karakterizojnë tri elemente thelbësore:

- a. procedura e shpejtë;
- b. rreziku i cili paraqitet dhe
- c. shkaqet mbi të cilat ajo vendoset⁴⁵⁶.

Procedura e shpejtë për vendosje lidhur me këtë masë nën kupton ato që gjykata mund të caktojë masën e përkohshme të sigurimit pa njoftim dhe dëgjim paraprak të kundërshtarit të sigurimit.

Rreziku për vendosjen lidhur me këtë masë nënkupton atë se në rast se nuk caktohet masa e përkohshme e sigurimit, atëherë do të humbte qëllimi i saj.

⁴⁵⁴Neni 185 e tutje i LMD-së

⁴⁵⁵Neni 302 i LPK-së, përcakton në mes tjerash që, pala e cila e shkel vendimin e gjykatës për masën e sigurimit me të cilën mbrohet pasuria apo të drejtat e paditësit, bartë përgjegjësi civile në rast të shkeljes, dhe nuk janë të vlefshme shitjet apo ngarkimet e pasurisë me detyrime për shkak se ato transaksione nuk mund të regjistrohen në librat publik pasi të ketë marrë formën e prerë vendimi për caktimin e masës së sigurisë (dhe të jetë regjistruar në librin përkatës publik.

⁴⁵⁶Komentari i LPK-së, Iset Morina & Selim Nikqi, Prishtinë, 2012, faqe 540 e tutje

Ndërsa shkaqet dhe pretendimet mbi të cilat vendoset masa përkohshme e sigurimit nënkupton se ato duhet të jenë të besueshme dhe të bazuara.

Përgjithësisht lidhur me masat e përkohshme të sigurimit mund të thuhet ato mund të caktohen kur parashtruesi jep prova të besueshme se në rast se masa e përkohshme e sigurimit nuk caktohet, ai do të ketë dëme të menjëhershme dhe të riparueshme. Praktika e deritanishme në gjykatat tona, ka dëshmuar se palët kryesisht i drejtohen gjykatës me propozimin për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit duke u thirrur në arsyet e lartcekura të cilat (sipas tyre) e justifikojnë caktimin e kësaj mase.

Pasi të merret vendimi nga ana të gjykatës për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit dhe pasi që për të njëjtin vendim të njoftohet kundërshtari i sigurimit, atëherë ky i fundit, mundet që brenda afatit 3 ditor në përgjigjen e tij, t'i kontestoj shkaqet për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit. Në qoftë se kundërshtari i sigurimit në këtë rast arsyeton kundërshtimet e tij, atëherë gjykata do të jetë e detyruar që brenda 3 ditëve të ardhshme, lidhur me këtë çështje të caktoj seancë. Në rast se pas mbajtjes së kësaj seance, gjykata gjen se kundërshtimet e kundërshtarit të sigurimit (të paditurit) janë të bazuara, atëherë ajo mundet që me aktvendim të veçantë të anuloj aktvendimin e mëhershëm për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, ose që të njëjtin ta zëvendësoj me një aktvendim tjetër mbi caktimin e masës së sigurimit e në pajtim me nenin 307 të këtij ligji. Kundër këtij aktvendimi të ri për caktimin e masës së sigurimit, tani lejohet ankesa.

Nga kjo del se edhe pse me rastin e caktimit të masës së përkohshme të sigurimit, kundërshtarit të sigurimit nuk i jepet mundësia që ai të deklarohej për të njëjtën, apo ta kundërshtoj atë, ai ka të drejtë që brenda afatit 3 ditor të shpreh qëndrimet e tij në lidhje me masën e caktuar përmes një përgjigje me shkrim⁴⁵⁷.

Dallimi në mes të masës së përkohshme të sigurimit dhe masës së sigurimit

Në fakt, Ligji i Procedurës Kontestimore i ri nuk bënë ndonjë dallim esencial në mes të masave të sigurimit dhe masave të përkohshme të sigurimit, por me dispozitat e nenit 306 të LPK-së parashihen vetëm rrethanat e caktuara të cilat mund ta determinojnë nevojën e caktimit të masës së përkohshme të sigurimit. Sipas këtij kuptimi, masën e përkohshme të sigurimit, e karakterizon nevoja e veprimit urgjent dhe atë propozimin e propozuesit me propozim për caktimin e masës së sigurimit gjykata mund ta caktojë masën e përkohshme të sigurimit pa njoftim dhe dëgjim paraprak të kundërshtarit të sigurimit, po që se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshëm pretendimin se masa e sigurimit është e bazuar dhe urgjente dhe se me veprim ndryshe do të humbte qëllimi i masës së sigurimit.

Në praktikën e gjykatave tona zakonisht kemi propozim për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, ndonëse realisht propozimi duhet të jetë për masë të sigurimit me propozim për nxjerrjen e masës së përkohshme, në të shumtën e rasteve edhe pas vendosjes për masën e përkohshme të sigurimit dhe veprimit të gjykatës konform 306 dhe 307 të LPK-së, nuk ndryshohet kërkesa dhe

⁴⁵⁷Neni 306 i LPK-së

mbetet me propozim të njëjtë për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë, ndonëse gjykata me rastin e mbajtjes së seancës sipas nenit 306 par 2, të LPK-së, nuk mund të vendosë për propozimin për masën e përkohshme të sigurimit, por për masën e sigurimit. Në praktikë gjykatat edhe pas mbajtës së seancës prap vendosin lidhur me masën e përkohshme të sigurimit, që në kuptim të dispozitave të LPK-së, konsiderohet se kanë vendosur për masën e sigurimit.

LPK nuk e parashih mundsinë e caktimit të masës së përkohshme të sigurisë, para se të jetë ngritur padia. Sipas dispozitave të neneve 296, 304 dhe 308 të LPK-së, parashihet mundsia e caktimit vetëm të masës së sigurisë, e jo edhe të masës së përkohshme të sigurimit. Kjo ngase në rast të ekzistimit të ndonjë propozimi për caktimin e masës së sigurisë para se të jetë ngritur padia, para se të vendos për të gjykata do të mbajë një seancë dëgjimore të palëve, në të cilën ata do t'i shprehin qëndrimet e tyre. E meqenëse në rastet e propozimit eventual për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë, para se të jetë ngritur padia, gjykata do të duhej të vendos fare pa u dëgjuar palët dhe pa pasur asnjë provë – shkresë të lëndës, del se me LPK, në mënyrë të drejtë është rregulluar kjo çështje.

Dallimi tjetër është sa i përket mjeteve juridike. Kundër aktvendimit të shkallës së parë me të cilin vendoset sa i përket propozimit për caktimin e masës së sigurimit mund të paraqitet ankesa brenda afatit 7 ditor nga dita e dorëzimit të tij. Gjithsesi ankesa duhet t'i dërgohet edhe kundërshtarit të sigurimit, i cili brenda afatit prej tri ditësh nga dorëzimi, ka të drejtë që të paraqes përgjigjen në ankesë. Mbi ankesën vendos gjykata e shkallës së dytë, brenda afatit prej 15 ditëve nga dita në të cilën gjykatës së shkallës së dytë i arrin përgjigjja në ankesë, apo skadimit të afatit për paraqitjen e saj. Po ashtu duhet të ceket se ankesa me këtë rast nuk e shtynë përmbarimin e aktvendimit për caktimin e masës së sigurisë⁴⁵⁸.

Kundër aktvendimit mbi caktimin e masës së përkohshme të sigurimit nuk është e lejuar ankesa. Vlen të ceket se dispozita e nenit 310.5 të LPK-së, lë vend për interpretim të ndryshëm, ngase nëse ankesa në këtë rast nuk do të lejohej në asnjë mënyrë, mund të vij deri te cenimi i parimit të dëgjimit të palës dhe cenimi i parimit të kontradiktoritetit, ndërsa që gjithashtu mund të shkelet edhe neni 206.2 i LPK-së, i cili parashih se po që se me ligj parashihet shprehimisht se ankimi i veçantë nuk lejohet, aktvendimi i shkallës së parë mund të goditet vetëm me anë të ankesës që paraqitet kundër vendimit me të cilin përfundon procedura në gjykatën e shkallës së parë⁴⁵⁹.

GARANÇIONI ME RASTIN E CAKTIMIT TË MASËS SË SIGURIMIT TË KËRKESËPADISË

Me dispozitat e Ligjit të Procedurës Kontestimore neni 297 par.2, është përcaktuar se “Po që se nuk është përcaktuar ndryshe me ligj, gjykata e cakton masën e sigurimit vetëm nën kushtet që propozuesi i sigurimit, brenda afatit të caktuar nga gjykata, ashtu siç parashihet me Ligjin mbi

⁴⁵⁸Neni 310 i LPK-së

⁴⁵⁹Neni 206 i LPK-së

Procedurën Përmbartimore, jep garanci në masën dhe në llojin e caktuar nga gjykata, për dëmin që mund t'i shkaktohet palës kundërshtare me caktimin dhe ekzekutimin e masës së sigurimit. Në këto raste garancioni paguhet në para të gatshme, por gjykata në pajtim me dispozitat e LPP-së mund të lejojë që dhënia e garancionit të bëhet në formë të: letrave me vlerë, sende të çmueshme, apo edhe garancitë bankare. Në garancionin e deponuar në këtë mënyrë pala kundërshtare e fiton të drejtën e pengut ligjor ⁴⁶⁰.

Sidoqoftë me dispozita ligjore është e paraparë se me kërkesën e propozuesit gjykata mund ta lirojë atë nga detyrimi i dhënies së garancisë, po që se konstatohet se ai nuk ka mundsi financiare për një gjë të tillë. Për tu liruar nga pagesa e garancionit propozuesi masës së sigurimit duhet ta dëshmojë pamundsinë e pagesës, përmes dëshmimeve përkatëse (certifikatës mbi kohën e papunësisë, certifikatës mbi të drejtën e shfrytëzimit të ndihmës sociale, etj), i'a argumenton gjykatës gjendjen e tij të rënduar financiare, përkatësisht pamundsinë e pagesës së garancionit të kërkuar.

Po që se propozuesi nuk e paguan garancionin në masën dhe afatin e caktuar nga gjykata, kjo e fundit do ta refuzojë propozimin për caktimin e masës së propozuar të sigurimit ⁴⁶¹. Ngjashëm do të veprohet edhe në rastet kur gjykata fillimisht e ka caktuar masën e përkohshme, e pastaj duke vepruar sipas kundërshtimit të paditurit – kundërshtarit të masës së propozuar ndaj aktvendimit për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, e cakton seancën dëgjimore për caktimin e tani masës së sigurisë, poqë se paditësi – propozuesi i masës së sigurisë, sipas urdhrit të gjykatës, nuk e deponon shumën e garancionit përkatës për tani masën e sigurisë. Bashkësitë e pushtetit lokal, respektivisht të gjithë personat juridik të së drejtës publike janë të përjashtuara nga detyrimi i pagesës së garancionit. Një gjë e tillë është e paraparë edhe me dispozitat e LPP-së ri ⁴⁶².

Shuma e të hollave e paguar në emër të garancisë sipas nenit 297 të LPK-së, i kthehet personit që e ka paguar brenda afatit 7 ditor nga dita në të cilën shuhet masa e sigurimit. Nëse në ndërkohë propozuesi i sigurimit parashtrohet padi ndaj të paditurit edhe për kompensimin e dëmit, gjykata kompetente për gjykimin sipas padisë do të vendos për lënien në fuqi të masës përkatëse të sigurimit ⁴⁶³.

Me rastin e caktimit të garancionit dhe kthimit të tij aplikohen përshtatshëm dispoziat e ligjit të procedurës për

⁴⁶⁰Neni 14 i LPP-së të ri.

⁴⁶¹Neni 297.3 i LPK-së

⁴⁶²Neni 297.4 i LPK-së, dhe neni 14.2 i LPP të ri.

⁴⁶³Neni 298 të LPK-së.

PËRFUNDIMI I PROCEDURËS KONTESTIMORE

Aktgjykimi

Me aktgjykim gjykata vendos për themelësinë e kërkesëpadisë e cila është objekt i gjykimit. Me rastin e vendosjes për çështjen kryesore gjykata është e lidhur më kërkesën e palëve. Ajo nuk mund të vendos për asgjë tjetër, përveç për atë që ka kërkuar pala. Gjykata me rastin e vendosjes meritore ka për detyrë që të vendos për të gjitha kërkesat në mënyrë të plotë.

Përmbajta e aktgjykimit

Aktgjykimi duhet të përmbajë pjesën formale dhe materiale. Përmbajtjen formale e përbëjnë pjesët e aktgjykimit, ndërsa përmbajtjen materiale e përbën PËRMBAJTJA e vendimit me të cilin pranohet apo refuzohet aktgjykimi.

Përmbajtja formale e aktgjykimit:

Pjesa Hyrëse

Sipas nenit 160.2 të LPK-së, pjesa hyrëse e aktgjykimit përmban këto dhjetë (10) lloje të informacioneve:

- emrin e gjykatës,
- emrin dhe mbiemrin e gjyqtarit,
- emrin dhe mbiemrin, vendbanimin, gjegjësisht vendqëndrimin e palëve,
- identifikimin e përfaqësuesve ligjorë dhe me prokurë të palëve,
- përshkrimin e shkurtër të objektit të kontestit dhe vlerën e tij,
- ditën e përfundimit të shqyrtimit kryesor,
- përshkrimin e versionit të palëve lidhur me kontestin dhe të përfaqësuesve të tyre ligjorë dhe me prokurë që kanë qenë të pranishëm në seancën për shqyrtim,
- ditën kur është dhënë aktgjykimi.

Gjykata Themelore e [...]

Numri i lëndës: [...]

Data: [...]

Gjykata Themelore e [...] [Emri / mbiemri i gjyqtarit]

[Emri / mbiemri i palëve dhe vendbanimi apo vendqëndrimi i palëve]

[Emri / Mbiemri i përfaqësuesve ligjorë dhe të autorizuar të palëve që janë të pranishëm në shqyrtim gjyqësor]

[Përshkrimi i objektit të kontestit dhe vlerës së kërkesës]

[Dita e shqyrtimit kryesor]

[Përshkrimin e versionit të palëve lidhur me kontestin dhe të përfaqësuesve të tyre ligjorë dhe me prokurë që kanë qenë të pranishëm në seancën për shqyrtim]
[Kohën dhe datën kur është dhënë aktgjykimi]

Dispozitivi

Sipas nenit 160.3 të LPK-së, dispozitivi i aktgjykimit përmban:

- vendimin me të cilin aprovohen apo refuzohen kërkesat e veçanta që kanë të bëjnë me çështjen kryesore dhe kërkesat aksesore,
- vendimin për ekzistimin apo mosekzistimin e kërkesës së parashtruar me qëllim kompensimi të saj me kërkesëpadinë,
- vendimin mbi shpenzimet procedurale.

Pjesa e arsytimit

Në pajtim me nenin 160.4 të LPK-së, në pjesën e arsytimit të aktgjykimit, gjykata duhet të përfshijë rezultatet e veprimeve të mëposhtme:

- Kërkesat e palëve;
- Faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar palët;
- Specifikimi se cilat nga faktet e tilla janë vërtetuar, dhe arsyet përse janë vërtetuar ato fakte;
- Përshkrimin se si janë vërtetuar ato fakte;
- Nëse faktet janë vërtetuar me anë të provave, duhet të saktësohet se cilat prova i ka shfrytëzuar gjykata dhe si i ka vlerësuar ato;
- Kualifikimin juridik të veprës dhe dispozitat e së drejtës materiale të cilat janë zbatuar në nxjerrjen e aktgjykimit;
- Pretendimet e palëve lidhur me bazën juridike të kontestit, si dhe propozimet dhe kundërshtimet e tyre për të cilat gjykata nuk ka arsyetuar vendimet e nxjerra më parë në procedurë.

Udhëzimi mbi të drejtën në ankesë

Sipas nenit 160.1 të LPK-së, aktgjykimi duhet të përmbajë udhëzimin mbi të drejtën në ankesë.

Nënshkrimi

Neni 159 i Ligjit për Procedurën Kontestimore përcakton që aktgjykimin burimor e nënshkruan gjyqtari.

Disa udhëzime rreth arsytimit të aktgjyimit

Përmbajtjen materiale të aktgjyimit e përbëjnë pjesët përbërëse të aktgjyimit të përpiluar me shkrim. Përmbajtjen materiale e përbën përmbajtja e vendimit me të cilin pranohet apo refuzohet kërkesëpadia.

Çdo gjyqtar duhet të ketë pikësynim që me rastin e vendosjes në një çështje juridike civile përveç se të vendos drejtë dhe ligjshëm vendimi i gjykatës të jetë edhe bindës. Komponent e padiskutueshme për të krijuar besueshmëri në objektivitetin e gjykatës dhe ligjshmërinë e vendimeve të gjykatës është arsytimi i aktgjyimit. Përmes arsytimit të aktgjyimit duhet të prezantohet në mënyrë të besueshme një pamje e gjithë procesit gjyqësor duke përfshirë edhe konkludimet e gjykatës.

LPK, me dispozitën e nenit 160 paragrafi 4, përcakton se: *“Arsyetimi i aktgjyimit përmban: kërkesat e palëve, faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar, cilat nga faktet e tilla i ka vërtetuar, pse dhe si i ka vërtetuar ato fakte, e po që se i ka vërtetuar me anë të provave, cilat prova i ka shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar ato”*, ndërsa në paragrafin 5 të nenit të njëjtë përcaktohet se:

“Gjykata posaçërisht tregon se cilat dispozita të së drejtës materiale i ka zbatuar me rastin e vendosjes mbi kërkesat e palëve. Kur është nevoja gjykata deklarohet edhe lidhur me qëndrimet e palëve për bazën juridike të kontestit, si dhe për propozimet dhe prapësimet e tyre, për të cilat gjykata nuk ka bërë arsytime të vendimeve që i ka dhënë më herët gjatë procesit gjyqësor”.

Referuar dispozitës së cituar për arsytimin e aktgjyimit mund të konkludojmë se ligjdhënësi përveç strukturës së aktgjyimit apo pjesës formale ka përcaktuar edhe kornizat e përmbajtjes së aktgjyimit veçanërisht të arsytimit të aktgjyimit.

Përmes përmbajtjes së përcaktuar janë saktësuar hapa që duhet të ndjekë gjykata gjatë arsytimit të aktgjyimit në mënyrë që të sigurohemi se përmes aktgjyimit përveç se do të vendoset drejtë dhe ligjshëm një çështje kontestuese të sigurohet edhe besimi se gjykata ka vendosur drejtë dhe ligjshëm.

Hapat që duhet ndjekur gjatë arsytimit të aktgjyimit janë të renditura sipas një kronologjie logjike dhe juridike në mënyrë që përmes arsytimit të prezantohet figura e plotë e çështjes kontestuese dhe vlerësimet respektivisht përfundimi i gjykatës.

Praktika gjyqësore është e prerë sa i përket arsyetimit të aktgjykimit respektivisht përmbajtjes që duhet të ketë arsyetimi i aktgjykimit sipas dispozitave të cituara nga neni 160 paragrafi 4 dhe 5 i LPK-së.

Dispozita e LPK-së, për përmbajtje e arsyetimit të aktgjykimit në fakt vendosin kornizat respektivisht hapa që duhet ndjekur gjatë arsyetimit të aktgjykimit, mirëpo është po ashtu me rëndësi të merret në konsideratë fakti se arsyetimi i aktgjykimit diktohet në një farë mase edhe nga kërkesat dhe pretendimet e palëve ndërgjyqësore. Prandaj gjykata në arsyetimin e aktgjykimit përveç se duhet të ndjekë secilin hap në procesin e arsyetimit ajo duhet të jep arsyetimin e saj edhe duke u fokusuar në kërkesat respektivisht pretendimet e palëve ndërgjyqësore.

Hapi i parë me të cilin tregohet objektiviteti i gjykatës lidhur me vendosjen e çështjes kontestuese në një farë mënyre është paraqitja e kërkesave të palëve. Në pjesën e arsyetimit të aktgjykimit që i referohet paraqitjes së kërkesave të palëve gjykata duhet të paraqesë në mënyrë objektive kërkesat e palëve, realisht secilën kërkesë dhe secilin pretendim, sepse nga kërkesat dhe pretendimet e palëve ndërgjyqësore rrjedh pastaj edhe epilogu i arsyetimit të aktgjykimit.⁴⁶⁴

Paraqitja e fakteve dhe provave që i kanë propozuar palët: në arsyetimin e aktgjykimit i referohet fakteve që palët i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar palët për vërtetimin e fakteve të propozuara.

Me dispozitën e nenit 7 paragrafi 1, i LPK-së, është përcaktuar se: “ *Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla*”, ndërsa me dispozitën e nenit 319 paragrafi 1, të LPK-së, është përcaktuar se: “*Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazonkërkimet dhe pretendimet e veta*”. Nga këto dy dispozita rrjedh se në sistemin tonë të procedurës kontestimore dominon sistemi i bazuar në parimin e shqyrtimit sepse palëve u takon e drejta ekskluzive që të parashtrojnë faktet të cilat gjykata do ti merr për në themel të vendimit të saj.⁴⁶⁵

Ky hap i arsyetimit të aktgjykimit është tejet me rëndësi sepse mbi bazën e fakteve dhe provave të paraqitura nga palët ndërgjyqësore gjykata do të jep edhe vlerësimin për themelësinë e kërkesëpadisë. Është po ashtu me rëndësi paraqitja e besueshme e fakteve dhe provave të propozuara nga palët ndërgjyqësore sepse nëse gjykata nuk i përshkruan të gjitha faktet e

⁴⁶⁴ Bashkim Hyseni, Albert Zogaj & Fejzullah Hasani, *Doracaku i Gjyqtarëve për Shkrimin dhe Arsyetimin Ligjor*, Prishtinë 2017, fq 126.

⁴⁶⁵ Siç vërehet nga dispozita e cituar lidhur me paraqitjen e fakteve të çështjes mund të konkludojmë se parimisht vlen parimi i shqyrtimit që nënkupton se përgjegjësia për prezantimin e fakteve u takon palëve, ndërsa si përjashtim gjykatës i është dhënë mundsi e konstatimit të fakteve nëse palët provojnë të disponojnë me kërkesa që nuk mund të disponojnë. Ndryshe qëndron situata sa i përket marrjes së provave për vërtetimin e fakteve sepse edhe marrja e provave do të duhet me qenë analoge me mënyrën e paraqitjes së fakteve, por ligjdhënësi ka bërë një përjashtim të dispozitave të nenit 356 kur ka përcaktuar marrjen e provës me ekspertizë edhe ex officio, pa e kufizuar marrjen e kësaj prove vetëm për vërtetimin e fakteve që kanë të bëjnë me kërkesat e padisponueshme.

paraqitura nga palët ka gjasa që aktgjykimi të jetë i përfshirë në kontradikcion të fshehtë, çka ndikon drejtpërdrejt në ligjshmërinë e aktgjykimit.

Paraqitja e fakteve me korrektësi nga ana e gjykatës në këtë pjesë të arsytimit të aktgjykimit pikërisht ashtu siç palët i kanë parashtruar jep një mundsi që lehtësisht të vlerësohet ligjshmëria dhe besueshmëria e aktgjykimit. Kjo për faktin se mbi bazën e fakteve dhe provave të paraqitura nga palët do të pasojnë hapat tjerë të vërtetimit të fakteve vendimtare dhe pastaj të kualifikimit të fakteve vendimtare në raport me normat materialo-juridike të cilat japin e përfundimin për themelësinë e kërkesëpadisë.

Specifikimi se cilat nga faktet e tilla janë vërtetuar, dhe arsyet përse janë vërtetuar ato fakte:

Ka një diferencë në mes të fakteve të paraqitura respektivisht të propozuara nga palët ndërgjyqësore dhe fakteve të vërtetuara, sepse është në diskrecionin e gjykatës të vendos se cilat nga faktet e propozuara kanë peshën e *“fakteve vendimtare”* e të cilat duhet të vërtetohen.

Gjatë shqyrtimit gjykata varësisht nga vlerësimi i saj bënë një lloj *“klasifikimi”* të fakteve në mes të atyre që kanë rëndësi për tu provuar dhe atyre jo vendimtare.⁴⁶⁶

Në këtë hap të arsytimit të aktgjykimit gjykata specifikon se cilat fakte janë vërtetuar dhe rrjedhimisht jep arsytimin se përse janë vërtetuar ato fakte. Sigurisht për të vlerësuar se cilat fakte duhet të vërtetohen gjykata mbështetet në disa rrethana që kanë të bëjnë me natyrën e çështjes kontestuese, bazës juridike të cilës i është referuar pala, rrethanave kontestuese, etj.⁴⁶⁷

⁴⁶⁶ Bashkim Hyseni, Albert Zogaj & Fejzullah Hasani, *Doracaku i Gjyqtarëve për Shkrimin dhe Arsyetimin Ligjor*, Prishtinë 2017, fq 84 dhe 128.

⁴⁶⁷ Objekt i të provuarit mund të jetë një fakt ose tërësia e fakteve juridike që janë vendimtare për pranimin e padisë, të prapësimeve ose të kundërpadisë dhe për zgjidhjen e çështjes nga gjykata. Objekti i të provuarit nuk është çdo fakt që pretendohet nga palët, por vetëm ato fakte juridike që janë të rëndësishme për zgjidhjen e çështjes nga gjykata. Sipas dispozitës së nenit 319.2 të LPK, duhet të provohen të gjitha faktet të cilat janë të rëndësishme për dhënien e vendimit. Është detyrë e gjyqtarit apo e trupit gjykues që nga një numër i madh i fakteve, të cilat i kanë theksuar palët, t'i ndaj ato të cilat janë të rëndësishme për të vendosur lidhur me çështjen juridike kontestimore. Nga faktet relevante, për të cilat ligji e lidhë pasojën juridike, objekt i të provuarit bëhen vetëm ato që janë kontestuese midis palëve. Gjykata është ajo që vendos se cilat fakte duhet provuar dhe cilat prova do merren për vërtetimin e tyre. Kjo i jep mundsinë gjykatës që sipas bindjes së lirë ta caktojë rrethin e fakteve juridike të cilat i konsideron të rëndësishme për marrjen e vendimit dhe të përqendrohet në provimin e tyre. Sipas kësaj gjykata ka mundsi që mos t'i merrë për bazë faktet që nuk kanë ndonjë rëndësi për çështjen dhe me atë rast t'i refuzojë propozimet e palëve me të cilat kërkojnë vërtetimin e këtyre fakteve. Ekzistojnë raste kur objekt i të provuarit nuk janë drejtpërdrejt faktet, por janë pretendimet e palëve për ekzistimin apo mosekzistimin e fakteve juridike, nga të cilat varet zbatimi i normave të së drejtës materiale në procesin kontestimor gjyqësor. Ky është quajtur fakt negativ. Vërtetimi i vërtetësisë së pretendimit mohues negativ, mund të bëhet vetëm në mënyrë të tërthortë, me anë të konstatimit të ekzistimit të faktit që e përjashton ekzistimin e përnjëhershëm të faktit të kontestuar.

Pra duke i pasur parasysh të gjitha këto rrethana gjykata gjatë gjykimit ka vlerësuar se cilat fakte duhet të provohen dhe ato fakte i paraqet në arsytimin e vendimit. Natyrisht gjykata duhet të ketë edhe një arsytim të veçantë pse disa fakte të paraqitura nga palët ka refuzuar ti provoj.

Përshkrimin se si janë vërtetuar ato fakte, nëse faktet janë vërtetuar me anë të provave, duhet të saktësohet se cilat prova i ka shfrytëzuar gjykata dhe si i ka vlerësuar ato

Edhe pse në disa raste e përbëjnë thelbin e padisë, të kundërpadisë apo të prapësimeve, disa fakte nuk ka nevojë të provohen, dhe atë: *Faktet e ditura botërisht dhe ato të vërtetuara nga gjykata në gjykimin e mëhershëm, Faktet e pranuar (pohuara) dhe Faktet e prezumuara me ligj.*

Faktet e njohura botërisht nuk kanë nevojë të provohen, për shkak se ato njihen prej një rrethi të gjerë personash.

Pohimi i fakteve është veprim procedural i njëanshëm me të cilin pala deklaron se janë të vërteta për disa apo tërë faktet në të cilat kundërshtari i saj e bazon kërkesën e tij. Sipas nenit 321 paragrafi 2 të LPK nuk duhet të provohen faktet të cilat i ka pranuar pala para gjykatës gjatë procesit gjyqësor. Motivi i pranimit të fakteve zakonisht është relevant dhe gjykata nuk është e detyruar ta vërtetojë saktësinë e atij fakti, përveç në rastet kur bindet se pranimi i fakteve bëhet me qëllim të disponimit të palejueshëm – zbatimi i nenit 3 paragrafi 3 të LPK. Në këtë rast gjykata vërtetësinë e tyre e bënë me mjetet provuese që i ka në dispozicion.⁴⁶⁸

Objekt i të provuarit nuk mund të jetë as fakti, ekzistimin e të cilit ligji e prezumon. Prezumimi ligjor i fakteve përfaqëson rregullin sipas të cilit gjykata është e detyruar që ta marrë si ekzistues një fakt (fakt i prezumuar) nëse vërtetohet se ekziston një fakt tjetër i përcaktuar nga ligji. Ekzistojnë ligje përkatëse që përmbajnë dispozita për faktet e prezumuara. *P.sh., Ligji për Familjen (neni 99)* prezumon se at i fëmijës është personi i cili është në martesë me nënën e fëmijës 300 ditë para lindjes së fëmijës.

Në faktet e prezumuara nga ligji barra e të provuarit bien në palën e cila e konteston ekzistimin e fakteve të tilla.

Marrja e provave është veprim procedural i gjykatës me anën e të cilit ajo merr dijeni për bazat e të provuarit nga mjetet provuese. Gjykata cakton rrethin e fakteve që duhet të provohen, lloji i provave që do të lejohen për vërtetimin e tyre, caktohet mënyra, koha dhe vendin e marrjes së provave.

Vërtetimin e fakteve kontestuese gjykata e bënë përmes mjeteve provuese. Mjet provues (provë) quhet çdo burim nga i cili me anë të organeve të shqisave nxjerrim njohuri për vërtetësinë e thënies se ekziston apo nuk ekziston një fakt për të cilin lidhet pasoja e caktuar juridike.

Mjetet provuese janë të parashikuara në dispozita të veçanta të LPK sipas llojit të tyre. Këto mjete janë: Këqyrja në vend, shkresat, dëshmitarët, ekspertët dhe dëgjimi i palëve. Siç shihet lloji i provave varet nga lloji i burimeve të parashikuar në ligj.

Varësisht nga mënyra se si janë vërtetuar faktet do të jetë edhe arsyetimi i aktgjykimit. Posaçërisht të faktet kontestuese të cilat rëndom vërtetohen përmes mjeteve provuese gjykata duhet të ketë një arsyetim të zgjeruar dhe atë duke arsyetuar specifikisht secilin fakt kontestues dhe provën e admistruar me të cilin është vërtetuar secili fakt. Gjykata në këtë hap të arsyetimit duhet të ketë

⁴⁶⁸ Bashkim Hyseni, Albert Zogaj & Fejzullah Hasani, *Doracaku i Gjyqtarëve për Shkrimin dhe Arsyetimin Ligjor*, Prishtinë 2017, fq 129.

edhe një vlerësim/arsyetim për vlerën provuese/fuqinë provuese të secilës provë të administruar dhe rrjedhimisht besueshmërinë e saj.

Sistemi i jonë i procedurës kontestimore i përket sistemeve që çmuarjen e provave e bënë në bazë bindjes se lirë. Në sistemin e vlerësimit lirisht të provave nuk parashikohen rregulla procedurale për zgjedhjen, shfrytëzimin dhe fuqinë provuese të mjeteve provuese. Gjykata, sipas këtij sistemi, nuk është e lidhur e as e kufizuar me rregulla të posaçme formale për të provuarit. Pretendimin e caktuar gjykata e merr si të provuar vetëm pasi të jetë bindur në saktësinë e tij (në bazë të provave të shfrytëzuara dhe të vlerësuara).

Gjykata është e lirë të vlerësojë rezultatin e hetimit gjyqësor dhe të vendos për themelin e çështjes. Vlerësimi i lirë i provave nga gjykata, kërkon një kujdes të veçantë në respektimin e rregullave dhe kufijve të caktuar për këtë qëllim, si dhe përdorimi me efektivitet i eksperiencës. Gjykatësi duhet të ruhet nga ajo që quhet interpretim personal i tij, në drejtim të vlerësimit subjektiv e të njëanshëm të provave dhe të pranimi të konkluzioneve të nxjerra nën influencën e të dhënave të marra privatisht prej tij ose të ofruara nga palët, e që nuk i janë nënshtruar debatit gjyqësor. Del e domosdoshme formimi i një disipline të fortë juridike në vlerësimin e provave, ku si çështje bazë duhet të jetë formimi dhe konsolidimi i provës në procesin e përpjekjes së dy të kundërtave. Çdo cenim i këtyre rregullave të shpie në varfërimin e vlerës ligjore të gjykimit.

Përshkrimet e dëshmive duhet të jenë të arsyetuara dhe të strukturuar në mënyrë që të tregojnë se gjykata i konsideron ato bindëse, bashkë me arsyet për një përfundim të tillë. Për shembull, kur gjykata të konstatojë se pretendimi i një pale nuk është i pranueshëm, ajo duhet të arsyetojë vendimin duke cituar dëshmi konkrete, duke paraqitur referenca për kundërthëniet në mes të dëshmitarëve dhe dëshmitë e tjera materiale të cilat kanë çuar gjykatën deri te një përfundim i caktuar. Në këtë mënyrë, gjykata po ashtu bënë një vlerësim të dëshmive të pranuar. Gjykata po ashtu, në mënyrë të veçantë do të vlerësojë besueshmërinë e dëshmive kundërthënëse, arsyet për mosaprovimin e kërkesave individuale të palëve dhe arsyet me të cilat është udhëhequr gjykata në përcaktimin e pikave të ligjit e veçanërisht, në përcaktimin se a ekziston detyrimi ligjor.

Gjykata nuk do të krijojë besimin thjeshtë duke përshkruar arsyetimin e saj për pranimin e dëshmive ose argumenteve pa sqaruar se pse dëshmitë ose argumentet kundërthënëse nuk kanë qenë bindëse. Arsyetimi i vendimit duhet të pasqyrojë në mënyrë të qartë paanshmërinë e gjykatës kur ajo sjellë përfundimet e veta. Një prej standardeve të procesit racional ligjor përfshinë respektimin e parimit të barazisë që aplikohet për të dy palët në një kontest. Rrjedhimisht, ky standard është i lidhur ngushtë me paanshmërinë dhe objektivitetin e gjykatës, dhe duhet të pasqyrohet jo vetëm në procedurat gjyqësore por edhe në arsyetimin e vendimit përfundimtar të gjykatës.⁴⁶⁹

Dispozitat e së drejtës materiale të cilat janë zbatuar në nxjerrjen e aktgjykimit: Në pjesën e analizës për përfundimin e gjykatës lidhur me themelin e kërkesëpadisë përveç hapave tjerë ta arsyetimit të përshkruar më lartë, pjesa e përshkrimit të dispozitave materialo-juridike për rastin konkret është tejet e rëndësishme sepse përmes zbatimit të normës materiale do të përcaktohet nëse

⁴⁶⁹ Po aty, fq. 131.

rrethanat faktike të çështjes kontestuese konsumojnë elementet e normës juridike për mbrojtjen gjyqësore të kërkuar.

Praktika gjyqësore është mjaft rigoroze në këtë pikë dhe realisht e konsideron si pjesë qenësore të arsyetimit të aktgjykimit referencën e gjykatës në normën materialo-juridike, në të kundërt aktgjykimit do ta kualifikojë në shkelje për të cilat çështja kthehet në rishqyrtim.

Është e domosdoshme referenca në normën materialo-juridike sepse në këtë mënyrë tregohet burimi i së drejtës dhe rrjedhimisht se si gjendja e fakteve të çështjes konkrete ka përmbushur konditat ligjore që gjykata të vendos për mbrojtjen gjyqësore të kërkuar.

Gjykata duhet të marrë parasysh disa karakteristika të caktuara që kanë të bëjnë me llojin e kërkesës e cila po gjykohet, pastaj edhe natyrën e raportit ligjor që ka të bëjë me kontestin. Aktgjykimi duhet të jetë specifik sa i përket analizës ligjore që bëhet për normën ligjore si pjesë e të drejtës objektive në të cilën bazohet pretendimi për të drejtën subjektive të parashtruesit të kërkesës. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Argumentet dhe pjesa arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht duke respektuar rregullat dhe ligjet.

Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit i cili përjashton çdo kundërthënie apo kontradikison të hapur apo të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë të mjaftueshme për të mbështetur dispozitivin e aktgjykimit.

Aktgjykimi i shkruar duhet të citoj dhe interpretojë normat ligjore të aplikuara në zgjidhjen e kundërthënieve që janë ngritur në një rast të caktuar. Kur e bënë këtë, gjykata duhet të marrë parasysh disa karakteristika të caktuara që kanë të bëjnë me llojin e kërkesës e cila po gjykohet, e pastaj edhe natyrën e raportit ligjor që ka të bëjë me kontestin. Në këtë aspekt, aktgjykimi duhet të jetë specifik sa i përket analizës ligjore që bëhet për normën ligjore si pjesë e të drejtës objektive në të cilën bazohet pretendimi për të drejtat subjektive të parashtruesit të kërkesës. Arsyetimi i aktgjykimit lidhur me aplikimin e ndonjë norme të veçantë duhet të shërbejë si argument i fuqishëm dhe bindës se vendimi i gjykatës është i drejtë sepse do të jetë e qartë se ai është i bazuar në ligj.

Vendimi i gjykatës në çdo rast duhet të jetë logjik, me formë të duhur dhe me përmbajtje të qartë. Argumentet dhe pjesët e arsyetimit duhet të jenë të bazuara dhe të kenë lidhje logjike dhe në të njëjtën kohë të respektojnë rregullat dhe ligjet. Ato duhet të krijojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, e cila përjashton çdo mospërputhje ose kundërthënie të drejtpërdrejtë apo të nënkuptuar. Këto argumente duhet të jenë të mjaftueshme në mënyrë që të mbështesin dispozitivin e aktgjykimit të shkruar.⁴⁷⁰

Deklarimi për pretendimet e palëve lidhur me bazën juridike të kontestit, si dhe propozimet dhe kundërshtimet e tyre për të cilat gjykata nuk ka arsyetuar vendimet e nxjerra më parë në procedurë: Duhet theksuar se gjatë zhvillimit të procedurës gjykata si subjekt kryesor i procedurës e ushtron diskrecionin e saj për zhvillimin e procesit gjyqësor duke marrë një mori veprimesh

⁴⁷⁰ Po aty, fq. 132.

proceurale për të cilat nuk jep sqarime gjatë shqyrtimit, por është detyrim i gjykatës që në arsyetimin e aktgjykimit t'i arsyetojë disa nga veprimet e saj procedurale.

Sigurisht gjykata nuk do të arsyetojë çdo veprim procedural sepse vetë zhvillimi i procesit gjyqësor dhe mënyra e vendosjes me vendimin meritore e konsumon nevojën që të arsyetohet çdo veprim procedural, por sigurisht gjykata duhet të arsyetojë ato veprime procedurale në frymën e përfundimit të saj meritore për çështjen.

Aktgjykimi duhet të përshkruajë veprimet procedurale të ndërmarra gjatë gjykimit, qëndrimet dhe vendimet procedurale lidhur me çështjet paraprake dhe procedurale, mocionet (kërkesat) e aprovuara dhe të refuzuara të palëve, përfshirë edhe sqarimet se cilat rrethana kanë ndikuar në aprovimin apo refuzimin e kërkesave të tilla. Gjykata duhet të sqarojë rrethanat e rastit ashtu siç janë pranuar (në proces kronologjik) dhe bazuar në rrethana, gjykata duhet të sqarojë përfundimin (konkluzionin) që e ka sjellë ajo. Përveç kësaj, gjykata duhet të demonstroj saktësinë faktike me referenca në dëshmitë që ajo i ka pranuar gjatë gjykimit. Gjatë tërë kohës gjykata duhet të shmangë arsyetimin jo të plotë dhe të pabazuar.

Për shembull, duhet të shmangen deklaratat si më poshtë: *“nga ajo që u tha më lartë rezulton se..., pastaj bazuar në deklaratat e dëshmitarëve..., pa sqaruar, analizuar dhe dëshmuar saktësinë e deklaratave...,”* e kështu me radhë).

Argumentet dhe pjesa arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht duke respektuar rregullat dhe ligjet. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit i cili përjashton çdo kundërthënie apo kontradikison të hapur apo të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë të mjaftueshme për të mbështetur dispozitivin e aktgjykimit.

Procesi gjyqësor i hartimit të aktgjykimit

Në përgjithësi dhe si koncept, Ligji për Procedurën Kontestimore e përcakton se hapi i fundit drejt zgjidhjes së një kontesti pronësor juridik, është dhënia e aktgjykimit me shkrim i cili e aprovon apo e refuzon kërkesëpadinë e paditësit, dhe vendos mbi kërkesën e personit të tretë,⁴⁷¹ kërkesën e bashkëpaditësit apo bashkë të paditurit⁴⁷² dhe vendosë mbi kundërpadinë.⁴⁷³

⁴⁷¹ Për shembull, shih nenin 275.1 i LPK-së, që përcakton ndërrimin e të paditurit me paraardhësin juridik në padi; nenin 275.2 i LPK-së, që përcakton pëlqimin e paditësit për ndërrimin e palëve në rrethana të caktuara; nenin 275.3 i LPK-së, që përcakton që i padituri duhet të vazhdojë procedurën në rastet kur “paraardhësi juridik” nuk e jep pëlqimin që të hyjë në kontest. Shih gjithashtu, nenet 258 të LPK-së, (që lejon disa ndryshime në padi) dhe 260.3 të LPK-së, që përcakton se personi i tretë i ndërruar me të paditurin duhet ta pranojë procedurën në gjendjen në të cilën ndodhet në momentin kur hyn në të.

⁴⁷² Neni 408.1 i LPK-së, përcakton që, gjyqtari mund t'i bashkojë gjykimet e ndërlidhura që zhvillohen në të njëjtën gjykatë dhe të jep aktgjykim të përbashkët për to, nëse me këtë veprim do të zvogëloheshin shpenzimet dhe do të përshpejtohej shqyrtimi i çështjeve); neni 147.2 (përcakton që, gjyqtari mund ta zgjidhë cross-claim përmes aktgjykimit të pjesëshëm.

⁴⁷³ Neni 408.1 i LPK-së, përcakton që, gjyqtari mund t'i bashkojë gjykimet e ndërlidhura që zhvillohen në të njëjtën gjykatë dhe të jep aktgjykim të përbashkët për to, nëse me këtë veprim do të zvogëloheshin shpenzimet dhe do të

Nëse e përshkruajmë në mënyrë praktike, aktgjykimi meritor mbi çështjen rezulton nga bindja e lirë në prova mbi atë se kërkesëpadia e paditësit, a i përmbushë kushtet ligjore për të qenë e themeltë dhe a i mposht të gjitha pretendimet e paraqitura në përgjigjen në padi, duke shtuar si pjesë të tij edhe shpjegimin se si gjyqtari e ka zgjidhur çështjen. Me anë të aktgjykimit përmbillet kontesti gjyqësor përmes vendimit mbi atë se si janë zbatuar të drejtat ligjore të palëve karshi rrethanave të cilat janë vërtetuar me prova gjatë shqyrtimit kryesor të çështjes, si dhe jepet përgjigja ndaj kërkesës së paditësit me të cilën ai/ajo kërkon mbrojtje gjyqësore. Mirëpo, ekzistojnë disa situata në të cilat gjyqtari mund të mos e përfshijë pjesën e arsytimit të aktgjykimit, duke përfshirë rastet kur palët e pranojnë dispozitivin e aktgjykimit të shpallur gojarisht nga gjyqtari pas përfundimit të shqyrtimit kryesor (në pritje të aktgjykimit të shkruar) dhe heqin dorë nga e drejta e ankimit, dhe kur heqin dorë nga e drejta për një diapozitiv të arsytuar në aktgjykimin e shkruar.⁴⁷⁴

Natyrisht, aktgjykimi nuk është i formës së prerë përderisa nuk janë shfrytëzuar të gjitha mjetet e goditjes⁴⁷⁵ apo nuk kanë skaduar afatet për paraqitjen e tyre. Rrjedhimisht, aktgjykimi u shërben dy qëllimeve në këtë aspekt. Së pari, aktgjykimi i cili hartohet me shfrytëzimin e listës kontrolluese do të sigurojë se vendosja e çështjes nga gjyqtari dhe vendimet përkatëse kanë qenë tërësisht të bazuara në prova dhe në ligj. E dyta, një aktgjykimi hartuar me kujdes, do ta përcaktojë skenarin për fazën e shqyrtimit të lëndës në apel, ashtu që identifikimi dhe ballafaqimi i të gjitha çështjeve në kontekst të zbatimit të dispozitës ligjore dhe të fakteve, do t'i shtojë gjasat që i njëjti të vërtetohet pa shqyrtimit të tij në apel.

Ajo që është më e rëndësishme, aktgjykimi duhet të frymëzojë palët dhe shoqërinë civile që të kenë besim në rezultatin e procesit gjyqësor, për rastin konkret si dhe për sistemin gjyqësor në përgjithësi. Rrjedhimisht, është shumë e rëndësishme përmbajtja e aktgjykimit dhe mënyra se si është vërtetuar gjendja faktike. Vendimet e gjyqtarit duhet të jenë në pajtim me parimet të cilat në komunitetin ndërkombëtar për sundimin e ligjit konsiderohen si praktikat më të mira dhe janë në qendër të kodeve të etikës gjyqësore, veçanërisht të Ligjit për procedurën kontestimore:

- **Të kuptuarit e ligjit të zbatueshëm dhe parimeve përkatëse juridike**-Vendim i gjyqtarit në një lëndë duhet të reflektojë të kuptuarit e ligjit i cili do të zbatohet

përshpejtohej shqyrtimi i çështjeve; neni 256.1 i LPK-së, përcakton të drejtën e të paditurit që të paraqesë kundërpadi derisa nuk ka përfunduar seanca përgatitore (apo deri para fillimit të shqyrtimit kryesor nëse nuk është mbajtur seanca përgatitore)) nëse i padituri ka parashtruar (apo mëton ta paraqes) kundërpadinë ndaj paditësit; neni 256.2 i LPK-së, përcakton që, i padituri pas seancës përgatitore nuk mund të paraqesë kundërpadi ndaj paditësit, pa pëlqimin e tij); neni 256.3 i LPK-së, përcakton që, gjyqtari duhet të konstatojë nëse për procedimin e kërkesës nga kundërpadia është kompetente gjykata tjetër.

⁴⁷⁴Neni 161 (përcakton që, po që se palët pas shpalljes së aktgjykimit kanë hequr dorë nga e drejta e ankimit, si dhe kurato nuk kanë kërkuar shprehimisht që aktgjykimi, që do tu dërgohet, ta përmbajë pjesën arsytuese, gjykata nuk do ta arsyetojë posaçërisht aktgjykimin e dhënë, por vetëm do të tregojë se palët kanë hequr dorë nga ankimi dhe se nga ky shkak aktgjykimi nuk është arsytuar.).

⁴⁷⁵Nenet 166-169 i LPK-së, në esencë përcaktojnë se aktgjykimi nuk është i formës së prerë përderisa nuk janë shfrytëzuar të gjitha mjetet e goditjes.

në rastin konkret, si dhe detyrimet e gjyqtarit në kuadër të parimeve më të përgjithshme të sundimit të ligjit.

- **Vendimi i bazuar në prova**- Vendim i gjyqtarit duhet të reflektojë se zgjidhja e tij/saj mbi çështjen ka qenë e bazuar vetëm në faktet materiale dhe se ato fakte janë vërtetuar vetëm duke u bazuar në provat të cilat janë marrë gjatë shqyrtimit kryesor të çështjes apo gjatë procedimeve tjera ligjore lidhur me çështjen.
- **Përdorimi i një procesi analitik të drejtë**- Konkluzionet e gjyqtarit gjatë vendosjes së çështjes duhet të reflektojë një vendim i cili ka rezultuar nga një proces i drejtë, dhe sa ka qenë i bazuar në analizën e ligjit të zbatueshëm dhe fakteve relevante të cilat gjyqtari i ka pranuar si prova.
- **Pavarësia gjyqësore**-Vendim i gjyqtarit duhet të reflektojë se gjyqtari ka vepruar në mënyrë të pavarur dhe i lirë nga çdo ndikim i jashtëm, nxitje, kërcënim, ndërhyrje apo kritikë publike.

Vendimet gjyqësore për përputhshmërinë ligjore të kërkesave

Ligji për procedurën kontestimore përmban dispozita për zgjidhjen e drejtë dhe të kujdesshme të kontesteve civile juridike. Me ligj janë paraparë mekanizma të ndryshëm për ekzaminimin e vazhdueshëm të përputhshmërisë procedurale dhe ligjore të padive civile juridike, si dhe mekanizma për vendosjen e çështjeve me apo pa shqyrtim kryesor të çështjes, varësisht nga rrethanat e rastit. Gjyqtari duhet ta përgatisë vendimin – që mund të jetë një aktvendim i shkruar (urdhër) apo aktgjykim—⁴⁷⁶ i cili në secilin rast duhet ta arsyetojë vendosjen mbi padinë apo mbi kërkesat në padi.

Krahas aktgjykimit meritator që jepet pas shqyrtimit kryesor, me ligj është e paraparë që gjyqtarët mund të japin edhe aktvendime apo aktgjykime pa e mbajtur shqyrtimin kryesor, gjithnjë në situata të caktuara të cilat mund të rezultojnë në zgjidhjen apo hedhjen poshtë të padisë, pa paragjykim lidhur me atë se paditësi a do ta paraqes përsëri padinë e njëjtë në një fazë të mëvonshme, dhe mund të marrin vendime apo lëshojnë urdhra që ndihmojnë në menaxhimin më efikas të procedimit të lëndëve.

Shqyrtimi i afateve

Gjyqtarët shpeshherë deklarojnë se është sfiduese dhënia në kohë e aktgjykimit me shkrim. Ligji për procedurën kontestimore si parim përcakton se gjyqtarët e kanë për detyrë që procedurën me të cilën do ta zgjidhin kontestin civil, ta zhvillojnë pa vonesa të panevojshme.⁴⁷⁷ Në këtë pikë,

⁴⁷⁶Neni 143.1 i LPK-së, përcakton që, me aktgjykim gjyqtari vendos mbi kërkesën që ka të bëjë me çështjen kryesore dhe me kërkesat aksesore; neni 143.2 i LPK-së, përcakton që, në qoftëse me një padi janë përfshirë disa kërkesëpadi, gjyqtari, zakonisht vendosë për të gjitha me një aktgjykim të vetëm.

⁴⁷⁷Neni 10.1 i LPK-së, përcakton detyrimin e gjyqtarit që procedurën ta zhvillojë pa zvarritje, me sa më pak

përkundër ngarkesës së madhe me lëndë dhe diskutimeve për pajtim gjyqësor që shpesh rezultojnë të suksesshme—gjyqtarët e kanë për detyrë që aktgjykimin e shkruar ta dorëzojnë brenda 15 ditëve të punës nga dita e përfundimit të shqyrtimit kryesor. Gjyqtarët nuk mund ta zgjasin këtë afat përveç se përjashtimisht —dhe vetëm nën mbikëqyrjen e kryetari të gjykatës—dhe pas njoftimit të palëve.

Afati ligjor

Sipas ligjit, gjyqtarët kërkohet ta japin aktgjykimin e shkrim më së voni brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e përfundimit të shqyrtimit kryesor.⁴⁷⁸

Njoftimi i palëve për ditën e dhënies së aktgjykimit

Pas përfundimit të shqyrtimit kryesor, gjyqtari i njofton palët e pranishme për ditën e dhënies së aktgjykimit ose me shkrim do ta njoftojë palën që nuk ka marrë pjesë në shqyrtimin kryesor.⁴⁷⁹

Njoftimi i detyrueshëm për kalimin e afatit

Po qe se gjyqtari e kalon afatin, ai ka për detyrë që me shkrim ta njoftojë kryetarin e gjykatës për shkaqet e tejkalimit të tij.⁴⁸⁰

Njoftim i palës për shtyrjen e afatit

Kur gjyqtari nuk e arrin afatin 15 ditësh, ai/ajo do t'i njoftojë palët për shtyrjen e afatit duke zbatuar të njëjtat rregulla mbi dërgimin e shkresave.⁴⁸¹

Llogaritja e afatit për ankim kundër aktgjykimit

Nëse palëve u jepet aktgjykimi në ditën kur është nxjerrë, afati për ankim kundër aktgjykimit do të fillon të ecë ditën e nesërme pas dorëzimit të aktgjykimit.⁴⁸² Përndryshe, afati për ankim do të llogaritet nga data kur aktgjykimi i është dorëzuar palëve.⁴⁸³

shpenzime, si dhe të parandalojë çdo shpërdorim të të drejtave procedurale të palëve.

⁴⁷⁸Neni 153.1 i LPK-së, përcakton se aktgjykimin e jep gjykata brenda 15 ditëve nga dita e përfundimit të shqyrtimit kryesor.

⁴⁷⁹Neni 154.1 i LPK-së, përcakton që, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor, gjyqtari i njofton palët e pranishme për ditën e dhënies së aktgjykimit ose me shkrim do ta njoftojë palën që nuk ka marrë pjesë në shqyrtimin kryesor).

⁴⁸⁰Neni 153.2 i LPK-së, përcakton që, po qe se gjyqtari e kalon afatin, ai ka për detyrë që me shkrim ta njoftojë kryetarin e gjykatës për shkaqet e tejkalimit të tij).

⁴⁸¹Neni 157 i LPK-së, përcakton që, kur gjyqtari nuk e arrin afatin 15 ditësh, ai/ajo do t'i njoftojë palët për shtyrjen e afatit duke zbatuar të njëjtat rregulla mbi dërgimin e shkresave).

⁴⁸²Neni 154.2 i LPK-së, përcakton që, nëse palëve u jepet aktgjykimi në ditën kur është nxjerrë, afati për ankim kundër aktgjykimit do të fillon të ecë ditën e nesërme pas dorëzimit të aktgjykimit.

⁴⁸³Neni 158 i LPK-së, përcakton që, kur dërgimi i shkresës është bërë në pajtim me nenet 155, 156, apo 157, afati për ankim fillon të ecë në ditën kur palëve i është dorëzuar aktgjykimi.

Megjithatë, gjyqtarët mund të gjejnë lehtësim (dhe të shmangin kritikën) nëse ata e ndjekin strategjinë globale të vendosje së skenës për aktgjykim. Për shkak se ngarkesa me lëndë është një dukuri shqetësuese, praktikën më të mirë për gjyqtarët do të ishte që në mënyrë aktive ta menaxhojnë procedimin e lëndëve të tyre, duke mbledhur dhe organizuar informatat përgjatë rrugës, dhe këtu do të hynin:

Monitorimi i vazhdueshëm i respektimit të rregullave procedurale nga palët

Ekipit gjyqësor (i përbërë nga gjyqtari, bashkëpunëtori profesional dhe nga përfaqësuesi i Zyrës për menaxhimin e lëndëve), nën drejtimin e gjyqtarit do të duhej të monitoronte në vazhdimësi nëse palët janë duke i respektuar rregullat e procedurës, duke i mundësuar gjyqtarit të ndërmerr çfarëdo veprimi parandalues apo korigjues sipas rrethanave të rastit, duke përfshirë hedhjen poshtë të padisë apo vendosjen e saj pa procedim të mëtutjeshëm. Ky proces do të duhej të lehtësohej nga përdorimi i listave kontrolluese, modeleve dhe formave të standardizuara.

Detyrat administrative

Bashkëpunëtori profesional dhe/ose përfaqësuesi i ZML-së sipas udhëzimeve të gjyqtarit i kryejnë detyrat administrative që kanë të bëjnë me paditë, duke i mundësuar kështu gjyqtarit që të përqendrohet në kryerjen e funksionit të tij/saj gjyqësor. Ky proces do të duhej të lehtësohej nga përdorimi i listave kontrolluese, modeleve dhe formave të standardizuara—dhe do të duhej përfshirë monitorimin e afateve, respektimit të afateve, orarin e gjykimeve, dhe aktivitetet e ngjashme administrative të cilat i mbajnë lëndët brenda standardeve kohore të përcaktuara me ligj.

Monitorimi i vazhdueshëm i përputhshmërisë ligjore të kërkesave

Gjyqtari, i ndihmuar nga bashkëpunëtori profesional sa herë që është e mundur dhe e përshtatshme, vazhdimisht e monitoron përputhshmërinë ligjore të kërkesës dhe ndërmerr veprimet e duhura gjyqësore për rrethanat e rastit duke përfshirë veprimet që rezultojnë në hedhjen poshtë të padisë apo në vendosjen e çështjes pa proceduar më tutje. Ky proces do të duhej të lehtësohej nga përdorimi i listave kontrolluese, modeleve dhe formave të standardizuara.

Aktivitetet përgatitore

Gjyqtari, i ndihmuar nga bashkëpunëtori profesional, sa herë që është e mundur dhe e përshtatshme, do të angazhohet me palët (*seanca përgatitore*) për të siguruar që vetëm provat relevante të merren në shqyrtimin kryesor të çështjes, dhe që të paraqiten para afatit apo në afatin e caktuar me ligj apo të dhënë nga gjyqtari, dhe që përjashtimet ndaj rregullave ligjore apo urdhrave gjyqësor përkitazi me shqyrtimin kryesor do të lejohen vetëm në rastet e pashmangshme dhe kur janë të arsyetuara. Gjyqtarët duhet të inkurajojnë palët që kontestin e tyre ta zgjidhin me marrëveshje, veçanërisht në rastet kur gjendja faktike nuk është e kontestuar, apo kur palët duket

se kanë gjasa të arrijnë marrëveshje. Ky proces do të duhej të lehtësohej nga përdorimi i listave kontrolluese, modeleve dhe formave të standardizuara.

Aktivitetet gjyqësore përkitazi me provat

Gjyqtari, i ndihmuar nga bashkëpunëtori profesional, sa herë që është e mundur dhe e përshtatshme, duhet të përdorë një fletë pune apo ndonjë mekanizëm tjetër për të përcjellë provat e pranueshme (që zakonisht përbëjnë deklaratat e dëshmitarëve, provat fizike, dokumentacionin origjinal, mendimet e ekspertëve, dhe këqyrja në vend) gjatë ballafaqimit të provave të pranuar me elementet juridike të padisë, dhe duke treguar bazën për përjashtimin e çdo prove.

Prandaj, menaxhimi aktiv i lëndës nga gjyqtari në një mjedis ekipor, do të duhej ta vendoste gjyqtarin në një pozitë e cila do t'i mundonte hartimin me shkrim në kohë të një aktgjykimi të bazuar në prova dhe ligj dhe me përmbajtjen dhe formatin e përcaktuar me ligj.

Llojet e aktgjykimeve sipas LPK-së

Aktgjykimi i pjesshëm

Aktgjykim i pjesshëm quhet ai aktgjykim me të cilin gjykata vendos vetëm për një pjesë të kërkesëpadisë, apo për njërën nga disa kërkesat që janë objekt gjykimi. Gjykata e jep këtë aktgjykim kur pjesa e objektit të gjykimit, për shkak të pohimit ose në bazë të shqyrtimit të mjaftueshëm, njëra ose disa sosh, janë pjekur për vendim definitiv dhe meritore, gjykata mundet, në pikëpamje të kërkesave të përgatitura, përkatësisht të pjesës së kërkesës së përgatitur, ta përfundojë shqyrtimin dhe të jep aktgjykim të pjesshëm.

Raste nga praktika: Në qoftë së paditësi ka paraqitur disa kërkesa kundër të paditurit, si p.sh., dorëzimin e sendit, kompensimin e dëmit dhe kompensimin për pasurim pa bazë, nën supozimin së është përgatitur për vendosje pjesa e kërkesëpadisë që ka të bëjë me dorëzimin e sendit por jo edhe për kompensimin e dëmit dhe pasurimit pa bazë, atëherë gjykata mund të marrë aktgjykim të pjesshëm me të cilin vendos për dorëzimin e sendit tek paditësi e pastaj të vendos edhe për dy kërkesat tjera. Kjo mund të ndodhë për arsyes se në këtë rast kërkesa për kompensim dëmi dhe pasurim pa bazë mund të zgjasë për shkak të procesit kompleks të të provuarit të dëmit dhe kompensimit për pasurim pa bazë, pasi që gjykata sigurisht sipas propozimeve të palëve do të nxjerr ekspertizat përkatëse dhe provat tjera materiale për të provuar faktet e çështjes dhe vlerën e kompensimit.

Gjykata mundet të jep aktgjykim të pjesshëm edhe kur objekt i gjykimit është edhe kundërpadia, por që për vendim është përgatitur vetëm kërkesa e padisë apo e kundërpadisë.

Nuk do të lejohet aktgjykimi i pjesshëm në qoftë së në padi apo kundërpadia janë përfshirë me tepër kërkesa vendosja e të cilave nuk mund të bëhet ndaras për shkak të natyrës së raportit kontestues për themelësinë e kërkesave të tilla.

Gjykata e jep ex officio këtë aktgjykim në qoftë se një gjë të tillë e çmon si të arsyeshme. Gjykata duhet të marrë parasysh me rastin e vendosjes së pjesshme të kërkesëpadisë madhësinë e kërkesës e cila është përgatitë për vendosje⁴⁸⁴ por edhe qëllimet tjera procedurale realizimin e të cilave e mundson aktgjykimi i pjesshëm.⁴⁸⁵

Aktgjykimi i pjesshëm është aktgjykim i pavarur nga aktgjykimi definitiv për pjesën tjetër të kërkesëpadisë si në pikëpamje të mjeteve të goditjes ashtu edhe sa i përket përmbartimit të aktgjykimit.

Aktgjykimi në bazë të pohimit

Aktgjykimi në bazë të pohimit është vendimi meritor të cilin e jep gjykata në bazë të deklaratës së shprehur të palës së paditur. Me pohimin e kërkesëpadisë, si veprim procedural i njëanshëm i palës së paditur, bëhet i panevojshëm zhvillimi i mëtutjeshëm i procesit kontestimor.

LPK përcakton se në qoftë se i padituri deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor të çështjes e pohon kërkesëpadinë pjesërisht apo në tërësi, gjykata e jep, pa shqyrtim të mëtejshëm, aktgjykimin me të cilin e aprovon pjesën apo gjithë kërkesëpadinë (aktgjykimi në bazë të pohimit).

Përcaktimi ligjor se i padituri mund të pohojë kërkesëpadinë deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor nënkupton se i padituri mund ta pohojë kërkesëpadinë jashtë seancës gjyqësore por edhe në seancë gjyqësore, (shembull mund ta pohojë kërkesëpadinë me përgjigje në padi apo edhe me parashtrësë gjatë zhvillimit të shqyrtimit përgatitor dhe atij kryesor e gjithashtu edhe me pohim të drejtpërdrejtë në seancën përgatitore apo të shqyrtimit kryesor).

Zakonisht posa të kryhet veprimi procedural me të cilin pohohet kërkesëpadia, gjykata menjëherë pa e pritur propozimin e palës paditëse e jep aktgjykimin në bazë të pohimit me të cilin e pranon kërkesëpadinë si të themeltë. Pavarësisht se gjykata në rrethana normale duhet që menjëherë posa të pohohet kërkesëpadia të jep aktgjykimin në bazë të pohimit, në qoftë se kërkesa e padisë ka të bëjë me kërkesa me të cilat palët nuk mund të disponojnë lirisht (par.3 i nenit 3 të LPK-së), pavarësisht se plotësohen kushtet që gjykata të jep aktgjykim në bazë të pohimit, të njëjtin nuk do ta jap.

⁴⁸⁴Dispozita e nenit 147.3 e LPK-së.

⁴⁸⁵ Qëllimet tjera të cilat duhet t'i ketë parasysh gjykata me rastin e nxjerrjes së aktgjykimit të pjesshëm përveç madhësisë së kërkesëpadisë është edhe qëllimi i ekonomizimit të procedurës, e po ashtu edhe qëllimin e efikasitetit të procedurës dhe të vendosjes brenda një afati të arsyeshëm kohor.

Gjykata nuk do të jep aktgjykim në bazë të pohimita herë të konstaton se kërkesa e padisë është kërkesë me të cilën palët nuk mund të disponojnë lirisht e gjithashtu nuk do të jep aktgjykim në baza të pohimit as në konteste martesore.⁴⁸⁶

Shtyrja e dhënies së aktgjykimit në bazë të pohimit - dhënia e aktgjykimit në bazë të pohimit mund të shtyhet për më vonë në qoftë se është e nevojshme që të merren njoftimet e duhura nëse kërkesa e padisë është kërkesë më të cilën palët mund të disponojnë lirisht apo jo.

Raste nga praktika: Subjekti X e ka paditur subjektin Y për vërtetim të së drejtës së pronësisë lidhur me pronën NN dhe gjatë seancës përgatitore nga ana e subjektit të paditur para gjykatës jepet deklarata e pohimit të kërkesëpadisë. Në qoftë se gjykata nuk ka dëshmi të mjaftueshme mbi bazën e të cilave mund të konstatojë rrethanën se a është kërkesë e disponueshme për të paditurit objekti i kërkesëpadisë, mund ta shtyjë dhënien e aktgjykimit në bazë të pohimit dhe të ndërmerr verimet e duhura me të cilat do të konstatoj nëse kërkesa e padisë është e disponueshme ose jo për të paditurin. Në këtë mënyrë ex-officio mund t'i drejtohet organit kompetente në kuptim të dispozitës së nenit 7.2 të LPK-së, me kërkesë që organi përkatës t'i dorëzojë gjykatës në afat të caktuar (afat gjyqësor) certifikatën e pronës dhe informata tjera për historiatin e pronës etj. Pas marrjes së këtyre informatave gjykata do të vendos që të pranohet apo të refuzohet deklarata e pohimit të kërkesëpadisë.

Revokimi i deklaratës mbi pohimin e kërkesëpadisë

I padituri i cili e ka dhënë deklaratën mbi pohimin e kërkesëpadisë ka mundsi që ta revokoi deklaratën mbi pohimin e kërkesëpadisë. LPK me dispozitën e nenit 148.4 e ka paraparë mundsinë që i padituri ta revokojë deklaratën me të cilën e ka pohuar kërkesën e padisë por vetëm deri në momentin e dhënies së aktgjykimit në bazë të pohimit nga ana e gjykatës.

Për kryerjen e veprimit procedural me të cilin revokohet deklarata për pohimin e kërkesëpadisë nuk nevojitet pëlqimi i palës së paditur. I padituri nuk ka nevojë që gjykatës t'i paraqes kurrfarë arsytimi për revokimin e deklaratës me të cilën është pohuar kërkesa e padisë, por mjafton vetëm deklarimi se e revokon deklaratën për pohimin e kërkesëpadisë por me kusht që të mos jetë dhënë aktgjykimi.

Posa të revokohet deklarata për pohimin e kërkesëpadisë gjykata duhet të vazhdojë procedurën, një gjë të tillë gjykata do ta bëjë edhe nëse konstaton se kërkesa e padisë nuk është e disponueshme për palët.

Edhe pas revokimit të deklaratës për pohimin e kërkesëpadisë i padituri ka mundsi që ta ripohojë kërkesën e padisë dhe natyrisht kjo deklaratë e ka efektin e plotë në bazë të së cilës gjykata do të

⁴⁸⁶ Neni 85 par 2 i Ligjit për Familjen i Kosovës.

jep aktgjykimin në bazë të pohimit nëse konstaton së kërkesa padisë është e disponueshme për palët.

Nëse nxjerrët aktgjykimi në bazë të pohimit i njëjti duhet të përmbaj këtë emërtim “aktgjykim në bazë të pohimit”.

Arsyetimi i aktgjykimit në bazë të pohimit– arsyetimi i aktgjykimit në bazë të pohimit dallon prej arsyesimit të aktgjykimit të zakonshëm sepse tek ky arsyetim gjykata do të kufizohet në dhënien e arsyeve sa i përket vërtetimit të gjendjes së fakteve, analizës së provave dhe aplikueshmërisë së të drejtës materiale. Esenciale është përshkrimi i kërkesëpadisë, përshkrimi i deklaratës së pohimit të kërkesëpadisë, konstatimi se kërkesa është e disponueshme për palët dhe referenca në dispozitat e LPK-së, pjesa e aktgjykimit në bazë të pohimit.

Shkaqet e ankimit kundër aktgjykimit në bazë të pohimit- LPK, me dispozitën e nenit 181.2 ka përcaktuar se ”aktgjykimi në bazë të pohimit mund të goditet për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, apo nga shkakun se deklarata e pohimit, është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin e dhunës apo mashtrimit.

Aktgjykimi në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia

Me dispozitat e nenit 149 të LPK-së është paraparë mundësia e përfundimit të procesit gjyqësor me anë të veprimeve disponibile të palëve. Për derisa me dispozitat e nenit 148 të LPK-së është paraparë mundësia e përfundimit të procesit gjyqësor me pohimin e kërkesëpadisë, me dispozitat e nenit 149 të LPK-së procesi gjyqësor mund të përfundojë me heqjen dorë nga kërkesa e padisë. Në qoftëse paditësi deri në përfundimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes heq dorë nga një pjesë e kërkesëpadisë apo nga e gjithë kërkesëpadia, gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm e jep aktgjykimin me të cilin e refuzon kërkesëpadinë në pjesën nga e cila paditësi ka hequr dorë apo në tërësi.

Edhe në këtë rast kemi të bëjmë me një veprim procedural të palës paditëse i cili i nënshtrohet rregullave të LPK-së përkatësisht dispozitës nga neni 149 të LPK-së. Për heqjen dorë nga kërkesa e padisë palës paditëse nuk i nevojitet pëlqimi i palës së paditur.

Në praktikën gjyqësore gjykatat duhet qartësojnë situatat kur kemi të bëjmë me tërheqje të padisë me deklarin e palës paditëse dhe heqje dorë nga kërkesa e padisë.

Qartësimi i këtyre situatave më së lehti bëhet duke i identifikuar dallimet në mes të tërheqjes së padisë dhe heqjes dorë nga kërkesa e padisë.

Dallimet ne mes të tërheqjes së padisë dhe heqjes dorë nga kërkesëpadia janë:

- Padiësi mund të heq dorë nga kërkesëpadia pa pëlqimin e të paditurit deri në përfundimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes, ndërsa padiësi mund ta tërheq padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilën i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi.
- Në qoftëse padiësi heq dorë nga kërkesa e padisë atëherë gjykata do të nxjerrë aktgjykim në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia, ndërsa në qoftëse padiësi e tërheq padinë gjykata do të merr aktvendim me të cilin do ta konsiderojë të tërhequr padinë.
- Kundër aktgjykimit në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia në çdo rast mund të paraqitet ankesë drejtuar gjykatës së shkallës së dytë, ndërsa kundër aktvendimit me të cilin konstatohet e tërhequr padia e padiësit nuk lejohet fare ankesë.
- Procesi gjyqësor i përfunduar me aktgjykim të heqjes dorë nga kërkesëpadia konsiderohet çështje e përfunduar me vendim meritore dhe nënkupton pamundsinë që padiësi për çështjen e njëjtë të paraqes përsëri padi pasi që nëse do të paraqiste përsëri padi do të konsiderohej si çështje e gjykuar, ndërsa në qoftëse procesi gjyqësor ka përfunduar me aktvendim me të cilin është konstatuar e tërhequr padia e padiësit i njëjti mund ta përsërisë prapëpadinë e tij.

Refuzimi i dhënies së aktgjykimit në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia – Gjkata nuk do të jep aktgjykim në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia edhe pse janë plotësuar kushtet e nevojshme për një gjë të tillë poqëse konstaton se është fjala për kërkesën me të cilën palët nuk kanë të dejtë të disponojnë lirisht.

Gjkata nuk do të jep aktgjykim në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia sa herë që të konstaton se palët nuk mund të disponojnë lirisht me kërkesëpadinë e gjithashtu nuk do të jep aktgjykim në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia as në kontestet martesore.⁴⁸⁷

Shtyrja e dhënies së aktgjykimit në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia - dhënia e aktgjykimit në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia mund të shtyhet për më vonë në qoftë se është e nevojshme që të merren njoftimet e duhura, nëse kërkesa e padisë është kërkesë në të cilën palët mund të disponojnë lirisht (paragrafi 3 i nenit 3 të LPK-së).

Raste nga praktika: Në qoftë se subjekti X e ka paditur subjektin Y për vërtetimin e të drejtës së pronësisë lidhur me pronën N.N. Supozojmë se në rastin konkret padiësi nuk ka legjitimitet aktiv në këtë çështje juridike - kontestuese për shkak të mungesës së raportit juridik - civil me palën e

⁴⁸⁷Neni 85 paragrafi 2 i Ligjit për Familjen i Kosovës

paditur dhe nën supozimin se i njëjti e deklaroi heqjen dorë nga kërkesëpadija, gjykata mund ta shtyjë për më vonë dhënien e aktgjykimit deri sa të siguroj dëshmi të mjaftueshme në bazë të cilave mund të konstatojë rrethanën se a është kërkesa e disponueshme për palët në këtë rast për paditësin. Në këtë mënyrë gjykata ex officio në kuptim të nenit 7.2 të LPK-së mund të mbledh të gjitha informacionet e nevojshme për të nxjerrë përfundimin nëse kërkesa është e disponueshme apo jo.

Revokimi i deklaratës mbi heqjen dorë nga kërkesëpadija – Paditësi i cili e ka dhënë deklaratën mbi heqjen dorë nga kërkesëpadija gojarisht në seancë gjyqësore ose me anë të parashtrës jashtë seancës gjyqësore, mund ta revokojë të njëjtën pa pëlqimin e palës së paditur deri në momentin e dhënies së aktgjykimit.

Aktgjykimi për shkak të padëgjueshmërisë

Aktgjykimi për shkak të padëgjueshmërisë është risi të cilën e ka sjell LPK-ja aktual. Aktgjykimi për shkak të padëgjueshmërisë është në funksion të efikasitetit të procedurave gjyqësore dhe shtimit të masave në funksion të parimit të ekonomizimit. LPK me dispozitën e nenit 150 në mënyrë specifike e ka rregulluar mundsinë e marrjes së këtij aktgjykimi.

Është me rëndësi të theksohet për praktiken gjyqësore se ky lloj i aktgjykimit mund të merret vetëm jashtë seancës gjyqësore dhe asnjëherë në seancë gjyqësore.

Sipas dispozitës së nenit 150.1 të LKP-së përcaktohet se: në qoftë se i padituri, brenda afatit të përcaktuar me këtë ligj nuk paraqet në gjykatë përgjigje në padi, gjykata jep aktgjykim për shkak të padëgjueshmërisë me të cilin aprovon kërkesëpadinë.

Aktgjykimin për shkak të padëgjueshmërisë do të mund ta nxjerr gjykata në qoftë se plotësohen disa kushte kumulative:

- Po qëse të paditurit i është dorëzuar rregullisht padija dhe thirrja për dhënien e përgjigjes në padi,
- Po që se themelësia e kërkesëpadijes del nga faktet e treguara në padi,
- Po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadija nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vet paditësi apo me faktet e ditura botërisht.

Kushtet e lartë cituara nga ana e gjykatës duhet të vlerësohen në mënyrë kumulative dhe në mënyrë që e njëjta mund të nxjerr vendim për shkak të padëgjueshmërisë dhe atë jashtë seancës dhe pa propozimin e palës paditëse. Nga kjo rrjedh se gjykata kryesisht vlerëson nëse plotësohen kushtet për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të padëgjueshmërisë. Është me rëndësi të theksohet se gjykata përveç kushtit që ndërlidhet me përgjigjen në padi duhet të bëjë një vlerësim objektiv të themelësisë së kërkesëpadijes e cila gjithsesi duhet të rezultojë si e bazuar duke u mbështetur në

faktet e treguara në padi të cilat duhet të jenë të provuara me provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Kur analizohen me kujdes kushtet kumulative që duhet të plotësohen për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të padëgjueshmërisë rezulton se praktika gjyqësore do të jetë e kufizuar në shumë raste për nxjerrjen e këtij aktgjykimi pasi që në të gjitha rastet nga të cilat rrjedh se faktet do të provohen me prova të cilat nuk mund të deponohen së bashku me padinë me rastin e punimit të padisë në gjykatë, ky aktgjykim do të jetë i pamundur të nxirret. Për shembull në qoftëse një fakt do të provohet me dëgjimin e dëshmitarëve, ky aktgjykim nuk mund të nxirret, pastaj në qoftëse një fakt do të provohet me nxjerrjen e ekspertizës ky aktgjykim gjithashtu nuk mund të nxirret etj.

Mosdhënia e aktgjykimit për shkak të padëgjueshmërisë

Gjykata nuk do të nxjerr aktgjykimin për shkak të mosbindjes pavarësisht se plotësohen kushtet, nëse gjykata konstaton se është fjala për kërkesën në të cilën palët nuk kanë të drejt të disponojnë lirisht.

Kjo situatë është identike me të gjitha rastet në të cilat gjykata do të veprojë kryesisht kur konstaton se palët kanë pretendime të disponojnë me kërkesa që nuk mund të disponojnë (neni 3.3 i LPK).

Shtyrja e dhënies së aktgjykimit për shkak të padëgjueshmërisë

Gjykata mund të shtyjë dhënien e aktgjykimit për shkak të padëgjueshmërisë në qoftë se ka nevojë të merr njoftimet e duhura lidhur me rrethanën nëse kërkesa e palëve është kërkesë e disponueshme për palët. Gjithmonë kjo shtyrje duhet të ndodhë në periudhën deri sa gjykata nuk u ka dërguar palëve ftesat për seancën përgatitore apo të shqyrtimit kryesor në qoftë se nuk cakton seancë përgatitore. Kjo për arsye se siç u theksua gjykata mund të jep këtë aktgjykim vetëm jashtë seancës.

Në çdo rast kur i padituri nuk ka dhënë përgjigje në padi por që nga faktet e treguar në padi nuk del themelësia e kërkesëpadsisë, gjykata cakton seancën përgatitore dhe poqëse në seancën e këtillë paditësi nuk e ndryshon padinë, jep aktgjykim metë cilin e refuzon kërkesëpadinë. Kjo situatë ka nevojë të sqarohet përpraktiken gjyqësore pasi që në seancën e shqyrtimit kryesor gjykata do të nxjerr edhe prova tjera me të cilat provohen faktet e padisë e të cilat nuk i ka pasur në disponim gjykata me rastin e vlerësimit të kushteve për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të padëgjueshmërisë. Pra në shqyrtim gjyqësor kërkesëpadia nga provat e administruara mund të del si e bazuar.

Kundër aktvendimit të gjykatës me të cilin refuzohet propozimi i paditësit që t'i jepet aktgjykimi për shkak të padëgjueshmërisë nuk lejohet ankimi. Ky përcaktim ligjor mund të krijojë hamendje në praktiken gjyqësore pasi që mund të interpretohet se është kusht propozimi i palës paditëse për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të padëgjueshmërisë. Vlerësojmë se nuk është kusht propozimi i palës paditëse për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të padëgjueshmërisë.

Nga praktika: Në praktikën gjyqësorë ekzistojnë raste kur dispozitat e LPK-së, nga neni 150, për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mosbindjes nuk janë zbatuara në mënyrë të drejtë. Gjykata nuk duhet të mjaftohet vetëm me rrethanën se pala e paditur nuk ka paraqitur përgjigje në padi, sepse mos dhënia e përgjigjes në padi është vetëm njëri nga kushtet për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mosbindjes. Gjykata duhet që në çdo rast pa përjashtim të kujdeset nëse themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi. Në kjo rrjedhe se faktet e treguara në padi duhet të konfirmojnë themelësinë e kërkesëpadisë, e gjithashtu ato fakte duhet të jenë në harmoni me provat në shkresat lëndisë dhe të mos jene në kundërshtim me fakte e ditura botërisht.

Për ta zhvilluar edhe me tutje idenë mund të theksohet ose duhet të kuptohet që themelësia e kërkesëpadisë duhet të del nga fakte e treguara në padi të cilat duhet të provohen me provat që gjenden në shkresat e lëndës, apo faktet të jenë të ditura botërisht. Në këtë kuptim pashmangshëm del se po qesë për vërtetimin e fakteve vendimtare janë propozuar mjetet provuese si: këqyrja e gjykatës në vend, nxërja e ekspertizë, dëgjimi i dëshmitarëve apo dëgjime i palëve, atëherë nuk mund të nxjerrët aktgjykimi për shkak të mosbindjes. Pra si përfundim mund të theksohet se faktet vendimtare duhet të konfirmohen nga provat materiale që gjend në shkresat e lëndës, të cilat gjithashtu duhet të jenë në harmoni të plotë në mes tyre.

Aktgjykimi për shkak të mungesës

Me aktgjykim për shkak të mungesës kuptojmë atë aktgjykim me të cilin pranohet si e themeltë kërkesëpadija e përmbajtur në padinë e ngritur kundër të paditurit i cili nuk mbrohet nga ajo, nuk e kundërshton kërkesëpadinë me veprim të shkruar dhe mungon në seancën përgatitore, apo në qoftë se nuk është mbajtur kjo, nga seanca e parë për shqyrtim kryesor, e paditësi i pranishëm e propozon dhënien e tij apo gjykata sipas detyrës zyrtare e jep këtë aktgjykim. Aktgjykimi për shkak të mungesës është paraparë me dispozitate nenit 151 të LPK-së. Në qoftë se krahasohen kushtet për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mungesës dhe aktgjykimit për shkak të padëgjueshmërisë do të vërehen se ekzistojnë disa ngjashmëri por edhe disa dallime esenciale.

Kështu gjykata do të nxjerrë aktgjykim për shkak të mungesës kur të paditurit nuk i është dërguar padija për përgjigje, por vetëm bashkë me letërthirrje për seancë përgatitore apo në seancën e parë të shqyrtimit kryesor në qoftë se seanca përgatitore nuk është caktuar fare, ndërsa i padituri nuk vjen deri në përfundimin e seancës, atëherë gjykata me propozimin e paditësit apo sipas detyrës zyrtare e jep aktgjykimin me të cilin e aprovon kërkesëpadinë poqëse plotësohen edhe këto kushte:

- nëse i padituri është thirrur rregullisht në seancë;

- nësei padituri nuk e ka kontestuar kërkesëpadinë me anë të parashtrësës;
- nëse themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi;
- nëse faktet në të cilat bazohet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat e paraqitura nga vetë paditësi apo me faktet e ditura botërisht;
- nëse nuk ekzistojnë rrethana notore nga të cilat del përfundimi se e kanë penguar të paditurin shkaqe të arsyeshme që të vijë në seancë.

Kushte për dhënien e aktgjykimit për shkak të mungesës duhet të kuptohen si prezumime procedurale dhe materiale që duhet të plotësohen përveç prezumimeve që duhet të plotësohen për çdo aktgjykim.

Është me rëndësi të theksohet se gjykata duhet tu kushtojë vëmendjen e duhur plotësimit të kushteve siç kërkohen e veçanërisht gjykata duhet të bëjë një vlerësim objektiv të themelësisë së kërkesëpadisë e cila gjithsesi duhet të rezultojë si e bazuar duke u mbështetur në faktet e treguara në padi të cilat duhet të jenë të provuara me provat që gjenden në shkresat e lëndës. Në këtë pikë vërehen zakonisht dobësitë e vendimeve të cilat merren për shkak të mungesës.

Mosdhënia e aktgjykimit për shkak të mungesës

Gjykata nuk do të nxjerrë aktgjykimin për shkak të mungesës pavarësisht se plotësohen kushtet, nëse konstatohet se është fjala për kërkesën në të cilën palët nuk kanë të drejtë të disponojnë lirisht. Kjo situatë është identike me të gjitha rastet në të cilat gjykata do të veprojë kryesisht kur konstaton se palët kanë pretendime të disponojnë me kërkesa që nuk mund të disponojnë.

Shtyrja e dhënies së aktgjykimit për shkak të mungesës

Gjykata mund të shtyjë dhënien e aktgjykimit për shkak të mungesës në qoftë se ka nevojë të merr njoftimet e duhura lidhur me rrethanën nëse kërkesa e palëve është kërkesë e disponueshme për palët.

Gjykata me aktvendim e refuzon propozimin e palës për dhënien e aktgjykimit për shkak të mungesës, kundër të cilit nuk lejohet ankesë.

uhet theksuar se dispozita e nenit 151 të LPK-së, të cilat parashohin mundsin e marrjes së aktgjykimin për shkak të mungesës, nuk janë duke gjetur zbatimin e duhur pasi që njëri ndër kushtet për dhënien e këtij aktgjykimi është që gjykata fare mos t'i ketë dërguar të paditurit aktvendim për përgjigje në padi, ndërsa LPK-ja, në ana tjetër parashih detyrimin e gjykatës që palës së paditur t'i dërgoj aktvendimin për përgjigje në padi. LPK-ja nuk ka dispozita me të cilat e qartëson saktësisht se në cilat raste gjykata mundet fare mos t'i dërgojë palës së paditur aktvendimin për përgjigje në padi.

Vlerësojmë se aktgjykimi për shkak të mungesës më së shumti mund të gjej zbatim të kontestet me vlerë të vogël.⁴⁸⁸

Nga praktika: Disa nga gabimet në zbatimin e dispozitave për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mungesës kanë të bëjnë me momentin kur mund të konstatohet nxjerrja e këtij aktgjykimi nga ana e gjykatës, pastaj me rrethanë se duhet apo nuk duhet të mbahet seancë në mungesë, e pastaj të konstatohet nxjerrja e aktgjykimit në mungesë si dhe nevoja që provat të administrohen dhe të konstatohen në procesverbal apo t apo të mos administrohen.

Është me rëndësi të theksohet se në rastet kur i paditur nuk prezanton në seancë dhe gjykata konstaton se plotësohen kushte nga neni 151 paragrafi 1, pika a) *nëse i padituri është thirrur rregullisht për në seancë; b) nëse i padituri nuk e ka kontestuar kërkesëpadinë me anë të parashtrësës; c) nëse themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi; d) nëse faktet në të cilat bazohet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat e paraqitura nga vetë paditësi apo me faktet e ditura botërisht; e) nëse nuk ekzistojnë rrethana notore nga të cilat del përfundimi se e kanë penguar të paditurin shkaqe të arsyeshme që të vijë në seancë*, atëherë gjykata me propozimin e palës paditëse apo edhe zyrtarisht pasi konstaton prezencën e palëve, respektivisht mos prezencën e të paditurit me shpjegim së i është dërguar padia së bashku me ftesë për seancë dhe mungesën nuk e ka arsyetuar (*pasi vlerëson edhe kushtet tjera*) në procesverbal konstaton drejtpërdrejt nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mungesës.

Nga kjo rrjedh se gjykata nuk duhet të vendos që seancën ta mbaj në mungesës sepse po vendosi që seancën ta mbaj në mungesë atëherë është e pamundur nxjerrja e aktgjykimit për shkak të mungesës.

Gjykata nuk duhet të lexoj-administroj provat sepse pamundsohet nxjerrja e aktgjykimit për shkak të mungesës.

Nëse shikohen me hollësi kushtet për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mungesës rezulton se gjykata për kushtet nga neni 151 paragrafi 1, pika c) *nëse themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi; d) nëse faktet në të cilat bazohet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat e paraqitura nga vetë paditësi apo me faktet e ditura botërisht; e) nëse nuk ekzistojnë rrethana notore nga të cilat del përfundimi se e kanë penguar të paditurin shkaqe të arsyeshme që të vijë në seancë*, duhet të ketë vlerësim konkluden se plotësohen kushte sepse rëndom nuk konstatohen në procesverbal arsye për mënyrën e plotësimit të kushteve. Arsyetimi pastaj pason në vendimin e veçantë i cili duhet të arsyetohet sikurse çdo aktgjykim tjetër por duke dhen arsye shtesë për kushtetprocedurale që lidhen me nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

⁴⁸⁸Shih për këtë pjesën ku flitet për procedurat e posaqme kontestimore, konkretisht procedura në kontestet e vlerës së vogël.

Aktgjykimi pa shqyrtim kryesor të çështjes

Aktgjykimi pa shqyrtim kryesor të çështjes nuk ka qenë i paraparë më LPK-në e vjetër. Me dispozitën e nenit 152 të LPK-së, është paraparë mundësia e nxjerrjes së aktgjykimit pa shqyrtim kryesor të çështjes. Me këtë dispozitë synohet efikasiteti i procesit gjyqësor civil.

Sipas kësaj dispozite gjykata do të nxjerrë aktgjykim pa shqyrtim kryesor të çështjes po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seancë gjyqësore, të nxjerrë aktgjykim (neni 143 dhe 147 i LPK-së), nëse nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e tij.

Duhet theksuar se dispozita e nenit 152 ka ngjashmëri substanciale me dispozitën e nenit 398 të LPK-së.

Kusht esencial për nxjerrjen e aktgjykimit sipas dispozitës së nenit 152 të LPK-së, është që pala e paditur të ketë dhënë përgjigje në padi dhe më përgjigje në padi t'i ketë pohuar faktet e prezumuara nga ana e palës së paditur. Në këtë rast për nxjerrjen e aktgjykimit pa shqyrtim kryesor të çështjes duhet të plotësohen në mënyrë kumulative kushtet që pala e paditur të ketë dhënë përgjigje në padi dhe gjithashtu t'i ketë pohuar faktet e çështjes të prezumuara nga paditësi.

Në çdo rast për praktikën gjyqësore duhet të jetë e qartë se aktgjykimi pa shqyrtim kryesor të çështjes mund të nxirret vetëm jashtë seancës gjyqësore, çka do të thotë se për nxjerrjen e këtij aktgjykimi nuk do të caktohet as seancë përgatitore dhe as e shqyrtimit kryesor.

Në çdo rast nëse gjykata vlerëson se plotësohen kushtet për nxjerrjen e aktgjykimit pa shqyrtim kryesor të çështjes atëherë mundet vetëm ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësit por jo edhe ta refuzoj. Kjo nënkupton se nëse është dhënë përgjigje në padi, janë pohuar edhe faktet e prezumuara nga paditësi, por megjithatë pavarësisht së janë pohuar fakte nuk del themelësia e kërkesëpadisë apo nëse kemi të bëjmë me kërkesë me të cilën palët nuk mund të disponojnë lirisht atëherë gjykata nuk e nxjerr aktgjykimin pa shqyrtim kryesor të çështjes por e cakton seancën përgatitore apo të shqyrtimit kryesor.

Nxjerrja e aktgjykimit pa caktuar seancë gjyqësore sipas dispozitës së nenit 398 të LPK-së

Dispozita e nenit 398 e LPK-së, ka ngjashmëri substanciale me dispozitën e nenit 152 të LPK-së, pasi që në të dy rastet gjykata pasi t'i arrijë përgjigja në padi pa shqyrtim kryesor do të nxjerr aktgjykim me të cilin do ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar.

Me dispozitën e nenit 398 parashihet se: kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, dhe konstaton së ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit merit, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund të jep aktgjykim me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.

Edhe sipas kësaj dispozite rrjedh se njëri ndër kushte substanciale për dhënien e këtij aktgjykimi është dhënia e përgjigjes në padi nga ana e të paditurit. Kusht tjetër esencial është edhe vlerësimi i gjykatës përkatësisht konstatimi i gjykatës së ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit merititor. Dhënia e përgjigjes në padi është me rëndësi edhe te ky aktgjykim pasi që gjykata nga padia dhe përgjigja në padi do të mund të konstatojë, se cilat fakte në mes të palëve janë kontestuese e cilat jo dhe në bazë të kësaj të vendos për veprimet e mëtutjeshme.

Dallimet në mes të aktgjykimit pa shqyrtim kryesor të çështjes (neni 152) dhe aktgjykimit sipas dispozitës së nenit 398 janë:

- aktgjykimi pa shqyrtim kryesor të çështjes do të emërtohet “aktgjykim pa shqyrtim kryesor të çështjes, ndërsa aktgjykimi sipas dispozitës së nenit 398 vetëm “aktgjykim” por në hyrje të aktgjykimit do të shënohet data e nxjerrjes dhe konstatimi se është vendosur jashtë seancës.
- te aktgjykimi pa shqyrtim kryesor të çështjes (neni 152), domosdoshmërisht duhet të ketë pohim të fakteve të çështjes nga ana e të paditurit, ndërsa te aktgjykimi sipas dispozitës së nenit 398 nuk është e domosdoshme të ketë pohim të fakteve të prezumuara nga paditësi, por vlerësimi se gjendja faktike nuk është kontestuese në mes të palëve duhet të jetë vlerësim i gjykatës.
- te aktgjykimi pa shqyrtim kryesor të çështjes (neni 152), arsyetimi i aktgjykimit sa i përket analizës dhe përfundimit për gjendjen e fakteve në të cilat mbështetet kërkesëpadia është fare i shkurtër, ndërsa te aktgjykimi sipas dispozitës së nenit 398 arsyetimi i aktgjykimit për faktet e çështjes dhe përfundimi i gjykatës lidhur me konstatimin se nuk është kontestuese gjendja faktike në mes të palëve duhet të jetë analizë e mirëfilltë, vlerësim logjik e objektiv se si gjykata ka konstatuar se nuk është kontestuese gjendja e fakteve.

Nxjerrja e aktgjykimit pa caktuar seancë gjyqësore sipas dispozitave nga neni 399 i LPK-së

Dispozita e nenit 399 janë risi në LPK-në aktual, pasi që LPK-ja e vjetër nuk i ka përmbajtur këto dispozita.

Qëllimi i këtyre dispozitave është në funksion të parimit të ekonomizimit dhe efikasitetit të procesit gjyqësor.

Sipas dispozitës së nenit 399.1 është përcaktuar se: kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendim merititor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia.

Sipas dispozitës nga paragrafi 2 i nenit 399 parashihe se: kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të nenit 399, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo po që se faktet mbi të cilat mbështet kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura.

Për dallim nga dispozitat e nenit 152 dhe 398 me të cilat është paraparë mundsia që gjykata të bie aktgjykim pa shqyrtim me të cilin e aprovon kërkesëpadinë, me dispozitën e nenit 399 është parë mundsia e nxjerrjes së aktgjykimit pa shqyrtim por për refuzimin e kërkesëpadisë.

Gjykata do të vlerësojë se kërkesëpadia është e pathemeltë në qoftë se ajo qartazi është në kundërshtim me faktet të cilat paditësi i ka theksuar në padi, në qoftë se faktet të cilat i ka prezantuar janë në kundërshtim me provat të cilat i ka propozuar paditësi për vërtetimin e fakteve, apo nëse kërkesëpadia është në kundërshtim me faktet e ditura botërisht.

Kërkesëpadia do të jetë në kundërshtim me faktet në qoftë se sipas të drejtës materiale nga faktet e treguara nuk del themelësia e kërkesëpadisë, faktet do të jenë në kundërshtim me provat në qoftë se me provat e propozuara do të vërtetohen fakte tjera nga ato të prezantuara nga paditësi e gjithashtu në qoftë se faktet e prezantuara nga paditësi do të jenë në kundërshtim me faktet e ditura botërisht⁴⁸⁹ e të cilat nuk ka nevojë të provohen.

Aktgjykimi plotësues

Nëse gjykata me vendim meritor nuk ka vendosur për ndonjë kërkesë të palës, atëherë ajo mund të kërkojë që gjykata të vendos lidhur me këtë kërkesë.

LPK sa i përket kërkesës nuk bën dallim në mes të kërkesave kryesore dhe atyre aksesore. Me dispozitën e nenit 162.1 të LPK-së, është përcaktuar se: *“Po që se gjykata nuk ka vendosur mbi të gjitha kërkesat që është dashur të përfshihen në aktgjykim, ose kur vetëm një pjesë e kërkesës ka mbetur pa u përfshirë me të, pala mundet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita kur i është dorëzuar aktgjykimi t’i propozojë gjykatës që të bëjë plotësimin e tij”*. Po që se pala nuk paraqet propozimin brenda afatit do të konsiderohet se është tërhequr padia në pjesën që nuk është përfshirë në aktgjykimin e dhënë. Propozimi i vonuar për plotësimin e aktgjykimit hidhet poshtë nga ana e gjykatës ndërsa propozimi i pathemeltë refuzohet nga gjykata pa u caktuar seanca gjyqësore.

Nga të cekurat rrjedh se gjykata do ta plotësojë aktgjykimin nëse plotësohen disa kushte në mënyrë kumulative:

⁴⁸⁹Fakte e ditura botërisht sqarohen në pjesë ku trajtohen mjetet provuese.

- Nëse nuk është vendosur për të gjitha kërkesat apo për një pjesë të kërkesës,
- nëse paraqitet propozimi për plotësim nga pala dhe
- nëse propozimi për plotësim të aktgjykimit është i afatshëm.

Vlerësojmë se gjykata nuk mundet exofficio të bëjë plotësimin e aktgjykimit pa pasur propozim nga pala.

Konsiderohet se është kërkesë për plotësim edhe ankesa e cila mbështetet vetëm në shkakun se gjykata nuk ka vendosur për tërë kërkesëpadinë, pra në këtë rast gjykata ankesën duhet ta trajtoj si kërkesë për plotësimin e aktgjykimit.

Paditësi i cili nuk e ka parashtruar kërkesën për plotësimin e aktgjykimit nuk e humb të drejtën që për pjesën e pavendosur të paraqesë padi të re.

Në qoftë se propozimi për plotësimin e aktgjykimit i referohet vetëm kërkesës për shpenzime atëherë gjykata nuk vendos me aktgjykim por me aktvendim.

Kundër aktgjykimit plotësues lejohet ankesë e veçantë.

Dhënia, hartimi me shkrim dhe dërgimi i aktgjykimit

Parimisht, aktgjykimi duhet dhënë menjëherë pas përfundimit të shqyrtimit kryesor.

Sipas dispozitës së nenit 153.1 të LPK-së, gjykata e jep aktgjykimin më së voni brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e përfundimit të shqyrtimit kryesor. Koha në të cilën jepet aktgjykimi quhet dita në të cilën ai hartohet me shkrim.

Në qoftë se gjyqtari e kalon afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh për dhënien e aktgjykimit ai ka për detyrë ta njoftojë kryetarin e gjykatës për shkaqet e tejkalimit të tij.

Mos përmbajtja ndaj afatit për dhënien e aktgjykimit nuk ka kurrfarë pasojash procedurale-juridike për palët, ndërsa për gjyqtarin mos përmbajtja e afatit mund të ketë pasojë administrative të natyrës disiplinore.

Shpallja e aktgjykimit

Pas përfundimit të shqyrtimit kryesor gjykata i njofton palët e pranishme për ditën e dhënies së aktgjykimit, e në qoftë se ndonjëra nga palët nuk merr pjesë në seancë atëherë gjykata duhet që ta njoftojë me shkrim.

Duhet theksuar se në praktikën gjyqësore në vendin tonë nuk respektohet detyrimi i shpalljes së aktgjykimit përveç në një numër të vogël kontestesh, pasi që në praktikën gjyqësore respektohet

detyrimi i gjykatës që palës t'i dërgojë aktgjykimin me shkrim siç parasheh dispozita e nenit 155.2 e LPK-së.

Mos shpallja e aktgjykimit nga gjykatat tonë është edhe pasoja e procedurës shumë formale që parasheh dispozitat e nenit 154 paragrafi 1 e LPK-së, me të cilën përcaktohet detyrimi i gjykatës që pas përfundimit të shqyrtimit kryesor t'i njoftojë palët e pranishme për ditën e dhënies së aktgjykimit (mendohet për shpalljen e aktgjykimit), e rrjedhimisht në qoftë se ndonjëra nga palët nuk ka marrë pjesë në seancën për shqyrtim kryesor, gjykata më shkrim ta njoftoj të njëjtën për ditën e dhënies së aktgjykimit.

Vlerësojmë së kjo është një procedurë shumë formale që është në kundërshtim me parimin e ekonomizimit të procedurës, prandaj ne insistojmë që të respektohet afati për hartimin me shkrim brenda 15 ditësh, ndërsa për detyrimin e shpalljes së aktgjykimit gjithsesi mendojmë së është një detyrim ligjor që duhet respektuar, por rrethanat praktike sigurisht që do të ndikoj që ky detyrim që mos jetë i zbatuar. Në këtë aspekt paraqitet edhe një problematikë që lidhet më afatin e ankimit pasi që sipas dispozitës së nenit 154.2 të LPK-së, përshihet së në qoftë së palët janë njoftuar rregullisht për ditën e dhënies së aktgjykimit, afati për ankim kundër aktgjykimit fillon të ecë ditën e nesërme pas dozimit të aktgjykimit. Në këtë kontekst shtrohet pyetja çka nëse palët nuk janë njoftuar rregullisht për ditën e dhënies së aktgjykimit sidomos kur njëra palë nuk ka marrë pjesë në seancën, çka ndodh me afatin nëse njëra palë ka qenë e njoftuar rregullisht dhe nuk ka marrë pjesë.

Mendojmë se dispozitat ligjore janë të pa qarta, e për rrjedhojë ka ndikuar edhe në krijimin e praktikës që palëve t'ju dërgohet aktgjykimi me shkrim pa e shpallur paraprakisht gjykata të njëjtin.

Aktgjykimi burimor

Aktgjykimin burimor e nënshkruan gjyqtari. Nga kjo rrjedh se gjyqtari e nënshkruan vetëm një dokument origjinal (aktgjykimin burimor). Sipas kuptimit të dispozitës së nenit 159 rrjedh se palëve të kontestit duhet tu dërgohet kopja e legalizuar e aktgjykimit, ndërsa aktgjykimi burimor duhet të ruhet së bashku me shkresat e lëndës në gjykatë. Praktika gjyqësore është e ndryshme pasi që gjykatat tona palëve u dërgojnë nga një kopje të aktgjykimit të cilat janë të nënshkruara nga gjyqtari, ndërsa praktika tregon se në gjykatën e shkallës së dytë dhe të tretë respektohet kuptimi i kësaj dispozite.

Momenti i komunikimit të aktgjykimit në aspektin procedural është i rëndësishëm sepse nga ky moment fillon të ec afati partitiv (afati i përmbushjes vullnetare të detyrimit)e gjithashtu fillon të ecë edhe afati për të drejtën e ankesës. Këtu bëhet fjalë për dorëzimin e aktgjykimit palëve e jo shpalljen e tij.

Korrigjimi i aktgjykimit

Korrigjimi i aktgjykimit i referohet vetëm mungesave që kanë të bëjnë me gabimet e bëra në shkrim ose llogari, si dhe pasaktësitë e dukshme të vendimit. Të kësaj natyre janë edhe gabimet në

lidhje me formën e aktgjykimit si dhe mospajtimi midis kopjes dhe origjinalit të aktgjykimit. LPK-ja me dispozitën e nenit 165 i referohet korrigjimit të aktgjykimit.

Sipas dispozitës së nenit 165.1 përcaktohet se: gabimet në emra dhe numra, si dhe gabimet tjera në shkrim dhe llogaritje, mungesat në aspektin e formës së aktgjykimit dhe mospajtimi midis kopjes me origjinalin e aktgjykimit, e korrigjon gjykata në çdo kohë.

Gjykata për korrigjimin e gabimeve nxjerr aktvendim të posaçëm dhe një kopje e këtij aktvendimi u dërgohet palëve.

Në qoftë se midis origjinalit dhe kopjes së aktgjykimit ka mospajtime atëherë palëve u dërgohet nga një kopje e korrigjuar e aktgjykimit, duke u treguar se më këtë kopje të aktgjykimit zëvendësohet kopja e mëparshme e aktgjykimit. Në këtë rast afati për ankim kundër pjesës së korrigjuar fillon të ecë nga dita e pranimit të kopjes së korrigjuar nga palët.

Për korrigjimin e aktgjykimit gjykata vendos pa dëgjimin e palëve. Kundër aktvendimit me të cilin bëhet korrigjimi i aktgjykimit lejohet ankesë e veçantë.

Gabimet përkatësisht mungesat në aktgjykim të cilat janë bazë e korrigjimit të aktgjykimit nuk guxojnë të jenë rezultat i formulimit të gabuar të vullnetit të gjykatës në kohën e dhënies së vendimit, sepse me anë të korrigjimit nuk mund të ndryshohet vullneti i gjykatës i formuar me rastin e dhënies së vendimit, pasi që gjykata është e lidhur me të nga momenti i shpalljes së aktgjykimit.

Forma e prerë e aktgjykimit

Marrëdhëniet e ndryshme juridike të palëve në kontest caktohen në mënyrë përfundimtare, atëherë kur vendimi i gjykatës merr formën e prerë.

Pas marrjes së formës së prerë, vendimi fiton fuqinë e “*gjësë së gjykuar*” që do të thotë se pala që ka fituar gjyqin mund të vërë vendimin në përmbarrim të detyrueshëm në qoftë se ai nuk ekzekutohet vullnetarisht nga subjekti që ka humbur gjykimin (debitori).

Sipas dispozitës së nenit 166.1 të LPK-së, parashihet se “aktgjykimi i cili nuk mund të goditet me anë të ankesës bëhet i formës së prerë për aq sa është vendosur me të mbi kërkesëpadinë apo të kundërpadisë”.

Është detyrë e gjykatës që ex officio gjatë tërë procedurës të kujdeset nëse çështja objekt i shqyrtimit është gjë e gjykuar. Nëse konstatohet se kemi të bëjmë me çështje të gjykuar padia hedhet poshtë si e palejueshme.⁴⁹⁰

Aktgjykimi mund të bëhet i formës së prerë:

- nëse palët kanë hequr dorë nga e drejta për të parashtruar ankesë,
- nëse palët i kanë tërhequr ankesat e paraqitura,

⁴⁹⁰ Neni 391 i LPK-së.

- nëse ka kaluar afati për paraqitjen e ankesës dhe
- nëse ka vendosur gjykata e shkallës së dytë duke e refuzuar ankesën dhe duke e vërtetuar vendimin e shkallës së parë.

Sipas LPK-së, kundër të gjitha aktgjykimeve lejohet e drejta e ankesës, prandaj në asnjë rast aktgjykimi nuk mund të bëhet i formës së prerë në mënyra tjera përveç mënyrave të cekura.

Aktgjykimi i formës së prerë prodhon efekt juridik vetëm ndërmjet palëve ndërgjyqëse, përveç kur nga shkaku i natyrës së raportit kontestues apo, sipas urdhrorit të ligjit, prodhon efekt kundër personave të tretë.

Aktvendimi

Aktvendimi është lloj i vendimit gjyqësor me të cilin gjykata gjatë procesit vendos për të gjitha çështjet tjera të cilat paraqiten gjatë zhvillimit të tij, pos për vet objektin e gjykimin.

Zakonisht me aktvendim gjykata vendos për çështje procedurale, sepse shumica e çështjeve gjatë gjykimin zgjidhen me zbatimin e normave procedurale. Mirëpo ka raste kur me aktvendim zgjidhen edhe çështje të natyrës materiale por të cilat nuk e kanë rëndësinë e çështjes kryesore, si p.sh, çështja e shpenzimeve të procedurës, pjesëmarrja e ndërhyrësit në gjykim etj.

Aktvendimet jepen sikurse në seancë gjyqësore ashtu edhe jashtë seancës gjyqësore. Të gjitha aktvendimet që jepen në seancë gjyqësore i shpall gjyqtari. Aktvendimi i shpallur në seancë gjyqësore u dërgohet palëve në kopje të verifikuar vetëm nëse mund të goditet me ankesë të posaçme, apo nëse në bazë të aktvendimit mund të kërkohet menjëherë përmbarimi, apo nëse një gjë të tillë e kërkon drejtimi i procesit.

Aktvendimet të cilat gjykata i jep jashtë seancave gjyqësore u komunikohen palëve duke iu dërguar kopja e vërtetuar e aktvendimit.

Gjykata është e lidhur për aktvendimet e saj, po që se ato nuk i përkasin drejtimit të procesit, apo nëse me LPK nuk është përcaktuar ndryshe.

Aktvendimi ndaj të cilit lejohet ankim i veçantë duhet të ketë arsyetim.

**NDËRMJETËSIMI SI METODË ALTERNATIVE E
ZGJIDHJES SË KONTESTEVE**

Ndërmjetësimi në çështje civile

“Nuk është turp kur nuk e di, por është turp kur nuk dëshiron ta mësoh”.

Zhvillimi i shoqërisë në përgjithësi, përveç të mirave të shumta që ka sjell, ka ndikuar që të që të ndodhin dhe të shtohen edhe mosmarrëveshjeve të reja dhe të ndryshme në mes njerëzve. Si rezultat, është shtuar edhe nevoja të shikohen edhe mënyra tjera të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve/kontesteve në mes qytetarëve - përveç zgjidhjeve që ofrojnë gjykatat.

Neni 6, paragrafi 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut thotë: “Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohe drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij”.

Për ta arritur qëllimin e këtij neni në gjyqësorin e Kosovës, ku numri i rasteve të pazgjidhura të natyrës civile/familjare dhe penale është shumë i lartë, është paraqitur si nevojë e domosdoshme që të ndërmerren masa të menjëhershme për të ndryshuar situatën aktuale, kjo përmes zgjidhjes alternative të kontesteve, me theks të veçantë ndërmjetësimi, gjë që ndihmon në përmbushjen e nevojave të palëve dhe në zvogëlimin e numrit të lëndëve të grumbulluara.

Numri i madh i lëndëve që i adresohen gjykatave dhe mungesa e kapaciteteve të mjaftueshme për të menaxhuar me kohë e në mënyrë efikase me të njëjtat, ka ndikuar që zgjidhja e tyre e e tyre në procedurë të rregullt gjyqësore, të vështirësohet dhe të tejzgjatet, gjë që ndikon negativisht në perceptimin dhe besimin e publikut, prandaj “ndërmjetësimi”, si mekanizëm i qëndrueshëm që funksionon brenda sistemit gjyqësor, paraqitet si rrugë më e lehtë, më pak e kushtueshme dhe më e shpejtë, për zgjidhjen e çështjeve të ndryshme kontestuese me të cilat ngarkohet gjyqësori.

Themel të fortë dhe sistem të qëndrueshëm për përdorimin e ndërmjetësimit siguron Ligji i ri për Ndërmjetësimin, nr. 06/L-009, në fuqi nga Gushti 2018.

Ndërmjetësimi është mënyrë alternative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve/kontesteve në mes të palëve me ndihmën e personit të tretë, i pa anshëm dhe neutral, i cili ndihmon palët për të gjetur zgjedhjen e duhur/të kënaqshme lidhur me mosmarrëveshjet që kanë mes veti.

Ligji për Procedurën Kontestimore parasheh mundsinë e pajtimit gjyqësorë në mes palëve në kontest, që lidhet në mes tyre në prani të gjyqtarit, gjë që ka ngjashmëri me ndërmjetësimin, i ku marrëveshja në mes palëve lidhet në prani të ndërmjetësuesit, për faktin se në të dy rastet marrëveshja/pajtimi, në momentin e lidhjes marrin formën e prerë dhe karakterin e titullit ekzekutiv.

Ndërmjetësimi - si mënyrë alternative e zgjidhjes së kontesteve, ka benefitet e veta sepse begaton sistemin dhe përmbush nevojat e palëve, por ka edhe sfidat e veta. Sidoqoftë. Ndërmjetësimi,

gjithsesi duhet të zbatohet në gjyqësorin e Kosovës aq më tepër kur me nenin 9 të Ligjit për Ndërmjetësimin është paraparë edhe si i detyrueshëm për një kategori të caktuar të lëndëve.

Historiku

Që nga data 1 Janar 2013, pushteti gjyqësor në Kosovë ushtrohet përmes shtatë gjykatave themelore (gjykata të shkallës së parë) me degë në njëzet komuna; Gjykata e Apelit (që ka kompetencë, ndër të tjera, për të shqyrtuar dhe vendosur mbi ankesat ndaj vendimet e gjykatave themelore); dhe Gjykata Supreme, e cila përfaqëson autoritetin më të lartë gjyqësor në Kosovë. Në secilën gjykatë themelore, kryetari i gjykatës është përgjegjës për “menaxhimin dhe veprimet” e gjykatës, dhe në secilën degë të gjykatave themelore, gjyqtari mbikëqyrës i përgjigjet kryetarit përkatës të gjykatës për “veprimet” e asaj dege. Kryetari i Gjykatës së Apelit është përgjegjës për “veprimet” e asaj gjykate, ndërsa Kryetari i Gjykatës Supreme është përgjegjës për “menaxhimin dhe veprimet” e asaj gjykate.

Me shekuj, e sipas të drejtës zakonore (Kanuni i Lekë Dukagjinit) shqiptarët në përgjithësi, janë përfshirë në formën e tyre të zgjidhjes së kontesteve përmes palëve të treta, e cila përfshinte pleqtë e komunitetit. Më rishitazi, qytetarët e Kosovës kanë pasur Këshillat e Pajtimit, që kanë qenë produkt i sistemit socialist, të cilët kanë funksionuar si organe të vogla, të organizuara në nivel të Bashkësive Lokale.

Në këtë proces tradicional, i cili i ngjason arbitrazhit, pleqtë e komunitetit apo anëtarët e Këshillit të Pajtimit vizitojnë secilën familje disa herë për të dëgjuar rrëfimet e tyre para marrjes së vendimit bazuar në zakonet tradicional (Kanunin e Lekë Dukagjinit). Këshilli i Pajtimit veçanërisht është përfshirë në “gjakmarrjet” apo vrasjet nga hakmarrja. Andaj, nga ajo periudhë kohore, ZAK si ndërmjetësimi dhe arbitrazhi ka qenë pjesë tradicionale e shoqërisë dhe kulturës së Kosovës, por, kjo mënyrë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve nuk shfrytëzuar vetëm përjashtimisht në kohët e sotme.

Për herë të parë, pas luftës së fundit në Kosovë, Kuvendi i Republikës së Kosovës miratoi Ligjin për Ndërmjetësim Nr.03/L-057, në fuqi nga Marsi 2008, me të cilin është rregulluar procesi i ndërmjetësimit në përgjithësi, themelimin, organizimin dhe funksionimin e Komisionit për Ndërmjetësim, si dhe të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e ndërmjetësuesve në nivel shtetëror. Me këtë ligj është shënuar një hap i rëndësishëm në sistemin juridik të Republikës së Kosovës. Në bazë të këtij ligji, Ministria e Drejtësisë ka themeluar Komisionin për Ndërmjetësim, dhe Komisioni përbëhet prej Kryesuesit dhe katër anëtarëve.

Qendrat e ndërmjetësimit në Kosovë kanë pasur rolin kryesor në zhvillimin, promovimin dhe avancimin e procesit të ndërmjetësimit. Pas miratimit të Ligjit për ndërmjetësim, qendrat e konsoliduara të ndërmjetësimit, të cilat kanë vepruar në 6 qytete, janë mbështetur kryesisht nga donatorët e huaj, por që nuk kanë arritur të ndihmojnë në zvogëlimin e konsiderueshëm të numrit të lëndëve të pazgjidhura në gjykatat e Kosovës.

Ndonëse Kosova ka ndërmarrë shumë reforma në sistemin e drejtësisë, fatkeqësisht procedurat e ekzistuese alternative për zgjidhjen e rasteve shfrytëzohen minimalisht. Procedurat civile dhe penale marrin vite për të arritur deri te zgjidhja përfundimtare. Kjo ndikon jo vetëm në efikasitetin e sistemit në kuptim të shpenzimeve të mëdha që ndërliken me procedura të gjata, por edhe në të drejtat e palëve për gjykim të drejtë brenda një kohe të arsyeshme, ashtu siç kërkohet me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Procedurat e tejzgjatura ndikojnë negativisht në perceptimin dhe besimin e publikut në gjyqësor dhe në ekonomi. Thënë troç, investitorët e huaj nuk janë të gatshëm të investojnë në Kosovë pjesërisht për shkak të mungesës së qasjes në zgjidhje të besueshme dhe të shpejtë të kontesteve. Në raste penale, shfrytëzimi i procedurave alternative do të rriste konfiskimin e pasurive të fituara me vepër penale dhe do të jepte mundsi për të kompensuar viktimat e krimit.

Me Direktivën 2008/52/EC, të BE, shtetet anëtare të BE-së janë obliguar që të rregullojnë me ligje të veçanta çështjen e ndërmjetësimit, si instrument i rëndësishëm së veçantë, gjë që Komisioni Evropian, i ka rekomanduar edhe Republikës së Kosovës.

Si rezultat, është treguar si e nevojshme dhe e rëndësishme për të themeluar një sistem të qëndrueshëm për përdorimin e ndërmjetësimit, dhe atë në kuadër të sistemit gjyqësor, gjë që është realizuar përmes Ligjit të ri për Ndërmjetësimin, Nr. 06/L-009, në fuqi nga Gushti 2018, (i cili ka shfuqizuar ligjin e vjetër), me të cilin vëhen themele të fortë për ndërmjetësimin, si mekanizëm i qëndrueshëm, i paraparë të funksionojë edhe brenda sistemit gjyqësor.

Analizë

Ndërmjetësimi është mënyrë alternative për zgjidhjen e kontesteve ndërmjet dy apo më tepër personave/palëve, me ndihmën e ndërmjetësuesit, si palë e tretë, neutral e i paanshëm, që vetëm ndihmon ata që, përmes bisedave, të arrijnë te zgjidhja e tyre lidhur me mosmarrëveshjen që kanë në mes veti.

Pas luftës së fundit në Kosovë, mundsia e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve/kontesteve përmes ndërmjetësimit, fillimisht është paraparë me Ligjin Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, në fuqi nga Korriku 2008.

Me nenin 411 par. 1 të këtij ligji është paraparë se *“nëse gjykata e gjen të nevojshme një gjë të tillë, atëherë ajo më së voni në seancën përgatitore, duke marrë parasysh natyrën e kontestit dhe rrethanat tjera, u propozon palëve ndërgjyqëse që kontestin ta zgjidhin në procedurën e ndërmjetësimit të rregulluar me ligj të veçantë.*

Po ashtu me këtë dispozitë, par. 2, është paraparë se “ *Zgjidhjen e kontestit me anë të ndërmjetësimit mund ta propozojnë edhe vetë palët me marrëveshjen e tyre. Propozimin e këtillë palët mund ta bëjnë deri në përfundimin e seancës për shqyrtimin kryesor të çështjes*”

(Për pajtimin gjyqësor nuk do të flitet këtu).

Ka pasuar edhe Ligji për Ndërmjetësimin, Nr.03/L-057, në fuqi nga Marsi 2008, si ligj i veçantë, i cili ka filluar së zbatuari më vonë, tek në vitin 2012, e që me të njëjtin është rregulluar procesi i ndërmjetësimit në përgjithësi, pastaj themelimi, organizimi dhe funksionimi i Komisionit për Ndërmjetësim, si dhe janë paraparë të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e ndërmjetësuesve në nivel shtetëror, të cilët janë licencuar nga Ministria e Drejtësisë.

Ndërmjetësuesit e licencuar kanë funksionuar brenda Qendrave të Ndërmjetësimit në Kosovë, të financuara kryesisht nga donatorët e huaj, të cilat kanë pasur rolin kryesor në zhvillimin, promovimin dhe avancimin e procesit të ndërmjetësimit, por që këto Qendra bashkë me ndërmjetësuesit, nuk kanë arritur të ndihmojnë në zvogëlimin e konsiderueshëm të numrit të lëndëve të pazgjidhura në gjykatat e Kosovës. Këto qendra aktualisht nuk funksionojnë (në mungesë të donacioneve), por – ndërmjetësuesit janë në dispozicion.

Me Ligjin e ri për Ndërmjetësimin, Nr. 06/L-009, në fuqi nga Gushti 2018, *(i cili ka shfuqizuar ligjin e vjetër)*, vëhen themele të fortë për ndërmjetësimin, si instrument dhe mekanizëm i qëndrueshëm, që për herë të parë ka paraparë që ndërmjetësimi të funksionojë edhe brenda sistemit gjyqësor. Për herë të parë, me nenin 9 të këtij ligjit është paraparë edhe ndërmjetësimi i detyrueshëm për një kategori të caktuar të lëndëve.

Ky trajnim iu dedikohet gjyqtarëve/bashkpuntorëve profesional të cilët janë pjesë e Gjyqësorit të Kosovës, me të cilin, pas identifikimit të problemeve të gjyqësorit, me qëllim të arritjes së objektivit për “gjykimin të drejtë dhe në kohë të arsyeshme” synohet që të njëjtit të njoftohen me Ligjin për Ndërmjetësimin dhe aktet nënligjore të nxjerra nga KGJK *(Rregullorja për procedurën e Ndërmjetësimit në gjykata dhe Udhëzuesi për lëndët e përshtatshme për ndërmjetësim)*.

Tërë kjo me qëllim që gjyqtarët të kuptojnë më për së afërmi “ndërmjetësimin” - si zgjidhje alternative e mosmarrëveshjeve/kontesteve në mes palëve, procedurën, rëndësinë e të njëjtit si dhe rëndësinë e motivimit të tyre për të shfrytëzuar më shumë këtë instrument juridik duke referuar më shumë çështje të tyre në procedurë të ndërmjetësimit, me qëllimin e përbashkët që është rritja e efikasitetit në sistemin gjyqësor si për rastet civile ashtu edhe për rastet penale.

Parimet e Ndërmjetësimit

Ndërmjetësimi, si instrument juridik dhe si procedurë jo formale për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve/kontesteve bëgatton sistemin e drejtësisë, por që ka benefite të shumta edhe për palët edhe për gjykatat. Për gjykatat se shkarkon punën e gjykatave me zvogëlimin e lëndëve të prapambetura, ndërsa për palët se ju mundsohet zgjidhje më e lirë dhe më të shpejtë e çështjeve të tyre.

Ndërmjetësimi mund të zbatohet pothuajse në të gjitha procedurat apo natyrat e lëndëve: si ato civile, familjare, ekonomike-komerciale, administrative, por edhe në procedurat penale.

Parimet e Ndërmjetësimit:

- 1.Shprehja e vullnetit (të lirë) të palëve
- 2.Barazia e palëve në procedurë
- 3.Paanshmëria
- 4.Privatësia dhe Konfidencialiteti

Shprehja e Vullnetit të palëve

Parim kryesor në procedurën e ndërmjetësimit është vullneti i lirë i palëve për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në mes tyre, zgjidhje kjo që nuk mund ti imponohet nga askush, natyrisht as nga ndërmjetësuesit e çështjes. Ky parim siguron autoritetin vendimmarrës të vet palëve në kontest.

Kjo e bënë ndryshe procedurën e ndërmjetësimit nga procedura gjyqësore, ku çështja nuk zgjidhet sipas vullnetit të lirë të palëve por sipas provave dhe dispozitave imperative të ligjeve në fuqi.

Vullneti i palëve kërkohet edhe për të provuar zgjidhjen e mosmarrëveshjes në mes tyre në procedurë të ndërmjetësimit, me përjashtim të kategorisë së çështjeve për të cilat me ligj parashihet ndërmjetësimi i detyrueshëm, e që pajtimi/pëlqimi i tyre për këtë kërkohet të jetë i formës së shkruar.

Barazia e Palëve në Procedurë

Barazia e palëve në procedurë nënkupton se të dy palët që marrin pjesë në procedurën e ndërmjetësimit janë të barabarta në secilin aspekt. Kjo qoftë në pajtimin për ndërmjetësim, për zgjedhjen e ndërmjetësuesit, në aspektin e pretendimeve, në paraqitjen e provave eventuale e deri në arritjen e marrëveshjes eventuale në mes tyre.

Parimi i Barazisë palëve në procedurë të ndërmjetësimit është i njëjtë sikurse në procedurën gjyqësore, ku palët trajtohen në mënyrë të barabartë nga ana e gjykatës, pa kurrfarë diskriminimi mbi çfarë do baze, e që njësoj duhet të trajtohen edhe nga ndërmjetësuesit.

Paanshmëria dhe Pavarësia

Paanshmëria si parim, vlen edhe për ndërmjetësuesit, të cilët nuk duhet të anojnë nga asnjëra palë, por duhet të udhëhiqen nga objektiviteti i plotë, dhe në mënyrë të paanshme të menaxhojnë procedurën e ndërmjetësimit, duke lehtësuar komunikimin e palëve në mes veti, për të arritur deri të zgjidhja e tyre, përkatësisht zgjidhja e mosmarrëveshjes në mes tyre. Po ashtu, ndërmjetësuesi, duhet të jetë i pavarur dhe i pandikuar nga askush – as nga palët, as nga personat e tretë brenda apo jashtë gjykatës.

Këto dy parime janë të ndërlidhura me njëri tjetrin. Shkelja e njërit ndikon edhe në shkeljen tjetrit.

Privatësia dhe Konfidencialiteti

Ky parim i obligon si palët në kontest ashtu edhe ndërmjetësuesit, që deklaratat e dhëna në procedurë të ndërmjetësimit ti mbajnë të fshehta apo konfidenciale. Deklarimet e palëve nuk mund të shfrytëzohen në ndonjë procedurë tjetër pa pëlqimin e tyre. As vetë palët nuk mund të shfrytëzojnë deklaratat e njëra tjetrës të bëra në procedurën e ndërmjetësimit, pa pëlqimin e njëra-tjetrës, gjë që e siguron/vërteton edhe barazinë në mes tyre.

(Urgjenca nuk është e përfshirë si parim në Ligjin për Ndërmjetësim)

Urgjenca

Ky është njëri ndër adutët kryesor që shfrytëzohet nga promovuesit e ndërmjetësimit, ndërmjetësuesit, gjykatat apo institucionet tjera me rastin e propozimit të palëve në kontest që procedurën ta ndjekin apo ta vazhdojnë (nëse ka filluar në gjykatë) në procedurë të ndërmjetësimit. Për dallim kur në gjykata koha ideale për zgjidhjen e një kontesti do të ishte periudha 6 mujore e krejt kjo edhe në përputhje me Konventën Evropiane për Të Drejtat e Njeriut më konkretisht neni 6 i saj, ndërsa procedura e ndërmjetësimit duhet të përfundon brenda periudhës 90 ditore.

Në sistemin e drejtësisë në Kosovës për shkaqe tashmë të njohura që janë numri i madh i lëndëve të grumbulluara në gjykata, pastaj numrit të pamjaftueshëm i gjyqtarëve, duhet vite të tëra që një procedurë të përfundojë dhe palët të marrin një epilog ligjor, andaj ndërmjetësimi paraqet alternativë të domosdoshme për zgjidhjen e kontestit në mes palëve në kontest.

Përparësitë dhe pengesat në Ndërmjetësim

Secila metodë apo formë e zgjidhjes së kontestit në mes të palëve ka përparësitë por edhe pengesat e veta që e vështirësojnë dhe e bëjnë më të komplikuar procesin.

Ndërmjetësimi, si mënyrë alternative për zgjidhjen e kontesteve ka përparësi të shumta e që nuk kufizohet vetëm në to, si në vijim:

- procedurë më e shpejtë, më pak e kushtueshme, më pak formale dhe konfidenciale
- inkurajon dhe ndihmon palët për shkëmbimin e informatave në mjedis jo armiqësor;
- ndihmon në sigurimin e informatave të reja për palët që mund të ndihmojnë në zgjidhjen e dallimeve të tyre;
- ndihmon palët që të kuptojnë mendimet dhe vështirësitë e njëri-tjetrit;
- jep palëve mundsinë që të sigurojnë kuptimin e shqetësimeve të tyre nga homologët në kontest;
- ndihmon në promovimin e nivelit produktiv të shprehjes së vullnetit të tyre;
- merret me dallimet në perceptime dhe interesa në mes të palëve në konflikt;
- ndihmon palët që të vlerësojnë realisht alternativat e tyre në ujdë miqësore;
- inkurajon fleksibilitetin dhe ofron mundsi për zgjidhje kreative që nuk kufizohen nga mjetet ligjore të parashkruara me ligj;
- siguron autoritetin vendimmarrës të vet palëve në kontest - e jo t'ia delegojnë dikujt tjetër: arbitrazhit apo gjykatës;
- ndihmon palët që të artikulojnë më lehtë kërkesat lidhur me të drejtën në të cilën pretendojnë se iu takon;
- kalon përqendrimin e vëmendjes së palëve nga e koha e kaluar në të tashmen;
- ndihmon në zbulimin e interesave të cilat palët ngurrojnë ti shpalosin njëri-tjetrit, por që megjithatë mund të ndihmojnë në zgjidhjen e kontestit.
- ofron më shumë fleksibilitet dhe kontroll nga palët
- ruan marrëdhëniet në mes palëve
- jep rezultate më të kënaqshme për të gjitha palët

Si probleme apo pengesa në ndërmjetësim, mund të paraqiten:

- negociatat e pafund
- pandershmëria e palëve, dhe
- mungesa e mirëbesimit të palëve
- çështje shumë të komplikuar dhe shumë palë të involvuara

E drejta për të inicuar procedurën e ndërmjetësimit

Me nenin 8 të Ligjit të ri për Ndërmjetësimin është paraparë se kush mund ta iniciojë procedurën e ndërmjetësimit ku, si palë me këtë të drejtë përfshihen vetë palët, gjykata, prokuroria, apo organi kompetent administrativ sipas legjisllacionit në fuqi.

Fokusi i këtij trajnimi nuk është te rastet e Vet-referimit, kur palët para se të arrijë çështja e tyre në gjykatë kërkojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të tyre përmes ndërmjetësimit, por fokusohet

në rastet e referuara nga gjykata, për çështjet që aktualisht gjenden në gjykatë, e që kjo procedurë e ndërmjetësimit rregullohet më detaisht me akt nënligjor përkatësisht me Rregulloren e KGJK-së nr. 04/2019, e miratuar me datë 08.05.2019.

(E drejta e gjykatave për të referuar lëndë në procedure të ndërmjetësimit është paraparë me nenin 411 të LPK-së, por më detaisht është paraparë me dispozitat e Ligjit të ri për Ndërmjetësimin).

Me nenin 4 të Rregullores së KGJK-së nr. 04/2019, për procedurën e Ndërmjetësimit për lëndët e referuara nga gjykata, është paraparë mundësia e referimit të çështjes në ndërmjetësim edhe në momentin kur regjistrohet padia, si lëndë e veçantë, në seancën përgatitore ose në shqyrtimin fillestar, por edhe në çdo fazë të procedurës, pas vlerësimit të përshtatshmërisë së lëndës për tu zgjidhur në procedurë të ndërmjetësimit, natyrisht nëse me këtë pajtohen palët për rastet kur nuk parashihet ndërmjetësimi i detyrueshëm.

Kategoria e lëndëve të përshtatshme për tu zgjidhur në procedurë të ndërmjetësimit parashihet me Ligjin për Ndërmjetësim, neni 2 i tij, me të cilin përfshihen marrëdhëniet kontestuese të subjekteve të së drejtës në raportet juridiko-pasurore, tregtare, familjare, të punës, rastet tjera të kontesteve nga e drejta pronësore, siç janë të drejtat që kanë të bëjnë me fitimin e të drejtave pronësore përmes marrëdhënieve kontraktuale apo të fituara përmes trashëgimisë, procedurat e falimentimit, raporte të tjera civile, administrative dhe penale, në të cilat palët lirisht mund të disponojnë vullnetin e tyre të lirë, në rast se me ligj të veçantë nuk është paraparë përgjegjësia ekskluzive e gjykatës, prokurorisë apo e një organi tjetër kompetent.

Ndërsa, sipas këtij neni, Ndërmjetësimi në fushën penale zbatohet në rastet ku parashihet dënimi me gjobë dhe dënim me burgim deri në 3 vjet, përveq rasteve që kanë të bëjnë me dhunën në familje, në pajtim me Ligjin kundër Dhunës në Familje ose për çdo mosmarrëveshje për të cilat është paraparë përgjegjësia ekskluzive e gjykatës apo ndonjë organi tjetër kompetent. Më detaisht rastet e përshtatshme për tu zgjidhur në procedure të ndërmjetësimit janë paraparë me Udhëzuesin e KGJK-së, i datës 27.1.2020.

Ndërmjetësimi i Detyrueshëm

Me Ligjin e ri për Ndërmjetësimin për herë të parë është paraparë që ndërmjetësimi të organizohet dhe menaxhohet nga stafi i gjykatës (Referentët për ndërmjetësim) dhe të ndodhë në kuadër të gjykatës pa pasur nevojë që lëndët e gjykatës të dalin jashtë saj.

Po ashtu, për herë të parë, është paraparë “Ndërmjetësimi i Detyrueshëm”, si dhe kategoria e lëndëve për të cilat duhet domosdoshmërisht të provohet ndërmjetësimi.

Me nenin 9 të këtij Ligji, paragrafi 1 dhe 2 i tij, ndërmjetësimi i detyrueshëm është paraparë për rastet kur:

- *”palët parashetrojnë kërkesëpadi në gjykatë, për kontestet nga marrëdhëniet familjare lidhur me rastet nga alimentacioni, kujdestaria, kontaktet, mbajtja e fëmijës dhe ndarjen e pronës së përbashkët martesore, gjyqtari në seancën përgatitore dhe pas shqyrtimit paraprak të padisë, duhet të informojë dhe obligojë palët në procedurën e ndërmjetësimit”, si dhe*
- *“kur palët parashetrojnë kërkesëpadi në gjykatë, për kontestet pronësore që kanë të bëjnë me të drejtat dhe detyrimet nga të drejtat e servituteve, dhe kompensimi i pronës së shpronësuar, gjyqtari në seancën përgatitore dhe pas shqyrtimit paraprak të kërkesëpadisë, detyrohet të informojë dhe udhëzojë palët në procedurën e ndërmjetësimit.”*

Me këtë dispozitë janë përcaktuar edhe afatet për fillimin e procedurës së ndërmjetësimit të detyrueshëm. Ata duhet të takohen me ndërmjetësuesin dhe kanë tridhjetë (30) ditë kohë për të provuar fillimin e ndërmjetësimit, duke filluar nga dita kur gjyqtari i obligon palët të provojnë ndërmjetësimin.

Palët mund të mos vazhdojnë me procedurën e ndërmjetësimit dhe mund të kthehen në procedurën gjyqësore, jo më gjatë se tridhjetë (30) ditë, por para se të kthehet rasti i tyre në procedurë gjyqësore, ata duhet të prezantojnë dëshmi të shkruar, të nënshkruar nga palët dhe ndërmjetësuesi, se kanë provuar ndërmjetësimin.

Ndërmjetësimi i detyrueshëm nuk ua mohon të drejtën e palëve qasjes në gjykatë apo në procedurën e arbitrazhit, nëse nuk arrihet marrëveshje në procedurë të ndërmjetësimit.

Çka nënkupton “ndërmjetësim i detyrueshëm”

Nga vet emërtimi kemi të bëjmë me ndërmjetësim që nuk varet nga vullneti i palëve për të provuar procedurën e ndërmjetësimit, e as nga vlerësimi i Gjykatës, sepse dispozita e nenit 9 e Ligjit për Ndërmjetësimin – është dispozitë imperative dhe obligon edhe palët edhe gjykatën për kategorinë e çështjeve të caktuara me këtë nen.

Ky nen nuk obligon palët që të zgjidhin çështjen e tyre domosdoshmërisht në procedurë të ndërmjetësimit por obligon ata që çështjen të provojnë ta zgjidhin në këtë procedurë, dhe në asnjë mënyrë nuk iu mohon atyre të drejtën që çështja e tyre të vazhdojë të shqyrtohet në procedurë të rregullt gjyqësore.

Shkakton dilema në interpretim paragrafi 1 dhe 2 i nenit 9 të Ligjit për ndërmjetësimin. Me paragrafin 1, parashihet se:

- për kontestet nga marrëdhëniet familjare lidhur me rastet nga alimentacioni, kujdestaria, kontaktet, mbajtja e fëmijës dhe ndarjen e pronës së përbashkët martesore, gjyqtari në seancën përgatitore dhe pas shqyrtimit paraprak të padisë, duhet të informojë dhe obligojë palët në procedurën e ndërmjetësimit,
- ndërsa me paragrafin 2, për kontestet pronësore që kanë të bëjnë me të drejtat dhe detyrimet nga të drejtat e servituteve, dhe kompensimi i pronës së shpronësuar,

gjqytari në seancën përgatitore dhe pas shqyrtimit paraprak të kërkesëpadisë, detyrohet të informojë dhe udhëzojë palët në procedurën e ndërmjetësimit.”

Sidoqoftë në të dyja rastet bëhet fjalë për ndërmjetësim të detyrueshëm, për faktin se neni 9 i referohet pikërisht “ndërmjetësimit të detyrueshëm”, dhe për shkak se ky nen nuk përmban ndonjë dispozitë përjashtuese nga ky rregull.

Çështjet tjera, mbesin në diskrecion dhe varen nga vullneti i palëve për të provuar apo jo zgjidhjen e çështjes në procedurë të ndërmjetësimit.

Ligji i Procedurës Kontestimore, në fuqi nga viti 2008, me nenin 411 ka paraparë mundësinë e gjykatave, që t’iu propozojnë palëve ndërgjyqëse që kontestin e tyre ta zgjidhin në procedurë të ndërmjetësimit, por edhe mundësinë e palëve që ata vet të propozojnë që çështja e tyre të zgjidhet përmes ndërmjetësimit të rregulluar me ligj të veçantë, por që ligji i veçantë (i vjetri) për ndërmjetësimin Nr.03/L-057, për shkaqe të ndryshme (?), ka filluar të zbatohet tek në vitin 2012, përkundër faktit se daton nga viti 2008.

Kosova nuk ka traditë formale sa i përket shfrytëzimit të ndërmjetësimit, si zgjidhje alternative e mosmarrëveshjeve/kontesteve, sepse rastet e para të referimit në procedurën e ndërmjetësimit, në kohën e pas luftës kanë filluar tek në vitin 2012, pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Ndërmjetësim Nr.03/L-057, në fuqi nga Marsi 2008, me të cilin është rregulluar procesi i ndërmjetësimit në përgjithësi, themelimi, organizimi dhe funksionimi i Komisionit për Ndërmjetësim, si dhe të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e ndërmjetësuesve në nivel shtetëror, dhe pas konsolidimit të Qendrave të Ndërmjetësimit të cilat kanë qenë të varura kryesisht nga donatorët e huaj, ndërsa brenda gjykatave nuk ka qenë e paraparë të ndodhë ndërmjetësimi, gjë që parashihet me Ligjin e ri për Ndërmjetësimin.

Ndërmjetësimi në përgjithësi e as ndërmjetësimi i detyrueshëm, në veçanti, nuk iu mohon palëve të drejtën e qasjes në gjykatë apo në procedurën e arbitrazhit, nëse nuk arrihet marrëveshje në procedurë të ndërmjetësimit, lënda dërgohet prapë në gjykatë apo në arbitrazh. Palët nuk janë të obliguara të arrijnë marrëveshje përmes ndërmjetësimit, pa vullnetin e tyre të lirë. Në këtë rast gjyqtaret janë të obliguar që të aplikojnë këtë dispozitë e cila i obligon ata që rastet e lartpërmendura apo rastet që parashihen të dërgohen në ndërmjetësimin detyrueshëm ti njoftojnë palët për këtë mundsi dhe obligim ligjor si dhe mos të vazhdojnë më shqyrtimin e këtyre lëndëve pa ofruar dëshmi të shkruar nga ana e palëve se kanë provuar ndërmjetësimin për zgjidhjen e kontestit të tyre.

Roli dhe rëndësia e gjyqtarit në zhvillimin e ndërmjetësimit

Sistemi gjyqësor dhe gjyqtari, si pjesë e këtij sistemi, pa përjashtuar edhe stafin tjetër kompetent të gjykatave, kanë rol të rëndësishëm në zhvillimin dhe avancimin e zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve në përgjithësi, e ndërmjetësimit në veçanti. Për rëndësinë e kësaj metode gjyqtari apo edhe stafi tjetër kompetent i gjykatës, kanë tagër apo autorizim t’iu japin shpjegime

të hollësishme palëve, kur gjejnë se mosmarrëveshja e tyre ka elemente që e bëjnë të besueshëm faktin se çështja e tyre është e përshtatshme dhe e mundshme të zgjidhet me ndërmjetësim.

Gjyqtari ka rol qenësor në rastin me rastin e ekzaminimit të marrëveshjes së arritur në mes palëve, të hartuar nga ndërmjetësi, sepse gjyqtari është faktori personi i cili i jep dritën jeshile, fuqizimit e më pas edhe zbatimit të saj, pasi që paraprakisht të vlerësoj se ajo përmban elementet e duhura, a është e përshtatshme për përmbarrim dhe a është në pajtim me ligj dhe nëse eventualisht ka të bëjë me disponimet e lejuara të palëve.

Mundësia e referimit ex-officio i çështjeve në ndërmjetësim nga ana e gjyqtarit, sipas nenit 9 të Ligjit për Ndërmjetësimin, fuqizon edhe më shumë gjyqtarët por edhe këtë instrument ligjor, duke e veshur me petkun e rëndësisë së veçantë, si kredibil dhe i dobishëm për gjyqësorin dhe palët, e në të kundërtën - injorimi i këtij instrumenti do të shkaktonte jo vetëm dështimin e tij por edhe dështimin e gjyqtarëve e gjykatave në përmbushjen e objektivave të tyre dhe në përmbushjen e nevojave të palëve që i adresohen gjykatave.

Se sa i rëndësishëm është roli i gjykatës më konkretisht roli i gjyqtarit në referimin e rasteve në ndërmjetësim, në fuqizimin e të njëjtit e vërteton edhe Udhërrëfyesi apo Udhëzimi i Komisioni Evropian për Efikasitet në Drejtësi i cili në pikën 1.2 në mënyrë shprehimore përmend rolin e gjyqtarit ku në fjalinë e parë thekson: “Gjyqtari ka rolë të rëndësishëm në zhvillimin e ndërmjetësimit”. Më tutje thekson se gjyqtari do të duhej të ishte në gjendje që përmes sesioneve këshilluese t’ua sqaronte çështjet që kanë të bëjnë me ndërmjetësimin palëve si dhe t’i inkurajoj palët që problemet e tyre t’i zgjidhin përmes ndërmjetësimit.

Kjo vë në pah rolin pro aktiv të gjyqtarit në raport me ndërmjetësimin, i cili rol në Kosovë ende është në nivel të ultë dhe len shumë për tu dëshiruar, sepse statistikat e rasteve të referuara nga gjykatat, sidomos për lëndë civile/familjare, përkundër dispozitave imperative të Ligjit për Ndërmjetësimin, tregojnë se në përgjithësi, ky instrument ende nuk përfillet sa duhet nga gjykatat, edhe pse përdorimi i kësaj metode do të ndikonte dukshëm dhe pa dyshim në zvogëlimin e lëndëve të grumbulluara në gjykata, në ofrimin e drejtësisë në kohë dhe në mënyrë efikase, por edhe në promovimin dhe fuqizimin e ndërmjetësuesve.

Natyra e rasteve civile që mund të zgjidhen përmes ndërmjetësimit

Me neni 2 par. 1 të Ligji Nr. 06/L-009 për Ndërmjetësimin, është paraparë se ky ligj zbatohet në çështjet/marrëdhëniet kontestuese të subjekteve të së drejtës në raportet juridiko-pasurore, tregtare, familjare, të punës, rastet tjera të kontesteve nga e drejta pronësore, siç janë të drejtat që kanë të bëjnë me fitimin e të drejtave pronësore përmes marrëdhënieve kontraktuale apo të fituara përmes trashëgimisë, procedurat e falimentimit, raporte të tjera civile, administrative dhe penale, në të cilat palët lirisht mund të disponojnë vullnetin e tyre të lirë, në rast se me ligj të veçantë nuk është paraparë përgjegjësia ekskluzive e gjykatës, prokurorisë apo e një organi tjetër kompetent.

Me paragrafin 2 është paraparë që Ndërmjetësimi zbatohet edhe në fushën penale, në rastet ku parashihet dënimi me gjobë dhe dënimi me burgim deri në tri (3) vjet, përveç rasteve të parapara në paragrafin 3. të këtij neni.

Paragrafi 3 i këtij neni është dispozitë përjashtuese me të cilën përjashtohet ndërmjetësimi për rastet që kanë të bëjnë me dhunën në familje, në pajtim me Ligjin kundër Dhunës në Familje dhe për çdo mosmarrëveshje për të cilat është paraparë përgjegjësia ekskluzive e gjykatës apo ndonjë organi tjetër kompetent. Ka karakter përjashtues edhe një pjesë e paragrafit 1 të nenit aktual, me të cilin përjashtohet ndërmjetësimi për çështjet/kërkesat me të cilat palët nuk mund të disponojnë me vullnetin e tyre të lirë, gjë që e ka përmend ligjdhënësi në nenin 3.3 të LPK-së, pra për të drejta që janë në kundërshtim me dispozitat ligjore, rregullat e moralit publik dhe rendin juridik.

Me Udhëzuesin e KGJK-së, i datës 27.1.2020, janë listuar llojet e lëndëve të gjykatave të përshtatshme për ndërmjetësim, nga të gjitha fushat, si orientim për gjyqtarët dhe stafin tjetër të gjykatave për identifikimin më të lehtë të kontesteve të përshtatshme për tu zgjidhur në procedurë të ndërmjetësimit, si dhe kategoria e lëndëve të tjera për të cilat parashihet ndërmjetësimi i detyrueshëm.

Procedura e Ndërmjetësimit

Në Ligjin për Ndërmjetësimin nuk jepen shumë detaje se si zhvillohet procedura e ndërmjetësimit, gjë që është lënë në diskrecion të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për lëndët që referohen nga gjykatat, dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës, për rastet që referohen nga prokuroritë - të rregullohet me akte nënligjore të tyre. Ndërsa për rastet e vet-referimit dhe rastet e referimit nga organi administrativ kjo i është lënë Ministrisë së Drejtësisë (*neni 8 i Ligjit për Ndërmjetësimin*).

KGJK, ka nxjerrë Rregulloren për Ndërmjetësimin, e cila është në dispozicion të gjykatave, me të cilën më detajisht rregullohet procedura e ndërmjetësimit, nga momenti i referimit të lëndës në procedurë të ndërmjetësimit e deri në përfundimin e saj, bashkë me aneks-formularët e ndryshëm me të cilët lehtësohet puna e gjyqtarëve, referentëve për ndërmjetësim dhe ndërmjetësuesve.

Referimi i lëndëve në procedurë të ndërmjetësimit

Me nenin 8, paragrafi 1 i Ligjit për Ndërmjetësimin, është paraparë e drejta e inicimit të procedurës së ndërmjetësimit nga palët, gjykata, prokuroria apo organi kompetent administrativ sipas legjislacionit në fuqi.

Ndërsa Rregullorja e KGJK-së për Ndërmjetësimin ka paraparë hapat dhe veprimet që duhet të ndërmerren në procedurën e ndërmjetësimit për lëndët e referuara nga gjykata, nga fillimi i saj e deri në marrëveshjen e arritur në mes palëve në kontest, por që nuk është paraparë që marrëveshja të arrihet domosdoshmërisht në këtë procedurë.

Me nenin 4 të kësaj Rregullore është paraparë mënyra e referimit të çështjeve në procedurë të ndërmjetësimit që nga Zyra për pranimin e parashtresave në gjykatë, në momentin e regjistrimit të lëndës sipas padisë së palës, me ç'rast zyrtari për pranimin e parashtresave, pas vlerësimit të përshtatshmërisë së lëndës, i informon palën paditëse kur dorëzon padinë për mundsinë e zgjidhjes së çështjes në ndërmjetësim, e nëse më këtë ai pajtohet, situata plotësohet me veprimet e duhura në vijim të cilat duhet ti ndërmarrë referenti i ndërmjetësimit për të njoftuar edhe palën e paditur.

Edhe gjyqtari në seancën përgatitore ose në shqyrtimin fillestar, pas vlerësimit të përshtatshmërisë së lëndës, informon palët se kanë mundsi që mosmarrëveshjen ta zgjidhin përmes ndërmjetësimit.

Për të provuar procedurën e ndërmjetësimit duhet të merret pëlqimi i palëve në kontest, me përjashtim të rasteve për të cilat parashihet ndërmjetësimi i detyrueshëm, ku nuk kërkohet ky pëlqim, por asnjërës kategori nga askush nuk mund t'iu imponohet zgjidhja e çështjes në procedurë të ndërmjetësimit ngase kjo varet ekskluzivisht nga vullneti i palëve.

Referimi i lëndëve në ndërmjetësim të detyrueshëm

Për lëndët nga neni 9 i Ligjit për Ndërmjetësimin, që përmenden edhe në nenin 3 paragraf 2 të kësaj Rregullore së KGJK-së për Ndërmjetësimin, parashihet ndërmjetësimi i detyrueshëm, ku përfshihen kontestet nga marrëdhëniet familjare, lidhur me rastet nga alimentacioni, kujdestaria, kontaktet dhe mbajtja e fëmijës, ndarja e pronës së përbashkët martesore, kontestet pronësore që kanë të bëjnë me të drejtat dhe detyrimet nga të drejtat e servituteve dhe kompensimi i pronës së shpronësuar.

Gjyqtari pas shqyrtimit paraprak të padisë, në seancën përgatitore, njofton dhe obligon palët që të provojnë ndërmjetësimin, dhe merr vendim për referimin e lëndës në ndërmjetësim ndërsa palët udhëzohen ta bëjnë përzgjedhjen e ndërmjetësuesit dhe lënda i dërgohet referentit për ndërmjetësim. Palët duhet të takohen me ndërmjetësuesin dhe kanë tridhjetë (30) ditë kohë për të provuar fillimin e ndërmjetësimit, duke filluar nga dita kur gjyqtari i obligon palët të provojnë ndërmjetësimin.

Palët mund të mos vazhdojnë me procedurën e ndërmjetësimit dhe mund të kthehen në procedurën gjyqësore, jo më gjatë se tridhjetë (30) ditë, por para se të kthehet rasti në procedurë gjyqësore, ata duhet të prezantojnë dëshmi të shkruar, të nënshkruar nga palët dhe ndërmjetësuesi, se kanë provuar ndërmjetësimin.

Ndërmjetësimi i detyrueshëm nuk iu imponon palëve që domosdoshmërisht çështjen e tyre ta zgjidhin në procedure të ndërmjetësimit, pa vullnetin e lire të tyre të lire, e as nuk iu mohon drejtën që kontestin e tyre të vazhdojnë ta zgjidhin në procedurë të rregullt gjyqësore.

Pëlqimi për procedurën e ndërmjetësimit

Palët të cilat pajtohen ta përdorin procedurën e ndërmjetësimit fillimisht duhet të nënshkruajnë marrëveshjen për fillimin e procedurës së ndërmjetësimit, e që procedura e ndërmjetësimit konsiderohet e filluar në momentin kur palët nënshkruajnë këtë marrëveshje. Se çka duhet të përmbajë kjo marrëveshje është e paraparë me nenin 11, par. 3 të Ligjit për Ndërmjetësimin si dhe me nenin 9 të Rregullores së KGJK-së për Ndërmjetësimin. *(emrat e palëve në procedurë dhe përfaqësuesit e tyre; objektin e ndërmjetësimit; deklaratën e pranimit të ndërmjetësimit; si dhe shpenzimet e procedurës së ndërmjetësimit dhe tarifën e ndërmjetësuesit).*

Përrjashtim bënë ndërmjetësimi i detyrueshëm ku nuk kërkohet pëlqimi i palëve për ta provuar procedurën e ndërmjetësimit, por vetëm vendimi i gjyqtarit më të cilin ai i orienton palët për ta provuar këtë procedurë për zgjidhjen e kontestit në mes tyre.

Menaxhimi i lëndës së referuar nga gjykata

Me nenin 6 të Rregullores së KGJK-së për Ndërmjetësimin, përgjegjësia për të menaxhuar me e lëndët e referuara nag gjykata në procedure të ndërmjetësimit, menaxhon referenti për ndërmjetësim, i cili duhet të ndërmarrë veprimet si në vijim:

- a. E regjistron lëndën e referuar në Regjistrin e Lëndëve të Ndërmjetësimit me numër referues të ndërmjetësimit (Nd.nr.--/---);
- b. Kontakton palët në bazë të informacioneve kontaktuese që gjenden në shkresat e lëndës, për ditën në të cilën mund të vijjnë për përzgjedhjen e ndërmjetësuesit. Nëse palët nuk dëshirojnë ta përzgjedhin vet ndërmjetësuesin, referenti cakton ndërmjetësuesin sipas radhës së listës së ndërmjetësuesve që mbulojnë rajonin e asaj gjykate. Nëse palët kanë përzgjedhur ndërmjetësuesin më herët, referenti i njofton palët për kohën e mbajtjes së seancës së ndërmjetësimit;
- c. informon palët për procedurën, parimet, afatin ligjor, efektin juridik të marrëveshjes dhe informata tjera plotësuese
- d. Menaxhon me lëndët dhe orarin e seancave të ndërmjetësimit;
- e. Harton raportin mujor lidhur me ecurinë e lëndëve të referuara në ndërmjetësim dhe kujdeset për çështje tjera administrative që ndërlidhen me ndërmjetësim.

Në vijim, me nenin 7 të kësaj Rregullore, Referenti për ndërmjetësim iu ofron palëve mundsinë e përzgjedhjes së ndërmjetësuesit nga lista e ndërmjetësuesve të licencuar nga Ministria e Drejtësisë, kontakton ndërmjetësuesin e përzgjedhur nga palët i cili duhet ta konfirmojë angazhimin e tij në lëndën e referuar brenda afatit prej tri (3) ditëve, në të kundërtën referenti do të kontaktojë ndërmjetësues tjetër, i cili po ashtu duhet ta konfirmoj angazhimin e tij brenda afatit prej tri (3) ditësh nga dita e thirrjes, në të kundërtën vet referenti cakton ndërmjetësues tjetër sipas radhës nga

lista e ndërmjetësuesve të rajonit që mbulon ajo gjykatë. Palët mund të angazhojnë dy ndërmjetësues në procesin e ndërmjetësimit (bashkë ndërmjetësim).

Fillimi i procedurës së ndërmjetësimit

Sipas nenit 8 të Rregullores përkatëse konsiderohet e filluar procedura e ndërmjetësimit nga data kur palët nënshkruajnë marrëveshjen me shkrim për fillimin e procedurës së ndërmjetësimit, dhe kanë 90 ditë për të arritur marrëveshje.

Me këtë nen është paraparë se, para se të fillojë procedura e ndërmjetësimit, ndërmjetësuesi duhet t'i informojë palët për parimet, rregullat, shpenzimet e procedurës dhe efektet juridike të marrëveshjes.

Zhvillimi i Procedurës së Ndërmjetësimit

Me nenin 12 të Ligjit për Ndërmjetësimin është paraparë se, kur palët pajtohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen e tyre përmes ndërmjetësimit, referenti për ndërmjetësim e informon gjyqtarin e çështjes (organin iniciues), duke ia dorëzuar një kopje të marrëveshjes së nënshkruar për fillimin e procedurës së ndërmjetësimit, me ç' rast gjyqtari pezullon procedurën, deri sa të kalojë afati i ndërmjetësimit.

Nga ana tjetër palët, para ndërmjetësuesit janë të obliguara që gjatë procedurës së ndërmjetësimit, të prezantojnë në mënyrë më reale dhe të vërtetë rrethanat e rastit kontestues. Procedura e ndërmjetësimit zhvillohet nga një ndërmjetësues i vetëm, përveç në rastet kur palët pajtohen të kenë edhe një bashkë ndërmjetësues.

Në procedurë të ndërmjetësimit, personat fizik duhet të jenë të pranishëm personalisht, apo të autorizuarit e tyre, por mund të marrin pjesë edhe përmes teknologjisë informative, sikurse edhe personat juridik të cilët duhet të jenë të përfaqësuar nga përfaqësuesi i tyre i autorizuar. Përveç palëve, përfaqësuesve të tyre dhe ndërmjetësuesit, në procedurën e ndërmjetësimit mund të marrin pjesë edhe pala e tretë, pas pëlqimit paraprak të palëve në procedurë, por që është e detyruar ta respektoj parimin e fshehtësisë së procedurës.

Përfundimi i procedurës së ndërmjetësimit

Me nenin 16 të Ligjit për Ndërmjetësim, sikurse edhe me nenin 16 të rregullores së KGJK-së, është paraparë se procedura e ndërmjetësimit përfundon me:

- 1.1. arritjen e marrëveshjes në mes të palëve,*
- 1.2. mosarritjen marrëveshjes në mes palëve brenda afatit ligjor,*
- 1.3. tërheqjen e cilësdo palë, në çfarëdo kohe gjatë zhvillimit të procedurës dhe për shkak të mungesës së interesit juridik për vazhdimin e mëtejshëm të procedurës së ndërmjetësimit*
- 1.4. kur ndërmjetësuesi vlerëson se vazhdimi i procedurës nuk është i arsyeshëm dhe*
- 1.5. për arsyt e njëjta të përfundimit të procedurës- sikurse në procedure gjyqësore.*

Sipas nenit 13 të Rregullores përkatëse, kur palët arrijnë marrëveshje, ndërmjetësuesi harton marrëveshjen me shkrim të cilën duhet ta nënshkruajnë palët dhe ndërmjetësuesi, e që kjo . marrëveshje është e detyrueshme për palët vetëm për objektin e marrëveshjes, por në raste të veçanta ka efekt juridik edhe ndaj personave të tretë dhe “*erga omnes*”

Në frymën e parimeve bazë të ndërmjetësimit me këtë nen parashihet se marrëveshja në ndërmjetësim arrihet dhe varet ekskluzivisht vetëm nga vullneti i lirë i palëve.

Të gjitha marrëveshjet e arritura në mes palëve në procedurë të ndërmjetësimit duhet të jenë në pajtim legjislacionin në fuqi dhe të përshtatshme për përmbartim.

Marrëveshja e ndërmjetësimit

Qëllimi i ndërmjetësimit është arritja e marrëveshjes në mes të palëve në konflikt, përmes të cilës konflikti në mes tyre të zgjidhet. Marrëveshja e arritur në ndërmjetësim duhet të hartohet në formë të shkruar , dhe e nënshkruar nga palët dhe ndërmjetësuesi i angazhuar në çështjen konkrete.

Marrëveshja nuk duhet të bie ndesh me ligjet në fuqi e as me nenin 3.3 të LPK-së dhe duhet ta pasqyroj vullnetin e lirë të palëve.

Me nenin 14 të Rregullores përkatëse të KGJK-së, është paraparë se, marrëveshja definitive e ndërmjetësimit duhet të përmbajë të dhënat si në vijim:

- 1.1 emrin e gjykatës,*
- 1.2 emrat e palëve në procedurë dhe emrat e të autorizuarve/përfaqësuesve të tyre (nëse kanë)*
- 1.3 emrin e ndërmjetësuesit/ve,*
- 1.4 tekstin e marrëveshjes së arritur lidhur me objektin e ndërmjetësimit,*
- 1.5 nënshkrimet e palëve dhe të ndërmjetësuesit/ve,*
- 1.6 datën dhe vendin e lidhjes së marrëveshjes,*
- 1.7 miratimi nga ana e gjyqtarit (me aktvendim të posaçëm apo me vendosjen e vulës së gjykatës).*

Jo gjithmonë procedura e ndërmjetësimit përfundon me marrëveshje të arritur në mes palëve lidhur me objektin e kontestit. Kjo për shkak të tërheqjes së cilësdo palë, e në çfarëdo kohe gjatë zhvillimit të procedurës dhe për shkak të mungesës së interesit juridik për vazhdimin e mëtejshëm të procedurës së ndërmjetësimit

Procedura e ndërmjetësuesi përfundon pa marrëveshje në mes palëve edhe në rastet kur ndërmjetësuesi vlerëson se vazhdimi i procedurës nuk është i arsyeshëm për shkaqe të ndryshme të cilat mund të jenë të ndryshme si dhe për arsyet e njëjta të përfundimit të procedurës- sikurse në procedure gjyqësore.

Efekti juridik i marrëveshjes së arritur në ndërmjetësim

Për tu fuqizuar dhe për të fituar e prodhuar efekt të plotë juridik, sipas nenit 17 të Rregullores së KGJK-së për Ndërmjetësimin, marrëveshja e arritur në ndërmjetësim duhet ti dërgohet gjyqtarit të çështjes - për miratim, i cili pas vlerësimit se marrëveshja i plotëson kriteret e parapara me legjislacionin në fuqi, me aktvendim të veçantë apo me vendosjen e vulës së gjykatës (bashkë me nënshkrimin e tij), e miraton të njëjtën, pas çka ajo e fiton fuqinë e vendimit të formës së prerë dhe pas kësaj fiton edhe fuqinë e dokumentit përmbarues, në kuptim të dispozitave ligjore në fuqi përfshirë këtu edhe dispozitat e Ligjit për Procedurën Përmbarimore, e që e njëjta, e verifikuar, iu dorëzohet palëve.

Ndërsa, klauzola e përmbarueshmërisë në marrëveshje vendoset sipas të njëjtave rregulla si në vendime të gjykatës.

Nëse gjyqtari gjen se marrëveshja e arritur me ndërmjetësim është lidhur në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe kur pala dëshmon-argumenton se e njëjta është lidhur pa vullnetin e lirë dhe të plotë të saj, ai me aktvendim të veçantë anulon të njëjtën, i cili ju dërgohet palëve.

Kundër marrëveshjes së arritur në ndërmjetësim, palët nuk kanë të drejtë ankese, por mund të kërkojnë prishjen apo anulimin e saj, vetëm me padi të veçantë në procedurë të veçantë gjyqësore, ku vendoset sipas dispozitave të Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore.

Nëse palët nuk mund të arrijnë marrëveshje brenda 90 ditëve, por ndërmjetësuesi vlerëson se marrëveshja mund të arrihet, atëherë ky i fundit me kërkesë të arsyetuar i drejtohet gjyqtarit që e ka referuar lëndën, për t'i lejuar një afat shtesë dhe të fundit prej tridhjetë (30) ditëve për zgjidhjen definitive të mosmarrëveshjes-kontestit në mes palëve. Gjyqtari mund ta lejojë afatin e tillë shtesë, nëse nga kjo kohë shtesë nuk shkaktohen pasoja ligjore në humbjen ose fitimin e të drejtave për njëërën palë.

Përfundimi

Ndërmjetësimi ofron një qasje të dobishme alternative për zgjidhjen efikase të një numri të konsiderueshëm të rasteve. Për rastet që referohen nga gjykatat në ndërmjetësim, suksesi në

zgjdhjen e kërkesave ka qenë përgjithësisht i madh, duke shkuar nga 60% deri në 90%. Vlerësimi i ndërmjetësimit në vendet tjera tregon që palët që zgjidhin rastet e tyre përmes ndërmjetësimit kanë shkallë më të lartë të kënaqshmërisë me zgjidhjen. Shpesh, ndërmjetësimi adreson shkaqet e thella të kontestit, gjë që në anën tjetër mund të shmangë konfliktet tjera ndërmjet palëve me marrëdhënie të vazhdueshme.

Kryetarët e Gjykatave theksojnë që ndërmjetësimi ka tashmë pranueshmëri më të madhe, si dhe sukses më të madh, kur ndërmjetësimi bëhet në hapësirat e gjykatës. Ata kanë theksuar që palët kanë më shumë gjasë t'i japin legjitimitet procesit të ndërmjetësimit kur ai kryhet në hapësirat e gjykatës, kështu duke qenë më të gatshme që të pajtohen për ndërmjetësimin, si edhe kanë më shumë gjasë të marrin pjesë në mënyrë aktive në procesin e ndërmjetësimit kur rasti i tyre referohet tek ndërmjetësimi.

Ndikimi i mundshëm pozitiv i ndërmjetësimit në zgjidhjen e rasteve megjithatë ka qenë i kufizuar, pjesërisht për shkak të numrit të vogël të referimeve të rasteve. Numri i vogël i referimeve ka të bëjë me disa faktorë, përfshirë këtu ngurrimin e palëve që të marrin pjesë në ndërmjetësim (sidomos kur ndërmjetësimi bëhet jashtë gjykatës), mungesën e trajnimit të gjyqtarëve dhe administratorëve për procesin e ndërmjetësimit, duke çuar kështu në nivele të ulëta të referimit, si dhe tek mungesa e hapësirave adekuate brenda gjykatave për kryerjen e ndërmjetësimit.

Ka pasur përkrahje të konsiderueshme për zbatimin e ndërmjetësimit në Kosovë, nga donatorë të ndryshëm ndërkombëtarë, siç përmenden më lart (USAID, UNDP, CSSP). Në bazë të Ligjit për Ndërmjetësimin, parametrat e përgjithshëm për procesin e ndërmjetësimit janë krijuar, ndërsa janë bërë edhe veprime për trajnimin dhe certifikimin e ndërmjetësve. Mbikëqyrja e këtyre çështjeve është mandat i Komisionit të Ndërmjetësimit, që është themeluar me ligj brenda Ministrisë së Drejtësisë. Megjithatë, që ndërmjetësimi të bëhet mënyrë efektive e zgjidhjes së kontesteve gjyqësore, Këshilli duhet të artikulojë përkrahjen formale për shfrytëzimin e vazhdueshëm të ndërmjetësimit si mënyrë alternative e zgjidhjes së rasteve që janë parashtruar në gjykata. Mënyra më efektive do të ishte implementimi i një pilot-projekti ndërmjetësimi në Gjykatën Themelore të Prishtinës, pasuar me implementimin e politikave në të gjithë Kosovën për shfrytëzimin e ndërmjetësimit për zgjidhjen e rasteve gjyqësore.

Nuk ka synim që pilot-projekti të ndikojë apo të ndërhyjë në rolin e MD-së apo të Komisionit të Ndërmjetësimit në vendosjen e parametrave të procesit të ndërmjetësimit, apo trajnimin, certifikimin dhe disiplinimin e ndërmjetësve. Në vend të këtij, projekti ka për qëllim të sigurojë shfrytëzim maksimal të ndërmjetësimit në zgjidhjen e rasteve si mënyrë për rritjen e efikasitetit të gjykatave dhe rritjes së kënaqshmërisë së palëve me zgjidhjen e atyre rasteve. Projekti do të fokusohet tek metodat për identifikimin e hershëm të rasteve të mundshme për ndërmjetësim, inkurajimin e palëve për të shfrytëzuar procesin e ndërmjetësimit (sa më herët që është e mundur në procesin e menaxhimit të rastit), trajnimin e gjyqtarëve mbi dobinë e ndërmjetësimit si mënyrë e zgjidhjes së rasteve, si dhe për menaxhimin e procesit të referimit të rasteve.

PROCEDURA PËRMBARIMORE

Hyrje

Procedura përmbartimore është procedurë e veçantë, përmes së cilës realizohet ekzekutimi i kërkesave të palëve në procedurë e të cilat derivojnë nga një raport juridik i konstatuar në një dokument përmbartimor. Procedura përmbartimore është faza e fundit e procedurës, kur pala kërkon realizimin e të drejtës së tij në mënyrë të dhunshme apo të detyrueshme përmes shfrytëzimit të mekanizmit ligjor.

Vendimmarrja e gjykatës, e ka për qëllim vendosjen e rendit dhe sigurimin e kërkesave të palëve, mirëpo një vendimmarrje e tillë nëse nuk arrihet të realizohet në praktikë por vetëm mbetet në letër, nuk është asgjë tjetër përveç letër me dëshira. Ligdhënësi ka paraparë mjete dhe mekanizma se si palët mund ti realizojnë të drejtat e tyre në një procedurë të veçantë siç është procedura përmbartimore.

Përmbartimi me të drejtë njihet si faza e fundit e një procesi gjyqësor, pasi pas kësaj faze pala realizon të drejtën e vet të paraparë me një dokument përmbartimor apo një dokument të besueshëm, i cili dokument ia njeh një të drejtë.

Përmbartimi paraqet fazën e fundit, nëse pala nuk ka mundsi që pa procedurë ta realizon të drejtën e tij/saj, pra përmes realizimit vullnetar nga ana e palës tjetër. Nuk është e thënë se secila lëndë gjyqësore e përfunduar me një aktgjykim apo aktvendim, duhet medoemos të kaloj nëpër stadin e procedurës përmbartimore. Pas përfundimit të një procedure gjyqësore, apo pas dërgimit të një dokumenti të besueshëm si faturë apo dokument tjetër, pala e cila ka një detyrim të paraparë me atë dokument, ka garancion që nëse e realizon në mënyrë vullnetare një gjë të tillë pas njoftimit për detyrim, në raport me të nuk do të iniciohet asnjë procedurë përmbartimore.

Përmbartimi si procedurë fillohet dhe zhvillohet vetëm në rastet kur në asnjë mënyrë tjetër pala nuk mund ta realizojë të drejtën e tij, përndryshe, numri i madh i lëndëve përmbartimore, nuk është i tillë në secilin shtet, por kjo dallon pastaj nga niveli i zhvillimit shoqëror, perceptimi dhe besueshmëria e qytetarëve në sistem e tutje.

Matja e performancës së sistemit të drejtësisë bëhet duke marrë për bazë përmbartimin e vendimeve gjyqësore apo ekzekutimit të tyre, përndryshe nuk do të kemi drejtësi efektive Pamundsia, vonesa apo pengesat e ndryshme në procedurën përmbartimore me të drejtë nga të gjithë do të vlerësohen si dështim i sistemit, për realizim në kohë të të drejtave të palëve, por edhe sinjal i keq për investitorët e huaj që dëshirojnë të investojnë në një vend.

PALËT NË PROCEDURË PËRMBARIMORE

Në secilën procedurë marrin pjesë dy apo më tepër palë e të cilat varësisht nga procedura kanë emërtime të ndryshme por edhe role të kundërta. Palët në procedurë kanë kuptimin e personave me iniciativën e të cilëve apo e drejta e të cilëve kërkohet të realizohet kundrejt personave që kërkohet kjo e drejtë të realizohet. Palët varësisht nga pozicioni i tyre në procedurë edhe marrin emërtime ligjore si p.sh në procedurën kontestimore palët emërtohen si paditës dhe i paditur etj. Në procedurën përmbarimore palë në procedurë janë: kreditori dhe debitori. Kreditori është pala e cila kërkon realizimin e të drejtës së tij përmes propozimit për përmbarim të dokumentit përmbarimor/dokumentit të besueshëm, debitori është pala kundërshtare dhe personi kundër të cilit realizohet kredia apo kërkesa.

Palët në procedurë varësisht nga pozicioni i tyre kanë të drejta dhe detyrime, mirëpo të njëjtit në aspektin e trajtimit në procedurë janë të barabartë, përveç përparësisë apo të drejtës që ia njeh ligji, të barabartë janë edhe në kuptim të shfrytëzimit të mjeteve juridike.

Në procedurën përmbarimore palët pavarësisht të drejtave të garantuara me ligj, të njëjtit nuk kanë të drejtë të keqpërdorin pozitën e tyre me qëllim të shkaktimit të dëmit palës kundërshtare, sepse qëllimi i procedurës nuk është shkaktimi i dëmit, por realizimi i një të drejte të caktuar të parapara me ligj, apo me dokument tjetër përmbarimor/ besueshëm.

Keqpërdorimi i pozitës dhe të drejtës nga ana e secilës palë mund të ketë reperkusione apo pasoja ligjore të parapara me ligj. Ajo që në rastin konkret debatohet dhe vlerësohet është pozita e debitorit në këtë procedurë, pasi nga disa llogaritet se e tërë procedura që udhëhiqet ndaj debitorit të njëjtin e vendos në pozitë të pa barabartë dhe jo të drejtë, mirëpo ekziston një e drejtë ligjore apo parim ligjor e që debitorit ia mundson të ketë mbrojtje të veçantë ligjore e që njihet si “ dinjiteti i debitorit”, pra është kusht që të mbrohet dinjiteti i debitorit gjatë gjithë procedurës.

PROPOZIMI PËR PËRMBARIM

Secila procedurë fillohet përmes një akti të caktuar, e që më pastaj vihet në lëvizje procedura. Në procedurën kontestimore procedura fillohet me anë të padisë, në procedurë jo kontestimore me propozim, ndërsa procedura përmbarimore vihet në veprim në bazë të propozimit për përmbarim. Propozimi për përmbarim është parashtrësë e cila i paraqitet organit përmbarues (gjykatës apo përmbaruesit privat) dhe përmes të cilit kreditori kërkon realizimin e kredisë apo kërkesës së tij ndaj debitorit. Secila parashtrësë që paraqitet duhet t'i ketë disa elemente përbërëse në mënyrë që e njëjta të procedohet më tuje, pra duhet të jetë ë e qartë, e plotë me të dhëna dhe të ketë formë të caktuar, përmes të cilës vihen në dukje elementet përbërëse të saj. Me nenin 38 të LPP-së përcaktohen elementet që duhet t'i përmbajë propozimi për përmbarim citoj: *“Propozimi për*

përmbardim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbardim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbardimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbardimi, kërkuesi i përmbardimit dhe debitorit, adresa e vendbanimit –vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbardimi, objekti i përmbardimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbardimit”.

Me rastin e ekzaminimit të propozimit për përmbardim, nëse propozimi nuk përmban të dhënat e kërkuesit si në dispozitën e cituar më lartë dhe elemente tjera sikurse numri personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbardues, në raste të tilla do të veprojë konform dispozitës së nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore.

Si ka mundsi që në procedurën përmbardimore të zbatohet dispozita e procedurës kontestimore?

Përgjigjen në këtë pyetje e jep neni 17 i Ligjit të Procedurës Përmbardimore, përmes së cilës dispozitë përcaktohet zbatimi i ligjeve tjera në procedurën përmbardimore *“Në procedurën përmbardimore përshtatshmërisht zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën kontestimore, po qe se me këtë ligj ose me ndonjë ligj tjetër nuk parashihet diçka tjetër”*. Ligjdhënësi përmes kësaj dispozite me qëllim të plotësimit të zbrazëtirave ligjore në LPP, ka përcaktuar mundsinë që për çështje të caktuara për të cilat LPP-ja nuk ka paraparë apo nuk e ka rregulluar një çështje, atëherë vihen në zbatim dispozitat ligjore nga ligjet tjera, por kryesisht nga Ligji i procedurës Kontestimore si ligj bazik në aspektin e procedurës.

Shabllone të vendimeve procedurale me rastin e ekzaminimit dhe lejimit të propozimit për përmbardim

REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

CP.nr../2016

GJYKATA THEMELORE NË _____, si përmbarduese me Gjyqtarin individual N.N, në lëndën përmbardimore të Kreditorit: X.X nga _____, kundër Debitorit: Y.Y ,Rr. “Mbretëresha Teuta” p/n – _____ me pronar _____, në lëndën përmbardimore E.nr.____/2011 të dt.____.2011-tani me nr. te ri CP.nr.____/2016, për pagimin e borxhit në lartësi prej 349.47 €, me dt. _____.2018 mori këtë:

K O N K L U Z I O N

URDHËROHET kreditorit: X.X nga _____, që brenda afatit prej 3 ditësh pas pranimit të konkluzionit, që kësaj Gjykate t’ia sjell adresën e saktë të debitorit _____ Rr. “Mbretëresha Teuta” ___ me pronar _____, pasi që është vërtetuar nga shërbimi postar me datë: __.__.2016 se pala e kërkuar është shpërngul nga kjo adresë.

Nëse nuk vepron sipas këtij konkluzioni në afatin e cekur në bazë të dispozitave të nenit 102 pika 3 të LPK-së, lidhur me nenin 66 të LPP-së, procedura përbarimore do të pezullohet dhe veprimet e ndërmarra do të abrogohen.

GJYQTARI
N. N

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij konkluzioni nuk është e lejuar ankesa.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

CPP.nr..../2017

GJYKATA THEMELORE NË _____, si përbarimore në çështjen juridike të kreditorit _____ me adresë _____, kundër debitorit: Y.Y Rr. “Çlirimi” _____ me pronar _____ të cilin e përfaqëson sipas autorizimit me shkrim av. _____ nga _____, me dt. _____.2018 bie këtë:

KONKLuzion

URDHËROHET Kreditori: X.X nga _____, që brenda afatit prej 7 ditësh pas pranimit të këtij konkluzioni, që kësaj Gjykate t’ia sjell të gjitha faturat për secilin muaj në mënyrë kronologjike për borxhin i cili është grumbulluar vetëm në një faturë në shumë prej 2700 euro. Gjykata nuk e ka të qartë se si ka ardhur deri te ky borxh dhe për cilat vite apo muaj është ky borxh pasi që në faturën 17/161 të datës së lëshimit 01.01.2017 e në bazë të së cilës është lejuar përbarimi nga përbaruesi privat është cekur vetëm borxhi paraprak 2700 pa e cekur se si ka rrjedhur ky borxh, sa është borxhi për secilin muaj dhe vit paraprak dhe për cilat vite bëhet fjalë. Pra krejt në fund kreditori ka për obligim që gjykatës t’ia dorëzoj ekstraktin apo faturat për secilin

vit dhe shumat për secilin vit në mënyrë që Gjykata të vendos për kundërshtimin nga ana e debitorit.

Nëse nuk veproni konform këtij konkluzioni, gjykata konform nenit 38 të LPP në lidhje me nenin 102 par 3 të LPK-së propozimi për përmbardim do të konsiderohet se është tërhequr, po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtrës do të hidhet poshtë.

G J Y Q T A R I

N.N

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij konkluzioni nuk është e lejuar ankesa.

DOKUMENTI PËRMBARIMOR DHE DOKUMENTI I BESUESHËM

Dokumenti përmbardimor është dokumenti apo objekti i përmbardimit, pasi përmes propozimit për përmbardim kërkohet përmbushja e kërkesës që përfshihet në dokumentin për përmbardim. Organi përmbardues e cakton dhe e zbaton përmbardimin duke u bazuar në dokumentin përmbardimor dhe dokumentin e besueshëm. Ligji i Procedurës Përmbardimore ka përcaktuar llojet e dokumenteve përmbarduese dhe dokumenteve të besueshme. Parimisht llojet e dokumenteve të përmbardimit janë të përcaktuara në mënyrë taksative me LPP, mirëpo ka mundsi që si dokument përmbardues me qenë dokumenti tjetër i paraparë me ndonjë ligj tjetër, kjo përbën përjashtim. Se cilat janë dokumentet e përmbardimit këtë e përcakton neni 22 i LPP-së:

- vendimi përmbardues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësor përmbardues,
- vendimi përmbardues i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi (më tej ujdia),
- dokumenti noterial i përmbardueshëm në pajtim me ligjin për noterinë,
- marrëveshja e lidhur në procedurën e ndërmjetësimit në pajtim me Ligjin mbi ndërmjetësimin pas aprovimit të Gjykatës,
- aktvendimet, aktet dhe memorandumet për ujdite gjyqësore të Gjykatave të huaja si dhe vendimet e Gjykatave të huaja të arbitrazhit dhe ujdite e arritura para Gjykatave të tilla në raste të arbitrazhit, të cilat janë pranuar për përmbardim brenda territorit të Republikës së Kosovës,
- vendimet dhe marrëveshjet përmbarduese të arbitrazhit në Republikën e Kosovës të shpallura të ekzekutueshme nga Gjykata,

- kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe e regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit,
- vendimi gjyqësor i vërtetuar si urdhër përmbarues evropian dhe
- dokumenti tjetër që me ligj është quajtur dokument përmbarues.

Dokumentet e besueshme sipas LPP-së janë:

- kambialet dhe çeqet me potest dhe faturë kthyese, po që se janë të nevojshme për themelimin e kërkesës,
- ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave,
- faturat,
- dokumentet që sipas dispozitave ligjore të posaçme kanë rëndësinë e dokumenteve publike.

Përshtatshmëria e dokumentit përmbarimor

Njëra prej sfidave që e përcjell praktikën gjyqësore në procedurën e përmbarimit pa dyshim se është jo përshtatshmëria e dokumentit përmbarimor. Parimisht në procedurën përmbarimore dokumentet përmbarimore do të duhej të ishin të përshtatshme për përmbarim, përndryshe pala nuk do të mund të kërkonte përmbarimin e tyre.

Çka e përbën një dokument të pa përshtatshëm për përmbarim?

Secili dokument përmbarimor i cili në kuptimin e elementeve të atij dokumenti, nuk i ka të gjitha elementet përbërëse apo sikurse kërkohet me ligj (LPP), dokumentin në fjalë e bëjnë të pa përshtatshëm për përmbarim.

Neni 27 i LPP-së e ka trajtuar problematikën e përshtatshmërisë së dokumentit përmbarimor duke iu qasur faktit se cilat elemente duhet të posedoj dokumenti në mënyrë që i njëjti të jetë i përshtatshëm për përmbarim, *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*. Mungesa e njërit nga elementët e cekur më lartë dokumentin e bëjnë të pa përshtatshëm për përmbarim, dhe realisht rrezikojnë humbjen e rastit të tyre për përmbarim.

Organi përmbarues e ka detyrim që secilin propozim për përmbarim ta ekzaminoj edhe në këtë drejtim pra të vlerësimit të përshtatshmërisë së dokumentit para se ta lejoj propozimin në fjalë, pasi vetëm në këtë mënyrë do të respektohej procedura dhe zbatohet parimi i ekonomizimit dhe efikasitetit në procedurë.

Në praktikë jo rrallëherë, gjejmë raste të lejimit të propozimit për përmbarim, kur objekti i përmbarimit apo kërkesa nga dokumenti përmbarues, ka qenë pjesë e një dokumenti i cili është i

mangët në kuptimin e të gjitha elementeve dhe po ashtu i pa përshtatshëm për përmbardim. Neglizhimi i këtij fakti nga ana e organit përmbardues ka raste kur shkon edhe më tutje, deri në gjykatë të shkallës së dytë, dhe tek nga gjykata e shkallës së dytë konstatohet se dokumenti në fjalë nuk është vlerësuar si duhet në aspektin e përshtatshmërisë, dhe se i njëjti duhet edhe njëherë të vlerësohet apo se nga gjykata e shkallës së dytë vendoset, se dokumenti në fjalë nuk mund të përmbardohet dhe rrjedhimisht anulohet aktvendimi mbi lejimin e përmbardimit apo urdhri përmbardimor.

Ligji i Procedurës Përmbardimore e jep mundsinë e ndërhyrjes vetëm në elementin e afatit kohor për përcaktim të përmbardjes vullnetare, pra kur në dokumentin përmbardimor nuk është cek ky afat, LPP-ja ka paraparë mundsinë e intervenimit duke përcaktuar këtë afat organi përmbardues me aktvendim për përmbardim dhe urdhër për përmbardim me afat 7 ditor, kjo përcaktohet me nenin 27 paragrafi 2 i LPP-së “ *Në qoftë se me anë të dokumentit përmbardues nuk është caktuar afati për përmbardje vullnetare të detyrimit, afati i tillë do të caktohet me anë të aktvendimit për përmbardim dhe urdhrin për përmbardim, për shtatë (7) ditë* “.

Pra mundsia e intervenimit nga ana e organit përmbardues në elementet e tjera nuk ekziston, pra kjo nënkupton se të gjitha organet që lëshojnë dokumente përmbardimore sikurse përcaktohen me nenin 22 duhet kushtuar kujdes që dokumentet në fjalë të përfshijnë të gjitha elementet përndryshe të njëjtat nuk do të kenë mundsi të përmbardohen.

ORGANI PËRMBARUES DHE VENDIMET

Nga emërtimi i titullit kuptohet se organi përmbardues është organi kompetent i cili e zhvillon procedurën e përmbardimit apo organi pranë të cilit paraqitet propozimi për përmbardim.

Procedurën e përmbardimit parimisht e udhëheq dhe për të vendos përmbarduesi privat, ndërsa përjashtimisht gjyqtari individual kur me këtë ligj është caktuar se përmbardimin e cakton dhe e zbaton Gjykata (organi i shkallës së parë). Organi përmbardues vendos për propozimin e përmbardimit brenda afatit prej shtatë (7) ditëve pas pranimit të propozimit.

Me nenin 5 paragrafi 6 i LPP-së është përcaktuar se në cilat raste ka kompetencë gjykata të vendos dhe me përjashtim të këtyre rasteve, të gjitha rastet tjera bien në kompetencë të përmbarduesve privat. Neni 5 paragrafi 6 përcakton: “ *Gjykata është kompetente të vendos në procedurën e përmbardimit dhe të zbatoj përmbardimin e vendimeve gjyqësore lidhur me: 6.1 të gjitha çështjet nga e drejta familjare dhe 6.2 kthimin e punëtorëve dhe shërbyesve civil në punë dhe kompensimet tjera*”.

Përderisa në procedurën kontestimore gjykata vendos kryesisht me aktgjykim dhe aktvendim, në procedurën përmbardimore vendimet nxirren në formë të aktvendimit apo urdhrin përmbardimor dhe konkluzionit. Me aktvendim vendoset për çështjen kryesore apo siç njihet ndryshe vendosje

meritore, ndërsa me konkluzion vendoset për zbatim të veprimeve që i referohen drejtimit të procedurës.

Se procedura përbarimore ka evoluar shumë nga e kaluara e tregon fakti që u cek më lartë, parimisht dhe kryesisht procedurën përbarimore e udhëheq përbaruesi privat, organ i posaçëm i themeluar me ligj, ndërsa në raste specifike që llogaritet si përjashtim këtë procedurë e udhëheq gjykata. Pra, në të kaluarën nuk ka ekzistuar një organ i tillë dhe tërë procedurën që nga fillimi deri në fund e ka udhëhequr gjykata.

Ndryshimet e tilla që kanë ndodhur ndër vite i ka imponuar efikasiteti në kohë i zgjidhjes së lëndëve përbarimore, pasi lëndët përbarimore kanë pritur në gjykatë për tu zgjidhur me vite të tëra gjë që përveç që i ka humbur kuptimi kësaj procedure që njihet si procedurë urgjente, kanë ndikuar drejtpërdrejt edhe në humbjen e besimit në gjykata, pastaj në zbrapsjen e investitorëve potencial nga interesimi për të investuar. Për numrin e madh të lëndëve në gjykata kjo tashmë dihet se nuk ka qenë kryesisht për faj të gjykatës, por si rezultat i numrit skajshmërisht të madh të lëndëve në proporcion me numrin e gjyqtarëve, dhe se ka qenë e pamundshme të përfundohen lëndët jo vetëm brenda një afati optimal, por pothuajse ka qenë e pamundur të përcaktohet ndonjë afat.

Ndryshimet janë bërë në raport me themelimin e zyrave të organit përbarues, e të cilat funksionojnë si organe publiko/private pasi emërimi dhe shkarkimi i përbaruesve privat është në kompetencën e Ministrisë së Drejtësisë. Ligjshmëria e vendimeve dhe veprimeve të përbaruesve privat vlerësohet nga ana e gjykatave sipas procedurës së paraparë ligjore, përmes mjeteve juridike të cilat i shfrytëzojnë palët, ndërsa vlerësimin e punës së përbaruesve privat dhe odës së përbaruesve privat e bënë Ministria e Drejtësisë.

Urgjenca dhe rendi i veprimit

Urgjenca dhe rendi i veprimit janë parime të procedurës përbarimore, pasi secila procedurë udhëhiqet nga parime të caktuara. Urgjenca nga vet emërtimi nënkupton se procedura përbarimore si e tillë, është procedurë që duhet të zbatohet me ngutshmëri apo urgjencë. Ndërsa sa i përket rendit të veprimit, kjo i referohet aspektit të trajtimit të lëndëve në procedurë përbarimore, ku lëndët parimisht trajtohen me radhë ashtu si janë paraqitur dhe kanë marrë numër rendor, por përjashtimit në raste të caktuara një lëndë mund të trajtohet më shpejtë apo më herët se një lëndë që paraprakisht është regjistruar më herët, nëse ekzistojnë arsye për një gjë të tillë, e që mund të jenë: natyra e kredisë, aspekte të punësimit, çështjet familjare, alimentacion apo pagesat për fëmijë nëse interesat e palës mund të ndikohen negativisht si rezultat i vonësës.

MJETET E GODITJES

Mjet goditjeje quajmë mjetin procedural me të cilin pala apo personi tjetër i autorizuar me ligj kërkon që ta prishë (anulojë) apo ndryshojë vendimin por edhe veprimin për të cilin pretendon të vërtetoj se është i pavolitshëm, i padrejtë dhe i kundërligjshëm. Mjeti i goditjes është shprehje e pakënaqësisë së palës me vendimin por edhe veprimin e ndërmarrë në çështjen e saj dhe njëherazi kërkesë që ky vendim të përmirësohet, pasojat e këtij veprimi të eliminohen, apo në instancë të fundit urdhri apo aktvendimi mbi përmbarrim të shfuqizohet.

E drejta e goditjes së vendimeve është një e drejtë elementare e cila përveç se garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, kjo e drejtë garantohet edhe me Ligjin për Procedurën Kontestimore, përmbarrimore si dhe me Konventa Ndërkombëtare.

Në procedurën përmbarrimore mjete të rregullta juridike janë: prapësimi dhe Ankesa. Sa i përket mjeteve të jashtëzakonshme juridike revizioni dhe përsëritja e procedurës nuk janë të lejuara, por i ndaluar nuk është mjeti tjetër kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Prapësimi si mjet i rregullt juridik

Me nenin 69 është përcaktuar se kundër cilave vendime mund të paraqitet prapësimi, kujt i paraqitet edhe elementet e tjera sikurse përcakton ky nen citoj: *“1. Prapësimi mund të paraqitet vetëm kundër vendimeve të organit përmbarrues me të cilin përmbarrimi është i lejuar.*

2. Prapësimi duhet të paraqitet me shkrim, në Gjykatën Themelore e cila ka lëshuar vendimin përmbarrues kundër të cilit prapësimi është paraqitur kur organi përmbarrues është Gjykata.

3. Prapësimi duhet të paraqitet me shkrim në Gjykatën Themelore, siç është përcaktuar me paragrafi 5. të nenit 5 të këtij ligji kur organin përmbarrues është përmbarruesi privat.

4. Baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura. Provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet.

5. Prapësimi kundër vendimit përmbarrues ose urdhrin përmbarrues mund të paraqitet ekskluzivisht sipas dispozitave të nenit 71 të këtij ligji. Prapësimi do të përmbaj të dhënat e vendimit përmbarrimor kundër të cilit është bërë ankesa, arsyet e prapësimit dhe nënshkrimin e debitorit.

7. Vendimi me të cilin refuzohet propozimi për përmbarrim mund të goditet vetëm me ankesë të kreditorit të përmbarrimit në pajtim me nenin 77 të këtij ligji.”

Me nenin 70 është përcaktuar se afati për paraqitjen e prapësimit është brenda shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të vendimit përmbarrues ose urdhrin përmbarrues.

Shkaqet e prapësimit

Me nenin 69 janë numëruar në mënyrë taksative shkaqet e prapësimit, në të cilat pala duhet ta bazoj prapësimin e tij e që janë: “1.1 dokumenti, në bazë të cilit është marr vendimi përmbarues ose urdhri përmbarues, nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përmbarueshmerisë;

1.2. dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përmbarues ose urdhri përmbarues është prishur, anuluar, ndryshuar ose shfuqizuar në një mënyrë tjetër, gjegjësisht nëse në ndonjë mënyrë e ka humbur efektin e tij ose është konkluduar se është pa efekt juridik;

1.3. palët, përmes dokumentit publik ose dokumentit të certifikuar në pajtim me ligjin, të hartuar pas krijimit të dokumentit përmbarues, janë pajtuar që të mos e kërkojë përmbarimin në bazë të dokumentit përmbarues për një periudhë kohore të kufizuar ose përgjithmonë;

1.4. ka skaduar afati kohor brenda të cilit, sipas ligjit, mund të kërkohet përmbarimi; 1.5. përmbarimi është caktuar për sendet të cilat janë të përjashtuara nga përmbarimi i detyrueshëm dhe, si rezultat i këtij përjashtimi, mundsit për kryerjen e përmbarimit janë të kufizuara; 1.6. kreditori nuk është i autorizuar të kërkojë përmbarimin në bazë të dokumentit përmbarues, gjegjësisht ai nuk është i autorizuar të kërkojë përmbarimin kundër debitorit;

1.7. kushti i përcaktuar në dokumentin përmbarues nuk është përmbushur, përveç nëse parashikohet ndryshe me ligj; 1.8. kredia është shuar si rezultat i ndonjë fakti të shfaqur në kohën kur debitori me nuk ka mundur të paraqes faktin e tillë gjatë procedurës nga e cila ka derivuar vendimi, pas përmbylljes së një ujdje gjyqësore ose një ujdje administrative ose në ndonjë mënyrë tjetër;

1.9. realizimi i kredisë është shtyrë, ndaluar, ndryshuar ose parandaluar në ndonjë mënyrë tjetër, në mënyrë të përhershme ose për një periudhë të kufizuar kohore, si rezultat i ndonjë ngjarje që ka ndodhur në kohën kur debitori më nuk mund ta bënte të njohur në procedurë në të cilën është nxjerr vendimi, respektivisht kredia është shuar pas lidhjes së një ujdje në Gjykatë ose në organin administrativ;

1.10. kërkesa nga dokumenti përmbarues është e mbrojtur me ndonjë statut të kufizimeve;

1.11. Gjykata që ka marr vendimin për përmbarim nuk është kompetente;

1.12. përmbaruesi që ka lëshuar urdhrin për përmbarim nuk është kompetent.”

Është e rëndësishme të theksohet se në praktikë ka një keqkuptim dhe vendimmarrje të gabuar nga ana e disa profesionistëve ligjor me rastin e vlerësimit të prapësimit, për shkak se për secilin pretendim nga prapësimi kërkojnë provë shkresore, ndërsa në mungesë të provës shkresore për mbështetjen e pretendimeve nga prapësimi, refuzohet i pa bazuar prapësimi. Kjo mënyrë e të vendosurit cenon sigurinë juridike, pasi që ekzistojnë raste të ndryshme të cilat nuk kanë nevojë të provohen por e mjaftueshme është vetëm të thirret pala në to, e që pastaj gjykata duhet të vlerësojë ato pretendime dhe të vendosë.

Në cilat raste ka mundsit pala t'i paraqes si shkaqe të prapësimit e që nuk është e nevojshme dokumentimi me provë?

Njëra ndër rastet më të shpeshta të atakimit të vendimit përbarimor apo urdhrit përbarimor është parashkrimi i kërkesës, pastaj se dokumenti përbarimor është i pa përshtatshëm për përbarim, dokumenti i besueshëm nuk i ka të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 29 par 1 dhe 3 të LPP-së etj. Në raste të tilla vetëm thirrja në një shkak të tillë është e mjaftueshme, që pastaj gjykata ta vlerësojë një pretendim të tillë nga prapësimi dhe varësisht nga të gjeturat të marrë vendim.

Me rastin e vlerësimit të secilit pretendim nga prapësimi gjykata duhet të ketë pastaj këtu një qasje gjithëpërfshirëse vlerësuese, krejt kjo që procedura e filluar të zhvillohet në frymën demokratike dhe garantuese për të drejtat dhe liritë e njeriut. Qëllimi i secilës procedurë në vetvete është vendosja e të drejtës dhe ligjshmërisë në vend.

Më poshtë janë disa forma të vendimmarrjes së gjykatës në raport me prapësimin. Përmes këtyre formave synohet ngritja e njohurive në praktikë, dhe janë pothuajse forma që janë kryesisht të zakonshme dhe të përditshme në raport me vendimmarrjen pas ushtrimit të prapësimi. Normal që praktika gjyqësore nuk kufizohet vetëm në to, mirëpo këtu jepet një pasqyrë edhe e formës në aspektin procedural por edhe e përmbajtjes apo pjesëve të aktvendimit mbi prapësimin. Rastet e paraqitura nuk janë hipotetike por janë reale, dhe të vendosura në dy shkallë, pra janë raste që munden të shërbejnë për përfitime praktike.

Rasti i parë

CPP.nr../2017

GJYKATA THEMELORE NË, si përbarimore, me gjyqtarin individual N.N, në çështjen juridike të kreditorit X.X, Rr. "Agim Ramadani" nr. 15 me seli në Prishtinë, kundër debitorëve: Y.Y me nr. personal 1000005651 nga Fsh. xxx si kredi marrës dhe për shkak të borxhit në shumë prej 12.999.60 €, pas kundërshtimit të ushtruar nga debitorët X.X me datë 28.06.2017, kundër urdhrit mbi lejimin e përbarimit, P.nr.873/2017 të datës 19.06.2017, gjykata jashtë seance me datë 12.10.2017 nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET kundërshtimi i debitorit Y.Y me nr. personal 10003226 nga Fsh. __si Kredimarrës, ushtruar kundër urdhrit mbi lejimin e përbarimit P.nr.873/2017 të dt. 19.06.2017, dhe **SHFUQIZOHET** urdhri mbi lejimin e përbarimit P.nr.873/2017 të dt. 19.06.2017, dhe të gjitha veprimet e ndërmarra përbarimore abrogohen.

A r s y e t i m

Kreditori, X.X ka ushtruar propozim për përbarim për sekuestrim kolaterali duke kërkuar që të sekuestrohen pajisjet shtëpiake të specifikuar në listën e pengut nr.149113, pronë e Y.Y, dhe të bllokuj të gjitha llogarit bankare , dhe mjetet e mbledhura të barten në llogari të kreditorit X.X., Rr. “Agim Ramadani” nr. 15 me seli në Prishtinë, të gjitha këto të specifikuar në propozimin për përbarim të datës 16.06.2017.

Përbaruesi privat, me urdhrin, P.nr.873/2017 të dt. 19.06.2017 e ka lejuar përbarimin sipas propozimit te kreditorit.

Debitori, X.X me nr. personal 10000000 nga Fsh. _____ si kredi marrës, brenda afatit ligjor ka ushtruar kundërshtim kundër urdhrin përbarimor, duke i propozuar gjykatës që të njëjtin ta aprovoj si të bazuar dhe ta shfuqizojë urdhrin përbarimor, sepse debitori ka marrë kredi në BKT dhe obligimet e debitorit që kanë qenë në TEB SH.A i ka marrë BKT, provë konfirmimi i BKT-së i datës 20.06.2016, ku me datë 12.07.2016 shumën prej 17,300 € dhe ekziston pasqyra ku tregon se ky transfer është bërë për mbylljen e produkteve dhe nuk i di arsytet pse kreditori nuk i ka ndaluar këto mjete, provë pasqyra nga BKT e datës 04.10.2016, andaj më nuk jam klient te kreditori se e kam mbyll kredinë me rastin e marrjes se kredisë në BKT, e njëjta e ka blerë kredinë e debitorit, dhe tani kreditori nuk ka legjitimitet të plotë që të kërkoj të hollat nga unë se BKT-ja e ka marrë për obligim ku e njëjta i ka transferuar mjetet tek kreditori. Me rastin e transferimit të mjeteve atëherë ka ra nga fuqia lista e pengut dhe nuk është e ligjshme të kërkohet pengu kur mjetet i kanë pasur në konto kreditori. Më tutje debitori deklaron se bllokimi i llogarive bankare nuk gjen mbështetje në ligj apo në Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut sepse bllokimi i të njëjtave do të rrezikonte ekzistencën time dhe të familjes sime sepse nuk është faji jonë se pse nuk i ka tërhequr mjetet e transferuar kreditori, po ashtu kërkojmë nga gjykata që të hapë seancë dhe të deklarohejm për rastin në përgjithësi dhe ti prezantoj provat rreth pretendimeve të mia dhe varësisht prej rrethanave palët të udhëzohen në kontest civil sepse procedura përbarimore nuk është procedurë e përshtatshme për këtë rast.

Pas kundërshtimit të ngritur nga debitorët, kreditori X.X Prishtinë ka paraqitur përgjigje në kundërshtim me arsyetimin se debitori kundërshtimin e ka parashtruar vetëm që ta zvarrit procedurën, po ashtu kundërshtimi i debitorit nuk është i bazuar në nenin 71 të LPP-së, ku në vend të argumentimit të bazës ligjore të kundërshtimit, debitori mundohet të theksoj fakte të cilat në këtë fazë nuk janë relevante. Debitori në prapsim pretendon se nuk ka detyrim ndaj X.X, ky pretendim nuk qëndron sepse klienti ka ardhur që ta parapaguaj kredinë në X.X dhe ne i kemi thënë që procedura e mbylljes së kredisë, kredit kartelës dhe mbitërheqjes zgjatë disa ditë. Kjo është e rregulluar edhe në marrëveshjen e kredisë nr 149113 më saktësisht neni 4.6 ku sipas këtij paragrafi kredi marrësi nëse dëshiron ta mbyllë para kohe detyrimin e tij duhet ti drejtohet bankës me kërkesë e cila mund të aprovohet brenda periudhës 30 ditore, ku i njëjti nuk e ka bërë. Mjetet që janë derdhur nga BKT-ja nuk kanë pasur ndonjë tregues se kreditori është i detyruar ta mbyllë

kredinë ku ne nuk kemi pasur as të drejtë pa kërkesë të kredi marrësit ti rezervojmë mjetet që kanë ardhur në llogari të klientit. Së dyti kredi marrësi as nuk ka bërë kërkesë zyrtare për pagesë para kohe të kredisë, ai madje nuk e ka pritur edhe periudhën 30 ditore të cilin ka qenë i detyruar për aprovim e parapagimit të detyrimit. Kredi marrësi ditën që është realizuar transferi nga BKT në X.X, para datës 12.07.2017 ka tërhequr mjete në shumë prej 1000 €, dhe ka vazhduar ashtu që me datë 14.07.2016 shumën prej 100 €, 16.07.2015 shumën prej 50 €, 18.07.2015 shumën prej 10 €, 19.07.2015 shumën prej 500 €, dhe ka vazhduar tjera ku brenda periudhës 30 ditore shuma e transferuar nga BKT ka mbetur 7,223.13 €, ku edhe po të kishte kërkesë shuma e mbetur nuk do të ishte e mjaftueshme për mbyllje. Pra përveç mos plotësimit të kushteve për parapagim të kredisë, ai me vetëdije ka vazhduar me tërheqjen e mjeteve duke e bërë të pamjaftueshme shumën për mbylljen e detyrimit dhe në këtë mënyrë duke vënë në lajthim dy kreditorët të cilëve ju ka shkaktuar dëm në vlerë të konsiderueshme financiare, andaj nga të cekurat më lartë duke marr parasysh se pretendimet e debitorit nuk janë të mbështetura në dispozitat ligjore të LPP-së dhe në asnjë fakt domethënës kërkojmë që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pabazuar dhe të vërtetohet urdhri përmbarimor.

Gjykata Themelore në _____, si përmbarimore në zbatim të dispozitave të nenit 69 e 71 të LPP vlerësoi kundërshtimin e debitorit dhe thëniet të cekura në kundërshtim dhe gjeti se i njëjti është i bazuar. Arsyet e paraqitura në kundërshtimin të debitorit tregojnë shkaqe sikurse në nenin 69 e 71 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, sipas të cilave do të pengohet përmbarimi i lejuar me aktvendim nga gjykata.

Gjykata pas shikimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në Ligjin e Procedurës Përmbarimore ma saktësisht neni 36 par 1 i cili thotë se “Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmërisë për përmbarueshmëri”, lejimi i përmbarimit pa u plotësuar këto prezumime procedurale, përbën shkelje të dispozitave të procedurës përmbarimore. Gjykata e shkallës së parë duke u bazuar edhe në praktikën gjyqësore është e obliguar zyrtarisht të vlerësoj nëse janë përmbushur prezumimet lidhur me propozimin për përmbarim dhe dokumentin përmbarimor. Lidhur me të lartcekurat e duke u bazuar në nenin 38 par 1 të LPP-së i cili thotë citoi *“Propozimi për përmbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbarimi, kërkuesi i përmbarimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjete nëpërmjet cilit duhet kryer përmbarimi, objekti i përmbarimit po që se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbarimit”*, e në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet që të lejohet përmbarimi pasi që nga shkresat e lëndës vërtetohet se përmbaruesi privat propozimin për përmbarim e ka lejuar pa u plotësuar kushtet ligjore ashtu siç parashihen në nenin 36 par 1 dhe 38 par 1 të LPP-së sepse dokumenti përmbarimor nuk është as origjinal e as kopje e vërtetuar.

Pasi që në rastin e lejimit të përmbarimit janë bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës përmbarimore, gjykata e shfuqizoj urdhrin mbi lejimin e përmbarimit dhe fare nuk u lëshua në vlerësimin e provave në mënyrë që të vërtetohet gjendja faktike në këtë çështje përmbarimore. Andaj, nga arsyet e cekura më lartë, konform dispozitave të nenit 3, 36 par 1, 38 par 1, 69, 71 e 73 par. 3, të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, gjykata vendosi si në diapozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË _____

CPP.nr.../2017 dt. . . .20__

GJYQTARI

N.N

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

Rasti i Dytë

PPP.nr.../2020

GJYKATA THEMELORE NË _____, si përmbarimore, e përbërë nga gjyqtari individual N.N, në çështjen përmbarimore të Kreditorit: X.X SH.P.K me nr te biznesit 810106527 me adresë në Vicianum, K.Banesor Veranda C2.7, H 257 K 1 Nr. 5 Prishtinë të cilën sipas autorizimit me shkrim e përfaqëson _____ av. në Prishtinë, kundër debitorit: Y.Y. A. Rr. Bislim Bajgora p/n _____, për shkak të borxhit në shumë prej 37,500.00 €, pas prapësimit të ushtruar nga debitori me dt: 28.07.2020, kundër urdhrin mbi lejimin e përmbarimit P.nr.190/2020 të dt.17.07.2020, gjykata jashtë seance me dt.10.11.2020 nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit: “Y.Y” SH. A., Rr. “Bislim Bajgora” p/n _____, ushtruar kundër urdhrin mbi lejimin e përmbarim P.nr.190/2020 të dt.17.07.2020, sipas propozimit të kreditorit “X.X” SH.P.K me seli në Prishtinë.

A r s y e t i m

Kreditori: X.X me nr. të biznesit 810106527 me adresë në Vicianum, K.Banesor Veranda C2.7, H 257 K 1 Nr. 5 Prishtinë të cilën sipas autorizimit me shkrim e përfaqëson _____ av në Prishtinë ka

ushtruar propozimin për përbarim e te precizuar të përbaruesi privat, me të cilin ka kërkuar që të lejohet përbarimi ndaj Y.Y Rr. Bislim Bajgora p/n _____, si në shkresat e lëndës me të cilën do të paguaj borxhin në shumë prej 37,500.00 €, me kamatë ligjore prej 8% nga dita kur kërkesa është bërë e arritshme për pagesë si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, në të kundërtën ti bllokohen llogaritë bankare të debitorit dhe mjetet e mbledhura të transferohen në llogarinë e përbaruesit privat, të gjitha të specifikura në propozimin për përbarim të datës 17.07.2020.

Përbaruesi privat me urdhrin P.nr.190/2020 të dt.17.07.2020, e ka lejuar propozimin për përbarim në këtë çështje juridike përbarimore.

Kundër propozimit për përbarim të lejuar me urdhrin përbarimor, P.nr.190/2020 të dt.17.07.2020, debitori “X.X” SH. A. Rr. “Bislim Bajgora” p/n _____, ka ushtruar prapësim me dt. 28.07.2020, me të cilin ka kërkuar nga Gjykata Themelore në _____, që urdhrin mbi lejimin e përbarimit ta lë jashtë fuqie dhe të abrogohen të gjitha veprimet e ndërmarra përbarimore me arsyetimin se urdhri mbi lejimin e përbarimit është i pa rregullt duke u bazuar në nenin 71 pika 1.2 të LPP-së. Më tutje debitori shton se arsyeja e vonësës së pagesave është se projekti ka qenë subvencion nga ana e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, ku e njëjta ministri ka qenë e obliguar të bëjë përcjelljen e pagesave, ku ne si kompani me kohë në MZHE, mirëpo për shkak të pandemisë janë vonuar pagesat, po ashtu kreditori është vonuar sipas kontratës në kryerjen e punimeve.

Pas ushtrimit të prapësimit nga ana e debitorit, me të njëjtin është njoftuar te kreditori si dhe me mundsinë e ushtrimit të përgjigjes në prapësim, ku me dt. 05.08.2020 ka paraqitur përgjigje duke e kontestuar në terësi prapësimin e debitorit dhe ka kërkuar nga gjykata që të njëjtin ta refuzoj si të pa bazë, të lihet në fuqi urdhri përbarimor, të detyrohet debitori pagesën e shpenzimeve të procedurës përbarimore me arsyetimin se debitori ka ushtruar prapësim vetëm që ta shtyj përbarimin, pasi që i njëjti nuk ka plotësuar asnjë kusht ligjor siç parashihet me nenin 69 dhe 71 të LPP-së. Po ashtu sa i përket asaj se urdhri përbarimor nuk ka bazë ligjore konform nenit 71 par.1.2 të LPP-së, i njëjti pretendim është i pa qëndrueshëm juridikisht dhe faktikisht sepse dokumenti me të cilin është iniciuar procedura përbarimore – fatura është e rregullt dhe asnjëherë nuk është anuluar, shfuqizuar apo është bërë e pa efektshme. Më tutje kreditori shton se sa i përket pretendimeve të debitorit se ka qenë subvencion i MZHE-së dhe e njëjta ka qenë e obliguar të përcjellë pagesat si dhe është bërë vonesa e pagesave për shkak të pandemisë, të njëjtat pretendime nuk janë bazë për anulimin e urdhrin përbarimor. Gjykatës i bëjmë të ditur faktin se debitori e ka paguar një pjesë të detyrimit dhe atë 112,500.00 € me dt. 29.07.2020 kurse për pages ka mbetur shuma prej 37,500.00€. Andaj në prapësimin e debitorit nuk janë plotësuar asnjëri nga shkaqet e theksuara në nenin 71 të LPP-së, dhe në rast se debitori paraqet ankesë kundër aktvendimit mbi refuzimin e prapësimit, debitori detyrohet të paguaj garancinë sipas nenit 78 të LPP-së.

Gjykata Themelore në _____, si përmbartimore në zbatim të dispozitave të nenit 69 e 71 të LPP vlerësoi prapësimin e debitorit dhe thëniet e cekura në prapësim dhe gjeti se i njëjti është i pa bazë. Arsyet e paraqitura në prapësimin e debitorit nuk tregojnë shkaqet sikurse në nenin 69 e 71 të Ligjit të Procedurës Përmbartimore, sipas të cilave do të pengohet përmbartimi i lejuar nga përmbartuesi privat.

Gjykata, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe lidhur me pretendimet e debitorit kur thirret në atë se urdhri mbi lejimin e përmbartimit është i pa rregullt duke u bazuar në nenin 71 pika 1.2 të LPP-së, të njëjtat pretendime gjykata i refuzoj si të pa bazuara dhe atë duke u bazuar në dispozitat ligjore të LPP-së, ma saktësisht neni 29 par.1 nën par 1.3 parashihet se “Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: 1.3 faturat”, kurse par.3 i po të njëjtit nen parasheh se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”, e në rastin konkret fatura me të cilin është lejuar përmbartimi i plotëson të gjitha kushtet ligjore të cekura më lartë, ashtu që lejimi i përmbartimit është bërë në përputhje me dispozitat ligjore të LPP-së.

Po ashtu sa i përket pretendimeve të debitorit lidhur me atë se arsyeja e vonës së pagesave është se projekti ka qenë subvencion nga ana e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, ku e njëjta ministri ka qenë e obliguar të bëjë përcjelljen e pagesave, ku ne si kompani me kohë në MZHE, mirëpo për shkak të pandemisë janë vonuar pagesat, po ashtu kreditori është vonuar sipas kontratës në kryerjen e punimeve, lidhur me pretendimet e lartcekura gjykata sqaron faktin se me dt.22.10.2019 në mes kreditorit dhe debitorit është lidhur kontrata për ndërtimin e objektit administrativ regional në Suhadoll të _____, në të cilën kontratë askund nuk parashihet që projekti ka qenë subvencion nga MZHE, për me tepër kreditori ka qenë i obliguar kryerjen e punëve të specifikuar si në pjesën II dhe III të kontratës, kurse debitori pagesën e të hollave lidhur me punën e kryer, e në rastin konkret me rastin e lidhjes së kontratës, kanë lindur të drejta dhe obligime në mes palëve kontraktuese, të cilat kanë qenë të obliguara të dy palët ti respektojnë, dhe në rast të mos respektimit të kushteve të kontratës secila nga palët ka pasur të drejtë që të iniciojë procedurë gjyqësore për mos zbatim të dispozitave kontraktuese, e në rastin konkret debitori kur nuk ka bërë pagesat e faturës, atëherë janë shkelur nenet e kontratës nga debitori dhe janë shkaktuar pasoja juridike në dëm të kreditorit, e në rastin konkret debitori si shkelës i kontratës ka obligim pagesën të cilën e kërkon kreditori në këtë çështje juridike-përmbartimore, e duke u bazuar në nenin 245 par.1 të LMD-së i cili nen parasheh se “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”, ndërsa par.2 i po të njëjtit nen parasheh se “Kur debitori nuk e përmbush detyrimin ose vonohet me përmbushjen e tij, kreditori ka të drejtë të kërkojë edhe shpërblimin e dëmit që ka pësuar për këtë shkak”. Po ashtu neni 249 par.1 të LMD-së parasheh se “Kreditori ka të drejtë në shpërblim të dëmit të thjeshtë dhe të fitimit të humbur, të cilat debitori është dashur t’i parashikonte detyrimisht në kohën e lidhjes së kontratës, si pasoja të mundshme të shkeljes së kontratës e duke marrë parasysh faktet të cilat i ka pasur të njohura ose

është dashur detyrimisht t'i kishte të njohura”, ndërsa par.2 i po të njëjtit nen parasheh se “Në rast mashtrimi ose të mos përmbushjes me dashje, si dhe të mos përmbushjes për shkak të pakujdesisë së rëndë, kreditori ka të drejtë të kërkojë nga debitori shpërblimin e të tërë dëmit, i cili është shkaktuar për shkak të shkeljes së kontratës, pa marrë parasysh atë se kreditori nuk ka ditur për rrethana të veçanta, për shkak të cilave janë shkaktuar ato”.

Ndërsa sa i përket pretendimeve të debitorit se kreditori është vonuar në kryerjen e punëve sipas kontratës, për të njëjtat pretendime gjykata sqaron faktin se në nenin 17 pjesës II te kontratës është paraparë fillimi dhe vonesat kurse neni 37 pika f) e kontratës se lartcekur parasheh se kontrata mund të shkëputet kur kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës, e në rastin konkret duke u bazuar në dispozitat e lartcekura në shkresa të lëndës nuk ka dëshmi se a është kryer projekti me kohë, si dhe nuk ka dëshmi që debitori është ankuar tek kreditori ose në organe kompetente si psh gjykata konform nenit 43 te kontratës se lartcekur lidhur me vonesën e moskryerjes së punimeve, e në rastin konkret pretendimet e pa argumentuara me prova gjykata i refuzon si të pa bazuara konform nenit 7 te LPK-së.

Sa i përket kamatës së aplikuar për detyrimin, gjykata u referua nenit 382, par.1 dhe 2 te LMD-së, me të cilën obligohet debitori pagesën e të njëjtët nga data 17.07.2020, pra nga dita e inicimit të procedurës përmbartimore e deri në pagesën definitive të detyrimit. jykata konform nenit 17 te LPP-së, përshtatshmërisht aplikoj dispozitat ligjore të LMD-së dhe LPK-së.

Gjykata, pretendimet e debitorit në prapësimin e tij nuk mund t'i aprovoi si të bazuara për faktin se të njëjtat ishin në kundërshtim me provat e prezantuara në vet shkresat e lëndës, andaj i REFUZOI SI TË PABAZUARA.

Andaj nga arsyet e cekura më lartë, e konform dispozitave të nenit 3, 17, 29 par.1 nën par.1.3 dhe par.3, 69, 71, 73 par 3 të Ligjit të Procedurës Përmbartimore, e në lidhje me nenin 245 par. 1 dhe 2, 249 par.1 dhe 2 dhe 382 par.1 dhe 2 te LMD-së e në lidhje me nenin 7 te LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË
PPP.nr..../2020, dt. . . .20__

GJYQTARI
N.N

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.

GJYKATA THEMELORE NË _____, si përmbarimore me gjyqtarin individual N.N, në çështjen juridike te kreditorit: X.X me seli ne Prishtinë, Bulevardi Bill Klinton, nr.5, , kati VII, kundër debitorit Y.Y me adresë në Rr. “Brigada 142” _____, lidhur me pagesën e borxhit në shumë prej 1,238.10 €, gjykata, duke vendosur sipas prapësimit te parashtruar nga debitori me datë 14.03.2019, kundër Urdhrit për lejimin e Përmbarimit, pas kthimit të lëndës në rigjykim, gjykata jashtë seancës me dt. 09.02.2021, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

I.APROVOHET PJESËRISHT prapësimi i debitorit Y.Y nga _____, ashtu që:

II.SHFUQIZOHET PJESËRISHT Urdhri mbi lejimin e Përmbarimit P.nr.507/2019 i dt: 11.03.2019 për periudhën kohore 27.12.2016 e deri me 31.12.2017 në shumë prej 453.76 €, dhe **OBLIGOHET** debitori Y.Y nga, qe kreditorit X.X me seli ne Prishtinë, ne emër te borxhit për energjinë elektrike e harxhuar për periudhën kohore 01.01.2018 e gjerë me 09.02.2019, t’ia paguaj shume prej 784.34 €, me kamatë ne lartësi prej 8% nga dita e nxjerrjes se këtij aktvendimi e deri ne pagesën definitive te detyrimit, te gjitha këto në afat 7 ditor duke filluar nga pranimi i këtij aktvendimi nën kërcënimin e përmbarimit te detyrueshëm.

A r s y e t i m

Kreditori, X.X me seli ne Prishtinë, ka parashtruar propozim për lejimin e përmbarimit kundër debitorit Y.Y me adresë në Rr. “Brigada 142” _____, për pagesën e borxhit ne emër te energjisë elektrike te harxhuar për periudhën kohore 27.12.2016 e gjerë me 09.02.2019, në shumë totale prej 1,238.10 €, me kamate prej 8% vjetore, si dhe shpenzimet e procedurës, te gjitha këto ne afat 7 ditor ne te kundërtën te behet bllokimi i llogarive bankare, sekuestrimi, regjistrimi dhe shitja e sendeve te luajtshme dhe te paluajtshme e mjetet e mbledhura ne shumen e kërkuar te derdhen ne llogari te kreditorit, te gjitha këto te specifikuar ne propozimin për përmbarim te dt. 11.03.2019.

Organi përmbarues me Urdhrin P.nr.507/2019 i dt: 11.03.2019, ka lejuar përmbarimin sipas propozimit te kreditorit.

Debitori Y.Y me adresë në Rr. “Brigada 142” _____, brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësim me shkrim, duke theksuar se dokumenti i besueshëm- ekstrakti i lëshuar nga kreditori konform nenit 29 par.1 nën par.2, nuk është i përshtatshëm për përmbnim, sepse i njëjti është konfuz i pa saktë. Më tutje debitori shton borxhi i tillë është parashkruar konform dispozitave të nenit 360 par.1 nën par.1.1 të LMD-së, andaj i propozoj Gjykatës të aprovohet prapësimi i debitorit, të anulohet ose të ndryshohet urdhri përmbnimor dhe të obligohet kreditori që ti paguaj shpenzimet e procedurës përmbnimore.

Pas prapësimit të ngritur nga debitori, kreditori, ka paraqitur përgjigje në prapësim duke e kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit si të pa bazuar dhe të pa argumentuar me asnjë provë, pasi që debitori ka një shumë të borxhit të pa paguar, kreditori propozimin për përmbnim e ka filluar duke u mbështetur ne dokumentin e besueshëm konform nenit 29 par.1.2 dhe 40 par.1 dhe 341 te LPP-së, propozimi për përmbnim është bërë për periudhën 27.12.2013 e deri më 09.02.2019, dhe ka bërë pagesa të kohëpaskohshme në vlera të ndryshme por nuk e ka përmbushur obligimin në tërësi e konform nenit 368 par.1 dhe 2 kemi ndërprerje të parashkrimit. Debitori faturat rregullisht i ka pranuar, dhe se asnjëherë nuk ka pasur ankesa të parashtruara për kontestim të borxhit për muajt të cilët është bërë propozimi për përmbnim. Me tutje kreditori shton se kërkesa për prapësim nuk është ne harmoni me nenin 69 te LPP-së, po ashtu për ta vërtetuar validitetin e kësaj përgjigje konform nenit 73 te LPP-së kërkojmë qe te hapet seancë publike.

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin PPP.nr.429/2019 të dt. 06.12.2019, e ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit si të bazuar duke e shfuqizuar pjesërisht urdhrin përmbnimor për periudhën kohore dt. 27.12.2016-31.12.2017 për shkak te parashkrimit, kurse për periudhën kohore dt. 01.01.2018-09.02.2019, e ka obliguar debitorin për pagesën e borxhit, si në dispozitiv te aktvendimit të lartcekur.

Kreditore i pa kënaqur me vendimin e lartcekur ka ushtruar ankesë me dt. 23.12.2019, me propozimin që gjykata e shkallës së dytë, ta aprovoj të njëjtën si të bazuar, dhe ta prish aktvendimin e atakuar e çështjen të e kthej në rivendosje.

Gjykata e shkallës së dytë me aktvendimin Ac.nr.284/2020 të dt. 15.06.2020, e ka aprovuar, si të themeltë ankesën e kreditorit dhe çështjen e ka kthyer në rivendosje me vërejtjet dhe rekomandimet që të vlerësohet se borxhi i krijuar për periudhën e precizuar në propozim a korrespondon me borxhin e kërkuar si dhe te konstatohet se a kemi parashkrim.

Gjykata Themelore në _____, si përmbnimore në zbatim të dispozitave të nenit 69 e 71 të LPP-së, vlerësoi prapësimin e debitorit dhe gjeti se e njëjta është pjesërisht e bazuar. Arsyet e paraqitura në prapësimin e debitorit pjesërisht tregojnë shkaqe sikurse në nenin 69 e 71 të Ligjit të Procedurës Përmbnimore, sipas të cilave do të pengohet përmbnimi i lejuar nga përmbnuesi privat.

Gjykata, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe pretendimeve të debitorit në prapësimin e parashtruar kur thirret në atë se dokumenti i besueshëm- ekstrakti i lëshuar nga kreditori konform nenit 29 par.1 nën par.2, nuk është i përshtatshëm për përmbartim, sepse i njëjti është konfuz i pa saktë, të njëjtat pretendime i refuzoj si të pa bazuara, për faktin se kreditori propozimin për përmbartim e ka iniciuar në bazë të dokumentit të besueshëm e konform nenit 29 par.1.2 të LPP-së ekstraktet të verifikuar nga librat afariste janë dokumente të përshtatshëm për përmbartim, po ashtu në shkresat e lëndës gjendet transaksioni i konsumatorit ku në mënyrë të qartë janë të cekura si fatura, referenca, nr. i konsumatorit, data, shuma e energjisë së shfrytëzuar, pagesa dhe borxhi kryesorë.

Ndërsa sa i përket pretendimeve rreth parashkrimit, gjykata gjeti se të njëjtat janë pjesërisht të bazuara, për faktin se i tërë borxhi me të cilin ngarkohet debitori Y.Y me adresë Rr. “Brigada 142” _____, për periudhën kohore 27.12.2016 e gjerë më 31.12.2017, është borxh i parashkruar, konform nenit 360 par.1, të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, për faktin se edhe pse debitori nga transaksioni i kreditorit gjatë kësaj periudhe shihet se ka bërë disa pagesa paushallë mirëpo nuk ka dëshmi se këto pagesa janë bërë në emër të borxhit paraprak apo në emër të faturave për muajt vijues, dhe se me vet faktin se ndërmjet kreditorit dhe debitorit nuk ka ekzistuar paraprakisht një marrëveshje për ri programim eventual të borxhit, këto pagesa nuk e ka bërë ndërprerjen e rrjedhjes së afatit të parashkrimit, konform nenit 368 të LMD-se. Njëkohësisht, ky është edhe qëndrim i Gjykatës Supreme të Kosovës, referuar vendimin të saj (aktgjykimi Rev.nr.148/12, dt:09.09.2013).

Pagesat e kohëpaskohshme në shumë dhe lartësi të ndryshme të bëra nga debitori nuk mund të llogariten siç pretendon kreditori. Me nenin 360 par.1 nën par.1.1 të LMD-së përcaktohet afati i parashkrimit të kërkesave e që është: cituar “Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti: 1.1. kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake”. Me paragrafin 2 të nenit 360 përcaktohet se kur fillon të rrjedh afati i parashkrimit cituar “Afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë.”

Ndërsa me nenin 368 par.2 përcaktohet mënyra e ndërprerjes së parashkrimit cituar “Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë, sikurse janë pagesa e këstit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit”. Në rastin konkret pagesa e debitorit nuk hynë në kategorinë e pagesës të kësteve të cekura më lartë pasi që kësti konsiderohet ndarje e borxhit në periudha të caktuara mujore apo më gjatë, ku borxhi i përgjithshëm ndahet në pjesë më të vogla për pagesë për një periudhë të caktuar. Pagesë e këstit do të mund të llogaritet nëse do të ekzistonte një marrëveshje në mes të kreditorit dhe debitorit, qoftë për ri programim të borxhit apo për pagesë të borxhit total të ndarë në këste, ndërsa kjo asesi nuk i atribuohet pagesave

të debitorit, sepse edhe pse kemi borxh të akumuluar nga faturat mujore nuk kemi marrëveshje për ndarje me këste në mes të palëve, dhe pa një marrëveshje të tillë pagesat nuk trajtohen këste.

Dispozita ligjore qartë e përcakton dhe nuk e cek faturën e as shumën më të madhe sesa fatura, sepse pala gjatë pagesës ka mundsi të paguaj më tepër sesa ka borxh dhe ajo i llogaritet si avans për muajin tjetër, por assesi kjo nuk llogaritet këst.

Interpretimi i Gjykatës në raport me dispozitën e cituar më lartë është se pa marrëveshje të kreditorit dhe debitorit për pagesën e borxhit me këste, pagesat e kohëpaskohshme assesi nuk mund të trajtohen apo konsiderohen si këste në vetvete.

Kurse sa i përket borxhit për periudhën kohore 01.01.2018 e gjerë me 09.02.2019, gjykata, gjeti se i njëjti është i bazuar dhe nuk ka vjetërsim të borxhit të kreditorit, në raport me debitorin për këtë periudhë kohore, referuar nenit 360, par.2 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Ligji nr. 04/L-077), parashihet që afati i parashkrimit për çdo kërkesë të arritur gjatë një viti, fillon të rrjedhë në fundin e atij viti, e që në rastin konkret për të gjitha kërkesat e arritura në vitin 2018, afati I parashkrimit ka filluar të rrjedhë me 01.01.2019, dhe në rastin konkret nuk kemi kalim të afatit të parashkrimit, për faktin se kreditori, propozimin për përmbarim e ka parashtruar me datën 11.03.2019, me çka ka shkaktuar ndërprerjen e rrjedhjes së afatit të parashkrimit, konform nenit 369 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Ligji nr. 04/L-077).

Sa i përket kamatës së aplikuar për detyrimin e aprovuar si në piken II të dispozitivit, gjykata u referua nenit 382, par.1 dhe 2 të LMD-se.

Andaj, nga arsyet e cekura më lartë, dhe konform dispozitave të nenit 3, 17, 29 par.1.2 dhe par.3, 69, 71, 73 par.3 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, lidhur me nenin 360 par.1 dhe 2, dhe 368, dhe 382 par.1 dhe 2 të LMD-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË _____
PPP.nr..../2020, dt. __.__.20__

G J Y Q T A R I
N.N

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh nga pranimi i të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa parashtrohet përmes kësaj gjykate.

GJYKATA THEMELORE NË, si përmbare, me gjyqtarin individual N.N, duke vendosur në çështjen përmbare të kreditorit “X.X” SH.A Rr. “Bislim Bajgora” _____, kundër debitorit Y.Y me adresë në Rr. “Mehdi Frasheri” Mitrovicë, për shkak të borxhit në shumë prej 588.92 €, pas prapësimit të ushtruar nga debitori me dt: 24.12.2018 kundër urdhrin mbi lejimin e përmbarimit të dt. 29.11.2018, gjykata jashtë seance me dt.16.03.2021 nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET POSHTË prapësimi i debitorit Y.Y me adresë në Rr. “Mehdi Frasheri” , ushtruar kundër urdhrin mbi lejimin e përmbarimit P.nr.1221/2018 të dt. 29.11.2018, për shkak të borxhit në shumë prej 588.92€, si i **PA AFATSHËM**.

A r s y e t i m

Kreditori, “X.X” SH.A Rr. “Bislim Bajgora” _____, ka ushtruar propozimin për përmbare, me të cilin ka kërkuar që të lejohet përmbare ndaj debitorit Y.Y me adresë në Rr. “Mehdi Frasheri” _____, si në shkresat e lëndës për borxh në shumë prej 588.92€, me propozim që të bëhet bllokimi i llogarive bankare të debitorit, regjistrimin, sekuestrimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të pa luajtshme dhe mjetet e mbledhura të transferoj në llogari të kreditorit të gjitha të specifikua në propozimin për përmbare të datës 29.11.2018.

Organi përmbare me Urdhrin P.nr.1221/2018 të dt. 29.11.2018, e ka lejuar përmbare sipas propozimit të kreditorit.

Pas lejimit të përmbare, përmbaresi privat urdhrin së bashku me propozim i’ a ka dorëzuar debitorit të cilin propozim i njëjti e ka pranuar me datë 13.12.2018 me paralajmërimin se pala e pakënaqur ka të drejtë të paraqes prapësim në afat 7 ditor nga dita e pranimit të të njëjtit.

Debitori, Y.Y me adresë në Rr. “Mehdi Frasheri” _____, ka ushtruar prapësim me dt: 24.12.2018 kundër urdhrin për lejimin e përmbare të dt. 29.11.2018, me të cilën është lejuar përmbare sipas propozimit të kreditorit X.X SH.A Rr. “Bislim Bajgora” _____.

Nga shkresat e lëndës, konstatohet se debitori, nuk ka vepruar brenda afatit ligjor të përcaktuar për paraqitjen e prapësimit kundër urdhrin mbi lejimin e përmbare, andaj gjykata, bazuar në nenin

70 te Ligjit të Procedurës Përmbareme i cili thotë citoi “Prapësimi duhet ti paraqitet gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbareme ose urdhrit përmbareme” e në rastin konkret debitori Y.Y me adresë në Rr. “Mehdi Frashëri” _____, propozimin për përmbareme e ka pranuar me dt. 13.12.2018 dhe afati ka filluar të ecë nga data 14.12.2018 ndërsa prapësimin e ka paraqitur me datë 24.12.2018, e nga pranimi i propozimit të përmbaremit e deri me ditën e paraqitjes së prapësimit kanë kaluar dymbëdhjetë (12) ditë, e në rastin konkret afati i fundit për ngritjen e prapësimit ka qenë data 20.12.2018, ashtu që prapësimi i debitorit konsiderohet si I PA AFATSHËM.

Për gjykatën nuk ishte kontestuese fakti se debitori prapësimin e ka ushtruar pas afatit ligjor, konkretisht me datën 24.12.2018 kjo vërtetohet përmes prapësimit ku ne faqen e dyte ne fund është shkruar se i njëjti është përpiluar me 24.12.2018, po ashtu kjo vërtetohet edhe përmes vulës se pranimit përmbareme privat ku është konstatuar se data e pranimit është 24.12.2018, ndërsa ne shkresa te lendes nuk ka prova se prapësimi është dorëzuar përmes postes ne ndonjë datë tjetër.

Andaj, nga të lartcekurat e duke u bazuar në nenin 70, 73.3 të LPP-së (Ligjit të Procedurës Përmbareme), u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË _____
PPP.nr..../2019, dt. __.__.20__

G J Y Q T A R I
N.N

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa ushtrohet përmes kësaj gjykate.

ANKESA KUNDËR AKTVENDIMIT LIDHUR ME PRAPËSIMIN

Aktvendimi mbi prapësimin nuk nënkupton përfundimin e procedurës përmbare, pasi kjo llogaritet si përfundim i një faze të procedurës në shkallë të parë, por që një vendimmarrje e tillë mund të atakohet përmes mjetit juridik të emërtuar ankesë, e që pastaj vendimmarrja i kalon gjykatës së shkallës së dytë. Pasi që gjykata e shkallës së parë të vendos në raport me prapësimin e palës debitorë, pala e pakënaqur me vendimin mbi prapësimin ka të drejtën e mjetit tjetër të rregullt juridik ankesës.

Ankesa është mjet i rregullt procedural, përmes së cilit pala e pakënaqur në raport me vendimmarrjen pas ushtrimit të prapësimin, e godet aktvendimin në lidhje me prapësimin, dhe kërkon nga gjykata e shkallës së dytë që të vendos në favor të palës ankuese, duke vlerësuar në këtë mënyrë kthimin e ligjshmërisë në vend.

Mjetet juridike si të tilla edhe pse janë garanci për palët, të njëjtat kanë një afat kohor brenda të cilit mund të paraqiten, përndryshe paraqitja pas afatit nënkupton hedhjen e tyre.

Afati i ankesës është i njëjtë me afatin për paraqitjen e prapësimi, pra brenda 7 ditëve nga dita e pranimit të vendimit mbi prapësimin.

Për dallim nga procedura kontestimore kur parimisht efekti i ankesës është suspenziv sepse nuk e lejon marrjen e formës së prerë të vendimit të atakuar me ankesë, në procedurë përmbare, ankesa nuk e ndalon procedurën përmbare, përjashtimisht apo përveç nëse janë dhënë garancitë për shumën e plotë të kredisë, ndërsa efekti tjetër është ai devolutiv, pasi me paraqitjen e ankesës themelohet kompetenca e gjykatës së shkallës së dytë. Gjykata e shkallës së dytë kryesisht vendos në kolegji prej tre gjyqtarësh, mirëpo në rastet e ankesave në procedurë përmbare vendos gjyqtari individual si gjyqtar i vetëm.

Në raport me shkaqet e ankesës ato janë pothuajse një përzierje e shkaqeve që pala i ka shfrytëzua me prapësim duke ia shtuar në disa raste edhe shkaqet e përgjithshme të ankimit sipas dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore.

Në procedurën përmbare ekziston një rast i veçantë i paraqitjes së ankesës, e që nuk lidhet me vendimin mbi përmbare, por lidhet me parregullsitë që janë kryer nga organi përmbare gjatë kryerjes së procedurës së përmbare. Afati i kësaj ankesë është po ashtu 7 ditor dhe lidhet me ndodhinë e parregullsisë, pra ekziston vetëm afati objektiv.

Ankesa sikurse u cek më lartë e ka veç një synim ky mjet duhet të shfrytëzohet me qëllim të goditjes së aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë si jo të drejtë dhe të ligjshëm, duke specifikuar elementet e kundërligjshmërisë përmes shkaqeve të ankimit, si dhe duke kërkuar nga gjykata e shkallës së dytë vendosjen e ligjshmërisë dhe drejtësisë.

Drejtësia nuk është e njëjtë me të drejtën andaj jo gjithmonë secili vendim i drejtë nënkupton edhe drejtësi në vetvete, pasi drejtësia i atribuohet diçka shumë më të lartë si diçka hyjnore ndërsa e drejta diçka të njohur dhe garantuar me ligj.

VENDIMET E GJYKATËS SË SHKALLËS SË DYTË NË RAPORT ME ANKESËN

Secila ankesë që paraqitet nga ana e palëve, fillimisht dhe detyrimisht ishte dashtë që të ekzaminohet nga shkalla e parë në aspektin e afatshmërisë, lejueshmërisë dhe interesit, e pastaj në raport me të gjeturat me rastin e ekzaminimit të vendoset dhe procedohet më tutje. Në praktikë ekzaminimi i ankesave nga ana e gjykatës së shkallës së parë është ekzaminim i lehtë dhe jo adekuat, sepse shumë ankesa të pa afatshme procedohen si të tilla në gjykatën e shkallës së parë apo ankesa të palejueshme, gjë që nuk ishte dashur të ndodh.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, pasi ta pranojë lëndën me ankesë, fillimisht e ekzaminon në aspektin e lejueshmërisë dhe afatshmërisë e më pastaj pasi të kalohet kjo fazë e ekzaminimit vendoset për meritat e ankesës.

Gjykata e shkallës së dytë me rastin e vendosjes së ankesës ka mundsi të vendos në tri mënyra në raport me ankesën: ta refuzojë ankesën dhe ta vërtetoj vendimin e gjykatës së shkallës së parë mbi prapësimin, ta aprovojë ankesën dhe ta prishë vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të njëjtës t'ia kthej në vendosje të serishme si dhe ta aprovojë ankesën dhe vendimin e gjykatës së shkallës së parë ta ndryshojë.

Shabllone të disa vendimeve të Gjykatës së Apelit

Ac.nr..../...

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË _____, me gjyqtarin individual _____, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorëve X.X etj që të gjithë nga _____, lagja Kolonia pn., të cilët i përfaqëson me autorizim _____, avokat nga Prishtina, kundër debitorës _____, të cilën e përfaqëson përfaqësuesja ligjore _____ nga _____, sipas aktgjykimit të plotfuqishëm, C.nr.../20__, i datës __.__.20__, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorës të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në _____ –Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr...../20__, i datës __.__.20__, më datë __.__.20__ mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pa themeltë ankesa e debitores _____, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në _____ –Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr..../20__, i datës __.20__, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin PPP.nr..../2019, i datës __.20__ ka refuzuar si të pa bazuar prapësimin e debitores _____, i ushtruar kundër urdhrin të përmbauesit privat _____ në Prishtinë, P.nr..../2019, i datës __.20__ dhe ka lënë në fuqi të njëjtin. Me aktvendimin e atakuar gjykata ka vendosur që ankesa kundër këtij aktvendimi nuk e ndalon procedurën përmbaimore.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, me të cilin e atakon aktvendimin për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e debitorit dhe aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë të priset dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas shqyrtimit të tyre, konform nenit 3 paragrafi 2 të Ligjit të Procedurës Përmbaimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa është e pa themeltë

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditorët përmes përfaqësuesit të autorizuar kanë paraqitur propozim për përmbaimit pranë organit përmbaimit me datë 01.11.2019. Organi përmbaimit me urdhrin, P.nr.798/2019, i datës 01.11.2019 ka lejuar përmbaimit.

Debitori në afatin ligjor ka parashtruar prapësim kundër urdhrin të organit përmbaimit me propozim që të aprovohet prapësimi si i bazuar dhe të anulohet urdhri përmbaimit.

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin, PPP.nr..../20__, i datës 16.12.2019 ka refuzuar prapësimin e debitorit duke vendosur më saktësisht sikurse në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se pas vlerësimit të pretendimeve të debitores ka gjetur se të njëjtat janë të pa bazuara për faktin se dokumenti në bazë të cilit është paraqitur propozimi për përmbaimit është në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe se i njëjti e mban vullën e plotfuqishmërisë dhe atë të ekzekutueshmërisë, si dhe i njëjti është në kopje të vërtetuar nga noteri. Gjykata e shkallës së parë tutje ka theksuar se ka gjetur se pretendimet e debitorit nuk hyjnë në shkaqet e parapara nga neni 71 i LPP-së, andaj, duke u bazuar

në kuptim të nenit 69 par.4 dhe nenit 73 par.3 të LPP-së ka vendosur sikurse në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë, Gjyqtari i Gjykatës së Apelit e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së, po ashtu gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Debitori në ankesën e parashtruar pretendon se propozimi për përmbarrim është bërë në kundërshtim me nenin 36 të LPP-së, për shkak se aktgjykimi në bazë të cilit është bërë propozimi për përmbarrim nuk e mban vulën e ekzekutueshmërisë, si dhe ndaj të njëjtit aktgjykim është ushtruar edhe revizion në Gjykatën Supreme. Po ashtu, debitori pretendon se aktgjykimi në bazë të cilit është bërë propozimi përmban gabime të shumta, tutje shton se gjykata e shkallës së parë gabimisht e ka vlerësuar edhe urdhrin edhe pse paraparakisht është dashur që të veprohet konform nenit 102 të LPK-së, në mënyrë që kreditori të bëjë plotësimin e të metave që i ka propozimi për përmbarrim.

Gjyqtari i Gjykatës së Apelit, i ka vlerësuar pretendimet e mësipërme ankimore, mirëpo konstaton se të njëjtat janë të pa bazuara. Nga shikimi i shkresave të lëndës kjo Gjykatë vëren se propozimi për përmbarrim është bërë në bazë të aktgjykimit të plotfuqishëm dhe të ekzekutueshëm, i nxjerrë nga Gjykata Themelore në _____, C.nr. _/__, i datës __.__.20__.

Neni 22 par.1 nën par. 1.1 i Ligjit për procedurën Përmbarrimore përcakton se: *“1. Dokumente përmbarruese janë: 1.1 vendimi përmbarrues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësor përmbarrues”*, në rastin konkret organi përmbarrues ka lejuar përmbarrimin në bazë të dokumentit përmbarrues, pra, vendimit përmbarrues të Gjykatës e që është në përputhje të plotë me nenin e sipërcituar. Neni 23 i Ligjit për Procedurën Përmbarrimore e përcakton se çka konsiderohet vendim gjyqësor, pra me këtë nen në paragrafin 1 përcaktohet se: *“Sipas këtij ligji, vendim gjyqësor konsiderohet aktgjykimi, aktvendimi, si dhe vendimi tjetër i dhënë në procedurën gjyqësore ose të arbitrazhit, kurse ujdi gjyqësor konsiderohet ujdia e arritur përpara Gjykatës dhe arbitrazhit si dhe marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit”*, ndërsa neni 24 par.1 përcakton se: *“Vendimi gjyqësor me të cilin është urdhëruar përmbushja e kredisë për ndonjë dhënie apo bërje, është i përmbarrueshëm po që se ka marrë formën e prerë, si dhe po që se ka skaduar afati për përmbushje vullnetare”*.

Gjykata e Apelit, vlerëson se propozimi për përmbarrim është bërë duke i zbatuar plotësisht dispozitat e LPP-së, për faktin se propozimi në fjalë pra është bërë në bazë të aktgjykimit i cili

është vendim gjyqësor sipas LPP-së, dhe se ky vendim është bërë i përmbarueshëm pasi që e ka marrë formën e prerë dhe se ka kaluar edhe afati për përmbushje vullnetare.

Po ashtu, propozimi për përmbarim i përmban të gjitha elementet e përcaktuara e nenin 38, i cili përcakton se çka duhet të përmbajë propozimi për përmbarim, ku përcaktohet se: *“Propozimi për përmbarim duhet të përmbajë kërkesën për përmbarim në të cilën tregohet dokumenti përmbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cili kërkohet përmbarimi, kërkuesi i përmbarimit dhe debitori, adresa e vendbanimit –vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditori dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbarimi, objekti i përmbarimit po që se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbarimit”*, andaj nuk qëndron pretendimi se gjykata ka vendosur në kundërshtim me nenin 102 të LPK-së, sepse nuk ka pasur nevojë që propozimi të kthehet në plotësim pasi që i njëjti ka qenë i kompletuar, duke i përmbajtur të gjitha elementet e kështu nuk ka ekzistuar asnjë pengesë ligjore që i njëjti të konsiderohet si jo i plotë.

Nuk qëndron pretendimi i debitorës, Komuna e _____ se propozimi për përmbarim është bërë në kundërshtim me nenin 36 të LPP-së, ku ky nen paragrafi 1 përcakton se: *“Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmërisë për përmbarueshmëri”*.

Nga shkresat e lëndës Gjykata e Apelit vëren se urdhri i lëshuar nga organi përmbarues është bërë në bazë të dokumentit përmbarues, pra aktgjykimit i cili i është dorëzuar organit përmbarues në kopje të vërtetuar tek noteri, me numër LRP. Nr. rendor: ____/2020, i datës __.__.20__, dhe nuk është në kundërshtim me nenin 36 të LPP-së, ashtu siç ka pretenduar debitori me ankesë.

Sa i përket pretendimit se aktgjykimi në bazë të cilit është bërë propozimi për përmbarim nuk e ka vulën e ekzekutueshmërisë dhe se kemi të bëjmë me çështje paraprake për shkak se ky rast me të cilin është vendosur me aktgjykimin në fjalë, lënda gjendet në Gjykatën Supreme as ky pretendim nuk qëndron. Në shkresat e lëndës siç u cek edhe më lart gjendet aktgjykimi në bazë të cilit është bërë propozimi për përmbarim, e ky aktgjykim e përmban vulën e plotfuqishmërisë, ku ky vendim është bërë i plotfuqishëm me datë 16.07.2019, dhe e përmban edhe vulën e ekzekutueshmërisë, e që është bërë i ekzekutueshëm me datë 30.0.2019. Fakti se aktgjykimi është goditur me mjet të jashtëzakonshëm, revizion, nuk paraqet pengesë që të përmbarohet i njëjti e që kjo është paraparë edhe me dispozita ligjore, me nenin 213 të LPK-së i cili përcakton se: *“Revizioni i paraqitur nuk është pengesë për përmbarimin e aktgjykimit të formës së prerë të goditur”*.

Gjykata, gjithmonë duke u bazuar në parimet e të drejtës më saktësisht në parimin e rigozitetit formal, e njëjta nuk ka tagër që të lëshohet në ligjshmërinë materiale dhe rregullsinë e dokumentit përmbarues, në bazë të të cilit kërkohet përmbarimi. Po ashtu, nuk mund të konstatohet në asnjë mënyrë se këtu kemi të bëjmë me çështje paraprake sepse në këtë rast nuk kemi të bëjmë me

vendosjen se a ekziston ndonjë e drejtë subjektive apo marrëdhënie juridike e që lidhur me këtë nuk është marrë ende një vendim, për shkak se tani më vetëm është marrë aktgjykimi e duke u bazuar në parimin e rigorozitetit formal, Gjykata në këtë rast kujdeset vetëm në çështjen e asaj se a është bërë propozimi për përmbarrim dhe a është lejuar përmbarrimi në bazë të dokumentit përmbarrues siç kërkohet me dispozitat ligjore në fuqi.

Debitori po ashtu, nuk ka cekur asnjë nga shkaqet e përcaktuara me nenin 71 të LPP-së për të bazuar prapësimin e tij, e po ashtu as me ankesë nuk ka paraqitur ndonjë provë apo fakt me anë të cilës do të bazonte pretendimet e tij, e meqenëse nuk ekzistojnë shkaqet ligjore nga neni 71 i LPP-së, e as pretendimet ankimore nuk qëndrojnë kjo Gjykatë e konsideron vendimin e gjykatës së shkallës së parë si të drejtë dhe të ligjshëm.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në bazë të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr. /_, të datës __.__.20__

Gjyqtari

N.N

Ac.nr..../..

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, me gjyqtarin individual N.N, në çështjen juridike përmbarrimore të kreditorit: X.X, me seli në _____, kundër debitorit Y.Y nga _____ për shkak të borxhit në shumë prej 2,351.03 euro, duke vendosur sipas ankesës së kreditorit e ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në _____ – Dega në _____, Departamenti i përgjithshëm, CPP.nr.../..., i datës __.__.20__, me datë __.__.20__ mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e themeltë ankesa e kreditorit: X.X, me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në _____ – Dega në _____i, Departamenti i përgjithshëm, CPP.nr.../..., i datës __.__.20__ **PRISHET** dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në procedim të serishëm.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në _____ – Dega në _____, Departamenti i përgjithshëm, me aktvendimin CPP.nr.../..., të datës __.__.20__, ka aprovuar në tërësi prapësimin e debitorit Y.Y nga _____, ashtu që e ka anuluar në tërësi urdhrin për lejimin e përmbarrimit të përmbarruesit privat, P.nr.1299/18, i datës 05.12.2018.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditori, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbarimore, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovet ankesa e kreditorit dhe aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet, ashtu që të mbetet në fuqi urdhri për përmbarim, apo që aktvendimi të priset dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje duke i evituar lëshimet e cekura më lartë si në ankesë.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur debitori me propozim që ankesa e kreditorit të refuzohet si e pabazuar dhe aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas shqyrtimit të tyre, konform nenit 3 paragrafi 2 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa është e themeltë

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori ka paraqitur propozim për përmbarim me datë __.__.20__, ndaj debitorit në bazë të dokumentit autentik- ekstraktit nga librat e kontabilitetit për periudhën kohore 21.02.2015 deri me 06.11.2018, në vlerë prej 2,351.03 euro.

Përmbaruesi Privat, me urdhrin P.nr.1299/18 të datës 05.12.2018, ka lejuar përmbarimin. Debitori pas pranimi të aktvendimit për përmbarim ka paraqitur prapësim me datë __.__.20__, me propozim që të anulohet urdhri i përmbaruesit privat dhe të prishen të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë çështje.

Gjykata Themelore në ___ –Dega në ___ pas pranimi të prapësimit, ka nxjerrë aktvendimin, CPP.nr.../..., i datës __.__.20__ duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit ka theksuar se pas shqyrtimit të kundërshtimit të debitorit, ka gjetur se pretendimet e kreditorit nga ekstraktet e prezantuara nuk korrespondojnë me periudhën e kërkuar kohore, propozimi për përmbarim është kontradiktor me lartësinë e pretenduar të borxhit ndaj debitorit, e po ashtu kundërthënës ngase, nga ekstrakti i transaksionit për debitorin Y.Y, konstatohet se shuma e detyrimit nga data 07.02.2015 deri me datën 06.11.2018, është shuma prej 1.019.68 euro dhe jo shuma e pretenduar andaj meqenëse kreditori disponon me të njëjtat, gjykata vlerëson se propozimi për përmbarimin e shumës në fjalë është i pabazuar, i paqartë dhe kontradiktor, andaj duke mos u lëshuar në pretendime të tjera të debitorit se borxhi i kërkuar nga kreditori është parashkruar, ka gjetur se urdhri për lejimin e përmbarimit duhet anuluar.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjyqtari i Gjykatës së Apelit nuk e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n), neni 182.1 lidhur me nenin 199 të LPK-së, nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë gjendja faktike si dhe kemi zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Dispozitivi i aktvendimit është i pakuptueshëm, në kundërshtim me arsyet e aktvendimit e po ashtu arsyet e paraqitura lidhur me faktet vendimtare të çështjes janë të mangëta dhe të paqarta, kjo për faktin se në dispozitivin e aktvendimit të atakuar gjykata thekson se ka aprovuar prapësimin e debitorit Y.Y, ndërsa në arsyetim të aktvendimit thekson se kreditori ka ushtruar propozim ndaj një personi tjetër të quajtur N.N duke mos lënë të kuptohet qartë se për cilin person bëhet fjalë, pra është e pa kuptueshme se realisht ndaj kujt është ushtruar propozimi për përmbarim.

Po ashtu, në një pjesë të arsyetimit të aktvendimit thuhet se kreditori e ka paraqitur propozimin për përmbarim për periudhën kohore 21.02.2015 deri me datë 06.11.2018, ndërsa në një pjesë tjetër, gjykata në arsyetim thekson se bëhet fjalë për periudhën nga data 07.02.2015 deri me datën 06.11.2018, prandaj edhe në këtë pjesë është plotësisht e pa qartë se për cilën periudhë kohore bëhet fjalë, sepse faktikisht nga shkresat e lëndës vërehet se kreditori propozimin për përmbarim e ka bërë pikërisht nga data 21.02.2015, e jo për datën 07.02.2015 siç edhe ka pretenduar gjykata në një pjesë të arsyetimit të aktvendimit të saj që merret edhe si kohë nga e cila ka filluar detyrimi i debitorit ndaj kreditorit.

Gjendja faktike rezulton të mos jetë vërtetuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë, sepse siç u tha edhe më lartë është e pa qartë se për cilën periudhë kohore bëhet fjalë, e po ashtu gjykata e shkallës së parë nuk ka arritur që të sqarojë se pse propozimi për përmbarim është kontradiktor, për faktin se nga shkresat e lëndës vërehet se propozimi për përmbarim si dhe datat nga ekstrakti nga librat afariste, janë të njëjta sepse kreditori e ka precizuar se për cilën periudhë e kërkon borxhin. Në arsyetim të aktvendimit gjykata ka theksuar se: *“Nga ekstrakti i transaksionit për debitorin Y.Y me numër DMI-28108, konstatohet se shuma e detyrimit nga data 07.02.2015 e gjer më datën 06.11.2018 është shuma 1.019.68 euro, dhe jo shuma e pretenduar, andaj meqenëse kreditori disponon me të njëjtat...”*, kështu duke lënë fjalinë e pa përfunduar sepse nga ky lloj i arsyetimit nuk mund të kuptohet se me çka disponon kreditori, po ashtu nuk është arsyetuar se nga ka rrjedhur shuma prej 1.019.68 euro, si dhe se për çfarë arsye nuk mund të kërkohej shuma e pretenduar nga ana e kreditorit.

Gjykata vëren po ashtu, se pala debitore është lëshuar edhe në parashkrim duke pretenduar se borxhi i kërkuar nga kreditori është parashkruar, kështu që gjykata duhet të vlerësojë mirë parashkrimin dhe të konstatojë se a bëhet fjalë për pagesën e secilës faturë veç e veç apo për borxhin e përgjithësuar, sepse ndërprerja e parashkrimit ekziston vetëm atëherë kur debitori e pranon borxhin dhe atë përmes pagesës së kështit, pagesës së kamatës, dhënia e sigurimi e që

përcaktohet me dispozitën e nenit 368 të LMD-së, e që kjo dispozitë nuk përmend askund se pagesa e faturave ndërprehet parashkrimin.

Në ri procedurë, gjykata e shkallës së parë duhet të veproj në kuptim të vërejtjeve të sipërpërmendura, ashtu që të vlerësojë çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe të ketë parasysh pretendimet e palëve në procedurë, e në veçanti të eliminoj shkeljet e konstatuar nga kjo Gjykatë, e më pas të marr të marr vendim meritore, të drejtë dhe të ligjshëm duke i zbatuar dispozitat ligjore në fuqi.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika d), të LPK-së., u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr..../..., të datës __.__.20__

Gjyqtari

N.N

Ac.nr...../20

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, me gjyqtarin individual _____, me zyrtaren ligjore _____ në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit: X.X me seli në Prishtinë, rr. "Nënë Tereza" nr.36 ndaj debitorit Y.Y rr. "Rexhep Mziu" _____, për shkak të borxhit në shumë prej 2,316.02 euro, duke vendosur sipas ankesës së debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në _____, PPP.nr...../2019 i datës __.__.2020, me datë __.__.20__ mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e themeltë ankesa e debitorit Y.Y rr. "Rexhep Mziu" _____, **NDRYSHOHET** aktvendimi i Gjykatës Themelore në _____, PPP.nr..../2019 i datës __.__.2020, ashtu që tani gjykohet si vijon: **APROVOHET** prapësimi i debitorit: Y.Y, rr. "Rexhep Mziu" _____ dhe **Anulohet** Urdhri Përmbarimor i përmbaruesit privat P.nr..../19 i datës __.__.20__

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në ____, me aktvendimin PPP.nr..../2019, i datës __.__.2019, ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar prapësimin e debitorit Y.Y, rr. "Rexhep Mziu" _____, ushtruar kundër urdhrimit mbi

lejimin e përmbarimit, P.nr...../2018 të datës __.__.2018 sipas propozimit të kreditorit X.X, rr. “Nëna Terezë” nr.36, Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që të aprovohet ankesa e debitorit dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas shqyrtimit të tyre, konform nenit 3 paragrafi 2 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa është e themeltë

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori ka paraqitur propozim për përmbarim me datë __.__.2018, ndaj debitorit në bazë të dokumentit autentik –ekstraktit nga librat afariste për periudhën kohore 14.04.2006 deri me 20.03.2013, në vlerë prej 2,316.02 euro.

Përmbaruesi Privat, me urdhrin P.nr.1.../18 të datës __.1__.2018, ka lejuar përmbarimin. Debitori pas pranimit të aktvendimit për përmbarim ka paraqitur prapësim me datë __.__.2019, me propozim që urdhri i përmbaruesit privat të anulohet.

Gjykata Themelore në ___ me aktvendimin, PPP.nr.../2019, i datës __.__.2019 ka refuzuar prapësimin e debitorit Y.Y, ndërsa ka lënë në fuqi urdhrin përmbarimor, për pagesën e borxhit në shumë prej 2,316.02 euro.

Në arsyetim të aktvendimit ka theksuar se pas shikimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, gjykata ka konstatuar se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, për faktin se iniciimi i procedurës së përmbarimit është bërë në bazë të dokumentit të besueshëm –ekstraktit të verifikuar në librat afarist dhe si i tillë është i përshtatshëm për përmbarim. Gjykata e shkallës së parë në arsyetim ka theksuar se me lidhjen e kontratës kanë lindur të drejta dhe obligime në mes të palëve kontraktuese të cilat kanë qenë të obliguara të dy palët ti respektojnë ku kreditori i ka falur një pjesë të borxhit debitorit, ndërsa ky i fundit ka qenë i obliguar që ta paguajë borxhi në mbetur në 17 këse, dhe në rast të mosrespektimit të kushteve të kontratës secila nga palët ka pasur të drejtë që të inicioj procedurën përmbarimore për mos zbatim të dispozitave kontraktuese, e që sipas gjykatës së shkallës së parë debitori nuk ka bërë pagesat e dy kësteve të fundit, atëherë janë shkelur nenet e kontratës nga debitori dhe janë shkaktuar pasoja juridike në dëm të kreditorit.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë, Gjyqtari i Gjykatës së Apelit nuk e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar edhe pse nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, drejtë është vërtetuar edhe gjendja faktike, mirëpo sipas

vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë e ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale kur ka vendosur që ta refuzojë si të pa bazuar prapësimin e debitorit.

Gjykata e shkallës së parë me vendosjen si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar duke e refuzuar si të bazuar prapësimin e debitorit dhe lënë në fuqi urdhrin për lejimin e përmbaruesit privat, nuk ka vepruar drejtë e kjo për faktin se nga shkresat e lëndës rrjedh se nga deklarata mbi poseduesin faktik, kreditori ka nënshkruar këtë deklaratë me personin e tretë N.N, sipas të cilës e njëjta ka deklaruar se është posedues faktik i njehsorit të energjisë elektrike, e po ashtu edhe nga kontrata për pagesën e borxhit vërtetohet se kjo kontratë është lidhur në mes të kreditorit dhe N.N, pasi që e njëjta është edhe shfrytëzuese e njehsorit të energjisë elektrike. Duke pasur parasysh provat në shkresat e lëndës, kjo gjykatë vlerëson se debitori Y.Y nuk ka legjitimitet real pasiv sepse i njëjti edhe nuk është shfrytëzues i energjisë elektrike dhe nuk është palë kontraktuese, që nënkupton se nuk ka nënshkruar as kontratë, apo deklaratë që do të prodhonin ndonjë efekt juridik, që të njëjtin ta bënin përgjegjës për pagesën e borxhit ndaj kreditores.

Kreditori në procedurë gjyqësore mund të kërkojë nga personi, përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata, por jo të ngarkohet debitori i cili në raportin e krijuar në mes të kreditorit dhe personit tjetër nuk ka marrë kurrfarë detyrimi.

Kreditori në rastin konkret ka lëshuar dokumentin përmbarimor faturat dhe më pastaj ka nxjerrë ekstraktin nga librat afarist në emër të debitorit, ndërsa marrëveshjen e ka nënshkruar me personin e tretë si shfrytëzues dhe posedues faktik, gjë që fatura apo ekstrakti nuk përputhet me gjendjen faktike dhe si i tillë dokumenti është i pa përshtatshëm për përmbarim, kështu në mënyrën se siç është proceduar nuk mund të kërkojë që borxhi të paguhet nga debitori, vetëm pse njehsori është evidentuar në emër të tij. Në rastin konkret gjykata vlerëson se prapësimi i debitorit gjen mbështetje në nenin 69 të LPP-së pika 1.6 e cila përcakton: “1.6. kreditori nuk është i autorizuar të kërkojë përmbarimin në bazë të dokumentit përmbarues, gjegjësisht ai nuk është i autorizuar të kërkojë përmbarimin kundër debitorit”, pasi që me hyrjen në marrëveshje për pagesën e borxhit dhe dakordimin e personit të tretë për mënyrën e pagesës kreditorit i humb e drejta të rikthejë borxhin ndaj debitorit dhe ta kërkojë atë nga debitori, pasi me nënshkrimin e kontratës e ka përjashtuar vetën nga kjo mundsi.

Mos pagesa apo mos respektimi i kontratës për pagesën e kësteve të borxhit nga ana e personit të tretë N.N, nuk mund të kuptohet si mos pagesë apo refuzim i debitorit, për çka i njëjti nuk mund të ndëshkohet me rikthim të borxhit të vjetër, krejt kjo pasi kreditori ka qenë i vetëdijshëm për rrezikun që ka hyrë me rastin e nënshkrimit të kontratës për pagesën e borxhit me personin e tretë, e në të cilën kontratë palë kontraktuese nuk ka qenë debitori.

Kontrata si e tillë është marrëveshje në mes të palëve kontraktuese, sipas të cilave palët marrin të drejta dhe detyrime reciproke, dhe se mos përmbushja ka për pasojë vetëm për palët kontraktuese dhe jo për personat e tretë.

Kreditori nuk ka të drejtë që në këtë procedurë të kërkojë rikthimin e borxhit dhe pagesën e tij nga debitori, kur debitori nuk ka pranuar borxhin si të tillë dhe po ashtu nuk ka hyrë në raport kontraktual për pagesën e të njëjtit.

Gjykata e Apelit ndër të tjera vlerëson se kreditori duke u bazuar në dispozitën e nenit 71 par.1 pika 1.6, nuk është i autorizuar që ta kërkojë përmbarimin në bazë të dokumentit përmbarues, gjegjësisht ai nuk është i autorizuar të kërkojë përmbarimin kundër debitorit, për faktin se duke u bazuar në shkresat e lëndës kreditori nuk mund të ndëshkojë debitorin për shkak të mos pagesës së personit të tretë.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në bazë të nenit 209 pika c) të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr...../20, të datës __.__.20__

Gjyqtari

N.N

Ac.nr...../19

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtarin individual N.N, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit: Kolegji “N.N” sh.p.k me seli në _____, kundër debitorit Y.Y nga _____, për shkak të borxhit në shumë prej 600 euro, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në _____ – Dega në _____, Departamenti i Përgjithshëm, CPP.nr...../.., të datës __.__.20__, më datë __.__.20__ mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e themeltë ankesa e debitorit; Y.Y nga _____, **NDRYSHOHET** aktvendimi i Gjykatës Themelore në _____ – Dega në _____, Departamenti i Përgjithshëm, CPP.nr...../.., ashtu që tani gjykohet si vijon: **APROVOHET** prapësimi i debitorit: Y.Y nga _____ i bazuar dhe Anulohet Urdhri Përmbarimor i përmbaruesit privat P.nr...../.. i datës 21.06.2019

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin CPP.nr.262/2019 në pikën I ka refuzuar si të pa bazuar prapësimin e debitorit Y.Y nga _____, ashtu që ka mbetur në fuqi urdhri për lejimin e përmbarimit p.nr.2096/19, i datës 21.06.2019.

Kundër këtij Aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, me të cilin e atakon aktvendimin për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të pranohet si e bazuar ankesa e parashtruar, ashtu që të ndryshohet aktvendimi i atakuar dhe të shfuqizohet urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr.2096/19, i datës 21.06.2019.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, Aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas shqyrtimit të tyre, konform nenit 3 paragrafi 2 të Ligjit të Procedurës Përmbimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa është e themeltë

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Kolegji “Iliria” sh.p.k ka paraqitur propozim për përmbarim kundër debitorit Y.Y për pagesën e borxhit prej 600 euro për një vit akademik të studimeve.

Debitori në afat ligjor ka ushtruar prapësim kundër urdhrimit për përmbarim duke theksuar se vendimi i lëshuar nga kreditori nuk është dokument përmbarimor dhe rrjedhimisht i njëjti nuk ka fuqi ekzekutuese dhe as nuk konsiderohet si titull ekzekutiv në bazë të cilit mund të filloj procedura përmbimore, duke propozuar që të aprovohet prapësimi dhe të shfuqizohet urdhri për përmbarim P.nr.2096/19, i datës 21.06.2019.

Kreditori nuk ka ushtruar përgjigje në prapësim.

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin CPP.nr.262/19 të datës 06.08.2019, në zbatim të dispozitave të nenit 71 dhe 73 të LPP-së, vlerësoi se prapësimet e debitorit janë të pa bazuara. Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktvendimit të ankimuar ndër të tjera ka theksuar se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, për faktin se me vendimin e nxjerrë nga kreditori, nr.12214, i datës 10.10.2014, debitori është obliguar që në emër të shumës vjetore për vijimin e vitit akademik të kreditorit të paguajë shumën prej 800 euro në vit dhe atë në fillim të vijimit të vitit akademik. Tutje në arsyetim thuhet se nga shkresat e lëndës shihet se debitori nuk e ka përmbushur detyrimin ndaj kreditorit, sipas kontratës dhe vendimit që me vullnetin e tij të lirë ka hyrë në raporte

kontraktuese dhe se nuk i ka përmbushur në tërësi detyrimet sipas këtij raporti kontraktues dhe se nga vërtetimi i lëshuar nga kreditori, debitori është në vijim të vitit të parë akademik dhe se konsiderohet se ka pasur për detyrim të pagesës vitin e parë akademik 2014/2015 të vijuar te kreditori.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë, Gjyqtari i Gjykatës së Apelit nuk e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se Aktvendimi i atakuar edhe pse nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1 lidhur me nenin 71 pika 1.1 të Ligjit të procedurës Përmbartimore, po ashtu gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, mirëpo, Gjykata e Apelit pas vlerësimit të shkresave të lëndës ka gjetur se e drejta materiale është zbatuar gabimisht kur gjykata e shkallës së parë ka vendosur që debitorit ti refuzojë prapësimin e ushtruar kundër urdhrin të përmbartuesit privat.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes në raport me prapësimin e debitorit, nuk ka vlerësuar prapësimin në raport me të drejtën e kreditorit për të kërkuar përmbartimin ndaj debitorit. Kreditori propozimin për përmbartim e ka kërkuar ndaj debitorit Y.Y në bazë të një vendimi të lëshuar nga Kolegji “_X.X” i lëshuar nga sekretari i këtij kolegji i cili vetëm tregon se debitori është regjistruar si student te kreditori për herë të parë në vitin akademik 2014/2015 në drejtimin Bachelor –Banka, Financa dhe Kontabilitet. Si i tillë ky vendim nuk ka bazë që të konsiderohet si dokument i besueshëm –titull ekzekutiv për përmbartim, për shkak se nuk përmban tipare të përmbartueshmërisë të përcaktuara me nenin 22 par.1 nënpar.1.2 të LPP-së.

Ligji nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore parasheh vendimin përmbartues në procedurë administrative si dokument përmbartues neni 22, paragrafi 1.2 i LPP-së i cili përcakton se: *“Vendim i organit administrativ, sipas këtij ligji konsiderohet vendimi dhe konkluzioni i dhënë në procedurë administrative nga organi ose shërbimi administrativ apo nga personi juridik i ngarkuar me autorizime publike”*, neni 23, paragrafi 2 i LPP-së përcakton se: *“Vendim i organit administrativ, sipas këtij ligji konsiderohet vendimi dhe konkluzioni i dhënë në procedurë administrative nga organi ose shërbimi administrativ apo nga personi juridik i ngarkuar me autorizime publike, kurse aktapajtim administrative konsiderohet ujdia e arritur në procedurën administrative përpara organit ose shërbimit, përkatësisht personit juridik të tillë, po qe se ka të bëjë me detyrimin në të holla dhe po qe se me ligj nuk është paraparë diçka tjetër”*, ndërsa neni 24, paragrafi 3 i LPP-së thotë se: *“Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbartimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë”*.

Akti administrativ është akti me të cilin organi kompetent vendos përkritazi me një të drejtë të caktuar ose obligim të caktuar, rrjedhimisht vendos për interesin e drejtpërdrejtë personal të personave fizik, juridik ose të palëve të tjera.

Si i tillë ky vendim i lëshuar nga kreditori, nuk përmban as tiparet e aktit administrativ, e as nuk përmban arsyetim, ku Ligji për Procedurën Administrative –Ligji Nr.02/L-28, i vitit 2005, i

zbatueshëm në rastin konkret (sepse këtu kemi të bëjmë për periudhën e vitit 2014, kur edhe është lëshuar vendimi për të cilin kërkohet përmbartimi ndërsa ligji në të cilin është thirrur organi përmbartues është ai i vitit 2016), më saktësisht neni 84 e përcakton qartë se çka duhet të përmbajë akti administrativ. Neni 84.1 i LPA-së përcakton se “*Në çdo rast aktet administrative duhet të tregojnë qëllimin e tyre*”. Ndërsa 84.2 përcakton se “*Akti administrativ duhet patjetër të përmbajë informacionin e mëposhtëm: a) emrin e organit të administratës publike që nxjerr aktin, numrin, datën e nxjerrjes së aktit si dhe çdo delegim kompetencash, në bazë të të cilit është nxjerrë akti; b) identitetin e palëve të cilave iu drejtohet akti; c) një përmbledhje të konstatimeve faktike bazuar vetëm në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruara nga administrata; d) një deklaram të bazës ligjore në të cilën bazohet akti; e) një shpjegim të pasojave praktike të aktit për palët në procedimin administrativ; f) një kujtesë për palët që ato kanë të drejtë të kërkojnë rishqyrtimin e çështjes; g) një kujtesë për palët që ato kanë të drejtë të apelojnë kundër vendimit në rrugë administrative ose gjyqësore; h) një kujtesë për afatet kohore që palët duhet t’i kenë parasysh për dorëzimin e kërkesës për rishqyrtim ose të ankimit administrativ apo gjyqësor; i) datën kur akti hyn në fuqi; j) nënshkrimin e udhëheqësit të organit të administratës publike që nxjerr aktin ose të drejtuesit të organit kolektiv.*” Në rastin konkret, Gjykata vëren se vendimi i lëshuar nga kreditori përveç emrit të organit që e ka lëshuar vendimin, identitetin e palëve, si dhe nënshkrimin e organit të administratës nuk përmban asnjë element tjetër apo tipar të aktit administrativ të ligjshëm.

Po ashtu, LPA përcakton se aktet administrative duhet të arsyetohen në raste konkrete, ku Neni 85 më saktësisht neni 85.1. përcakton se “*Përveç rasteve kur ligji vet parashikon dhënien e arsyeve, duhet të jepen domosdoshmërisht arsye për të gjitha ato akte të cilat pjesërisht ose tërësisht: a) mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekin në ndonjë mënyrë tjetër të drejta dhe interesa ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime; b) përbëjnë vendim në lidhje me kërkesat për rishqyrtim apo ankimet; c) përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara ose janë në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar; d) përbëjnë devijim nga praktika e ndjekur për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme; e) shkaktojnë revokimin, shfuqizimin, modifikimin ose pezullimin e një akti të mëparshëm.*” Si i tillë vendimi i lëshuar nga kreditori ka pasur për qëllim që të prekë të drejtat dhe interesat ligjore të debitorit, më konkretisht ka pasur për qëllim që të vendosë detyrim ndaj debitorit pra pagesën e studimeve, andaj, si i tillë në bazë të dispozitave të përcaktuara është dashur të përmbajë edhe arsyetimin.

Vendimi si i tillë është vendim i nxjerrë nga administrata e kreditorit, dhe i cili shërben për qëllime të funksionimit të brendshëm të aspektit administrativ të kreditorit, por ky vendim nuk hynë në kategorinë e vendimeve administrative, e të cilave LPP-ja ua ka dhënë fuqinë e dokumentit përmbartimor.

Nxjerrja e aktit administrativ mund të bëhet vetëm nëse është e bazuar në ligj, e që do të thotë se duhet të jetë në përputhje me parimin e ligjshmërisë, ku edhe neni 3 i LPA-së, përcakton parimin

e ligjshmërisë ku neni 3.1 parasheh se “*Organet e administratës publike ushtrojnë veprimtarië administrative në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovës, brenda kufijve të kompetencave që u janë dhënë atyre dhe konform qëllimit për të cilat janë dhënë këto kompetenca*” e në të kundërtën një akt jo i ligjshëm nuk mund të prodhojë as pasoja juridike, sepse një nga veçoritë e aktit administrativ është edhe përmbarueshmëria, që në rastin është objekt i shqyrtimit në këtë çështje juridike ky vendim i lëshuar nga kreditori nuk mund të konsiderohet as i ligjshëm e as i përshtatshëm për përmbarim.

Nga shikimi i shkresave të lëndës nuk është gjetur se kreditori ka ofruar ndonjë provë tjetër përveç një vërtetimi me të cilën tregon se studenti ka përfunduar ligjëratat dhe iu është nënshtruar provimeve tri herë, por që ky vërtetim nuk mund të merret për bazë, për shkak se është vetëm kopje, nuk është i protokolluar askund dhe nuk është kopje origjinale me anë të së cilës do të dëshmohej se debitori ka vijuar studimet rregullisht, iu është nënshtruar provimeve dhe se a ka bërë pagesa ndonjëherë. Po ashtu, në shkresat e lëndës nuk ekziston ndonjë dokument apo kontratë e cila do të dëshmonte se realisht debitori ka obligim që të përmbushë ndonjë detyrim ndaj kreditorit, sepse me anë të kontratës do të krijohej detyrimi në qoftë se palët kontraktuese janë marrë vesh për elementet thelbësore të saj. Ndër të tjera, nuk është vërtetuar as fakti se kreditori ndonjëherë ka kërkuar përmbushjen e detyrimit nga ana e kreditorit, ka lëshuar ndonjë faturë për pagesën e kështit mujor e që do të dëshmonte se kreditori me të vërtetë ka hyrë në marrëdhënie detyrimi me debitorin dhe se debitori nuk e ka përmbushur detyrimin e tij apo është vonuar në përmbushjen e detyrimit.

Në shkresat e lëndës siç u cek edhe më lartë nuk gjendet asnjë provë apo fakt tjetër e që do të ishte indikator që të vendosej në favor të kreditorit e të lejohej përmbarimi. Kreditori të drejtat e tij mund që të kërkojë që të realizohen përmes padisë në procedurë kontestimore, por që tani për tani në këtë çështje juridike, të drejtën e realizimit të borxhit që e ka kërkuar kreditori me propozim për përmbarim nuk mund të realizohet pasi që nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore në fuqi.

Gjykata në secilin rast kujdeset që të mbrohen pozita e debitorit dhe kreditorit, varësisht nga rrethanat, por nuk mund të legjitimon veprimet të tilla në procedurë përmbarimore që nuk kanë mbështetje ligjore.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në bazë të nenit 209 pika c) të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË _____
Ac.nr..../..., të datës __.__.20

Gjyqtari
N.N
Ac.nr.../..

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, me gjyqtarin individual N.N, në çështjen juridike përbarimore të kreditorit: X.X, të cilën e përfaqëson ____ nga ____, kundër debitorit Y.Y nga ____, rr. “Kadri Halimi”, nr.170 duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në ____ –Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, CPK.nr.../..., i datës __.__.20__, me datë __.__.20__ mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET ankesa e debitorit Y.Y nga ____ –Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, CPK.nr.../__, i datës __.__.20__, si e **PA AFATSHME**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në ____ – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil me aktvendimin CPK.nr.../..., i datës __.__.20__, në pikën I të dispozitivit të aktvendimit ka aprovuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit Y.Y nga)_____, i ushtruar kundër urdhrit përbarimor, P.nr..../..., i datës __.__.20__ i Përbaruesit Privat, _____ nga ____ dhe pjesërisht është shfuqizuar Urdhri Përbarimor sa i përket detyrimit për pagesën e shumës së të hollave në lartësi prej 728.34 euro, kurse pjesa tjetër e prapësimit të debitorit lidhur me shumën e të hollave në lartësi prej 268.53 euro në emër të borxhit për faturat e pa paguara, refuzohet si e pa bazuar në ligj, ashtu që për këtë pjesë të kërkesës ka mbetur në fuqi urdhri përbarimor P.nr.316/18, i datës 28.06.2018 i Përbaruesit Privat dhe është detyruar debitori që në afat prej 7 ditësh ta përmbush detyrimin ndaj kreditorit. Në pikën II të dispozitivit të aktvendimit është vendosur që në rast të ushtrimit të ankesës, kundër aktvendimit të atakuar debitori është liruar nga deponimi në emër të garancionit.

Kundër këtij aktvendimi ankesë ka paraqitur debitori për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim me dispozitave të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa është paraqitur pas afatit ligjor

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori ka paraqitur propozim për përbarim me datë 26.06.2018 kundër debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm. Organi përbarues me urdhrin, P.nr.316/18, i datës 28.06.2018 ka lejuar përbarimin.

Debitori në afatin ligjor ka parashtruar prapësim me propozim që prapësimin të aprovohet si i bazuar dhe të shfuqizohet urdhri përbarimor.

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin, CPK.nr.106/18, i datës 04.08.2020 ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit duke vendosur më decidi visht sikurse në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Gjykata e Apelit, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, konstatoi se aktvendimi CPK.nr.106/18, i datës 04.08.2020, është pranuar nga debitori me datën 13.08.2020, ndërsa ankesën kundër aktvendimit e ka dorëzuar në Gjykatë me datën 01.09.2020, që vërtetohet nga vula e pranimit të Gjykatës, pasi ka kaluar afati 7 ditë, për paraqitjen e ankesës. Ankesa në gjykatë ka mbërritur me datën 01.09.2020, si datë e fundit për paraqitjen e ankesës ka qenë data 20.08.2020, që do të thotë se ankesa e debitorit është paraqitur 12 (dymbëdhjetë) ditë pas afatit të paraparë ligjor.

Sipas nenit 77 paragrafi 2 i LPP-së, është përcaktuar se: *“Ankesa kundër vendimit mbi prapësimin parashtrohet përmes Gjykatës së shkallës së parë për Gjykatën e shkallës së dytë, në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit”*, andaj Gjykata e Apelit duke u bazuar në nenin 186 paragrafi 2, lidhur me nenin 208, të LPK-së, sipas të cilit ankesa është e pa afatshme po që se është paraqitur pas skadimit të afatit ligjorë për paraqitjen e saj, si dhe nenit 196, të LPK-së, ku është përcaktuar se: ankesën e vonuar, jo të plotë, apo të palejueshme, e hedhë poshtë gjykata e shkallës së dytë me aktvendim, po që se nuk e ka bërë një gjë të tillë gjykata e shkallës së parë siç është parashikuar në nenin 186 të LPK-së vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 209 pika a), të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr..../20 __, me datë ..20 __

Gjyqtari

N.N

MJETET E PËRMBARIMIT

Mjetet e përmbarimit janë metoda me të cilat organi përmbarues qoftë edhe pa pëlqimin e debitorit, ndërmerr veprime për realizimin e kredisë së kreditorit. Veprimet përmbarimore kryhen me qëllim të zbatimit të përmbarimit. Zbatimi i përmbarimit përbehet nga veprimet që i kryejnë organet përmbaruese, si gjykata apo përmbaruesi privat, me qëllim të krijimit të një situate të re materiale juridike, në mes të palëve në procedurë, apo në mes palëve dhe pjesëmarrësve të tjerë që fitojnë ndonjë të drejtë në procedurë. Llojet e mjeteve përmbarimore janë si rezultat i dinamikes së zhvillimit të rrethanave ekonomike, domosdoshmërisë për realizimin më efikas të kërkesës së

kreditorit, gjithmonë duke pasur për bazë edhe parimin e mbrojtjes së debitorit, dinjitetin e tij, duke mos cenuar me këto veprime të mirat materiale të domosdoshme për ekzistencë.

Në nenin 7 parag. 1. të LPP-së, percaktohet se: *'Mjete të përbarimit janë veprimet përbarimore ose sistemi i veprimeve të tilla, me të cilat sipas ligjit kërkesa realizohet me detyrim'.*

Vendimet përbarimore duhet të kenë formën e tyre procedurale, por edhe përmbajtjen dhe efektin juridik si pasuror, statusor, nga marrëdhënia e punës etj.

Legjislacioni në fuqi përcakton mjetet përbarimore për realizimin e kredive në të holla, si shitja e sendeve të luajtshme të debitorit, shitja e sendeve të paluajtshme, kalimin e kredisë në të holla, transferin dhe bartjen e të hollave prej llogarisë së debitorit në llogarinë e kreditorit.

Përbarimi i kërkesave në të holla realizohet në tri faza dhe atë në fazën e parë kreditori e fiton të drejtën psh, me inventarizim, në fazën e dytë shiten sendet dhe në të tretën kreditori realizon të drejtën nga shuma e shitjes së sendit.

Mënyra e përbarimit nënkupton mjetet përbarimore për realizimin e kërkesës jo në të holla të kreditorit. Këto veprime organi përbarues, si gjykata apo përbaruesi privat i ndërmer me rastin e dorëzimit të sendit të luajtshëm, zbrazjes së palujtshmërive dhe dorëzimin e tyre, detyrimin për veprim apo mosveprim, dorëzimi i fëmiut, kthimi i punëtorit në punë etj.

Në nenin 7 parag. 2. të LPP-ës thuhet se objektet e përbarimit janë pasuria dhe të drejtat tjera që mund t'i nënshtrohen përbarimit, përveç atyre që përjashtohen nga përbarimi me ligj dhe aktet ndërkombëtare të zbatueshme në Kosovë.

Objekt përbarimi janë sendet dhe të drejtat e debitorit mbi të cilat zbatohet përbarimi, ndërsa në vazhdim do të trajtohen disa sende dhe të drejta të debitorit, të cilat mund të jenë objekt përbarimi.

Veprimet përbarimore mund të kryhen drejtpërdrejtë kundër debitorëve dhe personave tjerë, në pajtim me këtë ligj.

Përbarimi në sendet e luajtshme

Për të vendosur mbi propozimin për përbarim për sendet e luajtshme, si dhe për zbatimin e përbarimit të tillë, kompetente në pikëpamje territoriale është Gjykata në territorin e së cilës ndodhen ato sende sipas të dhënave të shkruara në propozimin për përbarim (neni 82 i LPP).

Kreditori mund të kërkojë që organi përbarimor të nxjerrë aktvendimin për përbarimin për sendet e luajtshme, duke mos e përmendur vendin e ndodhjes së tyre.

Lidhur me propozimin për përbarim në sendet e luajtshme e kompetencës territoriale është Gjykata në territorin e së cilës ndodhet vendbanimi i debitorit, e nëse nuk ka vendbanim në Kosovë, atëherë në territorin e së cilës ndodhet vendqëndrimi i tij, kur kemi të bëjmë me personin fizik.

Në qoftë se Gjykata e ka caktuar përmbarimin për sendet e luajtshme që ndodhen në territorin e saj dhe të Gjykatës tjetër, atëherë pas kryerjes së përmbarimit për sendet e luajtshme në territorin e saj, aktvendimin për përmbarimin do t'ia dërgojë Gjykatës tjetër për përmbarim të mëtejshëm, deri në realizimin e plotë të kredisë së kreditorit të përmbarimit (neni 84 i LPP).

Gjykata nga e cila është larguar rasti, me përfundimin e largimit, nuk ka më kompetencë në lidhje me rastin.

Përjashtimi nga përmbarimi

Në praktikën gjyqësore ky institut ka paraqitur shume dilemma, edhe pse ligjdhënësi decidivisht është munduar të paraqes se cilat sende të luajtshme përjashtohen nga përmbarimi.

Bazuar ne nenin 85 te LPP-es përjashtohen nga përmbarimi sendet si në vijim:

- Veshjet, këpucët, ndërresat dhe gjësendet tjera personale, çarçafët, veglat e kuzhinës, orenditë, stufa, frigoriferi dhe objektet tjera me vlerë të zakonshme që shërbejnë për përmbushjen e nevojave themelore të familjes, nëse janë të nevojshme nga debitori dhe familjarët e tij;
- furnizimi me ushqim për tre (3) muaj dhe materialet për nxehje që shfrytëzohen nga debitori dhe familjarët e tij;
- kafshët e punës dhe mbarështimit, pajisjet bujqësore dhe mjetet tjera, farërat, ushqimi për kafshë, mjetet, makinat dhe objektet tjera që i duhen debitorit, bujkut apo zanatliut për vazhdimin e punës në bujqësi, respektivisht në kryerjen e aktivitetit të zanatit, të nevojshme për të fituar të ardhurat minimale të nevojshme për të mbajtur veten dhe familjarët e tij;
- librat dhe objektet tjera që janë të nevojshme nga debitori që në mënyrë të pavarur dhe me punë personale të kryej një aktivitet shkencor, artistik apo aktivitet tjetër profesional;
- të hollat e gatshme të debitorit i cili ka të hyra mujore të përhershme deri në shumën mujore që sipas ligjit përjashtohet nga përmbarimi e proporcionalisht me afatin kohor deri në pagesën e ardhshme;
- dekorimet, medaljet, certifikatat ushtarake të nderit apo dekoratat tjera të debitorit për vlerësimin e nderit, unazën e martesës, letrat personale, manuskriptet apo dokumentet tjera personale që i përkasin debitorit si dhe fotografit e familjes; dhe
- mjetet mjekësore që i jepen personave me aftësi të kufizuara apo personave tjerë me paaftësi fizike në pajtim me rregulloret, apo që ai ka përvetësuar personalisht dhe që janë të domosdoshme për kryerjen e funksioneve jetësore.

Dispozitat nga nënparagrafi 1.3. paragrafi 1. te nenit 85 te LPP nuk vlejne për përmbarrim të realizimit të kërkesave monetare të bankave, në bazë të huave specifike për qëllime të zhvillimit të bujqësisë, respektivisht zanatit, me kusht që ky qëllim është deklaruar në mënyrë të veçantë në kontratën për hua.

Pakot postare apo transferimet monetare përmes postës që i janë adresuar debitorit, nuk mund të jenë objekt i përmbarrimit para se t'i dërgohen debitorit.

Me ndryshimet e reja të LPP-es përjashtohen nga përmbarrimi edhe të ardhurat në bazë të ndihmës sociale.

Veprimet përmbarrimore

Përmbarrimi për sendet e luajtshme zbatohet me anë të regjistrimit, dhe vlerësimit të tyre, sekuestrimit, shitjes së sendeve dhe përmbushjen e kredisë së kreditorit nga shuma e fituar nga shitja e atyre sendeve. (neni 86 i LPP).

Organi përmbarrues në parim para se të filloj sekuestrimin, debitorit ia dorëzon aktvendimin për përmbarrimin dhe e urdhëron që ta paguaj menjëherë shumën e të hollave bashkë me kamatat dhe shpenzimet procedurale, për të cilën është lejuar përmbarrimi.

Nëse është e pamundshme që t'i dorëzohet debitorit aktvendimi apo urdhri përmbarrimor në rastin e sekuestrimit, atëherë lejohet kryerja e njoftimit duke vendosur një njoftim për datën e sekuestrimit në tabelën e shpalljeve të organit përmbarrimor dhe të lihet një kopje e vendimit përmbarrues në lokalet ku bëhet sekuestrimi.

Për kohën dhe vendin e sekuestrimit të sendeve të luajtshme, kreditori do të njoftohet nga organi përmbarrimor.

Mos prania e palëve nuk e pengon kryerjen e sekuestrimit. Për sekuestrimin e kryer njoftohet pala e cila nuk ka qenë e pranishme në vendin e sekuestrimit të kryer.

Sekuestrimi bëhet me anë të përpilimit të regjistrimit të inventarizimit në sendet e luajtshme që ndodhen në posedim të debitorit, si dhe sendet e debitorit që ndodhen në posedim të kreditorit. (neni 88 i LPP-es).

Në qoftë se personat e tretë nuk e njoftojnë organin përmbarrimor për të drejtat e tyre për sendet në posedim të debitorit, e as nuk i provojnë të drejtat e tyre për to në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga data e njoftimit dhe më së voni tre (3) muaj nga data e sekuestrimit, merret se të drejtat e tilla të personave të tretë nuk ekzistojnë dhe se debitori është pronar i sendeve që ndodhen në posedimin e tij.

Supozohet se bashkëshortët martesor dhe jashtëmartesor janë bashkëpronar në pjesë të barabarta të gjitha sendeve të luajtshme që gjenden në shtëpinë, banesën ose lokalit afarist të tyre.

Sendet e debitorit që ndodhen në posedim të personit të tretë mund të inventarizohen vetëm me pëlqimin e këtij të fundit.

Në qoftë se personi i tretë nuk e jep pëlqimin për inventarizim, organi përmbarues me propozimin e kreditorit, këtij të fundit ia kalon të drejtën e debitorit që t'i dorëzohen sendet nga i tretë.

Me anë të inventarizimit sekuestrues përfshihen aq sende të luajtshme, sa mjaftojnë për përmbushjen e kredisë në të holla të kreditorit të përmbarimit dhe për pagimin e shpenzimeve procedurale.

Së pari inventarizohen sendet për të cilat nuk ka vërejtje lidhur me ekzistimin e të drejtës që do ta pengonin përmbarimin dhe sendet që mund të shiten më lehtë.

Sendet e inventarizuara organi përmbarues ia lenë për ruajtje debitorit. Me propozimin e kreditorit organi përmbarues mund të vendosë që ato t'i dorëzohen për ruajtje atij (neni 90 i LPP).

Rrezikun e asgjësimit apo të dëmtimit të sendeve të inventarizuara të dhëna për ruajtje kreditorit e bartë ky i fundit, përveçse kur asgjësimi ose dëmtimi është pasojë e fuqisë madhore.

Secili person që i posedon apo mbikëqyrë sendet e inventarizuara, i ndalohet që të disponojë me sendet e tilla pa urdhrin e organit përmbarues (91 i LPP).

Fitimi i të drejtës së pengut

Kreditori e fiton të drejtën e pengut për sendet e luajtshme të inventarizuara (neni 92 i LPP-es).

Po që se me rastin e sekuestrimit në pasurinë e debitorit nuk gjenden sende të luajtshme që mund të bëhen objekt përmbarimi, organi përmbarues për një gjë të tillë do ta njoftoj kërkuesin e përmbarimit nëse nuk ka qenë i pranishëm gjatë sekuestrimit.

Me kërkesën e kreditorit i cili përcakton mundsinë se debitori dinë se ku mund të gjenden pasuritë e padeklaruara të luajtshme, organi përmbarues urdhëron debitorin që në afat prej tre (3) ditësh nga dita e dorëzimit të jep informatat për vendndodhjen e pasurive të luajtshme.

Nëse debitori nuk respekton këtë detyrim aplikohen dispozitat e neneve 15 dhe 16 të këtij ligji.

Kërkuesi i sekuestrimit, brenda afatit prej tre (3) muajsh nga dita në të cilën i është dërguar njoftimi, respektivisht nga dita e tentimit të sekuestrimit me rastin e të cilit ka qenë i pranishëm, mund të propozoj që sekuestrimi përsëri të kryhet.

Ne rastin e sekuestrimit të sendeve, organi përmbarues e bënë edhe vlerësimin e vlerës së sendeve të luajtshme.

Vlerësimin e bënë organi përmbarues, po qe se Gjykata nuk e ka caktuar për një gjë të tillë vlerësuesin gjyqësor apo ekspertin e posaçëm, ose përmbaruesi privat ka caktuar një ekspert të posaçëm.

Për propozimin për caktimin e ekspertit organi përmbaues vendosë me anë të vendimit që ka formë të konkluzionit.

Secila palë ka të drejtë që brenda afatit prej tre (3) ditësh, nga dita e vlerësimit të bërë të sendeve të sekuestruara, që t'i propozojë organi përmbaues caktim të vlerës më të vogël apo më të madhe të sendeve të sekuestruara nga ajo e caktuar më parë, apo caktim të vlerësimit të ri. Një gjë e tillë nuk lejohet po që se vlerësimin e parë e ka bërë eksperti. Lidhur me këtë propozim organi përmbaues vendosë me anë të konkluzionit.

Shitja e sendeve të sekuestruara

Në praktiken gjyqësore organizimi i ankandëve mbetet sfidë për shkak të mungesës së hapësirave ku gjykatat do të vendosnin sendet e sekuestruara, si dhe krijimit të mendimit se sendet në ankande publike nuk duhet blerë.

Shitja e sendeve të sekuestruara kryhet jo më herët se pesëmbëdhjetë (15) ditë dhe jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga data e sekuestrimit.

Shitja mund të bëhet edhe para skadimit të afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga po që se debitori propozon, apo pajtohet me propozimin e kreditorit që shitja e sendeve të sekuestruara të bëhet më herët.

Shitja e sendeve të sekuestruara mund të bëhet para skadimit të afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, po që se sendet e këtilla prishen shpejtë, apo kur ekziston mundësia që të bie dukshëm çmimi i tyre pas një kohe të shkurtër.

Në qoftë se kreditori jep garancinë për dëmin eventual që do të duhej kompensuar debitorit në rast të anulimit të vendimit për përmbaues, shitja e sendeve të sekuestruara mund të bëhet edhe para skadimit të afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh.

Shitja e sendeve të sekuestruara bëhet me anë të ankandit verbal publik ose me ujdinë e drejtpërdrejtë midis blerësit, nga njëra anë dhe organi përmbaues, apo subjektit tjetër të autorizuar, nga ana tjetër.

Mënyra e shitjes së sendeve caktohet me anë të konkluzionit të organit përmbaues, duke pasur parasysh faktin që të arrihet çmimi më i volitshëm për debitorin.

Ankandin publik të shitjes e administron organi përmbaues, apo personi tjetër i caktuar nga organi përmbaues.

Shitja me anë të ujdisë së drejtpërdrejtë bëhet midis blerësit, nga njëra anë dhe organit përmbaues, apo personit që kryen veprime komisioni, nga ana tjetër. Organi përmbaues sendet e sekuestruara i shet në emër dhe llogari të debitorit, kurse personi që merret me veprime komisioni, në emër të vet, por për llogari të debitorit.

Shitja me anë të ankandit do të caktohet në qoftë se është fjala për sendet e sekuestruara që kanë

vlerë të madhe, ndërkaq mund të pritët se ato do të shiten sipas çmimit më të lartë nga sa është shuma e vlerësuar.

Shitja e sendeve do të publikohet në tabelën e shpalljeve të organit përmbaues së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë para se të mbahet seanca për shitjen e tyre. Publikimi i shitjes mund të bëhet edhe në mënyrën e paraparë për publikimin e shitjes së sendeve të paluajtshme. Pala mund të përcaktojë se, përveç këtyre mjeteve të shpalljes së shitjes publike, mund të përdoren mjetet tjera të shpalljes, në shpenzim të asaj pale, dhe organi përmbaues do të ndihmojnë që shpallja të bëhet edhe me këto mjete shtesë.

Kreditori dhe debitori do të informohen për vendin, ditën dhe orën e shitjes së sendeve të sekuestruara (Neni 99 i LPP-es).

Seanca e shitjes publike

Neni 15 i ligjit për ndryshime dhe plotësime parashikon që të mbahet vetëm një seancë e ankandit të shitjes. Sendet e sekuestruara mund të shiten në seancën e shitjes publike me çmim më të vogël se ai i caktuar, por jo me çmimin më të vogël së pesëdhjetë përqind (50 %) e vlerës së caktuar me rastin e regjistrimit dhe vlerësimit të sendeve të luajtshme të debitorit, respektivisht në afatin që e ka caktuar organi përmbaues për shitjen e tyre me anë të ujdisë së drejtpërdrejtë.

Seanca e shitjes publike mbahet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e sekuestrimit. Nëse sendet e sekuestruara nuk shiten në seancën e shitjes, atëherë kreditori mund të kërkojë transferimin e sendeve në pronësi të tij, për mbulim të pjesshëm apo të plotë të kredisë në çmim të vlerësuar të atyre sendeve, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e mbajtjes së seancës së shitjes publike.

Organi përmbaues e pezullon përmbauesimin, nëse nuk ka asnjë ofertues apo nëse nuk ka propozim për shitjen me anë të ujdisë së drejtpërdrejt brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve apo nëse kreditori nuk paraqet propozim për transferim të sendeve në pronësi të kreditorit sipas paragrafit 3. të nenit 100 të ligjit.

E drejta e pengut

Përkufizimin e pengut e rregullon Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Pronësore ku në nenin 133 citohet “E drejta e pengut” (pengu) do të thotë krijimi i ndonjë interesi mbi pasurinë e luajtshme ose mbi ndonjë të drejtë me anë të marrëveshjes ose me anë të ligjit, i cili i jep pengmarrësit të drejtën për ta marrë në posedim atë pasuri ose për ta shfrytëzuar atë të drejtë me qëllim të përmbushjes së ndonjë obligimi ekzistues dhe të identifikueshëm që është siguruar me anë të pengut.

Kontrata e pengut mund t’i shmanget dispozitave të këtij ligji. Në raste të veçanta ajo mund të parasheh që pengu të sigurojë ndonjë obligim i cili ka efekt vetëm pas lidhjes së kontratës së pengut.

Bazuar ne dispozitat e Ligjit për Pronësinë dhe te drejtat tjera Sendore, e drejta e pengut ligjor ka efekt ndaj palëve të treta vetëm atëherë kur të parashtrohet deklarata për njoftim në përputhje me ligjin. Përveç në rastet kur palët pajtohen ndryshe, e drejta e pengut ligjor të qiradhënësit ka efekt vetëm atëherë kur sendi i lënë peng të ketë kaluar në posedim të qiradhënësit.

Pengu gjyqësor mund të themelohet me vendim te organit gjyqësor. Në këto raste vendimi i gjykatës paraqet titullin juridik për fitimin e të drejtës se pengut. Konstituimi i kësaj të drejte bëhet në kundërshtim me vullnetin e debitorit. Megjithatë ka raste kur edhe në procedurën përbarimore themelohet pengu gjyqësor me marrëveshjen e kreditorit dhe debitorit.

Kontrata mundet në çdo kohë të plotësohet, të ndryshohet apo të shuhet.

Organi përbarues ka për obligim qe pas krijimit të pengut gjyqësor të vazhdoi me procedurën përbarimore, të organizoj ankandet publike për shitjen e sendeve me qellim të realizimit të kërkesës së kreditorit.

Me rastin e përbarimit të pengut të kontraktuar organi përbarues ka për detyrë që në bazë të kërkesës së kreditorit, të marre sendet e lëna peng dhe ti dorëzoj kreditorit, ku me pas kreditori organizon shitjen sipas dispozitave ligjore.

Autorizimi për shitjen e sendit të lënë peng

Pengdhënësi duhet të jetë pronar i sendit të lënë peng në kohën e lënies së pengut. Nëse pengdhënësi nuk është pronar i sendit të lënë peng, ai duhet të ketë autorizimin ligjor për vënien e të drejtës së pengut.

Pasuria e një bashkëpronësie ose të një pronësie të përbashkët mund të lihet peng vetëm nëse të gjithë bashkëpronarët ose pronarët e përbashkët e japin pëlqimin për pengun.

Një e drejtë e pengut e siguron tërë shumën e kërkesës, duke përfshirë kapitalin dhe kamatën e papaguar, dënimet kontraktuese, shpenzimet e zbatimit, të mirëmbajtjes dhe shitjes së objekti të pengut.

Pas krijimit të së drejtës së pengut, pengdhënësi dhe pengmarrësi mund të pajtohen që ta rrisin kërkesën e siguruar ose ta rrisin objektin e pengut. Për çdo rritje e cila nuk është e bashkëngjitur apo e lidhur me objektin e pengut, duhet të trajtohet si krijim i një të drejte të re të pengut.

E drejta e pengut ndaj palëve te treta

Kjo e drejte është e parapare ne nenin 149 te Ligjit për pronësinë dhe te drejtat tjera sendore (në vazhdim LPDS) ku citohet "*Nëse një kërkesë për pagesë në të holla është lënë peng, atëherë debitori i kësaj kërkesë ("debitori i tretë") mund ta përmbushë detyrimin në përputhje me kontratën me pengdhënësin".*

Nëse pengdhënësi ose pengmarrësi e ka njoftuar debitorin e tretë lidhur me lënien peng, debitori i tretë duhet t'ia bëjë pagesën pengmarrësit, pasi të ketë ardhur koha për pagesën e kërkesës së lënë

peng.

Njoftimi për debitorin e tretë duhet të bëhet me shkrim, të përfshijë emrat e pengdhënësit dhe pengmarrësit, të identifikojë kërkesën e siguruar me anë të pengut dhe të përmbajë udhëzime të sakta rreth mënyrës së pagesës për pengmarrësin.

Bazuar në nenin 150 debitorin e tretë ka të drejtë të bëjë kundërshtimet e njëjta lidhur me kërkesën për pagesë nga pengmarrësi, të cilat ai i ka kundër pengdhënësit, si kreditori paraprak i kërkesës së lënë peng.

Në qoftë se nuk është arritur marrëveshje tjetër, një pengdhënës mund të lë peng disa sende pasurore ose të drejtën e njëjtë.

Fitimi i sendit të lënë peng nga pala e tretë

Në bazë të dispozitave të Ligjit për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, sendi i lënë peng mund të ngarkohet apo të fitohet nga pala e tretë vetëm në bazë të ndonjë të drejte ekzistuese të pengut. Sendi i lënë peng fitohet i pangarkuar, nëse:

- *sendi i lënë peng është shitur në qarkullimin afarist të zakonshëm të pengdhënësit;*
- *sendi i lënë peng është shitur me pëlqimin e dhënë me shkrim nga të gjithë pengmarrësit të cilët kanë ndonjë të drejtë të pengut në atë send;*
- *sendi i lënë peng është ndonjë aksion, borxh ose ndonjë instrument sigurie i ofruar në ndonjë treg të pranuar, ndonjë instrument negociimi apo dokument pronësie, ose para të gatshme; ose*
- *blerësi mund të supozojë me mirëbesim në kohën e blerjes se ndaj sendit të lënë peng nuk ekziston ndonjë e drejtë tjetër.*

Regjistrimi i të drejtave të pengut pa posedim

Sipas nenit 162 të Ligjit për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore regjistrimi i të drejtës së pengut pa posedim në regjistrin e pengut prodhon efekt me regjistrimin e njoftimit të pengut në zyrën për regjistrimin e pengut. Njoftimi i pengut përfshin:

- *identitetin e qartë të pengdhënësit, personit i cili duhet ta paguajë kërkesën e siguruar nëse nuk është pengdhënësi) dhe të pengmarrësit;*
- *përcaktimin e veçantë apo të përgjithshëm të natyrës së detyrimit të siguruar;*
- *vlerën maksimale të detyrimit të siguruar të shprehur në para;*
- *përcaktimin e veçantë apo të përgjithshëm të sendit të lënë peng;*
- *nënshkrimin nga pengdhënësi ose në emër të tij; dhe*
- *datën e kontratës së pengut.*

Një peng konsiderohet të jetë i regjistruar në regjistrin e pengut, atëherë kur njoftimi i pengut të ketë arritur në zyrën për regjistrimin e pengut në formën e parashikuar dhe duke e paguar taksën e parashikuar.

Regjistrimi në regjistrin e pengut është i vlefshëm për tri (3) vjet nga koha e regjistrimit. Me kalimin e afatit tri (3) vjeçar, e drejta e pengut pa posedim e humb efektin e saj ndaj personave të tretë, përveç kur vazhdohet regjistrimi ose kur pengu pa posedim shndërrohet në peng posedimor.

Ekzekutimi i se drejtës se pengut

Bazuar në nenin 166 Ligjit për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore nëse pengdhënësi ose debitori i detyrimit të siguruar, nëse ky nuk është njëkohësisht pengdhënës, nuk e përmbush detyrimin e siguruar ose kontratën e pengut, pengmarrësi i pengut pa posedim mund të kërkojë nga pengdhënësi që t'ia dorëzojë sendin e lënë peng.

Nëse pengdhënësi i pengut pa posedim nuk e dorëzon sendin e lënë peng, pengmarrësi mund ta marrë në posedim sendin e lënë peng me ndihmën e gjykatës kompetente.

PËRMBARIMI NË SENDET E PALUAJTSHME

Objekt i përmbarimit përveç sendeve monetare, sendeve tjera të luajtshme, munden me qenë edhe sendet e paluajtshme. Sa i përket përkufizimit të sendeve të paluajtshme tashmë kjo përcaktohet sipas Ligjit për Pronësinë dhe Të Drejtat e Tjera Sendore dhe sipas përkufizimeve në doktrinën shkencore, të cilat përcaktojnë tokën dhe atë që është e ndërtuar në të, e që lëvizja apo transportimi i të njëjtës nga një vend në tjetrin të mos bëhet pa ia ndryshuar formën.

Objekt i përmbarimit në sendet e paluajtshme janë kryesisht karakteristikë me rastin e hipotekës, kur debitori me qëllim të ofrimit të garancisë për kthimin e kredisë me vullnetin e tij.

Përmbarimi në sendet e paluajtshme realizohet nëpër disa faza apo hapa të caktuar, ku fillimisht në bazë të kontratës mbi hipotekën regjistrohet e drejta e kreditorit në sendin e debitorit në regjistrat e pronës pranë Komunës ku gjendet prona. Pas regjistrimit kreditori nëse nuk mund ta realizon të drejtën e tij nga debitori, kalohet në procedurën e shitjes së hipotekës, sepse edhe ashtu e drejta e hipotekës ka kuptimin e sigurimit të kredisë, që në rast të mos pagesës apo kthimit të kredisë, kreditori të fitojë të drejtën që nga sendi i lënë peng si hipotekë të realizon të drejtën e tij. Pra është me rëndësi të cekët se sikur sendet e luajtshme që regjistrohen si peng, por edhe sendet e paluajtshme vlerësohen, duke iu përcaktuar një çmim, e më pastaj hapet procedura e shitjes së hipotekës, përmes shitjes me ankand. Ankandi nënkupton thirrje publike që sendet e lëna peng apo hipotekë në kohën e caktuar në vendin e caktuar do të kenë mundsi të ofertojnë për blerje nga personat e interesuar. Në procedurën e shitjes së hipotekës hapet ankandi ku është e përcaktuar minimumi i çmimit të hipotekës nën të cilin çmim nuk ka mundsi në shitet në ankandin e parë e që është 80 % i vlerës, më pastaj nëse kjo nuk realizohet, duke respektuar afatet kohore caktohet ankandi i dytë me kusht që pasuria mos të ketë mundsi të shitet nën vlerën e 50 % të objektit, dhe

nëse dështon shitja edhe në seancën e dytë të ankandit kalohet në seancën e tretë ku çmimi minimal apo më i ultë nuk mundet me qenë nën 1/3 e vlerës së sendit.

SHITJA E PALUAJTSHMËRIVE

Përmbartimi në sendet e paluajtshme rregullohet sipas dispozitave nga neni 190 deri në nenin 271 të LPP-ës si dhe sipas nenit 22 të Ligjit Nr. 05/L-118, për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit të procedurës përmbartimore nr. 04/L-139.

Në rastet kur përmbartimi kërkohet me shitjen e paluajtshmerive si atyre që nuk janë vënë nën hipotekë, po ashtu edhe të atyre të vëna në hipotekë paraqesin mënyrën më të vështirë të realizimit të kërkesës së kreditorit, për arsye se kostoja e procedurës është e lartë, duke pasur parasysh faktin se duhet të ndërmerren shumë veprime të cilat shkaktojnë vonesa të mëdha.

Kurse objekt ekzekutimi mund të jetë paluajtshmeria e cila nuk është vënë nën hipotekë me marrëveshjen e palëve veprimet ekzekutive të gjykatës duhet kalojnë nëpër disa faza:

- Shënimi i paluajtshmerisë në librat publike,
- Përcaktimi i vlerës së paluajtshmerisë,
- Shitja e paluajtshmerisë, dhe
- Pagimi i kreditorëve nga shitja e paluajtshmerisë.

Paluajtshmeria si objekt ekzekutimi mund të bëhet si tersi e caktuar me anë të dispozitave që rregullon pronësinë, si dhe bashkëpronësia mund të jetë objekt ekzekutimi.

Ankandet

Qëllimi i ankandit publik është të fitohet çmimi më i lartë i mundur për paluajtshmerinë duke inkurajuar për pjesëmarrje numër të madh të ofertuesve. Në rast se vetëm një ofertues është prezent, ligji lejon që procedura të vazhdojë. Kjo parashihet njësoj në ligjin e vjetër ashtu edhe në të riun.

Afatet në mes të ankandëve janë më të gjatë nga afatet e ankandëve për sendet e luajtshme duke pas për qëllim të tërheqjen e ofertuesve të rinjë.

Shitjet me ankand janë duke u përcjellur me probleme të mëdha në praktikë në Kosovë. Sfida kryesore është interesimi i vogël i palëve për të blerë këto paluajtshmeri i gërshetuar me mendimin e krijuar se sendet e vëna në hipotekë pas blerjes mund të përcillen me probleme. Ky mendim duhet harruar sa më parë dhe duhet kuptuar se edhe ky është një proces ligjor që duhet realizuar. Kjo situatë shihet se është duke u përmirësuar, por me hapa shumë të ngadalshëm.

Konform dispozitave ligjore gjyqtari ka për detyrë që të verifikojë se:

- *Paluajtshmeria është pronë e debitorit;*
- *Vendimi mbi përmbartimin është regjistruar në librin publik të paluajtshmerive;*

- *Njoftimi mbi ankandin është publikuar së paku 30 ditë para ankandit; si dhe*
- *Të udhëheqë ankandin publik, përfshirë përfundimin e ankandit 5 minuta pas ofertës më të mirë.*

Ligji Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit te procedurës përbarimore nr. 04/L-139, parasheh vetëm dy ankande të shitjes se paluatshmerive. Në seancën e parë të shitjes publike, paluajtshmëria nuk mund të shitet me çmimin që është më i ulët se pesëdhjetë përqind (50%) e vlerës së përcaktuar me vlerësimin e paluajtshmërisë. Ofertat fillestare në seancën e parë të shitjes publike, të cilat janë më të vogla se pesëdhjetë përqind (50%) e vlerës së përcaktuar, nuk do të shqyrtohen.

Në qoftë se paluajtshmëria nuk ka mundur të shitet në seancën e parë të shitjes publike, organi përbarues e cakton seancën e dytë të shitjes publike, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) deri në tridhjetë (30) ditë. Në këtë seancë, paluajtshmëria nuk mund të shitet me çmim më të vogël se një e treta (1/3) e vlerës së përcaktuar të paluajtshmërisë”.

Në qoftë se paluajtshmëria nuk ka mundur të shitet as në ankandin e dytë, atëherë me propozim të kreditorit, organi përbarues merr vendim që paluajtshmëria t’i dorëzohet kreditorit duke kaluar në pronësi të tij, me ç’rast edhe kërkesa ndaj debitorit konsiderohet si e përmbushur në tërësi.

Po që se nuk ekzistojnë persona me të drejtë parablerjeje ligjore, apo kontraktuale, atëherë personi i cili sipas këtij ligji e ka të drejtën e realizimit me prioritet të kredisë së tij nga çmimi i shitjes, e fiton të drejtën e parablerjes së paluajtshmërisë me çmimin e arritur në seancën e dytë.

Po ashtu është ndryshuar edhe neni 220 i ligjit bazik, pas paragrafit 1., shtohet paragraf i ri 1a., me tekstin si vijon: 1a. *‘Në rast të kontestimit të vlerës së paluajtshmërisë, të arritur nga palët para procedurës përbarimore, organi përbarues me propozim të palëve mund të caktoj ekspertin përkatës për caktimin e vlerës së paluajtshmërisë’.*

Shitja me marrëveshje

Nëse palët dhe kreditorët e hipotekës arrijnë marrëveshje për shitjen e pronës pa ankand, do të bëhet shitja me marrëveshje të drejtpërdrejtë. Shitja e drejtpërdrejtë duhet të shënohet në kontratë me shkrim .

Në praktikë, kjo mënyrë e shitjes shpesh ka qenë e duhur për shkak të problemeve me shitjen në ankand. Në çdo kohë, palët dhe kreditorët e pengut mund të pajtohen të kalojnë nga procedura e ankandit në marrëveshje. Vendimi i tyre duhet të shënohet në procesverbalin e procedurës së përbarimit.

Hipoteka si rast special i pasurisë së paluajtshme të regjistruar

Hipoteka në Kosovë është rregulluar me Ligjin për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore nr. 03/L-154, si dhe me Ligjin për hipotekat nr. 2002/4.

“Hipoteka” do të thotë krijimi i interesit në pasurinë e paluajtshme me anë të marrëveshjes apo ligjit, që kreditorit të hipotekës (pengmbajtësit) i jep të drejtën të iniciojë procedurën për heqjen e të drejtës mbi pronën e vënë në hipotekë për pasurinë e tillë të paluajtshme, me qëllim të përmbushjes së një detyrimi që është siguruar me hipotekë dhe që duhet të paguhet.

Hipoteka krijohet përmes një kontrate ndërmjet pronarit të paluajtshmerisë së ngarkuar dhe kreditorit hipotekues, si dhe përmes regjistrimit në Regjistrin e të drejtave për paluajtshmeritë neni 173 i Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore.

Kontrata e hipotekës duhet të lidhet në formën me shkrim. Nënshkrimet e pronarit të paluajtshmerisë dhe kreditorit hipotekues duhet të vërtetohen sipas të njëjtave rregulla sikurse punët e tjera juridike rreth paluajtshmerisë.

Hipoteka shtrihet mbi të gjitha pjesët e paluajtshmerisë së ngarkuar, duke përfshirë edhe ndërtesat që aty qëndrojnë apo janë të lidhura në mënyrë të pandashme me tokën.

Përjashtimisht nga paragrafi 1 i nenit 176 te Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore mund të krijohet një hipotekë e pavarur, e cila nuk shtrihet mbipjesët e tjera të paluajtshmerisë në një ndërtesë ose në një banesë, të cilat i plotësojnë kushtet e nenit 10 paragrafi 2 nën-paragrafët 2.1. dhe 2.2. të këtij ligji.

Hipoteka përfshin edhe të gjitha pjesët tjera dhe frutat natyrore të paluajtshmerisë, përderisa këto nuk janë të ndara nga sendi kryesor.

Nëse paluajtshmëria është dhënë me qira, hipoteka shtrihet edhe në kërkesat nga qiraja të pronarit të paluajtshmerisë.

Paluajtshmëria me shumë pronar

Në një pjesë të bashkëpronësisë ose të pronësisë së përbashkët nuk mund të vihet hipoteka pa pëlqimin e bashkëpronarëve të tjerë ose të pronarëve të përbashkët (neni 179 i Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore).

Hipoteka e përbashkët

Një hipotekë mund të vihet për të njëjtën kërkesë në disa paluajtshmeri të të njëjtit pronar ose të pronarëve të ndryshëm (hipoteka e përbashkët). Secila paluajtshmeri përgjigjet për tërë kërkesën e siguruar.

Kërkesa e siguruar

Hipoteka siguron tërë shumën e kërkesës duke përfshirë kapitalin dhe kamatën papaguar, dënimet kontraktuese, shpenzimet e zbatimit të mirëmbajtjes dhe shitjes.

Pronari i paluajtshmërisë së ngarkuar administron dhe mirëmban me kujdes këtë, duke përfshirë edhe ndërtimet e krijuara mbi to, si dhe sendet aksesore, sa është e nevojshme për përkujdesjen dhe mirëmbajtjen e zakonshme. Pronari i paluajtshmërisë i lejon kreditorit hipotekues apo një të treti të autorizuar nga ky këqyrjen e paluajtshmërisë së ngarkuar, nëse për këtë paralajmërohet me kohë para kohës së caktuar.

PËRMBARIMI I VENDIMIT PËR KTHIMIN E PUNËTORIT NË PUNË

Bazuar në dispozitën e nenit 313 të ligjit për Procedurën Përmbarimore, propozimi për përmbarim mund të paraqitet brenda afatit prej 90 ditëve, ndërsa lidhur me afatin për paraqitjen e propozimit, gjykata vendos sipas detyrës zyrtare, prandaj propozimet e paraqitura pas afatit do të hedhen poshtë si të pas afatshme.

Mënyra e zbatimit të përmbarimit

Zbatimi përmbarimit për kthimin e punëtorit në punë nënkupton angazhimin e vërtetë të tij në procesin e punës. Sipas dispozitave të ligjit të ri për procedurën përmbarimore lidhur me zbatimin e kthimit të punëtorit në punë është paraparë dënimi me të holla dhe shpërblimi i të ardhurave personale.

Sipas dispozitës së nenit 314 të LPP-së përmbarimi në bazë të dokumentit ekzekutiv sipas të cilit punëdhënësi është i detyruar që punëtorin ta kthejë në punë, apo që ta sistemojë në vendin përkatës të punës, zbatohet me shqiptimin e dënimit me të holla kundër punëdhënësit dhe personit përgjegjës duke aplikuar dispozitat e nenit 15 dhe 16 të këtij ligji. Shpërblimi i të ardhurave personale është paraparë në dispozitën e nenit 315 të LPP-së.

DORËZIMI DHE MARRJA E FËMIJËS

Përmbarimi i vendimeve nga lëmia e së drejtës familjare mbeten kompetencë ekskluzive e gjykatave, duke pasur për bazë ndjeshmërinë e këtyre çështjeve, ndërlikueshmërinë e tyre, si dhe ndërmarrjen e veprimeve që kërkohet kujdes i veçantë nga organet e specializuara.

Bazuar në nenin 318 të LPP-së, *“Për të vendosur për propozimin për përmbarimin e vendimit të Gjykatës me të cilin urdhërohet dorëzimi i fëmijës prindit, apo personit tjetër, respektivisht institucionit të cilit i është besuar fëmija në ruajtje dhe edukim, është kompetente Gjykata e cila është e kompetencës së përgjithshme territoriale për palën që e kërkon përmbarimin, por edhe Gjykata në territorin e së cilës ndodhet fëmija”*. Ndërsa lidhur me zbatimin e përmbarimit, kompetente në pikëpamje territoriale, është Gjykata në territorin e së cilës ndodhet fëmija në kohën e përmbarimit.

Mënyra e zbatimit të përmbarimit

Me rastin e zbatimit të përmbarimit, Gjykata sidomos kujdeset për nevojën që të mbrohen interesat e fëmijës në masën më të madhe të mundshme, neni 320 i LPP-së. Zbatimi i përmbarimit bëhet përmes shqiptimit të gjobave, e nëse nuk ka sukses kjo atëherë me marrjen dhe dorëzimin e fëmiut prindit tjetër, përkatësisht personit tjetër të cilit i është besuar fëmija dhe me dorëzimin e fëmijës prindit përkatësisht personit tjetër të cilit i është besuar ai për ruajtje dhe edukim (neni 352 I LFK-së).

Me aktvendimin për përmbarimin, Gjykata i cakton debitorit afat prej tri (3) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar aktvendimi, që fëmijën t'ia dorëzoj prindit, apo personit tjetër, respektivisht institucionit të cilit fëmija i është besuar në ruajtje dhe edukim, me kërcënim të shqiptimit të gjobës në të holla. Gjoha në të holla shqiptohet dhe përmbarohet sipas dispozitave të LPP-së, për kryerjen e veprimit që mund ta bëjë vetëm debitori.

Marrja e fëmijës

Përrjashtimisht nga dispozitat nga neni 320 të LPP, në rastin në të cilin konstatohet se i është rrezikuar jeta, shëndeti, ose zhvillimi psikofizik i fëmijës, Gjykata do ta zbatojë përmbarimin pa caktuar paraprakisht afat për dorëzimin e fëmijës dhe pa shqiptuar gjoha gjyqësore, duke marrë fëmijën dhe duke ia dorëzuar prindit, apo personit tjetër, respektivisht institucionit të cilit fëmija i është besuar në ruajtje dhe edukim.

Marrjen dhe dorëzimin e fëmijës, mund ta bëjë vetëm Gjykatësi në bashkëpunim me psikologun e organit të kujdestarisë, të shkollës, këshillimores së familjes, apo të institucionit tjetër të specializuar për ndërmjetësim në marrëdhëniet familjare. Mendimi i ekspertit në këtë fazë të procedurës është shumë i rëndësishëm, por gjykata pavarësisht mënyrës se dhënies se këtij mendimi duhet ta përfundoj përmbarimin edhe në rastet kur eksperti jep mendim ndryshe për faktin që të mos krijohet precedent për mos ekzekutimin e vendimeve në të ardhmen, për këtë është dhënë edhe opinion juridik i Gjykatës Supreme të Kosovës.

Gjykata me propozimin e palës të cilës i është besuar fëmija, e vazhdon ekzekutimin sipas të njëjtit aktvendim për përmbarimin, në qoftë se fëmija në afatin tre mujor, nga dita e dorëzimit të fëmijë përsëri gjendet te personi nga i cili është marrë

KUNDËR PËRMBARIMI

Procedura e kundër përmbarimit nënkupton të drejtën e debitorit, që të kërkoj kthimin e sendit apo kredisë së marrë në procedurën e përmbarimit nga ana e kreditorit, në këtë rast debitori merr rolin

e kreditorit faktikisht dhe kreditori aktual rolin e debitorit. Pra e drejta e kërkesës përcakton edhe rolin faktik në procedurë.

Procedura e kundër përmbarrimit është e rregulluar dhe specifikuar me dispozita ligjore, ku me nenin 54 janë përcaktuar në mënyrë taksative shkaqet e kundër përmbarrimit:

“1. Debitori ka të drejtë që në të njëjtën procedurë përmbarrimore edhe pasi të ketë përfunduar përmbarrimi, të kërkojë nga Gjykata nxjerrjen e aktvendimit me të cilin i urdhërohet kreditorit që t’ia kthejë atë që e ka marrë në bazë të procedurës së përmbarrimit, në qoftë se:

1.1. dokumenti përmbarrues me anë të vendimit të formës së prerë është prishur, ndryshuar,

anuluar, shfuqizuar, ose në ndonjë mënyrë tjetër është konstatuar se është i pa efekt juridik;

1.2. aktvendimi apo urdhri për përmbarrim me anë të vendimit të formës së prerë është anuluar apo ndryshuar;

1.3. gjatë kryerjes së procedurave përmbarruese, kreditori ka marrë më shumë sesa vlera e kredisë, përfshirë kostot e përmbarrimit dhe kamatat;

1.4. përmbarrimi i kryer në një objekt specifik të përmbarrimit është i palejuar.

2. Në qoftë se kreditori me anë të përmbarrimit e ka realizuar një shumë të hollash, debitori në propozimin për kundër përmbarrim mund të kërkojë pagimin e kamatëvonesës që nga dita e pagimit të shumës së tillë.

3. Propozimi për kundër përmbarrim nga paragrafi 1. i këtij neni mund të paraqitet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita në të cilën debitori ka marrë dijani për shkakun e kundër përmbarrimit por jo më vonë se një (1) vit nga dita e përfundimit të procedurës përmbarrimore.

4. Pas skadimit të afatit nga paragrafi 3. i këtij neni, debitori nuk mund të fillojë kundër përmbarrimin, por duhet të fillojë procedurën kontestimore për kërkesën e tij.”

Pra kundër përmbarrimi mund të kërkohet vetëm nga shkaqet e përcaktuara me ligj.

Afati për të paraqitur propozimin për kundër përmbarrim i përcaktuar me paragrafin 3 të nenin 54, nënkupton se nëse tani debitori nuk paraqet propozim për kundër përmbarrim brenda këtij afati, e që në rastin konkret kemi afatin subjektiv 15 ditor dhe afatin objektiv 1 vjeçar atëherë debitorit i humb e drejta për të kërkuar kundër përmbarrimit sipas rregullave të procedurës përmbarrimore, por duhet të fillojë procedurën kontestimore për realizimin e kërkesës së tij.

SHTYRJA, PEZULLIMI DHE PËRFUNDIMI I PËRMBARRIMIT

Me dispozitat ligjore nga neni 60 deri në nenin 66 janë përcaktuar rregullat që përcaktojnë kushtet dhe procedurën me rastin e shtyrjes së përmbarrimit, pezullimit dhe përfundimit të procedurës së përmbarrimit. Nga vet emërtimi shtyrje, nënkuptohet kërkesa e palës apo personit të tretë për shtyrje të përmbarrimit.

Kush ka të drejtë të paraqes kërkesë për shtyrje të përmbarrimit?

Kërkesën për shtyrje të përbarimit sipas ligjit mund ta parashtrijë kreditori, debitori dhe personi i tretë. Parimisht koha maksimale që mund të përcaktohet për shtyrje të përbarimit është periudha kohore 6 mujore, me një përjashtim që nëse kreditori dhe debitori merren vesh për pagesë me këste të kredisë, shtyrja vlen deri në momentin e njoftimit të organit përbarues nga ana e kreditorit se debitori nuk po e respekton marrëveshjen, respektivisht kushtet e saj, e që mund jetë vonesa në pagesë të kësteve apo mos pagesa e kësteve etj.

Për dallim nga shtyrja e përbarimit që ndodh kryesisht me kërkesë të palëve dhe personave të tretë pezullimi i procedurës mund të ndodhë për rrethana të përcaktuara si në nenin 65 dhe pezullimi bëhet sipas detyrës zyrtare. Rrethanat apo kushtet që duhet të plotësohen për pezullimin e përbarimit janë:

“1. Përveç nëse parashihet ndryshe me këtë ligj, përbarimi pezullohet sipas detyrës zyrtare në këto rrethana:

“1.1. kur debitori apo pasuritë e tij nuk mund të gjenden për qëllime të njoftimit dhe sekuestrimit të pasurisë brenda tre (3) muajve nga fillimi i rastit të përbarimit, përkundër faktit se janë bërë së paku dy (2) tentime nga organin përbarues që të gjej atë person për qëllime të njoftimit apo sekuestrimit të pasurisë;

1.2. kur është tentuar nga organi përbarues që të zbatohet përbarimi i vendimit së paku dy (2) herë pa arritur asnjë rezultat të synuar nga këto veprime;

1.3. kur adresa e debitorit e dhënë në propozimin për përbarim vërtetohet se është e pasaktë ndërsa kreditori nuk mund të argumentojë para organit përbarues saktësinë e adresës.

2.Procedura e pezulluar me konkluzion nga paragrafi 1. i këtij neni mund të vazhdojë nëse kreditori në afatin prej gjashtë (6) muajsh paraqet informata të reja lidhur me çështjen e pezulluar, në të kundërtën procedura konsiderohet e përfunduar.”

Shabllon i vendimit për pezullim të Procedurës

CP.nr.../2013

GJYKATA THEMELORE NË _____, si përbarimore, me Gjyqtarin individual N.N, në çështjen përbarimore të kreditorit; X.X. në Prishtine, kundër debitorit Y.Y Rr. Brigada 142 p/n _____, lidhur me pagesën e borxhit në shumë prej 110.70 € me dt: __.__.2017 nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

PEZULLOHET procedura përmbarimore e kërkuarit të përmbarimit X.X në _____ ndaj të debitorit Y.Y Rr. Brigada 142 p/n _____, lidhur me pagesën e borxhit për shkak se është i pa mundur procedimi i mëtutjeshëm.

A r s y e t i m

Kreditori X.X në _____, ka ngritur propozim për përmbarim të borxhit në emër të shfrytëzimit të shërbimit _____ në shumë prej 110.70 €, kundër debitorit Y.Y Rr. Brigada 142 p/n _____.

Gjykata Themelore në _____ me aktvendimin numër Cp.nr.____.____ e ka lejuar përmbarimin me date _____.2017.

Gjykata, pas lejjimit të përmbarimit, aktvendimin mbi lejimin e përmbarimit ia ka ekspeduar debitorit të përmbarimit Y.Y Rr. Brigada 142 p/n _____, mirëpo nga flet kthesa me date _____.2017 konstatohet se pala është e pa njohur dhe adresa e pa mjaftueshme.

Gjykata me anë të konkluzionit me datë _____.20.. ka kërkuar nga kreditori adresën e saktë të debitorit duke e njoftuar se nëse nuk veproni konform konkluzionit procedura përmbarimore do të pezullohet, të cilin konkluzion e ka pranuar kreditori me datë _____.2017.

Gjykata me datë _____.2017 ia ka ekspeduar aktvendimin për lejimin e përmbarimit debitorit Y.Y Rr. Brigada 142 p/n _____, për të dytën herë mirëpo nga flet kthesa me date _____.20__ konstatohet se pala është e pa njohur e po ashtu adresa e pa mjaftueshme.

Pasi që kreditori nuk ka vepruar konform konkluzionit duke mos kthyer përgjigje për adresën e saktë të debitorit, gjykata duke u bazuar në nenin 65 të LPP-së i cili flet për Pezullimi i procedurës së përmbarimit ma saktësisht par 1.3 i cilit thonë citoi “ *Përveç nëse parashihet ndryshe me këtë ligj, përmbarimi pezullohet sipas detyrës zyrtare në këto rrethana: “ kur adresa e debitorit e dhënë në propozimin për përmbarim vërtetohet se është e pasaktë ndërsa kreditori nuk mund të argumentojë para organit përmbarues saktësinë e adresës”*, e në rastin konkret edhe pse gjykata ka tentuar dy here që t’ia dorëzoj debitorit propozimin për përmbarim së bashku me aktvendimin për lejimin e përmbarimit, mirëpo nga flet kthesat është konstatuar se pala është e panjohur në këtë adresë, gjithashtu kreditori nuk i është përgjigjur konkluzionit të gjykatës në raport me adresën e debitorit, çka për gjykatën nuk ka mundur ta argumentoj adresën e saktë të debitorit Y.Y Rr. Brigada 142 p/n _____, andaj e PEZULLOJ procedurën përmbarimore në këtë çështje juridike.

Gjykata, duke u bazuar në nenin 65 par 2 të LPP-së I cili thotë citoi “*Procedura e pezulluar me konkluzion nga paragrafi 1. i këtij neni mund të vazhdojë nëse kreditori në afatin prej gjashtë (6) muajsh paraqet informata të reja lidhur me çështjen e pezulluar, në të kundërtën procedura konsiderohet e përfunduar*”

Andaj nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi e në vështrim të nenit 65 par 1.3 dhe par 2 të LPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË _____
CP.nr..../2013 me dt. __. __. 2017

Gjyqtari
N.N

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar e drejta në ankesë në afatin prej 7 ditësh prej ditës së marrjes së të njëjtit, Gjykatës e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.

PËRFUNDIMI I PROCEDURËS SË PËRMBARIMIT

Përfundimi i procedurës së Përmbarrimit nuk ndodhë vetëm në rastin e përmbarrimit me sukses të procedurës dhe realizimit të kërkesës apo kredisë së kreditorit, por deri te përfundimi mund të vijë edhe për shkaqe tjera. Përfundimi i procedurës pas përmbushjes së kredisë së kreditorit do të ishte përfundimi më i dëshiruar i të gjithëve, sepse në këtë mënyrë një procedurë e filluar do të arrihej të përfundonte suksesshëm dhe do të nënkuptonte realizimin e një të drejte. Me nenin 66 janë përcaktuar rastet e përfundimit të procedurës:

“1. Në qoftë se me këtë ligj nuk është paraparë ndryshe, përmbarrimi do të përfundojë sipas detyrës zyrtare në qoftë se dokumenti përmbarrimor është anuluar, ndryshuar, shfuqizuar, apo në ndonjë mënyrë tjetër është bërë i pa efekt, apo në qoftë se vërtetimi për përmbarrueshmërin e tij anulohet me vendim të formës së prerë. Përmbarrimi do të mbarojë gjithashtu sipas detyrës zyrtare nëse një rast është pezulluar dy (2) herë dhe përherë i plotëson kriteret për pezullim siç përcaktohet në paragrafin 1. neni 65. të këtij ligji.

2. Përmbarrimi do të përfundohet sipas detyrës zyrtare edhe kur në pajtim me dispozitat ligjore me të cilat rregullohen marrëdhëniet detyrimore, personi i tretë e përmbushë obligimin në dobi të kreditorit në vend të debitorit.

3. Përmbarrimi do të përfundohet edhe kur ai është bërë i pamundshëm apo kur nga shkaqe të tjera nuk mund të zbatohet, si dhe pas kalimit të afatit absolut të parashkrimit për përmbarrim.

4. Pas përmbushjes se kredisë se kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbarrimore.”

Shabllon i vendimit të përfundimit të procedurës

GJYKATA THEMELORE NË _____, përmes gjyqtarit individual N.N dhe me bashkëpunëtorin profesional S.S, në lëndën përbarimore të kreditorit X.X nga _____, të cilën me autorizim e përfaqëson av. _____, ndaj debitorit _____ jashtë seancës gjyqësore me datë __.__.2021, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDOHET procedura përbarimore e kreditorit X.X nga _____, ndaj debitorit Y.Y nga _____, që zhvillohet në Gjykatën Themelore në _____, në bazë të aktvendimit CP.nr.../2020 të datës __.__.2021.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e kësaj gjykate CP.nr.../2020 të datës __.__.2021 është caktuar përbarimi sipas propozimit të kreditorit X.X nga _____, ndaj debitorit Y.Y nga _____.

Me shkresën e datës __.__.2021, përfaqësuesi i kreditorit av. _____ ka njoftuar Gjykatën se procedura përbarimore e inicuar me datë __.__.2020 në bazë të propozimit për përbarim i evidentuar si CP.nr.../2020 është përbaruar në tërësi.

Gjykata duke u bazuar në nenin 66 të LPP-së, i cili flet për përfundimin e procedurës përbarimore më saktësisht paragrafi 4 i po të njëjtit nen thotë citoi “*Pas përmbushjes së kredisë së kreditorit nxjerret vendim për përfundimin e procedurës përbarimore*”, e nga të lartëcekurat pasiqë borxhi është paguar në tërësi e PËRFUNDOJ procedurën përbarimore. Nga arsyet e cekura si më lartë, e konform nenit 66 paragrafi 4 të LPP-së (Ligjit të Procedurës Përbarimore) është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË _____

CP.nr.../2020, datë __.__.2021

GJYQTARI

N.N

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa brenda afatit 7 ditor nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

GJYKATA THEMELORE NË _____, përmes gjyqtarit individual N.N, në lëndën përbarimore të kreditorit X.X, ndaj debitorit Y.Y Rr. Qlirimi p/n _____, jashtë seancës gjyqësore me datë __.__.2017, bjen këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDOHET procedura përbarimore e kreditorit X.X, ndaj debitorit Y.Y Rr. Qlirimi p/n _____, që zhvillohet në Gjykatën Themelore në __, në bazë të aktvendimit E.nr..../2010 i dt: __.__.2015.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e kësaj gjykate E.nr..../2010 i dt: __.__.2015 është caktuar përbarimi sipas propozimit të kreditorit X.X nga _____, ndaj debitorit Y.Y nga _____.

Pas lejitimit të përbarimit, debitori e ka paguar borxhin në tërësi me datë __.__.2017.

Gjykata duke u bazuar në nenin 66 të LPP-së, i cili flet për përfundimin e procedure përbarimore ma saktësisht par 4 i po të njejtë nen thotë citoi “*Pas përmbushjes së kredisë së kreditorit nxjerret vendim për përfundimin e procedure përbarimore*”, e nga të lartëcekurat pasiqë borxhi është paguar në tërësi e PËRFUNDOJ procedurën përbarimore.

Nga arsyet e cekura si më lartë, e konform nenit 66 par 4 të LPP-së (Ligjit të Procedurës Përbarimore është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË _____

E.nr..../2010 me dt. __.__.20__

GJYQTARI

N.N

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa brenda afatit 7 ditorë nga dita e pranimit të kërrij aktvendimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

Procedura Përbarimore, si procedurë e veçantë, edhe pse është më tepër procedurë formale, sepse edhe qëllimi i kësaj procedure është ekzekutimi i kërkesave të palëve të parapara me dokumente

përmbare apo dokumente tjera të besueshme. Organi përmbareues gjatë gjithë procedurës duhet të kujdeset maksimalisht që procedura të udhëhiqet nga urgjenca e veprimt, në mënyrë që kërkesat e palëve të përmbareohen në kohë sa më të shpejtë dhe sa më efikase.

Procedura përmbare dallohet nga procedurat tjera, pasi kontestimi që i bëhet kërkesës së kreditorit nuk është i njëjtë me kontestimin në procedurën kontestimore. Parimisht kërkesat që paraqiten në këtë procedurë ishte dashtë me qenë kërkesa ta pa kontestueshme në kuptimin e përmbajtjes së tyre, por të njëjtat do të mund të kontestoheshin nga shkaqe tjera të veçanta që parashihen në këtë procedurë. Ajo që ndodh në praktikë është se parimin e rigorozitetit formal, apo shqyrtimit formal të propozimit për përmbare një pjesë e profesionistëve ligjorë e keqkuptojnë duke mos dhënë përgjigje në prapësime të bazuara dhe përgjigjet e dhëna janë përgjigje të natyrës jo përmbajtësore duke deklaruar se pikërisht duke u mbështetur në këtë parim, dokumentin përmbare duhet ekzaminuar vetëm formalisht. Këtu me të drejtë parashtrohet një pyetje çka nënkupton ekzaminimi formal i dokumentit që është objekt përmbareimi?

Ligdhënësi me rastin e hartimit të Ligjit të Procedurës Përmbare, ligjin e ka sjellë në frymën e tillë që të mund të shërbej për rregullimin adekuat dhe efikas të kësaj procedure, mirëpo praktika jonë juridike, dhe rastet e shumta dhe të shumëllojshme që paraqiten na detyrojnë që ekzaminimin e dokumentit që është objekt kontesti sidomos dokumenteve të besueshme ta bëjmë edhe në drejtim pak më të thellë në kuptim të faktit se si derivon një dokument i tillë i besueshëm.

Numri i faturave dhe rrethi i personave fizik dhe juridik, bizneseve të ndryshme që lëshojnë fatura është i madh, e të njëjtat jo gjithmonë dhe gjithnjë lëshohen në përputhje me dispozita ligjore, determinojnë edhe sqarimin e rrethanës apo raportit juridik për bazueshmërinë e faturës. Fatura si dokument i besueshëm kur është paraparë si i tillë nuk është menduar se dikush mund ta keqpërdorë lëshimin e një dokumenti të tillë, andaj jo secila faturë parimisht pa përjashtim duhet të shikohet vetëm në ekzistimin e elementeve të saj, por edhe raportit që vërteton ajo. Fatura medoemos lëshohet me qëllim kompensimin e një borxhi që derivon nga një raport juridik në mes të palëve, andaj kontestimi i këtij raporti nënkupton edhe kontestimin e bazës së faturës.

Më lartë potencuam se keqkuptimi apo keqinterpretimi i parimit të rigorozitetit formal juridik shkon edhe në drejtim tjetër, që nga pothuajse secili rast në procedurën përmbare, për shkak të kontestimeve, shndërrohet faktikisht në procedurë kontestimore të vërtetimit të fakteve, edhe kjo përbën gabim në vetvete dhe keqkuptim. Procedura përmbare si e tillë është e veçantë dhe nuk është procedurë kontestimore. Seancat në procedurë përmbare nuk mbahen dhe caktohen kryesisht por përjashtimisht dhe është në diskrecion të gjykatës që të vlerësoj se a duhet të mbahet apo jo, nëse vlerëson se gjendja faktike apo ndonjë rrethanë cruciale për vendimmarrje duhet të vërtetohet në seancë. Marrja e provës në procedurë përmbare mund të bëhet përjashtimisht dhe jo parimisht siç po ndodh në shumë raste.

Bibliografia

Literatura e shfrytëzuar

I. LIBRA DHE ARTIKUJ SHKENCORË

Haxhi Gashi & Ruzhdi Berisha, “Komentari” Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Prishtinë 2014

Hamdi Podvorica, E Drejta Trashëgimore, Prishtinë 2006

Haxhi Gashi, Abdulla Aliu, Adem Vokshi, *Komentar i Ligjit për Familje të Kosovës*, Prishtinë, GIZ dhe Ministria e Drejtësisë. 2012

Dr. Faik Brestovci, E drejta e procedurës civile, Prishtinë 2002

Abdullah Aliu & Haxhi Gashi, E drejta Familjare, Prishtinë, 2007

Gani Oruçi, Ligjerat të autorizuara, E Drejta Familjare, Prishtinë

Hamdi Podvorica, E drejta Familjare, Prishtinë, 2011

Arta Mandro, E Drejta Familjare, Tiranë, 2009

Valon Murati & Qerkin Berisha, Roli i Edukimit në Parandalimin e Delikuencës së të Miturve Prishtinë, 2009

Editor: Wolfgang Benedek, Kuptimi i të Drejtave të Njeriut, Wien-Graz 2009

Gudmund Alfredsson & Asbjorn Eide, Deklarata Universale mbi të Drejta e Njeriut/ Standard i arritjes së Përbashkët, Holandë 1999

Bardhyl Hasanpapaj & Vjosa Osmani, Fëmijët e rrugës në Kosovë, Prishtinë, 2004

Enver Hasani & Ivan Cukalovic, “Komentar” Kushtetuta e Republikës së Kosovës, botimi I, Prishtinë 2013

Marek Antoni Nowicki, Rreth Konventës Evropiane, Tiranë 2003

Bedri Bahtiri, Aspektet Nacionale dhe Ndërkombëtare të Regjimit Pasuror Martesor të Bashkëshortëve, Prishtinë 2018

Gani Uruçi, Doracak për të Drejtën Familjare dhe Trashëgimore, 2011

Praktika e Gjykatës së Apelit e Fokusuar në Çështjet e Kthyerat në Rishqyrtim, Prishtinë, 2019

Pollock, Frederick & Wright Rober Samuel, An Essaz in Possession in Common Law, Oxford, Clarendon Press, 1888

Isa Kelmendi, Padia për mbrojtjen nga akti i pengim posedimit, material trajnimi, IGJK 2013

Ivo Puhan.....

Dr. A. Mandro, E Drejta Romake, Tiranë 1998

Altin Shkurti, Disertacion për mbrojtjen e gradës shkencore „Doktor ‘’, në temën Posedimi dhe Mbrojtja e tij, Tiranë Tetor 2015

E Drejta Civile, pjesa e dytë, SENDET, 2007/036, Prizren-Kosovë

Faik Brestovci, E drejta Procedurale Civile II, Prishtinë, 2006

Skender Gojani & Granit Curri, E Drejta Kontraktore, Prishtinë, 2020

Komentari i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve i Kosovës, Libri I, Prishtinë 2013

Dr. Nerxhivane Dauti, E drejta e detyrimeve, Pjesa e përgjithshme dhe e veçantë, Prishtinë, 2007

Dr. Abdulla Aliu, E Drejta Civile, Pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2013

Geoffrey Samuel. PhD, Law of Obligations and Legal Remedies, Second Edition, London, 2001

Dr. Mariana Tutulani-Selimi, E drejta e detyrimeve dhe e Kontratave, Tiranë, 2006

Francesco Galgano, E Drejta Private, Tiranë, 2006

Catherine Elliott & Frances Quinn, Tort Law, Seventh Edition, London, 2009
Vivienne Harwood, Modern Tort Law, Seventh Edition, London and New York
Irir Hoti, Industria e Sigurimeve dhe Menaxhimi i Rrezikut, Tiranë, 2008
Dr. Mehdi Hetemi, E Drejta me Njohuritë Themelore të së Drejtës Afariste, Prishtinë, 2002
Alajdin Alishani, E drejta e detyrimeve
Enver Hasani, *Ne Bis In Idem në Procedurën Kontestimore*, Prishtinë, 2009
Faik Brestovci, *E Drejta Procedurale Civile I*, Prishtinë 2006
Iset Morina & Selim Nikçi, *Komentari i Ligjit për Procedurën Kontestimore*, Prishtinë 2012
“Praktikum za parnicu”, Vukasin Ristic, Milosin Ristic, Beograd, 2000
Mendimi juridik i Gjykatës Supreme të Kosovës nr.217/13, i datës 25.03.2013
Organi i Kujdestarisë në kuadër të Qendrave për Punë Sociale

Bashkim Hyseni, Albert Zogaj & Fejzullah Hasani, *Doracaku i Gjyqtarëve për Shkrimin dhe Arsyetimin Ligjor*, Prishtinë 2017

II. AKTE NORMATIVE / INSTRUMENTE NDËRKOMBËTARE

Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje.

Udhëzimit Administrativ Nr.02/2013, për mënyrë e trajtimit të kryerësve të dhunës në familje ndaj të cilëve është shqiptuar masa e trajtimit të obligueshëm mjekësor nga varësia e alkoolit dhe substancave psikotrope

Kodi Penal i Republikës së Kosovës NR. 04/L-082

Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje

Ligjit për Shërbimet Sociale dhe familjare nr. 02/L-17, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-081.

Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare, Ligji Nr. 02/L-17

Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore

Ligji Nr. 04/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore

Ligji Nr. 2004 / 26 për Trashëgiminë i Kosovës

Ligji Nr. 03/L-007 për Procedurën Jokontestimore

Ligji Nr. 06/L-007 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-007 për Procedurën Jokontestimore

Ligji Nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës

Ligji Nr. 06/L - 054 për Gjykatat

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore

Ligji nr.03/L-199 për Gjykatat

Konventa për të Drejta e Fëmijës, e Kombeve të Bashkuara, 1989

Konventa e Gjenevës, 1949, protokollat shtesë

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 2004/32 për familjen i Kosovës

Ligji Nr. 03/L-212 i Punës

Ligji nr. 03/L-054 Për Pronësinë Dhe Te Drejtat Tjera Sendore
E Drejta Civile, pjesa e dytë, SENDET,2007/036, Prizren-Kosovë
Kodi Civil i Shqipërisë

Ligji nr. 04/L-139 për procedurën përmbartimore

LIGJI NR. 04/L-077 PËR MARRËDHËNIET E DETYRIMEVE

Ligji Nr.04/L-018 Për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia
Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Kodi i Etikës Profesionale për Gjyqtarët, miratuar me vendimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës
(KGJK) nr.20/2016, datë 02.03.2016, i ndryshuar me vendimin e KGJK-së, nr.50/2016, datë
11.05.2016, në fuqi nga data 01.09.2016

Rregullorja 04/2016, Për Sjelljet e Pahijshe, miratuar me vendimin e KGJK-së, nr.21/2016,
datë 02.03.2016, në fuqi nga data 01.09.2016

Ligji NR. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale

Ligji për Avokaturën Publike (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.9/83)

Ligji nr.04/L-157 për Avokaturën Shtetërore, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.8, e
datës 08.04.2013

Ligji i vjetër i LPK-së, i ish RSFJ-së

Ligji për Noterinë

III. STATISTIKA / VENDIME GJYQËSORE

Aktvendimi C.nr. 2550/1, i datës 02.12.2011, Gjykata Themelore në Prishtinë.

Aktvendimi Ac.nr.153/18, i datës 05.02.2018, Gjykata e Apelit të Kosovës

Aktvendimi Ac.nr.39933/17, i datës 14.09.2017, Gjykata e Apelit të Kosovës

Aktvendimi Ac.nr.2330/17, i datës 14.06.2017, Gjykata e Apelit të Kosovës

Aktvendimi Ac.nr.1637/17, i datës 24.01.2017, Gjykata e Apelit të Kosovës

Aktvendimi Ac.nr. 3363/16, i datës 20.09.2016, Gjykata e Apelit të Kosovës

Aktvendimi C.nr.2808/17, i datës 24.10.2017, Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i
Përgjithshëm

Vendimin Ac.nr.115/17, i datës 19.01.2017, Gjykata e Apelit të Kosovës

Aktvendimi AC.nr.2156/17, i datës 07.06.2017, Gjykata e Apelit të Kosovës

Aktgjykimi C.nr.2784/11, i datës 21.01.2013, Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i
Përgjithshëm

Aktgjykimi Ac.nr. 3533/13, i datës 12.05.2016, Gjykata e Apelit të Kosovës

Aktgjykimi C.nr.2302/11, i datës 08.02.2013, Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i
Përgjithshëm.

IV. LINQE

Vana Jerliu Ramadani: Divorcet rrezikojnë të ardhmen e familjes/

<http://www.zemrashqiptare.net>

Robin Leonard & Stephen Elias, “ Child Custoday” <http://www.lectal.com>

Akademia e Drejtësisë
<https://ad.rks-gov.net>
infoad@rks-gov.net
Rr."Muharrem Fejza"-Prishtinë
Tel:+383 38 200 18 660

